



SI PËR QËLËNTRIMIN E TIRANËS E TË RE
HONORARI

ENVER HOXHA

DITAR

PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE

(1975-1976)

8

TIRANË, 1984

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

LIBRI I DITË

DITË

LIBRI I DITË

(1975-1976)

LIBRI I DITË

1975

E PREMTE
17 JANAR 1975

SHTRAUSI MIK I MAO CE DUNIT

Agjencia HSINHUA njoftoi se Mao Ce Duni priti dje kryetarin e Bashkimit Kristian-Social të RF të Gjermanisë, Franc Jozef Shtraus, përkrasësin më të vendosur të nazizmit hitlerian e një nga militaristët më të egër gjermanë. Në takim ishte edhe nënkryetari i Këshillit të Shtetit, Ten Hsiao Pin.

Gjithnjë e më thellë po ecën udhëheqja kineze në rrugën e saj të çuditshme e të çoroditur!

SHËNIM

Shokët më vunë në dijeni për punët në ushtri; për delegacionin kinez të studimit ekonomik që ikën nesër me përshtypje të mira; për çështjet e brendshme ekonomike që ecin mirë.

Shkëmbyem mendime edhe mbi ngjarjet e jashtme, sidomos mbi marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

TEN HSIAO PINI GRADOHET

Kinezët njoftuan sot zyrtarisht se Plenumi i 2-të i KQ të PK të Kinës zgjodhi Ten Hsiao Pinin nënkryetar të Komitetit Qendror dhe anëtar të Komitetit të Përherëshëm të Byrosë Politike të Partisë.

Teni po i ngjitet shkallët përsëri.

VDIQ BABAI I EMIN DURAKUT

Sot mësova me hidhërim të thellë se në Gjakovë ka vdekur miku im i respektuar, patrioti Rexhep Duraku, babai i komunistit veteran Emin Duraku. I bëra telegram familjes.

IMPERIALIZMI AMERIKAN DHE AI SOVJETIK PËRGATITIN LUFTËN E TRETË BOTËRORE, POR EDHE I TREMBEN ASAJ

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik vazhdojnë të armatosen në mënyrë të hapët e me arrogancë, pa përfillur opinionin publik botëror. Ata janë gati t'i hidhen në grykë njëri-tjetrit dhe të tjerëve, njërit pas tjetrit. Vazhdon armatosja dhe çdo ditë që kalon duket më shumë psikoza e shfrenuar e luftës. Të dyja superfuqitë kanë vënë në gatishmëri e në lëvizje çdo gjë, forcat e tyre të armatosura në dete e në oqean, në portet e ndryshme të tyre dhe në baza detare të vendeve të treta, të marra me qira ose të grabitura me forcë. Sapo një flotë e mbiujshme ose e nënujshme e ndonjë superfuqie del në ndonjë det ose oqean, aty përnjëherë ia mbërrin edhe flota e superfuqisë tjetër. Këto flota bëjnë politikën e kanonierave kundër atyre vendeve të treta, udhëheqësit e të cilave ose duan të çlirohen nga kthetrat e këtyre dy armiqve të egër, ose përpiqen të heqin njërin zinxhir për të rënë nën zinxhirin tjetër, që i jep më shumë dollarë apo rubla. Këto flota agresive detare dhe ajrore në dete e në baza të ndryshme u përngjasin atyre sharonjarëve¹ që fluturojnë mbi kufomat e të vrarëve në fushat e betejës. Ato janë të gatshme dhe mbështetin po-

¹ Charognards (frëngjisht) — zogj që ushqehen me kufoma.

litikën agresive të qeverive të tyre, presin sinjalin e veprimit të diplomacisë agresive, që është shndërruar në një spiunazh të shfrenuar, në një tregtar për të blerë dhe për të korruptuar ata që janë të korrupueshëm në vende të ndryshme, të cilët i përdor për të ushtruar atje influencën, intrigën, korrupsionin, «luftën civile» dhe të tjera komplete.

Të dyja superfuqitë janë kthyer në tregtarë armësh aq të tmerrshëm, saqë Armstrongët, Mauzerët, Bazil Zaharovët e së kaluarës, po t'i krahasosh me këta të sotmit, duken si shitës të lojnavë të kalamanëve. Por këto armë shiten, natyrisht, për llogaritë e tyre, për të mbrojtur nga gjithsecili interesat e tyre strategjike dhe për t'i vënë blerësit e këtyre armëve në luftë me njëri-tjetrin.

Të marrim një nga sheshet e betejës: Lindjen e Mesme. Këtu një numër shtetesh arabe janë në grindje e në mosmarrëveshje haptazi me Izraelin. Por, në realitet, në këtë rajon në grindje janë të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, për zona influence, për naftën, për sigurimin e rrugëve imperiale, për depërtimin në kontinentin e Afrikës e të Azisë për të siguruar tregje shfrytëzimi, shkatërrimi dhe për skllavërim qytetërimesh dhe popujsh. Qeverive dhe klikave reaksionare të këtyre vendeve, të përgatitura nga diplomacia e tyre e agresionit, u shesin vetëm armë dhe u rrëmbejnë bukën e gojës. Kush të kërkojë më shumë armë dhe kush të shesë më shumë! Vendet e naftës janë krimbur me dollarë dhe me këto blejnë armë nga Bashkimi Sovjetik, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Franca, nga Anglia dhe nga kush ka t'u shesë. Po për kë i blejnë këto armë? Për të shtypur popullin e tyre, për të goditur popuj të tjerë dhe për të ndihmuar gjithsecili padronin e tij. Egjipti hedh valle në litar. Sadati lidhet me Brezhnëvin dhe merr armë prej tij, pastaj zemërohet me të dhe lidhet me «vëllanë» Kisinger, i cili është vëlla edhe me

Izraelin, që me Egjiptin është në luftë. Kisingeri kështu ka dy «kuaj» dhe manovron. Rusi e ka «grurë» me Sirinë, e cila merr armë prej tij dhe është pizmosur me Egjiptin, që e ka mirë me mbretin e Arabisë Saudite dhe ky nuk e ka keq me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që mbrojnë Omanin dhe kanë ndërtuar baza atje. Omani ka miqësi dhe mbrohet nga shahu i Iranit, i cili është në konflikt me Irakun, që është edhe prosovjetik, edhe antijordanëz, që është proamerikan, antiegjiptian dhe kundër Organizatës për Çlirim të Palestinës, pra është me të gjithë dhe kundër të gjithëve etj., etj. e kështu mund të vazhdojmë gjatë. E gjithë kjo që them është pasqyrë reale e politikës në Lindjen e Mesme.

Ç'po ngjet në Mesdhe?

E njëjta gjë. Kolonelët e Athinës bënë puç në Qipro të shtyrë nga CIA. Dështuan edhe ata, edhe amerikanët. Bashkimi Sovjetik «mbrojti» Qipron dhe «inkurajoi» Turqinë. Kjo sulmoi Qipron dhe u vendos atje, Greqia u zemërua keq për këtë, po s'kishte ç'të bënte. Ajo kërcënoi NATO-n dhe doli «përgjysmë prej saj». Shtetet e Bashkuara të Amerikës u zemëruan me Greqinë, rusi e la Turqinë dhe e ktheu fytyrën me buzëqeshje cinike nga Greqia. Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i frikësuar se rusi po futej në Greqi, mori një vendim që t'ia priste Turqisë furnizimet me armë. «Të jap unë armë», i tha kësaj rusi. Mirëpo meqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës rrezikoheshin në të dyja tablotë, atëherë organizuan, tash së fundi, me CIA-n një puç të ri «të vogël» sa për paralajmërim kundër Karamanlisit dhe pro Papadhopollosit. Ky puç dështoi, por duhen pritur të tjerë që do të vijjnë pas, pse as në Turqi, as në Greqi, as në Bullgari, as në Rumani, as në Jugosllavi nuk ka qetësi, nuk ka asnjë stabilitet. Mbi të gjitha këto vende sundojnë dy egërsira të armatosura deri në dhëmbë, që në gjak

nuk kanë veç luftën grabitqare, intrigën, shtypjen, agresionin.

Bota zien mbi një vullkan dhe vetëm rezistenca e vendosur e popujve e shpëton njerëzimin nga këto dy kuçedra e nga këto intriga.

E MARTË

1 PRILL 1975

FORMIMI DHE ZHVILLIMI I BORGJEZISË SË RE TITISTE JUGOSLLAVE

Procesi i zhvillimit kapitalist në Jugosllavi ka krijuar kontradikta midis procesit të bashkimit ekonomik të popujve të ndryshëm me nacionalitete të ndryshme të këtij vendi. Vetadministrimi, duke filluar që nga ai i ndërmarrjeve të vogla, deri tek ato të mëdhatë, nuk është veçse një formë kapitaliste e drejtimit të ekonomisë. Të gjitha ndërmarrjeve që vetadministrohen u janë lënë kompetenca të mëdha decentralizuese dhe u është caktuar një formë shumë e zbehtë ose fare e paqenë centralizuese. Këto ndërmarrje vetadministruese kanë krijuar një burokraci dhe një teknokraci të atillë, sa jo vetëm që nuk mund të ecin përpara, por ato punojnë për të krijuar fitime legale dhe ilegale për kastën burokratike.

Superfuqitë kapitaliste, që kanë investuar kapitale me qëllime kolonialiste në Jugosllavi, nuk mund ta bënin një gjë të tillë, në qoftë se nuk do të kishin mbështetjen politiko-ideologjike të regjimit të vendit. Por edhe kjo nuk mund të ishte e mjaftueshme për ta, në rast se ekonomia nuk organizohej dhe nuk drejtohej me forma kapitaliste. Kapitalistëve të huaj investitorë nuk u interesonte se si do ta mbiquanin titistët këtë organizim të ekonomisë. Atyre u interesonte natyra dhe funksioni i këtij sistemi, që t'u siguronte investimet dhe fitimet dhe të krijonte stabilitet për ta në ndërhyrjet politiko-ushtarake në këtë vend.

Organizimi kapitalist i ekonomisë jugosllave nuk mund të mos ndiqte rrugën shoviniste nacionaliste, për arsye se kasta burokratike qoftë në planin e brendshëm, qoftë në atë të jashtëm nuk mund t'u nënshtrohej ligjeve të klasës punëtore, internacionalizmit të saj. Partia në Jugosllavi nuk ishte më një parti e klasës punëtore. Atje sundonin revizionistët, matrapazët, mashtruesit, kasta e borgjezisë së re në ekonomi, në ushtri, në kulturë, në arsim. Nuk ekziston frymë proletare as në ekonomi, as në politikë, as në ideologji. Çdo gjë është borgjezuar, fashistizuar. Nacionalizmi borgjez u bë detyrimisht ideologjia dominuese. Kjo gjendje ka krijuar elementët e përçarjes së kombësive dhe «uniteti», në qoftë se ekziston dhe në qoftë se mund të ekzistojë edhe më vonë, nuk është në baza socialiste, proletare, marksiste-leniniste, por ai është një unitet në baza kapitaliste, me kontradikta armiqësore në mes popujve që formojnë federatën. Ky farë uniteti mund të ekzistojë dhe të mbahet, natyrisht, me forcë, pse disa popuj do të dominohen nga kasta më të forta, që do të bëjnë ligjin mbi popujt e tjerë. Jugosllavia titiste mund «të rrojë» në federatë, por ajo është një federatë e varfër, është si një lopë që milet nga shumë duar dhe së cilës i kanë dalë brinjët. Prandaj sistemi i vet-administrimit i shtyn republikat e ndryshme drejt armiqësisë dhe drejt kërkesave të kapitaleve të huaja. Kjo do të thotë se klikat kapitaliste shoviniste thërresin robërinë ekonomike të vendit, robërinë politike, zhdukjen e lirive dhe të drejtave demokratike, shtypjen e klasës punëtore, zhdukjen e frymës internacionaliste dhe izolimin e klasës punëtore jugosllave nga klasa punëtore ndërkombëtare dhe nga revolucioni botëror. Titoja e ktheu Jugosllavinë në një rezervë të borgjezisë kapitaliste botërore. Borgjezia titiste nuk mund ta gjejë rrugën e unitetit nacional. Kjo borgjezi mund të përdorë terma të majtë, por rruga e saj nuk është veçse «uniteti» nationalist serbo-

-kroat i carit Aleksandër, i veshur me rrobat e kohës së pas Luftës së Dytë Botërore.

Derisa borgjezia e re titiste jugosllave vendosi në Jugosllavi pushtetin e kapitalit, me këtë ajo vendosi edhe shtypjen e kombësive, nuk njihte më *de facto* barazinë në mes kombësive dhe zhduku mundësinë e bashkëpunimit dhe të vëllazërimit vullnetar të tyre. Parulla «bashkim-vëllazërim» jo vetëm nuk dëgjohet më, dhe ka arsye të thella që s'dëgjohet, por, edhe kur e thonë ndonjëherë, ajo ka mbetur një slogan anakronik dhe pa përmbajtje. Politika e titistëve nuk është veçse një politikë gjysm-imperialiste, në pamundësi të bëhet e plotë, se nuk ka «këllqe».

Borgjezia e re titiste noton në kontradikta. Nga njëra anë, ajo nuk mbahet dot në fuqi pa u bërë zonë influencë e njërës ose e tjetrës superfuqi, nga ana tjetër, e zhytur në borxhe e në detyrime, kërkon të hiqet si e parvarur dhe të ruajë federatën nga goditjet e mundshme të njërës ose të tjetrës superfuqi. Borgjezia titiste nxiti nacionalizmin dhe shturi unitetin e kombësive, nga ana tjetër, kërkon ta forcojë këtë unitet në rrugën kapitaliste.

Borgjezia titiste me vet-administrimin shturi unitetin ekonomik të federatës dhe, në të njëjtën kohë, siç doli nga një intervistë e kohëve të fundit e Ljubiçicit, ministri i Mbrojtjes i Jugosllavisë, po bën thirrje për «unitetin ushtarak kundër rrezikut që na kërcënon nga dy superfuqitë». Kështu Jugosllavia bëhet një vend që do të ndjellë rreziqe dhe andrralla për ne, prandaj duhet të jemi vigjilentë.

Borgjezia titiste nuk e ka harruar shovinizmin serbo-madh. Ajo s'e ka luftuar dhe këtë nuk mund ta bëjë dot, por përpiqet ta kundërbalancojë me atë kroatomadh. Borgjezia luan në litar, si në platformën e brendshme me serbët e kroatët, ashtu edhe në platformën e jashtme me Bashkimin Sovjetik dhe me Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës. Është e qartë se mbeturinat e vjetra të Karagjorgjeviçëve dhe të Maçekëve janë plotësisht të gjalla te titistët. Derisa këto tendenca ekzistojnë dhe ushqehen nga borgjezia titiste dhe mbështeten me politikën, me ideologjinë antimarksiste dhe me ekonominë kapitaliste, nuk mund të ketë as barazi, as unitet në mes popujve të Jugosllavisë.

Si mund të ekzistojë kjo barazi, kur Kosova me popullsi shqiptare shtypet e gjakoset dhe shqiptarëve në Jugosllavi nuk u jepeshin e nuk u jepen nga titistët të drejtat e tyre kombëtare dhe demokratike? Si mund të ketë unitet, kur për shkak të vetadministrimit Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së prapambetur nuk u jepet asnjë ndihmë efektive ekonomike? Lënia pas dore nga ana kulturore e Kosovës nga funksionarët serbë, dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre për në Turqi, nuk tregon veçse atë që asgjë nuk kishte ndryshuar në mendjen e shovinizmit serb titist. Një nga personat që i shtypte kosovarët dhe që i gjakosi ishte Dushan Mugosha¹, kurse një nga ata që i mbronte ishte Miladin Popoviçi². Bor-

1 Erdhi në Shqipëri në verën e vitit 1941. Siç u vërtetua më pas ishte ngarkuar nga udhëheqja jugosllave për të zhvilluar punë agjenturore në radhët e komunistëve shqiptarë e të PKSH. Në pranverën e vitit 1943 rekrutoi si agjent të jugosllavëve Mehmet Shehun, të cilin e nxiti që të kryente akte terroriste e gabime të rënda sektare me qëllim që të përgatitej terreni për shtrembërimin e vijës së drejtë të PKSH, për goditjen e nënshtrimitin e udhëheqjes së saj.

2 Komunist internacionalist jugosllav, i cili u lirua nga komunistët shqiptarë në vjeshtë të vitit 1941 nga një kamp përqendrimi fashist në Shqipëri. Qëndroi në Shqipëri për të mbajtur lidhje midis PKSH dhe PKJ dhe përkrahu qëndrimin internacionalist të PKSH. Në shtator të vitit 1944, me urdhër të udhëheqjes së PKJ, u largua nga Shqipëria dhe, në mars të vitit 1945, u vra me atentat të kurdisur nga shërbimi i fshehtë jugosllav.

gjezia titiste të parin e bëri «hero të popujve të Jugosllavisë», të dytin «natën» e vrau me atentat, «ditën» e bëri hero.

Procesin e zhvillimit të Jugosllavisë duhet ta kemi vazhdimisht në vëzhgim të rreptë.

E MËRKURË
2 PRILL 1975

LUFTE TË PARESHTUR E TË ASHPËR KUNDËR SUPERFUQIVE TË ERRËSIRËS E TË GJAKUT

**Rreth fitores në Kamboxhia dhe në Vietnamin
e Jugut**

Lon Noli¹, kukull e amerikanëve dhe gjakatari i popullit të Kamboxhias, i thyer, i dërrmuar, i mundur u largua dje, me bisht në shalë, si kriminel lufte dhe si bandit nga Pnom-Peni me gjithë haremin, me 17 gjeneralë, me kryeministrin, me Sirik Matakun dhe me shumë kriminelë të tjerë.

Luftën e drejtë të popullit kamboxhian e ndihmoi me të gjitha forcat, politikisht, ideologjikisht e materialisht edhe Partia jonë e Punës dhe Republika Popullore e Shqipërisë. Ne kishim besim në fitoren e luftëtarëve kamboxhianë, derisa do të ndiqnin rrugën revolucionare pa kompromis.

Partia Komuniste e Kamboxhias, në përgjithësi, mbajti një qëndrim të drejtë në lidhje me politikën e frontit e ndaj Sihanukut, ndaj të cilit mund të mbante edhe qëndrim sektar. Një gjë e tillë mund të ndodhte fare lehtë, sepse Sihanuku jo vetëm ishte një princ e mbret, por edhe vrasës i komunistëve para se t'i uzurpohej pushteti. Mirëpo ngjarjet dhe koniunkturat bënë që amerikanët

¹ Mareshal, president kukull i Republikës Kmere.

dhe banda e Lon Nolit e rrëzuan Sihanukun dhe ky u armiqësua me ta. Në mes amerikanëve dhe Sihanukut u krijua kështu një kontradiktë e madhe, e cila duhej shfrytëzuar e thelluar. Në këtë mes nuk ishte vetëm vlera e Sihanukut si person, por sidomos e gjithë atyre masave në Kamboxhia që besonin tek ai dhe te dinastia mijëvjeçare e tij, te besimet fetare, mistike, doket etj. E gjithë kjo masë duhej hedhur në luftë, në revolucion, pse vetëm në këtë rrugë jo vetëm do të përmbysej klika gjakatare e Lon Nolit, por edhe do të tronditej besimi i masave në mitet e së kaluarës dhe do të mësoheshin ato të gjykonin ndryshe.

Pra, qenia e Sihanukut në unitet me luftën e popullit kamboxhian dhe në krye të frontit e lehtësonte ngri-tjen e masave në luftë. Prandaj ne me shokët e partisë së Kamboxhias dhe personalisht me Sihanukun e mbrojtëm këtë rrugë të drejtë. Nga ana tjetër, shokët kamboxhianë duhet të njohin se Sihanuku, me qëndrimet e tij, gjatë kësaj periudhe e ndihmoi luftën nacionalçlirimtare. Ai s'pranoi e nuk bëri asnjë bisedim politik as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as me klikën e Lon Nolit dhe as me revizionistët sovjetikë dhe jo vetëm që nuk pranoi, por të gjithë këta armiq i luftoi dhe i sulmoi me ashpërsi. Në momentet aktuale të Kamboxhias disa sjellje personale prej princërish nuk kanë rëndësi parimore përpara qëndrimit të patundur dhe të drejtë të Sihanukut kundër armiqve të tij. Në problemet e luftës e të qëndrimit ndaj armiqve faktet tregojnë se Sihanuku qëndroi shumë më lart se disa vietnamezë e laosianë. Po të don-te, ai mund të bënte edhe keq. Një kompromis nga ana e tij me armiqtë mund ta ndërlikonte luftën, si në planin e brendshëm, në Kamboxhia, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Po ai nuk e bëri këtë gabim, prandaj Partia Komuniste e Kamboxhias duhet ta ketë parasysh këtë qëndrim.

Ç'do të bëhet nesër me Sihanukun? Kjo varet nga Partia Komuniste e Kamboxhias. Në qoftë se ajo bën një politikë të zgjuar, natyrisht, duke i bërë Sihanukut edhe ndonjë lëshim të sipërfaqshëm që nuk pengon zbatimin e reformave revolucionare dhe ecjen përpara të revolucionit, ai mund të ecë në rrugën e re që duhet të nisë Kamboxhia. Aq sa ka rëndësi fakti që Sihanuku në kohën e luftës nuk u lidh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me reaksionin, po aq rëndësi ka që edhe pas luftës të evitohet shkëputja e tij nga Fronti. Rreziqe sigurisht ka, se eksperiencia jonë ka treguar që pas Çlirimit janë shkëputur nga Fronti ynë Nacionalçlirimtar Demokratik elementë të borgjezisë liberale dhe jo më të mos shkëputet një princ, si Sihanuku. Mirëpo kjo nuk duhet gjykuar *a priori*. Ne, nga ana jonë, elementëve të borgjezisë liberale u krijuam të gjitha mundësitë të bashkëpunonin ndershmërisht me Frontin për ndërtimin e Shqipërisë së re, por ata na tradhtuan. Një politikë e tillë afruese duhet të bëhet me Sihanukun. Jeta do të tregojë deri ku do të ecë ai me partinë dhe me Frontin.

Tash forcat e Frontit janë gati brenda në Pnom-Pen. Reaksioni po jep shpirt dhe është pikërisht në dridhmën e fundit para vdekjes. Kjo është një fitore e shkëlqyer e popullit kamboxhian, që ndihmon edhe luftën në Vietnamin e Jugut kundër Thieut.

Forcat çlirimtare të Vietnamit të Jugut, të ndihmuara edhe nga Vietnami i Veriut, ndërmeren ofensivën drejt Sajgonit, duke spastruar zonat, provincat, rrafshnaltat dhe bregun e detit që nga kufiri që ndahet në paralelin «e famshëm»¹, deri në drejtim të deltës së Mekongut. Forcat sajgoneze janë detyruar të tërhiqen. U

¹ Paraleli i 17-të.

çliruan kështu Hueja, Danangu, Kuantria, afër një e treta e Vietnamit të Jugut. Thieu kërkon ndihmën e amerikanëve dhe pretendon se u tërhoq për të mbrojtur «më mirë» kryeqytetin. Por e vërteta është se ushtria e Sajgonit po largohet në panik drejt Jugut. Kjo pra nuk është një tërheqje strategjike, por një *déroute*¹ e vërtetë. Armë të rënda e raketa po braktisen rrugëve prej ushtarëve të Thieut dhe bien në duart e forcave çlirimtare.

Fordi dhe Kisingeri janë të parët që po pësojnë një disfatë kolosale. Fordi i kërkon senatit fonde për të ndihmuar Sajgonin. «Nderi i Amerikës, — thotë ai, — është poshtë, ne s'po i mbrojmë më miqtë» e të tjera zhërimiada². Senati amerikan heziton të ndërhyjë përsëri drejtpërdrejt me forca. Ai do të dërgojë, me siguri, ndihma të kamfluara, gjoja ndihma për refugjatët. Por kjo ndihmë nuk mund ta shpëtojë Thieun.

A mund të ndërhyjnë përsëri me armë Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Si e zorshme duket, por imperializmi çdo gjë bën. Prandaj që tash duhet demaskuar fort një orvatje e tillë e rrezikshme.

Imperializmi amerikan po pëson një varg disfatash politiko-ushtarake. Disfatë në Kamboxhia, në Vietnamin e Jugut, në tratativat në Lindjen e Mesme. Mbreti Fejsal i Arabisë Saudite, mik i amerikanëve, por dhe armik i Izraelit dhe shkaktar i krizës së vajgurit, u vra në një atentat. Kush e vrau? Armiqtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo ato vetë? Mbreti që erdhi në fuqi është njëlloj si Fejsali, «mik» i amerikanëve, apo mik pa thonjëza i amerikanëve? Vetë Rokfeleri shkoi në Riad, ku manjatët imperialistë amerikanë të naftës po bisedojnë me

¹ Frëngjisht — shpartallim.

² Jérémiaade (frëngjisht) — ankesë.

«mbretërit» arabë të naftës. Do të shohim ku do t'i dalë tymi.

Barzani i kurdëve e shpartalloi luftën kundër Bagdadit, pse u mor vesh me Teheranin. Barzani, «njeriu i sovjetikëve», kaloi në egzil¹ tek «armiku i tij» — shahu i Persisë. Ky i fundit ishte në armiqësi me Bagdadin, ndërsa tash u mor vesh me këtë. Shahinshahu nuk ishte dakord me mbretin saudit, pse i pari ndihmonte princin e Omanit që ishte mik i amerikanëve dhe armik i mbretit Fejsal, që hëngri plumbin. Ç'botë gangsterësh! Njëlloj vepronjë revizionistët sovjetikë, amerikanët, shahu i Iranit, mbreti saudit e të tjerë, siç vepronin gangët e Al Kapones, Luki Lucianos, Messaris, Manzanarës, që jo vetëm kishin në dorë të gjitha degët e ekonomisë, por kishin me vete edhe policinë, zgjidhnin edhe presidentët e republikës, si Huverin, Trumanin e të tjerë.

Pasardhësit e këtyre presidentëve, me maska demokratike, me shpirt dhe me veprime gangsterësh, po dominojnë sot botën, po hedhin popujt në luftë e në zjarr për interesat e gangëve të tyre. Këta banditë pretendojnë se «mbrojnë paqen botërore», bëjnë sikur japin ndihma e kredi «për të përmirësuar jetesën e disa vendeve». Ky është një bluf i madh, këto janë veprime gangsterësh, të cilët asgjë nuk bëjnë jashtë interesave të tyre, asgjë nuk japin pa nxjerrë për vete fitime kolosale, prandaj asgjë nga ato që thonë nuk u duhet besuar, pse çdo gjë ka qëllime djallëzore. Në gjithë aparatit kolosal imperialist sundon mënyra e jetesës, e veprimit dhe e organizimit të gangsterizmit, i cili ka dominuar jetën amerikane.

Gangu i pijeve të dikurshme është kthyer në gangun e naftës, gangu i brendshëm i dikurshëm, i mishit dhe i një sërë artikujsh ushqimorë, është kthyer në gangun e shitjes së tepricave bujqësore. Gangsterizmi i dikurshëm

¹ Exil (frëngjisht) — mërgim.

«kombëtar» i shitjes së armëve për të vrrarë bandat rivale në Nju-Jork e në Çikago, tash është kthyer në gangsterizëm «ndërkombëtar» që merret me shitjen e armëve klikave proamerikane, për të ndezur luftëra lokale e për të vrrarë popujt. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dominojnë botën me gangsterizmin e tyre imperialist ndërkombëtar.

Çifuti Kisinger është një gangster amerikan i tipit hitlerian. Ky ishte një gangster politik, një leitënant i zgjedhur nga padroni i tij Nikson për të bërë allishverishe të poshtra prej çifuti spekulant. Niksoni u mbyt në m. . . dhe ia pasoi leitënantin Fordit. Por shtëpia po merr zjarr dhe Kisingeri do të digjet bashkë me të.

Luftë të pareshtur dhe të ashpër duhet të vazhdojmë t'u bëjmë pa pushim këtyre dy superfuqive të errësirës dhe të gjakut, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik revizionist. Ata na luftojnë ne me ashpërsi, hapur dhe në mënyrë subversive. Punët armiqësore që kemi zbuluar dhe goditur këta muaj janë vepra e tyre¹. Prandaj vigjilencë, vigjilencë, vigjilencë! Veçse jo vigjilencë me llafe, por me vepra: vigjilencë në punë, në mendime, në fabrika, në fushë, në shkollë, në pushtet e në Parti.

¹ Është fjala për komplotin e madh armiqësor që zbuloi e shpartalloi Partia në fushat e ideologjisë, ekonomisë, ushtrisë gjatë viteve 1974-1975.

E MARTË

8 PRILL 1975

DE PROFUNDIS TJETËR PËR SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i lanë duart nga Kamboxhia. Tok me kukullën e tyre, Lon Nolin, vranë e prenë kamboxhianë, dogjën qytetet e fshatrat dhe tash, në pamundësi të vazhdonin barbarizmat, tërhoqën Lon Nolin dhe kriminelët e luftës dhe i kënduan *De profundis*-in Kamboxhias.

Amerikanët janë duke larë duart edhe nga Vietnam i Jugut. 3-4 presidentë amerikanë, njëri pas tjetrit, hodhën në Vietnam aq bomba, aq napalm, aq hiperit, sa as në Luftën e Dytë Botërore nuk u përdorën! Të vrarët, të plagosurit, shkatërrimet dhe djegiet nuk mund të llogariten. Hunëve, të cilët historia i përshkruan shumë barbarë, ashtu siç edhe ishin, amerikanët ua kaluan aq shumë, saqë, pa u gabuar, hunët mund t'i cilësojmë më «humanitarë» se amerikanët! Por patën edhe amerikanët «fushat katalonike»¹ të tyre.

Thiëut, kukullës së tyre në Vietnamin e Jugut, iu shtrëngua laku dhe po i zihet fryma. Ai, duke qenë në shkatërrim e sipër, thërret amerikanët në ndihmë. Mirëpo Fordit nuk i vjen zëri, sepse është duke i dalë tymi i fundit në një «Dien Bien Fu» të ri që quhet Sajgon, ku

1 «Champs catalauniques» (frëngjisht) — fusha, ku Atila u mund nga kundërshtarët e tij.

gjenerali amerikan nuk dëshiron të pësojë fatin e gjeneralit Dë Kastri.

Tash Fordi shpërtheu «fushatën humanitare» për Vietnamin. Ai po tërheq «jetimët» e barbarizmave të tij, 100 mijë refugjatë vietnamezë, ndër të cilët preferon, sa të jetë e mundur më shumë, të rinj dhe të reja. Këta janë kolonët e rinj që ngjyrën e fytyrës s'e kanë të zezë si sklevërit që bliheshin dikur në Afrikë duke u shikuar dhëmbët dhe muskujt, por janë nga raca e verdhë. Sklevërit e rinj vijnë nga Azia, megjithatë edhe këtyre përsëri ua shikojnë dhëmbët dhe ata që nuk i kanë në rregull, i hedhin në det. Amerikanëve u duhen këto rezerva sklevërish, prandaj shpërthyen operacionin «për shpëtimin e refugjatëve vietnamezë», të cilin do ta bekojë edhe papa Pavli VI dhe «do të derdhin lot» plakati amerikanë, të cilat do t'u japin refugjatëve, «këtyre viktimave të barbarëve komunistë», nga një këmishë të vjetër najloni që ta veshin.

Kisingeri, i kthyer dje nga një takim me Fordin, mbajti një *De profundis* tjetër, atë të Vietnamit. «S'kemi, — tha ai, — veçse 150 milionë dollarë për ndihma, të cilat do të shërbejnë për shpëtimin e refugjatëve», pra për operacionin që thamë më lart dhe për të përgatitur ndonjë kompromis. Shtetet e Bashkuara të Amerikës arrogante kërkuan ndihmën e Francës ose të ndonjë shteti tjetër (lexoje, të Bashkimit Sovjetik), që këta të bëjnë diçka për t'u shpëtuar fytyrën agresorëve amerikanë dhe, si shpërblim, Shtetet e Bashkuara do t'u japin atyre që do t'u vijnë në ndihmë nga një kockë.

Kambanat e disfatave për Shtetet e Bashkuara të Amerikës po bien nga çdo anë. Ato nuk janë akoma kambanat e vdekjes, por të disfatave të mëdha e vdekjeprurëse.

Këto disfata politike janë rezultat i krizës së madhe ekonomike, që prej vitesh ka mbërthyer botën kapitalisto-

-revizioniste, duke shkaktuar dallgë të thella, që u dobësojnë forcën dhe u nxjerrin pareshtur bojën manovrave dhe intrigave imperialisto-revizioniste. Lindja e Mesme është një «furrë» tjetër për imperializmin amerikan. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet «kobures së tyre», Izraelit, harxhuan në këtë zonë miliarda dollarë. Përse? Për të siguruar naftën e kësaj zone. Mirëpo miti i «pathyeshmërisë së Izraelit» u zhduk dhe plani amerikan nuk u solli atë që dëshironte. Dominimi i intrigave të Kisingerit nëpërmjet Izraelit perëndoi. Prandaj tash po duket në qiell një tjetër plan amerikan: pse SHBA të mos bëjnë sikur do ta lënë në llucë Izraelin dhe të kthehen në «miqësinë» me arabët? Politika e armiqësisë me arabët dhe e miqësisë me Izraelin nuk solli gjë veç krizën e naf-tës. Prandaj duket se po fillon një fazë e re: «dashuri» me arabët dhe «zemërim» me Izraelin. Në të vërtetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta sakrifikojnë kurrë plotësisht Izraelin, por do të bëjnë demagogji të madhe sikur gjoja janë për «përmbajtjen» e Izraelit, bile edhe për «kthimin e tij në kufijtë e mëparshëm», ndërsa po-pujve arabë do t'u thonë «ne jemi miq me ju». *De profundis* tjetër për politikën agresive amerikane, një gjoja kthim në rrugën e «paqes» e të «miqësisë» dhe papa Pa-vli VI do të mbetet i kënaqur. Miku i amerikanëve, shahu i Iranit, po punon në drejtimin e tyre. Ai «u puth» me Al-Bakrin¹, me të cilin gjer dje po thereshin në kufi. Qëllimi është: T'i qërojnë sovjetikët nga kjo zonë, t'ua ngrenë këmbët nga Afganistani dhe të mbështetin Bu-ton² me armë kundër Indisë, ku sovjetikët po livadhisin. Pra, kthesa e amerikanëve të detyruar nga disfatat synon të qërojë terrenin nga sovjetikët që kërkojnë të kullotin në Egjipt, në Siri, në Liban dhe kudo rreth këtyre zona-

1 Ahmed Hasan Al-Bakr — ish-president i Republikës së Irakut.

2 Zylfikar Ali Buto — ish-kryeministër i Pakistanit.

ve. Duket, pra, qartë se imperializmi amerikan është në krizë të madhe.

Edhe partnerët e tij në këtë gjiriz janë futur, deri në grykë kanë hyrë. Zërat e tyre janë të ngjirur, që të gjithë po përpëliten, po dridhen, po hedhin çape hezituese. NATO-ja lëkundet dhe zien nga tërmetet, por edhe mbahet në këmbë: Franca edhe ka ikur prej saj, edhe vërtitet brenda si me nder «pordha në brekë». Zhiskar d'Estëni vërtitet andej-këtej, pa pasur as personalitet dhe as ndonjë politikë të qartë. Ai ecën si i hutuar, hiqet si me arabët, fut atje gishtin dhe prapë e tërheq, fut gishtin në Greqi dhe shpejt e tërheq, diku thotë një fjalë të mirë për Turqinë, jep dy buzëqeshje për Rusinë, një të shtrënguar të dorës për Gjermaninë, një buzëqeshje për Anglinë dhe kështu me të tjerët... Franca gjoja është kundër amerikanëve, por, në fakt, nuk është kundër. Anglia është në fund të qypit, ose më mirë në fund të detit. Ajo po merret edhe me Shelepinin¹! Gjermania e Bonit s'po dëgjohet, sigurisht punon nën rrogos, punon me *sotto voce*².

Rusi ka hyrë në një krizë po aq kolosale sa edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përpara krizës amerikane ai rri sus, si një qen salloni. Pse vallë? A nuk do të sulmojë kur partneri i tij i madh gjendet në vështirësi? Jo! Bashkimi Sovjetik është agresiv, por ndodhet vetë në krizë të brendshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Bashkimi Sovjetik është në dekadencë ekonomike, industria e tij është e vjetër, ai dëshiron ta modernizojë këtë, prandaj kërkon kredi kolosale nga imperializmi amerikan, i cili nuk ia jep pa marrë koncesione. Satelitët e tij janë në lëvizje. Në Traktatin e Varshavës ata mbahen me forcë, në KNER mbahen me forcë, detyrohen, gjithashtu,

1 Në atë kohë kryetar i KGB-së.

2 Italisht — me zë të ulët.

me forcë të bëjnë mbledhje partie dhe deklarata të përbashkëta.

Dhe megjithëse e tërë kjo krizë, tërë kjo kalbësirë e imperializmit dhe e socialimperializmit duket qartë, pra-pëseprapë bëhen përpjekje që të fshihet, të mbulohet. Me se? Me çfarë? Me psikozën e luftës së përgjithshme dhe të pjesshme. Kjo psikozë është e kurdisur nga dy superfuqitë dhe e ushqyer nga agjenturat e tyre.

«Qipro!» — zhurmë e madhe: «Mesdheu në rrezik!» Kolonelët grekë vepruan, turqit kundërvepruan, sovjeti lëvizi, bullgari «qëndisi», Titoja «lukurisi», Zhiskari «dërdëllisi» dhe Italia u shiti toka, ishuj dhe porte Shteteve të Bashkuara të Amerikës që këto të shtojnë e të fuqizojnë bazat e tyre ushtarake. Këto bëhen nga frika që kanë fuqitë imperialiste e socialimperialiste nga popujt e botës, si dhe për të kapërcyer pa plagë të mëdha krizën e rëndë që po kalojnë Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe klikat antipopullore në vendet e ndryshme.

Karakteristikë e përgjithshme e klikave antipopullore kapitaliste në vendet e ndryshme është përpjekja që bëjnë ato për të mos u angazhuar shumë dhe fare hapur me njërin ose me tjetrën superfuqi. Këtë nuk e bëjnë se janë për një politikë të pavarur nga superfuqitë, por se nuk janë të sigurta se si do të dalin nga kriza. Ato edhe lidhjet e vjetra i mbajnë nën presion, por, kur u duhet, lëshojnë edhe nga ... një zhurmë, hiqen sikur «mbrojnë interesat kombëtarë», kurse, në fakt, trustet e koncernet që drejojnë këto vende janë kokë e këmbë kozmopolite, kokë e këmbë në duart e superfuqive.

Shtetet e Evropës Perëndimore edhe e duan çlirimin nga zgjedha e amerikanëve, por edhe nuk rrojnë dot pa amerikanët, se dridhen nga sovjetikët. Ato kanë frikë po të largohen forcat amerikane nga kontinenti, sepse e dinë që, në një luftë të mundshme me sovjetikët, amerikanët, në qoftë se do t'u vijnë në ndihmë, këtë do ta bëjnë pas

orës 12, sikurse kanë bërë në dy luftërat e para. Por Shtetet e Bashkuara, thonë disa, nuk mund të kthehen në «izolacionizëm». Kjo është e vërtetë, por pikërisht këtë lodër «joizolacioniste» bënë ata si në kohën e Uilsonit¹, ashtu dhe në të Rusveltit². Këtë mund ta bëjnë fare mirë edhe nën një president tjetër. Kësaj i thonë «një manovër e vogël» për të dobësuar kundërshtarët me një luftë të përgjakshme që pastaj të vijnë SHBA e të hanë gësh-tenjat që të tjerët ua kanë nxjerrë nga zjarri.

Mendimi im është se në këto situata të dy superfuqitë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik, janë në krizë të madhe, ndaj lufta kundër tyre duhet të vazhdohet e ashpër në të dy frontet. Ne as mund të dalim e as mund të jemi dakord me konkluzionin e disave, sipas të cilëve «socialimperializmi sovjetik është më i rrezikshëm se imperializmi amerikan», prandaj «të ashpërsojmë luftën kundër të parit dhe ta dobësojmë luftën kundër të dytit». Kjo do të thotë të ndihmojmë njërin, imperializmin amerikan, duke u bashkuar me të në luftë kundër tjetrit, socialimperializmit sovjetik. «Thellojmë kontradiktat», thonë ata. Po në favor të kujt i thellojnë? Në qoftë se pretendojnë se i thellojnë në favorin e proletariatit e të popujve, atëherë duhet të godasësh njëloj edhe të dy superfuqitë.

Janë, po ashtu, të gabuara, mendoj unë, ato pikëpamje, sipas të cilave duhet mbrojtur Tregu i Përbashkët Evropian, që nuk është tjetër veçse një krijesë e kapitalizmit botëror. Po pse të mbrohet? Gjoja për të përballuar presionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik. Po në duart e kujt është ky Treg i Përbashkët? Në duart e kapitalistëve dhe të monopoleve

1 Tomas Udrou Uilson — president i SHBA-së në vitet 1913-1920.

2 Franklin Delano Rusvelt — president i SHBA-së në vitet 1933-1944.

ndërkombëtare për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt. Si rrjedhim, ata që i mbrojnë këto teza, pranojnë se duhet fuqizuar pushteti i borgjezisë evropiane mbi popujt. Kjo do të thotë që, në vend që të nxitim revolucionet progresiste popullore kundër kapitalit nacional dhe atij kozmopolit, të nxitim shtypjen dhe shfrytëzimin, të nxitim luftën botërore imperialiste. Ne komunistët jemi për luftëra të drejta dhe jo për luftëra të padrejta dhe, në rast se pëlçet një luftë e padrejtë nga imperializmi botëror, ne duhet ta sabotojmë atë dhe ta kthejmë në një luftë revolucionare.

Për sa i përket Partisë së Punës të Shqipërisë, kjo do të vazhdojë të zbatojë vijën e saj të drejtë pa lëkundjen më të vogël. Vija e Partisë sonë është revolucionare, prandaj ne i ndihmojmë revolucionarët, partitë komuniste (marksiste-leniniste) që janë në pozita revolucionare, një-rëzit përparimtarë. Ndihma që u jep këtyre Partia jonë është një ndihmë modeste, por edhe ata i japin Partisë dhe popullit tonë ndihmën dhe përkrahjen e tyre në arenën ndërkombëtare. Shqipëria duhet ta çmojë drejt këtë ndihmë të jashtme që i jepet. Kjo ndihmë ka bërë që jo vetëm të çahet izolimi borgjezo-revizionist i Shqipërisë socialiste, por që edhe politika, historia, zhvillimi dhe përparimi i vendit e i Partisë sonë të njihen kudo. Në kohë të mira dhe të vështira ne duhet ta llogaritim këtë ndihmë. Prandaj punën me miqtë e jashtëm ta zgjerojmë vazhdimisht në rrugë marksiste-leniniste, ta kemi kurdoherë në vëmendjen tonë dhe dita-ditës ta ushqejmë propagandën tonë për vendet e huaja.

Vendet e vogla, popujt e vegjël kanë nevojë për një-ri-tjetrin; ata duhet të mbështetin njëri-tjetrin në luftën kundër synimeve djallëzore të superfuqive. Këtu nuk është fjala vetëm për të qenë vigjilentë ndaj aleancave që kurdisin me njëri-tjetrin krerët borgjezë ose revizionistë që shtypin popujt e tyre, por sidomos për të kri-

juar dhe për të vënë në lëvizje opinionin përparimtar revolucionar, për të mbrojtur çështjen e të gjithë popujve në tërësi dhe të çdo populli në veçanti.

Natyrisht, kohët janë shumë të rrezikshme. Popujt duhet të kuptojnë se aktualisht të dyja superfuqitë përgatitin luftën e tretë botërore, e cila do të pëlçasë kur kontradiktat në mes dy superfuqive do të acarohen në kulm, kur si njëri, edhe tjetri imperializëm do të kenë harxhuar të gjitha mjetet e politikës «paqësore» dhe do ta vazhdojnë politikën e tyre me mjete të tjera, me luftë. Por kësaj i tremben të dy palët, se do të jetë luftë me armë bërthamore, shkatërrimtare, ku zor të ketë fitues e të mundur. Prandaj përgatitja e saj nga të dyja superfuqitë nuk bëhet vetëm duke u armatosur ato vetë kush e kush më shumë, më shpejt e deri në dhëmbë për ditën e «ndeshjes së tmerrshme». Kjo është njëra anë. Ana tjetër është se superfuqitë në politikën e tyre armatosen e i bëjnë shantazh njëri-tjetrit për ndarjen e tregjeve të botës, zhvillojnë procesin e kolonizimit dhe të shfrytëzimit të popujve të tjerë. Në këtë proces hyn edhe armatosja e klikave që sundojnë mbi këta popuj. Këto klika janë shtypëse të popujve të tyre dhe «aleate» të asaj superfuqie që u ofron më shumë. Nga kjo lindin konfliktet e veçara, që çojnë drejt konfliktit të përgjithshëm botëror e që do të jetë katastrofal.

Pra, të dyja superfuqitë, para «lojës tragjike» të fundit, luajnë lojën e shahut, duke përdorur pionet e tyre: Izraelin kundër vendeve arabe, Greqinë kundër Turqisë, Vietnamin e Thieut kundër Vietnamit të Veriut. Nesër ata do të nxitin popujt e Afrikës në mes tyre, gjë që qysh tani e kanë filluar: Etiopinë kundër Eritresë etj. Lufta e pjesshme mund të kalojë edhe në Amerikën Latine. Pasi mbaroi Bangladeshi, mund të fillojë një luftë midis Indisë dhe Pakistanit ose midis Pakistanit dhe Afganistanit. Po vazhdon lufta e Jemenit të Veriut me atë të

Jugut dhe kështu do të ecë puna, derisa zjarri i luftës të kalojë në Evropë.

Kjo metodë e dy superfuqive, në garë me njëra-tjetrën, ndiqet për hegjemoninë botërore. Para Luftës së Parë Botërore dhe duke u maskuar më me kujdes pas saj, Fuqitë e Mëdha çonin zyrtarisht ushtritë dhe kanonierat e tyre për të kolonizuar popujt. Pas Luftës së Dytë Botërore ndodhi e njëjta gjë, por në forma të tjera. Vende të ndryshme, siç ndodh në Evropë, janë pushtuar *de jure* prej superfuqive me ushtri dhe me bomba atomike. Këto forca ushtarake shtohen vazhdimisht dhe qëndrojnë të pacenuara, qysh kur u fitua lufta mbi Hitlerin. Popujt e Evropës, në vend që të çliroheshin, u robëruan trefish, politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Të gjitha shtetet e tjera të botës, me përjashtim të Shqipërisë dhe deri këto kohët e fundit edhe të Republikës Popullore të Kinës, u pushtuan, gjithashtu, si të thuash në mënyrë të trefishtë: diku politikisht ato janë bërë bishti i dy superfuqive, diku ekonomikisht janë bërë kolonitë e tyre dhe diku gjetkë janë kthyer në baza ushtarake, ku klikave në fuqi u jepen armë për të ruajtur zgjedhën mbi popujt.

Këto taktika, kjo strategji vdekjeprurëse e të dyja superfuqive duhen demaskuar, duhen luftuar. Kjo është çështje e përbashkët e gjithë popujve, ndaj dhe lufta duhet zhvilluar e ashpër prej gjithë popujve. Kina dhe Shqipëria duhet të jenë në pararojë të kësaj lufte kundër dy superfuqive dhe satelitëve të tyre në të gjithë botën. Kjo është një ndërmarrje kolosale, e rëndë, e koklavitur, e cila, pa ngritur në këmbë gjithë popujt, nuk mund të ketë suksesin e duhur. Popujt e botës në këtë luftë duhet të kenë strategjinë dhe taktikat e tyre, të cilat kërkohet të jenë revolucionare. Në vendet e tjera jokomuniste nuk është e thënë që këtë luftë duhet ta udhëheqin vetëm komunistët e vërtetë. Jo, kjo do të ishte gabim. Lufta kundër dy superfuqive dhe aleatëve të tyre nuk mund të

bëhet nga një pakicë, por nga shumica, me kusht që kjo pakicë, partia marksiste-leniniste, të mos humbasë personalitetin e vet dhe as Kina të mos bëjë deklarata se «bën pjesë në botën e tretë» apo se «duhet luftuar vetëm kundër njëres superfuqi» etj. Shqipëria socialiste nuk bën pjesë në të ashtuquajturën botë e tretë dhe as e pranon këtë koncept antimarksist. Shqipëria ndihmon gjithë popujt dhe shtetet që ngrenë krye kundër të dyja superfuqive, që u prishin këtyre planet agresive dhe robëruese, që i dobësojnë me goditjet e tyre dhe ngjallin frymën luftarake revolucionare për të shkuar më tej në fitoren e plotë të popujve. Me këta do të jetë Shqipëria socialiste, pa qenë as në «botën e dytë», as në «të tretën». Shqipëria i përket vetëm botës socialiste dhe për këtë lufton në rrugën marksiste-leniniste.

PNOM-PENI U ÇLIRUA — POPULLI KAMBOXHIAN TRIUMFOI MBI ARMIQTË E TIJ IMPERIALISTË

Sipas njoftimit të agjencive të huaja të lajmeve, mbështetur në vetë transmetimet e Agjencisë Kamboxhiane të Informacionit, sot forcat e armatosura popullore të Çlirimit Kombëtar të Kamboxhias çliruan plotësisht Pnom-Penin. Kështu ata shpartalluan agresionin imperialist amerikan që zgjati afër pesë vjet.

Fitore e madhe e popullit vëlla kamboxhian. Do ta përshëndetim këtë fitore të tij, do t'u bëjmë telegrame urimi udhëheqësve kamboxhianë, Sihanukut e kryeministrit¹.

¹ Pen Nut.

NJË VËZHGIM I POLITIKËS NDËRKOMBËTARE NË DRITËN E NGJARJEVE DRAMATIKE PËR SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Shtetet e Bashkuara të Amerikës hëngrën një dru të madh, pësuan një disfatë të pariparueshme në Kamboxhia. E para, u pa qartë nga gjithë bota se imperializmi amerikan, me gjithë forcën e armëve dhe forcën e tij ekonomike, nuk mund t'i imponojë vullnetin e tij qoftë dhe një popull shumë të vogël që ka vendosur t'i rezistojë dhe ta luftojë me armë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës hodhën në balancën e Kamboxhias armët moderne, këshilltarë, gjeneralë dhe ushtri të tyre, hodhën furnizime ekonomike të pallogaritshme, ngritën në skenë një grusht tradhtarësh, me Lon Nolin në krye, organizuan ushtri mercenare, angazhuan edhe «prestigjin» e një fuqie super të madhe dhe, megjithatë, balanca anoi nga ana e popullit kamboxhian.

Ç'mësime nxjerrin popujt nga kjo disfatë kolosale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës? Se imperializmi është në kalbëzim, se perandoria e Shteteve të Bashkuara po kërcet në themelitë, në organizimin dhe në politikën mbi të cilën është ndërtuar. Me luftë, me armë, me kulla, me baza, me kredi dhe me shfrytëzim e shantazh atyre u duhet të mbajnë në sundim popuj. Mirëpo karakterin e dollarit që kullon gjak e njohin të gjithë. Kukullat përdoren deri në fund për të mbështetur padronin, gja-

kosin popullin e tyre, por më në fund thyhen e bëhen pluhur nga lufta popullore. Shembull i fundit janë Lon Noli dhe Van Thieu, që janë duke dhënë shpirt. Pra s'mund të qëndrojnë në këmbë demagogjia se gjoja Shtetet e Bashkuara të Amerikës «demokrate» luftojnë tok me miqtë e tyre «demokratë», Lon Nolin dhe Van Thieun, për «lirinë dhe demokracinë» e popujve.

Domethënë nga të gjitha anët disfata politike, ushtarake dhe ekonomike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. «Besimi» i aleatëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të këta, kuptohet, ka rënë te këmbët. Perëndoi besimi i mëparshëm i klikave dhe i kukullave për padronin «e fuqishëm». Në fakt, klikat dhe kukullat mendojnë tash më shumë se kurdoherë, se padroni është bërë i rrezikshëm, ai punon vetëm për vete, i përdor këta si vrasës të popujve të tyre dhe i lë në baltë, kur thyhet në beteja me popujt e botës. Po nuk janë vetëm klikat dhe kukullat si Lon Noli, Van Thieu, kolonelët grekë apo ata kilianë që mendojnë kështu, ka edhe «aleatë të mëdhenj» zyrtarë, që me kohë po dyshojnë në këtë aleancë të krimbur, ku sundon një superfuqi imperialiste, që edhe me ta, pavarësisht nga traktatet, ka të njëjtat qëllime dhe vepron e do të veprojë në të njëjtën mënyrë si me klikat dhe me kukullat.

Ky mosbesim real në këtë aleat të pabesë po duket haptazi në format e shantazheve që i bëhen. Grekët i kërcënohen, turqit po ashtu. Në «aleancë» ka filluar të spikatë ndjenja «nacionale», mbrojtja «nacionale». «Aleatët», edhe në qoftë se nuk e thonë, kanë filluar të mendohen dhe të lëvrijnë: «Si do të mbrohemi? Asgjë nuk kemi të sigurt me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; këta të lënë në llucë për interesat e tyre».

Socialimperializmi sovjetik, nga ana e tij, është po në këtë krizë të madhe. Asnjëri nuk i beson demagogjisë së tij, çdo veprim i tij u tregon popujve se politika, qëllimet,

synimet e tij janë të njëjlojta me ato të imperializmit amerikan: «hegjemoni botërore, ndarje e tregjeve, duke bërë çmos të evitojnë ballafaqimin në mes tyre», por lufta për tregje të dy nuk i pengon të kenë klika dhe kukulla, t'i vënë këto të gjakosen me njëra-tjetrën dhe t'u nxjerrin gështenjat nga zjarri. «Aleatët» e socialimperialistëve sovjetikë janë të pakënaqur në kulm nga padroni, por vendet e tyre janë të pushtuara, ato nuk mund të çlirohen pa luftë. Këtë nuk mund ta bëjnë. Deri në njëfarë pike mund të bëjnë ca tregti me vendet kapitaliste dhe të marrin ndonjë çikë kredi, aq sa i leverdis të lëshojnë perin padroni. Po të tendoset peri në këtë drejtim nga ana e tyre, padroni ua pret me shpatë.

Rumania bën përjashtim nga ky regjim, por me siguri sovjetikët i kanë caktuar asaj detyra speciale, që mund të hedhë edhe vicka kundër padronit, edhe t'i shërbejë, bile të jetë në shërbim të plotë të tij. E gjithë veprimtaria e grupit të Çausheikut të lë të dyshosh për këtë, pse edhe bërtet se kërcënohet nga sovjetikët, por edhe nuk shpëputet nga Traktati i Varshavës. Kësaj i thonë të jesh brenda, por të hiqesh sikur je gjysmëjashtë.

Në marrëdhëniet padronë-satelitë, këta të fundit ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë më të lirë, më manovrues, hedhin vicka më të forta, bëjnë shantazhe, kurse satelitët e sovjetikëve janë në fre të fortë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërcënojnë satelitët e tyre me kërcënimin sovjetik, kurse sovjetikët nuk i kërcënojnë dot satelitët e tyre me kërcënimin amerikan, pse këtë kërcënim ata e lutin, mbasi duan «lirinë» amerikane. Por që të dy luajnë me kërcënimin e luftës botërore. Kurse vendet e ashtuquajtura të paangazhuara rrojnë nën kërcënimin e dyfishtë, të luftës së përgjithshme dhe të asaj të pjeshme.

Por në këtë kuadër të përgjithshëm shkon duke u dobësuar miti i fuqive të mëdha, që mund të bëjnë ç'të

duan pa u ndëshkuar dhe pa pësuar disfata. Amerikanët po pësojnë të tilla disfata politike, ekonomike dhe ushtarake etj. Sovjeti nuk ka pësuar disfata ushtarake. Ai pësoi një disfatë politike të madhe në Çekoslovaki, nga e cila hala s'e ka marrë veten. Deri tash ai është ruajtur të bëjë agresion atje ku parashikon se mund të gjejë rezistencë me armë, pse me siguri do të pësojë disfata politike dhe ushtarake. Ai mezi mban njëfarë emri me demagogji, po e çori edhe këtë cipë, mbaroi nga çdo pikëpamje. Sovjeti me këtë taktikë kërkon të ruajë «mitin» se ushtria e sovjetëve është «lubi e pamposhtur». I duhet ky mit dhe nuk do që ta djegë, pse atëherë do të vijë rrokullisja e tmerrshme drejt greminës. Strategjia e sovjetikëve është ta ruajë këtë mit dhe të vazhdojë politikën hegjemoniste të socialimperializmit.

Imperializmi amerikan ka pësuar disfata, rusi duket sikur jo. Ky është një iluzion, se të dy kanë pësuar disfata dhe të dy manovrojnë për një strategji të re dhe për taktika të reja. Fordi paralajmëroi hapur që «askush të mos përpiqet të peshkojë në ujë të turbullt kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës». «Uji i turbullt» janë Kamboxhia, Vietnami, Lindja e Mesme. «Askushi» është në radhë të parë Bashkimi Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara disfatave nuk rrinë pa menduar dhe pa i përgatitur rusit një shkelm që të mos lëvizë. Ç'mund të jetë ky shkelm? Supozime: e para, s'i jep kredi për të cilat ai ka shumë nevojë; e dyta, ta qërojë krejtësisht Rusinë nga Lindja e Mesme, nga Gjiri Persik dhe nga Afrika. Kjo pikë e dytë është pikë jetike ekonomike dhe strategjike.

Kush ka influencë në vendet arabe dhe në Afrikë, e mbyll Rusinë në kafaz. Këtë do të orvaten të bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Izraelin këta do ta mbrojnë, por edhe miqësinë me vendet arabe nuk do ta sakrifikojnë, sepse në disa drejtime ajo vlen sa «koburja

izraelite», në mos më tepër. Këtu imperializmi amerikan, si imperializëm që është, ka bërë gabimin më të madh. Do të vazhdojnë ta bëjnë Shtetet e Bashkuara këtë gabim kur i gjithë ky pellg sundohet nga një borgjezi kapitaliste që ka besim më shumë te Shtetet e Bashkuara të Amerikës se te Bashkimi Sovjetik? Amerikanët janë shumë më të pasur dhe mund t'i kënaqin më mirë tekat e asaj borgjezie.

Bashkimit Sovjetik i mbeten pozitat e Evropës. Disa hapin parullën se Shtetet e Bashkuara të Amerikës në politikë do të ecin sipas doktrinës Monro¹. Jo, ata nuk do të shkojnë në izolacionizëm, por në gjysmë mundet, në pamundësi që të vendosin hegjemoni të plotë mbi aleatët e NATO-s. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa në Evropë, të cilët do të vazhdojnë t'i mbrojnë. Pra, në parim, ata janë mburoja e Evropës Perëndimore kundër «rrezikut sovjetik». Por «izolacionizmi amerikan» mund të shprehet në atë që «unë do t'ju ndihmoj, por më ndihmoni edhe ju mua në këto dy kriza kolosale, se kështu ndihmoni edhe vetveten».

Ne shohim Francën të lëvizë në këtë drejtim, të japë përshtypjen se po bëhet një fuqi botërore, që duhet të pyetet. Nesër këtë rrugë do të marrë edhe Gjermania Federale, e cila tash s'po ndihet shumë. Politika e Brandit dështoi, ajo kryesisht synonte «bashkimin e të dy shteteve gjermane». Kësaj nuk ia arriti dot, po kjo nuk do të thotë se imperializmi gjerman ka hedhur armët. Një mëngjes ky do të zgjohet dhe synimi i tij kryesor do të jetë kundër sovjetikëve. Anglia po këtë rrugë do të ndjekë. Pra, mund të mendohet një strategji e re: Të izohet Bashkimi Sovjetik në Evropë dhe t'i ndalet vrapi

¹ Xhejms Monro — president i SHBA-së në vitet 1817-1825, themelues i doktrinës së izolimit të Shteteve të Bashkuara (kundër ndërhyrjes së SHBA-së në punët e Evropës dhe ndërhyrjes së Evropës në punët e SHBA-së).

kudo, Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbeten xhandari kryesor, por të ngjallen edhe xhandarë të tjerë, ndaj të cilëve bëhej një politikë përbuzëse dhe kështu Timurlengu dhe aleatët e tij ta thyejnë Bajazit Jelldëremi, Bashkimin Sovjetik, ta mbyllin në kafaz dhe ta shëtisin si ariun në panair.

Nuk dimë sa e vërtetë është çështja se perëndimorët janë «dakord» që të përfundojë faza e parë e mbledhjes për «sigurimin evropian», «nuk ngulin shumë këmbë për çështjen e hyrjeve të lira të ideve dhe të njerëzve», siç duket të dy palët duan të nënshkruajnë një paçavure pa vlerë. Pse vallë? Mos duan t'i japin një «satisfaksion» grupit proamerikan të Brezhnjev, për të fituar kohë derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës të marrin veten nga disfatat, të ngjitin vazot e thyera, të krijojnë njëfarë besimi të humbur, të përgatiten për zgjedhjet e ardhshme presidenciale dhe perëndimorët, aleatë të tij, ta ndihmojnë, të ndihmojnë edhe veten në konsolidimin e njëfarë pavarësie dhe fuqie më të madhe në aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Këtë zhvillim duhet ta vëzhgojmë, se ky po bëhet, por në ç'forma dhe në ç'drejtime ndonjë gjë e përcaktuar nuk është. Rëndësi ka të vazhdohet tatëpjeta e dy superfuqive, të minohet prepotenca dhe hegjemonia e tyre, të pengohen dhe të luftohen intrigat e tyre, të luftohet psikoza e frikës që mbajnë gjallë këto dy superfuqi, të forcohet ndjenja e mbrojtjes dhe e dinjitetit kombëtar të popujve e të shteteve të pavarura dhe të kaliten fryma revolucionare dhe uniteti ndërkombëtar i proletariatit dhe i punonjësve në të gjithë botën.

Disfatat e superfuqive duhet të shfrytëzohen në kulm e në të gjitha mënyrat. Ne duhet të japim kontributin tonë në këtë luftë si kurdoherë e më shumë se kurdoherë.

E MËRKURE
23 PRILL 1975*

KINEZËT ZVARRITIN VAJTJEN E NJË DELEGACIONI SHQIPTAR NË KINË

Shokët kinezë ende nuk po e hapin dritën jeshile për vajtjen e delegacionit tonë qeveritar ekonomik në Pekin. Drejtorë të ndryshëm të diskastereve qendrore të Kinës u thoshin shokëve tanë se «ne do ta presim delegacionin tuaj nga fillimi i prillit ose nga 15 prilli ose nga fundi i prillit». Por të gjitha këto data u dogjën. Po vjen maji dhe asnjë lajm nuk na jepet, në një kohë kur në Kinë nuk mbeti delegacion i vendeve të tjera pa vajtur, i çfarëdo tipi, i çfarëdo natyre dhe i çfarëdo ngjyre.

Pse ngjet kjo? «Po studiojmë materialet», thonë shokët kinezë, materiale të cilat kanë gati një vit që u janë dërguar së bashku me kërkesat tona. Këtu erdhën dy-tri grupe delegacionesh kryesore nga RP e Kinës, gjoja për të studiuar kërkesat që u kemi bërë, por, në fakt, ata studiuan gjendjen ekonomike të vendit tonë, me qëllim që, në bazë të gjykimit të tyre, të akordojnë pastaj kreditë. Ata na bënë shumë «lavdërime» për përparimet tona, për sukseset e mëdha që kemi arritur, për gjendjen e mirë ekonomike etj. Na thanë se «përfituam shumë nga përvoja e madhe e Shqipërisë».

Mirë që i bënë të gjitha këto mburrje për ne, po akoma nuk po na lajmërojnë se kur duhet të nisim delegacionin ynë. Ne presim këtë, kurse ata vazhdojnë të na thonë «po studiojmë materialet»!

Ambasadori i RP të Kinës në vendin tonë pyeti: «Kur do të shkojë delegacioni juaj, se e pret Li Çiani, ministri i Tregtisë së Kinës». Shokët tanë, me të drejtë, iu përgjigjën: «Kur të na njoftojë Pekini». Kur Li Çiani vajti për drekë tek ambasadori ynë, i lëshoi të gjitha formulat lavdëruese të zakonshme për vendin tonë. Pas këtij lavdërimit, tha se «Kina është në deficit të madh, se Kina nuk ka devizë, nuk ka tuba për naftë, se ka një industri akoma të dobët, se kriza botërore e ka prekur edhe atë, se Kina ndihmon gjithë botën, se ajo do të ndihmojë të dy Vietnamët, do të ndihmojë Kamboxhian, do të ndihmojë... deri edhe Maltën, që te kjo të mos futet influenca sovjetike» etj.

Konkluzioni është i qartë: «**Shqipëria duhet të ecë me këmbët e veta**» dhe, ashtu sikurse na thoshte dikur Mikoiani, edhe zoti Li Çian na tha: «**Bëni tregti me shtetet kapitaliste, zgjeroni marrëdhëniet me to**». I poshtri! Revizionisti! Ambasadori ynë ia dha përgjigjen. Li Çiani, para se të largohej, pyeti: «Kur vjen delegacioni juaj?». Yni iu përgjigj: «Ne presim përgjigjen tuaj».

Në qëndrimet e kinezëve ndaj nesh shikojmë dy tendenca. Njëra është tendenca politike. Kudo dhe me këdo që të takosh në Kinë, që nga njerëzit e thjeshtë e deri te mjaft kuadro, si në qendër e në provinca, sidomos në ndërmarrje dhe në komuna popullore, flitet me simpati, bile me dashuri të madhe për ne, ndërsa në sferat e larta ndihet njëfarë qëndrimi i rezervuar, për të mos thënë i ftohtë. Tjetra është tendenca në marrëdhëniet ekonomike. Për sa u përket çështjeve ekonomike ne nuk mund të themi se kinezët nuk na kanë ndihmuar, por ndihma nga ana e tyre na ka ardhur jo në kohë dhe pas debatesh të shumta që kemi bërë. Në këto debate ka pasur shprehje dhe mendime që nuk kanë qenë të arsyeshme nga disa udhëheqës kinezë. Ne edhe tash e kuptojmë që Kina do t'u japë ndihma, dhe, në fakt, u jep edhe të tjerëve, por

të na flasin neve për të tilla situata të Kinës, siç bën Li Çiani, të na këshillojnë si Mikoiani, të zvarritet kështu vajtja e delegacionit tonë qeveritar, me shokun Adil Çarçani në krye, dhe, akoma më keq, të bëjnë sikur e kanë harruar kërkesën tonë për vajtjen e një delegacioni tjetër qeveritar, një qëndrim i tillë nuk është miqësor.

E MARTË
29 PRILL 1975

PËR PROVOKATORIN MIJAL

Sot mora dijeni se polaku Mijal, në takimin që ka pasur më 17 prill me shokët Agim Popa dhe Koci Zengo ka thënë sa vijon:

1) Fushata në shtypin shqiptar kundër burokratizmit është e njëanshme, se nuk flet për stilin e punës dhe del kundër aparateve.

2) Kryeartikulli i «Zërit të popullit»: «Kur flet klasa nuk flet burokratizmi» është i gabuar dhe i dëmshëm, se ngrihet vetëm kundër aparateve. Ai është një artikull demagogjik, pse në të jepen shifra globale.

3) Ardha e punëtorëve në aparate do ta shtojë burokratizmin dhe nuk do ta pakësojë (për këtë, ka thënë ai, jam i bindur qind për qind), sepse në aparate kërkohen njerëz të specializuar e kompetentë. Punëtorët do të mërzen në aparate. Është e gabuar që të përcaktohet përqi-ndja (30-40-50%) e punëtorëve për të ardhur në aparate.

4) Qarkullimi i kuadrove është një parim i gabuar, bile revizionist (edhe Hrushovi fliste për rotacion¹, me qëllim që të eliminonte nga udhëheqja revolucionarët). Ky është një parim borgjez. Edhe ju vetë e shihni se qarkullimi është pa baza, prandaj bëni përjashtim për udhëheqjen. Aparati ka nevojë për njerëz të mësuar, të kualifikuar dhe, derisa njerëzit punojnë mirë, përse të qarkullojnë? Nuk duhet shkaktuar nervozizëm në aparate.

¹ Qarkullim.

5) Në funksionimin e aparateve nuk ka rëndësi qarkullimi (ky është i gabuar) dhe as sjellja e punëtorëve, por organizimi i shëndoshë i punës.

6) Në fjalën e shokut Enver në rrethin e Matit eliminohet roli i degëve të kuadrit, sepse kërkohet që kandidaturat të diskutohen më parë nga masat.

Mijali, me kritikën armiqësore që po bën, po demaskohet më shumë se ç'është. Siç duket ai ka marrë udhëzime nga qendra e tij të vërë në veprim bateritë dhe, nën maskën se ka arritur shkallën e «besimit» tonë e në mënyrë gjoja shoqërore, të na bëjë vërejtje të atilla që ne të mos e vazhdojmë rrugën e revolucionarizimit, që me siguri u prishi planet e fshehta revizionistëve sovjetikë, polakë e të tjerë, agjent i të cilëve është ky provokator.

Udhëzimet Mijali i mori nga pseudokomunisti polak që e kishte dërguar sigurimi polak dhe që Mijali, në kundërshtim me mendimin tonë, shkoi dhe e takoi në Itali.

Polaku na qenka kundër luftës që po i bëjmë ne burokratizmit, sigurisht pse kjo i dhemb atij dhe padronëve të tij. Ai e mëson Partinë tonë si «duhet të flasë për stilin dhe për metodën e punës»; u dashkësh të na e kujtonte ky, se e kishim harruar! Ai e quan «të dëmshëm dhe megaloman» artikullin e «Zërit të popullit», pse u prish gjumin aparateve dhe «aparatchikëve» aq të dashur për këtë farë marksisti fals dhe si akuzë na quan antileninistë, se ne «flasim kundër aparateve». Për sovjetikët, polakët dhe agjentin e tyre ne nuk duhet «t'i shqetësojmë aparatchikët e të krijojmë nervozizëm», por t'i lëmë të na krimbin shtetin dhe Partinë. Ata, duke pretenduar se specialistët janë çdo gjë dhe punëtorët asgjë, veçse për punë, mendojnë se po të sjellim punëtorë, këta do të mërzen dhe do të kërkojnë të venë të punojnë

atje nga kanë ardhur. Pra, për këta lloj marksistësh, teknokratët duhet të drejtojnë dhe punëtorët të punojnë.

Partia jonë as ka qenë dhe as do të jetë kundër aparateve, por këto dhe njerëzit që punojnë në to duhet të jenë revolucionarë, të zhdërvjellët, antiburokratikë, anti-teknokratikë, të ndershëm, në shërbim të plotë të Partisë, të shtetit dhe të popullit. Që të jenë të tillë si aparatet, si njerëzit, duhet vazhdimisht të kontrollohen dhe të freskohen. Ka aparate që fryhen, që bëhen të rënda, të kushtueshme dhe burokratizohen. Lenini na mëson se duhet t'i luftojmë këto. Ky «marksist i madh», që quhet Mijal, e mëson Partinë tonë se «s'duhet bërë kjo, pse punët janë zgjeruar». Ky zotni e ditka më mirë nga Partia jonë punën tonë.

Njerëzit që qëndrojnë në një vend myken dhe Partia e ka për detyrë t'i edukojë, t'i lidhë më mirë me bazën, me masat dhe jo tërë jetën t'i shohin këto nga zyra me syzet e burokratit, të shifrave etj. Një nga mjetet e këtij freskimi është qarkullimi! Ndërsa ky agjent provokator e cilëson këtë masë të Partisë sonë si atë të Hrushovit, «që rotacionin e bënte për të larguar revolucionarët nga drejtimi». Sipas këtij agjenti polak, ne e bëjmë qarkullimin për të larguar revolucionarët nga drejtimi dhe sjellim punëtorët që, sipas tij, «nuk janë revolucionarë», ose sjellim nga baza shokë pa eksperiencë e që «nuk janë revolucionarë». Deri këtu vete armiqtësia e tij, demaskimi i tij është i plotë.

Sovjetikëve, polakëve dhe agjenturës së tyre u ka djegur shumë zbulimi i komplotit të Beqir Ballukut, i naftës, i «teknikëve» agjentë polakë që arrestuam. Atëherë padronët i kanë thënë Mijalit: «Ç'po bën ti, përpiqu t'i frenosh ca këta leninistë, duke përdorur sentenca leniniste». Ky agjent shkon deri atje sa të thotë gjëra të paqena, se gjoja nuk ekzistojnë te ne drejtoritë e kuadrin, pse Enver Hoxha në Mat ka thënë që masa duhet

të japë mendimin për kuadrin. Këtij agjenti nuk i pëlqen kjo demokraci proletare, duke ruajtur kurdoherë Partia të drejtën që të vendosë për kuadrin. Ky farë «marksisti» fals e mendjemadh, që gjoja partinë e tij diçka e ka, por në fakt ajo nuk ekziston gati fare dhe më shumë për fajin e tij, dëshiron që te ne të dominojnë teknokratizmi dhe burokratizmi. Zaten këndeje ka lindur dhe në këto peggje është rritur ai.

Mijali bëri sikur u arratis nga Polonia, por, siç po del nga këto fakte, ai nuk u arratis, por e bënë që «të arratisesh». Ne i dhamë dhe i japim çdo ndihmë, e ndihmuam dhe e ndihmojmë të ngrinte dhe të ndihmonte partinë, këtu silleshim si shokë me të, por ky na doli judë.

Ne jemi marksistë-leninistë, ne pranojmë kritika nga shokët, por të tilla kritika të pabazuara dhe provokuese jo vetëm s'i pranojmë, por ia pështyjmë në fytyrë. Ne do t'i përgjigjemi si duhet këtij agjenti provokator dhe do t'i priten ndihmat, lëvizjet dhe mbledhja e informacioneve. Duket qartë se ai po mbledh informacione në vendin tonë. Ai nuk sillet si mik, si shok dhe kemi vënë re se gëzhëvon çdo gjë, në detaje dhe për çdo gjë po jep «mendime të mëdha dhe të autorizuar» si një zëdhënës i Leninit, që ka ardhur këtu jo si emigrant që ndihmohet për Partinë Komuniste të Polonisë, por për të na «mësuar ne kalamantë» si duhet të punojmë dhe si nuk duhet të punojmë. Por ai harron se ne kemi parë shumë si ai dhe më të fortë se ai dhe u kemi dhënë shkelmin.

Në këto situata armiqtësore që po zbulojmë, ky duhet të jetë një armik jo i vogël. Neve s'ka ç'na bën, se do ta izolojmë, por duhet të izolohet edhe nga marksistë-leninistët e tjerë, se ky është një Gripë¹ i ri.

¹ Zhak Gripa — ish-sekretar i përgjithshëm i PK të Belgjikës (m-l), revizionist i maskuar.

E MËRKURË
30 PRILL 1975

PËRGJIGJJA QË DUHET T'I JEPET POLAKUT MIJAL

1) Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqja e saj kanë pranuar dhe i pranojnë kurdoherë kritikën shoqërore dhe miqësore nga çdo anë që t'u vijnë. Kurse kritikën armiqësore, të pabazuara dhe prepotente, i luftojnë dhe i hedhin poshtë me neveritje. Ky është një qëndrim leninist karshi kritikës.

2) Lufta në vendin tonë kundër burokratizmit është plotësisht e drejtë, marksiste-leniniste. Vetëm armiqve të vendit tonë dhe të socializmit nuk u pëlqen një luftë e tillë.

3) Artikulli i «Zërit të popullit» i 3 prillit 1975 nuk është i gabuar e i dëmshëm dhe as demagogjik, siç e gjykoni ju, por ai ideologjikisht është shumë i drejtë, i përshtatshëm e me vend, pse është Partia jonë ajo që do t'i gjykojë më mirë se kushdo tjetër arsyet, momentet dhe nevojat tona.

4) Partia jonë as nuk ka qenë, as nuk do të jetë kundër aparateve, se këto i duhen për shumë kohë akoma shtetit socialist, por këto aparate duhet të jenë revolucionare, të zhërvjellëta dhe jo të kushtueshme. Kështu i duan ato klasa punëtore dhe fshatarësia, kështu na mëson Lenini dhe këtë qëllim shpreh artikulli i «Zërit të popullit», që ju e cilësoni demagogjik. Artikulli në fjalë, sipas jush, është i njëanshëm dhe ju na këshilloni që ta

ruajmë burokratizmin e të forcojmë «stilin dhe metodën» e punës. Ju faleminderit për këshillën, por lufta e Partisë sonë për një «stil e metodë» pune revolucionare (këtë fjalë të fundit ju harroni ta përmendni), ka qenë dhe është një preokupim i përditshëm dhe i përhershëm dhe duhet të dini se të luftosh burokratizmin, teknokratizmin dhe intelektualizmin, do të thotë të luftosh me forcë armiqë të stilit dhe të metodës revolucionare që na mëson Lenini.

5) Konstatojmë se për ju koncepti i shtetit dhe i aparateve të tij është antileninist. Shteti, diktatura e proletariatit, është shteti i punëtorëve dhe, sipas jush, punëtorët do të mërzhiten po të vijnë edhe nga ata në pushtet për ta freskuar aparatën, për ta revolucionarizuar, për të mos e lejuar që të burokratizohet. Partia jonë kurrë nuk mund të pranojë dhe të mos i luftojë këto parime që nuk njohin rolin historik të proletariatit, të cilit duhet t'i nënshtrohen të gjithë dhe të gjithë organizmat e aparateve të shtetit të tij. Ju keni një mendim të gabuar dhe pa baza për klasën tonë punëtore, ju e mendoni atë injorante, por gaboheni, pse keni besim më shumë te burokratët dhe teknokratët.

6) Për sa u përket teknikëve, Partia jonë është ajo që i ka krijuar dhe i ka mësuar që nga klasat e para të shkollës, derisa i bëri të vlefshëm për atdheun socialist. Ju mendoni me ligësi kur thoni se Partia jonë i nënvlef-tëson teknikët. Kjo nuk është bërë dhe s'do të bëhet kurrë. Ne ndjekim rrugën leniniste edhe në këtë çështje.

7) Ju nuk jeni në rrugën leniniste, kur afirmoni me prepotencë se në aparatet kërkohen njerëz të specializuar e kompetentë. Lexoni edhe një herë «Shtetin dhe revolucionin» e Leninit dhe do të mësoni ç'thotë ai për këtë çështje. Megjithatë, nga e nxorët ju mendimin se ne po qërojmë nga aparatet njerëz të zotë dhe sjellim të pazo-

të? Ne i njohim njerëzit dhe punët tona, ju nuk i njihni fare.

8) Ajo që thoni se qarkullimin e kuadrove ne e bëjmë siç e bënte Hrushovi, për të hequr qafe kuadrot revolucionarë, pra na akuzoni se jemi hrushovianë është kulmi i pikëpamjeve armiqësore, antimarksiste dhe hrushoviane tuajat kundër Partisë sonë dhe udhëheqjes së saj. Ky është një mendim provokator, pse as Partia jonë nuk është revizioniste dhe as udhëheqja e saj hrushoviane, siç i akuzoni ju.

Qarkullimi i kuadrove, që zbaton Partia jonë, është nga më leninistët, nga më revolucionarët. Me qarkullimin e kuadrove Partia jonë «nuk heq qafe revolucionarët», por bën atë që kuadri të qëndrojë kurdoherë i kuq, revolucionar, të freskohet, të lidhet ngushtë me masat, të largohet nga zyrat ku myket dhe të vejë të ndihmojë bazën me eksperiencën e tij. Antileniniste na qenka kjo? Për ju po, për ne jo.

Sipas jush, njerëzit që u zënë vendin atyre që qarkullojnë janë kundërrevolucionarë, për ne jo, këta janë po aq revolucionarë sa të parët dhe po aq të zotë në mos edhe më shumë se të parët.

9) Sa për fjalimin e Matit, që ka mbajtur shoku Enver dhe që ju bëni aluzion se gjoja eliminon degët e kuadrit, ju jeni krejt në gabim. As Partia, as shoku Enver nuk kanë eliminuar degët e kuadrit, dhe jo vetëm në formën organizative, siç e kuptoni thjesht ju, po Partia dhe shoku Enver kanë vendosur, dhe kjo ka qenë një prerogativë e përhershme, që politikën e kuadrit e bën Partia. Çka ju kritikoni në tezat e fjalimit të Matit për të drejtën e klasës dhe të masës që të prononcohet për kuadrin, është një kritikë që u bëni tezave të njohura të Marksit dhe të Leninit, të cilët thonë se kuadrot duhet të zgjidhen dhe të hiqen nga masat. Derisa të zgjedhësh dhe të heqësh një kuadër ju e quani të gabuar të pyesësh

masën dhe klasën, vallë kështu e kuptoni ju demokracinë proletare? Na duket se Leninin nuk e keni mirë parasysh. Praktika jonë është të pyesim klasën dhe masën dhe pastaj të vendosë Partia. Për ne ky veprim nuk është formal, por kështu ne zbatojmë porositë e Marksit e të Leninit dhe mos harroni se në vendin tonë në fuqi është proletariati dhe punët e veprat e të gjithëve janë të hapëta.

10) Bëni, gjithashtu, kritikën se në udhëheqjen tonë nuk e praktikojmë qarkullimin dhe se në udhëheqje duhet të vijnë punëtorë. Në qoftë se me këtë kuptoni që duhet të qarkullojnë edhe shoku Enver Hoxha dhe udhëheqës të tjerë kryesorë, kjo dëshirë nuk do t'ju plotësohet kurrë as juve, as armiqve të marksizëm-leninizmit.

Për sa i përket çështjes nëse në udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë duhet të vijnë punëtorë, ju nuk jeni në gjendje të dini sa kanë ardhur dhe sa duhet të vijnë. Këtë politikë di ta bëjë dhe e bën drejt Partia jonë. Mund të lejohemi, gjithashtu, t'ju themi disa gjëra në lidhje me udhëheqjen e Partisë sonë. Shumica e anëtarëve të udhëheqjes sonë punojnë në bazë, në çdo kongres bëhet qarkullimi i arsyeshem dhe i nevojshem. Kur një udhëheqës nuk punon mirë, përjashtohet nga udhëheqja dhe, kur del armik i Partisë dhe i shtetit të proletarëve, arrestohet, shkon në gjyq dhe dënohet sipas rëndësisë së fajit që ka bërë. Kjo është në vijën leniniste. Kjo nuk u pëlqen antileninistëve, prandaj na kritikojnë dhe na shajnë antileninistët. Por ajo tregon se ne jemi në rrugë leniniste.

SAJGONI U ÇLIRUA — FITORE E MADHE E POPULLIT VIETNAMEZ

Agjencia vietnameze e lajmeve «Çlirimi» njoftoi se sot, më 30 prill 1975, në orën 11³⁰, Sajgoni u çlirua dhe flamuri i Qeverisë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut u ngrit mbi ish-pallatin presidencial në Sajgon dhe në të gjithë qytetin.

Një fitore tjetër e madhe kjo mbi imperializmin amerikan pas një lufte të gjatë e heroike të popullit të Vietnamit, mbas asaj që shënoi këto ditë populli kambokhian. Edhe këtë fitore të popullit vëlla vietnamez ne do ta festojmë me mitingje, me shtyp e me telegrame drejtuar udhëheqësve të Vietnamit të Jugut. E meritojnë.

VIETNAME I JUGUT U ÇLIRUA

I gjithë Vietnamit i Jugut u çlirua. Sajgoni ra me luftë dhe jo në bazë të kompromisit të marrëveshjeve të Parisit. Me rënien e Sajgonit mori fund një nga luftërat më të gjata e më barbare që ka parë bota gjatë shekullit të 20-të. Imperializmi amerikan kishte zënë vendin dhe luante rolin e imperializmo-fashizmit hitlerian, kurse populli heroik vietnamez, për më shumë se 35 vjet me radhë, luftoi heroikisht dhe pa pushim kundër francezëve, kundër japonezëve, përsëri kundër francezëve dhe kundër amerikanëve. Nga gjatësia e luftërave kjo e Vietnamit u ngjet luftërave 100-vjeçare, 30-vjeçare etj. të shekujve të kaluar, por lufta e imperializmit amerikan në Vietnam ia kaloi egërsisë, barbarizmave dhe mjeteve që u përdorën në Luftën e Dytë Botërore.

Megjithëkëtë, populli vëlla heroik vietnamez luftoi me armë në dorë, rezistoi dhe fitoi. Fuqia më e madhe botërore, imperializmi amerikan, pësoi disfatën më të bujshme, më të turpshme, më të kushtueshme. 150 miliardë dollarë derdhën Shtetet e Bashkuara të Amerikës për luftën kundër Vietnamit dhe fituan me të turpin dhe urrejtjen e gjithë popujve të botës. Miqtë dhe aleatët e Shteteve të Bashkuara pësuan edhe ata deziluzionin më të madh dhe tok me të frikën që u ka kallur kjo fitore e popullit të Vietnamit dhe e atij të Kamboxhias.

Kjo luftë vërtetoi tezën leniniste se pushteti fitohet me pushkë, me luftë. Derri do plumb. Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionare duhen luftuar me armë nga popujt. Këta vetëm kështu mund të çlirohen. Rruga parlamentare dhe reformiste s'ka dhënë asnjë shembull, sipas të cilit populli dhe klasa punëtore të marrin pushtetin në këtë mënyrë. Revizionistët e reklamojnë shumë këtë rrugë, bile e theksojnë si të vetmen, pse ata janë kundër revolucionit, kundër revolucionit proletar, kundër çlirimit të popujve. Ata janë për pajtimin e proletariatit me padronët kapitalistë, ata janë për reformat ku proletarët të marrin thërrimet e sofrës së majme të kapitalistëve, ata janë për «kompromisin historik» të revizionistëve italianë, që u çanë të puthen me reaksionin italian. Kjo është rruga e sovjetikëve që e mbështetin kudo, për të dominuar mbi të tjerët. Këtë taktikë përdorin ata edhe me vietnamezët.

Revizionistët sovjetikë arritën t'i çonin vietnamezët në tryezën e bisedimeve për të shpëtuar fytyrën e Niksonit, mikut të tyre, tek i cili ata vinin shpresa të mëdha për marrje kredish, për modernizimin e industrisë së tyre të vjetër, për të vendosur sferat e influencës së të dyve. Marrëveshjet e Parisit ishin pjella e këtij kompromisi të ndyrë sovjeto-amerikan në kurriz të vietnamezëve. Marrëveshjet e Parisit ua zgjatën jetën dhe sundimin edhe dy vjet të tjera banditëve amerikanë dhe atyre sajgonezë. Vietnamezëve u duhej të vazhdonin të luftonin që të arrinin çlirimin e plotë, siç e arritën. Ne ua thamë hapur pikëpamjen tonë mbi marrëveshjen e Parisit se, pa e hedhur në shportë atë, nuk do të kishin çlirim. Dhe kështu ngjau.

Edhe tash që Vietnam i u çlirua, do të vazhdojnë intrigat sovjetike dhe amerikane, do të vazhdojë lufta e ashpër me mjete të tjera. Në rast se vietnamezët që kanë luftuar bien në kthetrat e revizionistëve sovjetikë ose

të ndihmës amerikane, atëherë ata po përgatitin për vete një robëri të re politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake. Në qoftë se do të ndjekin këtë rrugë, gjoja për të dalë nga kriza e tmerrshme reale ekonomike etj., që u ka shkaktuar kjo luftë shkatërrimtare, atëherë ata do të futen në zinxhirët e një krize të re të tmerrshme, ku ka hyrë gjithë bota kapitaliste dhe revizioniste.

Në qoftë se vietnamezët me këtë luftë të madhe dhe heroike që kanë bërë nuk kanë kuptuar kush ua shkaktoi luftën, kush ua zgjati, cilët ishin miqtë e vërtetë dhe miqtë e rremë dhe cila është ideologjia e vërtetë, ku duhet të mbështeten për të korrur fitoren tjetër të pasluftës, atëherë nuk kanë kuptuar gjë. Gjaku i derdhur do t'u shkojë kot dhe Vietnam i do të bëhet një Bullgari e dytë në Azi ose, më afër, një Mongoli e dytë, si ajo e Cedenbalit.

Revizionistët sovjetikë do të përveshin mëngët në Vietnam dhe, tok me agjenturën e tyre të vendosur me kohë në Vietnamin e Veriut dhe me mbeturinat e agjenturës amerikane të Sajgonit, do të kurdisin kashën për sofrën e tyre. Kujdes Vietnam, se ka rreziqe!

SHËNIM

Festën e 1 Majit e kaluam gëzuar, populli qe shumë entuziast, veçanërisht pionierët i vinin kapakun manifestimit ashtu si duhej. Ai ishte madhështor, emocionant.

Në tribunën qendrore ftuam përfaqësuesit diplomatikë të RP të Kinës, të RD të Vietnamit, të Republikës së Vietnamit të Jugut dhe të Mbretërisë së Kamboxhias. U gëzuan shumë. Populli manifestoi për ta.

POZITA E KAZHIMIEZH MIJALIT ËSHTË SHUMË E DYSHIMTË

Çështja e polakut Mijal, sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Polonisë, po bëhet përditë e më shumë e dyshimtë. Kritikak që bëri në adresë të Partisë sonë jo vetëm që ishin pa baza, por armiqësore. Këto kritika iu thanë shokëve Agim Popa dhe Koci Zengo me një arrogancë të madhe nga ana e tij. Ato nuk ishin si diçka spontane, por të menduara me kohë dhe ai gjeti rastin dhe i lëshoi si i porositur ose i urdhëruar nga dikush.

Mijali shkoi në Itali dhe atje u takua me një shokun e tij, i cili hapur i kërkonte takim, se ishte i dërguar nga sigurimi polak. Ne dy herë i sugjeruam se nuk duhej të shkonte. Megjithatë ai shkoi. Tash ne dimë bisedën që bëri polaku me shokun tonë në Romë dhe bisedën që na tha Mijali. Ato nuk korrespondojnë. Mijali këtu na fshehu të vërtetën.

Pas kësaj, kohët e fundit Mijali shkoi edhe në Kinë. Qëndrimi i kinezëve ndaj tij kishte ndryshuar qind për qind. Nga ftohja erdhi ngrohja, atje iu bë atij një «pritje madhështore, me popull». Këto na i tha vetë Mijali, i cili qe «çuditur».

Mos ia bënë për t'i ngritur Mijalit kredinë në sytë tanë, kur «puna e partisë së tij në Poloni» është në duart e sigurimit? Edhe këtë ai na e tregoi vetë, se ia kishte

thënë «shoku i tij» që e takoi në Itali. Pas ardhjes nga Kina, i pari veprim politik që bëri Mijali ishte sulmi kundër Partisë sonë. Kjo as që na çudit, agjentura revizioniste është e kurdisur dhe aktive kundër Partisë sonë.

Kur Agim Popa i çoi përgjigjen tonë këtij provokatori, ky i tha:

— se gjoja janë shtrembëruar thëniet e tij;

— se e konsiderojmë si armik;

— se udhëheqja jonë nuk pranon kritika dhe ai nuk do të bëjë më.

Ai kërkoi që t'i jepej «letra» që e kritikonte. Agimi i tha «kjo nuk është letër që të drejtohet ty, por përgjigje e atyre akuzave që bëre».

E MARTE

6 MAJ 1975

FITORE QË DUHET KONSOLIDUAR NË RRUGËN MARKSISTE-LENINISTE

Fitorja e Kamboxhias dhe e Vietnamit është një fitore e madhe që duhet konsoliduar. Është fakt se imperializmi amerikan dhe kukullat e tij të Pnom-Penit dhe të Sajgonit dështuan, por duhet shtypur reaksioni i brendshëm, duhet luftuar korrupsioni moral, politik dhe ekonomik, duhet zhdukur banditizmi, kaosi, tregu i zi dhe rrëmuja në trafik, duhet rindërtuar vendi i shkatërruar në një mënyrë të tmerrshme.

Këtë situatë të vështirë mund ta përballojë dhe ta përmirësojë vetëm një parti marksiste-leniniste, që i ka të qarta parimet, që di të zbatojë drejt e në mënyrë korrekte, në situatat konkrete të vendit, një vijë politike dhe organizative të drejtë, në qoftë se kjo parti e përcakton drejt dhe në rast se me programin e saj grumbullon rreth vetes masat e gjera të popullit.

Ndihma e jashtme, në rast se do t'u ofrohet, dhe me siguri do t'u ofrohet, duhet të jetë pa kushte. Po pranuan kushte, po nuk u treguan vigjilente, këto vende do të jenë të robëruara përsëri ekonomikisht e politikisht dhe partitë marksiste do të degjenerohen.

«Ndhma» e sovjetikëve dhe e satelitëve të tyre është vdekjeprurëse për ta. Në qoftë se nuk do ta kuptojnë këtë që në fillim, atëherë mbaruan. Edhe një majë gjilpëre që do të japin revizionistët sovjetikë, do të jetë e

helmatisur, do të jetë e skurjasur, do të jetë e shtrenjtë dhe do të konsiderohet prej tyre si «gozhda e Nastradinit». Sa gozhda të vendosin, aq predha dhe mina do të jenë kundër lirisë dhe sovranitetit të këtyre popujve. Ka shumë rrezik që nga varfëria, nga djegiet dhe nga barbarizmat që u shkaktoi lufta, këto vende të bien kokë e këmbë në kurthin që u ngrënë Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bashkimi Sovjetik është brenda në Vietnam, ai ka njerëzit dhe miqtë e vet vietnamezë, që me kohë bashkëpunojnë brenda. Armiku me kohë është në kështjellë. Por vietnamezët po u bëjnë thirrje për ndihma të gjitha shteteve, edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dyert po i hapin «për zemrat e mira» që i dogjën e i zhuritën dhe tashti i thërresin të vijnë të «ndërtojnë shtëpinë socialiste». Pikëpamje «të çuditshme socialiste»! Atdheun e tyre ata duhet ta ndërtojnë me forcat e veta, **ndihma e jashtme është vetëm e dorës së dytë dhe duhet të jetë kurdoherë pa asnjë kusht.**

Tashti janë momente shumë delikate. Imperializmi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe socialimperializmi, Bashkimi Sovjetik, pësojnë disfata, por janë përsëri të fortë dhe agresivë, ata përdorin armët, por përdorin edhe gjoja ndihma ekonomike. Kjo të vret njësoj si arma, pse në vend që të të forcojë, të dobëson, të përgatit që të kthehesh në një fushë lufte dhe mish për top. Rreziku është i madh dhe i vazhdueshëm. Duhet vigjilencë!

E DIEL
18 MAJ 1975

TEN HSIAO PINI VIZITOI FRANCËN

Vazhdon hapja kineze në botën perëndimore me shkëmbim delegacionesh të nivelit të lartë. Agjencia HSINHUA njofton se dje pasdite i dha fund vizitës së tij zyrtare në Francë zëvendëskryetari i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, Ten Hsiao Pin. Gjatë qëndrimit në Paris ai ka zhvilluar bisedime me personalitetet më të larta zyrtare të Francës.

E MARTË
20 MAJ 1975

ÇU EN LAI PRET PRINCESHËN ASHRAF

Agjencia HSINHUA njoftoi se dje pasdite Çu En Lai, me funksionin e tij si kryetar i Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, ka pritur në spital ku është shtruar, princeshën Ashraf Pahlevi, motra dhe këshilltarja kryesore politike e shahut barbar të Iranit, Mohamed Reza Pahlevit.

E MËRKURË
21 MAJ 1975

JAO VEN JUANI PRET DELEGACIONIN E SHOQATËS SË MIQËSISË SHQIPËRI-KINË

Agjencia HSINHUA njoftoi se anëtari i Byrosë Politike të KQ të PK të Kinës, Jao Ven Juan, priti sot delegacionin e Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë, të kryesuar nga shoku Hekuran Isai¹, i cili ndodhet për vizitë në Kinë.

¹ Në atë kohë anëtar i KQ të PPSH dhe sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

ÇU EN LAI PRET MINISTRIN E JASHTËM TË LESOTOS

Sipas njoftimit të agjencisë HSINHUA, Çu En Lai, edhe pse i sëmurë e në spital, ka pritur dje ministrin e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Lesotos.

Çuja, pra, ka kohë të presë miqtë e tij «të ngushtë», por jo delegacionin tonë të miqësisë, i cili kthehet nesër në atdhe.

ÇU EN LAI PRET NJË DELEGACION RUMUN

Agjencia HSINHUA bëri të ditur se Çu En Lai priti dje në spital një delegacion qeveritar rumun, i cili ka shkuar në Kinë për të marrë pjesë në hapjen e një ekspozite industriale rumune.

Rumunëve u është bërë një pritje e posaçme. Sipas HSINHUA-së, në takimin e tyre me Çunë merrnin pjesë edhe Li Hsien Nieni, Gën Biaoja, ministri i Tregtisë së Jashtme, Li Çiani, e të tjerë.

NJERIU QË BREDH «HU MË HU»

Çaushesku është një aventurier që s'e ka shokun në botë. Aventurierë si ky bota kapitaliste ka me barrë, por Çaushi na hiqet si marksist dhe nën maskën e komunistit bredh «hu më hu». S'la vend pa shëtitur¹, s'la dekoratë pa marrë Çaushi, është shitur kudo, ka shitur bile edhe atdheun e tij. Këtij njeriu kinezët i buzëqeshin.

¹ Më 4 qershor Çaushesku u nis për një turne në disa vende të Amerikës Latine.

U RIHAP KANALI I SUEZIT

Sot u njoftua rihapja e kanalit të Suezit, që ishte mbyllur më 5 qershor të vitit 1967, për shkak të agresionit ushtarak izraelit.

Që kanali u rihap, u bë mirë, sepse do të përfitojmë edhe ne: anijeve tona do t'u shkurtohet rruga për në Oqeanin Indian. Por konditat në të cilat u bë kjo rihapje janë të rënda, në dëm të interesave të luftës së popujve arabë, në favor të Izraelit dhe të dy superfuqive.

KIM IR SENI VIZITON MIQTË E TIJ

Siç kanë njoftuar agjencitë e huaja të lajmeve, Kim Ir Seni po bën këto ditë një turné në disa vende të Ballkanit. Nga fundi i muajit maj ai ishte në Rumani. Nga fillimi i qershorit kaloi në Bullgari dhe më 5 qershor shkoi për vizitë në Jugosllavi.

Kimi po viziton kështu miqtë e tij të ngushtë.

LIDHUR ME KREDITË QË NEVOJITEN PËR PESËVJEÇARIN E GJASHTË

Bashkë me Hysniun bëmë mbledhjen me shokët e Qeverisë e të Komisionit të Planit të Shtetit për të biseduar përfundimisht mbi kërkesën për kreditë që do të kërkojmë nga Kina për pesëvjeçarin e gjashtë.

Vendosëm që shokët Adil dhe Petro, që shkojnë në Kinë më 14 qershor, të kenë tri variante në kërkesat e tyre dhe t'i diskutojnë këto shoqërisht me shokët kinezë, t'ua arsyetojnë atyre kërkesat tona ekonomikisht, por edhe politikisht.

U thamë, gjithashtu, të na mbajnë në korent për ndonjë çështje që do t'u dalë.

TAKIM ME SARIN ÇAKUN

Prita ministrin e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Kamboxhias, Sarin Çak, i cili më solli mesazhe nga Sihanuku dhe nga udhëheqësit e brendshëm dhe më vuri në dijeni për përfundimin e luftës, çlirimin e vendit, për kongresin që do të mbajnë, për luftën për rindërtim dhe vështirësitë që hasin, por që do t'i kalojnë. Më tha se Vietnami i Jugut ka sulmuar disa ishuj kamboxhianë dhe një fshat brenda kufijve tokësorë. E falënderova për informacionin që më dha dhe e dënova këtë akt të vietnamezëve të Jugut. Këta duhet të tërhiqen dhe të sillen si miq e vëllezër dhe jo si invadues.

TË SHPEJTOHET KËRKESA PËR DËMSHPËRBLIMET NGA RF E GJERMANISË

Nesti Nases i tërhoqa vërejtjen që po e zvarrit tre vjet me radhë kërkesën tonë për dëmshpërblimet e Luftës së Dytë Botërore nga Republika Federale e Gjermanisë. E porosita që praktikën mbi këtë çështje ta nxjerrin sa më parë nga dora dhe të mendojnë rrugët dhe mënyrat zyrtare të paraqitjes, meqë nuk kemi marrëdhënie diplomatike me këtë shtet. Nesti Naseja merret me gjëra të vogla dhe kam përshtypjen se ndjek një ritëm pune prej breshke. Ne kemi humbur të paktën dy vjet për këtë çështje, që është një e drejtë e ligjshme e popullit tonë. Gjermanët mund të mos na peshojnë fare, por ne u bëjmë një zhurmë të atillë, saqë të bindet dreqi! Ne fitojmë, ata humbasin.

Duhet parë edhe koniunkturat aktuale. Kina e ka grurë me Bonin. Ne, miqtë e Kinës, duhet t'i themi kësaj në mënyrë indirekte se Boni, me të cilin ajo po bën allishverishe të mira, ne na ka djegur e na ka bërë hi. Prandaj Republika Federale e Gjermanisë duhet të paguajë deri në një dhe, në qoftë se s'paguan, ne i ngremë boritë, të cilat do të bien në avaz të kundërt me të Kinës dhe jo për fajin tonë.

FILLOI PRESIONI I FORTË EKONOMIK KINEZ, POR NE KURRË NUK DO TË THYHEMI

Pas fasadës së pritjes, pas fjalimeve të zakonshme me formula stereotipe, Adil Çarçanin me shokët e tjerë të delegacionit tonë qeveritar i priti Çu En Lai për 15 minuta në spital. Ai i pyeti për shëndetin tonë dhe, në të ikur, u tha: «Nesër do të bëhem operacion, prandaj ju prita më parë. Ky operacion më bëhet për të më zgjatur jetën». Mund të jetë kështu, po mund të jetë edhe... «Lamtumirë, mos kërkonit më të piqeni me mua».

Sot morëm radiogram nga Adili, i cili na relatton mbi bisedën që kishte bërë me të zyrarisht Li Hsien Nieni, kryetar i delegacionit qeveritar të RP të Kinës, pas parashtrimit të problemeve nga ana e Adilit.

Përgjigjja e kinezëve dhënë kërkesave tona për kredi dhe ndihmë për pesëvjeçarin e afërt, ishte e ulët: Kinezët na akordojnë vetëm 25 për qind të kredisë që kërkuam, nga e cila 50 për qind për vepra dhe 50 për qind për materiale. Në këtë kredi futin edhe kërkesat ushtarake. Kjo është ndihmë sa për të mos thënë që nuk ju japim fare.

Arsyet që dhanë kinezët për këtë, janë si për t'u tallur: «Jemi një vend shumë i varfër». Kurse 5 vjet më parë, që ishin një «vend shumë më i varfër», na akorduan

një kredi disa herë më të madhe. Është çështje tjetër fakti që 20 nga 35 veprat që janë në marrëveshjet e përfunduara as që na i kanë dhënë akoma dhe, natyrisht, këto mbeten për pesëvjeçarin e ardhshëm, por dhe veprat që po ndërtojmë, na i shtynë tej pesëvjeçarit aktual.

Pesë vjet me radhë çdo zyrtar kinez, duke filluar që nga Çu En Lai, na thoshte: «Ndihma që ju japim ne është shumë e vogël, por pas dy vjetësh dhe në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do t'ju japim më shumë, se do të jemi më mirë». Kurse sot, sipas Li Hsien Nienit, na rezulton se gjendja e Kinës qenka «më keq», se Kina qenka bërë «vend shumë i varfër» dhe fjalët se «do t'ju ndihmojmë më shumë», i reduktuan në një ndihmë qesharake.

Për ne është e qartë se ky qëndrim i kinezëve nuk vjen ngase ata «janë të varfër», por është kundërveprim ndaj qëndrimeve të vendosura marksiste-leniniste të Partisë dhe të shtetit tonë për politikën e tyre të brendshme dhe të jashtme. Kinezët nuk janë dakord me politikën tonë të jashtme, për arsye se ne nuk ndjekim qëndrimet politike të tyre.

Ne nuk pranojmë që «imperializmi amerikan është më pak i rrezikshëm se socialimperializmi sovjetik», siç pretendojnë kinezët. Ne themi se «që të dy këta janë të rrezikshëm, dhe duhen luftuar ashpërsisht». Kinezët kanë deklaruar se janë pjesëtarë të «botës së tretë». Ne themi se jemi vend socialist dhe mbështetim atë politikë të drejtë nacionale antiimperialiste dhe antisocialimperialiste të çdo populli dhe shteti të së ashtuquajturës botë e tretë, botë e dytë, e ku ta dimë ne si vetëquhen e vetëndahen. Shqipëria është vend socialist, nuk konfondohet me kurrkënd dhe ka një politikë të pavarur marksiste-leniniste. Kinezët mbështetin NATO-n, Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar».

Ne jemi kundër qëndrimeve të tilla dhe nuk i konsiderojmë ato marksiste-leniniste. Të gjitha këto traktate

dhe organizma janë mjete në duart e imperializmit amerikan dhe të vendeve të tjera imperialiste, të cilat i përdorin për të shtypur popujt dhe për t'u hedhur në një luftë të tretë botërore për hegjemoni. Të tillë janë edhe Traktati i Varshavës, «Bashkësia socialiste» dhe KNER-i. Të dyja këto grupime e bashkësira duhen luftuar me ashpërsinë më të madhe. Lenini në kohën e vet organizma të tillë të borgjezisë kapitaliste i ka demaskuar, i ka dënuar dhe i ka luftuar me forcë.

Cilindo shtet, cilindo njeri, qoftë ky trockist, qoftë titist, qoftë çankaishist, po të thotë se «jam në kundërshtim me sovjetikët», kinezët e bëjnë mikun e tyre. Ne jemi kundër këtij parimi. Kontradiktat ndërmjet armiqve të socializmit ne dimë t'i thellojmë dhe i thellojmë me sa mundim, por më parë ruajmë parimet. Derrit dajë ne nuk i themi.

Këto qëndrime tonat e të tjera si këto është e qartë se kinezëve nuk u pëlqejnë, sepse ato u heqin maskën marksiste-leniniste që duan të mbajnë, prandaj na bëjnë presion. Ky presion është ekonomik, sepse politikisht dhe ideologjikisht nuk mundën të na thyenin dhe nuk do të na thyejnë dot kurrë. **Ky është nga ana e tyre fillimi i bllokadës së fortë ekonomike. Po edhe në këtë drejtim ata do të dështojnë. Ne nuk do t'i përulemi kurrë askujt, as kinezëve dhe as ndonjë tjetri.**

Është e qartë se ky qëndrim nga ana e tyre bën pjesë në një komplot të madh imperialisto-revizionist që kurdiset kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Shqipërisë socialiste. Ky akt i kinezëve nuk mund të konsiderohet i veçuar nga presioni i madh politik, ideologjik, propagandistik, ekonomik dhe ushtarak që na bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe sateletitët e tyre, duke përfshirë këtu edhe ato shtete të «botës së tretë», siç konsiderojnë kinezët Jugosllavinë dhe Rumaninë. **Presioni i këtyre nuk është imagjinar, po**

u konkretizua në komplotin ushtarako-ekonomik të kryesuar nga Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Lipe Nashi etj. Qëllimi i këtyre tradhtarëve ishte likuidimi i Partisë dhe i udhëheqjes së saj marksiste-leniniste, që Shqipëria socialiste të kthehej në një vend revizionist. Një të tillë Shqipëri ëndërrojnë sovjetikët, jugosllavët, kinezët etj. Të gjithë këta janë në kundërshtim dhe në luftë me politikën marksiste-leniniste të Partisë sonë, prandaj kanë organizuar me agjenturën e tyre komplotin brenda vendit tonë, e kanë ndihmuar dhe vazhdojnë ta ndihmojnë atë edhe tash që e zbuluam dhe po e likuidojmë. Këto shtete, me aktet e tyre, vazhdojnë të nxitin këtë agjunkturë të mundur nga goditja që i dhamë, vazhdojnë ta inkurajojnë atë dhe me këtë veprimtari mendojnë të na dobësojnë dhe të na bëjnë presion ekonomik etj., që ne të mos i dënojmë rreptë tradhtarët. Bllokada ekonomike aktuale që na bëjnë kinezët, këtë qëllim ndjek.

Agjentë të kujt ish in tradhtarët që zbuluam? Kjo s'ka rëndësi. Ata kryesisht ish in agjentë të sovjetikëve dhe të jugosllavëve, por këtu kanë gisht edhe kinezët, mbasi pikërisht tani që ne jemi në vështirësi, me qëndrimin e tyre këta përpiqen të na i shtojnë vështirësitë.

Vallë, kështu veprojnë miqtë? Jo! Si veprouam ne, kur Kina u ndodh në vështirësi të mëdha dhe e izoluar nga të gjithë? Ne e ndihmuam me të gjitha forcat, qëndruam vetëm përpara furtunës së madhe që sulmonte Kinën dhe luftuam tok me të, deri në fund. **Beqir Balluku dhe grupi i tij ish in jo vetëm agjentë të vjetër të sovjetikëve, por u lidhën edhe me kinezët. Plani strategjik armiqësor që po përgatiste Beqir Balluku, po hartohej me sugjerimin e Çu En Lait. Vetë Beqiri na tha se këtë plan «ia propozoi Çuja», kurse ne ia hodhëm poshtë sugjerimin e tij, si armiqësor. Beqir Balluku punoi në**

fshehtësi në atë drejtim që i tha Çu En Lai, domethënë për «tërheqje në male», për «aleancë me Jugosllavinë dhe me Rumaninë». Kjo përmbledh gjithë strategjinë revizioniste kineze dhe jo vetëm strategjinë ushtarake, por edhe atë politike dhe ideologjike. Ne e shqelmuam këtë strategji armiqësore, pse ishte në favor të NATO-s dhe të sovjetikëve, si dhe në favor të kinezëve. Kjo strategji synonte që Shqipëria të kthehej në një shesh intri-gash dhe lakmish për fuqitë e mëdha. A nuk është vallë shumë i errët plani kinez? Po në marrëdhëniet ekonomike me ne, këto vitet e fundit, si vepruan kinezët? Më e pakta gjë që mund të themi, ata nuk ishin aspak korrektë.

Është e vërtetë se kinezët na akorduan një kredi të mirë për pesëvjeçarin e pestë, por janë larg plotësimit të detyrimeve të tyre. Nga 35 vepra që do të na jepnin gjithsej, vetëm 10 a 15 na dhanë. Disa vepra as që i kemi filluar dhe kjo jo për fajin tonë. Tri vepra të mëdha, metalurgjinë, Fierzën dhe Ballshin, për të cilat na u desh të bënim një luftë të madhe, mezi i filluam. Megjithatë, përfundimi i tyre u shty për një ose dy vjet tej afatit të caktuar me kontrata. Gjithashtu edhe kjo shtyrje u bë jo për fajin tonë.

Të gjitha këto ndodhnin në atë kohë që Beqir Balluku po organizonte komplotin ushtarak dhe Abdyl Këllezi me Koço Theodhosin na sabotonin naftën dhe ekonominë në përgjithësi. Të rastit ta quajmë këtë koordinim në qëllime dhe në kohë? Po kur likuiduam puçin tradhtar ushtarak, kur i dhamë goditjen Abdyl Këllezit e kompani, a nuk na treguan kinezët dhëmbët e ujkut? Ka shumë mundësi që Abdyl Këllezi, duke qenë njeriu i jugosllavëve, të ishte njëkohësisht edhe i kinezëve. Ky, pra, na del një komplot shumë i gjerë, me pjesëmarrje të shumë shteteve armike, të cilat duan të ndryshojnë me dhunë gjendjen në Shqipëri.

Unë besoj se Kina ka gisht në këtë komplot, po vallë

cila Kinë? Këtu ka gisht Kina revizioniste, korrenti revizionist, që duhet të jetë i fortë dhe në fuqi.

Këtë situatë të vështirë ne, me siguri, do ta përballojmë me sukses. Do të tendosim akoma më shumë energjitë kolosale të popullit dhe të Partisë, patriotizmin e zjarrtë të tyre dhe do ta thyejmë edhe këtë bllokadë, siç i kemi thyer të gjitha të tjerat. Ne do të ecim me kujdes. Nuk do të jemi ne që do t'i presim urat e miqësisë me Kinën. Mendimet tona dhe pakënaqësinë tonë do t'ua shprehim hapur dhe shoqërisht shokëve kinezë, prandaj përgatitëm një përgjigje zyrtare, që Adili do t'ua thotë gojarisht se ç'mendojmë ne për ndihmën jashtëzakonisht të vogël që na akorduan. Ne do t'u themi se nuk mund ta kuptojmë këtë veprim pa asnjë bazë dhe në kundërshtim me të gjitha ç'na janë thënë më parë nga ana e tyre. Ne do t'u themi se ky qëndrim nga ana e tyre do të na dëmtojë rëndë jo vetëm ekonomikisht, por edhe politikisht.

Shokët kinezë duhet të kuptojnë se po gabojnë dhe se ne e kuptojmë ku e ka burimin ky gabim dhe ku synon të arrijë ky qëndrim i tyre.

E MËRKURË
18 QERSHOR 1975*

KINEZËT NUK NA JAPIN TË GJITHA OBJEKTET INDUSTRIALE

Morëm një radiogram nga Adili. Grupi kinez i punës, i kryesuar nga Fan Ji, komunikoi se ç'objekte industriale do të na akordojnë. Nga 20 që kërkonim ne, kanë hequr 10, domethënë na japin 10 objekte. Nga këto të 10-ta që na lënë, përveç një ose dy prej tyre, të tjerat janë të reduktuara si kapacitet, nga ç'kishim kërkuar. Nga ato që na hoqën, më të rëndësishmet për ekonominë tonë janë hidrocentrali i Komanit (na kanë dhënë hidrocentralin e Bushatit, që është i vogël), uzina për prodhimin e uresë dhe ajo për prodhimin e sodës, që është shumë e leverdishme për ne, pse prodhimet e saj do t'i kemi edhe për eksport. Ne, natyrisht, do t'u themi më parë kinezëve se çfarë mendojmë për ndihmën që na japin, dhe, në qoftë se ata nuk lëvizin, atëherë duhet të kërkojmë që të na jepen këto tri vepra kryesore që përmenda, dhe të heqin nja dy a tri objekte nga ato që na dhanë e që pa to ne mund të bëjmë. Do të presim deri të premtën radiogram tjetër, pas këtij të sotmit, që do të bëjë fjalë për pjesën tjetër të kërkesave tona, për materialet që u kemi kërkuar dhe, pasi t'i studiojmë së toku, të shtunën, me avionin kinez, t'i dërgojmë delegacionit tonë në Pekin udhëzimet e mendimet tona përfundimtare.

Me Hysniun, Hakiun dhe shokët e Qeverisë vendo-

sëm se cilat vepra duhet të kërkojmë brenda kredisë që na caktuan kinezët. Këto vepra janë: hidrocentrali i Komanit (në vend të atij të Bushatit), uzina e uresë komplet për prodhimin e plehrave, uzina për prodhimin e sodës, si dhe pajisje për minierat dhe lëndë eksplozive.

Për variantet e tjera, Adili i ka listat se çfarë duhet të kërkojë. Për këto ramë dakord që t'i jepet ndonjë udhëzim suplementar.

Më 20 qershor Adili do të na dërgojë me siguri letër me avionin kinez për materialet që na akordojnë.

Do të shohim ç'efekt do të bëjë deklarata jonë, po shpresa nuk kemi. Ata nuk janë të dispozuar ta shohin politikisht problemin në favorin e Shqipërisë socialiste.

KINA PO FUTET NË INGRANAZHIN E LOJËS POLITIKE TË TË DY SUPERFUQIVE

Kina tregohet pro dhe mbështet Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar».

Cili është synimi strategjik i Kinës dhe a mbështetet ky në parimet marksiste-leniniste? Që ta përcaktojmë këtë, duhet të përcaktohen qëllimet e vetë këtyre organizmave që mbron ose mbështet Kina.

Tregu i Përbashkët Evropian, kur u krijua, kishte për qëllim zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare në mes të pjesëtarëve, të cilët në fillim ishin 6 dhe pastaj u bënë 9. Qëllimi i këtij institucioni ishte të përfitonte sa më shumë borgjezia kapitaliste e çdo vendi pjesëmarrës, si edhe forcimi i ekonomisë kapitaliste të çdo shteti në veçanti e i të gjithëve në përgjithësi. Natyrisht, tok me rregullimin e problemit të marrëdhënieve doganore, u sistemuan edhe një sërë çështjesh të tjera, si problemi i çmimeve, problemet monetare e të tjera marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Në fillim Tregu i Përbashkët Evropian nuk kishte se si të mos e llogariste ekonominë e fuqishme amerikane dhe ta hidhte çapin gjoja si të veçuar prej saj, por, në fakt, të bashkërenduar me çapin e imperializmit amerikan. Ky i fundit, fill pas Luftës së Dytë Botërore, me «ndihmat» që dha, kontribuoi në mëkëmbjen ekonomike të Evropës Perëndimore, por për asnjë çast ai nuk harroi

interesat e tij, të cilat ishin dhe u bënë të mëdha. Pra, me krijimin e Tregut të Përbashkët Evropian, vazhduan, nga njëra anë, përpjekjet e imperializmit amerikan për t'i diktuar këtij institucioni politikën e tij ekonomike dhe, nga ana tjetër, vazhduan përpjekjet e pjesëtarëve të Tregut të Përbashkët Evropian për t'u çliruar nga tutela amerikane. Lindën kështu kontradikta midis tyre, të cilat erdhën duke u thelluar.

E ashtuquajtura luftë e ftohtë i mbulonte ca këto kontradikta, sepse pjesëtarët e Tregut të Përbashkët Evropian, edhe në qoftë se fillonin seriozisht të tregoheshin të pavarur ekonomikisht, nga ana e mbrojtjes ishin të detyruar të rronin nën ombrellën atomike amerikane. Natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dinin të shfrytëzonin në favor të tyre ndjenjën e frikës që u lindte vendeve të Tregut të Përbashkët Evropian nga një luftë me sovjetikët.

Tradhtia e hrushovianëve largoi nga borgjezia kapitaliste frikën nga revolucioni dhe nga komunizmi, ndihmoi kapitalin botëror, i dha këtij mundësi të merrte frymë. Tradhtia hrushoviane përçau forcat revolucionare në të gjithë botën, largoi revolucionin proletar, ndihmoi shfaqjet nacionaliste dhe u dha kohë e mundësi borgjezëve kapitalistë të forconin pozicionet e dobëta të tyre të brendshme në kurriz të revolucionit proletar dhe të ndërmerrnin veprime dhe kombinime të tjera ndërmjet shteteve në arenën ndërkombëtare. Hrushovianët social-imperialistë, të fryrë me ndjenjën nacionaliste, aspironin për ta kthyer Bashkimin Sovjetik nga një shtet socialist në një superfuqi imperialiste atomike dhe punuan derisa ia arritën këtij qëllimi. U bënë kështu dy superfuqi, të cilat konkurrojnë për hegjemoni botërore. Ligji i të dyve, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i Bashkimit Sovjetik, është ligji i luftës për grabitje, është ligji i skllavërimit të popujve. Ky ligj shoqërohet me realizimin

e «aleancave» të përbindshme, me zaptimin me forcë të maskuar të pikave strategjike, për t'i përdorur ato për përgatitjen e luftës, me armatosjen deri në dhëmbë dhe me shtimin e armatimeve atomike, çdo ditë e më moderne, shoqërohet me grabitjen dhe gllabërimin ekonomik dhe politik të shumë shteteve me anën e frikës, shantazhit, kredive e «ndihmës» dhe të subversionit.

Në këto situata koniunkturale, Evropa Perëndimore mori më tepër kurajë. Franca me Dë Golin zhvilloi një politikë më të pavarur nga amerikanët dhe në përgjithësi nga anglosaksonët. Dë Goli doli nga NATO-ja, duke respektuar vetëm traktatin. Sigurisht, edhe Dë Goli ëndërronte një Treg të Përbashkët Evropian dhe një «Evropë të Bashkuar», ku, pa neglizhuar Gjermaninë e Adenauerit, të dominonte Franca. Dë Goli ishte i fryrë me një nacionalizëm të madh, gjë që e kërkonte edhe nga partnerët e tjerë të tij, por të kanalizuar në një të tillë Evropë, siç e ëndërronte ai. Natyrisht, synimet e Dë Golit nuk mund të arriheshin, pse edhe partnerët e tij kishin qëllimet, synimet dhe frikën e tyre. Këto shtete nuk e konceptonin të tërë njësoj rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë dhe në botë. Gjermania Perëndimore, në radhë të parë, aktualisht e ndarë nga pjesa tjetër e vendit, preferon t'u bëjë disa koncesione Shteteve të Bashkuara të Amerikës në fusha të tjera, pa ndjekur rrugën e Francës në shkëputjen nga mbrojtja amerikane. Gjermania dhe partnerët e tjerë nuk e vlerësojnë «forcën atomike» jo vetëm të Francës, por as atë të Anglisë, bile as të Anglisë dhe të Francës të marra së bashku. Kjo forcë, mendojnë ata, është një «shkurtabiq» përpara forcës bërthamore sovjetike ose amerikane.

Të gjitha këto fuqi imperialiste, qofshin dy superfuqitë, qoftë «Evropa e Bashkuar», qoftë Japonia, aspirojnë për hegjemoni. «Evropa e Bashkuar», që kur filluan kriza e rëndë e dollarit dhe disfatat ushtarake

amerikane në Azinë Juglindore — në Vietnam, në Kamboxhia e gjetkë, ka filluar të rirforcojë pozitën politike të brendshme dhe të aspirojë më shumë, që, si një organizëm më vete, të kthehet në një superfuqi të re kapitaliste dhe imperialiste. Ja pra, këtë «Evropë të Bashkuar» inkurajon dhe ndihmon Kina e Mao Ce Dunit. Këtë «Evropë të Bashkuar» inkurajon dhe ndihmon Franca e Pompidusë dhe më pas ajo e Zhiskarit, e cila jo vetëm përpiket ta ruajë dhe ta zhvillojë më tej forcën e saj bërthamore, por ka filluar më aktivisht të ringjallë politikën e vjetër kolonialiste me petka neokolonialiste në Afrikën frankofone, në Lindjen e Mesme dhe në Lindjen e Largme. Forcat e saj ekonomike nuk e lejojnë Francën të konkurrojë të tjerët, por, me aq sa mundet, ajo këtë e bën. Qëndrimi i Francës ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk është më si ai i kohës së Dë Golit dhe të Pompidusë. Tani ky qëndrim është ca më i zbutur, por, megjithatë, në të duket pavarësia e saj. Edhe Anglia vazhdon të forcojë disi ndikimin e humbur ekonomik në vendet e Komonuelthit, kurse Boni po ndërhyrë ekonomikisht në Evropën Qendrore, në Ballkan (përveç Shqipërisë), në Turqi dhe kudo ku mundet rreth e rrotull.

Të gjitha këto përpjekje të tyre mund ta shtojnë potencialin ekonomik të përbashkët, i cili duhet të jetë një faktor për të qenë një superfuqi. Por, për t'u bërë superfuqi, nuk mjafton vetëm ky faktor. Kësaj «Evropë të Bashkuar» i mungon forca bërthamore që kanë dy superfuqitë. Nga ana tjetër, në këtë «Evropë të Bashkuar» ekzistojnë kontradikta të mëdha politike dhe ekonomike ndërmjet shteteve që e përbëjnë, saqë as për dhjetëra vjet nuk mund të arrihet prej saj ai potencial ekonomik dhe ushtarak që kanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. «Shtetet e Bashkuara të Evropës» nga shumë pikëpamje nuk u ngjasin Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është zor që këto shtete evropiane të asimilohen,

siç janë asimiluar ato shtete të kontinentit amerikan, nga të cilat u formuan Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çdo shtet në Evropë ka personalitetin e tij si komb, të formuar historikisht, me shekuj. Gjithsecili prej tyre ka historinë e vet, ka zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të ndryshëm prej të tjerëve. Çdo shtet kapitalist e revizionist evropian në vetvete ka brendapërbrenda kontradikta të forta klasore, të cilat e bëjnë të zorshëm jo vetëm unitetin e jashtëm, por edhe atë të brendshëm.

Pra, të mbështetësh, siç po bën Kina, një rrugë të kapitalizmit evropian, i cili aspiron për hegjemoni, aspiron të bëhet një superfuqi, parimisht nuk është e drejtë. Të veprësh kështu do të thotë të lësh në harresë rrugën e revolucionit dhe të futësh në ingranazhin e lojës politike të dy superfuqive, duke luftuar dhe duke manovruar nga pikëpamjet e politikës së tyre, duke mbivlerësuar manovrimet e superfuqive në situatat koniunkturale të kontradiktave që kanë dhe duke nënvleftësuar revolucionin proletar botëror, duke nënvleftësuar luftën e popujve kundër superfuqive dhe shteteve kapitaliste borgjeze. Kina gabon kur predikon se «armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më pak të rrezikshme». Shtetet e Bashkuara të Amerikës është e vërtetë që kanë pësuar disfata, por ato mbeten fuqi imperialiste. Të dobësosh luftën kundër tyre do të thotë të dobësosh revolucionin dhe të ndihmosh imperializmin amerikan. Të njëjtin gabim do të bëjnë kinezët, në rast se Shteteve të Bashkuara të Amerikës «do t'u ngrihen qimet e ujkut»; atëherë Kina do të fillojë të thotë se «Bashkimi Sovjetik është më pak i rrezikshëm, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bënë më të rrezikshme». Kina gabon kur vihet në pozitë e Don Kishotit ndaj Evropës së vjetër kapitaliste, gjoja sepse kjo do të bëhet një kundërpeshë për sovjetikët nga njëra anë dhe për amerikanët nga ana tjetër, kurse «Kina

do të fitojë», meqenëse ajo mbështet «Evropën e Bashkuar».

Kontradiktat ndërmjet imperialistëve duhen thelluar dhe shfrytëzuar në dobinë tonë, por vetëm nga pozitë klasore, nga pozitë e revolucionit proletar. Këtë Kina nuk e bën, por bën të kundërtën, duke u thënë popujve të Evropës, të Amerikës dhe të «botës së tretë»: «Mbështetni borgjezinë tuaj kapitaliste dhe imperialiste, sepse armiku kryesor është socialimperializmi sovjetik». Kjo rrugë nuk është leniniste, kjo nuk nxit revolucionin, por mbron atë oportunist që mbrojti Internacionalja e Dytë, të cilën e ka demaskuar Lenini. Ne, pra, nuk mund të pajtohemi me këtë strategji dhe taktikë të Kinës. Për ne lufta kryesore kundër superfuqive imperialiste dhe kapitalizmit botëror është lufta e popujve, lufta e proletarëve, është revolucionin proletar botëror. Në këtë prizëm dhe duke i mbështetur këto luftëra të drejta, ne duhet të manovrojmë dhe të përfitojmë nga koniunkturat, duke ndihmuar në thellimin e kontradiktave.

Kontradiktat dhe krizat në gjirin e imperializmit, të socialimperializmit dhe të kapitalizmit botëror e kanë burimin në shtypjen e popujve nga kapitalistët dhe në luftën që bëjnë këta popuj kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist. Atëherë duhet nxitur dhe ndihmuar lufta e popujve kundër kapitalistëve, apo duhen ndihmuar këta të fundit që të manovrojnë për t'u majmur e për t'u bërë luftë njërit ose tjetrit imperialist, duke u thënë popujve «Shkoni e vrituni ju për mua»? **Marksistë-leninistët duhet të nxitin, të ndihmojnë dhe të bashkojnë forcat e tyre me luftën e popujve, me luftën e proletarëve kundër superfuqive imperialiste dhe kapitalizmit botëror. Këtë rrugë ka ndjekur dhe do të ndjekë Partia jonë e Punës.**

Politika e jashtëme, e gabuar e Maos, në këtë drejtim, të jep përshtypjen se është sempliste. Në këtë politikë

kinezët jo vetëm që nuk nisen nga pozitat klasore proletare, por, pa e thënë, bile edhe duke e mohuar me fjalë, ata ecin në rrugën e një fuqie të madhe. Kina nuk është një superfuqi, po ndikimi i saj në çështjet botërore është dhe mund të jetë i madh. **Kina mund të luajë dhe do të luajë një rol në botë në njërin nga këto dy rrugë: ose në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e revolucionit, ose në rrugën borgjezo-kapitaliste, me një nuancë të re revizioniste.** Vetëm duke milituar në rrugën marksiste-leniniste revolucionare, Kina do të fitojë besimin e popujve, të cilët duan dhe luftojnë për revolucionin.

Kina, aktualisht, përpqet të bindë vendet kapitaliste se «rreziku atyre u vjen nga Bashkimi Sovjetik». Se mos Kina po u mëson ndonjë gjë të re kapitalistëve të botës! Por armik kryesor kapitalistët kanë komunizmin dhe revolucionin. Në rast se Kina ecën në rrugën revolucionare, thënia e saj se «Bashkimi Sovjetik revizionist është armiku kryesor» jo vetëm që nuk do të bindë njeri, por gjithë kapitalistët, të çdo ngjyre qofshin, do t'i drejtojnë goditjet kundër Kinës. Në rast se aktualisht ata nuk ia kanë frikën Kinës, kjo ka disa arsye: ose sepse Kina është komuniste vetëm me fjalë dhe jo me vepra, ose sepse ende është e dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht, ose sepse është një faktor antisovjetik që duan ta përdorin deri në fund për të dobësuar agresivitetin e sovjetikëve kundër tyre.

Politika e të dy palëve, e kinezëve dhe e amerikanëve, ka për qëllim të luftojë Bashkimin Sovjetik, por, ndërsa kinezët duan të ndërsejnë amerikanët kundër Bashkimit Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tyre duan të ndërsejnë Kinën kundër Bashkimit Sovjetik. Të dyja palët e zhvillojnë këtë «*chassé-croisé*»¹

¹ Frëngjisht — ndërrim reciprok dhe i njëkohshëm i vendeve të të dy palëve.

nga të njëjtat pozita dhe me të njëjtat shpresa. Por veç Bashkimi Sovjetik nuk rri me duar lidhur. Ai përpqet të evitojë luftën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të dominojë mbi popujt që mund të shtypë vetë, të prishë aleancën e NATO-s dhe të izolojë Kinën, mundësisht edhe ta nënshtrojë atë. Dhe të gjitha këto synime ai i zhvillon nën maskën e socializmit.

Kapitalizmi botëror, dhe veçanërisht ai evropian, ka kaluar një sërë luftërash botërore, që e kanë pasë burimin në natyrën e tij të egër. Kështu që «Evropa e Bashkuar», ose Franca e Zhiskar d'Estënit, ose Gjermania e Shtrausit nuk gënjehen kollaj nga politika e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit. Ato nuk futen në luftë me sovjetikët, pse u fryn në vesh Ten Hsiao Pini. Jo, ato përpqen ta evitojnë përplasjen me Bashkimin Sovjetik, derisa atë e gjykojnë më të fortë se veten e tyre, përpqen ta krimbin kalanë nga brenda, pastaj të përgatitin goditjen. Të gjithë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia, Franca, Republika Federale e Gjermanisë etj., përpqen t'i dobësojnë sovjetikët, t'i dobësojnë në aleancat që kanë me Poloninë, me Rumaninë, me Çekoslovakinë etj., por ashtu siç do Kina, ata nuk ecin. Ujqit e vjetër i dinë mirë taktikat e sulmit, prandaj është zor t'i çosh në ato shtigje nga të vjen për mbarë ty, pse të tilla plane i kanë përdorur dhe vazhdojnë t'i përdorin vetë, pikërisht edhe në drejtim të Kinës. Presidenti i Francës me siguri e ka dëgjuar me një vesh të shurdhër përrallën e «rrezikut sovjetik». **Sigurisht Zhiskar d'Estëni i ka thënë Ten Hsiao Pinit se ne dëshirojmë ta zhvillojmë miqësinë me Kinën, por jo kundër Bashkimit Sovjetik, sepse duam të evitojmë konfliktin. Por, nga ana tjetër, d'Estënët me shokë indirekt nxitin Tenin të shkojë kundër sovjetikëve, të nxjerrë gështenjat nga zjarri dhe ata të bëjnë shir.**

Borgjezia evropiane është një kurvë plakë, që i ka bërë të gjitha të zezat. Ajo është e regjur në dredhi dhe

në intriga. Vetëm lufta revolucionare e proletariatit dhe e popullit i vjen hakut asaj. Në këtë terren lufte ajo demaskohet dhe thyhet, e humbet forcën e intrigës dhe të dredhisë. Nga ky terren duhet të luftojë edhe Kina, e cila duhet të niset nga parimi që njohjet diplomatike dhe tregtia me vendet kapitaliste të Evropës t'i shërbejnë një strategjie të shëndoshë revolucionare, e jo të përpiqet të ndërsejë Evropën Perëndimore kundër sovjetikëve. Këtë rrugë të gabuar të Kinës e kanë përdorur më parë Anglia dhe Franca për të nxitur Hitlerin kundër Bashkimit Sovjetik dhe Bashkimin Sovjetik kundër Gjermanisë. Ne e dimë rezultatit e këtyre manovrave. Stalini nuk ra në këto gabime, nuk ra as në pozitat e anglo-amerikanëve, as në ato të hitlerianëve.

Duke qëndruar në pozita të forta revolucionare, edhe kontradiktat e armiqve mund t'i shfrytëzosh më mirë, edhe t'i dobësosh në radhë të parë më të rrezikshmit, por pa harruar as ata që për një moment mund të jenë dobësuar e që mund të ringjallen. Po t'i gjykosh ngjarjet dhe situatat nga pozita revolucionare, e sheh qartë se nuk ke si mbështetje një faktor koniunktural, por ke një potencial shumë të fuqishëm dhe të qëndrueshëm në luftën kundër kapitalit, ke proletariatin e çdo vendi dhe në tërësi proletariatin ndërkombëtar, si edhe popujt që duan lirinë dhe revolucionin. Revolucionin duhet bërë duke luftuar edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe kundër Bashkimit Sovjetik.

E MËRKURË

25 QERSHOR 1975*

RRUGË ARMIQËSORE KUNDËR SHQIPËRISË NGA ÇU EN LAI E GRUPI I TIJ

Kinezët e përcaktuan përfundimisht ndihmën ekonomike që do të na japin për pesëvjeçarin që vjen. U mblodh komisioni i të dyja palëve. Komisionin kinez e kryesonte «i famshmi» Li Hsien Nien, i njohur mirë për ndjenjat e tij antishqiptare.

Adili paraqiti sinqerisht dhe miqësisht mendimin tonë për ndihmën që na akordonte RP e Kinës jo për pesë vjet, por për shtatë dhe deri tetë vjet, sepse disa vepra zyrtarisht e kapërcejnë kohën nga pesë deri në shtatë vjet, përveçse ç'mund të shtyhet akoma nga kinezët mbarrimi i tyre, me pretekste të ndryshme, që do të kenë për qëllim të vetëm të na dëmtojnë ekonominë. Në këtë mënyrë kanë proceduar kinezët edhe me veprat e pesëvjeçarit që po mbyllet, të cilat po kalojnë të papërfunduara në pesëvjeçarin që vjen.

Pra, Adili u shprehu kinezëve mendimin tonë «se shuma... për pesë deri shtatë vjet është një kufizim i madh që po na bëni, dhe kjo bie në kundërshtim me premtimet, në kundërshtim me gjendjen e avancuar të ekonomisë kineze dhe me gjendjen e bllokadës që i bëhet Shqipërisë nga imperialistët, socialimperialistët, titistët dhe fqinjët e tjerë kapitalistë. Për këtë ne jemi të pakënaqur», — u tha Adili, duke dhënë arsyet tona të shëndosha dhe rrëzoi «arsyet» e dobëta të tyre. Në fund ne

kërkuam që të rishikohej vendimi i tyre me dashamirësi dhe në frymë internacionaliste, sikundërqë edhe ne e rishikuam tonin dhe zbritëm kërkesat...

Li Hsien Nieni, ky armik i socializmit në Shqipëri, këlyshi i Çu En Lait, iu përgjigj Adilit në mënyrë të paturpshme, brutale, armiqësore, duke i thënë: «Propozimet tuaja nuk pranohen, ne as i marrim ato në shqyrtim; vendimi ynë është i prerë dhe i vendosur nga e gjithë udhëheqja jonë, duke përfshirë edhe Mao Ce Dunin». «Ne nuk lëvizim asnjë juan, — tha zoti Li Hsien Nien, — nga ato që kemi vendosur». Me fjalë të tjera, me këtë përgjigje ai donte të thoshte: «Po të doni, i merrni; po të doni, mos i merrni, aq na bëjnë neve thëniet tuaja».

Edhe kërkesës që mendimet tona, të cilat Adili ia dorëzoi Li Hsien Nienit edhe me shkrim, t'i komunikohen shokut Mao Ce Dun, Li Hsien Nieni iu përgjigj: «Do t'ia jap, por ju mos pritni asnjë përgjigje». Sipas tij, kjo donte të thoshte: ose «Maoja është vendosmërisht kundër që të denjojë t'u japë një përgjigje kërkesave të shqiptarëve», ose «po e marr këtë ekspozenë tuaj që nuk kam ndër mend t'ia jap Maos, por do ta hedh në shportë». Në të gjitha versionet që ta marrësh, klika armiqësore kundër Shqipërisë ka fuqi të mëdha në udhëheqjen e Kinës dhe u dikton vullnetin e vet miqve kinezë të Shqipërisë.

E gjithë kjo veprimtari është vazhdim i qëndrimeve armiqësore të këtij grupi në udhëheqjen kineze. Ky grup kishte shfaqur edhe më parë qëndrime të tilla, por qëndrimet revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë në mbrojtjen e Kinës, kur të gjithë, e theksoj të gjithë, i kthyen krahët dhe e sulmuan atë, i ndaluan njerëzit e këtij grupi t'i vinin në zbatim si të donin qëllimet e tyre armiqësore që kishin kundër nesh. Tash Maoja u plak, mundet që nuk e pyesin fare, mundet që nuk ia marrin fare mendimin

jo për çështjen tonë, të cilën, me sa dimë, ai e ka mbrojtur, por as për problemet e tjera të brendshme dhe ndërkombëtare. Vazhdon taktika e këtyre «shokëve» të dyshimtë kinezë: «Nën flamurin e Maos, bëjmë punën tonë», mendojnë ata.

Kjo që po na bëjnë kinezët, është fillimi i një presioni të fortë ekonomik, me anën e të cilit shpresojnë të na nënshtrojnë politikisht dhe ideologjikisht. Ata veprojnë si një fuqi e madhe jorevolucionare dhe aspak marksiste-leniniste. Ata nuk duan që ne të kemi një vijë të drejtë marksiste-leniniste në çdo drejtim, por duan që vija dhe qëndrimet tona të jenë një apendiks i vijës së tyre oportuniste, joparimore, koniunkturale. Njerëzit e këtij grupi janë në kundërshtim me vijën tonë dhe nisën presionin ekonomik, siç bënë revizionistët sovjetikë, duke menduar se do të na detyronin që të thyhemi.

Kjo rrugë armiqësore kundër Shqipërisë, nga ana e Çu En Lait dhe e grupit të tij, ndiqet në të njëjtën kohë kur në vendin tonë u likuiduan grupet armiqësore të Beqir Ballukut dhe të Abdyl Këllezit. Nga kjo del se këta ishin njerëzit e tyre, siç ishin njëkohësisht edhe të sovjetikëve e të jugosllavëve. Për të gjithë këta, për kinezët, sovjetikët dhe jugosllavët, nuk ishte e durueshme dhe e pranueshme kjo gjendje e shëndoshë e vendit tonë, prandaj, pavarësisht se si bëheshin lidhjet ndërmjet tyre, për të tri palët e përmendura, të gjithë ata që qenë armiq të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të udhëheqjes së saj marksiste-leniniste, ishin miqtë e tyre dhe ndihmoheshin në mënyra të ndryshme. Plani armiqësor i Beqir Ballukut ishte i diktuar nga Çu En Lai. Beqir Balluku punonte fshehtëzi për «antitezat» dhe për organizimin e puçit. «Antitezat» atij ia sugjeroi Çu En Lai. Ne ia hodhëm poshtë ato dhe Beqir Balluku mund t'i ketë vënë në dijeni kinezët.

Çuja i tha Beqir Ballukut: «Forconi lidhjet dhe bash-

këpunimin me Jugosllavinë, kundër sovjetikëve» dhe «për ju nuk ka strategji tjetër, përveç strategjisë së malit». Domethënë: «Ua mbathni këmbëve në male që në ditën e parë të sulmit armik»!

Plani Çu En Lai-Beqir Balluku ishte prosovjetik, sepse u linte këtyre dorë të lirë të pushtonin Shqipërinë; ai ishte edhe projugosllav, sepse synonte të likuidonte socializmin në vendin tonë. Zbulimi, demaskimi dhe dënimi i Beqir Ballukut dhe i njerëzve të grupit të tij, ishin njëkohësisht një grusht kundër Çusë, që kishte kurdisur këtë komplot me Beqir Ballukun dhe me Abdyl Këllezin, i cili edhe ky, si tradhtar, sabotonte naftën dhe ekonominë tonë popullore.

Çuja, pra, e humbi luftën që të na rrëzonte nga brenda dhe, në pamundësi të vepronte ndryshe, përdori armën e bllokadës ekonomike. Ai dhe grupi i tij mendojnë, si revizionistë, se ne do të izohemi, do të vdesim urie, do të gjuhëzohemi. Ata mendojnë: «Shqiptarët nuk kanë çfarë bëjnë» dhe Çu En Lai i përsëriti Adil Çarçanit planin e vjetër djallëzor: «Bashkohuni ngushtë me vendet e tjera të Ballkanit, pavarësisht nga mosmarrëveshjet që keni». Armik i ndyrë, pseudomarksist i urryer! Ne as gjuhëzohemi, as trembemi, as pa bukë nuk do të mbetemi, por do të rrojmë me nder, të lirë, të pavarur dhe sovranë si marksistë-leninistë, si komunistë shqiptarë, si bij të këtij populli të lavdishëm dhe heroik, që nuk është për-kultur në shekuj. Ne do të luftojmë ditë e natë në unitet, me forca të shumëfishuara kundër çdo armiku, ngado që të vijë. Flamuri i Partisë sonë kurdoherë do të valojë fitimtar në beteja. Me Partinë tonë në krye ne do të thyejmë çdo bllokadë, çdo komplot dhe populli ynë do të fitojë, do të ecë kurdoherë përpara me sukses në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Çuja dhe shokët e tij do të thyejnë kokën, si të tjerët, përpara kështjellës së çeliktë të Shqipërisë socialiste

dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, Parti e hekurit marksiste-leniniste. Komplot i poshtër dhe i bashkërenduar ky i grupit të Çu En Lait!!

Pikërisht pas një ose dy ditëve, kur Li Hsien Nieni i refuzonte kredinë Adil Çarçanit, duke i dhënë si arsye se «Kina është shumë e varfër», Radio Moska, në një koment për Shqipërinë, në mes të tjerash, thoshte: «Njerëzit e Tiranës tash e kanë kuptuar se Kina është një shtet i varfër. . . që nuk e ndihmon Shqipërinë» etj. Çfarë t'i themi kësaj? **Presion ekonomik i koordinuar kino-sovjetik?!**

Dy-tri ditë pasi Çu En Lai i tha Adil Çarçanit që «të bashkoheni me vendet ballkanike», një gazetë jugosllave, në një artikull të gjatë, pretendon se «Shqipëria, me gjithë mosmarrëveshjet, ka kthyer sytë nga Evropa dhe veçanërisht nga Jugosllavia në marrëdhëniet tregtare, kulturore» etj. Gazeta shton se «pas Kinës, Shqipëria bën më shumë tregti me Jugosllavinë» etj. **«Perspektivë» e mirëkoordinuar për ne nga Çu En Lai-Tito.**

Nuk ka si të mos lidhen këto fakte. Ndër të tjera që dimë, edhe këto vërtetojnë lidhjet me komplotin e Beqir Ballukut e të Abdyl Këllezit, me bllokadën dhe me «perspektivën» që na hap «i famshmi» Çu En Lai.

Të gjitha këto ne po i mbajmë shënim dhe do t'i shohim qëndrimet tona me të tillë njerëz, por do të jemi të kujdesshëm që të mos biem në provokacionin e tyre, pse ata këtë duan. Por neve nuk do të na e hedhin dot.

Ata po e prishin miqësinë, kurse ne do të vazhdojmë të flasim për të, natyrisht, jo me terma hipokritë, siç do të bëjnë ata për ne, për të larë m... me sh... Ne do të jemi korrektë, por mbaruan fjalët e zjarrita, derisa kjo klikë do të vazhdojë punën armiqësore kundër nesh.

Ne jo vetëm nuk u nënshtrohemi shantazheve të tyre, por kundër kësaj klikë do të tregojmë ftohtësi, në mos më shumë, derisa të mos mbajë më kupa dhe të demaskohet.

E MËRKURE
2 KORRIK 1975

BALLKANI, SUPERFUQITË, KINA DHE NE

Politika ballkanike ka hyrë në fazën dhe në gjendjen e gjysmës së shekullit të 19-të. «*Questions balkaniques, Les Balkans poudrière de l'Europe*»¹.

Fuqitë e mëdha po lëvizin fijet e tyre në prapaskena në Jugosllavi, Greqi, Bullgari, Rumani dhe Turqi. Shqipëria socialiste, për veten e saj, ua ka prerë fijet me gërshtë të madhe. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglinë ajo s'i qasi as te pragu i derës, që kur u çlirua, sovjetikët i shporri me forcë dhe të turpëruar. Kështu ua bëri edhe titistëve jugosllavë, kurse Italisë dhe Greqisë «ua vuri, siç thotë populli, kufinë te thana».

Pra, në vendet e mësipërme ballkanike mbretëron kaosi i brendshëm, kaos politik, ekonomik, kulturor. Nuk ekziston asnjë stabilitet, qoftë edhe borgjezo-kapitalist. Çfarë sallatë ruse! Të gjitha këto shtete trumbetojnë se bëjnë «një politikë të pavarur», se «janë independentë», se «luajnë një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare», gjoja njëri «në botën e të paangazhuarve», njëri me qëndrimet pseudoantisovjetike, tjetri me politikën prej lakeu të sovjetikëve, Greqia gjoja ka kundërshtime me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me NATO-n, Turqia, gjithashtu, është në kundërshtim me Greqinë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

¹ Frëngjisht — çështjet ballkanike, Ballkani fuçi baruti e Evropës.

Në këtë «çorbë derri», Bullgaria, si pion i sovjetikëve, reklamon diplomacinë, me një fjalë i bën presion dhe shantazh Jugosllavisë që të vejë të lidhet te grazhdi i sovjetikëve. Po kështu, i njëjti Zhivko, politikani pa vlerë, po këtë punë bën edhe me Rumaninë, por duke i kënduar kësaj një avaz tjetër: «Miqësinë e madhe dhe të sigurtë» nën ombrellën e djadja Ivanit. Çaushti e Zhivkoja venë e vijnë, priten me popull, betohen për miqësi, por, siç thotë populli, që të dy ia kanë njëri-tjetrit me lesh në bark.

Çaushti ka dalë në arenën ndërkombëtare si «një figurë e madhe». Ai bredh nga të katër anët e botës, mbledh dekorata, firmos deklarata bajate e stereotipe dhe nënshkruan me dhjetëra marrëveshje me çdo vend ku vete, marrëveshje që nuk realizohen, pse Rumania është një shtet i falimentuar, mufliz. Por Çaushesku do ta ngrejë në «një pedestal antisovjetik» Rumaninë, gjë që është një bluf. Politika e Rumanisë është një politikë me shumë dashnorë.

Gjendja politike dhe ekonomike në Rumani është plotësisht e korrumpuar dhe e rëndë. Çmimet po ngrihen, kush të vjedhë më shumë, shushunjat nga kudo i janë qepur trupit të shtetit dhe i pinë gjakun. Në krye qëndron shushunja e madhe, Çaushesku dhe klika e tij, që rron mbi korrupsion, që mbrohet me korrupsion. Kjo klikë e falimentuar, me paturpësinë më të madhe, flet fjalë të mëdha, lëshon parulla ndërkombëtare, shpall projekt-propozime në OKB për çarmatimin, bën amendamente për çështjen e «sigurimit evropian», për mbledhjet e partive revizioniste që predikon sovjeti etj. As që i skuqet faqja. «Vija» e Çaushtit është «të veshim politikën me rroba të bukura», «të mbulojmë falsitetin me mendjemadhësinë», me mburrjen, me arrogancën, me gënjeshtren dhe me blofin. Çaushti vetëm me shqiptarët nuk e ka mirë dhe as i duron, as i gënjen dot, prandaj ka urdhë-

ruar që tregtia me ne të pengohet, ambasadën tonë e ka vënë në ndjekje nga policia sekrete, shqiptarët që jetojnë atje i ka penguar të venë në ambasadën tonë dhe revistën tonë të ilustruar «Shqipëria e re», e pengon të shpërnda-het. Dhe me këtë shtet revizionist-kapitalist, me këta aventurierë antimarksistë, «miku» Çu En Lai na këshillon të bashkëpunojmë ngushtë, të bashkohemi kundër sovjetikëve.

Këto janë këshilla të neveritshme dhe katastrofike të një personi që nuk e njeh gjendjen, që nuk arrin të bëjë sinteza të drejta dhe të nxjerrë konkluzione reale nga gjendja, pse është një person armik, që mendon e vepron si armik, e që çdo gjë do ta vërë të ecë në rrugën e strategjisë së tij të gabuar globale. Sidoqoftë, në të dyja rastet, ne nuk i hamë kollaj «këshillat» e tij, ne nuk shkelim në dhogë të kalbur, pse jep mendje Çu En Lai, kryeministri i një shteti të madh. Ne jemi në gjendje të mendojmë dhe të gjykojmë me kokën tonë, ne i marrim në konsideratë edhe këshillat, edhe eksperiencën e mirë të shokëve dhe të miqve, por kurrë nuk mund të rrezikojmë interesat e popullit dhe të atdheut tonë socialist, duke u vënë veshin broçkullave të njerëzve të dyshimtë.

Për sa i përket Bullgarisë kjo është e tëra e integruar te Bashkimi Sovjetik. Vetëm emri dhe forma e jashtme, natyrisht edhe emrat e fshatrave dhe të maleve, i kanë mbetur bullgare, se çdo gjë tjetër bie erë e qelbët revizioniste sovjetike. Administrata e Todor Zhivkovit është e tëra në duart e sovjetikëve. Çdo nëpunës i lartë dhe i mesëm bullgar ka hijen e tij sovjetike, e cila është «hija» që sundon manekinin. Toka bullgare, vendet strategjike, aerodromet, portet, ushtria, të tëra janë në duart e sovjetikëve. Kuadrot, armatimet e divizioneve dhe të korp-armatave sovjetike janë të ngritura në Bullgari. Në momentin e sulmit, efektivitë sillet me avionë brenda një nate. E ashtuquajtura ushtri bullgare është një kuverturë

«couleur locale» e komanduar nga këshilltarë sovjetikë. Ekonomia bullgare atë çka mund ta ketë më të mirë, domatet e hershme, perimet, frutat i ka për Bashkimin Sovjetik. Ata palo motorë që bën, mund t'i shesë ku të dojë, për këta ka liri të plotë, kurse metalet e rralla, siç është uraniami, duhet të marrin rrugën e Moskës, e «ale-atit në shekuj». Dhe Bullgaria quhet e lirë, e pavarur dhe sovraane. Por hiqet dhe «e fuqishme». «Ëndërron» të marshojë mbi Stambollin. «Ëndërron» për Thrakën, pretendon për Maqedoninë, gërthet se ushtritë e saj të Borisit çliruan Jugosllavinë etj. Jo po, ato mend thyen tërë Gjermaninë! Këto «ëndrra» të Bullgarisë së Todorit s'janë hajale, po veprime me sy hapur.

Bullgaria e Zhivko hrushovianit është në pararojë për të shpënë kudo mendimin dhe dëshirën e sovjetikëve. Kasneci i këtyre të fundit është Zhivkoja, veçse të gjithë e dinë: në qoftë se grinden ose përqafohen me Zhivkon, këtë e bëjnë një manekin tragjik. Ai është njëkohësisht fitili i barutit në duart e sovjetikëve. E tillë u katandis Bullgaria e Dimitrovit. Për kinezët dhe për Çu En Lain hëpërhë kjo Bullgari prosovjetike nuk hyn në «politikën gjeniale ballkanike të tij». S'ka se si, duhet të jetë anti-sovjetike, që të jetë prokineze, duhet të jetë proamerikane, që të jetë prokineze dhe probalkanike.

Jugosllavia po, kjo i plotëson kushtet paraprake për Kinën. Me Jugosllavinë «mund të merreni vesh dhe mund të bashkoheni e të bashkëpunoni shumë mirë, pavarësisht se keni mosmarrëveshje», thotë Çu En Lai. Këtë gjë na këshillon ai ta bëjmë. Gjellë e helmatisur! «Marksist-leninisti» Çu En Lai na këshillon të shkelmojmë parimet dhe të puthemi me Titon e me titistët! Po kush janë këta? Njihen botërisht dhe për arsye se njihen botërisht, nuk mund të mendohet për asnjë çast se Çu En Lai gabohet në pikëpamjet e tij politike. Ai është i ndërgjegjshëm për atë që thotë.

Jugosllavia e Titos ka ardhur në buzën e humnerës, të katastrofës. Është e arsyeshme pyetja që bën sot gjithë bota: Ç'do të bëhet Jugosllavia pas vdekjes së Titos? Të kuptohemi, të gjithë e dinë që Titoja, në krye të klikës së tij antimarksiste dhe agjente e borgjezisë, e solli Jugosllavinë në këtë bankërutë kolosale shtetërore, politike, ekonomike, ushtarake, kombëtare. Pra këtu nuk është çështja e krizës së një personi, nuk është çështja se kush do ta zëvendësojë këtë person kur të vdesë, por është çështja e një shteti të tërë të bërë lesh e li nga një klikë antipopullore. Jugosllavinë as aktualisht nuk e mban dot Titoja në këmbë, por janë koniunkturat politiko-ekonomike të fuqive të mëdha nga jashtë dhe e klikave të brendshme që përplasen njëra me tjetrën. Të gjitha këto kanë interesat e tyre në Jugosllavi, koncesionet e tyre, kapitalet e tyre që duhet t'i mbrojnë. Atyre u leverdis të gjithave që ustai i këtyre koncesioneve që ka shitur Jugosllavinë t'u rojë edhe ca, por gjithsecila ka njerëzit e vet, zonat e influencës dhe këta veprojnë. Titoja arbitron si një politikan «i madh», megjithëse është i falimentuar.

Brenda ai i ka larë duart, çdo gjë e ka marrë lumi. Titoja dozon grindjet prosovjetike dhe ato proamerikane, balancon sa mundet kontradiktat e atyre që janë në fuqi rreth tij dhe të atyre që duan t'i rrëzojnë ata. Titoja, në pamundësi të bashkojë tendencat armiqësore në mes serbëve nga një anë dhe kroato-slllovenëve nga ana tjetër, përpiqet të balancojë «fuqinë» e tij me republikat e tjera, Maqedoninë, Bosnjë-Hercegovinën, Malin e Zi dhe krahinën e Kosovës. E tërë kjo punë është një mishmash politik «ballkanik», një supë ku kanë futur duart të gjitha shtetet imperialiste, socialimperialiste dhe kapitaliste, që e mbajnë gjallë Jugosllavinë me lëmosha e me kredi rrjepëse.

Këto kredi dhe të ardhurat e popujve të Jugosllavisë

janë vënë në haraç, me përjashtim të asaj pjese që u takon investitorëve të huaj, të cilët e mjelin rregullisht «lo-pën» jugosllave. Resti bëhet rrush e kumbulla nën drejtimin e sistemit të vetadministrimit. Ky vetadministrim titist u krijua që të grabitej pasuria shtetërore nga shtresat e larta dhe të mesme të regjimit titist. Renegatëve të marksizëm-leninizmit u duhej një sistem i tillë si urë për të kaluar nga fillimi i ndërtimit të socializmit në kapitalizëm. Duhej rikthyer prapa, të ndërrohej mentaliteti që krijoi në popull lufta nacionalçlirimtare, të organizohej instrumenti përkatës dhe borgjezia e re që ta bënte këtë kthesë. Borgjezia e re titiste u krijua, ajo u lidh me borgjezinë kapitaliste dhe me flamurin e antistalinizmit u rreshtua në një shtet agjenture në shërbim të imperialistëve amerikanë, në radhë të parë, pastaj në shërbim të mafias së zezë ndërkombëtare.

Kuptohet që Jugosllavia është në krizë të rëndë politike dhe ekonomike. Çmimet atje ngrihen çdo ditë në kurriz të masave, të cilat çdo gjë e blejnë me kredi. Punëtori atje vë në ankand pagën, djersën, ai punon për borgjezinë e brendshme dhe për padronët e saj të jashtëm.

Grindjet dhe kontradiktat në mes nacionaliteteve po shtohen, acarohen. Titoja, me gënjeshtër e me demagogji, përpiqet të mbajë në këmbë federatën. Por forcat centrifugale veprojnë, veprojnë dhe fuqitë e mëdha që, në pamundësi të vendosin hegjemoninë, do të preferojnë të vendosin zonat e influencës. Dhe këto zona influence po duken: amerikanët mbështetin Kroacinë e Sllloveninë, rusët Serbinë dhe Malin e Zi, kurse Maqedoninë ata ia rezervojnë Bullgarisë, ndërsa Kosovën, si ngaherë, e bëjnë pre të serbëve.

Jugosllavisë mund t'i përshtatet si një dorashkë fjala e urtë e minoritetit grek në Shqipëri «okso lilia, mesa

kaka»¹. Titoja ka zënë një rrugë për të «ndritur» politikën e jashtme dhe brenda politikën e «kakës». Ai hiqet dhe e trumbetojnë si një «politikan të madh», që e «dredh vallen» si të dojë, por janë të tjerët që e dredhin atë si të duan. Fjalimet e tij janë «të modës», me poza «*mata-mori*»², ç' thotë sot, nuk thotë nesër, ai ka një mënyrë jetese që ia kalon asaj të mbretëreshës së Anglisë, e cila ka hapëset e kashtës, kurse Titoja vë në ankand Jugosllavinë. Titoja dhe rezidencat e tij janë qendrat e vajtje-ardhjeve të «njerëzve të mëdhenj». Ai jep e merr, bie e shpie ku duhet, hiqet «lideri» i «botës së tretë», është i lidhur pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por flet nganjëherë si i pavarur. Të njëjtën gjë bën edhe me Bashkimin Sovjetik. Një kloun «i shkëlqyer», një iluzionist i mbaruar. Ky njeri i ka hyrë në qejf edhe Çu En Lait, i cili ka filluar ta imitojë e na këshillon edhe ne ta ndjekim në këtë valle makabre.

Te Titoja venë shumë njerëz, ai hiqet si «njeri me vlerë të madhe politike». Nuk mund të thuhet se nuk ka fare-fare vlerë, po me vite të tëra i është organizuar një tamtam i tillë nga specialistë të regjur, sa që çdo kryetar shteti ka qenë dhe është kurioz ta njohë këtë «kafshë» të çuditshme, që bluan si mulliri pa kokrra. Ç'të mirë mund të presë njeriu nga një person i tillë, nga i cili vetë vendi i tij është në kaos e po vuan e do të vuajë nga kjo politikë e Titos: «Ha të hamë me të dyja duart». Por, siç thotë populli, megjithëse në rastin e Titos kjo nuk përshtatet plotësisht, më mirë të të dalë syri sesa nami. Titos i doli nami si antistalinist, si ndërmmjetës, si shembull për të likuiduar socializmin në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore. Duke iu vënë të gjithë kësaj pune nga brenda Hrushovët, Gomulkat,

1 Jashtë me lulka, brenda me m...

2 Nga spanjishtja — mburravec (me poza).

Ulbrichtët, Novotnët, Zhivkot, Dezhët e Çausheskët dhe imperialistët amerikanë me Titon, Toliatin, Torezin e Marshenë nga jashtë, ia arritën qëllimit.

Socializmi në këto vende është histori «e lashtë».

Jugosllavia e kralëve dhe e Titos në çdo kohë ka qenë armike e betuar e Shqipërisë. Kralët dhe fuqitë imperialiste të kohës na i shkëputën Kosovën, Dibrën dhe toka të tjera shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi. Po kralët serbë rrëmbyen më vonë edhe një pjesë të krahinës së Vermoshit dhe Shën Naumin, si shpërblim që sollën Zogun në fuqi me anën e vrangelistëve. Titoja deshi që Shqipërinë gjatë kohës së luftës e më vonë ta kishte në zap. Edhe pas Çlirimit ai manovroi me skena e prapaskaena të na bënte republikë të shtatë të Jugosllavisë. Pasi dështoi, vazhdoi luftën subversive të na shkatërronte nga brenda dhe, duke shpresuar, filloi gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilët i persekutoi, i burgosi, i vrau e me qindra mijë i shpërnguli në Turqi.

Çu En Lai na sugjeron t'i harrojmë të gjitha këto, gjoja për të «shpëtuar» Jugosllavinë e gjoja edhe Shqipërinë nga rreziku sovjetik. Rreziku sovjetik është real, po atë e shkakton rreziku dhe kaosi titist. Çuja, me mendjen e tij «të hollë», mendon se ne, po të futemi në këtë furrë, do të dalim të padjegur. Rreziku për Shqipërinë shtohet njëqind herë po të ndjekim rrugën e Çusë. Ne jemi të vendosur të luftojmë socialimperialistët sovjetikë me armë në çdo rast, reziston ose jo Jugosllavia. Po rezistoi, ca më mirë, po nuk rezistoi, ne do të luftojmë. Por rezistenca e Jugosllavisë nuk është plotësisht e sigurt. Nga ana tjetër, Jugosllavia as që pyet për Shqipërinë, ajo e di që ndonjë e keqe prej saj nuk i vjen, dhe kjo është e vërtetë për sa i përket qëndrimit tonë. Për sa i përket qëndrimit të titistëve ndaj vendit tonë, s'ka asnjë siguri e garanci. Ne nuk e hamë atë që thotë Çuja «të bashkohemi» dhe të bëhemi mish për top për kralët

e rinj të Serbisë që bëjnë një mijë dredhira si me Lindjen, si me Perëndimin. Në lojën e shahut ne nuk bëhemi pionë as të Titos, as të Çu En Lait. Shqiptari nuk e ka pasë e nuk e ka kurrë zakon të ulë kokën para armiqve ose atyre që ia kanë me hile. Ne do të ndjekim këtë politikë që po ndjekim me Jugosllavinë dhe titistët të ndihen të kënaqur. Për sa u përket shqiptarëve të Kosovës, ata kanë të drejtë të kërkojnë e të mbrojnë të drejtat e tyre kombëtare e shoqërore të njohura me kushtetutë. Çuja po nuk qe i kënaqur, le të pijë uthull.

Fadil Hoxha, një antishqiptar me damkë dhe titist deri në lidhëset e këpucëve, në një fjalim televiziv, sulmoi shqiptarët e Kosovës, duke thënë se, meqë janë shumica, rrezik në ta është shovinizmi shqiptaromadh, rrezik më i madh nga ai serbomadh etj. Kjo tregon armiqësinë e titistëve kundër shqiptarëve, të cilët akuzohen si shovinistë-nacionalistë në një oqean të madh të shovinizmit serbo-kroat etj.

Mund të merret me mend ç'qëllime kanë këta armiq kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Politika «ballkanike» e Çu En Lait ka rënë në veshin e «mirë» titist jugosllav dhe tash gazetat jugosllave kanë filluar të shkruajnë artikuj se «Shqipëria u pajtua me Jugosllavinë, se të dy vendet kanë interesa të përbashkët, se tregtia me Jugosllavinë vjen pas asaj me Kinën» etj. I njohim mirë ne këto blofe jugosllave. I gjithë qëllimi është që të krijojnë opinionin se Shqipëria socialiste ka ndërruar rrugë dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk është më në vijën e saj të parë, por pajtohet me atë jugosllave dhe kineze.

Jugosllavët edhe mund të kenë të dhëna për qëndrimin e kinezëve kundër nesh, por edhe vetë ata nxjerrin konkluzione, që Kina ka kontradikta me ne dhe nderin «shkopin» të kapemi, pse mendojnë që u mbytëm. Por, me qëndrimet tona, ne do t'u tregojmë titistëve dhe indi-

rekt kinezëve se janë mbytur ata dhe jo ne. Ne qëndrojmë të patundur në vijën tonë të drejtë marksiste-leniniste. Jugosllavët dhe njerëzit e Çusë kanë ardhur në një konkluzion të përbashkët se «ne rrojmë të lirë në sajë të Jugosllavisë titiste, e cila është, sipas tyre, bastioni kryesor kundër sovjetikëve». Kjo nuk ka qenë ndonjëherë, nuk do të jetë edhe tash. Shqipëria i ka bërë llogaritë të luftojë dhe të fitojë edhe vetëm kundër një armiku eventual. Ne as jugosllavët, as Çu En Lai, nuk do të mundin dot aspak, as edhe me metodat propagandistike, të na ngatërrojnë në llumin e tyre.

Qëllimi i kinezëve injorantë është «bashkimi i Ballkanit» nën drejtimin e Rumanisë «antisovjetike» dhe Jugosllavisë «proamerikane». Kështu që Greqia demokrate proangleze, profranceze, pro edhe amerikane, si dhe Turqia e Iyer po me të tilla ngjyra, të bashkohen me «Shqipërinë prokineze» dhe me Bullgarinë prosovjetike. Shikohet qartë ç'sallatë ruse mendojnë të gatujnë kinezët dhe gjithë këtë «bashkim» ta vënë kundër sovjetikëve. «Të zgjuarit» e Pekinit e formuan bllokun evropian kundër sovjetikëve. Po kush i dëgjon dhe kush i ndjek në këto ëndrra të çmendura? Të gjitha vendet e Ballkanit e dinë që kjo nuk bëhet kurrë dhe është një lodër kalamanësh. Çdo vend i Ballkanit ka kontradikta të thella me njëri-tjetrin, ka interesa të kundërt, secili ka aleatë të ndryshëm, dhe, përveç Shqipërisë, gjithë të tjerët bëjnë një politikë pazari, përveç Shqipërisë, klikat që sundojnë në Ballkan janë të shitura te fuqitë e mëdha. «Kundërshtimet» që mund të duken herë pas here në mes tyre dhe fuqive të mëdha janë koniunkturale.

Të marrim Greqinë. Tërë kohën ajo ka rrojtur nën sundimin anglez, francez dhe amerikan. Tash duket sikur është e pavarur. Kjo nuk është e vërtetë. Greqia jep përshtypjen e «një demokracie borgjeze» me shumë parti, të një republike konstitucionale. Ajo është në pozita

antiturke, pse Turqia sulmoi Qipron, që grekët më parë donin ta futnin nën gunën e tyre. Turqve iu hap oreksi, kërcënojnë me invadim edhe Dodekanezin. Greqia e Karamanlisit, për të qëndruar në fuqi, duke u mbështetur në shovinizmin pseudodemokrat grek, e hoqi një këmbë nga NATO-ja për t'u bërë presion Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë vendosur njëfarë embargoje mbi armët që i japin Turqisë. Situata, pra, zhvillohet kështu: Sovjeti u buzëqesh edhe Greqisë, edhe Turqisë. Kësaj tash së fundi i jep 700 milionë dollarë kredi, kurse Karamanlisit i dërgon deklarata e buzëqeshje me anë të Zhivkos, i cili e priti me triumf kryeministrin grek në Sofje. Zhivkoja i «premtoi miqësi shekullore». Të dy palët ranë dakord se nuk ekziston as Maqedoni, as popull maqedonas. Zhivkoja u përpoq të merrte koncesione portuale në Aleksandropolis në Thrakë, por nuk ia arriti dot qëllimit. Karamanlisi nuk kishte vajtur në Bullgari për të shitur «atdheun», por për të krijuar përshtypjen ndaj Turqisë se Greqia ka miqësi të ngushtë me Jugosllavinë, me Bullgarinë, me Rumaninë, por edhe me Shqipërinë. Greqia, qoftë ajo e Jorgos, e Konstandinit, e Venizellosit, e Metaksait, e Pavllos, e kolonelëve dhe e Papadhopullosit, ashtu edhe e të tjerëve si këta që janë e mund të vijë në fuqi, ka qenë dhe është për aneksimin e Shqipërisë së Jugut që ata e quajnë «Vorio-Epir». Ëndrrat janë ëndrra, por shovinizmi grekomadh kërkon t'i bëjë realitet, përpiqet, lufton dhe kurrë nuk heq dorë nga veprimi eventual agresiv. Por edhe ne nuk heqim dorë nga mbrojtja dhe vigjilenca. Kolonelët grekë pranuan të lidhnin marrëdhënie diplomatike me ne. Karamanlisi i vazhdoi dhe ne i vazhdojmë ato, pse interesi ynë na i do. Por ne nuk na zë gjumi. Ne bëjmë tregti me grekët, bëjmë nga ndonjë hap në shkëmbime kulturore, gjë që është edhe në interesin tonë. Por të marrë nuk jemi që të bëjmë siç thotë Çu En Lai. Ai na mëson ne si të bëjmë, por

nga ana e Kinës, që është një shtet i madh, nuk shohim të bëhet asnjë hap drejt Indisë. Po pse nuk e bën? Pse India është prosovjetike. Po Jugosllavia, Rumania, Greqia, Bullgaria me kë janë, në ç'grazhd hanë dhe në ç'krevat flenë?

Jo, këshillat dhe mendimet e Çu En Lait mbi politikën që ky predikon për Ballkanin janë të gabuara, antimarksiste, antisocialiste. Ne as e pranojmë një politikë të tillë dhe do të vazhdojmë në politikën tonë të drejtë, do të bëjmë që të duket se politika jonë s'ka të bëjë me këtë politikë revizioniste-reaktionare.

...Kështu kaqë...
...Mao Çu En Lait...
...në një politikë...
...dhe pa...
...statis...
...për...
...shtet...
...dimit...
...pse...
...shikohet...
...Propaganda...
...se...
...partim...
...antiosocialist...
...Në politikën...
...si një...
...Në realitet...
...vitet...
...është...
...Ditën...
...pjesë...
...lind...
...kuptohet...

E PREMTE

4 KORRIK 1975*

KINA KA HYRË NË VALLEN POLITIKE TË BORGJEZISË

Është tragjike që Kina kaosin e lufton me kaos. Kina e Mao Ce Dunit të jep përshtypjen sikur brenda vendit bën një politikë «socialiste», por, po të futesh në thellësi, qoftë edhe aq sa të lejojnë shfaqjet e jashtme, do të konstatohesh se politika «marksiste-leniniste», që trumbetohet prej saj, është një politikë maoceduniste, një diçka e përzier me qëndrime e parime të dyshimta. Vihen re vazhdimisht dy vija, të cilat herë ecin paralelisht, herë jo, sepse njëra ia hipën tjetrës. Një paqëndrueshmëri e tillë shikohet vazhdimisht edhe për shumë probleme kapitale. Propaganda bëhet në atë mënyrë që njerëzit të mendojnë se çdo qëndrim dhe çdo veprim i Kinës është «i drejtë, parimor, marksist-leninist, antiimperialist dhe sidomos antisocialimperialist».

Në politikën e jashtme, Kina e Mao Ce Dunit hiqet si një vend socialist dhe që bën një politikë socialiste. Në realitet nuk është kështu. Edhe pse Kina nuk mund të vihet në një radhë me dy superfuqitë, politika e saj nuk është një politikë marksiste-leniniste.

Derisa Kina e deklaroi veten si një shtet që bën pjesë në «botën e tretë», në parim ajo ndjek edhe politikën e kësaj «bote të tretë», e cila nuk ka asgjë socialiste. Kuptohet se Kina në «botën e tretë», konfondon politi-

kën e saj me politikën borgjezo-kapitaliste dhe revizioniste të kësaj «bote të tretë».

Politika e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit para Revolucionit Kulturor, ishte: «Aleancë me të gjitha shtetet e botës, edhe me revizionistët sovjetikë». Aktualisht politika e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit është: «Aleancë me të gjitha vendet e botës, edhe me imperializmin amerikan kundër sovjetikëve». Po Mao Ce Duni me cilën vijë është? Lihet të kuptohet se ai i aprovon dhe më vonë i dezaprovon këto vija, por, në fakt, ai është me to dhe kontribuon në këtë rrugë që ndjek Kina. Kjo është një politikë me shumë konsekuenca për vetë Kinën dhe për botën. Bota revolucionare dëshiron të shohë politikën klasore, revolucionare të Kinës, por ajo nuk e sheh atë, sepse në realitet nuk ekziston dhe duhet ta imagjinojë se si duhet të jetë.

Kina bën një politikë prej zigareje. Ajo është hapur, ka lidhje diplomatike me të gjithë, do që të afirmohet në botë. Edhe ne e kemi dashur dhe ia kemi sugjeruar këtë. Por si duhet të afirmohet Kina në botë? Si një vend socialist, apo si një vend i «botës së tretë»? Natyrisht, Kina duhet të afirmohet si një vend socialist. Mirëpo këtë ajo nuk e bën. Ajo po afirmohet në botë si një shtet kundër Bashkimit Sovjetik. Për Kinën Spanja e Frankos, Kili i Pinoçetit apo Rodezia e Jan Smitit janë miqtë e saj, kurse «sovjetikët janë më të rrezikshmit, sepse hiqen sikur janë marksistë-leninistë». Ky qëndrim nuk është parimor. Lufta e Kinës kundër sovjetikëve nuk zhvillohet në platformën ideologjike dhe nga kjo platformë të demaskohet politika e tyre socialimperialiste. Jo, këtë Kina nuk e bën aspak si duhet. Po pse nuk e bën? Sepse politika e saj nuk bazohet në teorinë marksiste-leniniste. **Kina ka hyrë në vallen politike të borgjezisë, në politikën e koniunkturave dhe është e bindur se kjo politikë është më e drejta. Kina harron se politika që ajo bën pa dallim me presi-**

dentë e me mbretër, me princër e me princesha, me fashistë e me revanshistë të Bonit, me imperialistë amerikanë apo me të tjerë si Pinoçeti, nuk është ndonjë politikë origjinale. Një politikë të tillë e ka praktikuar gjerësisht borgjezia kapitaliste botërore dhe ca më përpara e kanë praktikuar monarkitë e trashëgueshme dhe aristokracia. Kina kërkon miqësinë e klikave sunduese «për t'u futur në popujt», në vend që të futet në zemrën e popujve duke i bindur këta se ajo është plotësisht me kauzën e tyre.

Ç'ndihmë u jep Kina popujve dhe revolucionarëve kilianë ose filipinas, apo revolucionarëve gjermanë, kur ajo afishohet në mënyrë skandaloze me Pinoçetin, me Markosin, me Shtrausin dhe me të tjerë si këta? Asnjë ndihmë nuk u jep, veçse i dekurajon. Kina, me këtë politikë që bën, inkurajon reaksionin më të zi. Kina lë që revolucionarët të supozojnë se kjo është një «manovër politike». Në fakt, kjo është një manovër kundërrevolucionare, sepse revolucionarët, po të ndjekin politikën e Kinës, duhet të mos luftojnë kundër reaksionit. Mirëpo **revolucionarët nuk mund të jenë me dy faqe, të luftojnë kundër reaksionit dhe njëkohësisht të jenë me reaksionin.**

Kinezët përpiqen të japin përshtypjen se ndihmojnë fshehtazi forcat revolucionare. Kjo nuk është aspak e vërtetë dhe nuk mund të jetë e vërtetë, sepse Kina preokupohet ta ketë mirë, për shembull, me shtetin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe me firmat e saj, e jo me komunistët marksistë-leninistë gjermanë. E ashtuquajtura ndihmë për revolucionarët marksistë-leninistë është vetëm një përkrahje që u bën Kina atyre, në qoftë se e mburrin Kinën dhe politikën e saj në Bon, në Paris, ose në Romë. Mirëpo të veprosh kështu do të thotë të jesh mik me reaksionin e këtyre vendeve. Natyrisht, marrëdhënie diplomatike, tregtare dhe kulturore Kina duhet të ketë me këto vende, por këto marrëdhënie du-

het të bazohen në teorinë marksiste-leniniste dhe t'i shërbejnë revolucionit.

Kina u jep kredi disa shteteve, midis të cilave jemi edhe ne. Këto kredi, veçanërisht ajo që na jepet neve, marrin ngjyrën e politikës që ndjek Kina brenda dhe jashtë vendit. Kur situata brenda në Kinë është revolucionare, domethënë kur nga të dyja vijat, ajo revolucionarja dominon mbi regresiven, atëherë ndihma për ne ndjek një rrugë dashamirëse, miqësore, kinezët i kuptojnë drejt nevojat dhe vështirësitë tona. Ne nuk mungojmë t'u tregojmë mirënjohjen tonë të singertë dhe ata na thonë se «ndihma që na jepni ju, shqiptarët, është shumë e madhe, kurse ajo që ju japim ne, është shumë e vogël. Ne duhet t'ju ndihmojmë më shumë, dhe do t'ju ndihmojmë më shumë në të ardhmen».

Mirëpo, siç duket, kur thuheshin këto fjalë, vija regresive e Çu En Lait ishte në inferioritet, e dobët. Tash ajo duhet të ketë fituar supremacinë dhe ndjekësit e saj flasin krejt ndryshe.

Shoku Adil, që u kthye nga Pekini, ku kishte vajtur për marrëveshjen ekonomike, konstatoi një frymë të hapët arrogante, përbuzëse dhe të akullt, bile armiqësore nga ana e njerëzve të grupit të Çu En Lait e të Li Hsien Nienit. **Li Hsien Nieni ia tha gati hapur Adilit: «Edhe ato ndihma që ju kemi dhënë, kemi bërë gabim dhe jam kritikuar për këtë».** «Unë, — i tha Li Hsien Nieni, njeriu me sëpatë të madhe, — jam për të shkurtuar investimet». Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se: «Ju, shqiptarët, mendoni çfarë të doni, por unë jua pres me sëpatë kërkesat tuaja». Kërkesat tona janë të arsyeshme, por, për kinezët, mendimet dhe vija jonë politike janë «të parysyeshme». Kinezët duan që edhe ne të mendojmë dhe të veprojmë si ata, të kemi një politikë të jashtme oportuniste dhe joparimore, të kemi një qëndrim liberal bre-

nda vendit kundër armiqve të popullit dhe të Partisë, të cilët ne i dënojmë, kurse kinezët i kthejnë në fuqi. **Kinezët kërkojnë që Partia dhe shteti ynë të humbasin personalitetin që kanë fituar me gjak e me sakrifica dhe të bëhen një satelit i tyre. Ata dëshirojnë që, për çdo gjë, sahati ynë të bjerë në një kohë me sahatin e Pekinit. Kjo nuk do të ngjasë kurrë, në rast se sahati i Pekinit nuk bie si sahati i Marksit, i Engelsit, i Leninit dhe i Stalinit, të cilin e ndjek me besnikëri e konsekuencë Partia e Punës e Shqipërisë.**

Është e qartë se grupi i Çu En Lait bën presion mbi ne dhe dëshiron që vija jonë e drejtë marksiste-leniniste të mos i bëjë hije dhe të mos e vërë në pozita të vështira vijën e tyre, e cila nuk është marksiste-leniniste, por që ata bëjnë të gjitha përpjekjet për ta kaluar në histori si vijë «marksiste-leniniste revolucionare». Ky qëndrim i tyre armiqësor është përhapur anekënd. Ambasadorë të ndryshëm kinezë flasin për ne me gjuhën e Li Hsien Nienit. Sovjetikët, rumunët dhe jugosllavët i kanë rënë në erë këtij qëndrimi dhe kanë rforcuar presionet e tyre kundër nesh. Realiteti kështu është, por presionet as na lëkundin dhe as na frikësojnë. **Grupi i Çu En Lait gabohet rëndë kur mendon se do të na gjunjëzojë, ashtu sikundër u gabua edhe grupi i Hrushovit. Ne do ta mundim edhe këtë grup në arenën ndërkombëtare.** Bota dhe popujt do të shohin se një popull, sado i vogël që të jetë, kur udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, nuk mposhtet; përkundrazi, ai ecën me guxim përpara dhe fiton. Populli vëlla kinez do ta shohë edhe ai një ditë politikën shoviniste që bën udhëheqja e tij kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat, në çdo moment dhe veçanërisht në kohërat më të rënda për Kinën, kanë qenë pranë tij, e kanë mbrojtur dhe e kanë ndihmuar me të gjitha forcat.

Ne do të jemi kurdoherë me çështjen e drejtë të popullit kinez, do të jemi kurdoherë me rrugën e revolucionit dhe të marksizëm-leninizmit. Politika e shtetit të madh nuk mund të fshihet për shumë kohë prapa maslake.

E PREMTE
4 KORRIK 1975

MASAKRUESI I 500 MIJË KOMUNISTËVE INDONEZIANË NË BEOGRAD

Suhartoja, diktatori gjakatar indonezian, ndodhet në Jugosllavinë e Titos për vizitë zyrtare. Ai u prit me nderime të mëdha, me bandë, me paradë në arritje dhe në Brioni, me dreka e me darka, me puthje e me përqafime, me diskure e fjalime, me «më mburr e të të mburr». Dhe të gjitha këto ndere për cilin? Për gjakatarin Suharto, një fashist si Hitleri, si Musolini, si gjithë vrasësit e kohëve të ndryshme që përmend historia. Gjenocidi i Sulltan Abdyl Hamitit kundër armenëve është një kasaphanë «kandidate» përpara 500 000 a më shumë komunistëve dhe patriotëve që griu «bung Suhartoja» në një kohë të shkurtër, rekord.

Gjithë bota u indinjua, gjithë bota përparimtare e ngriti deri në qiell zërin e protestës për këto vrasje, edhe fashistët e maskuar nëpër botë me etiketa të ndryshme politike, u skuqën nga turpi. Revizionistët hrushovianë, gjithashtu, bërtitën «të indinjuar», lëshuan lot krokodili për «bung Sukarnon» dhe «tavarish Aiditin». Nga ana tjetër, hrushovianët fërkonin duart që «bung Suhartoja» digjte ambasadën kineze, plaçkiste dokumentet dhe vriste nëpunësit e ambasadës dhe qytetarët indonezianë me kombësi kineze.

Edhe Tito tradhtari, agjent i borgjezisë, që kishte vënë maskën e komunistit dhe tundte flamurin kundër

Stalinit, Titoja, miku i ngushtë i «bung Sukarnos» dhe solidar me të, me Naserin, Nehrunë, Nkrumën, «u indinjua», ngriti dhe ai zërin e protestës, «mbrojti» demokratët dhe komunistët indonezianë dhe «dënoi» me «indinjatë» prej vrasësi të kosovarëve dhe të komunistëve të kampeve të përqendrimit të Goli Otokut fashistin Suharto. Mirëpo shirat e lanë shpejt e shpejt gjakun e komunistëve indonezianë. Gjaku i gjysmë milion të vrarëve nga fashistët e Suhartos u bë ujë, toka përpiu kufomat e tyre dhe era e oqeanit shpërndau erën e kufomave që kishte mbuluar Indonezinë.

«Larg syve, larg zemrës». Të vrarët u harruan, u harruan ahengjet dhe «betimet politike të solidaritetit» me Sukarnon dhe fytyra e Suhartos po dilte nga errësira mesjetare në «dritën» e botës kapitaliste dhe revizioniste. Hrushovi, Titoja, Brezhnjevi, Çausheku dhe gjithë të tjerët që vijnë rrotull tyre ndërruan shpejt pllakën! «Dallëndyshe ktheje ndryshe». Rroftë bashkekzistencat paqësore, miq edhe me fashistët amerikanë, anglezë, indianë. Pse jo edhe me fashistët indonezianë? Kush të fitonte më parë miqësinë e «bung Suhartos», duke mos folur për litar në shtëpinë e të varurit. Suhartoja kriminel? Në asnjë mënyrë jo! Suhartoja demokrat? Po! «Të mos lëmë që ai të lidhet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Kështu mendonin hrushovianët dhe Hrushovi i Kinës, Liu Shao Çia.

Titoja përbrenda vetes mendon: «Kush është miku i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai është miku im. Kush më jep dollarë, kush më jep kredi, me atë jam unë». Dhe kështu erdhën kohët e sotme, që «bung Suhartoja» ka dalë në udhëtim për të bërë «la tournée des grands ducs».

Me paturpësinë më të madhe pritet në të gjitha kryeqytetet një njeri i tillë i lyer me gjak, flitet, bisedohet dhe sajohen komunikata me të, në të cilat bëhet fjalë për

«mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të paqes, të demokracisë, të sigurimit evropian dhe aziatik», flitet edhe për «socializmin», për të mirë flitet edhe për kapitalizmin, edhe për imperializmin dhe socialimperializmin, flitet edhe kundër gjenocidit. «Evenimente të mëdha të kohës» konsiderohen këto «takime historike». Gjithë këto dokumente që firmosen janë me mijëra, por që nuk vlej në veçse për t'u vënë në vende ku nuk flet goja, por flet diçka tjetër.

Kush pret dhe përcjell njerëz të tillë, konsiderohet «politikan i madh», ky është një sukses i madh politik. Kush arrin të vejë dhe të vijë në vendet ku sundojnë të tillë maskarenj, konsiderohet se i ka sjellë «dobi të madhe vendit dhe kauzës së paqes».

Politika që bëhet sot në botë është një politikë pa parime, false, hipokrite, që të lan e të lyen kur e do interesi, por ta kthen fletën në minutë, tregohet mik me ty dhe me armiqtë e tu, nuk bën asnjë dallim, jep e merr me këdo e për çdo gjë, sot të shan, nesër të lavdëron, sot të mbron, nesër të dënon.

E tërë kjo politikë e mijëra flamurëve afishon të gjitha «parimet më të drejta, më njerëzore, më paqësore e më demokratike», por prapa maskës qëndrojnë dhëmbët e ujkut dhe nën pelerinë fshihet thika që do të të godasë në shpinë. S'mund t'i zësh besë kurrkuajt, të gjithë të gënjejnë, të gjithë e urrejnë shoqi-shoqin. Nuk ekziston sinqeriteti, respekti, ndershmëria, dashuria. Politikë për ta do të thotë e kundërta e të gjitha këtyre virtyteve njerëzore.

E HËNË
7 KORRIK 1975*

LI HSIEN NIENI VEPRON KUNDËR SHQIPËRISË SOCIALISTE

Li Hsien Nienit në Kongresin e 4-t të Partisë sonë nuk i qeshi buza. Përkundrazi, ai rrinte si «Buda», veç një «tik» në mollëzën e faqes i dridhej, si duket nga nervozizmi, pse delegatët e Kongresit nuk u lodhën ditë të tëra së brohorituri e së duartrokituri, për t'ua përplasur mu në fytyrë revizionistëve sovjetikë, Pospjelov dhe Andropov, unitetin e komunistëve shqiptarë rreth Komitetit Qendror dhe besnikërinë e tyre e të popullit ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ndaj marksizëm-leninizmit. Ky Li Hsien Nien, që në Kongres rrinte rëndë, duke e hequr veten si përfaqësuesi i Kinës së madhe, për të cilën u bë zallamahia në Bukuresht e në Moskë, na këshilloi të tregohemi të matur me sovjetikët, të bisedojmë me Hrushovin e shokët e tij. Ky lake i Çu En Lait, në kohën e Revolucionit Kulturor ishte bërë si mi, që nuk gjente vrimë ku të futej. Atëherë gati i vunë kape-lën, pale që e kritikuan rëndë, e shanë, e dënuan, e bënë për ibret. Këto na i tha vetë. Gjatë Revolucionit Kulturor, me rastin e vajtjeve të delegacioneve tona të ndryshme në Kinë, ai dhe padroni i tij, Çu En Lai, që shpëtoi nga spastrimi në sajë të ndërhyrjes së vetë Maos, rrinin si pula të lagura.

O tempora! O mores! Kohët e furtunës kaluan, Çuja dhe Li Hsien Nieni dolën mbi ujë dhe morën fuqinë,

kurse Çen Po Taja na doli «agjent i të gjithëve» dhe u likuidua, Lin Biaoja «agjent i sovjetikëve, komplotist, mori avionin, u arratis dhe u dogj e u bë hi në Mongoli», të tjerë u burgosën. Kina u përpëliti për të riorganizuar partinë e hallakatur, e cila u mblodh dhe bëri kongresin. Mezi u mblodh Asambleja Kombëtare. Thonë se janë duke u përgatitur kongreset e organizatave të masave. Por, midis këtyre trazirave, një gjë u bë me baza: miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës u lidh dhe po forcohet. Bateritë u drejtuan vetëm kundër sovjetikëve. U rehabilitua Ten Hsiao Pini, i cili u bë nënkryeministër, nënkryetar i partisë, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe shef i shtatmadhorisë etj. Ai shkoi edhe në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe deklaroi që Kina «bën pjesë në botën e tretë». Kina u hap nëpër botë duke predikuar miqësinë me të gjithë, veç Bashkimit Sovjetik.

Li Hsien Nieni, pas sëmundjes së Çu En Lait, u pompua si «mbreti» i ekonomisë kineze. Jo vetëm kaq, po edhe si «mbreti» i politikës ndërkombëtare megalomane të Kinës. Ai u thoshte shokëve tanë: «Unë shkova në Pakistan dhe i thashë Ali Butos të jetë vigjilent ndaj sovjetikëve dhe t'i luftojë këta», — sikur Butoja priti ta mësojnë Çu En Lai dhe Li Hsien Nieni; «Unë shkova në Iran dhe i thashë shahinshahut të ketë kujdes nga sovjetikët dhe t'i luftojë ata», — sikur shahu i Iranit s'dinte t'i luftonte sovjetikët dhe priti t'ia thoshte Li Hsien Nieni; «Unë i këshillova irakianët që ta kenë mirë me Iranin dhe të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik». Nuk e shikon, për sytë e bukur të Li Hsien Nienit, Al Bakri u mor vesh me Pahlevinë!; «Unë i këshillova afganët që të jenë vigjilentë ndaj sovjetikëve», se Dauti priti Li Hsien Nienin që të mos lidhet ngushtë me Moskën. Politikë «shumë e zgjuar» dhe megalomani e gjeldetit! Bisedat «e përzemërta», që ata zhvillojnë me klikat në fuqi në vende

të ndryshme të «botës së tretë», kujtojnë se kanë peshë vendimtare! Këto klika veprojnë si borgjezë kapitalistë që janë: kërkojnë dollarë dhe, po u dha Kina, thonë ndonjë fjalë të mirë për të, por pa zarar për veten e tyre, pse ata marrin nga të katër anët dhe e kthejnë flamurin nga të fryjë era. Ata nuk kanë pasur dhe nuk kanë parime. Nga ana tjetër, një bisedë dhe miqësi false me Kinën, në vendet e tyre dobëson pozitat e revolucionit, dërrmon punën e patriotëve, të komunistëve dhe të demokratëve, të cilët mendojnë dhe propagandojnë se Kina është me revolucionin. Mjerisht, politika e Kinës është me mbretërit dhe me diktatorët borgjezë. Kina bën punën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat e lënë të lirë atë të veprojë deri diku në zonat e saj të influencës, sepse ajo është një bori antisovjetike dhe amerikanëve u intereson kjo gjë.

Kështu, «i zgjuari» Li Hsien Nien bën politikën e madhe ekonomike dhe ndërkombëtare të Kinës. Ai flet nën hijen e flamurit të Maos dhe vepron kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër Shqipërisë socialiste, kundër mikes besnike të Kinës. Tash këta elementë kanë fuqinë në Kinë. Rehabilitimi i Ten Hsiao Pinit, dhe sigurisht edhe i shumë të tjerëve si ai, të cilët i goditi Revolucioni Kulturor, sjell atë që të gjithë këta të bëjnë në Kinë ligjin, të luftojnë miqtë marksistë-leninistë dhe të mbrojnë antimarksistët, të lëkundurit, borgjezët dhe ata që u bëhen lakenj. Maoja ka thënë se çdo 7 ose 8 vjet, në Kinë do të bëhet nga një revolucion, i cili do të spastrojë ata që janë në fuqi. Sipas këtij «predikimi», afati po afrohet. Të presim se ç'do të shohim.

PRITJE TË MËDHA SUNDUESVE TË IRAKUT

Agjencia HSINHUA ka njoftuar këto ditë se zëvendës-presidentit të Republikës së Irakut, që ndodhet në krye të një delegacioni zyrtar irakian në Pekin, po i bëhen pritje të mëdha. Dje atë e ka pritur Mao Ce Duni. Pak ditë më parë e priti edhe Çu En Lai. Në takimin me Maon ka qenë i pranishëm edhe Ten Hsiao Pini. Vazhdon politika e hapjes kineze.

HEDHIM POSHTË SYNIMET ARMIQËSORE TË TITISTËVE DHE PADRONËVE TË TYRE**Shënime për një artikull**

Duhet të shkruajmë një artikull në përgjigje të një artikulli të revistës jugosllave «Politika ndërkombëtare». Në artikullin jugosllav lihet të kuptohet se ne tash po lidhemi me Jugosllavinë dhe se në këtë drejtim lidhjet tona janë të natyrshme. Ti hedhim poshtë këto synime propagandistike armiqësore, që nuk janë vetëm të jugosllavëve. Tu japim një përgjigje të mirë titistëve dhe, nëpërmjet tyre, edhe «miqve» kinezë që na predikojnë atë rrugë.

Konkretisht artikulli i jugosllavëve në revistën «Politika ndërkombëtare» duket se ndjek këto dy qëllime:

Së pari, të tregojë se Shqipëria po lëviz në politikën e saj dhe po mbështetet gjetiu, domethënë te jugosllavët. Për këtë arsye në artikull ata përdorin të gjitha ato gjoja argumente, se është rritur niveli i tregtisë, se po bëhen komisione për planet ekonomike etj., etj.

Së dyti, është edhe njëfarë sugjerimi që na bëhet neve se rruga e daljes gjoja është bashkëpunimi me Jugosllavinë.

Çfarë mund të shkruanim ne në artikullin tonë të përgjigjes? Si shkak imediat mund të marrim çështjen e «sigurimit evropian», mundet ndonjë gjë tjetër ose të

fillojë direkt. Sidoqoftë, idetë kryesore që mund të thuheshin janë këto:

— «Sigurimi evropian» është bërë dhe bëhet mbi bazën e dallaveve të fuqive të mëdha dhe të një politike koniunkturale joparimore të mjaft shteteve të mesme dhe të vogla, të cilat, në fakt, në realitet, nuk kanë një politikë të pavarur, por politika e tyre është mbështetur në kreditë që u japin dy superfuqitë, si dhe në luhatjen e politikës së këtyre dy superfuqive. Kurse vendi ynë ka një politikë krejt të kundërt.

— Politika jonë është një politikë revolucionare që mbështetet në mësimet e marksizëm-leninizmit. Kjo politikë nuk varet as nga kreditë, as nga tregtia. Kreditë që merr Republika Popullore e Shqipërisë dhe tregtia që zhvillon ajo nuk ndikojnë për asnjë çast në politikën e drejtë parimore, revolucionare të Shqipërisë socialiste.

— Kush mendon se Shqipëria e ndërron politikën e vet marksiste-leniniste, pse i shitka 1.000 tonë krom më shumë një shteti apo një tjetri, ai nxjerr sytë e vet. Ose kush mendon se politika e Shqipërisë, politika shqiptare e mbrojtjes, e cila është përcaktuar në bazë të një analize marksiste-leniniste se cilët janë armiqtë e saj, mbështetet në luhatjen e politikave të shteteve të ndryshme revizioniste, edhe ai ka futur gishtat në sytë e vet. Mbrojtja e Shqipërisë socialiste konsiston, në radhë të parë, në armatosjen e popullit në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit.

— Shqipëria gjithnjë ka dashur dhe do një politikë të fqinjësisë së mirë me shtetet e ndryshme. Ajo e di se këto shtete kanë një politikë krejt të kundërt me parimet e saj, por politika e Republikës Popullore të Shqipërisë përputhet si me interesat e vetë Shqipërisë, ashtu edhe me interesat e fqinjëve.

— Këtë politikë marksiste-leniniste të drejtë, Republika Popullore e Shqipërisë nuk e vë në ankand, as

është ajo që e prish këtë ekuilibër të politikës së vet. Por ajo as lejon që ndonjë shtet, i njohur për propagandë false, të lërë të kuptojë që qëllimet e fqinjësisë së mirë të vendit tonë karshi tij janë rezultat i ndonjë ndryshimi politik e ideologjik të vijës së shtetit të diktaturës së proletariatit në Shqipëri.

— Një politikë të tillë marksiste-leniniste Shqipëria ndjek me të gjitha shtetet e botës. Ajo mbështet të gjitha qëndrimet e drejta në arenën ndërkombëtare të shteteve që zhvillojnë luftë për çlirim kundër armiqve të ndryshëm. Nga kjo politikë Shqipëria niset edhe në qëndrimin e vet mbi «sigurimin evropian».

— Shqipëria e ka provuar dhe ua ka treguar vendin Hrushovit dhe Mikojanit, që njihen në historinë e politikës ndërkombëtare si udhëheqës tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe që me anën e bllokadave ekonomike e politike kërkuar t'i mbyllnin gojën dhe ta mbytnin Shqipërinë socialiste, pse pati guximin dhe mbrojtje me vendosmëri parimet e marksizëm-leninizmit.

— Ata që mendojnë se lidhjet e Shqipërisë me Kinën bazohen në koniunktura të ndryshme, gabohen rëndë. Miqësia jonë bazohet në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në internacionalizmin proletar.

— Të mos kenë iluzione ata që s'i duan të mirën Shqipërisë se gjoja kësaj aq lehtë mund t'i imponohen me një politikë tregtare revizioniste.

— Shqipëria tashmë është forcuar shumë ekonomikisht, pale politikisht dhe ideologjikisht. Prandaj nuk ka forcë që ta mposhtë ose të bëjë që të ndryshojë kursin e saj politik dhe ideologjik.

— Shqipëria kurdoherë ka mbrojtur miqtë marksistë-leninistë dhe aleatët e vet. Ajo edhe në të ardhmen do të vazhdojë të njëjtën politikë. Shqipëria e ka provuar edhe me gjakun e bijve më të mirë të saj, se si i mbron miqtë dhe aleatët, duke dërguar bijtë e saj më të mirë për të mbrojtur dhe për të çliruar popujt vëllezër.

SHËNIM

Në shtypin korean po zhvillohet me vrull kulturi i shfrenuar i Kim Ir Senit.

SHËNIM

Bisedë me Ramizin rreth revizionizmit jugosllav.

KOPAÇE NË KOKË REVIZIONISTËVE

Dje erdhi Ramizi dhe bashkë i dhamë dorën e fundit artikullit «Presionet e lajkat e revizionistëve nuk shkojnë në Shqipëri»¹, që do të botohet këto ditë në gazetën «Zëri i popullit».

Në artikull ne u përgjigjemi dhe hedhim poshtë lajkat dhe shantazhet e revizionistëve sovjetikë e të tjerë dhe veçanërisht të revizionistëve jugosllavë e miqve të tyre që u fryjnë në vesh, se «shqiptarët tash janë ngushtë, nderuni shkopin të kapen». Dhe ne, si përgjigje, ua hoqëm kopaçen në kokë.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 587.

DO TË DEMASKOJMË QËLLIMET E VËRTETA
TË KONFERENCËS SË HELSINKIT MBI

«SIGURIMIN EVROPIAN»

Me Ramizin diskutuam përfundimisht artikullin¹ mbi Konferencën e Helsinkit për «sigurimin evropian». I bëra një varg sugjerimesh të reja. Ta botojmë të martën që vjen dhe t'ia dërgojmë me urgjencë në katër gjuhë shtypit jashtë, veçanërisht të shpërndahet në Helsinki në ditët që do të mbahet konferenca. Kështu, i vetmi vend i Evropës, që nuk merr pjesë në konferencë, bën t'i dëgjohet zëri nëpërmjet gazetës së tij «Zëri i popullit». Besoj se mund të ngjallë interes në opinionin e delegatëve dhe të gazetarëve, natyrisht, me përjashtim të sovjetikëve, të amerikanëve dhe të Vatikanit që udhëheq kopenë e be-rrave që do të blegërijnë në haurin e «Betlehem Hel-sinkit».

¹ «Konferenca e pasigurisë së Evropës», «Zëri i popullit», 29 korrik 1975.

KONFERENCA E PASIGURISË SË EVROPËS

Nesër gazeta «Zëri i popullit» do të botojë artikullin tonë me titull: «Konferenca e pasigurisë së Evropës». Artikulli, që përcakton qëndrimin tonë të drejtë e të vendosur për këtë konferencë, iu dërgua sot redaksisë së «Zërit të popullit».

KONFERENCA E HELSINKIT — NJË LOJË INFERNALE PA SHPRESA

Konferenca e Helsinkit mbi «sigurimin evropian» u hap dje me «pompozitet» të madh, duke i rënë «daulles pa të kremte», pavarësisht se vatikanasi Kasaroli po udhëheq në emër të «vikerit» të Krishtit. Po përsëriten koncilet e Vormsit, të Pragës dhe liturgjitë orgjiake, në diskure si të papë Aleksandër Borxhias së 6-të. Vetëm këtë herë Titoja nuk e ka marrë me vete «Vanozën», të paktën shtypi s'e përmend. Shtypi botëror po bën «gjinahë të mëdha», kur numëron udhëheqësit «e mëdhenj» që marrin pjesë në këtë mbledhje dhe Titon e vë nga fundi i listës. Ç'krim! Radioja italiane e përmendte Titon në fund, para Makariosit.

Natyrisht, Konferenca e Helsinkit zhvillohet «me sukses», por nëpër hotele e rezidenca të Fordit, të Brezhnjevrit, të Zhiskarit e të tjerëve bëhen biseda vesh më vesh, pihet uiski dhe vendosen gjërat para se të venë në mbledhjen plenare të konferencës. Në këtë konferencë vetëm ballo nuk kërcëhet si në atë të Vjenës, kur në të njëjtën kohë Napoleoni linte ishullin e Elbës dhe vraponte drejt Parisit. Në Konferencën e Helsinkit u «kërcye valle» më shumë se dy vjet me radhë për të «pjellë mali një mi». Në dokumentin prej më tepër se 200 faqesh bluhet si në mullirin pa kokrra. Ai nuk detyron kërkënd dhe për asgjë. Prej kryetarëve të delega-

cioneve ai kërkon të hedhin vetëm nga një firmë në të.

Pa u hapur akoma mbledhja e daulleve, në korridoret e konferencës qarkulloi artikulli i «Zërit të popullit», zëri i të vetmit vend të Evropës që nuk merr pjesë në këtë konferencë dhe që demaskoi manovrën e ndyrë të dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Gazetarët me qindra u vërsulën mbi artikullin e «Zërit të popullit», organit të Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe ia servirën menjëherë opinionit botëror. Lakenjtë e hoteleve ua servirën në mëngjes në tepsi të argjendta, para se të flitnin, edhe Brezhnjev, Fordit, Titos, Çausheksut e të tjerëve.

Është interesante të analizojmë qëllimet e kësaj konference. Në realitet janë sovjetikët që ngulën këmbë për mbledhjen e saj. Shtypi perëndimor grinte se atë e donte Brezhnjevi për «prestigj personal», «për të lustruar politikën e tij personale të bashkekzistencës paqësore». Të gjitha këto janë përralla!

Imperialistët amerikanë dhe perëndimorët bënin sikur nuk ua kishte qejfi, sikur bënin naze, kurse çirakët e këtyre të fundit, Titoja e Çausheksu, bënin zhurmë se e donin, por gjoja jo për «qëllimet as të amerikanëve, as të sovjetikëve», por për «qëllimet e larta të paqes». Të gjitha këto janë përralla për t'i vënë njerëzit të flenë në këmbë.

Atëherë cilat janë arsytet e vërteta të kësaj konference? Sipas mendimit tim, konferencën e donin edhe Bashkimi Sovjetik, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se vetëm këto dy fuqi të mëdha imperialiste e manipuluan dhe e organizuan atë. Kjo konferencë krijonte te disa iluzione për veprime të mëvonshme agresive dhe për ndarjen e tregjeve në botë dhe krijimin e zonave të tyre të influencës. Për këto qëllime të këqija do të vënë firmën të gjitha klikat reaksionare që sundojnë në Evropë, me përjashtim të shtetit proletar të Shqipërisë socialiste.

Por le t'i marrim çështjet një nga një.

Sipas mendimit tim, Bashkimi Sovjetik përpiqet të evitojë një goditje atomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përpiqet të vazhdojë dialogun me të me kontradikta, por edhe me bashkëpunim. Bashkimi Sovjetik, si fuqi imperialiste e madhe që është, kërkon hapësira ekonomike dhe politike njëkohësisht, ai është bërë një fuqi neokolonialiste, që e konkurrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këta janë dy konkurrues me potenciale ushtarake të mëdha, por Bashkimi Sovjetik ekonomikisht, në krahasim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është hala i dobët. Si brenda, edhe për rolin hegjemon që dëshiron të luajë në botë, Bashkimit Sovjetik, për ta zënë këtë pozitë të fortë ekonomike, për të modernizuar industrinë dhe bujqësinë e tij të vjetruar dhe jorentabël, i duhet kohë, i nevojitet «statukuoja» aktuale. Që t'i arrijë këto mundësi, i duhet të bëjë koncesione, pse i duhet ndihmë nga jashtë. Por ndihma Bashkimi Sovjetik mund të marrë vetëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë, si dhe nga vendet e tjera të pasura të Evropës. Atëherë? «*Donnant, donnant*», siç thotë francezi, «më jep, të të jap». Kjo është baza «iluzioniste» e Konferencës së Helsinkit.

Dy luftërat e mëdha botërore filluan në Evropë, pastaj u përhapën në të gjithë botën. Ato filluan si luftëra imperialiste grabitqare dhe mbaruan në luftëra nacionalçlirimtare. Aktualisht në Evropë, me përjashtim të Republikës Popullore të Shqipërisë, të gjitha shtetet imperialisto-revizioniste janë kredhur në një valle të vdekjes.

Në Evropë dy blloqe qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. Do të fillojë lufta e tretë botërore, atomike, në Evropë apo do të fillojë gjetkë, në Azi, në kufijtë e Kinës? «Të mëdhenjtë» bëjnë llogaritë. Bashkimi Sovjetik përpiqet të «qetësojë evropianët se nuk i sulmon», të mos kenë

frikë nga Rusia hitleriane. Mirëpo evropianët duan prova dhe sigurime, duan edhe «hapësirë», edhe miq të tyre, në mes të cilëve edhe Bashkimin Sovjetik. Ata duan që vendet satelite të Evropës Lindore, të lidhura me Bashkimin Sovjetik, por edhe vetë Bashkimi Sovjetik, të bëhen han me dy porta për njerëzit dhe për idetë, domethënë të krimben plotësisht nga brenda. Në këto drejtime Bashkimi Sovjetik përpiqet të krijojë iluzionin në Helsinki sikur po bën lëshime. Disa lëshime natyrisht bën, se s'ka ç'të bëjë, se i duhet të fitojë kohë, të marrë kredi dhe teknologji moderne, i duhet të ketë disi duart e lira për të shtrirë këmbët edhe në kontinentet e tjera veç Evropës. Në Evropën e ujvë s'ka ç'fiton veç shqyerjes. Revizionistët dhe miqtë e tyre le të veprojnë në Evropë me bashkëpunimin me kapitalistët. Nga ana tjetër, derisa vetë Bashkimi Sovjetik do të marrë kredi dhe teknologji moderne, satelitët e tij nuk mund t'i pengojë të marrin edhe ata kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga perëndimorët, veçse duhet t'i mbajë të pushtuar ushtarakisht. Traktati i Varshavës përbën zinxhirët, të cilët Bashkimi Sovjetik i shtrëngon fort. Po shtetet satelite, si Polonia, Rumania, Çekosllovakia, Bullgaria janë kthyer në vende të degjeneruara kapitaliste nga çdo pikëpamje. Kjo aq i bën Bashkimit Sovjetik. Ky vetë është bërë i tillë. Të tërë shkojnë drejt greminës.

Kështu paraqiten pozitat në stanin sovjetik. Të gjithë satelitët e sovjetikëve, mundet me përjashtim të bullgarëve, duan t'i thyejnë zinxhirët e Traktatit të Varshavës, po nuk mundin. Atëherë kanë shpresa, në ato shpresa që lë dokumenti i Helsinkit, domethënë të shtojnë miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me perëndimorët, të krimben në kredi, në teknologji të tyre, kisha të zërë në to vendin e mëparshëm, degjenerimi moral të thellohet, të shtohet antisovjetizmi dhe Traktati i Varshavës të mbetet një celfë veze bosh. «Traktatin ta kemi,

po me të tjerë të jemi», këtë ëndërojnë dhe shpresojnë Gierekët, Çaushekët, Husakët dhe Honekerët. Këtë qëllim ndjekin edhe amerikanët, edhe perëndimorët, domethënë *glacis*-in në mes tyre dhe Bashkimin Sovjetik ta bëjnë të tyrin. Në garë janë amerikanët dhe perëndimorët për t'ia arritur qëllimit në këto drejtime, kurse sovjetikët përpiqen të frenojnë sa të jetë e mundur satelitët dhe këta të fundit sa të mundin të dalin nga dhokani sovjetik.

Kjo është përpjekja e Helsinkit, këtu janë iluzionet, shpresat, fokuset, këtu synojnë drekat e darkat e Brezhnjev, të Fordit, të Titos, të Zhiskarit e të tjerë. Një lojë infernale pa shpresa! Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u qëndrojnë mbi kokë, ata heqin valle.

«Baza dhe pozitat kyç janë armët atomike, forca ekonomike, shantazhi, «frika» dhe qëllimi «të jemi disi të lirë në Evropë, për t'u «interesuar» për gjatë». Të luftojmë, por jo në Evropë, mundësisht të bëjmë luftë me anën e popujve të tjerë, të shtypim me të gjitha mënyrat ata popuj që na pengojnë të konkurrojmë ne, vendet kapitaliste të Evropës, në kontinente të tjera dhe ligji i xhunglës do të vazhdojë më i egër se kurrë, ligji «peshku i madh e ha të voglin» do të jetë në rendin e ditës. Kjo është perspektiva sovjeto-amerikane që u hap atyre Konferenca e Helsinkit, perspektivë e zyrtë për popujt, plot rreziq, mjerime dhe luftëra grabitqare imperialiste.

Brezhnjevi dhe Fordi bëjnë mbledhje të veçanta për rregullimin financiar, për armatimet, për SALT-in dhe për shumë probleme të tjera që synojnë sundimin e botës, që përgatitin takimin e ardhshëm Ford-Brezhnjev.

Brezhnjevi, Fordi, Zhiskari dhe Shmidi bëjnë mbledhje për «Berlinin Perëndimor», por ky është «gishti» nga u kapën perëndimorët, kur Bashkimi Sovjetik u bëri atyre koncesionet e njohura, për të kapur krahun,

bashkimin e të dy shteteve gjermane. Në këtë mbledhje të tre i thanë njërit «Ç'fituam për Berlinin Perëndimor jo vetëm që duhet të mbahet, por të zhvillohet më tej në bazë të çka po nënshkruajmë në Helsinki».

Të gjitha drekat dhe darkat, që bëjnë «kryetarët» e tjerë, janë lojëra majmunësh për t'u gjendur në llaf dhe për të lënë të kuptojnë se edhe ata diçka po bëjnë nëpër kulisa. Por, megjithëkëtë, ata mbeten «jolixhinjtë» e dasmës që bëjnë Fordi dhe Brezhnjevi. Këta janë aristokracia që mbajnë «bombën dhe qeskën», të tjerët vijnë rrotull korridoreve dhe hoteleve të veshur e të pispillosur bukur, por pa asnjë personalitet të vet, veç atij të lakenjve. Jo vetëm Fordi, por edhe Zhiskari, edhe Uilsoni e thanë hapur se ato që thamë dhe që vendosëm në Helsinki nuk janë një detyrim, por «parime» që «duhen zbatuar», me fjalë të tjera që Bashkimi Sovjetik duhet t'i «zbatojë».

Në kohën që vazhdonte konferenca në Helsinki, drejtori i agjencisë angleze të lajmeve ROJTER i dërgoi një letër Gromikos dhe konferencës, ku thoshte se korrespondentët e tij po persekutohen në Bashkimin Sovjetik dhe dëbohen, ata nuk lihen rehat «të punojnë». Këtë protestë ROJTER-i ua bëri të njohur të gjithë delegatëve të konferencës, ky është preludi që u orkestrua në Helsinki, të cilin e drejtonte Fordi. Avazet «grandioze» vijnë më vonë. Artikujt që shkruam ne për këtë konferencë patën një jehonë të madhe në botë, pse ata vinin në dukje hapur dhe me kurajë atë që s'e thonë dot të tjerët, mbasi me anën e tyre ne zbulonim çdo gjë që po kurdisej nga të dy të mëdhenjtë dhe çdo gjë që do të ngjasë paskëtaj.

Duke vazhduar qëllimet që shtynë Bashkimin Sovjetik të kërkonte mbledhjen e kësaj konference, duhet të pohojmë se ai nuk e kërkoi atë vetëm për t'i krijuar telashe vetes. Jo, ai lëshon ca këndeje për të fituar nga

ana tjetër. Bashkimi Sovjetik, përveç që «u nënshtrohet» kushteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të marrë kredi dhe teknologji të re, do edhe të zhvillojë dominimin e tij në Lindjen e Mesme, në Pakistan, në Indi, në Indonezi, në Vietnam, në Kamboxhia, në Tajlandë, në Birmani e gjetkë. Qëllimi këtu është vendosja e neokolonializmit sovjetik në këto vende, vendosja e hegjemonizmit të tij dhe rrethimi i Kinës ushtarakisht, politikisht dhe ideologjikisht. Natyrisht, këtu do të zhvillohet njëkohësisht ndeshja me imperializmin amerikan, i cili në asnjë mënyrë dhe për asnjë çast nuk ka hequr dorë nga vendosja e hegjemonisë së vet në të gjitha këto vende. Ajo do ta kundërshtojë Bashkimin Sovjetik në këto synime.

Siç po shohim, Franca borgjeze ka marrë edhe ajo përsipër disa role në pellgun e Mesdheut, në vendet e Afrikës dhe në ato të Indokinës, për të rifituar diçka nga avantazhet e humbura, për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik dhe në këtë drejtim t'u thotë Shteteve të Bashkuara të Amerikës se si partneri i tyre dëshiron edhe ajo një copë të vogël të diellit të ngrohtë. Gjermania Perëndimore, siç po duket, mbetet që mbetet një nga xhandarët kryesorë në mes të xhandarëve të tjerë të Evropës për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik, për të arritur bashkimin e të dy shteteve gjermane, për të kri mbur satelitët e Bashkimit Sovjetik në Evropë, bile edhe vetë Bashkimin Sovjetik.

POLITIKA KINEZE NUK KA BOSHT KLASOR PROLETAR

Nuk duhet të harrojmë se Bashkimi Sovjetik, si një shtet socialimperialist, te Kina e Maos sheh një rrezik të madh, prandaj edhe përpiqet ta kribbë, mundësisht edhe ta sulmojë. Por, si shtet socialimperialist që është, mendon se edhe Kina mund ta sulmojë Bashkimin Sovjetik. Kina, mendoj unë, nuk do të arrijë ta bëjë këtë, por strategjikisht synon që të fitojë kohën e humbur për t'u bërë ekonomikisht dhe ushtarakisht një fuqi e madhe me bujqësi dhe me industri shumë moderne. Në qoftë se Kina ia arrin këtij objektivi pa luftëra, ajo do të bëhet një fuqi kolosale, e treta fuqi e madhe botërore. Po çfarë fuqi e madhe botërore? Socialiste apo imperialiste? Kjo varet nga qëndrimet politiko-ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës. Në qoftë se Kina do të vihet në pozita të forta e të palëkundshme marksiste-leniniste, ajo do të bëhet një fuqi e madhe socialiste, shtylla e revolucionit botëror, armike e betuar e dy superfuqive imperialiste, Bashkimin Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përndryshe, edhe Kina do të bëhet një fuqi socialimperialiste. Dhe atëherë të tria këto fuqi do të sundojnë mbi popujt me luftëra grabitqare, do të zhvillohet lodra e aleancave imperialiste dhe e luftërave të padrejta për hegjemoni e rindarje të zonave të influencës etj.

Aktualisht në ç'pozita qëndron Kina në arenën ndër-

kombëtare? Për mendimin tim, ajo nuk mban qëndrime revolucionare, nuk ndjek një politikë të parë si duhet nga këndi klasor i revolucionit. Kina konsideron se armiku kryesor i botës është Bashkimi Sovjetik. Kjo s'është plotësisht kështu. Sot armiqtë kryesorë në botë janë dy: Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për Kinën, strategjikisht, mundet që Bashkimi Sovjetik të jetë armiku më imediat, por në politikën botërore nuk mund ta bësh këtë ndarje, këtë dallim, sepse atëherë del sikur Kina mendon vetëm për vete, dhe nuk mendon edhe për popujt e tjerë që vuajnë dhe duan të çlirohen. Po nga kush duan të çlirohen? Vetëm nga Bashkimi Sovjetik? Po nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Sigurisht, popujt duan të çlirohen nga të dyja këto superfuqi dhe nga të gjithë kapitalistët e botës që të tërë së toku u pinë gjakun atyre.

Politika aktuale ndërkombëtare e Kinës dallohet nga thirrja për «unitet të të gjithëve»: të imperializmit amerikan, të fuqive të tjera të mëdha kapitaliste, të «botës së tretë», në të cilën publikisht është futur edhe vetë, të «botës së të paangazhuarve», dhe më në fund të popujve, marksistë-leninistëve dhe gjithë revolucionarëve. Pra të gjithë këtyre, pa dallim, u bën thirrje për «unitet» kundër Bashkimit Sovjetik socialimperialist. Kjo politikë e hapët dhe jomarksiste e Kinës u thotë të gjithëve: **«Lëreni mënjatë luftën e klasave, harrojeni për një kohë revolucionin (sa të bëhem unë, Kina, një fuqi e madhe), proletarë të të gjithë botës, bashkoni përpjekjet tuaja me borgjezinë që ju shtyp, sepse (dëgjomëni dhe ndiqmëni mua), ne duhet të shkatërrojmë më parë armikun numër një, Bashkimin Sovjetik socialimperialist, pastaj shohim e bëjmë».**

Kjo lloj politike e Kinës, që ndihmon imperializmin amerikan dhe fuqitë kapitaliste botërore, po çorodit dhe po përçan forcat revolucionare dhe komunistët në mbarë

botën. Këtë punë bënë edhe hrushovianët. Ç'thanë ata? «Bashkekzistencë paqësore, miqësi me të gjithë e veçanërisht me amerikanët; luftë kundër marksistë-leninistëve, kundër luftërave revolucionare; revolucion në rrugën paqësore» etj., etj. Ç'thotë tani Kina? Të gjitha këto që përmenda dhe që tash njihen, por në adresë të Bashkimit Sovjetik e kundër tij. «Kundër» Shteteve të Bashkuara të Amerikës flet në surdinë edhe Kina, ndërsa Hrushovi në kohën e tij fliste «me bomba të mëdha». Kontradiktat e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë, si të thuash, në gjumë.

Kina mendon, me një naivitet të habitshëm, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera, të cilave u bën thirrje për unitet, «do të marshojnë» kundër Bashkimit Sovjetik, ashtu siç e do ajo dhe kur të dojë ajo. Sa larg është dëshira e saj nga realiteti! E kundërta ngjet në jetë. Imperializmi amerikan dhe aleatët e tij e pranojnë dhe e mbështetin politikën dhe thirrjen e Kinës, sepse kanë fitime kolosale, ata ndihmohen shumë nga kjo politikë në veprimtarinë e tyre për çorientimin e revolucionarëve e shtypjen e tyre, për zbutjen e luftës së klasave dhe nxitjen e të gjitha forcave kundër Bashkimit Sovjetik dhe partive të tjera revizioniste, në çdo vend qofshin ato. Në strategjinë e tyre globale imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre nxitin Kinën, sa më shumë të jetë e mundur, kundër Bashkimit Sovjetik dhe bëjnë çmos që këtë ta trembin me rrezikun kinez për të realizuar më lehtë qëllimet e tyre, për ta dobësuar dhe për ta krimbur akoma më mirë dhe sa më shpejt Bashkimin Sovjetik, dhe pastaj t'i kthehen edhe Kinës me forca të shumëfishuara. Kjo është e qartë për çdo njeri me pak mend, kurse për kinezët «marksistë-leninistë-maoedunistë» jo. Udhëheqësit kinezë me politikën e tyre mburren se dobësojnë Bashkimin Sovjetik dhe thellojnë kontradiktat në mes tij dhe Shteteve të Bashkuara të

Amerikës. Por ata harrojnë se ekziston edhe mundësia tjetër për të cilën ata s'reflektojnë fare, që kjo politikë është në dobi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me naivitetet kinezët mendojnë se me politikën e tyre dobësojnë të dyja superfuqitë, Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kina socialiste mund të luajë me të vërtetë një rol vendimtar në botë, në rast se politika e saj e jashtme do të jetë një politikë klasore, marksiste-leniniste, që mbështetet në forcën, në dëshirat dhe në aspiratat e popujve. Kjo gjë me fjalë nga kinezët thuhet lehtë e shpesh, por me vepra jo. Kina vendos marrëdhënie diplomatike me shumë shtete në botë, deri edhe me shtete fashiste. Ajo po zhvillon tregti të madhe ndërkombëtare, mundet që jep edhe kredi, por kudo shihet qartë se në mënyrë të veçantë ajo u kushton shumë rëndësi dhe përpiqet të vërë në dukje lidhjet e saj me krerët e regjimeve të këtyre vendeve. Duhet thënë se lidhjet ndërshtetërore nuk mund të evitohen, por që të veprohet «kaq miqësisht» me krerët e borgjezisë sunduese, ashtu siç bën Kina, do të thotë fare qartë se ajo ka harruar anën klasore të marrëdhënieve midis shteteve. Nga politika kineze popujt dhe revolucionarët e këtyre vendeve pësojnë deziluzione të hidhura.

Populli është e vetmja bazë e vërtetë e luftës kundër socialimperialistëve sovjetikë, imperialistëve amerikanë dhe borgjezisë së vendit. Ky faktor nuk duhet harruar kurrë, në asnjë rast. Mirëpo këtë kinezët e harrojnë. Aleanca dhe shpresat e tyre mbështeten në krerët borgjezo-kapitalistë. Kinezët mendojnë se këta janë «aleatë besnikë» të revolucionit, në rast se tregojnë qoftë edhe shenjën më të vogël të antisovjetizmit. Regjimi fashist i Kilit është antisovjetik dhe proamerikan në palcë, por për kinezët është një aleat dhe bashkudhëtar.

Kinës nuk i vjen aspak mirë që Vietnami, Laosi dhe

Koreja e Veriut tregohen prosovjetikë. Dhe për këtë ka të drejtë. Por ama edhe këtyre s'u vjen mirë që Kina tregohet proamerikane. Të dyja palët bëjnë një politikë joparimore, joklasore, jomarksiste-leniniste. Qëndrimet e tyre janë oportuniste dhe të mbarsura me rreziqe për të gjithë. Revizionistët sovjetikë përpiqen që, me anën e vietnamezëve, të dominojnë në Indokinë. Kina, kuptohet, do që të hyjë medoemos në konkurrencë joparimore. Në qoftë se gjendet në inferioritet përballë Bashkimit Sovjetik, ajo ose do ta prishë me vendet e Indokinës, ose do të thërresë tërthorazi në ndihmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çfarë do të rezultojë në këtë mes? Vietnami dhe të tjerët si ky do të bëhen pre e një sërë imperialistësh.

Edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare këtë punë po bën Kina. Në fillim të lindjes së partive komuniste marksiste-leniniste ajo nuk u interesua shumë, më vonë aspak, kurse tash interesohet më tepër dhe bën thirrje për bashkim joparimor të grupeve të ndryshme nën parullën «luftë kundër Bashkimit Sovjetik në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e me borgjezinë kapitaliste të vendeve të tyre». Natyrisht, kjo politikë ka ngjallur pështjellim dhe pakënaqësi të madhe dhe reale në radhët e shokëve tanë në botë, por si ata, edhe ne nuk duam që të flasim hapur kundër kësaj politike të Kinës. Mirëpo ne me gojë mbyllur nuk mund të rrimë dhe as mund të bëhemi gramafoni i politikës së gabuar kineze.

Ne, haptazi dhe me forcë, afirmojmë qëndrimet dhe politikën tonë mbi çdo gjë, mbi çdo ngjarje, mbi çdo kombinacion politik që luhet në kurrizin e popujve. Dhe për të gjitha këto arsye shohim se politika jonë me atë të Kinës ndryshon në shumë çështje parimore. Kjo është mirë, mendojmë ne, sepse popujt dhe marksistë-leninistët janë në gjendje të gjykojnë vetë kush mendon dhe vepron drejt dhe kush gabim, pastaj u takon atyre të

ndjekin rrugën marksiste-leniniste dhe ta adaptojnë këtë në situatat konkrete të vendeve të tyre.

Partia jonë shumë herë ka dashur dhe dëshiron që të ketë bisedime shoqërore me shokët kinezë për këto probleme jetike parimore, por kinezët nuk i duan këto bisedime; ata u shmangen këtyre. Bile ata e shprehin haptazi këtë mendim, duke shtyrë deri edhe vajtjen e delegacionit të Partisë dhe të Qeverisë sonë në një kohë kur në vendin e tyre s'lënë reaksionar pa pritur. Për ne është e qartë se ata nuk janë dakord me qëndrimet tona të drejta dhe nuk duan të ballafaqohen në diskutime, sepse pozitat e tyre s'janë marksiste-leniniste.

Një politikë e tillë e gabuar e Kinës në arenën ndërkombëtare është rezultat i pikëpamjeve jomarksiste-leniniste, të afirmuara në Kinë. Është e zorshme të përcaktojmë me saktësi ç'po ngjet në këtë vend, por një gjë mund ta themi: atje nuk duhet të ketë stabilitet, atje duhet të ketë grupe rivale të fuqishme, që, nën flamurin e Maos, kërkojnë kush e kush të fitojë pozita zotëruese në parti dhe në shtet. Elementët që u dënuan nga Revolucioni Kulturor po rehabilitohen dhe po zënë postet e humbura. Sigurisht, këta do të hakmerren kundër atyre që bënë Revolucionin Kulturor. Revolucioni Kulturor zyrtarisht vazhdon të jetë flamur për çdo veprim e hap që bëhet atje, por ky është një flamur që po shqyhet. Ata që bënë Revolucionin Kulturor nuk mund të pajtohen me këtë kurs që po marrin ngjarjet, që rehabilitohen kundërshhtarët e tyre të djeshëm, që ndiqet një politikë e tillë e butë kundër imperialistëve amerikanë dhe që devijohet nga rruga e drejtë: luftë kundër Bashkimit Sovjetik revizionist dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këta, njerëzit e kësaj rruge, janë quajtur pasues të Lin Biaos, i cili u shpall se ishte «agjent sovjetik». Tash flitet se në Hanxhou, në Shangai dhe në qytete të tjera të Kinës ka trazira në ushtri. Thuhet se këta janë «partizanët e

Lin Biaos». Ata edhe mund të jenë partizanë të Lin Biaos, por rëndësi ka fakti se cilat janë mendimet e tyre të vërteta politike dhe ideologjike.

Festa e ushtrisë sonë u bë shumë e zbehtë në Pekin. Organizatori i festimit zyrtar, një nëpunës i protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pas një ore, tha: «Festa mbaroi». Në sallë me këtë rast udhëheqës kryesorë gati nuk kishte fare.

Pse ngjasin këto? Pse ngjet që artikullin tonë kundër Konferencës së Helsinkit kinezët nuk po e përmendin fare, në një kohë kur përpiqen të gjejnë fraza në çfarëdo lëvere që flet kundër Bashkimit Sovjetik lidhur me këtë konferencë? Në qoftë se flitet me të vërtetë me forcë kundër Bashkimit Sovjetik, flitet në artikullin tonë. Atëherë përse nuk zihet në gojë ky artikull nga shokët kinezë?! Për ne arsyeja është e qartë: në këtë artikull flitet po aq fort edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse kinezët nuk duan që opinionin e tyre i brendshëm të njihet me të. Nuk gjejmë dot asnjë shpjegim tjetër për këtë ndodhi politike me rëndësi.

E MARTË
5 GUSHT 1975*

QËNDRIMI I KINEZËVE NDAJ NESH PO KEQËSOHET

Nga ana e kinezëve po shohim disa qëndrime politike jo të drejta ndaj nesh, të cilat na tërheqin vëmendjen, sepse nuk i kishim parë kurrë më parë.

Çdo herë në festën e ushtrisë së tyre atasheun tonë ushtarak në Pekin e kanë vënë në një vend nderi, në një tryezë me udhëheqës ushtarakë dhe civilë kinezë ose me përfaqësues të atyre shteteve, me të cilat kemi lidhje, si me vietnamezët, koreanët e të tjerë. Këtë herë ndodhi ndryshe dhe në mënyrë krejt të hapët provokuese: atasheun tonë ushtarak e kishin caktuar në një tryezë me atasheun ushtarak sovjetik. Me ta marrë vesh këtë gjë, atasheu ynë nuk pranoi të ulej, kërkoi vend tjetër dhe protestoi që shokët kinezë donin ta vinin në një tryezë me armikun revizionist. E hoqën nga ajo tavolinë dhe e caktuan në një tjetër, ku kryesonte atasheu ushtarak anglez. Nga një provokacion, në një tjetër. Atasheu ynë nuk e pranoi as këtë vend dhe kërkoi t'i caktonin një vend tjetër; ndryshe, do të detyrohej të mos asistonte në festë. Atëherë provokatorët i caktuan një vend tjetër.

Këto qëndrime nga pala kineze ndodhin në një kohë kur artikujt tanë të këtyre ditëve të fundit nuk janë botuar në shtypin kinez. As edhe një lajm nuk dhanë kinezët për këta artikuj, saqë dhe mjaft ambasadorëve të huaj në Pekin u ka tërhequr vëmendjen një gjë e tillë: Si është e mundur që Kina përmend gjithë shtypin e

Lin Biaos». Ata edhe mund të jenë partizanë të Lin Biaos, por rëndësi ka fakti se cilat janë mendimet e tyre të vërteta politike dhe ideologjike.

Festa e ushtrisë sonë u bë shumë e zbehtë në Pekin. Organizatori i festimit zyrtar, një nëpunës i protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, pas një ore, tha: «Festa mbaroi». Në sallë me këtë rast udhëheqës kryesorë gati nuk kishte fare.

Pse ngjasin këto? Pse ngjet që artikullin tonë kundër Konferencës së Helsinkit kinezët nuk po e përmendin fare, në një kohë kur përpiqen të gjejnë fraza në çfarëdo lëvere që flet kundër Bashkimit Sovjetik lidhur me këtë konferencë? Në qoftë se flitet me të vërtetë me forcë kundër Bashkimit Sovjetik, flitet në artikullin tonë. Atëherë përse nuk zihet në gojë ky artikull nga shokët kinezë?! Për ne arsyeja është e qartë: në këtë artikull flitet po aq fort edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse kinezët nuk duan që opinionin e tyre i brendshëm të njihet me të. Nuk gjejmë dot asnjë shpjegim tjetër për këtë ndodhi politike me rëndësi.

E MARTË

5 GUSHT 1975*

QËNDRIMI I KINEZËVE NDAJ NESH PO KEQËSOHET

Nga ana e kinezëve po shohim disa qëndrime politike jo të drejta ndaj nesh, të cilat na tërheqin vëmendjen, sepse nuk i kishim parë kurrë më parë.

Çdo herë në festën e ushtrisë së tyre atasheun tonë ushtarak në Pekin e kanë vënë në një vend nderi, në një tryezë me udhëheqës ushtarakë dhe civilë kinezë ose me përfaqësues të atyre shteteve, me të cilat kemi lidhje, si me vietnamezët, koreanët e të tjerë. Këtë herë ndodhi ndryshe dhe në mënyrë krejt të hapët provokuese: atasheun tonë ushtarak e kishin caktuar në një tryezë me atasheun ushtarak sovjetik. Me ta marrë vesh këtë gjë, atasheu ynë nuk pranoi të ulej, kërkoi vend tjetër dhe protestoi që shokët kinezë donin ta vinin në një tryezë me armikun revizionist. E hoqën nga ajo tavolinë dhe e caktuan në një tjetër, ku kryesonte atasheu ushtarak anglez. Nga një provokacion, në një tjetër. Atasheu ynë nuk e pranoi as këtë vend dhe kërkoi t'i caktonin një vend tjetër; ndryshe, do të detyrohej të mos asistonte në festë. Atëherë provokatorët i caktuan një vend tjetër.

Këto qëndrime nga pala kineze ndodhin në një kohë kur artikujt tanë të këtyre ditëve të fundit nuk janë botuar në shtypin kinez. As edhe një lajm nuk dhanë kinezët për këta artikuj, saqë dhe mjaft ambasadorëve të huaj në Pekin u ka tërhequr vëmendjen një gjë e tillë: Si është e mundur që Kina përmend gjithë shtypin e

botës për Konferencën e Helsinkit dhe nuk thotë një fjalë për shtypin shqiptar?!

Gjithashtu ne kemi dërguar një ekspozitë pikturë në Pekin. Mirëpo kinezët këtë nuk do ta hapin më parë në Pekin, por në Kanton, «sepse i kanë sallat të zëna, pasi atje do të hapin një ekspozitë rumune, një vietnameze» etj.

Duket qartë, dhe unë mendoj se do të shtohen gjeste të tilla jomiqësore ndaj nesh, për arsye se kinezët nuk janë dakord me vijën e Partisë sonë, ata nuk janë të kënaqur që ne nuk ndjekim vijën e tyre liberale, proamerikane dhe perëndimore. Atyre me siguri nuk u ka ardhur mirë që ne zbuluam dhe goditëm tradhtarët ushtarakë, Beqir Ballukun me njerëzit e tij, të cilët, në themel të komplotit të tyre kishin këshillat e «mbrojtjes», që u dha Çu En Lai. Beqir Balluku dhe kinezët mund të kenë biseduar edhe për çështje të tjera që ne nuk i dimë, por «mendimet-këshilla» që Çu En Lai ia tha Beqirit kur ky ishte në Pekin, i dimë.

Nga ana tjetër, me goditjen që u bëmë ne armiqve Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerë, mundet që kinezëve t'u kemi shkelur në kallo, jo për arsyen se Abdyl Këllezi ishte kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë, por sepse ai ishte dakord me pikëpamjet politiko-ekonomike të Çu En Lait, ishte mik i kinezëve, «mik i vyer», në mos më shumë. Decentralizimi i ekonomisë, ecja drejt vetadministrimit, sabotimi i naftës, fryrja e burokracisë e të tjera të këqija të Abdyl Këllezit me shokë, i pëlqenin shumë Çu En Lait; në mos ishte vetë Çuja që të gjitha këto t'ua kishte fryrë në vesh. **Sidoqoftë, Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi ishin dy koka gjarpërinjsh, që ne i premë dhe kështu ata nuk na kashuan dot, siç mund të ëndërronin dhe të urdhëronin Brezhnjevi ose Titoja, Çuja ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës.** Çuja dhe njerëzit e grupit të tij mendojnë se ua zbuluam lodrën, dhe të drejtë kanë, sepse ne nuk

mendojmë për ta veçse të bazuar në faktet që na japin ata vetë. Akuza të drejtpërdrejta nuk po u bëjmë, por gjersa ata përballë miqësisë sonë vënë këto qëndrime armiqësore, na lënë të dyshojmë se në prapaskenë mund të kenë pasur qëllime armiqësore ndaj nesh, mund të kenë bërë edhe prapësira të tjera që ne nuk i dimë akoma, por që koha me siguri do t'i zbulojë.

Ne duhet të mbrojmë vijën tonë, parimet marksiste-leniniste, këto t'i afirmojmë hapur e me forcë, të ruajmë miqësinë me popullin kinez dhe me marksistë-leninistët kinezë, të kemi kujdes dhe të ruajmë nga provokacionet, se revizionistët kinezë këtë duan. Ata do të përpiqen që ne të biem brenda dhe pastaj të na bëjnë ne fajtorë për prishjen e marrëdhënieve me Kinën. Por marrëdhëniet me Kinën ne nuk duhet t'i acarojmë. Duhet të ruajmë parimet dhe, kur kinezët të na bëjnë ndonjë veprim të rëndësishëm që shkel parimet tona marksiste-leniniste, ne patjetër duhet t'ua vëmë në dukje dhe t'ua kundërshtojmë. Për mizerjet e vogla që bëjnë, le t'ua përgjigjemi miqësisht e me maturi, ashtu siç bënë nëpunësit e ambasadës sonë për çështjen e ekspozitës.

S'ka dyshim, që ndonjë nga këta armiq sabotatorë që zbuluam, si Beqir Balluku, Abdyl Këllezi, Hito Çakoja ose ndonjë tjetër, duhet t'u ketë thënë kinezëve se «udhëheqja jonë (shqiptare) ju kritikon për mjaft çështje» etj. Dhe, siç duket, udhëheqja kineze i ka marrë këto si kapital, prandaj dhe mban ato qëndrime që dimë për mospranimin akoma të delegacionit zyrtar të Partisë dhe të Qeverisë sonë. Për këtë dëshmon edhe mënyra dhe forma me të cilat ata i pritën kërkesat tona për kredi për pesëvjeçarin e gjashtë.

Qëndrimi i kinezëve në këtë rast ishte i prerë, i egër, armiqësor, dhe jo si më parë, që edhe pse nuk na i kanë pasë plotësuar të tëra kërkesat, toni i tyre ka qenë dashamirës, miqësor.

Këta dy vjetët e fundit qëndrimi i kinezëve ndaj nesh ka ndryshuar dhe ka shkuar drejt keqësimit. Cila është arsyeja? Për shkak të qëndrimeve tona të drejta parimore që nuk puqen me qëndrimet e tyre. Po ata i dinin këto me kohë. Qëndrimet tona janë të hapëta për çdo problem dhe miqësinë e madhe me Kinën ne e kemi vënë dhe e vëmë në dukje. Atëherë?! S'ka asnjë dyshim se mosmarrëveshjet tona ideologjike janë në bazë të këtij zemërimi të tyre, por këtu është luajtur edhe një intrigë e madhe nga armiqtë. Këta përpiqen me çdo kusht që të prishet miqësia jonë me Kinën, që të dobësojnë mbrojtjen dhe ekonominë tonë, pastaj të na godasin dhe të marrin fuqinë. Kështu që Beqir Balluku, Abdyl Këllezi e të tjerë, paralelisht edhe intrigonin e shpifnin me kinezët, edhe sabotonin brenda.

Me arrestimin e tradhtarëve ushtarakë dhe me likuidimin e punës armiqësore të Abdyl Këllezit me shokë, ka mundësi që kinezët të mendojnë se ne i kemi goditur këta armiq nga pozita «antikineze». Ne i vumë në dijeni ata për punën armiqësore të Beqir Ballukut, do t'i vëmë në dijeni edhe për veprimtarinë e Abdyl Këllezit. T'u flasim kinezëve për veprimtarinë armiqësore të këtyre tradhtarëve dhe t'u lëmë të kuptojnë qartë, siç është e vërteta, duke u vënë në dukje se fijet e kësaj veprimtarie të ndyrë lidhen me revizionistët e Moskës dhe me titistët. Ne duhet të caktojmë një shok të Byrosë Politike si kryetar të Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë¹ në vend të Abdyl Këllezit.

Ka mundësi që, në rast se nuk kuptohen çështjet në rrugën marksiste, por në rrugën subjektiviste, kinezët ta lidhin miqësinë tonë me Kinën me një person sabotator si Abdyl Këllezi. Këtë situatë duhet ta sqarojmë dhe mundësisht ta likuidojmë.

¹ Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë u caktua shoku Spiro Koleka.

VEPRIME TË ÇEKUILIBRUARA KINEZE

Shtypi i huaj vazhdon të flasë dhe t'i bëjë çështje «trazirat e Hanxhout», ku «janë revoltuar punëtorët për çështje pagash». Nga ana tjetër, po ky shtyp shkruan se gjoja në ambasadat e huaja në Pekin janë dërguar trakte nga «populli» kundër Ten Hsiao Pinit, të cilin e quajnë «shkaktarin e shtypjes së kryengritësve dhe të gjakderdhjes».

Lufta e klasave vazhdon dhe do të vazhdojë në periudhën e ndërtimit të shoqërisë socialiste, por kemi përshtypjen se kjo luftë në Kinë nuk bëhet me konsekuencë, ajo është e butë dhe nuk bazohet në parime të shëndosha e të qëndrueshme. Kur ka lëkundje në vijë, me siguri do të ketë dhe qëndrime të lëkundshme kundër armiqve.

Në momente kyç, duke mos pasur vijë të qëndrueshme, s'ke as situatën në dorë dhe ngjet ajo që ngjau: u zhvillua Revolucioni Kulturor kundër grupit tradhtar të Liu Shao Çisë dhe në këtë grup u futën edhe Ten Hsiao Pini, Li De Shenj e të tjerë. Pas një kohe këta na dolën «të pafajshëm» dhe u ngritën në pozitat e mëparshme, «u riedukuan». Fjalë «magjike», «mrekullitë» e «mendimit të Mao Ce Dunit»! Mirëpo ka shumë që nuk e hanë këtë rehabilitim të shpejtë dhe bëjnë pyetjen: Kush kishte të drejtë, ata që bënë Revolucionin Kulturor, apo ata që ishin kundër tij? Natyrisht do të ketë përpjekje, qoftë me dacibao, qoftë me turbullira e greva, por mu-

ndet edhe me armë, në rast se kontradiktat thellohen.

Mendoj se kjo politikë e Kinës, me zigzage, me ngjitje dhe me zbritje, me tendenca «proamerikane», një «politikë globale» e paqartë dhe e paqëndrueshme nuk do të ketë sukses në shtetet dhe në popujt e botës.

Vietnamezët dhe kinezët, prapa krahëve flasin jo mirë për njëri-tjetrin. Vietnamezët thonë se kinezët ndërhyjnë në punët e brendshme të tyre. Si është e vërteta ne nuk e dimë, por Kinës i intereson që Vietnami të mos bëhet bazë e Bashkimit Sovjetik.

SHBA janë bërë «Qabeja» e revizionistëve. Të gjithë venë e i marrin dorën «kryegjyshit botëror», presidentit amerikan në Uashington. Revizionistët, për dollarë, i çojnë me tepsi të argjenditë presidentit amerikan pjesë të majme të atdheut të tyre. Me një fjalë, ata venë si pa gjë të keq te presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shesin lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e atdheut të tyre. Kina me këtë rrugë, me veprimet e dezekuilibruara të politikës së saj të jashtme, i ndihmon revizionistët.

Japonezi Miki bisedoi fshehurazi me Fordin. Po përse vallë? Për interesin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë. Natyrisht, kundër Kinës është edhe Japonia. Fordi dhe Miki do të ndjekin tani një politikë të balancuar si ndaj Kinës, ashtu edhe ndaj Bashkimit Sovjetik. S'ka dyshim që Fordi i ka premtuar Japonisë armën atomike, por edhe Japonia, nga ana e saj, i ka premtuar Fordit miqësinë e xhandarit aziatik, kundër atij ose atyre që do ta rrezikojnë këtë miqësi amerikano-japoneze.

Kina po përpëlitet kështu në mes japonezëve dinakë dhe armiq, Kim Ir Senit megaloman, të lëkundshëm dhe revizionist, vietnamezëve prosovjetikë dhe Indisë armike! Asgjë e shëndoshë nuk mund të dalë nga një politikë e tillë pa një shtyllë kurrizore marksiste-leniniste. Në qoftë

se kinezët mendojnë se me një politikë të tillë do të arrijnë të forcojnë dhe të konsolidojnë pozitën e socializmit brenda dhe jashtë vendit të tyre, ata gabohen rëndë dhe do të kenë zhgënjime të hidhura. Kinezët mendojnë se kllakat kapitaliste anojnë nga politika e Kinës, për shkak të disa buzëqeshjeve diplomatike borgjeze, por duhet ta kenë të qartë se këto klika janë të lidhura kokë e këmbë me kapitalizmin botëror, me dy superfuqitë. «Miqësinë» me Kinën ato e duan për ndonjë kredi dhe për ndonjë shantazh sporadik. Për ta Kina është «një shtet i modës» që «as ndez, as shuan, aktualisht s'është i rrezikshëm për ne, por dhe dobi s'kemi». Kinën këta e konsiderojnë si «një shtet tampon» për të lehtësuar disi ndonjë të papritur.

Për fat të keq Kina beson se «miqësia» e këtyre klikave është baras me miqësinë e popujve që ato sundojnë. Këtu Kina gabon rëndë, ose vepron kështu, sepse kjo gjë i vjen më tepër për shtat.

SHËNIM

U takova sot me ministrin e Punëve të Jashtme. Më raportoi për punët e dikasterit të tij. Ai më foli edhe për përgatitjen e sesionit të jashtëzakonshëm të OKB-së. E këshillova të përgatiten mirë, pse duhet të ketë shumë tendenca që do të shfaqen në këtë sesion, si rrjedhim i konferencës që mbahet në Lima nga vendet «e paangazhuara». Duhet të studiohen këto tendenca dhe të ndërtojmë qëndrimet tona të përshtatshme.

SHOKU PEDRO LEON ARBOLEDO RA HEROIKISHT

Me hidhërim të thellë mësuam se sekretari i parë i Partisë Komuniste të Kolombisë (marksiste-leniniste), shoku Pedro Leon Arboledo, në fund të muajit korrik ka rënë heroikisht në luftë me forcat reaksionare kolombiane.

Kjo është një humbje e madhe për partinë motër të Kolombisë dhe për të gjithë revolucionarët kolombianë. Do t'i dërgojmë një telegram Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kolombisë (marksiste-leniniste).

THRIJMI MAO CE DUNI BISEDON ME HITHIN

Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi se dje Mao Ce Duni ka pritur dhe ka pasur një bisedë me ish-kryeministrin e Anglisë, kryetarin e partisë konservatore, Eduard Hithin. Në këtë takim ka qenë i pranishëm edhe Ten Hsiao Pini.

Pekinin po e vizitojnë kështu reaksionarët më të këqij të botës, në fuqi e të rënë nga fuqia!

SI DUHET TË JETË INTERESIMI YNË PËR KOSOVËN E KOSOVARËT

Bisedova me Hysniun për problemin e Kosovës dhe mbi mënyrën e interesimit tonë për zhvillimin politik, ekonomik, shoqëror dhe veçanërisht patriotik shqiptar të kosovarëve. Armiqtë e jashtëm shqiptarë, që nga Lekë Zogolloviçi dhe Vatikani, organizojnë në Kosovë plane djallëzore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Natyrisht, po kështu bëjnë, në radhë të parë, titistët, proamerikanët dhe prosovjetikët. Të gjithë këta Kosovën po e përdorin si një trampolinë kundër nesh, trampolinë e maskuar nën petkun e «Shqipërisë». Në këtë rrugë përdoret feja, përdoren njerëz nga shtresa e inteligjencies së lartë shqiptare kosovare, pronarë të mëdhenj të tokave. Midis zanatçinjve ka të lëkundshëm. Pjesa tjetër e popullit ka një frymëzim të madh patriotik shqiptar, anti-titist, antiserb etj. Kosovarët patriotë duhet të mendojnë vetë për të tashmen dhe për të ardhmen e tyre; vetë ata duhet të vendosin ç'duhet të bëjnë tash e më vonë, vetë ata duhet të gjejnë mënyrat e organizimit të tyre.

Ndihma jonë nuk mund të mendohet dhe as të shtrohet, siç bëjnë disa në Kosovë: «A do të na ndihmojë Shqipëria me ndërhyrje të armatosur?». Këta njerëz, në qoftë se s'janë provokatorë, duhet të mendojnë më parë si do të mbrohen vetë dhe jo të presin që Shqipëria socialiste «t'i deklarojë Jugosllavisë luftë të armatosur». Shqipëria

socialiste do të mbrohet, në rast se atakohet nga cilido shtet kufitar. Ne do të mbrojmë vëllezërit tanë kosovarë, siç kemi bërë në çdo kohë, në rast se persekutohen, por jo duke i deklaruar luftë Jugosllavisë. Lufta e Partisë sonë kundër titizmit dhe vetadministrimit titist është një ndihmë e madhe politiko-ideologjike që u japim ne shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi. Zhvillimi me sukses i ndërtimit socialist te ne është një ndihmë tjetër e madhe që kosovarët duhet ta propagandojnë dhe të luftojnë kundër atyre shqiptarëve titistë që e minimizojnë dhe e denigrojnë. Ne i ndihmojmë ata me letërsinë, me artet, me arsimin tonë dhe me ndihmën e posaçme që u japim në këtë fushë. Ne favorizojmë Kosovën, po kështu e ndihmojmë atë me tregtinë që bëjmë me Jugosllavinë dhe në shumë drejtime të tjera. Të gjitha këto ndihma kosovarët patriotë e të zgjuar duhet t'i kuptojnë, t'i konsolidojnë dhe këto të ndihmojnë organizimin e tyre brenda dhe të kalitin unitetin. Varet nga ata të mos lejojnë degjenerimin e rinisë kosovare, varet nga ata të mos lejojnë të depërtojnë kapitale amerikane, sovjetike, varet nga ata të mos lejojnë të organizojnë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe vetë Kosovës njerëzit e Zogut, të Xhafer Devës, të Vatikanit. Më parë se të vijnë «tek armët», kosovarët duhet të bashkojnë forcat dhe të godasin këtë punë armiqësore. Lufta me armë nuk mund të bëhet pa u matur mirë më parë se ç'mund të fitojnë. Prandaj duhen përdorur forma e mjete të cilat do të ishin preludi, që, kur të krijohen kushtet, të çojnë në kërkesa më të larta.

E HËNË

29 SHTATOR 1975*

RUMANIA DHE KINA KANË NJË VIJË

Ç'janë këta, revizionistët rumunë, me Çaushekun në krye, që kinezët i duan dhe i përkrahin kaq shumë?

Këto kohët e fundit personalitete të larta të partisë dhe të shtetit rumun venë e vijnë në Kinë si në shtëpinë e tyre, kanë takime me personalitete të larta të Byrosë Politike, marrin e japin, puthen e shtrëngohen, shkruajnë dhe lavdërohen.

Që borgjezia rumune njihet në histori për «dashuri», kjo s'ka dyshim. «Dashuri» ka bërë ajo me të gjithë, në çdo kohë; këtë ka bërë borgjezia, për shembull, me Francën borgjeze, këtë ka bërë e bën borgjezia e re revizioniste me Bashkimin Sovjetik të Hrushovit, me Kinën e Maos, me Jugosllavinë e Titos, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Republikën Federale të Gjermanisë dhe me të gjithë ata që i japin para. Kjo është açik për të gjithë, vetëm për kinezët jo. Për kinezët Rumania e Çaushekut është «kundër Bashkimit Sovjetik», prandaj «ajo është socialiste», «partia rumune një parti marksiste-leniniste». Të gjitha këto janë pa baza. E kundërta është e vërtetë.

Në qoftë se ka ndonjë grimë antisovjetizmi te Çaushi, kjo vjen se ai është një aventurier i tipit hrushovian, titist etj., që ka zënë një pozicion prej prokseneti dhe prokseneti rron pa u cingrisur nga sovjetikët, bile, ka shumë të ngjarë, me dijeninë e ndihmën e tyre për shërbimet

që u bën. Ai rron me paratë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Republikës Federale të Gjermanisë dhe të të gjithë atyre që e paguajnë. Regjimi i Çausheskut është një regjim i korrupsionit, i falimentimit, i diktaturës personale dhe familjare.

Turp për kinezët, që e quajnë marksiste-leniniste një parti të tillë dhe një person të tillë, si Çausheskun, e konsiderojnë një «politikan të madh»!

Po pse i mbajnë këto qëndrime kinezët ndaj Rumanisë dhe Çausheskut? S'ka tjetër shpjegim: u hahet buka, politikat e tyre puqen në strategji e në taktikë. Rumunët hiqen si antisovjetikë, kinezët janë antisovjetikë. Rumunët janë miq të amerikanëve dhe ndërhyjnë e i pajtuan kinezët me amerikanët. Çaushesku e Bodnarashi u bënë «kumbarja» e miqësisë kino-amerikane, që u përngjet lidhjeve rumuno-sovjetike ose sovjeto-amerikane. Gjoja shahen me njëri-tjetrin për të ruajtur fasadën, por prapa murit bëjnë sodomizma politike, tregtare etj.

Rumunët janë për një politikë të gjerë me kapitalistët e Evropës, te të cilët është shitur Rumania, gjoja për t'u mbrojtur nga sovjetikët. Kina po ashtu është për një politikë afrimi me reaksionin evropian, por kundër sovjetikëve. Taktika e kinezëve në këtë drejtim është: «Ruaju, moj Evropë, se të përpiu me një luftë Bashkimi Sovjetik!».

Pra, Rumania dhe Kina kanë një vijë. E para merr edhe kredi nga Evropa, Kina ende jo, por, sidoqoftë, bën tregti «interesante». Rumania e ka «burrin» të fuqishëm — Shtetet e Bashkuara të Amerikës — i zhvat këtij dollarë e favore të tjera, kurse Kina bën tregti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, blen e shet, pret më shumë se ç'dërgon grupe njerëzish të çdo lloji, të cilët atje priten me përzemërsi.

Çaushesku ka ndërmarrë të bëjë udhëtime diplomatike mbretërore në të gjitha vendet e botës. Çausheskun

më shumë e sheh jashtë Rumanisë se brenda. Ç'bën ai jashtë? Blen e shpie, lidh e zgjidh dhe merr nga një këst, kush i jep edhe nga një dekoratë. Çaushi po zëvendëson Titon në tratativat interlope nëpër kontinente.

Kina në botë nuk sillet si Rumania, asaj i pëlqen taktika «e hapjes, e njohjes», por, tani për tani, nuk bën turpësira si Rumania. Rumania ka hequr dorë nga komunizmi e revolucioni. Edhe Kina është në këto ujëra. Kina u deklarua e «botës së tretë», por, po të jesh e «botës së tretë», je dhe e «botës së të paangazhuarve». Se ç'ndryshim ka «bota e tretë» nga ajo e «të paangazhuarve» këtë e dinë «teoria» e Titos dhe «teoria» e Ten Hsiao Pinit, që inauguroi futjen e Kinës në këtë «botë».

Pra, të gjitha këto e të tjera e bëjnë Rumaninë «miqen e parë të Kinës»!

Ne e dënojmë politikën antimarksiste, proamerikane dhe prorevizioniste të udhëheqjes rumune. Natyrisht, një qëndrim i tillë yni sjell edhe ftohjen e Kinës ndaj nesh.

Në Kinë propaganda pro Rumanisë është shumë e madhe. Një person në Shangai i tha një shokut tonë: «Në Shqipëri u bë një puç nga agjentë sovjetikë për të rrëzuar Qeverinë tuaj, por juve ju erdhën në ndihmë dy divizione rumune, të cilat e shpëtuan situatën». Ky besoj se nuk do të ketë qenë i shtyrë nga lart ta thoshte këtë, por ka qenë ndonjë element armik, ose ndonjë element që mori vesh për Beqir Ballukun, e lidhi çështjen e tij dhe me «aleaten e tyre besnike, Rumaninë», dhe e ndërtoi kanevanë.

E tillë është politika ndërkombëtare e Rumanisë, të tilla janë konsideratat e Kinës për të. Ne jemi edhe kundër njërës, edhe kundër konsideratave të tjetrës, dhe këto qëndrime i bazojmë në analiza realiste, të shikuara në prizmin e marksizëm-leninizmit.

Në Evropë dhe në botë po e po që Rumania po bën «një politikë të madhe», por kërkon të marrë edhe shko-

pin e dirigjentit të politikës ballkanike. As më shumë, as më pak: Çaushi kërkon të bëhet bashçaushi i Ballkanit, duke predikuar mbledhjen e gjithë udhëheqësve të shteteve ballkanike, ku të thirren për të marrë pjesë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Italia. «Motra e vogël latine», tok me motrën e saj të madhe latine, që njihen për bashkëpunëtorë në fashizëm dhe në nënshtrim ndaj imperializmit amerikan, ëndërron të na çojë në vathën e amerikanëve.

Rumania e di që ky propozim i saj është një filluskë sapuni, por s'ka gjë, filluska, para se të pëlcase, ka «disa ngjyra» irize.

Ku qëndron antisovjetizmi i Çaushëskut? Në asgjë të rëndësishme. Ai gjoja nuk merr pjesë me trupa në manovrat e Traktatit të Varshavës, por merr pjesë me shtabe. Rumania është në Traktatin e Varshavës dhe atje do të qëndrojë. Në KNER ajo është kokë e këmbë brenda, por bën ndonjë kundërshtim, hedh ndonjë vickë, por vickë në KNER hedhin bile edhe bullgarët që janë «bythë e brekë» me sovjetikët.

Atëherë ku shprehet antisovjetizmi i tyre? A, që s'janë bërë si krerët bullgarë?! Po atje afër tyre janë, në mos më thellë. Ndonjëherë bullgarët mund të bëjnë edhe ndonjë «kolpo» të papritur, kurse rumunët nuk janë nga ata lloj «trimash».

E MARTË

30 SHTATOR 1975*

ASNJË FJALË NUK U THA NË KINË PËR HERONJTË SPANJOLLË

Një qëndrim antimarksist dhe skandaloz nga ana e kinezëve është ai që deri tash nuk kanë thënë as edhe një fjalë të vetme në mbrojtje të pesë shokëve spanjollë, tre nga të cilët anëtarë të Partisë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), që i pushkatoi xhelati Franko. Gjithë bota u ngrit në këmbë me protesta të rrepta, gjithë proletariati botëror, bile edhe qeveri borgjeze, dhe Vatikani, protestuan kundër këtij akti të ndyrë, revoltues, dhe thirrën ambasadorët e tyre nga Madridi, kurse vetëm «Kina socialiste revolucionare e Maos» nuk tha asnjë fjalë për heronjtë spanjollë!! Qëndrim revolucionar është ky?! Qëndrim marksist-leninist? Jo, ky është një qëndrim reaksionar me tërë kuptimin e fjalës. Kina mbron Frankon, sikundër veproi dje duke mbrojtur Pinoçetin e Kilit. Pra është e qartë se Kina mbron këlyshët fashistë të imperializmit amerikan, mbron Shtetet e Bashkuara të Amerikës. S'ka si fshihen të tilla qëndrime me slogane «...popujt duan revolucion» etj., kur në fakt Kina mbron kundërrevolucionin.

DEKLARATA TË FOSKO DINUÇIT

Ramizi më vuri në dijeni për bisedimet që pati me Fosko Dinuçin, sekretarin e përgjithshëm të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste).

Dinuçi ka folur mbi gjendjen në partinë e vet, mbi situatën politike të rëndë në Itali, mbi grevat dhe mbi përpjekjet e partisë revizioniste të Italisë, për të marrë pjesë në qeverinë borgjeze demokristiane. Sig ka treguar Dinuçi, krerët revizionistë italianë kanë marrë kontakt fshehurazi me amerikanët dhe i kanë siguruar ata se nuk do të kërkojnë asnjë ndryshim të statukuosë amerikane në Itali.

Dinuçi ka thënë se anëtarët e partisë po punojnë me rininë, ata janë futur e punojnë dhe në sindikatat e punëtorëve progresistë dhe shokët dëgjoheh prej tyre. Ai ka thënë, gjithashtu, se me grupet që quhen komuniste, «ne punojmë me bazën dhe mund edhe të bashkohemi me ta, por jo me krerët e tyre, të cilët janë antiparti». Dinuçi ka thënë se «Partia jonë lufton edhe kundër imperializmit amerikan, edhe kundër sovjetikëve në kushtet ndër-kombëtare dhe në kushtet e brendshme» dhe se «nuk jemi dakord me Partinë Komuniste Franceze të Zhyrkesë, e cila ka pikëpamje të gabuara mbi këto çështje».

Pastaj Dinuçi ka folur për bisedat që pati në Pekin me shokët kinezë. Ai ka folur shumë mirë për Çan Çun

Çiaon¹, duke treguar se «çdo gjë e kishte drejt dhe isha dakord me të, por, kur shkova te Gën Biaoja², pa qenë rasti, as tema, ai tha se Stalini ka bërë gabime, se ka bërë gabime në drejtim të Kinës, si në çështjen e kufijve, se Kominterni ka gabuar» etj.

«Gën Biaoja, ka shtuar më tej Dinuçi, filloi dhe më tori teorinë e «botës së tretë» dhe të qenies së Kinës në të».

Ne i kemi dënuar me kohë këto pikëpamje të gabuara të kinezëve. Por se mos janë vetëm këto. Nga goja e Gën Biaos kanë dalë mendime monstruoze kundër teorisë marksiste dhe kundër partive të reja marksiste-leniniste.

Por unë mendoj se këto çështje që Gën Biaoja ia ka ngritur Dinuçit synonin disa objektiva: për të futur pyka në mes Partisë sonë dhe Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste). Me fjalë të tjera, duke ditur vijën e Dinuçit, ai donte t'i thoshte këtij: «Ose me ne, ose me shqiptarët». Dhe Dinuçi u prononcua, duke dhënë pikëpamjet e drejta të partisë së tij mbi këto probleme. Kinezët, për ta përçarë këtë parti, thirrën në Pekin Peshen dhe Gracin, renegatë të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste).

1 Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të PK të Kinës.

2 Në atë kohë drejtor i Drejtorisë së Jashtme të KQ të PK të Kinës.

**E MËRKURË
1 TETOR 1975***

IMPERIALISTËT AMERIKANË JO VETËM T'I DEMASKOJMË, POR EDHE T'I LUFTOJMË

Mbrëmë gjithë Byroja Politike dhe Qeveria ishim për darkë tek ambasadori kinez me rastin e 26-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës. Hotel «Dajti» ishte plot me të ftuar, banket luksoz! Për dreka dhe darka Kina nuk e mbyll qesenë, por për të na plotësuar neve disa nevoja për planin tonë, ajo shtrëngon dorën. Sidoqoftë, kjo është një çështje që mbaroi, dhe, në bisedën që patëm me ambasadorin kinez, as që e zëmë më në gojë.

Natyrisht, gjatë bisedës shtruum probleme. Ambasadori kinez, si ngaherë, përdori formulat dhe sloganet e njohura, me fjalë të tjera «silazh». Ai sapo kishte ardhur nga Kina dhe na tha se në Taxhai u bë «mbledhja më e madhe që ka organizuar Këshilli i Shtetit» dhe filloi kështu formulat e njohura për Taxhain. I thashë se «kemi lexuar që në Taxhai Ten Hsiao Pini dhe Çian Çini kanë mbajtur fjalime të rëndësishme. A mund të na thoni diçka mbi përmbajtjen e këtyre fjalimeve, se «Zhenminzhibaoja» s'jep gjë?». Ambasadori na u përgjigj se «edhe në Pekin u përsërit po ajo mbledhje». Me fjalë të tjera, me këtë ai donte të thoshte se «s'di gjë më shumë» ose «nuk jam i autorizuar t'ju them më tepër se kaq». Megjithatë i thashë se, po të kishte mundësi, të na i dërgonin këto fjalime «që të përfitojmë edhe ne nga rëndësia e tyre».

«Pa dyshim», tha. Ne, natyrisht, i presim të na vijnë në... kalendrat greke, si të tjerat.

Më konkretisht ambasadorit kinez i fola për bujqësinë tonë, për grurin që nuk doli keq. I vura në dukje se tash po luftojmë për rendimente më të larta në misër etj., sepse këtë vit kemi pasur thatësi, e cila vazhdon akoma dhe po na dëmton.

Po ashtu i tregova për punën armiqësore të agentëve të sovjetikëve e të titistëve, Beqir Ballukut, Abdyl Këllezit e të tjerë, duke i vënë në dukje se na kanë dëmtuar shumë dhe tash jemi duke punuar për të riparuar dëmet që na shkaktoi veprimtaria e tyre. I theksova se këta tradhtarë ishin në shërbim të sovjetikëve, ishin sabotatorë, shpifës, gënjeshtarë etj. Ambasadori rrinte dëgjonte dhe tha vetëm: «Si Liu Shao Çia dhe Lin Biaoja».

Pastaj vazhdova bisedën mbi disa probleme kyç të situatës ndërkombëtare dhe mbi rolin agresiv të të dy superfuqive. Ai ndërhyri dhe theksoi parullën e tyre për luftë kundër Bashkimit Sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk i përmendi me emër, por tha vetëm kaq: «Të tjerët t'i demaskojmë». Unë ia ktheva: «T'i demaskojmë, por edhe t'i luftojmë, sepse, po nuk i luftuam, vetëm nga demaskimet ata s'duan t'ia dinë shumë».

Pastaj ambasadori kinez tha formulën: «Kryetari Mao na mëson të përgatitemi për luftë, prandaj të depozitojmë bukë».

Iu përgjigja: «Maoja flet drejt, përgatitja për kohë luftime do bukë, por do edhe armë moderne. Ne kemi një vijë, dhe e dimë se njeriu luan rolin kryesor në luftë, por dhe armët janë shumë të domosdoshme. Armiqtë tanë janë armatosur deri në dhëmbë dhe me armë ultra-moderne. Superfuqitë kanë armatosur jo vetëm veten e tyre, por ato armatosin edhe aleatët e tyre si Titon, i cili merr armë moderne si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe nga Bashkimi Sovjetik. Rumania ndjek

po të njëjtën rrugë. Kundër kujt do t'i drejtojnë ata këto armë? Vallë kundër atyre që ua japin?! Kjo duket e dyshimtë. Nuk përjashtohet dhe ky eventualitet, sepse ekzistojnë kontradikta në mes tyre, por këto armë, në radhë të parë, do të drejtohen kundër nesh, prandaj, ne, si Kina dhe Shqipëria, duhet të armatosemi sa më parë dhe me armë moderne. Shqipëria ka vetëm një rrugë të hapët për armë, atë të aleates sonë, Kinës. Po na u mbyll kjo rrugë, dhe kjo rrugë do të na mbyllet në kohë emergjence, Shqipëria socialiste do të luftojë e rrethuar».

Ambasadori lëshoi formulën tjetër të njohur: «Jemi shumë prapa për shkak të punës armiqësore të Lin Biaos».

Nuk m'u durua dhe i thashë: «Kjo situatë medoemos duhet kapërcyer, dhe sa më parë. Përndryshe, nuk zbatohet plotësisht mendimi i Maos, se me armë konvencionale nuk mund të luftohet si duhet. Ju, kinezët, gjykoni drejt kur thoni se Ballkani është një pikë sulmi iminent nga sovjetikët. Për këtë jemi dakord me ju, sepse ashtu gjykojmë edhe ne, prandaj po aktivizojmë shumë mbrojtjen tonë. Ne s'do ta lëmë armikun të gjallë të shkelë në tokën tonë, por ai do të ketë epërsi në ajër e në det, prandaj na duhen armë të përshtatshme për t'u bërë ballë këtyre mjeteve moderne të armiqve». «I zgjuari» ambasador kinez e ktheu prapë bisedën tek eksperiencia e Tashait! Unë vazhdova më tej të zhvilloja idenë time, duke i thënë se vërtet rreziku i sulmit iminent është në Evropë, por edhe ju në Azi duhet të keni mendjen, se as sovjetikët, as amerikanët nuk flenë.

E ENJTE
2 TETOR 1975*

POLITIKA E JASHTME E KINËS NUK ËSHTË REVOLUCIONARE

Partia Komuniste e Kinës në politikën ndërkombëtare mban qëndrime të gabuara, jomarksiste. Politika e saj është jorevolucionare, joklasore, joproletare, nuk është pro revolucionit. Deri dje Republika Popullore e Kinës dhe politika e saj e jashtme ishin mbyllur në guaskë, por tani janë hapur si vaji në lakra, dhe hapja, sipas mendimit tonë, ka marrë drejtim të gabuar.

Cili ishte drejtimi i tyre i gabuar?

Partia Komuniste e Kinës hiqet sikur ndihmon revolucionin botëror dhe partitë komuniste e punëtore marksiste-leniniste, por në realitet një gjë të tillë nuk e bën.

Partia Komuniste e Kinës pretendon se «Kina bën pjesë në botën e tretë», në vend që të afirmohet si një vend socialist dhe të ndihmojë popujt e botës dhe jo klikat sunduese të tyre, sidomos klikat gjakatare të borgjezisë reaksionare, që shiten te çdo imperialist, për të sunduar mbi popullin e vet. Kina propagandon miqësinë dhe aleancën me gjithë «botën e tretë», pa bërë dallime politike, por sidomos pa bërë asnjë dallim klasor, pa luftuar dhe pa bërë asgjë për thellimin e kontradiktave në mes klasës punëtore të këtyre vendeve dhe borgjezisë reaksionare shtypëse të tyre. Partia Komuniste e Kinës dhe politika e shtetit kinez i injorojnë këto kontradikta dhe veprojnë që t'i zbutin, duke mbrojtur haptazi klika, si

ajo e Pinoçetit, e Frankos, e Mobutus dhe e shumë të tjerëve. Kjo nuk është politikë marksiste-leniniste, por antimarksiste, sepse orvatet të shuajë luftën e klasave në planin ndërkombëtar. Pra, Partia Komuniste e Kinës dhe shteti kinez harrojnë aleatin e tyre klasor, proletariatin botëror, e nënvleftësojnë atë dhe vënë në dukje aleancën me krerët e borgjezisë që sundojnë mbi proletariatin dhe mbi popujt. Dhe kjo farë aleance, e shikuar jo me sy klasor, lëkundet sipas rasteve.

Politika e jashtme kineze udhëhiqet nga dy kritere bazë:

Kriteri i parë: Je dashamirës i Kinës apo jo? Po të jesh ose të hiqesh sikur je, cilido qofsh, ti je aleati dhe miku i Kinës dhe «unë, Kina, e harroj anën klasore të politikës dhe të mbroj, të pres me gongë, të jap edhe kredi. Po më këndove shumë, të dua shumë, qofsh kush të duash; më deshe mesatarisht, e rregulloj miqësinë me këtë diapazon; të dëgjova se më kundërshton ose më ktheve fletën, atëherë e kthej zhiruetën nga fillon armiqësia». Pra, miqësi e lëkundshme, miqësi me karakter borgjez.

Kriteri i dytë: Po qe kundër revizionistëve sovjetikë, je miku i Kinës, qofsh kush të duash. Parimi që ndjek politika kineze është: armiku kryesor i saj dhe i gjithë botës është socialimperializmi sovjetik, se ky «është i pademaskuar, se është luftënxitës, se kërkon hegjemoni botërore». Prandaj, sipas politikës kineze, kundër Bashkimit Sovjetik duhet të krijohet «aleanca e shenjtë» me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilat kinezët thonë «se janë imperialiste», por «armi» të dorës së dytë, pas Bashkimit Sovjetik. Kjo thuhet sa për të thënë, por kinezët synojnë të lidhen në një aleancë socialdemokrate me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata e kanë pakësuar propagandën për demaskimin e imperializmit amerikan, e kanë zbutur ose më konkretisht e kanë shuar luf-

tën e tyre kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, bile kanë shkuar edhe më tej në konsolidimin e kësaj aleance të rreme dhe të përbindshme. Në çdo parti që hiqet se është komuniste marksiste-leniniste ose në shtetet që e mbajnë veten për socialiste, kinezët propagandojnë, këshillojnë dhe ndihmojnë çdo rrymë proamerikane dhe ndikojnë që të flitet pak ose të mos flitet fare për veprimet agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës; ata i gënjejnë e i detyrojnë lëvizjet revolucionare, çlirimtare, ato marksiste-leniniste që të veprojnë sipas drejtimit të politikës kineze. Edhe atje ku imperializmi amerikan ka futur thellë kthetrat e tij të gjakosura dhe klikat e atij vendi janë bërë agjenturë e amerikanëve, lëvizjet përparimtare dhe revolucionare këshillohen, frymëzohen që, duan s'duan, të thonë se «armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik».

Kjo është e tmerrshme. Kësaj i thonë të gënjeshtër proletariatin, të shuash revolucionin e të nxitësh një luftë botërore imperialiste, në vend që të ecësh në rrugën marksiste-leniniste, duke luftuar për të dobësuar imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, duke ndihmuar revolucionin dhe jo duke e shuar atë, duke ndihmuar luftërat nacionalçlirimtare të popujve kundër dy superfuqive, që të shkatërrosh kështu planet e tyre të luftës grabitqare imperialiste dhe, po nuk munde ta evitosh këtë luftë, atëherë ta kthesh atë në luftë civile, në luftë çlirimtare e në revolucion.

Por Kina nuk ecën në këtë rrugë. Ajo ka deklaruar, dhe për këtë ka nënshkruar Komunikatën e Shangait, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë hegjemonë dhe nuk do të luftojnë për hegjemoni. Të mendosh kështu dhe të besosh një «copë letër», siç i quajti Fordi në Pekin të tilla deklarata, do të thotë të kesh devijuar nga teoria marksiste-leniniste dhe të ecësh në një rrugë të kundërt.

Kina përdor disa parulla si «kombet duan çlirim», «popujt duan revolucion», ndërsa në realitet luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionin ajo nuk i ndihmon, por i shuan. «Bota është e turbullt, por situata është e shkëlqyer», thonë kinezët. Të thuash se «situata është e shkëlqyer» kur të dy superfuqitë po shtypin e po robërojnë popujt, kur përgatiten për luftë imperialiste, kur i nxitin popujt të gjakosen me njëri-tjetrin etj., etj. dhe kur ti, Kinë, mban anën dhe kërkon ndihmën e njërit shtet imperialist për të luftuar tjetrin dhe për këtë politikë të dënueshme sakrifikon revolucionin, lëvizjen marksiste-leniniste dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve, do të thotë të gënjesh e t'i bësh një tradhti të madhe revolucionit. Këtë gjë tregon loja e rrezikshme e Kinës.

Demaskimi i Bashkimit Sovjetik, i Traktatit të Varshavës e i KNER-it, duke treguar se Bashkimi Sovjetik po futet, për shembull, në Bolivi, ku ka bërë një fabrikë çimentoje etj., të gjitha këto bëhen nga propaganda kineze dhe me këto jemi dakord. Kemi qenë kurdoherë dakord për luftën kundër socialimperializmit sovjetik. Por të pranosh që imperializmi amerikan është zbutur, siç bën Kina, se NATO-ja duhet, se Tregu i Përbashkët Evropian duhet, se duhet thënë: «Rroftë Evropa borgjeze kapitaliste e bashkuar», «Rrofshin Frankoja dhe Pinoçeti», me këto pikëpamje e qëndrime dhe me të tjera si këto, ne s'kemi qenë e s'do të jemi kurrë dakord me Kinën. Bile, jemi e do të jemi kundër dhe do t'i luftojmë haptazi të gjitha pikëpamjet e kësaj natyre, sepse ato janë në favor të imperializmit amerikan, të kapitalizmit botëror dhe kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit e socializmit.

Kriza e botës kapitaliste dhe revizioniste është aq e madhe, aq e thellë, sa s'është parë kurrë ndonjëherë. Po Kina ç'bën? I ndihmon ajo miliona proletarë që hidhen në greva? I ndihmon ajo të papunët, që janë me miliona

në botë? I ndihmon vallë Kina këto masa kolosale që janë ngritur në këmbë, dhe me ndihmën e saj të thellojë krizën e imperializmit amerikan e të revizionizmit sovjetik? Jo, aspak! Kina, për fat të keq, ndihmon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet kapitaliste perëndimore që ta kalojnë pa dhimbje krizën; i ndihmon ato politikisht e ideologjikisht. Ajo u ka hapur atyre tregun e vendit të vet dhe lejon investime të kapitaleve të huaja në Kinë. E tërë kjo bëhet nën maskën e një politike «marksiste-leniniste» dhe gjoja për të luftuar armikun numër një, Bashkimin Sovjetik, i cili nesër ka mundësi të bëhet edhe miku numër një i saj.

Kina, në fakt, gjithë masat e grevistëve e të të papunëve i lë t'i manipulojnë revizionistët, socialdemokracia, që janë të gjithë në shërbim të kapitalit vendas dhe atij ndërkombëtar. Lëvizjet revolucionare dhe partitë komuniste e punëtoresh marksiste-leniniste Kina as i përkrah dhe as i ndihmon, por i ka ndarë në kategori: ato që flasin mirë për Kinën dhe ndjekin politikën e saj, janë të mira; të tjerat s'janë gjë.

Por tragjedia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare qëndron në faktin që Kinën ajo e ruan dhe nuk flet kundër saj, e mbron edhe kur ajo gabon. Ne shqiptarët hapur nuk e atakojmë, se interesi i përgjithshëm nuk na e do akoma. Por politika jonë e jashtme dhe e brendshme është e hapur, e vendosur dhe në kundërshtim me atë të Kinës, në të gjitha çështjet që përmenda më lart. Kina këtë e di, popujt e botës e dinë, marksistë-leninistët, gjithashtu, e dinë, se gojën ne as e kemi mbyllur dhe as do ta mbyllim. Asgjë, asnjë ndërhyrje apo presion nuk do të lejojme që të cenohet e të shtrembërohet vija e Partisë sonë, e cila njihet botërisht. S'janë të paktë njerëzit dhe ata burra shteti e borgjezë përparimtarë në botë që flasin me shumë simpati për politikën e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Pse e shfaqin ata këtë simpati?

Së pari, sepse ne flasim hapur, me guxim dhe drejt kundër dy fuqive të mëdha, flasim dhe në të njëjtën kohë veprojme. Kjo politikë e drejtë u pëlqen, sepse shumë të tjerë s'e bëjnë dot, mbasi dy superfuqitë ua kanë lidhur duart dhe gojën.

Së dyti, se politika jonë ndaj qeverive borgjeze në fuqi nuk është as liberale, as sektare. Ne dimë të dallojmë cilat qeveri janë përparimtare, cilat jo, dhe të gjithë e kanë kuptuar dhe e shohin se politika jonë mbron në radhë të parë interesat e klasës punëtore dhe të popullit të këtyre vendeve e se nën prizmin e këtyre çështjeve ne i mbështetim ato qeveri ose ata qeveritarë që, në vija të përgjithshme, kanë sadopak kërkesa të tilla në programin e tyre qeveritar.

Së treti, se ata shohin në politikën e guximshme të Partisë sonë një shembull që edhe ata e popujt e tyre, qofshin të vegjël si ne ose të mëdhenj, duan ta ndjekin. Në momente krize e dhune nga ana e dy superfuqive, shumë qeveri ose qeveritarë borgjezë, për të dalë nga dara e hekurt, kujtojnë Shqipërinë dhe marrin zemër nga shembulli i saj.

Kinën si një vend të madh socialist ne e kemi dashur dhe e duam sinqerisht, e kemi mbrojtur dhe do ta mbrojmë në rrugë marksiste-leniniste, por këto gabime të sajat në vijë na hidhërojnë, nuk i pëlqejmë dhe nuk mund t'i pranojmë. Ne duam t'i diskutojmë këto, por kinezët nuk pranojnë. Ata kanë gjetur «rehat» që ne nuk flasim hapur për ta, paçka që botërisht duket se qëndrimet tona s'puqen. Pozita të tilla nuk duhet të ekzistojnë në mes dy partive dhe dy shteteve tona. Po bëhen dy vjet dhe tri herë e kemi përsëritur kërkesën e vajtjes në Pekin të një delegacioni të nivelit të lartë të Partisë dhe të Qeverisë sonë, por kinezët të tri herët e kanë shtyrë, duke bërë veshin e shurdhër. Nga ana tjetër, po

presin të gjithë burrat e shtetit, të çfarëdo kategorie, imperialistë, borgjezë, mbretër e princesha, që nga Fordi e deri te kryeministri revizionist jugosllav, Bijediç. E si mund ta quajmë këtë përbuzje e mospërfillje përveçse shprehje të pikëpamjeve të shtetit të madh që në mes nesh dhe me zë të ulët thotë se «ju kemi miq», por brenda vetes thotë: «Miq që nuk më sillni shporta me fiq», domethënë «nuk mbështetni politikën time ndërkombëtare». S'ka se si ta interpretojmë ndryshe këtë qëndrim jomiqësor të Kinës ndaj Shqipërisë. Por Partia e Punës e Shqipërisë di të mbajë gjakftohtësinë dhe të mos e humbasë durimin.

Shumë kemi vuajtur e shumë vështirësi kemi ndeshur, por i kemi kapërcyer me sukses, se kemi mbrojtur dhe ndjekur marksizëm-leninizmin, kemi qenë të drejtë e të matur, kemi ditur të lidhim ngushtë çështjen tonë nacionale me interesat ndërkombëtarë të punonjësve. Partia e Punës e Shqipërisë e di se forca e saj qëndron në popull, në atdheun e lirë e sovran socialist. Ky faktor është i pari dhe vendimtar. Ndihma ndërkombëtare vjen në radhë të dytë. Gjendjen ndërkombëtare ne e ndjekim me vigjilencë, po kështu ndjekim edhe manovrat e panumërta koniunkturale të shteteve të ndryshme në botë dhe përpiqemi të nxjerrim mësimë dhe konkluzione të drejta që të na shërbejnë në politikën e shtetit tonë. Por politika e shtetit tonë nuk mund as të bazohet, as të lëkundet sipas këtyre koniunkturave. Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ka në bazë një strategji dhe taktikë të saj, të bazuar në teorinë marksiste-leniniste, të zbatuar në kushtet e vendit dhe në ato ndërkombëtare. Shumë që hiqen se janë marksistë, por s'janë të tillë, mund ta thonë këtë formulë, por marksizmi duhet zbatuar në mënyrë korrekte. Për ne koniunkturat janë në politikë diçka anësore, jo e qëndrueshme, ku nuk mund të mbështetesh. Sot, synimi i një politike koniunkturale mund

të ketë një drejtim, nga i cili taktikisht mund të përfi-
tosh, po të dish ta shfrytëzosh; kurse nesër ajo ndërron
krejt drejtim, në disfavorin tënd. Pra, politika e Partisë
dhe e vendit tënd nuk duhet futur në labirintin e errët
e me kurthe që ngrenë shtetet kapitaliste, borgjeze dhe
revizioniste.

E MARTË

7 TETOR 1975*

KINA DHE JUGOSLLAVIA

Udhëheqjet e këtyre dy shteteve kanë rënë në «da-
shuri»! Njohje dhe simpati e vjetër. Kinezëve dhe vetë
Maos u ka pasë pëlqyer shumë lufta që ka zhvilluar Ti-
toja kundër Stalinit, ata e kanë brohoritur këtë luftë dhe
e kanë quajtur të drejtë. Nga goja e Maos dolën fjalët:
«Titoja nuk ka gabuar, por ka gabuar Stalini». Që Maoja
e ka thënë këtë është plotësisht e vërtetë, jo vetëm pse
na e ka thënë neve, por sepse ende edhe sot Çu En Lai,
Gën Biaoja e të tjerë po propagandojnë kundër Stalinit.
«Po, — thonë kinezët (për galerinë), — Stalini është njeri
i madh, por ka bërë gabime». Çfarë gabimesh ka bërë?
«Nuk e kishte parë drejt çështjen e Kinës»; «edhe çësht-
jen e Titos nuk e kishte parë drejt», «edhe të Bashkimit
Sovjetik», «edhe të komunizmit ndërkombëtar» etj.

Atëherë kur paska bërë këto gabime, siç thonë kine-
zët, pse shprehen këta se «Stalini ishte një marksist-leni-
nist i madh»? Po Hrushovi kush ishte, që kinezët tash e
futin në gjirize? «Lenini i kohërave tona» ka pasë thënë
Maoja në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957. Vlerësim
«gjenial» për tradhtarin nga ana e Maos!

Qëndrim joparimor kinezët kanë mbajtur edhe ndaj
Titos e titizmit. Në rast se në vijën kineze shohim zigza-
ge të theksuara mbi përcaktimin politik dhe ideologjik
të veprimtarisë revizioniste të Titos dhe të titizmit, kjo
buron nga politika oportuniste e kinezëve. Duhej folur

mirë për Titon, sepse e tillë ishte bindja e tyre, por duhej bërë edhe «demaskimi» se e demaskonin edhe të tjerë, deri edhe Hrushovi lëshonte ndonjë gur kundër tij. Erdhi koha që kinezët e pushuan polemikën kundër Titos dhe filloi afrimi politik e ideologjik *de facto* (ndonëse lidhje ideologjike dhe partie, në dukje, akoma nuk mbajnë).

Kur Kina zuri pozitën proamerikane dhe antisovjetike, kjo politikë u shfaq në të gjitha marrëdhëniet e saj me botën e jashtme. Amerika imperialiste, fashistët Pinoçeti dhe Franko, Titoja dhe Çausheku, renegatë dhe aventurierë, revanshistë gjermanë dhe fashistë italianë janë miqtë e saj. Për Kinën s'ka rëndësi ideologjia. Asgjë nuk shikohet prej saj me syrin klasor, asgjë nuk shikohet në prizmin e revolucionit botëror dhe të çlirimit të popujve! Sipas udhëheqjes kineze, për Kinën dhe për botën ekziston vetëm një armik — socialimperializmi sovjetik. Fakt i hidhur, tragjik, që harrojnë armikun tjetër, imperializmin amerikan.

Taktika kineze, antimarksiste, është: aleancë me gjithë reaksionin botëror, deri edhe me fashistët e deklaruar e me patentë, por që janë kundër sovjetikëve. Kjo jo vetëm është antimarksiste, por tregon se analizat e zhvillimit të çështjeve botërore bëhen prej tyre në mënyrë aq të gabuar dhe aq të marrë sa të habit. Çdo veprim politik i kinezëve çon ujë në mullirin e imperializmit dhe të reaksionit botëror.

Kinezët kujtojnë (dhe s'ka si interpretohen ndryshe veprimet e tyre) se gjithë bota është e bindur dhe mendon se Kina është e kuqe, revolucionare. Kjo politikë që bën Kina, ka një qëllim «revolucionar»: të bashkojë «botën e tretë», «botën e dytë» dhe imperializmin amerikan kundër socialimperialistëve sovjetikë. Dhe nga veprimet e tyre del se për ta bërë e për ta arritur këtë «ideal», nuk duhet shikuar shumë në parimet. «Shtetet e Bashkuara të Amerikës i mbrojmë tani, — justifikohen kinezët, —

sepse janë më të dobëta nga Bashkimi Sovjetik, por me këtë ne duhet të thellojmë edhe kontradiktat në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Idera gjeniale!! Bota ecka ashtu siç do Kina!! Rrotullimi i tokës, politika e kontinenteve me popujt dhe me shtetet e tyre u bëkan ashtu siç do Kina!! Ç'marrëzira! Gjithë reaksioni botëror, me përjashtim të reaksionit sovjetik, e shtyn Kinën në këtë rrugë të gabuar dhe e duartroket. Dhe udhëheqja kineze fryhet si gjeldeti, por, gjoja, si një gjel... modest.

Duke u larguar nga një politikë klasore dhe parimore marksiste-leniniste, është e natyrshme që Kina të bazohet në koniunkturën politike, në dredhitë dhe në intrigat e qeverive reaksionare.

Le të vijmë te miqësia kinezo-jugosllave. Kjo është tash reale, por do të pësojë disfatë, në rast se kinezët do të shohin tendencën prosovjetike në politikën jugosllave. Siç e dimë, politika e Titos, në thelb, është antisovjetike dhe proamerikane. Por Titoja dredhon; kurdoherë ai ka dredhuar dhe është treguar një aventurier akrobat. Titoja bën një politikë antipopullore, antisocialiste, pra antimarksiste dhe ka zënë pozitën e «liderit» të bllokut pa kuptim të «të paangazhuarve». Në të vërtetë Titoja bën politikën e këtyre shteteve, që në fakt janë të lidhura me superfuqitë, pavarësisht se nuk bëjnë pjesë në traktatet dhe në paktet e tyre ushtarake.

Titoja bie dhe shpie, merr çeqe e favore nga të gjithë. Ai e robëroi Jugosllavinë, krijoi atje shtresën e pasanikëve të rinj, ai rron si një mbret, hiqet vetë dhe e mbajnë si një «kokë politike të madhe». Të gjithë nuk i hanë dokrrat e Titos, por, kur u duhet ta përdorin, e pompojnë dhe, kur s'u vlen më, e hedhin e do ta hedhin tej si limon të shtrydhur.

Sovjetikët, s'ka asnjë dyshim, duan ta kenë nën zgjedhën e tyre Jugosllavinë dhe për këtë përdorin çdo mjet,

çdo politikë, çdo konspiracion, çdo manovër; e përkëdhe-
lin Titon, shkruajnë e flasin mirë për të, i premtojnë e i
japin kredi. Titoja, si një dhëlpër plakë, u avitet dhe u
buzëqesh. Kur s'ia arrijnë dot plotësisht qëllimit, sovje-
tikët i shtrëngojnë dhëmbët. Titoja merr atëherë pozën
e maces, që mpreh thonjtë dhe ngre mustaqet kundër so-
vjetikëve, por në të vërtetë bën mjau në drejtim të ame-
rikanëve.

E tillë është politika titiste, e cila u pëlqen shumë
kinezëve. Pse? E para, se ata janë në një mendje me Ti-
ton; e dyta, se ky në thelb është proamerikan dhe anti-
sovjetik, dhe e treta, se kinezëve u duhet ta shtojnë mi-
qësinë me Titon që «të thellojnë kontradiktat në mes
Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik». Taktikë gjeniale!!

Xhemal Bijediçi, kryeministri jugosllav, arriti dje
në Pekin, ku u prit «me dashuri, me ngrohtësi», me po-
pull, me gonge, me pllakata e me parulla. Me siguri që
atë do ta presë edhe Maoja. Kryeartikulli i «Zhenminzhi-
baos» i bënte hosana «Barabait» dhe Jugosllavisë titiste.
Për të maskuar lojën, nuk e përdorte termin «Jugoslla-
via socialiste», por, duke theksuar sukseset e mëdha eko-
nomike dhe qëndrimet e udhëheqjes jugosllave kundër ka-
pitalizmit, imperializmit, hegjemonizmit, nënkuptohej fare
qartë ky emërtim. Pra, sipas kinezëve, titizmi është në
një pozitë «politike progresiste» me Kinën.

Kina e ka futur veten në «botën e tretë», kurse Ti-
toja është në «botën e të paangazhuarve». Në mes tyre
është edhe Rumania, sepse është gjoja antisovjetike.
Kjo, duke qenë e angazhuar, hiqet si «e paangazhuar» edhe
nga kinezët, edhe nga Titoja, edhe nga sovjetikët. **Dife-
renca e «botës së tretë» me «botën e të paangazhuarve»,
është si ndryshimi që ka veja nga kokoveja.**

Në artikullin në fjalë të «Zhenminzhibaos» tirret ana-
liza e famshme «Imperializmi sovjetik kërcënon me luftë
dhe me agresion Evropën dhe veçanërisht Ballkanin».

Kinezët bëjnë «thirrjen»: «Evropë dhe Ballkan, jeni në
rrezik iminent, prandaj bashkohuni me njëri-tjetrin, lini
grindjet dhe çfarëdo divergjence që keni, mbështetuni te
Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te NATO-ja, te Tregu
i Përbashkët Evropian. Ju, vende të Ballkanit, jeni në
gojën e ujkut, prandaj bashkohuni me Jugosllavinë me
Titon në krye». Me fjalë të tjera, na thonë neve shqip-
tarëve: «Ju goboheni që s'keni besim, siç kemi ne, te
Jugosllavia e Titos, te Rumania e Çausheikut, te Greqia
e kolonelëve, te Turqia e Demirelëve, e pse jo, edhe te
Bullgaria e Zhivkos. Ju, shqiptarë, s'bëni mirë që nuk
merrni pjesë në këtë valle ballkanike». Kinezët me këto
qëndrime që mbajnë duan të na thonë: «Ç'ju duhet juve
shqiptarëve të shihni thelbin e çështjeve, shihni dhe kë-
naquni me tabelën e dyqanit».

Atasheu ushtarak kinez në Beograd i tha një diplo-
matit tonë se «delegacioni kinez u prit përzemërsisht nga
ushtarakët jugosllavë»; këta «u treguan çdo gjë», u folën
«haptazi dhe sinqerisht», «u treguan dhe armatime» etj.
**Atasheu ushtarak kinez do që të na mbushë mendjen se
ujku qenka bërë qengj, por harron se ujku kurdoherë
ujk mbetet, bile ka edhe raste, si në romanet e Xhek
Londonit, që edhe qeni kthehet në ujk.**

Ndërsa shtyjnë datën e vizitës së delegacionit tonë
për më tepër se dy vjet, kinezët presin kryeministrin
jugosllav Bijediçi. Me këtë qëndrim ata duan të na thonë:
«Nuk duam t'ju pranojmë, se kemi kontradikta politiko-
ideologjike me ju, kurse me jugosllavët (dhe faktet e
tregojnë këtë me vizitën e Bijediçit) ne kinezët nuk kemi
asnjë kontradiktë».

Natyrisht, revizionistëve sovjetikë dhe këlyshëve të
tyre nuk u pëlqen vajtja e Xhemal Bijediçit në Kinë dhe,
duke e ditur këtë, Ten Hsiao Pini, në darkën që dha,
bëri aluzion si ngaherë «për një superfuqi që do luftën»
apo diçka të tillë. Atëherë sovjetikët dhe miqtë e tyre

u ngritën nga salla dhe ikën. Kinezët mendojnë se me këtë i thelluan kontradiktat. Po ata gobohen. Punët i ndreq Titoja nga ana tjetër. **Vetëm ti, kinez, rro me iluzione, plotëso kërkesat materiale të jugosllavëve dhe vazhdo rrugën që po ndjek, pa sa ka parë të tilla lodra Titoja, nuk numërohen! Titoja është mjeshtër i të tilla fokuseve.**

E PREMTE
10 TETOR 1975*

MAO CE DUNI PRET XHEMAL BIJEDIÇIN

Bijediçi u prit me ngrohtësi në Kinë. Ten Hsiao Pini lavdëroi Titon për «qëndrimin burrëror kundër brutalitetit», që më shqip do të thotë kundër Stalinit. Turp për kinezët që mburrin gjestin armiqësor të Titos kundër një marksist-leninisti të madh, siç është Stalini! Por, sipas kinezëve, është Stalini ai që ka gabuar dhe jo Titoja.

Bijediçin e priti ngrohtësisht edhe Mao Ce Duni. Gjithë kësaj dandanaje ne i kushtuam në shtyp vetëm «një radhë», pra vetëm një radhë dhe asgjë tjetër. Këtë e bëmë për t'u dhënë kinezëve të kuptonin se ne nuk jemi dakord me ta, jo pse vajti Bijediçi në Kinë, por se kërkesën që ua kemi paraqitur tri herë me radhë për të shkuar delegacioni ynë, duke e lënë në heshtje, s'e kanë pranuar.

Kinezët janë edhe marifetçinj. Në pritjen e koreanëve për 30-vjetorin e Partisë së Punës të Koresë, Ten Hsiao Pini dhe gjithë suita e tij, në mënyrë demonstrative, shkuan dhe i shtrënguan dorën vetëm ambasadorit tonë. Këtë e bënë për të na thënë neve dhe të pranishmëve se «vërtet me jugosllavët ne bisedojmë, por me shqiptarët jemi miq të ngushtë».

NGRIHET MË LART AUTORITETI I VENDIT TONË

Shokët më njoftuan se fjalimi që mbajti delegacioni ynë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju-Jork, si ngahera ka pasur sukses, është pëlqyer nga shumë delegacione. Më shumë se herë të tjera shkuan e uruan deri dhe delegacioni i Indisë. Autoriteti i vendit tonë ngrihet, për arsye të qëndrimeve tona të drejta, të hapëta, pa frikë dhe të ndershme. Të gjithëve u pëlqejnë qëndrimet tona, pavarësisht se ata që na e shprehin këtë janë përfaqësues të borgjezisë liberale, pse ato që themi ne kundër superfuqive duan t'i shprehin edhe ata, por nuk mundin dot. Sidomos, nga vendet e Amerikës Latine duket një dashamirësi më e madhe ndaj vendit tonë dhe politikës së tij të pavarur.

SHËNIM

Prita sot ambasadorin e RP të Kinës në vendin tonë¹.

¹ Liu Xhen Hua. (Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 603.)

**NË SHFAQJEN E ANSAMBLIT ARTISTIK
TË KËNGËVE E VALLEVE «LIAONIN»
TË RP TË KINËS**

Shkova sonte në Teatrin e Operës e të Baletit për të parë shfaqjen që dha ansambli artistik i këngëve e valleve «Liaonin» i RP të Kinës, i cili ndodhet për turne në vendin tonë.

Në pushimin pas pjesës së parë të shfaqjes, takova kryetarin e ansamblit dhe një grup artistësh.

MAO CE DUNI PRET HELMUT SHMIDIN

Përveç zgjerimit dhe forcimit të marrëdhënieve me imperializmin amerikan e militarizmin japonez, udhëheqësit kinezë po i forcojnë lidhjet e tyre edhe me militaristët gjermanoperëndimorë. Agjencia HSINHUA njoftoi se Mao Ce Duni priti dje pasdite kancelarin e RF të Gjermanisë, Helmut Shmidin, dhe grupin që e shoqëron atë dhe pati me ta një «bisedë të gjerë, e cila kaloi në një atmosferë miqësore». Kjo është tekstualisht kështu.

Në këto bisedime, si gjithnjë, ndodhej i pranishëm edhe Ten Hsiao Pini, zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit.

GREKËT DUHET TA DINË SE NE NUK FLEMË

Erdhi më vizitoi shoku Hysni dhe më mori mendimin që t'i bëhet një protestë me gojë ambasadorit grek në Tiranë për veprimet e ndryshme propagandistike të shovinistëve grekë në Greqi, në lidhje me të ashtuquajturin Vorio-Epir. Jo vetëm gazetat shoviniste, por në Selanik po parakalojnë kuadrate «ushtarakësh vorioepirotë» përpara presidentit të republikës, Cacos, dhe ministrit të Mbrojtjes, Averof e të tjerë. Unë isha dakord që t'ua vëmë këtë në dukje grekëve dhe t'u kujtojmë se nuk flemë dhe janë ata që po i prishin këto situata «të qeta», që ne krijuam.

KATËR YJE QË NUK DO TË SHUHEN KURRË NË TOKËN SHQIPTARE

Shtatë dhe Tetë Nëntori, data e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe data e themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, janë dy data historike që janë rrënjësor thellë në zemrat, në mendjen dhe në gjithë jetën e popullit shqiptar. Të tilla janë edhe datat e 28 dhe 29 Nëntorit. Pra katër data të shënuara, të lavdishme për popullin dhe për komunistët shqiptarë në muajin e nëntorit 7, 8, 28 dhe 29 Nëntori, 4 yje, katër diej të zjarrtë, që nuk do të shuhet kurrë dhe do të na ndritin rrugën drejt socializmit dhe komunizmit.

Revolucioni i Madh i Tetorit, që udhëhoqi i madhi Lenin në bazë të teorisë së Marksit dhe të Engelsit, u bë pishtar i madh për proletariatin botëror, për gjithë popujt e shtypur të botës dhe i ndriçoi njerëzimit rrugën e së ardhmes, socializmin dhe komunizmin. Në një të gjashtë të botës u dërrmua kapitalizmi, u ngrit pushteti i punëtorëve, diktatura e proletariatit. Lindi, u themelua Bashkimi Sovjetik, vepër e teorisë së pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe mori këtë emër, pse i pari ishte Lenini dhe gjenialiteti i tij që vuri në zbatim si duhet mendimet dhe mësimet gjeniale të Marksit nëpërmjet revolucionit të madh të bolshevikëve, ku udhëhiqte Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik.

Revolucioni i Madh i Tetorit ngriti gjithë popujt e

botës në këmbë për ta mbrojtur këtë revolucion dhe pjellën e tij, Bashkimin Sovjetik. Vështirësi kolosale u kapërcyen nga bolshevikët nën udhëheqjen e Leninit dhe më vonë nën udhëheqjen e nxënësit të tij besnik, Stalinit. Valët e tërbuara të njëpasnjëshme të kapitalistëve, të imperialistëve, të fashistëve goditnin kalanë e proletarëve, zemrën e proletariatit botëror, por të gjitha thyheshin njëra pas tjetrës. Partia Bolshevike dhe Bashkimi Sovjetik po ndriçonin rrugën e popujve dhe të komunistëve.

Kapitali ndërkombëtar u fut në krizë të rëndë, proletariati botëror po luftonte, u krijuan kudo partitë komuniste dhe punëtore që udhëhiqnin popujt, proletarët dhe patriotët në luftë për çlirim ekonomik, politik, shoqëror.

Borgjezia reaksionare, socialdemokracia, imperializmi botëror, në pamundësi të shuanin valën e revolucionit që ngrihej dhe duke mos mundur dot të gënjenin dhe të shtypnin me metodat false të demokracisë së tyre borgjeze, përgatitën Luftën e Dytë Botërore, mëkëmbën dhe forcuan fashizmin në Itali, në Gjermani e gjetkë, po ashtu armatosën militarizmin japonez.

Kasaphana e dytë imperialiste filloi, Hitleri sulmoi, mundi e pushtoi të gjitha vendet perëndimore dhe lindore, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik dhe të Britanisë së Madhe. Hitleri sulmoi edhe Bashkimin Sovjetik dhe që atë ditë Lufta e Dytë Botërore mori karakter çlirimtar. Bashkimi Sovjetik u dha zemër dhe forcë popujve të shtypur që luftonin dhe Ushtria e Kuqe, e udhëhequr nga Stalini i madh, e ndihmuar nga lufta e popujve të tjerë, në mes të të cilëve edhe e popullit shqiptar që luftoi heroikisht, bëri që të thyheshin fashistët italianë, nazistët gjermanë dhe militaristët japonezë. Bota mori frymë, socializmi fitoi në shumë vende në Evropë dhe në Azi e në mes tyre edhe Shqipëria.

Partia Komuniste e Shqipërisë, që u themelua më

8 Nëntor 1941, pikërisht një ditë pas asaj që shënon fitoren e Revolucionit të Tetorit, e udhëhoqi popullin në fitoren e madhe të çlirimit të atdheut, të vendosjes së diktaturës së proletariatit dhe të ndërtimit të socializmit. Partia e Punës e Shqipërisë ndoqi me besnikëri marksizëm-leninizmin, luftoi dhe lufton me konsekuencë në këtë rrugë, prandaj vendi ynë përparon dhe qëndron i patundur si kështjellë e socializmit shkencor në Evropë dhe në botë dhe kjo i detyrohet Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë.

Revolucioni i Madh i Tetorit, ideologjia marksiste-leniniste, Bashkimi Sovjetik, vepra e Leninit dhe e Stalinit, pas vdekjes së këtij të fundit u tradhtuan në Bashkimin Sovjetik, në shumë vende të demokracisë popullore dhe nga shumë parti komuniste e punëtore të botës. Kundërrevolucionit triumfoi në to për shkak të tradhtisë së hrushovianëve dhe të revizionistëve modernë, si Titoja, Toliati, Ulbrihti, Pasionarja e shumë shokë të tyre renegatë dhe tradhtarë.

Partia jonë u ngrit si një heroinë e papërkultur, i goditi dhe po i godet pa mëshirë renegatët e tradhtarët revizionistë, kudo ku janë e nën çdo maskë qofshin. Partia e Punës e Shqipërisë është bërë simboli i madh i mbrojtjes së teorisë marksiste-leniniste, i pastërtisë së saj, i zbatimit korrekt të saj. Partia e Punës e Shqipërisë ndjek e zbaton me besnikëri mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, në mes të një oqeani armiqsh me valë të tërbuara.

Partia e Punës e Shqipërisë fiton mbi të gjithë këta armiq dhe u tregon qartë popujve dhe proletarëve të botës se idetë e Marksit e të Leninit janë universale, të pamposhtshme, kurdoherë fitimtare. Një Shqipëri e vogël socialiste po u bën ballë një morie armiqsh të mëdhenj e të fortë dhe fiton mbi ta në çdo betejë.

Partia e Punës e Shqipërisë është bërë një shembull

dhe një përkrahëse e vendosur e të gjitha partive komuniste e punëtore marksiste-leniniste që janë formuar rishitas në botë. Revolucioni vazhdon, ai udhëhiqet dhe do të udhëhiqet në fitore të plotë nga marksizëm-leninizmi. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Shqipëria socialiste janë dhe do të mbeten në shekuj një detashment i çeliktë i këtij revolucioni proletar botëror.

E SHTUNË
8 NËNTOR 1975

ASNJËHERË TË MOS HARROJMË RREZIKUN E ARMIQVE FQINJ

Populli dhe Partia jonë të mos harrojnë asnjëherë dhe për asnjë çast rreziqet e përhershme të fashizmit dhe të neofashizmit italian; të shovinizmit dhe të neofashizmit grek; të serbomëdhenjve, shovinistëve-titistë jugosllavë. Këta armiq janë rreth kufijve tanë. Secili prej tyre kërkon ta ketë nën dominimin e tij atdheun tonë, kërkojnë ta ndajnë në zona influence, ose ta copëtojnë. Këto kanë qenë dhe mbeten kurdoherë synimet e tyre. Prapa këtyre armiqve qëndrojnë dy superfuqitë, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kanë edhe synimet e tyre të drejtpërdrejta ndaj vendit tonë, por edhe tërthorazi, sipas rrethanave, duke ndihmuar fqinjët tanë në synimet e tyre.

Prandaj vazhdimisht duhet rritur vigjilenca dhe kjo bëhet me një ngritje politiko-ideologjike, domethënë duke kuptuar natyrën agresive të imperializmit, të social-imperializmit, të borgjezisë shoviniste dhe reaksionare. Përveç kësaj, populli dhe Partia duhet të ndjekin politikën e këtyre agresorëve, të kuptojnë taktikat dhe strategjinë e tyre për problemet botërore, ku implikohet edhe problemi i shtetit tonë socialist.

Koniunkturat politike në botë populli dhe Partia duhet t'i studiojnë dhe t'i kuptojnë drejt dhe, që të bëhet kjo, ato duhet të shikohen nën prizmin e luftës së kla-

save brenda dhe jashtë vendit. Ekzistojnë kontradikta në mes fqinjëve tanë për çështjen e Shqipërisë. Gjithsecili lakmon për vete dhe këndej linden kontradiktat. Nga këto kontradikta duhet të përfitojmë, por pa u vënë në gjumë nga një politikë e përkohshme dhe e kufizuar e fqinjësisë së mirë. Ne e duam këtë fqinjësi të mirë në bazë të parimeve të mosndërhyrjes në punët e brendshme etj., por shtetet fqinje këtë e kanë një flluskë sapuni.

Greqia hiqet sikur do dhe praktikon me ne një fqinjësi të mirë, por ky është një bluf. Si në kohën e kolonëve, edhe tani po parakalojnë të ashtuquajturit vorioepirotë dhe përpara presidentit Cacos, ministrave Averof, Ralis e të tjerë gërthasin në rrugë, në sheshe, në radio e në televizion për «Vorio-Epirin e tyre», «për Korçën dhe për Gjirokastrën e tyre». Ne, natyrisht, protestuam, u dhamë një përgjigje çakejve grekë. Grekët dëshatuan në Qipro dhe, për të mbuluar këtë disfatë, kanë lëshuar qentë kundër nesh, por ne ua thyejmë dhëmbët. Prandaj kurrë populli dhe Partia nuk duhet të kenë as fijen e iluzionit se ujku bëhet dele. Duhet barutin ta mbajmë të thatë dhe pushkën ta bëjmë top.

Kështu janë edhe Titoja me titistët. Regjimi i tyre i vetadministrimit falimento plotësisht, falimento politika dhe ideologjia revizioniste. Në Jugosllavi kudo mbretërojnë kaosi, vjedhjet, degjenerimi; vendi dhe ekonomia janë në duart e kapitalit të huaj dhe të borgjezisë reaksionare kompradore vendase. Pra, populli jugosllav e urren këtë regjim, urren Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, ai urren Titon dhe tradhtinë. Titoja lllomotit, por mbaroi, e pret varri. Ky regjim i kalbur solli përçarjen nacionale, ngriti popullin dhe punëtorët kundër borgjezisë së re dhe krijoi terrenin për organizimin e rezistencës. Në këtë mes edhe marksistë-leninistët e vërtetë me siguri organizohen, edhe rankoviçianët dhe ustashët, serbomëdhenjtë dhe agjentët e sovjetikëve në CIA-n ju-

gosllave. Një lëmsh. Titoja pseudodemokracinë e ka kthyer në një diktaturë fashiste dhe goditjeve u jep këtë ngjyrë: sovjetikët janë ata që organizojnë diversione. Kjo është e vërtetë, por është edhe i gjithë populli që nuk nënshtrohet. Titistët s'harrojnë të ngrënë edhe çështjen e «irredentizmit shqiptaromadh». Kjo ngrihet kundër shqiptarëve të Kosovës për t'i shtypur, siç kanë bërë përherë, por edhe kundër nesh, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, që e kanë halë në sy dhe që për të fshehur poshtërsitë e tyre sulmojnë tërthorazi edhe Shqipërinë socialiste, edhe shqiptarët.

Prandaj asnjëherë populli dhe Partia të mos harrojnë armiqësinë dhe rrezikun që na vjen nga qeveritarët armiq jugosllavë me çdo maskë që të paraqiten. Sa për shqiptarët e Kosovës ne ata do t'i mbrojmë në rrugën marksiste-leniniste, por u përket atyre t'i vënë gishtin kokës, të izolojnë tradhtinë dhe tradhtarët dhe të mbrohen nga titizmi, nga serbomëdhenjtë e të tjerë, që janë armiq të e tyre shekullorë.

Për sa i përket Italisë fashiste e neofashiste ajo ka qenë dhe mbetet agresore për Republikën Popullore të Shqipërisë. Topat duhet t'i kemi çdo minutë në gatishmëri dhe ngritur.

E HËNË

10 NËNTOR 1975*

NE JEMI TË SHQETËSUAR SE Ç'DO TË NGJASË NË KINË PAS VDEKJES SË MAOS

Lajmet që na vijnë prej shokëve tanë nga Pekini, janë shqetësuese, veçanërisht për shëndetin e Çu En Lait, por edhe për pleqërinë e rëndë të Mao Ce Dunit.

Siç na thuhet nga shokët kinezë, e këtë e vërteton edhe shtypi zyrtar i tyre, Çu En Lai është në spital. Nga se vuan, nuk thonë. Ndonjë nga agjencitë e huaja të lajmeve thotë nga kanceri (pra nga një sëmundje e pashërueshme), disa të tjera thonë nga zemra. Për një periudhë ai priste të huaj dhe miq në spital. Edhe delegacionin tonë, me shokun Adil, ai e priti 15 minuta dhe tha se do të bëhej operacion e nuk dihet si do të dilte, për të mirë a për të keq.

Tash ka një kohë që nuk pret as në spital. Li Hsien Nieni një shokut tonë, që e pyeti për shëndetin e Çu En Lait, iu përgjigj duke i thënë: «Është sëmurë» dhe me mimikë i la të kuptojë se nuk ka shpresë shërimi.

Sa për Maon nuk flitet për sëmundje, por për pleqëri; ai «nuk ecën dot, ose ecën me zor, nuk flet dot, ose flet shumë pak, rri shumë i kërrusur dhe me gojë hapët». Por, gjatë kohës që Çu En Lai është sëmurë, Maoja pret e përcjell njerëz të huaj, del me ta në televizion, u shtrëngon fort duart, ua tund etj. E kemi parë Maon edhe në televizionin italian. Por askush nuk na thotë gjë për gjendjen e tij. Ne pyesim, natyrisht, se na

shqetëson gjendja e tij, por ata që pyesim na thonë se mbahet mirë. Atë dëshirojmë edhe ne. Ajo që na shqetëson është: Në ç'gjendje po e lë partinë Maoja?! Ç'do të ngjasë në Kinë pas vdekjes së tij?

Ne dimë se lufta kundër fraksioneve dhe fraksionistëve, kundër «deviatorëve», «oportunistëve, liberalëve dhe sektarëve» jo vetëm është bërë me zigzage, por, pa bërë dallim, është përdorur metoda «e edukimit» dhe gjithë këta njerëz pas një kohe janë «riedukuar», janë «rehabilituar». Pra, ç'bëjnë tani këta njerëz dhe çfarë do të bëjnë ata kur të vdesë Maoja, natyrisht, ne s'dimë gjë, por kemi bindjen se të qetë nuk do të rrinë, se as janë riedukuar dhe as janë ndrequr.

Nga sa po duket, Ten Hsiao Pini kryen funksionet e Kryetarit të Këshillit të Shtetit. Tash ai flet në emër të Çusë se Maoja është në këmbë. Por pas Maos Teni mund të flasë edhe në emër të tij. Person tjetër «i përgatitur» nga Çuja është Li Hsien Nieni që, për mendimin tonë, nuk është njeri i shëndoshë. Ky po merr tani frenat në dhëmbë.

Në Byronë Politike ka edhe shokë të tjerë të rinj. Kjo është e vërtetë, por këta nuk po duken ose duken pak. Dy të parët që përmenda, zënë vendin e parë në skenë. Ç'kurs do të mbajë Partia Komuniste e Kinës dhe shteti kinez pas vdekjes së Maos, nuk mund ta themi me përpikëri. Do të shohim dhe do të gjykojmë nga qëndrimet që do të mbahen në politikën e brendshme dhe të jashtme. Siç kemi bërë kurdoherë, ne do të prononcohemi vetëm në bazë të fakteve dhe duke i shikuar këto nëpërmjet një analize marksiste-leniniste.

E PREMTE

14 NËNTOR 1975

MAO CE DUNI PRET U NE VININ

Ndërsa në Birmani Partia Komuniste e Birmanisë ndodhet në gjendje ilegaliteti të rëndë dhe komunistët persekutohen, terrorizohen e vriten egërsisht, presidenti i Birmanisë, U Ne Vin, ndodhet për vizitë zyrtare në Kinë.

Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi se kryetari i PK të Kinës, Mao Ce Duni, priti dje dhe «zhvilloi një bisedë të përzemërt e miqësore» me të.

E MËRKURË

19 NËNTOR 1975*

KINA E VIETNAMI JANË ZEMËRUAR ME NJËRI-TJETRIN PËR ÇËSHTJE KUFITARE

Kina, përveç të tjerave, është zemëruar me vietnamezët për çështjen e disa ishujve që «Vietnami i Veriut i ka pushtuar». Kina pretendon se këta i përkasin asaj dhe duhet t'i kthehen; me një fjalë nxjerr «tapitë» e vjetra, vë në lëvizje gjeografë dhe historianë për të vërtetuar tezat e saj. Vietnami hesht, qëndron në ishuj, pse thuhet që atje ka naftë. Kjo ndodh kur Kina na thotë neve: «S'mund t'ju jap kredi sa kërkoni, se ndihmoj Vietnamin».

Ç'THONË SOT, NUK THONË NESËR

Ambasadorët kinezë, kudo që janë, trumbetojnë se Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Evropën Perëndimore, se lufta është te dera, prandaj «ne (kinezët) jemi me ju, viktima (shtetet kapitaliste perëndimore), jemi me «Evropën e Bashkuar», me Tregun e Përbashkët Evropian dhe me NATO-n».

Ambasadorët kinezë ç'thonë sot, nuk thonë nesër. Thonë se «Bashkimi Sovjetik po rrethon Evropën, pastaj mund të sulmojë. Tash përpiqet të ndërhyjë, ose të bëjë subversion në Ballkan, në Portugali e në Spanjë dhe kë-shtu t'i zërë frymën Evropës».

Të shohim versionet e reja që do të na nxjerrin.

PËRSE ÇIRREN TITISTËT

Titoja dhe shokët e tij po mbajnë çdo ditë fjalime kundër «stalinistëve», «informbyroistëve», «ustashëve» etj. Ata kritikojnë Lidhjen dhe shumë anëtarë të saj «që flenë, që janë indiferentë, që shohin, por nuk reagojnë, ose ndihmojnë armiqtë e jashtëm e të brendshëm». U bëjnë thirrje «të ngrihen, të reagojnë, të jenë vigjilentë».

Qolet e tyre në Kosovë kanë shpallur edhe ata luftën kundër «irredentizmit shqiptaromadh». Titoja e paraqet të gjithë këtë si punë të përgatitur nga jashtë dhe, pa e përmendur, nga Bashkimi Sovjetik dhe nga satelitët e tij. Kjo është e mundshme, Bashkimi Sovjetik organizon diversionin, se ka gjetur fushë. Dhe këtë fushë e ka krijuar Titoja dhe vetadministrimi, i cili ka falimentuar dhe ka shkaktuar krizën e regjimit titist.

Populli jugosllav e urren këtë regjim për kaq të këqija që i ka bërë dhe e lufton me çdo mjet, por jo në bashkëpunim me demagogët dhe me vjedhësit titistë. Në këtë luftë antititiste të gjithë punojnë, organizohen edhe agjentët e sovjetikëve, të amerikanëve etj., por edhe komunistët e vërtetë, të cilët duhet të jenë në ilegalitet të rëndë. Që të gjithë kundërshtarët Titoja i quan «stalinistë», «informbyroistë», duke menduar të gënjejë dhe të frikësojë. Po ngjet e kundërta, popujt jugosllavë shohin tash qartë se Stalini dhe informbyroistët kishin shumë të drejtë dhe çdo gjë që thanë ata e vërtetoi koha.

FORDI U PRIT NGA MAO CE DUNI

Xherald Fordi në Pekin. E priti dhe bisedoi dy orë me të edhe Mao Ce Duni.

Në aeroport presidentin amerikan e priti Ten Hsiao Pini me suitën e tij. Me Tenin u zhvilluan bisedimet. Ky dha banketin dhe mbajti fjalimin. Edhe Fordi iu përgjigj me një fjalim.

Fjalimi i Ten Hsiao Pinit në esencë ishte ky:

«Bota është e turbullt, lufta po përgatitet dhe po troket në derë, gjendja është e shkëlqyeshme! Bashkimi Sovjetik përgatitet për luftë dhe kërcënon Evropën. Bashkimi Sovjetik lufton për hegjemoni botërore. Ju, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe ne, Kina, siç e kemi theksuar në Komunikatën e Shangait, nuk jemi për hegjemoni. Prandaj ju (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), ne (Kina) dhe bota e tretë të bashkohemi në një aleancë dhe t'i dërrmojmë brinjët Bashkimit Sovjetik. Ne kinezët nuk gënjehemi nga «ulja e tensionit», që predikojnë sovjetikët, prandaj edhe ju amerikanët, mos u gënjeni nga sovjetikët». U përdor edhe formula e tyre «bota do çlirim, bota do revolucion» etj.

Ky është thelbi i fjalimit të Tenit, të cilit presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës iu përgjigj me një fjalim të shkurtër: «Ne do të armatosemi, se kështu sigurohet paqja; ne do të bëjmë çmos që të ulet dhe jo të

ngrihet tensioni; ne kemi interesat tanë dhe politika jonë do t'i mbrojë ata dhe paqen e njerëzimit» etj.

Ne e dimë mirë kush është Fordi, dimë, gjithashtu, cili është imperializmi amerikan dhe cilët janë objektivat e tij. Por, duhet të analizojmë fjalimin e Ten Hsiao Pinit, që shpreh vijën themelore të politikës së Kinës dhe të Maos.

Në kohën kur Liu Shao Çia ishte në fuqi dhe Teni në atë kohë ishte sekretar i përgjithshëm i partisë, u hodh parulla e famshme: «Aleancë me të gjithë, edhe me revizionistët sovjetikë, kundër imperializmit amerikan». Ne nuk e pranuan këtë front kundër imperializmit amerikan, me revizionistët sovjetikë si aleatë, për arsye që dihen. Kjo parullë dhe politika kineze e mbështetur në të nuk patën jetë të gjatë, u fikën pa bujë.

Tash doli parulla tjetër që po e hedh Teni, por, natyrisht, me pëlqimin e Maos dhe të Çu En Lait: «Front me të gjithë, edhe me imperializmin amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik». Edhe me këtë parullë, me këtë politikë kineze, ne prapë jemi në kundërshtim. Të dyja vijat, si e para, si e dyta, janë antimarksiste. E para na puqte e na pajtonte me revizionistët sovjetikë e me të tjerë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit, të socializmit dhe të revolucionit. Pikëpamjet tona se imperializmi amerikan dhe Bashkimi Sovjetik revizionist ishin dhe mbeten armiqtë e betuar të socializmit dhe të popujve dolën të drejta. Jeta tregoi se ata, me të cilët kinezët bënin thirrje të futeshin në frontin antiimperialist, e treguan veten që ishin socialimperialistë. Pra, vija jonë ishte marksiste-leniniste, vija kineze ishte e gabuar, liberale, prorevizioniste. Dhe fajin për këtë ia hodhën Liu Shao Çisë.

Vija e tanishme e re e kinezëve prapë është liberale, oportuniste, antimarksiste dhe vija jonë, që e kundërshton atë, është e drejtë. Lufta jonë duhet të jetë e ash-

për kundër të dyja superfuqive imperialiste, që shtypin popujt, që janë kundër socializmit, që duan të rindajnë botën, që luftojnë që të dyja për hegjemoni botërore dhe që së bashku përgatitin luftën. Ne, nën këtë prizëm klasor, në interes të revolucionit duhet të bëjmë që të thellohen kontradiktat në mes dy superfuqive, t'i dobësojmë këto, duke u bashkuar jo me këto dy shtypëse të popujve dhe të revolucionit, por me popujt, me revolucionarët, me proletariatin e gjithë botës.

Përveç kësaj, Kina, në fakt, nxit luftën botërore që gjoja do të pëlcasë në Evropë, në vend që të luftojë kundër luftës grabitqare dhe të nxitë luftërat e drejta revolucionare. Kina as që e shtron objektivin e madh që, në rast se nuk e ndalon dot luftën imperialiste, ta kthejë këtë në një luftë revolucionare kundër luftënxitësve. Jo. Ajo nuk i ndihmon si duhet popujt që luftojnë kundër zgjedhës kapitalisto-imperialisto-revizioniste, por kërkon aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Pinoçetin, me Frankon, me Zhiskar d'Estënin, me Hithin, me Shtrausin dhe me të gjitha klikat borgjeze kapitaliste që sundojnë mbi popujt.

Teni dhe Maoja nxorën teorinë e «botës së tretë» dhe thanë se kjo botë është «aleatja e Kinës». Me këtë teori Teni «frikëson» Fordin, duke u hequr sikur këtë «botë të tretë» e ka në xhep. Kurse Fordi qesh, se klikat sunduese të kësaj «bote» i ka ai në xhep dhe jo Teni. Ky mund të kishte me vete popujt e së ashtuquajturës botë e tretë, në rast se Kina do të ndiqte një politikë marksiste, por politika e Kinës nuk i llogarit si duhet këta popuj. Ajo është kapur në klika të lëkundshme që venë nga fryn era e dollarit dhe e rublës. Popujt e shtypur e shohin se Kina kërkon dhe lidh aleanca me klika reaksionare, dhe, mbi të gjitha, tani edhe me imperializmin amerikan. Nesër mund ta kthejë zhiruetën nga Moska.

Lodra e Kinës është e rrezikshme dhe aguridhe. Ki-

na rrezikohet nga Bashkimi Sovjetik, por e fsheh këtë rrezik dhe hiqet e fortë që «të bindë» aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, Kina me këtë do të thotë se sovjetikët nuk e sulmojnë dot, por, meqë janë social-imperialistë, ata dikë do të sulmojnë. Prandaj Kina ka bërë «analizën marksiste» sipas së cilës «Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Evropën. Pra ti, Evropë Perëndimore, ruhu, se luftën e ke në prag të derës. Dëgjomëni mua, Kinën, ju, popujt të Evropës, armatosuni, bashkohuni me qeveritë tuaja borgjeze reaksionare që ju shtypin, dhe vërsuluni mbi Bashkimin Sovjetik, mos e ulni tensionin, po ngrijeni. Ja, unë jam me ju. Edhe ti, Amerikë, ki mendjen, dil nga kriza, bashkohu më fort me Evropën Perëndimore dhe me gjithë reaksionin botëror dhe mos e ul tensionin me Bashkimin Sovjetik, po ngrije, mundësisht godite dhe më nxirr gështenjat nga zjarri».

Teni arrin deri atje sa t'i përsëritë Fordit që «në Shangai ne kemi vendosur se që të dy nuk do të jemi hegjemonistë». Kina ka besim se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të jenë hegjemoniste!! Edhe miqtë edhe aleatët më besnikë të imperializmit amerikan as e thonë, as e besojnë këtë enormitet antimarksist.

Kina ka ndërmarrë një politikë jo të drejtë, jomarksiste, jo të shikuar nga pikëpamja klasore revolucionare. Por, edhe sikur ta marrim për një çast se me këtë politikë ajo do të fitojë kohë, do të bëjë «njëfarë shantazhi» dhe të shtyjë të tjerët kundër Bashkimit Sovjetik, që Kina e konsideron armikun numër një, prapë ajo nuk mund të ketë asnjë sukses në këtë manovër politike.

Fordi iu përgjigj Tenit e s'ia pranoi politikën e mosuljes së tensionit, «të miqësisë me popujt» dhe shprehu pikëpamjen se «çdo shtet ka politikën e vet për të mbrojtur interesat e tij». Se cilat janë interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai e shtjelloi në fjalimin e vet. Kuptohet se interesat e tyre janë: të vazhdojnë të sun-

dojnë botën, pra janë hegjemonistë; të dobësojnë Bashkimin Sovjetik dhe Kinën ta kenë, gjithashtu, në zap, bile mundësisht ta shtyjnë në luftë me Bashkimin Sovjetik dhe të jetë Kina ajo që t'ua nxjerrë Shteteve të Bashkuara të Amerikës gështenjat nga zjarri.

Historia ka parë disa herë tregti *de dupes*: kush të gënjejë shoqi-shoqin. Por a është vallë aq e lehtë të gënjehen imperializmi amerikan, francez, gjermanoperëndimor ose ai anglez? Duhet të jesh naiv që t'i besosh një gjëje të tillë. Duhet braktisur një politikë e tillë dritë-shkurtër e bazuar në ëndrra, e bazuar në pikëpamjet se «jam një fuqi e madhe», ose në idenë se «gjithë popujt, gjithë revolucionarët më duartrokasin për çdo gjë që bëj», sepse «quhem parti marksiste-leniniste» (por në realitet ti nuk i ndjek parimet marksiste-leniniste).

Fjalimi i Tenit përpara Fordit ishte i dënueshëm për thirrjen drejtuar imperializmit amerikan që të formohet fronti antisovjetik dhe për besimin në Komunikatën e Shangait se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të luftojnë për hegjemoni. Teni thotë se «popujt duan revolucion». Kjo mos vallë do të thotë se ka shpresa që imperializmi amerikan të bashkohet me ata që do të bëjnë revolucion? Apo mos me këtë ai e kërcënon Fordin që «dy rrugë ke: ose eja me ne, ose do të pëlçasë revolucioni»? Apo mos mendon Teni se klikat borgjeze të «botës së tretë» janë për revolucion?

Me të vërtetë ide të habitshme! Të çuditshme!! Ç'janë këta njerëz që sundojnë Kinën? Ç'manovra pseudorevolucionare luajnë? Po të analizosh më thellë këtë çështje, mendoj se nuk përjashtohet aspak një sulm i Bashkimit Sovjetik revizionist mbi Evropën Perëndimore, por kjo nuk përjashton as edhe një sulm të Bashkimit Sovjetik kundër Kinës. E tërë kjo nuk varet nga dëshira e një ose e pesë njerëzve. Sipas mendimit tim, luftënxitësit duhet të bëjnë akoma përgatitje për luftë. Siç e kam shprehur

edhe në një shënim tjetër, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë frikë njëri-tjetrin, për arsye të luftës bërthamore. Por kjo nuk mënjanon acarin e kontradiktave në mes tyre dhe kur këto kontradikta të acarohen aq sa s'mban më, atëherë do të përdoren armët. Aktualisht të dyja palët edhe armatosen, edhe bisedojnë, edhe bëjnë alishverishe politike, taktike dhe strategjike. Bashkimi Sovjetik revizionist e ka kthyer Evropën Lindore në një gubernë të tij dhe e përgatit këtë që ta ketë si fushë luftime, për sulm, por edhe për mbrojtje, pse kush mendon të sulmojë, duhet të mendojë se edhe mund të sulmohet. Bashkimi Sovjetik mund të organizojë një puç në Rumani dhe ta likuidojë Çausheksun dhe shokët e tij se s'i bëjnë më punë, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e perëndimorët të lidhin duart.

Një gjë e tillë mund të ngjasë edhe në Jugosllavi me një qeveri prosovjetike dhe amerikanët e perëndimorët të lidhin, gjithashtu, duart, sido që vihet në rrezik mbrojtja e NATO-s, e shteteve perëndimore, e Greqisë dhe e Turqisë. Mund që gabohem, por një luftë të drejtpërdrejtë të Bashkimit Sovjetik kundër NATO-s, tani për tani, siç e predikojnë kinezët, ne nuk e shohim kaq të lehtë, sido që jo të pamundur.

Unë kam shpjeguar se si mund të zhvillohen situatat dhe qëndrimi ynë i ka marrë parasysh të gjitha variantet më të zeza. Por do të jetë miopi të përjashtosh rastin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimorët nuk do të bëkan përpjekje që Bashkimin Sovjetik ta shtyjnë në drejtim të Kinës. Jo. Atë që kërkon në fakt të bëjë Kina, duke dashur të shtyjë Bashkimin Sovjetik kundër Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, po ashtu edhe këta bashkë me perëndimorët luftojnë që Bashkimi Sovjetik të sulmojë Kinën.

Me të ikur Teni nga Franca, Zhiskari shkoi në Moskë që të ringjallte «miqësinë». Këtë punë bëri Shelli i Gjer-

manisë, po ashtu Uilsoni i Anglisë dhe tash së fundi Leone i Italisë. Fol ti Ten që «ju perëndimorët po shkoni përpara në luftë kundër Bashkimit Sovjetik»; këta venë dhe marrin atje koncesione, bëjnë investime etj.

Kina është kundër Bashkimit Sovjetik, por, në vend që të punojë në Azi dhe rreth saj, ajo interesohet në mënyrë joreale për Evropën. Bashkimi Sovjetik ka futur kthetrat në të dy Vietnamët, në Laos; ka rrezik që të futet bile edhe në Kamboxhia, ose në Tajlandë. Me Indinë, ku Bashkimi Sovjetik po penetron thellë, Kina qëndron në pozita të ftohta, për të mos thënë armiqësore; i rroftë miqësia koniunkturale me Pakistanin, vizita e zonjës Markos të Filipineve. Po kështu duhet thënë dhe për princeshën Pahlevi, që pritet me aq ndere nga Mao Ce Duni e Çu En Lai.

Po me Japoninë ç'po bën Kina? Asgjë, vetëm tregti. Tash flitet se Kina do të marrë ose ka marrë kredi me afat të shkurtër për pesë vjet nga shtetet kapitaliste, veç jo «nga shteti», por nga shoqëritë private kapitaliste. Jo ve, po kokove. Politikë shumë e çuditshme dhe e rrezikshme!

E SHTUNË
6 DHJETOR 1975

SHËNIM

Kishim për darkë dhe zhvilluam një bisedë të ngrohtë miqësore me kryetarin e Partisë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste), Eduard Hill¹, dhe bashkëshorten e tij. Ndodheshin edhe Ramizi, Nexhmija e të tjerë.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 610.

TRIUMFUES E TË MBUSHUR ME LAVDI NË GJIRIN E TOKËS MËMË

Sot vijnë dhe varrosen në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në Tiranë shokët heroikë të lavdishëm partizanë, që ranë dëshmorë në luftën kundër nazistëve për çlirimin e popullit shqiptar të Kosovës, të popullit malazez, atij të Bosnjës, të Hercegovinës etj.

Kthehet kontingjenti i fundit i bijve dhe i bijave të lavdishme të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar që, me urdhrin e Komandantit Suprem të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pasi çliruan gjithë Shqipërinë nga okupatorët nazistë, i ndoqën këta duke luftuar dhe duke i grirë në fushat shqiptare të Kosovës, në gërxhet e në grykat me borë e acar të Malit të Zi, të Bosnjës e të Hercegovinës. Luftuan bijtë e nënave heroike të Shqipërisë tok me partizanët jugosllavë njësoj sikur luftonin për çlirimin e Tiranës, të Gjirokastrës, të Vlorës, të Shkodrës. Asgjë nuk i ndaloi trimat, që Partia i kishte edukuar me një frymë internacionaliste të lartë. Ata ecën përpara në mes plumbave dhe topave të armikut. Me qindra e qindra na u vranë për lirinë e popujve të Jugosllavisë, por e ngritën lart e më lart emrin e shqiptarit, që në shekuj ka treguar heroizma të shkëlqyer. Bijtë e Partisë Komuniste të Shqipërisë u treguan besnikë deri në sakrificën e jetës për idealet e Partisë. Ata, të inkuadruar në divizione dhe në brigada shqiptare, lanë

nam të madh në popujt e Jugosllavisë, që i nderonin duke vënë lule në varrezat e tyre. Populli shqiptar i Kosovës, i Malit të Zi etj., i përcolli eshtrat e tyre me nderime deri në kufi. Ata hynë triumfues, mbuluar me lavdi në gjirin e tokës mëmë, në zemrën e popullit të tyre që i rriti për një çështje të madhe të pavdekshme kurrë. Këta trima e trimëresha luftuan për çlirimin e popullit të tyre dhe për ata të Jugosllavisë.

Dje dhe sot gjithë populli i Shqipërisë është në këmbë dhe pret me dashuri, me respekt të pafund dhe me krenari të ligjshme bijtë dhe bijat e tij heroike. Që nga Hani i Hotit, që nga Kukësi, Shkodra, Lezha e deri në Tiranë populli pret e përcjell eshtrat e shokëve.

Sot ata janë në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë së tyre socialiste, për të cilën dhanë jetën. Tërë populli i Tiranës është jashtë dhe i rrethon bijtë e tij të lavdishëm me një dashuri të zjarrtë.

Më duket sikur jam në mes tyre, në mes shokëve të mi të shtrenjtë, i ndjek me emocion të madh makinat që kalojnë triumfalisht nga sheshi «Skënderbej», në bulevardin «Dëshmorët e Kombit», nga ku do të ngjiten në varrezat madhështore që Partia dhe populli ndërtuan për bijtë e tyre dëshmorë. Tash që shkruaj këto radhë, nga zyra dëgjoj breshërinë e topave që nderon kujtimin e tyre të pavdekshëm në shekuj. Ata tash janë në gjirin e tokës mëmë, që e lagën me gjak dhe «Mëma Shqipëri», statuja madhështore e Varrezave të Kombit, vigjilon mbi ta me shtatin e saj vigan, ajo i mbulon varrezat e shenjta të bijve dhe të vashave të saj të lavdishme me kurorën me dafina dhe me yllin e kuq të Partisë.

Lavdi në shekuj dëshmorëve të kombit dhe të Partisë sonë heroike!

TAKIM ME SIHANUKUN

Sot, në selinë e Komitetit Qendror, prita Sihanukun, që ndodhet për vizitë në vendin tonë.

Në mbrëmje Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Këshilli i Ministrave dhanë një pritje në Pallatin e Brigadave. Mbajtën fjalime shoku Haxhi Lleshi dhe Sihanuku. Çdo gjë shkoi mirë. Përveç «lëvdatave princore» që na bënte, nuk mendon keq, të paktën ashtu si shprehet, bile flet shumë më mirë se të vetëquajturit komunistë. Ishte shumë i kënaqur që erdhi, edhe ne po ashtu.

NJË NJOFTIM QË NA NGROH CA

Një telegram i ambasadorit dhe i shokëve të delegacionit tonë ushtarak nga Pekini sikur na ngroh ca. Shokët kinezë u thanë tanëve që të vizitonin disa qendra. «Shkoni të gjithë, mos lini në Pekin asnjë shok, pse ne i studiojmë vetë materialet që kërkoni, mbasi mesazhi i shokut Enver është me rëndësi politike». Të tëra ç'kërkojmë, s'na i japin, por me sa duket do të na japin diçka dhe do të lënë derën hapur.

SIHANUKU ANKOHET PËR RUMUNËT

Sot pasdreke do të pres Norodom Sihanukun, i cili ikën nesër për në Jugosllavi për të bërë 3 ditë pushim dhe dëshiron të më lërë lamtumirën. Ai erdhi te ne nga Rumania (ku nuk e pritën mirë dhe Çausheku, sipas thënies së Sihanukut, e kishte këshilluar që ta zbuste qëndrimin ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës).

PROVOKACION I RËNDË I TITISTËVE

Sot në mëngjes më njoftuan se rojat kufitare jugosllave kanë qëlluar në ujërat tona territoriale një peshkimi dhe kanë vrarë kapitenin e anijes¹. Duhet të thërresim të mbliidhet komisioni mikst kufitar, të protestohet shumë energjikisht, të merren masa për fajtorët, të kërkohet dëmshpërblim dhe t'u thuhet të mos përsëriten më veprime të tilla armiqësore.

¹ Fran Ndue Ivanaj — Hero i Popullit.

VDIQ SHOKU KAN SHEN

Pekini njoftoi lajmin e hidhur të vdekjes së shokut Kan Shen. U hidhërova shumë, se e njihja mirë. Ai ishte te ne në vitin 1966. Ishte edhe në Mbledhjen e Moskës më 1960, kur u hapëm zjarr Hrushovit dhe hrushovianëve. Ishte një marksist-leninist i shquar dhe shumë i vendosur. Me të ishim dakord jo vetëm në parimet e mëdha, por ai miratonte dhe gjente të drejtë edhe taktikën tonë në të gjitha qëndrimet. Ishte një shok besnik i parimeve, nxënës i shkollës së Leninit, Stalinit dhe Kominternit. Kan Shenin e donte shumë Shqipërinë socialiste, ai kishte një dashuri të madhe dhe të sinqertë për Partinë tonë dhe në çdo situatë na mbronte dhe ishte për ne një nga shokët më të mirë në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës. Ne humbëm një shok e mik të mirë, Partia Komuniste e Kinës një teoricien të shquar e një udhëheqës të denjë, revolucionin botëror humbi një militant besnik për çështjen e komunizmit dhe një internacionalist proletar.

POZITA TË DREJTA TË PK TË GJERMANISË (M-L)

Ramizi më vuri pak në dijeni për ardhjen e delegacionit të Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), të udhëhequr nga kryetari i saj, Ernst Aust. Ramizi pati një bisedë paraprake me ta. Shokët gjermanë i folën atij në lidhje me çështjet që duan të diskutojnë me ne. Ramizi pati përshtypjen se mbi problemet që shtrojnë (dhe që kryesoret janë qëndrimet ndaj të dyja superfuqive), ata janë të një mendimi me ne, por, për të qenë në «rregull» edhe me vijën kineze, bëjnë nga një shtojcë. Flasin, për shembull, për «botën e tretë», por thonë se «një shikim i tillë mund të pranohet» në vijë politike, pse në shikimin klasor kjo nuk ecën, duhet të plotësohen katër kushtet që ka përcaktuar Stalini.

Kur Ramizi i pyeti «Po Shqipërinë socialiste në ç'botë e futni?», ata qeshën. Ramizi i pyeti pse qeshnin. Kryetari i Partisë Komuniste të Gjermanisë i tha: «Qeshim se këtë pyetje që na bëni ju neve, ua bëmë ne shokëve kinezë, po ata nuk na u përgjigjën». Ata ngrihtën çështjen se «cila superfuqi është më e rrezikshme, Bashkimi Sovjetik apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës», sepse, siç thanë ata, do ta përcaktojnë si orientim në strategjinë e programit që do të vendosë kongresi i tyre.

Unë i thashë Ramizit t'u shpjegojë shokëve gjermanë pikëpamjen tonë, se që të dy janë njësoj të rrezikshëm. Ata le të gjykojnë dhe ta përcaktojnë vetë strategjinë e

partisë së tyre, por, në parim dhe në praktikë, nga ana strategjike, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë njësoj të rrezikshëm për popujt e botës, për revolucionin, për socializmin dhe partitë komuniste e punëtore (marksiste-leniniste) duhet të luftojnë kundër të dyja këtyre superfuqive imperialiste.

Por Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste), duke mos e nënvlerësuar këtë çështje të madhe, nuk mund të neglizhojë taktikat. Domethënë ajo duhet të udhëhiqet nga realiteti i vendit të vet për të organizuar punën dhe revolucionin. Ajo duhet të luftojë për unitetin e proletariatit gjerman, bile të të dyja shteteve gjermane, kundër reaksionit kapitalist e revanshist të brendshëm, si dhe kundër dy superfuqive njëkohësisht, që synojnë të pushtojnë njëra Gjermaninë Perëndimore dhe tjetra Gjermaninë Lindore. Në të dyja shtetet gjermane ekziston borgjezia reaksionare, njëra proamerikane, tjetra prosovjetike. Të dyja këto superfuqi dhe aleatët e tyre të brendshëm në të dyja shtetet gjermane synojnë të mbajnë statukuonë aktuale për të gllabëruar dhe për të bashkuar Gjermaninë Perëndimore dhe Gjermaninë Lindore, njëra nën hegjemoninë e revanshizmit, por edhe tjetra nën hegjemoninë e borgjezisë së re revizioniste socialimperialiste. **Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) duhet të luftojë kundër të dyja këtyre tendencave, të luftojë për unitetin e të dyja shteteve gjermane dhe pastaj të synojë për organizimin e revolucionit proletar në Gjermani.** Këtë orientim dhe këtë strategji duhet të kenë të gjithë revolucionarët e të dyja shteteve gjermane, domethënë uniteti i Gjermanisë pastaj revolucioni, i cili duhet përgatitur.

Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) në Perëndim duhet të luftojë edhe kundër borgjezisë kapitaliste revanshiste të Bonit, edhe kundër imperializmit amerikan. Ajo duhet të luftojë edhe kundër reaksio-

nit të brendshëm, pse ky është armik i betuar i popullit gjerman dhe i proletariatit të tij. Ky reaksion përgatit revanshin, po kundër kujt? Në radhë të parë kundër socialimperializmit sovjetik. Por që ta arrijë këtë, duhet të arrijë unitetin e të dyja shteteve gjermane. Këtë nuk mund ta arrijë pa luftë, prandaj ky reaksion gjerman ka nevojë për mbështetjen e imperializmit amerikan për t'ia arritur këtij qëllimi të bashkimit, por edhe për t'u mbrojtur nga një invadim sovjetik. Pra të dyja shtetet gjermane ndodhen në të njëjtën situatë. Armiqtë e tyre të jashtëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik i kanë brenda në vatër, prandaj të dy duhet të luftohen, se të dy janë po aq të rrezikshëm, janë kundër revolucionit, janë për revanshin, por ky revansh aktualisht merr një kuptim tjetër, pse Bashkimi Sovjetik aktualisht është socialimperialist dhe kërkon të vendosë hegjemoninë e vet, siç bëjnë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. **Pra, Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) duhet të luftojë në Perëndim dhe në Lindje kundër borgjezisë reaksionare revanshiste të të dyja shteteve gjermane, si dhe kundër të dyja superfuqive që kërkojnë të pushtojnë të dyja shtetet gjermane.** Pra, të katër këta armiq të të dyja shteteve gjermane janë njësoj të rrezikshëm dhe duhet të luftohen veç e veç dhe së bashku nga proletariati dhe nga gjithë populli gjerman.

Për mendimin tonë kjo çështje shikohet kështu: Kush do të sulmojë i pari? Këtë ne nuk jemi në gjendje ta themi, se që të shpallet lufta, duhet më parë të krijohen kushtet për të dhe ne mendojmë se kushtet nuk janë krijuar për një luftë të afërt. Ne duhet të jemi dhe të luftojmë kundër përgatitjes dhe shpalljes së luftës imperialiste dhe në rast se nuk mund ta ndalojmë dot, atëherë duhet ta shndërrojmë këtë në luftë civile dhe në luftë çlirimtare. Në të dyja shtetet gjermane, përveç pro-

letariatit, duhet të ketë edhe elementë përparimtarë kundër luftës imperialiste, kundër revanshistëve, kundër sundimit dhe qëllimeve të tyre. Detyra e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), është t'i njohë këta, të punojë me ta, t'i drejtojë dhe t'i hedhë në luftë kundër armiqve të proletariatit, të popullit gjerman dhe kundër luftës së tretë botërore. Ky është një problem që ka lidhje me aleancat, problem me rëndësi dhe shumë delikat. Askush nuk mund ta këshillojë Partinë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) se duhet bërë aleancë me këtë ose me atë. Vetë ajo mund të vendosë për këtë problem kaq të madh. Ne mund të themi vetëm se Gjermania ka qenë dhe mbetet zjarri i madh në Evropë, i cili mund të djegë Evropën dhe botën, por ky mund të jetë edhe zjarri i revolucionit që do të shpëtojë Evropën dhe botën. Prandaj **roli dhe lufta e proletariatit gjerman dhe e Partisë së tij Komuniste (marksiste-leniniste) është me rëndësi të jashtëzakonshme.**

Ne mund të themi, gjithashtu, se **lufta e tyre nuk mund të konsiderohet e shkëputur nga lufta e proletariatit botëror, nga luftërat nacionalçlirimtare të popujve të botës, por çdo gjë duhet të shikohet nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste, nën prizmin klasor dhe jo pse kështu do njëri ose tjetri. Politika e koniunkturave të çon në gabime të rënda, në rast se në bazë nuk është ideologjia marksiste-leniniste. Kjo është e vërtetë si në «aleancat» me jashtë, ashtu edhe në aleancat brenda.** Në këto të fundit duhet të ruhet personaliteti i partisë, duhen ruajtur parimet, duhet luftuar me forma legale dhe ilegale, s'duhet entuziazmuar në aleanca të përkohshme, që mund të durojnë një kohë të shkurtër, duhet tërhequr kur duhet nga këto lloj aleancash, të mos bëhen lëshime në parime etj. Mos harroni Sheidemanët, Elatët, Noskët e të tjerë, t'u thuhet shokëve gjermanë.

Mos harroni po kini parasysh luftën e «Spartakusit»,

vrasjen e Rozës, të Libknehtit, të Telmanit. Partia juaj ka një eksperiencë të shkëlqyer me të ngjitura, por ka edhe eksperiencë me disfata. Kohët atëherë kanë qenë të vështira, megjithëse në Rusi triumfoi Revolucion i Tetorit. Aktualisht Bashkimi Sovjetik u bë një vend imperialist. **Ne nuk kemi gjallë Leninin dhe Stalinin, por kemi mësimet e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, të cilat janë forca kolosale e pamposhtur që na udhëheq në revolucion e në fitore.** Po t'i ndjekim me rreptësi këto mësimet dhe t'i zbatojmë në mënyrë korrekte në situatat tona, atëherë ne do të realizojmë fitoren e revolucionit.

E PREMTE
19 DHJETOR 1975

GJERMANËVE T'U JEPET PËRGJIGJJA QË MERITOJNË

Nesti Nases ia ktheva projektnotën që i bëhet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga ana jonë si përgjigje të notës që ajo na drejtonte për dëmtshpërblimet e luftës që ne i kërkojmë. Nota gjermane ishte arrogante, vetëm treçerek faqeje. Ministria jonë i përgjigjet me 5 faqe me «nderime të larta» etj. I thashë se duhet t'u bëhet një përgjigje e ashpër, e bazuar dhe vetëm një faqe.

E SHTUNË
20 DHJETOR 1975

SHËNIM

Më raportojnë se shoku Ernst Aust, kryetar i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), ka qenë në Vlorë, në Fier e gjetkë dhe ka folur shumë mirë me kuadro në mbledhje, ku kishte 200-300 veta. Përveç fjalëve të mira për ne, edhe për problemet ndërkombëtare ai foli drejt dhe dha mendime të njëllojta me tonat.

E MARTË
23 DHJETOR 1975

**KINEZËT DUAN TË SABOTOJNË FORCËN
MBROJTËSE TË VENDIT TONË**

Pasdreke shokët e Qeverisë më dërguan listën e armatimeve që na japin kinezët. Për turp! Shumë, shumë pak! Të ulët e kurnacë u treguan, po na lënë shumë zbuluar. Vendosëm si do të veprojmë, por pa asnjë shpresë që ata të shtojnë gjë. Ata nuk na japin asnjë tank, asnjë raketë, asnjë top dhe shumë pak fishekë.

1976

ZIGZAGET E VIJËS KINEZE

Kam shkruar edhe herë të tjera se ç'mendoj për vijën e Partisë Komuniste të Kinës dhe, lidhur me të, kam dhënë mendime për shumë çështje dhe probleme të politikës kombëtare e ndërkombëtare të saj, ashtu si i kam gjykuar unë këto ngjarje (e natyrisht sa kam mundur), në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste. Kam dhënë mendime për të gjitha ngjarjet kryesore që vërtetoheshin në Kinë e për rrugën politiko-ideologjike që merrnin ato. Brenda mundësive, që më jepeshin nëpërmjet informacioneve për këto ngjarje, jam përpjekur t'i kuptoj dhe t'i interpretoj ato, në radhë të parë, në prizmin e vijës së Partisë sonë, por edhe të koniunkturave ndërkombëtare, duke thënë se këto qëndrime jokorrekte të Kinës ishin, sipas mendimit tim, të përkohshme dhe të detyruara nga rrethanat e brendshme e të jashtme, si një shtet i madh që ishte. Por, pavarësisht nga këto rrethana, gabimet në vijë të Partisë Komuniste të Kinës i kam cilësuar gabime, kurdoherë duke pasur shpresë se do të ndreqeshin me kapërcimin e situatave të vështira nëpër të cilat kalonte Kina.

Një diçka tjetër, që mund të të çojë në një gjykim të gabuar të vijës kineze, është fshehtësia e madhe në të cilën mbahen ngjarjet. Udhëheqësit kinezë këto ngjarje i fshehin me xhelozinë më të madhe, dhe, kur diçka shpallet, prapë ajo është e cunguar, jo e qartë, shumë

herë e pakuptueshme dhe e habitshme! «Shpjegimi» për ndonjë ngjarje (e kam fjalën për ngjarje me rëndësi) vjen papritur dhe kjo proklamohet si «vija e përsosur» me vite të tëra; pastaj për një a dy vjet me radhë flitet me aluzione, më vonë deklarohet «hapur» se ka qenë reaktionare. Por «hapur» i thënçin, sepse, pas një kohe prej dy ose tre vjetësh që «është folur hapur» për gabimet dhe për njerëzit që kanë gabuar, deklarohet se «gabimet u ndreqën dhe njerëzit u rehabilituan». Kjo tregon një lëkundshmëri të madhe në vijë, në ide, në qëndrime dhe në veprime, e cila është si lavjerrësi i orës që lëkundet djathtas dhe majtas, pra një *suspense*¹ e vazhdueshme në vijë.

Vija politike dhe ideologjike e Liu Shao Çisë u deklarua se ishte një vijë revizioniste, liberale, oportuniste. Dhe ne kështu mendojmë: e tillë ishte ajo. Liu Shao Çisë zyrtarisht iu vunë shumë epitete, por sidomos atij iu atribua epiteti «Hrushovi i Kinës». Ky «Hrushov i Kinës» ishte bërë «i plotfuqishëm» dhe, me sa lihej të kuptohej (se kështu, me nënkuptime, lihen të gjitha çështjet në Kinë) «Mao Ce Duni ishte izoluar, ishte lënë mënjanë», por çdo gjë bëhej «nën emrin e tij, me flamurin e tij». Kjo për ne do të thoshte, pra, se Maoja nuk duhej të ishte ashtu siç thoshin, «i izoluar», mbasi ai udhëhiqte partinë, udhëhiqte kongrese partie. Në vitin 1957 ai mori pjesë në Mbledhjen e Moskës dhe foli pro Hrushovit, të cilin e quajti «Lenini i kohëve tona». Maoja, me këtë rast, kritikoi edhe Stalinin, duke thënë: «Kur vajta te Stalini, qëndrova si nxënësi para mësuesit», dhe këtë Maoja e bëri për të treguar «prepotencën» e Stalinit ndaj tij. Ai, gjithashtu, e uroi Hrushovin se «kishte bërë mirë që goditi elementët antiparti», domethënë grupin e Molotovit. A mund të mendohet, pra, që Mao Ce Duni

¹ Frëngjisht — këtu ka kuptimin pasiguri.

të ketë qenë i izoluar nga Liu Shao Çia? Jo, më duket mua; përkundrazi, ai ka qenë në të njëjtat pozita me Liun dhe me Hrushovin.

Pra, pikëpamjet politike, ideologjike, ekonomike etj. të Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës, në të cilin asistua edhe ne, në vitin 1956, ishin jo vetëm idetë liberale, djathtiste dhe revizioniste të Liu Shao Çisë, por edhe të Maos, edhe të Ten Hsiao Pinit, të Çu En Lait, të Pen Çenit e të tjerëve, me fjalë të tjera, të të gjithë udhëheqjes. Vihet pyetja në këtë rast: Maoja, që uroi Hrushovin, përse nuk bëri edhe vetë ashtu, dhe t'u vinte fshesën këtyre fraksionistëve? S'u vuri fshesën, sepse ata kishin fuqinë?! Jo, kjo nuk u tha asnjëherë. Po çfarë ishte kjo bandë e Liu Shao Çisë, «e djathtë» apo «e majtë»? Kjo nuk u tha asnjëherë hapur. Por Maoja vetë çfarë ishte, djathtist, centrist, liberal, majtist, apo marksist-leninist? Kurdoherë ai është hequr dhe hiqet si marksist-leninist, si dishepull i Marksit, i Engelsit, i Leninit dhe i Stalinit, fotografitë e të cilëve në Kinë vihen në mure në formate të mëdha, por në realitet Maoja as veptoi dhe as vepron në bazë të mësimëve të tyre kundër deviatorëve dhe armiqve të marksizëm-leninizmit.

Në shkrimet e tij Maoja është shprehur dhe vazhdon të shprehet se «fshatarësia është forca më revolucionare, tek e cila duhet të mbështetet revolucioni». Rolin vendimtar të proletariatit në revolucion sipas teorisë së Marksit, Maoja e vë në plan të dytë, në mos të tretë. «Kështu është kryer revolucioni kinez, prandaj kjo teori duhet të mbizotërojë», — thotë ai. «Rroftë Marksi», — thotë Mao Ce Duni, por për të nuk qëndron teoria e Marksit për rolin udhëheqës të klasës punëtore. Me fjalë të tjera, sipas Maos, nuk mundet që klasa punëtore ta udhëheqë revolucionin dhe fshatarësia e varfër dhe e mesme të jetë aleatja e saj në revolucion; e kundërta duhet të ngjasë, ta udhëheqë revolucionin fshatarësia dhe klasa punëtore të jetë aleatja e së parës.

Shprehje tjetër e kësaj vije antimarksiste të Maos është edhe koncepti, sipas të cilit «fshati të rrethojë qytetin». Kjo do të thotë që revolucionin ta udhëheqë fshatarësia e varfër, se «proletariati i qytetit e ka humbur frymën revolucionare, ai është bërë konservator, i është përshtatur shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist». Natyrisht, kjo teori është antimarksiste dhe nuk mund të çojë në revolucion, nuk mund të vendosë dhe t'i japë rolin që i përket diktaturës së proletariatit dhe as udhëheqjes së saj, partisë proletare marksiste-leniniste. Me fjalë dhe me propagandë çdo gjë mund të mbulohet, por jo esenca e çështjes, dhe për pasojë, në mos sot, nesër do të vijë koha që çatia dhe muret të rrëzohen, sepse socializmi nuk mund të ndërtohet pa udhëheqjen e partisë komuniste marksiste-leniniste dhe pa zbatuar drejt e me vendosmëri tezat e pavdekshme të teorisë marksiste-leniniste.

Partia Komuniste e Kinës, pavarësisht nga pamja dhe nga reklama që bën, nuk është dhe nuk mund të jetë një parti e vërtetë marksiste-leniniste dhe në pozita të shëndosha revolucionare. Historia e kësaj partie tregon se në gjirin e saj jo vetëm kanë ekzistuar fraksione të ndryshme ideologjike që kanë vepruar kundër njëri-tjetrit, gjë që është e natyrshme, sepse edhe në parti ekziston dhe zhvillohet lufta e klasave, por më e rëndësishme dhe shqetësuese është se këto fraksione lejohen, vazhdojnë të ekzistojnë, bëhen zyrtare, derisa botërisht thuhet: «Le të lulëzojnë njëqind lulet». **Një partie që lejon të lulëzojnë në gjirin e saj liberalizmi, pikëpamjet kulake, revizioniste e anarkiste të çdo lloji, apo që lejon t'u paguhet rentë kapitalistëve të qytetit, në një kohë kur është vendosur diktatura e proletariatit (sic), nuk mund t'i vësh emrin parti marksiste-leniniste.**

Në një parti të tillë zotëron mentaliteti fshatar, mikroborgjez, dhe s'ka si të jetë ndryshe kur në veprimtarinë e saj parimet marksiste-leniniste jo vetëm nuk zba-

tohen, por ato shkelen, nënvleftësohen dhe përdoren si perde për të fshehur realitetin josocialist. Kjo vijë oportuniste revizioniste e kishte krimbur partinë dhe Kinën po e çonte në rrugën hrushoviane.

Mao Ce Duni reagoi në mënyrë vigoroze, por jo si udhëheqës i një partie marksiste-leniniste. E kam fjalën për «Revolucionin e Madh Kulturor Proletar». Ç'ishte ky Revolucion Kulturor?! Kush e drejtonte atë dhe kundër kujt bëhej?! Këtë revolucion, si të thuash, e drejtonte Mao Ce Duni dhe një shtab i ngushtë rreth tij. Maoja, afërsisht, bëri këtë thirrje: «Të sulmojmë shtabet». Po cilat ishin këto shtabe? Që nga Liu, Teni, Çuja, Li Hsien Nieni e shumë e shumë të tjerë, deri poshtë në komitetet. Kush do t'i sulmonte këto shtabe? Rinia, e cila me thirrjen e Maos doli rrugëve në mënyrë spontane, anarkiste.

E gjithë kjo veprimtari u bë e përqendruar jo në rrugë marksiste-leniniste dhe as u zhvillua në këtë frymë. Karakteristike është se ata që u ngritën në këtë «revolucion» ishin studentë, nxënës, intelektualë. **I famshmi «revolucion» bëhej kështu nga intelektualët, jashtë kontrollit të partisë dhe kjo jo vetëm që nuk drejtonte, por në fakt ishte, si të thuash, e likuiduar.**

Shtabi i revolucionit nuk kishte besim as te partia e klasës, as te vetë klasa. Dhe ngjanë përlëshje të përgjakshme, bile u bënë edhe luftime të rregullta me artilleri dhe me mortaja. Hunveibinët bënë ligjin në rrugë e në sheshe, arrestonin njerëz dhe, me faj e pa faj, i diskreditonin, u vinin «kapelën», deri dhe i vritnin nëpër rrugë; ata arritën sa të djegin edhe ambasada të huaja. Ksenofobia u shpreh e egër kundër të huajve, kundër kulturës së popujve të tjerë, por luftë u bë edhe kundër trashëgimisë kulturore mijëvjeçare të vetë Kinës.

Ç'tregonte gjithë kjo furtunë? Është e qartë se nuk tregonte frymën dhe parimet marksiste në veprim, por

dëshmonte për zbatimin e teorive anarkiste të Shtirnerit, të Bakuninit e të atyre të Prudonit, kundër të cilave Marksi dhe Lenini kishin luftuar me ashpërsinë më të madhe. «Revolucioni i Madh Kulturor Proletar» nuk ishte një revolucion kulturor (ai drejtohej kundër asaj kulture që predikonin Marksi dhe Lenini), ai ishte një revolucion politik jo në rrugën marksiste-leniniste, por një revolucion pa program, anarkist, kundër klasës punëtore dhe partisë së saj, sepse faktikisht roli udhëheqës i klasës dhe vetë partia qenë likuiduar. Por, veç rrëmujës dhe spontaneitetit anarkist edhe autoriteti i organeve lokale të pushtetit shtetëror po ashtu nuk ekzistonte më, kurse ushtria, e udhëhequr nga Lin Biaoja, që luftonte me flamurin e Maos, me librin e kuq të Maos dhe me miliarda pafka të madhësive të ndryshme me fytyrën e Maos, qëndronte e plotfuqishme «në rezervë» të Maos. Lin Biaoja ishte bërë figura kryesore e shtabit të revolucionit, po kështu edhe Çen Po Taja. Mirëpo më vonë këta të dy u deklaruan «komplotistë, tradhtarë, organizatorë të atentateve të ndryshme kundër Mao Ce Dunit, që dështuan».

Mao Ce Duni dha urdhër që fshati të mos ngrihej në revolucion, se gjoja atje çdo gjë ishte në rregull. Siç thuhej, «e keqja ishte në qytete, ishte në parti, ishte në klasën punëtore» (sic). Kjo dukej dhe cilësohej si majtizëm, por, në fakt, është djathtizëm, dhe kjo do të thotë se djathtistët revizionistë — dhe këta ishin njerëzit e grupit të Liu Shao Çisë — kishin hedhur në dorë klasën dhe partinë e saj, kurse «majtistët», Maoja me shokë, ngritën në revolucion studentët dhe intelektualët për të rimarrë partinë dhe klasën! Ç'gjëra të çuditshme ndodhin në Kinë! Këtu del qartë në pah teoria djathtiste e Maos, sipas së cilës «fshati dhe të rinjtë të sulmojnë dhe të kapin qytetin» (sic).

Gjatë revolucionit kaotik dhe anarkist gjoja u bënë riparime, gjoja u rikrijua partia. Dhe sa u përjashtuan

pas gjithë kësaj katrohure dhe periudhe mosbesimi e pasigurie? Vetëm 3-4 për qind. Por kjo shifër nuk dëshmon se partia ishte «krimbur», por dëshmon se Maoja me disa pasues të tij s'kishin besim te partia.

Ç'gjë tjetër «të mirë» solli Revolucioni Kulturor? Asgjë! Pushteti i diktaturës së shkatërruar duhej mëkëmbur. Po si? Një sallatë ruse, sido që udhëheqësit kinezë ishin kundër rusëve! Pushteti i krijuar kudo përbëhej nga njerëz të partisë, nga ushtria, fshatarësia dhe nga punëtorë. Udhëheqësi kryesor i këtij pushteti ishte oficeri më i lartë. Por akoma edhe tash nuk dihet se si është formuar pushteti në Kinë. Thonë se partia është organizuar, por organizatat e masave akoma nuk janë formuar dhe s'po i bëjnë kongreset përkatëse.

Lufta e klasave në teori gjoja vazhdon, veçse të gjithë ata që u dënuan dhe u poshtëruan nga ky «revolucion» u rehabilituan dhe Teni, *de facto*, tash zë vendin e parë në udhëheqje, meqë Maoja dhe Çuja janë sëmurë. Të gjithë njerëzit që kishin pasur përgjegjësi të larta, si ministra, mareshalë dhe gjeneralë të Çan Kai Shisë, u fallën dhe janë të lirë. Thuhet se ata po «punojnë me ndër-gjegje» për atdheun e tyre, Kinën socialiste.

Të gjitha teoritë jomarksiste të Maos u quajtën maocedunide. Natyrisht një gjë e tillë u bë për ndarjen në mes marksizëm-leninizmit dhe maocedunidesë. Këtë «teori» u përpoqën të na e impononin si neve, ashtu edhe gjithë komunistëve në botë, por ne nuk pranuan të binim në një gabim të tillë fatal. Maoistët, për të gënjer, domethënë për t'i shitur idetë liberale, revizioniste dhe anarkiste të Maos sikur janë marksiste, nxorën formulën tjetër: «Marksizëm-leninizmi-maocedunideja». Kuptohet qartë hileja e këtij maskimi. Bota revizionisto-kapitaliste dhe disa lakenj të kinezëve, që e quajnë veten «parti komuniste marksiste-leniniste», siç është ajo e Francës, e adoptuan këtë «teori». Maocedunideja revizioniste po

zhvillohet tash pa kurrfarë mbulese në politikën ndërkombëtare.

Politika kineze bazohet në «luftën kryesore kundër socialimperializmit sovjetik». «Kush ka kontradikta me Bashkimin Sovjetik, është në një anë me Kinën». Me këtë udhëheqësit kinezë duan të thonë, dhe e thonë hapur, se «socialimperializmi sovjetik është armiku kryesor». Këtë e thonë edhe për të forcuar idenë se Kina është një «vend socialist» dhe «udhëhiqet» nga marksizëm-leninizmi.

Në politikën e saj të jashtme, Kina nuk udhëhiqet në asgjë nga marksizëm-leninizmi, nga revolucioni dhe nga pikëpamja klasore. Në Kinë janë braktisur të gjitha parimet bazë marksiste-leniniste. Ajo nuk bën një luftë klasore kundër dy superfuqive, politika e saj jomarksiste e ka fshirë ideologjinë marksiste në politikën e jashtme. Kina e Liut ishte për «aleancë me të gjithë, edhe me revizionistët sovjetikë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës», kurse Kina e Maos është për «një aleancë me të gjithë, në radhë të parë me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë reaksionare, kundër Bashkimit Sovjetik».

Kina po shtrembëron teorinë marksiste-leniniste, e cila na mëson se nga njëra anë e barrikadës qëndrojnë popujt me në krye proletariatin dhe, nga ana tjetër, imperializmi dhe kapitalizmi botëror, të cilëve iu shtua edhe socialimperializmi sovjetik.

Në politikën e jashtme të Kinës vazhdon të mbizotërojë teoria e Maos «fshati të rrethojë qytetin» dhe kjo shprehet në «teorinë» sipas së cilës «bota e tretë (ku është inkuadruar dhe Kina) të rrethojë dhe të likuidojë botën e dytë dhe të parë». Por këto dy «botë», që Kina e Maos pretendon t'i rrethojë e t'i luftojë, efektivisht ajo i mbështet për të shtypur popujt e tyre dhe popujt e «botës së tretë», të cilët ajo i konsideron gjoja si ushtarët e revolucionit. Titoja, Çaushesku dhe të tjerë si këta janë alea-

tët e Kinës, janë për «revolucionin» (sic)! Të tillë konsiderohen gjithë këta edhe nga hrushovianët, bile këtë lojë hrushovianët e çojnë deri atje sa vendet ku drejtojnë ata që përmenda më sipër, i quajnë «socialiste». Kina mbron Frankon, Pinoçetin, NATO-n, Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar», reaksionarë si gjermanin Shtraus, anglezin Hith, italianin Fanfani e të tjerë. Kjo s'mund të quhet një politikë klasore marksiste-leniniste. E famshmja «botë e tretë» nuk mund të pranohet në bllok, siç bëjnë kinezët. Një vend i vërtetë socialist edhe në aleancat me shtete të ndryshme, edhe në dhënien e ndihmës shtetërore duhet absolutisht të bëjë diferencime. Pa folur këtu për Frankot dhe për Pinoçetët, edhe marrëdhëniet me një shtet të «botës së tretë» duhet më parë të shikohen me syrin klasor, në mënyrë që të mos pengohen forcat revolucionare dhe përparimtare që luftojnë brenda këtij apo atij vendi; përkundrazi, marrëdhëniet të bëjnë që këto forca të ndihmohen. Por Kina me teorinë e Maos i neglizhon këto, bile lë të kuptohet qartë se nuk dëshiron të priset me udhëheqësit borgjezë, kapitalistë e satrapë të këtyre vendeve që janë kundër popujve të tyre, që janë me ato fuqi të mëdha të cilat u japin më shumë përkrahje e kredi. Kjo s'duhet të jetë kurrë politika e një vendi socialist.

Një politikë e gabuar nga ana e Kinës duket edhe në lidhje me partitë komuniste marksiste-leniniste që janë formuar në botë. Krahas këtyre partive si kërpuha kanë lindur grupime të çdo kallëpi, trockiste, anarkiste, që nga grupet që vepronin nën udhëheqjen e Sartrit dhe deri tek ato të çdo fraksioni borgjez e provokator; dhe Kina na mban lidhje me të gjitha këto pa asnjë dallim. Përfaqësuesit e këtyre ajo i pret e i përcjell, u predikon bashkim me socialdemokratët, propagandim për Kinën e për Maon dhe aleancë me borgjezinë e vendit dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Bashkimit Sovjetik.

Kjo është një politikë armiqësore borgjeze, antimark-siste dhe antirevolucionare prej shteti të madh. Por me Partinë tonë atyre nuk mund t'u shkojnë të tilla aventura të rrezikshme. Kinezët e dinë që ne nuk jemi dakord në vijë me ta dhe këto kundërshtime i themi çdo ditë, duke mbrojtur pikëpamjet e Partisë sonë për çdo problem. Ne nuk dalim hëpërhë hapur kundër tyre, por edhe ata kë-shtu veprojnë, heshtin, flasin ndonjë fjalë të mirë në po-pull për ne, por asgjë nuk botojnë mbi qëndrimet tona, sepse atëherë do t'u dilnin probleme dhe bile të rrezik-shme. Edhe kur botojnë diçka në shtypin e tyre, e shtre-mbërojnë me marifete ala kineze.

Një karakteristikë e përbashkët është se, si në shty-pin kinez, edhe në atë sovjetik nuk gjen artikuj të thellë teorikë për demaskimin e njëri-tjetrit. Artikujt që botoj-në ata, janë bajatë, të përciptë, me slogane pa vlerë, dhe kjo ngjet sepse, po të bëjnë një analizë të thelluar të pro-blemeve, do të demaskojnë blonin e njëri-tjetrit, se që të dyja palët janë shtete dhe parti revizioniste.

Këto mendime për qëndrimet e Kinës dhe pikëpamja jonë që Kina të quhet një vend revizionist në shikim të sipërfaqshëm mund të duken si të çuditshme. Një men-dim i tillë mund të dukej i gabuar dhe joreal, por nuk ka si shpjegohen ndryshe këto drejtime në një varg çësht-jesh të politikës së brendshme dhe të jashtme. Kina është gati të bjerë në ujdi për bisedime, bile të pajtohet në shumë çështje edhe me vendet revizioniste, edhe me partitë revizioniste që deri dje e mbështetnin Bashkimin Sovjetik dhe sot e kritikojnë. Kjo që po them nuk është një supozim, por realitet. Kinezët priten në Pekin Ka-rriljon e Spanjës, biseduan dhe u ndanë me të si miq. Dhe pse jo? Pse nuk u shpall ndonjë komunikatë e kundërt? Me Spanjën e Frankos lidhën marrëdhënie diplomatike, kurse Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste),

anëtarët e së cilës vriten nga falangistët, kinezët as që e përfillin fare.

Kina flet mirë për çdo vend revizionist, mjaft që ky të afrohet me imperializmin amerikan. Ndjaj Polonisë, që po hyn në sferën e kapitalit amerikan, deri dhe ndaj Bullgarisë së Zhivkos, për të mos folur për Rumaninë dhe Jugosllavinë, Kina është e lëvizshme në qëndrime.

Rumania për kinezët është mikja më e shtrenjtë. Pse? Preteksti është se ajo «u reziston sovjetikëve». Kjo «rezistencë» e rumunëve kundër sovjetikëve është një maskë. Rumunët dhe sovjetikët shumë gjëra i kanë të njëjta, e njëjtë është politika e tyre e brendshme, po e njëjtë është edhe e jashtme. Të dyja partitë e tyre janë revizioniste, të dyja shtetet janë kapitaliste, dhe kontra-diktat, në qoftë se kanë, ose janë të pakta, ose janë efe-mere, ose janë fare lojë. Kina as bën dhe as që dëshiron të bëjë ndonjë analizë të kësaj gjendjeje. Për Kinën, Rumania është një «shtet socialist» dhe e mbron si të tillë.

Jugosllavinë, po ashtu, Kina e përkrah politikisht, se ideologjikisht tash për tash hapur s'mund ta përkrahë dot, për arsye se qelbet, bie erë tradhti. Por titizmi nuk është veçse kapitalizmi i gjallë; Jugosllavia titiste udhë-hiqet nga ide anarkiste të vetadministrimit federalist, ku shteti ruhet për nevojat e rastit, ku partinë e komunis-tëve titizmi e likuidoi. Ai e likuidoi partinë dhe gjoja la klasën të vetadministronte, por, në fakt, me këtë favo-rizoi borgjezinë pasanike, të re dhe të vjetër, të bëhej zonjë e Jugosllavisë, të pasurohej dhe ta shiste vendin te të huajt. Në realitet, në Jugosllavi mbretëron kaosi e anarkia, në ekonomi, në politikë e në ideologji. Dhe bo-ta borgjezo-revizioniste e quan Jugosllavinë «socialiste», kurse Titon «njeri të madh», se i rezistoi Stalinit, por me këtë ai u bëri dhe vazhdon t'u bëjë shërbime të mëdha imperializmit amerikan dhe kapitalit të madh botëror.

◦ Në politikën e Kinës ne nuk dënojmë marrëdhëniet diplomatike që ka vendosur ajo me shtete të ndryshme kapitaliste, revizioniste (marrëdhëniet e saj me shtetet fashiste, natyrisht, i dënojmë), por dënojmë vijën jomarksishte që e udhëheq këtë politikë. Ne nuk jemi dakord me qëndrimet joklasore të saj, ose me ato qëndrime kineze që nuk i shërbejnë as revolucionit botëror, as çlirimit nacional të popujve të «botës së tretë». Kina, me qëndrimet e saj politiko-ideologjike, **i bën një dëm të madh socializmit e revolucionit, si dhe luftës çlirimtare të popujve në shkallë botërore.**

◦ Bota kapitaliste e di dhe e njeh këtë shërbim të Kinës. Çdo lëvizje marksiste-leniniste të vërtetë ose turbullirat e studentëve të Kon Beditit e të Tupamarëve, me gjithë ndryshimet që kanë, bota kapitaliste i quan «maoiste» dhe Kina gëzohet për këtë kualifikim, për këtë «nder» që i bën reaksioni botëror. Bile ajo predikon bashkimin e të gjitha këtyre rrymave maoiste, «opozitare», anarkiste, dhe të partive komuniste marksiste-leniniste në një, pa marrë parasysh pikëpamjet diametralisht të kundërta që ekzistojnë midis tyre. **Përveç kësaj, Kina i këshillon që këto parti të bashkëpunojnë me qeveritë borgjeze të vendeve të tyre, të mbështetin ushtritë e tyre borgjeze që shtypin popujt dhe proletariatin. Ato parti marksiste-leniniste të cilat nuk e ndjekin vijën që predikon Kina, kjo i braktis dhe i lufton. Atëherë si mund ta quash këtë vijë marksiste-leniniste? Jo, kjo është një vijë revizioniste.**

◦ Karakteristikë dalluese e revizionizmit modern është «bashkekzistenca paqësore», e parë dhe e zbatuar kjo në prizmin joklasor, jorevolucionar. Një tjetër karakteristikë e tij është rruga paqësore, rruga parlamentare e marrjes së pushtetit «për të shkuar në socializëm». E tillë është vija që predikoi Hrushovi dhe që e predikojnë sot edhe revizionistët sovjetikë, e tillë është vija e revizionistëve

italianë, francezë, spanjollë etj. Kjo është edhe vija, rruga e kinezëve. Dhe ata po këtë rrugë predikojnë. Revolucionit ata i kanë vënë pikën, derisa predikojnë aleancë dhe bashkëpunim me shtetet borgjeze kapitaliste dhe me gjithë institucionet e tyre, në mes të të cilave edhe me parlamentin borgjez. Ky është realiteti, në teori dhe në praktikë, pavarësisht se teorikisht kinezët s'e pohojnë këtë. As sovjetikët nuk i pohojnë krimet e tyre: bashkekzistencën paqësore hrushoviane e quajnë «leniniste» dhe rrugën parlamentare të marrjes së pushtetit nuk harrojnë kurrë ta shoqërojnë me atë që ka thënë Lenini, se «ka mundësi të merret pushteti edhe me këtë rrugë». Por revizionistët këtë e kanë bërë të vetmen rrugë dhe *de facto* luftojnë rrugën tjetër, rrugën me armë, me dhunë, rrugën e revolucionit dhe vendosjen e socializmit të vërtetë.

Fidel Kastroja po trumbeton se «ushtria është partia». Revizionistët modernë këtë nuk e thonë hapur, por fakt është se në Kinë ushtria komandon partinë, të cilën Mao Ce Duni «e shpërndau» gjatë Revolucionit Kulturor. Gjatë këtij revolucioni ishte ushtria që mbeti dhe qëndroi si e vetmja «shtyllë» e regjimit: pa parti, pa bashkime profesionale, pa klasë punëtore në fuqi. Kështu ngjau, ky është fakt. Po pse ndodhi kjo? Është fare e qartë: për shkak të një botëkuptimi ideologjik jomarksisht-leninist.

Këtyre problemeve themelore teorike duhet t'u shkohet deri në fund dhe jo përciptas, nuk u duhet besuar fjalëve, por fakteve, dhe këto fakte duhen analizuar në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste. Si mund ta kuptosh gjestin e kinezëve në ditët e fundit të vitit të kaluar, kur liruan helikopterin sovjetik me tre aviatorë brenda, të cilët u mbajtën rob 21 muaj me radhë «pse kishin hyrë 400 km në tokën kineze»? Që i liruan, vepruan mirë, se dy gjëra duheshin bërë: ose të çoheshin

aviatorët sovjetikë në gjyq, ose të liroheshin pas ndonja dy muajsh. Por ç'ngjau? Gjatë 21 muajve ç'nuk u tha në shtyp nga ana e kinezëve për këtë helikopter: «Kjo është vepër kriminale, vepër spiunazhi, provokacion brutal» etj. Zyrtarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e RP të Kinës na është thënë se «aviatorët sovjetikë janë spiunë, helikopteri ishte plot me aparatura spiunazhi, kemi zënë dokumente të rëndësishme»; se «helikopteri kishte zbritur në Sinkiang për të rrëmbyer njerëz» etj. Kurse sovjetikët mbanin tezën se helikopteri kishte humbur rrugën. Mirëpo, pas 21 muajve, edhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Kinës deklaroi ndryshe, sikur helikopteri kishte humbur rrugën, se aviatorët janë të pafajshëm, prandaj lirohen, u jepet edhe një darkë zyrtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe përcillen në «mënyrë solemne» në aerodrom.

Ç'ti thuash këtij qëndrimi? Ç'emër t'i vësh? Kjo nuk mund të kuptohet veçse si diçka që ekziston në prapaskenë. Diçka ka në këtë mes, diçka e qelbur bie erë. Nuk është e papritur për ne që një kthesë e tillë ala kineze të quhet «gjest madhështor politik i Mao Ce Dunit», natyrisht, edhe kthesë «marksiste-leniniste». Mundet që pas kësaj «kthese gjeniale», Çu En Lai ose Ten Hsiao Pini t'i thonë ambasadorit tonë në Pekin: «Hajde të shkojmë në Moskë, ç'prisni, ndërroi situata», se tamam kështu i tha Çu En Lai ambasadorit tonë kur u rrëzua Hrushovi. Hedh ndokush ndonjë fjalë që «parashikohet rënia e Brezhnjev-it» dhe kinezët ëndërrojnë për kthesa e përgatitin plane në fshehtësi, ndoshta në marrëveshje me sovjetikët. Do t'i shohim hiletë revizioniste dhe tradhtarë.

Qëndrimi kinez ndaj Partisë sonë të Punës dhe Shqipërisë socialiste nuk është i sigurtë. Ne deri tani kemi qenë «miqtë më të mirë dhe më besnikë të Kinës dhe të Partisë Komuniste të Kinës». Kjo frymë në Kinë është zhvilluar e shtrirë shumë mirë në bazë, dhe për këtë s'ke-

mi asnjë vërejtje. Por qendra mban qëndrim tjetër. Kurse ne ua kemi shtruar hapur pikëpamjet tona dhe kemi kërkuar të shkëmbejmë delegacione e të zhvillojmë bisedime, por kërkesat tona kanë rënë në vesh të shurdhër. Udhëheqja kineze pa e thënë shprehimisht se nuk është dakord me ne për shumë çështje parimore, në fakt, me këtë qëndrim që mban, lë të kuptohet se nuk është dakord. **Ndihmat ekonomike që ne kërkuam për veprat e periudhës pesëvjeçare 1976-1980, të cilat me siguri do të mbaronin për 6-7 vjet, kinezët na i dhanë shumë të reduktuara.** Ata na dhanë 20-25 për qind të kredive që kërkuam, duke na pritur ftohtë, duke na mbyllur derën për çdo shtesë e duke thënë se «ky është edhe mendimi i Maos». «Jemi shumë të varfër», na thanë, kurse deri dy vjet më parë, pa u bërë asnjë shtesë pohimeve të tyre, bile të vetë Çu En Lai, deklaroi: «Ju ndihmojmë pak, shumë pak, po pas dy-tre vjetësh, në pesëvjeçarin tjetër (domethënë në këtë që kemi hyrë), do t'ju japim më shumë». Mirëpo ngjau krejt e kundërta, dhe me çfarë përbuzje flasin sot, duke na thënë: «Mos kërkonit gjë, se s'pranohet asnjë kërkesë tjetër». Mund ta quajmë këtë presion ekonomik? Mund ta quajmë, bile me plot gojën. Pse mbahen këto qëndrime nga ana e tyre? Sepse s'janë dakord me ne në vijë.

Me një mesazh drejtuar Maos u kërkuam ndihmë ushtarake. Kinezët, këtë radhë, na akorduan një ndihmë qesharake, ata me paturpësi na thanë që «tash mos kërkonit më»! Pse ngjau kjo kthesë? Sepse s'janë dakord me vijën tonë politike, strategjike dhe ideologjike, se duan që ne t'i nënshtrohemi vijës së tyre revizioniste.

Udhëheqësit kinezë na kanë thënë që «të bashkëpunojmë, të lidhemi me Jugosllavinë dhe me Rumaninë», domethënë të bëhemi revizionistë si ata, «të lidhim marrëdhëniet diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës» e të tjera poshtërsira si këto, domethënë të bëjmë

siç bën Kina. Kjo është një tradhti që ne e përbuzim me neveritje dhe këtë vijë ne e luftojmë në një mënyrë a në një tjetër, haptazi e në çdo rast, me shtypin dhe propagandën tonë.

U vërtetua se grupi tradhtar i Beqir Ballukut dhe i Abdyl Këllezit ka qenë për këtë vijë kineze, e cila në realitet është njëkohësisht edhe me vijën sovjetike, jugosllave, rumune, amerikane etj., sepse të gjithë këta duan dhe luftojnë që të likuidohet Partia jonë marksiste-leniniste dhe udhëheqja e saj që mbrojnë marksizëm-leninizmin dhe socializmin në Shqipëri. Udhëheqja revizioniste kineze, pra, mori gjithë këto masa për të na dobësuar. Këto veprime tash për tash nuk janë aq brutale sa ato të Hrushovit, por edhe kinezët në këtë rrugë ecin, duke menduar se do të na e marrin frymën pak nga pak, por... do të na e marrin të keqen!

Jo vetëm kaq, por Mao Ce Duni vepron njëlloj si hrushovianët. Dy-tri mesazhe të rëndësishme i janë dërguar atij në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe me firmën time, kurse ai, nga ana e tij, nuk ka denjuar të na japë përgjigje, të paktën për mirësjellje ose për reciprocitet. Ose s'ka denjuar, ose nuk do që të lërë dokument për problemet që i kemi ngritur. Edhe përgjigjet me gojë, që na janë dhënë nëpërmjet shokëve të tjerë të tij, kanë qenë shumë negative. Një letre zyrtare duhet t'i jepet përgjigje me letër, pozitivisht ose negativisht.

Mënyrat e veprimit të kinezëve janë të papëlqyera dhe, pse të mos e themi, edhe dinake. Për furnizimin me armë, gjithë pjesëtarët e delegacionit kinez, me të cilin u trajtua ky problem, kësaj radhe u sollën në mënyrë shumë të ulët ndaj nesh, ata na i mbyllën të gjitha portat. Dhe kryetari i delegacionit tonë ua shfaqti pakënaqësinë. Në darkën e fundit Jeh Çien Jini, në fjalën e tij, filloi nga përkëdheljet bajate «Do të vini edhe vitin tjetër të shihni dhe të bisedojmë» e të tjera profka të tilla

pa kripë, kurse nga ana tjetër na kishin thënë «nga viti 2 000 do të jemi në gjendje t'ju ndihmojmë».

Këto qëndrime jo vetëm që s'janë miqësore, por ato shkojnë edhe më tej, bëjnë përpjekje të përçajnë kuadrot tanë nga udhëheqja, duke u lënë atyre të kuptojnë se «Ja, ju ju presim shumë mirë, por armë nuk ju japim se s'e kemi mirë me udhëheqjen tuaj». Metoda trockiste!

E ENJTE
8 JANAR 1976*

VDIQ ÇU EN LAI

Sot, në mbrëmje, ambasada jonë në Pekin na njoftoi me radiogram se shoku Çu En Lai vdiq nga kanceri. Këtë lajm asaj ia ka komunikuar në emër të Komitetit Qendror ministri i Jashtëm i Kinës, Çiao Kuan Huaja, që ishte për darkë tek ambasadori ynë. Kur ky e pyeti për shëndetin e Çu En Lait, si duket, për të mos prishur darkën, ku mund edhe të mos kishte vajtur, iu përgjigj se do t'ia thoshte pas buke.

Çu En Lai ishte anëtar i PK të Kinës që me themelimin e saj. Duhet njohur se ai ishte personalitet i një kalibri të lartë, njeri shumë i zgjuar, i zoti, organizator dhe punëtor i madh. Pas Maos, Çu En Lai ishte njeriu më me autoritet në Kinë. Ai ishte njëkohësisht edhe një personalitet i madh ndërkombëtar. Ne e kemi njohur nga afër, kemi biseduar dhe e kemi çmuar zotësinë e tij të madhe në punë, në organizim. Ai ishte bashkëpunëtori më i afërt i Maos, luftonte si «komunist» me flamurin e Maos. Ne e kemi konsideruar si mik të vendit tonë, e kemi respektuar, e kemi pritur dhe kemi biseduar me të shqerisht. Por, duhet thënë se, megjithëqë ai ka kontribuar në ndihmat që Kina i ka dhënë Shqipërisë, ne kemi pasur edhe debate me të, kur nga ana e tij shkelej fryma ideologjike dhe miqësore me ne.

Ka ndodhur shpesh që, me vijën, me qëndrimet e tij dhe të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të

Kinës, ne kemi pasur divergjenca parimore, që shoqërisht ua kemi shprehur, sidomos Çusë, por edhe Komitetit Qendror të PK të Kinës, me gojë dhe me shkrim. Për të gjitha këto pikëpamje, kur Çuja i ka shprehur, ose kur vija e Partisë Komuniste të Kinës nuk pajtohej me vijën e Partisë sonë, unë kam shkruar në momentet përkatëse. Por kontradiktat parimore që kemi pasur me shokët kinëzë në vijë, as ne, as ata nuk i kemi hapur botërisht. Partitë tona qëndruan dhe qëndrojnë në pozitë të tyre respektive. Miqësia në mes dy popujve dhe dy vendeve tona ka vazhduar pothuaj si më parë.

Ne e kemi bërë dhe e bëjmë zemrën të gjerë, por parimet e Partisë sonë as i shkelim dhe as i bëjmë lojë të politikës oportuniste. Unë kam shkruar shumë për Çu En Lain, besoj pa *parti pris*, por termat nuk i kam zbutur, dhe për këtë nuk dua të zgjatem këtu. Vetëm them se, megjithë këto, ai ishte një njeri e një politikan i madh, por jo i bazuar në marksizëm-leninizmin. Çu En Lai ishte «i balancuar», njeri i kompromiseve joparimore, i kompromiseve «të një gjerësie të madhe».

Megjithëse me mendimet dhe me politikën e tij për shumë çështje s'kemi qenë dakord, vdekja e Çu En Lait na hidhëroi shqerisht, sepse Kina humbi një njeri të madh, më të madhin pas Maos, do të thosha, bile jo më pak «efikas» se Maoja vetë, që luante një rol të ndjeshëm në drejtimin dhe në administrimin e punëve të një shteti aq të madh, siç është Kina.

**E MËRKURË
14 JANAR 1976**

NË AMBASADËN KINEZE PËR NGUSHËLLIM

Bashkë me shokët e tjerë të udhëheqjes shkuam në ambasadën kineze për ngushëllime për vdekjen e Çu En Lait.

**E DIEL
18 JANAR 1976**

TU PËRGJIGJEMI SULMEVE TË REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË

Me Ramizin bisedova për t'i dhënë kundërpërgjigje revizionistëve jugosllavë, që kanë filluar një fushatë sulmesh ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, duke akuzuar për «irredentizëm shqiptar», politikë «shqiptaromadhe», për «shtet etatist stalinian», për «informbyroistë stalinianë» etj. Të maskuara i bëjnë ata sulmet, me aluzione do të flasim edhe ne, shkurt e në mënyrë koncize.

PËRGJIGJJA QË U DUHET DHËNË GREKËVE BICIOS DHE KARAJANIS

Thirra ministrin e Punëve të Jashtme dhe i dhashë vijat kryesore të përgjigjeve që duhet t'u jepen grekëve, Bicios dhe Karajanis, në lidhje me akuzat e tyre false se gjoja ne shkelim të drejtat e minoritetit grek.

Natyrisht, në përgjigjen tonë ne u themi: «Nuk ekziston Vorio-Epir», «të drejtat e minoritetit grek mbrohen nga Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, pse ky është vullneti i shtetit socialist shqiptar dhe jo se doni ju (grekët). Ne jemi zotër në shtëpinë tonë» etj.

SHËNIM

Ramizi më raportoi për bisedën që pati me shokët suedezë¹. Pas takimit me shokun Ramiz, ata kanë bërë disa vizita nëpër vendin tonë. Kanë thënë se mësuan shumë nga qëndrimi i tyre në Shqipëri. Kanë thënë, gjithashtu, se janë plotësisht dakord me vijën e Partisë sonë.

¹ Është fjala për delegacionin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Suedisë, të kryesuar nga anëtari i Komitetit Ekzekutiv dhe sekretar i Komitetit Qendror Per Aka Lindblom.

KINEZËT NUK PROPAGANDOJNË VIJËN E DREJTË TË PARTISË SONË

Vëllimi i 19-të i Veprave është shtypur dhe është shpërndarë në shumë gjuhë. Gjithë bota e jashtme, miq dhe armiq të Shqipërisë, flasin për vijën e drejtë dhe për guximin e Partisë sonë në demaskimin dhe në luftën që u bëri revizionistëve hrushovianë, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit e në veçanti për mbrojtjen që i bëri Partisë Komuniste të Kinës. Vetëm në Kinë nuk është folur, nuk po flitet dhe as që ka dalë ndonjë organ shtypi të thotë diçka, të paktën edhe vetëm si njoftim që një vepër e tillë është botuar në Shqipëri.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor botuan tekstin e Projektkushtetutës së re të Republikës Popullore të Shqipërisë. Jashtë, të gjithë kanë folur e po flasin për të dhe po e analizojnë publikisht. **Vetëm në Kinë as që është përmendur fare-fare kjo ngjarje me kaq rëndësi për vendin tonë, ky dokument, me kaq rëndësi politike, ideologjike, organizative dhe konstitucionale, i Partisë sonë dhe i shtetit shqiptar.**

Në shtypin kinez shkruhen gjëra pa vlerë për vendin tonë. Pikësëpari, shtypi atje nuk harron të riprodhojë ç'flitet mirë në vendin tonë për Kinën, kurse lajmet e tjera janë kronika banale: Jo u bë kjo mbledhje, jo u bë ky miting, në këtë foli ai, në këtë foli ky, në Shqipëri vajti ai, nga Shqipëria u largua ky, botohen edhe kronika

sportive. Por asnjëherë nuk përmendet se «në Shqipëri vajti ky ose ai delegacion i kësaj ose i asaj partie komuniste marksiste-leniniste». Deri në këtë shkallë i ka reduktuar Kina marrëdhëniet politiko-ideologjike me vendin tonë! Kjo ndodh në rrugën e shtypit dhe të propagandës, kurse bisedimet politiko-ideologjike midis dy palëve tona janë reduktuar me kohë në zero me xhufkë. As shkëmbimi më i vogël i pikëpamjeve mbi ngjarjet në botë nuk bëhet.

Për sa u përket marrëdhënieve ekonomike dhe ndihmave për ushtrinë, edhe këto u reduktuan në minimumin e minimumeve. Megjithëkëtë, në dukje kinezët blofojnë dhe duan të tregojnë se «Shqipëria është aleatja më besnike» e tyre.

Si duhet t'i kuptojmë në këto qëndrime? T'i shpjegojmë me atë që udhëheqja kineze të jetë informuar me vonesë nga njerëzit e saj? Kjo s'qëndron, sepse s'kemi të bëjmë me gjëra të vogla, por me ngjarje e materiale të rëndësishme të vendit e të Partisë sonë. Pastaj, përveç të dërguarve të HSINHUA-së në Tiranë, çdo javë ka avion Pekin-Tiranë dhe anasjelltas, Kina ka, gjithashtu, edhe ambasadën e saj në Tiranë.

Apo mos kinezët duan kohë sa t'i përkthejnë dhe t'i studiojnë materialet tona? As kjo nuk qëndron, sepse ata kanë një batalion përkthyesish dhe ne nuk kërkojmë që të botojnë ndonjë artikull ose të bëjnë komente për këto ngjarje, por vetëm të japin nga një lajm të thjeshtë, nëpërmjet të cilit opinionin kinez të mësojë se në Shqipëri «dolën këto dokumente». Atëherë përse veprojnë kështu? Ç'po ngjet? S'ka tjetër shpjegim veç këtij: nga ana e kinezëve ka sabotim, ata s'janë dakord me vijën politike të Partisë sonë.

Kinezët flasin «për diktaturën e proletariatit», edhe ne për atë po luftojmë; ata flasin kundër Bashkimit Sovjetik, po vëllimi i 19-të për çfarë bën fjalë? Pastaj çfarë

po bëjmë ne çdo ditë? Atëherë përse nuk japin të paktën thjesht lajmin që dolën në dritë këto dokumente?

Si të kuptohet kjo enigmë kineze? Ata nuk duan t'i bëjnë propagandë vijës së drejtë të Partisë sonë për këto arsye:

- a) Se del qëndrimi fals i tyre;
- b) se ekziston megalomania e partisë së madhe dhe e shtetit të madh;
- c) se s'janë dakord me vijën tonë marksiste-leniniste, si në teori, edhe në praktikë, prandaj, po të propagandojnë vijën e drejtë të Partisë sonë, vetvetiu do të evidentohet ballafaqimi;
- d) se del falsiteti i formulave dhe i sloganeve marksiste të kinezëve;
- e) se ata duan që ne t'u krehim bishtin, të flasim dhe të veprojmë njëllë me ta. Kinezët nuk e pranojnë qëndrimin parimor marksist-leninist të Partisë sonë. Ata duan që ne të bëhemi servilë të tyre. Kjo, natyrisht, nuk do të ngjasë kurrë;
- dh) se atyre nuk u kanë pëlqyer masat e brendshme që morëm ne kundër armiqve të Partisë dhe të shtetit, Beqir Ballukut, Hito Çakos, Petrit Dumes, Abdyl Këllezit e të tjerë. Pse? Deri ku kishin gisht kinezët në komplotin e tyre? Ne një gjë dimë: vija e tradhtarëve të vendit tonë u pëlqente shokëve kinezë;
- e) se kinezët duan të na shkulin nga pozitat marksiste-leniniste, duan që ne të bashkohemi me tradhtarët Tito dhe Çausheku dhe të na hedhin në pellgun revizionist. Natyrisht, ne ua kemi dënuar këto pikëpamje anti-marksiste dhe kapitulluese.

Të gjitha këto i kam bërë shumë herë si pyetje dhe u kam dhënë disa shpjegime. Jam përpjekur të jem objektiv dhe i drejtë në analiza, pavarësisht nga termat shumë të fortë që kam përdorur disa herë. Por mendoj se gjërat duhen quajtur me emrin e tyre.

Duke analizuar faktet për këtë çështje, në enigmën kineze mua më duket se kryesorja që duhet parë është kjo: A është Partia Komuniste e Kinës në rrugë të drejtë marksiste-leniniste? Ka qenë ajo në një rrugë të tillë? Është vallë ajo në rrugën organizative të një partie leniniste, siç na mësojnë Marks, Engelsi dhe Lenini? (Për të mos folur për Stalinin, ndaj të cilit kinezët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kundër. Kinezët flasin pro Stalinin, se s'kanë ç'të bëjnë, se morën një herë qëndrim lidhur me këtë çështje, dhe sa për formë e vënë Stalinin në opozicion me Hrushovin.)

Natyrisht nuk mund të kem pretendimin se e njoh Partinë Komuniste të Kinës në zhvillimin dhe në organizimin e saj. Por mendimi im është se kjo parti hapin e saj të parë nuk e ka pasë hedhur drejt, në rrugën marksiste-leniniste, qoftë në organizim, qoftë në parimet leniniste, qoftë në problemet e ndryshme që i viheshin përpara për të zgjidhur, në revolucionin demokratiko-borgjez apo më vonë në fuzionin me Guomindanin, në luftën civile, në luftën kundër japonezëve, në rolin e klasës punëtore, në rolin e fshatarësisë. Pra, në të gjitha këto probleme të dorës së parë mendoj se partia në Kinë ka ecur në mënyrë kaotike.

Ne konstatojmë se, derisa erdhi Maoja në udhëheqjen e partisë, në organizimin e saj, në ideologji dhe në praktikë, u vërtetuan devijime e fraksione që nga Li Li Sani, Van Mini etj., etj. Natyrisht, edhe në partinë e Leninit ngjanë gjëra të tilla, armiqtë e sulmonin nga brenda dhe nga jashtë Partinë Bolshevike; por Lenini veproi kundër tyre me ideologji të qartë marksiste dhe me dorë të hekurt; ai e kaliti partinë dhe i dha asaj normat e pavdekshme që udhëheqin dhe do të udhëheqin vazhdimisht drejt partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe revolucionin në botë.

Me të ardhur Maoja në fuqi, mendoj se ky vuri disi

rregull, krijoi dhe udhëhoqi ushtrinë dhe luftën, por në organizimin e partisë, në qëndrimet e saj, nuk u vendosën si duhet as parimet bazë, as normat leniniste. Partia Komuniste e Kinës e ngriti emrin e saj, por ajo duhej të kalitej në rrugën e madhe të luftës dhe të pasluftës. Në radhë të parë, pikëpamjet e Maos, të fillimit dhe të tanishmet, mbi hegjemoninë e klasës punëtore dhe mbi aleancën e saj me fshatarësinë nuk përputhen me teorinë marksiste-leniniste. Ato pikëpamje në këtë drejtim janë liberale, pavarësisht nga sloganet, dhe mendoj se këtej e kanë burimin lëkundjet në vijë të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Maos. **Këto, siç na mëson teoria dhe praktika, janë lëkundjet e borgjezisë së vogël, të fshatarësisë.** Fshatarësia luajti me të vërtetë një rol të madh në luftën nacionalçlirimtare si në Kinë, edhe te ne, por në Kinë ajo nuk u udhëhoq nga ideologjia e klasës punëtore si te ne. Në vendin tonë klasa punëtore nuk dominonte, si numër, ajo ishte shumë e vogël, por ideologjia e saj ishte e madhe. Kjo do të thotë se Partia jonë u organizua në baza leninistë dhe e vuri klasën punëtore në pozita hegjemone.

Kurse në Kinë vërtet u formua Partia Komuniste, por dominonte pikëpamja që «fshati të rrethojë qytetin». Këtej, medoemos, do të rridhnin edhe lidhjet e dobëta organizative të partisë, kjo do të vuante nga norma partie gjysmake dhe në radhët e saj me siguri do të lulëzonin, siç lulëzuan, një sërë fraksionesh dhe deviatorësh anti-marksistë, pavarësisht se Li Li Sanët dhe Van Minët u rrëzuan.

Kështu, mendoj unë, Partia Komuniste e Kinës shkoi në luftë e paorganizuar si duhej. Ajo nuk kishte një vijë të qartë dhe nuk mund ta luante rolin e vërtetë të pararojës. Kjo parti u rrit në fraksion dhe vazhdoi me fraksione, herë majtiste, herë djathtiste.

Ushtria dhe lufta i mbulonin këto sëmundje të rre-

zikshme dhe fraksionistët u grumbulluan nën drejtimin e «zotërve të luftës», por që këtë herë ishin komandantë armatash dhe komunistë, ashtu siç i mendonte Partia Komuniste e Kinës. Partia ekzistonte, por ushtria ishte aq e plotfuqishme, sa mund të gjykohej se nuk komandohej nga partia, por ishte ajo që e komandonte partinë. Të gjithë këta komandantë të shquar e trima e quanin veten komunistë, por komunizmin e kuptonin sipas pikëpamjeve dhe orientimeve jo të sakta, të lëkundura të partisë së tyre.

... Udhëheqësit kryesorë, ushtarakë, me Maon në krye, ishin në udhëheqje edhe në kohën e luftës, edhe në atë të pasluftës, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme. Tok me ta, në udhëheqjen e partisë dhe të shtetit të ri, erdhën jo vetëm njerëz që kishin bërë luftë, por edhe të tjerë. Kjo zgjedhje u bë gjoja «në rrugë partie», por, në fakt, secili udhëheqës solli me vete më shumë njerëzit e tij sesa njerëz me frymë partie.

Kina e madhe e dalë nga lufta duhej organizuar edhe si shtet. Po çfarë shteti? Shtet i demokracisë popullore, por flamuri i kuq i tij kishte 4 yje që përfaqësonin katër klasat e shoqërisë kineze (!) dhe një yll tjetër në mes. Hegjemoninë e kujt përfaqësonte ky yll? «Të klasës punëtore», thuhej, por reformat ekonomike, politike dhe organizative që bëheshin nuk ecnin në këtë drejtim, sepse vetë partia nuk ishte monolite, nuk ekzistonte uniteti ideologjik në radhët e saj, por «unitet» rreth Maos. Kapitalistët vazhdonin të rronin në këtë shtet, bile të merrnin edhe renta.

Liu Shao Çia, nën flamurin e Maos, hodhi në dorë pushtetin dhe partinë. Ten Hsiao Pini drejtonte partinë, kurse Çuja shtetin. Maoja ishte strumbullari rreth të cilit luhej vallja. Ushtria ishte në duart e mareshalit Pin De Hua. Ky grup i fuqishëm manovroi si deshi. Flitej për socializmin, por shkohej në revizionizëm.

Pin De Huaja ishte aq i lirë sa ushtrinë e manipuloi në rrugën hrushoviane, duke huajtur prej saj të gjitha tiparet psikike, politike, materiale dhe organizative. Liu me Pin De Huanë dhe me Ten Hsiao Pinin përgatitnin kundërrevolucionin. Pin De Huaja u shkarkua nga Komiteti Qendror dhe vendin e zuri shoku i tij, Lin Biaoja. Reforma të reja krejt të kundërta nga të parat u bënë në ushtri dhe këto bëheshin nga Maoja. Ushtria ishte kurdoherë shtylla, se gjoja e kishte Maoja nën drejtimin e vet. Partinë e kishte Liu Shao Çia, kurse Çu En Lai ishte moderatori oportunist, që kur lindi dhe derisa vdiq. U acarua lufta për pushtet. Po si? Me parulla oportuniste, duke filluar që nga ajo e «njëqind luleve», domethënë e lejimit të të gjitha ideologjive dhe fraksioneve në parti, te «lufta kundër operës dhe universitetit», e gjer te «çdo gjë ta hedhë hapin sipas ushtrisë». Kështu Lin Biaoja u bë «shpëtimtari» i plotfuqishëm. Liu Shao Çia e pa rrezikun dhe u përpoq t'ia ngrinte këmbët Maos, siç ia bëri Brezhnjevi Hrushovit.

Maoja, gjithashtu, e pa rrezikun dhe ngriti atëherë me miliona hunvebinë. Filloi Revolucioni Kulturor pa udhëheqjen e partisë, pa klasën punëtore. Veproji edhe Liu, dolën «rebelët» dhe të tjera organizata. Në Kinë po bëhej anarki, partia qe likuiduar, u likuiduan edhe organizatat e masave dhe filloi atëherë lufta civile midis fraksioneve. Merret, pra, me mend ç'parti komuniste ishte ajo e Kinës! Maoja atëherë i bëri thirrje Lin Biaos, të cilin e mbuloi me tituj, që t'i jepte urdhër ushtrisë të ndërhynte, dhe ushtria ndërhyri. U zhdukën nga ky «Revolucion Kulturor» Liu Shao Çia dhe disa kryesorë si Ten Hsiao Pini. (Se ç'u bë i pari nuk dihet, kurse Teni «u riedukua» dhe tash, si pa gjë të keq, «armiku numër dy» i Kinës ka zënë vendet që kishte më parë.) Lin Biaoja gjatë Revolucionit Kulturor u bë «zot i luftës», ai bënte ligjin; ai botoi dhe përhap «librin e kuq», «biblën» mao-

iste; ai bënte pafkat me portretin e Maos, kurse Çen Po Taja fjalimet. Ushtria dominonte mbi partinë dhe pushtetin, u krijuan «komitetet revolucionare», që bënë siç thoshte Lin Biaoja. Ky bënte petulla për vete, «përgatitej ta hidhte në erë Maon dhe ta lidhte Kinën me Bashkimin Sovjetik», siç thuhet. Maoja manovroi, ia ngriti këmbët Lin Biaos dhe bashkë me Çunë i kthyen antenat nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Tregu i Përbashkët Evropian, nga «Evropa e Bashkuar», nga Françoja e Pinoçeti dhe e deklaruan Kinën pjesëtare të «botës së tretë» tok me Spanjën, Egjiptin, Kilin, Jugosllavinë, Turqinë etj., etj.

Ç'mund të nxjerrim nga një radhitje jo shumë e plotë, e shkurtër, e këtyre ngjarjeve që kanë ndodhur në Partinë Komuniste të Kinës?

Udhëheqja e saj thotë se në Partinë Komuniste të Kinës ka dy vija. Ajo e pranon këtë ekzistencë dhe e vë, më duket mua, si kusht për ekzistencën e partisë, dhe këtë e quajnë lufta e klasave në parti. Mirëpo unë mendoj se nuk ka vetëm dy vija në këtë parti, por shumë vija, që përplasen njëra kundër tjetrës për të marrë fuqinë. Partia është në një kaos dhe nuk zhvillon një luftë klase mbi parime të shëndosha revolucionare marksist-leniniste, ose më mirë të themi se partia nuk zhvillon aspak luftë klase, por në të bëhet luftë klanesh. Klanet janë në parti dhe në pushtet, në bazë dhe në udhëheqje. Të gjithë partizanët e fraksionistëve, që gjoja janë dënuar, gjenden brenda në parti dhe veprojnë. I gjithë ky zhvillim është kryer dhe po kryhet nën emrin e Maos, i cili po bëhet tabu, mësohen citate të tij, por nën rrogos çdo fraksion bën punën e vet. Maoja vetë, në mos «njëqind lulet», lejon «dy lulet». «Le të jenë dhe le të bashkëjetojnë të dy ose tri fraksionet, pastaj bëjmë nga një revolucion në çdo 7 vjet, — thotë ai, — dhe shohim se kush do të fitojë. Në qoftë se do të fitojnë të djathtët, të

majtët do të ngrihen dhe do t'i rrëzojnë». Kjo është «teoria e ndritur e Maos»!! Dhe në fakt kështu ka ngjarë. Që kur erdhi Maoja në udhëheqje të Partisë Komuniste të Kinës, Li Li Sani u rrëzua, u ngrit Van Mini, u rrëzua, u ngrit Liu Shao Çia, u rrëzua, u ngrit Lin Biaoja, edhe ky u rrëzua, vetëm Çu En Lai vdiq duke qëndruar në fuqi. Po tash si do të vejë puna? Ja, në këtë rrugë vazhdon ta ndërtojë Maoja punën. Tash kryeministër s'ka në Kinë, funksionet e kryetarit të qeverisë i kryen Teni, i cili është edhe shef i shtabit të përgjithshëm. Po ne e dimë kush është ky. Si drejtor politik përballë Tenit qëndron Çan Çun Çiaoja, dhe në vend të ministrit të Mbrojtjes, se s'ka akoma, është një plak që anon më shumë nga rryma e Çu En Lai, kurse në ekonomi në krye, pa qenë në krye, qëndron Li Hsien Nieni, njeriu më besnik i Çusë, i Tenit, i Lin Biaos, i Maos, i të gjithëve, por kurrë i marksizëm-leninizmit.

Kjo është gjendja në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës, pa lëre pastaj gjendjen poshtë. Atje ka «të majtë», ka «të djathtë», ka «të moderuar», ka çfarë të duash. Të gjithë bëjnë sikur ndjekin vijën e Maos dhe në fakt janë të detyruar ta ndjekin, se kanë frikë nga grushtet që mund të hanë gjatë luftës fraksioniste, po kjo, në mos tash shpejt, kur të vdesë Maoja, do të pëlçasë. Tash kanë filluar skaramushet: jo ministri i Arsimit është revizionist, jo ai nuk është në rregull etj. Fushata kundër Liut është ulur, tash në rend të ditës është vënë fushata kundër Lin Biaos dhe Konfucit. Deri kur do të vazhdojë kjo? Po ulet? U botuan dy vjersha të Maos dhe u bë bujë e madhe për to. Ç'del nga këto vjersha-parabola? Asgjë s'po merret vesh. Vazhdohet, sipas zakonit, të flitet me dorashka dhe duhet të vijnë eksezhetë¹ t'i interpretojnë, siç bëri Lin Biaoja në kohën e tij.

¹ Exégète (frëngjisht) — komentues, interpret.

Shkruhet një artikull jo i keq mbi diktaturën e proletariatit, vazhdon daullja kundër revizionistëve sovjetikë, dhe, nga ana tjetër, mbështetet politika imperialiste amerikane. Vihet pyetja: Kush dominon në këtë mes? Të majtët: Çian Çini, Çan Çun Çiaoja, Van Hun Veni dhe Jao Ven Juani, apo të djathtët me Tenin e bandën e tij, apo të moderuarit, oportunistët, revizionistët si Çuja me rrethin e tij? As që mund të përcaktosh dot gjë me saktësi. Kina ecën «për inerci»; thuhet se po forcohet ekonomikisht dhe ushtarakisht, por ideologjikisht dhe politikisht nuk mund të themi se po ecën drejt. Populli kinez është trim, i zgjuar, punëtor, por politikisht dhe ideologjikisht nuk po udhëhiqet në rrugë të drejtë.

Thonë se të majtët dominojnë në udhëheqje, por në politikën e Partisë dhe të shtetit nuk shohim asnjë ndryshim të dukshëm. Thuhet se njerëzit e Lin Biaos janë të shumtë dhe kjo mund të jetë e vërtetë; thonë, gjithashtu, se Çu En Lai s'kishte shumë mbështetje veç asaj të Maos. Flitet se po marrin fuqinë njerëzit e Tenit, të tjerë thonë se po marrin ata të Linit, po kujt t'i besosh e kujt të mos i besosh? Çdo gjë duhet ta përcaktosh nga politika, nga ideologjia, nga veprimet e tyre. Pikërisht këto janë enigma, gjëra jo të qarta, si të njerit dhe të tjetrit.

Ç'tregon kjo? Sipas mendimit tim kjo tregon se **Partia Komuniste e Kinës nuk ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste, brenda saj ka rryma, ka fraksione, ka lëkundje, se në të s'ka stabilitet, sepse s'ka unitet marksist-leninist në mendime dhe në veprime.** Partia nuk është efektivisht në komandë; ushtria ecën, por ajo nuk është nën komandën e partisë; ekonomia ecën, por, gjithashtu, jo nën komandën e partisë; politikë bëhet, por jo e drejtuar nga partia dhe jo në rrugën marksiste-leniniste.

Njerëzit, grupet, fraksionet që punojnë nën ombrellën e emrit të Maos, drejtojnë, përplasen e ç'thonë sot nuk thonë nesër. E ardhmja, pra, e nesërmja e Kinës nuk dihet. Ku shkon, ku do të shkojë dhe si do të shkojë Kina? Kjo s'dihet. Në këto situata, siç e kam thënë edhe herë të tjera, kjo gjendje është me rrezik për revolucionin, për paqen botërore, për socializmin.

Qëndrimet e Kinës ndaj Partisë sonë dhe Republikës sonë Popullore shpjegohen. Ne nuk lëvizim nga pozitat tona të drejta, se udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi. Kurse qëndrimet e kinezëve ndaj nesh janë të lëkundshme. Baza në Kinë na do, ajo flet mirë, kurse udhëheqja e ka me hope; dikur fliste mirë, pastaj s'fliste fare, tash ia ka dhënë lumit. Kuptohet dhe shpjegohet se **këto qëndrime ndaj nesh nuk janë parimore, nuk janë marksiste-leniniste.**

Mund të ndryshojnë udhëheqësit kinezë? Mund të kemi më vonë «kohë të mirë»? Çdo gjë mund të ndodhë me kinezët. Ne jemi vigjilentë dhe mbrojmë Partinë tonë, vijën e saj marksiste-leniniste dhe Republikën. Ne punojmë dhe do të punojmë për revolucionin.

E PREMTE
23 JANAR 1976*

HEZITIM PËR ZËVENDËSIMIN E ÇU EN LAIT!

Për vdekjen e Çu En Lait, siç po lexojmë, popullit kinez i erdhi shumë keq dhe trishtimi i tij ishte i madh. Dhe kishte arsye, se për të Çuja, pas Mao Ce Dunit, ishte njeriu më i shquar, më punëtori, më organizatori dhe burrë shteti i zgjuar.

Kaluan kaq ditë pas vdekjes së Çu En Lait, por ne nuk po shohim të caktohet një kryeministër i ri. Kina, mendoj unë, pas kësaj tronditjeje shpirtërore nuk duhet të qëndrojë pa udhëheqës të organit të lartë ekzekutiv. Kina është një vend i madh me punë të shumta dhe të koklavitura, që duhen zgjidhur. Natyrisht, udhëheqja në vendet socialiste është një udhëheqje kolegjiale. Kjo është edhe për Kinën, por, meqë në udhëheqjen e Partisë atje janë vërtetuar mjaft ngjarje, nuk duhet ngurruar dhe nuk duhet lejuar zhvillimi i fraksioneve, sepse, parësisht që thuhet dhe shkruhet se nuk ka fraksione, fryma, rryma dhe njerëzit e Liu Shao Çisë ekzistojnë, rrojnë, punojnë dhe janë në funksione si të rehabilituar dhe, medoemos, intrigojnë e, po të mundin, do të përpiqen të marrin fuqinë.

Fryma, rryma dhe njerëzit e Lin Biaos dhe të Çen Po Tasë ekzistojnë, rrojnë, punojnë, janë në funksione si të rehabilituar ose si «të papërlyer» dhe, medoemos, intrigojnë e përpiqen, gjithashtu, të marrin fuqinë, po të mundin.

Ekzistojnë edhe elementë «të moderuar», «diplomatë», siç ishte Çuja, që mbështetjesh te Maoja dhe lëvizte sa andej-këtej. Njerëz me pikëpamje si të Çusë ka sa të duash si në udhëheqje, ashtu edhe në bazë.

Më në fund, në parti dhe në pushtet duhet të ketë dhe marksistë-leninistë që u takon të drejtojnë, të forcojnë dhe të kalitin Partinë Komuniste të Kinës, diktaturën e proletariatisht dhe të vazhdojnë me konsekuencë luftën e klasave.

Mirëpo, siç po duket, po ngurrohet për të caktuar një kryeministër. Pse? Është ky ngurrim për çështje procedurale apo ka luftë fraksionesh? Kjo e dyta është e rrezikshme dhe sa më shpejt të zgjidhet drejt, në rrugën marksiste-leniniste, aq më mirë do të jetë për Kinën. Në Kinë kemi parë edhe një praktikë të tillë: në Revolucionin Kulturor qeveria drejtonte pa ministra, vetëm me zëvendësministra. Edhe tash mund të udhëhiqet pa kryeministër, por me zëvendëskryeministra dhe me Ten Hsiao Pinin si zëvendëskryeministër të parë. Janë taktikat e Mabs: provo, shiko, koha pret, pastaj vendos cili fraksion të dominojë, ose cilin fraksion duhet të shfuqizosh me një tjetër. Një vijë e tillë s'ka kontinuitet, s'ka qëndrueshmëri, përdërisa ajo varet nga personi, pavarësisht se quhet kolegjiale dhe parimisht ekziston centralizmi demokratik. Do të presim dhe do të shohim si do të zhvillohen ngjarjet.

E HËNË
26 JANAR 1976

PËRGJIGJE E FORTË REVIZIONISTËVE JUGOSLLAVË

Shokët kosovarë, anëtarë të kooperativës bujqësore të Rrashbullit, më kanë drejtuar një letër shumë të ngrohtë me rastin e vdekjes së Qerim Mukës. Letra e tyre ka një kuptim të lartë politik dhe flet për vendosmërinë, për dashurinë dhe besnikërinë e kosovarëve që jetojnë te ne, ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe atdheut të tyre, Shqipërisë socialiste. Por indirekt, me këtë letër, ata u drejtohen vëllezërve kosovarë që rrojnë nën zgjedhën titiste.

Edhe me këtë letër, të cilën, u thashë shokëve që të botohet në shtyp, tërthorazi po u japim përgjigjen flakë për flakë titistëve dhe lakenjve të tyre shqiptarë në Kosovë, të cilët kanë rifilluar persekutimin, dënimin dhe burgosjen e shqiptarëve të Kosovës, duke u vënë këtyre epitete të tilla si «irredentistë», «informbyroistë», «stalinianë», «partizanë të shtetit etatist stalinian» etj.

E ENJTE
29 JANAR 1976*

KINEZËT PO ECIN DREJT BLOKADËS KUNDËR SHQIPËRISË

Personi kryesor ndër specialistët kinezë në Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit ka filluar të bëjë disa vërejtje me qëllim të keq, pa baza dhe që bien erë provokacion. Ai shkoi te drejtori i kombinatit dhe te sekretari i Partisë dhe u tha afërsisht: «Njerëzit tuaj poshtë në filan e filan ndërmarrje u thonë shokëve tanë (kinezëve) që «ju mund të largoheni, pse ne (shqiptarët) s'kemi më nevojë për ju; ju (kinezët) jeni të tepërt», prandaj edhe ne i larguam disa. Mirë duhet të jetë, vazhdoi ai, që të ketë më pak specialistë kinezë, por të mirë, sesa shumë e për lumë. Ne jemi vëllezër, prandaj vini rregull poshtë» etj.

Njerëzit tanë, natyrisht, hapën sytë, u çuditën dhe i thanë shokut kinez: «Ç'janë këto që na thoni? Ne këtu kemi shumë nevojë për ju, bile jo vetëm për këta që janë, por edhe për të tjerë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të largohen shokët kinezë dhe, në rast se ju doni të hiqni ndonjë, vendosni vetë, duke na lajmëruar dhe ne. Por, ju lutemi, na thoni cilët janë këta njerëz nga tanët që kanë bërë një gjë të tillë, pa lejen tonë?».

Kinezi iu përgjigj: «Ne nuk mund t'jua themi emrat, se ju merrni masa dhe i dënoni», bile më poshtë shtoi se «ai njeri (shqiptari) ia ka dhënë njërit prej tanëve edhe me letër këtë mendim, që ky (kinezi) mund të ikë».

Tanët i thanë: «Kjo, që ju s'doni të na i thoni emrat e njerëzve tanë, që s'na jepni as letrën, na çudit. Atëherë ç'të bëjmë ne? Si ta zgjidhim këtë enigmë?».

— Merrni masa poshtë, — shtoi ai.

— Por kundër kujt, kur ne nuk e dimë cilët janë fajtorët? Pastaj si mund të bazoheni ju në një ose në dy njerëz, që mund të jenë edhe provokatorë, që kërkojnë të mbjellin mjegull në mes nesh? Për këto çështje, kur të ketë probleme për të zgjidhur, mendojmë se ju duhet të vini t'i bisedoni me ne, drejtuesit, dhe ne me ju.

Në fakt ky është një provokim që na bëhet për t'i dhënë armë të paqena atij fraksioni në Pekin që nuk na e do të mirën dhe përpiqet të gjejë arsye të fabrikuara për të ngadalësuar apo për të frenuar punimet dhe realizimet e veprave në vendin tonë. Provokime të tilla s'janë personale, por me siguri të komanduara. Këto janë presione ekonomike, për të dalë pastaj edhe në presione politike, para Kongresit tonë të 7-të. Ne i kuptojmë mirë veprime të tilla, sepse na i kanë bërë edhe të tjerë më parë. Edhe tash, fraksioni i djathtë në Pekin po «lëshon brezin» që ne ta shkelim, dhe të na akuzojnë pastaj se e filluam ne sulmin.

Prandaj i këshillova shokët të mbajnë gjakftohtësinë në bisedat me ta. U thashë që të vejë në kombinat zëvendësministri i Ndërtimit, të bisedojë «shoqërisht e vëllazërisht», siç kanë qejf të thonë kinezët. Më parë i këshillova të pyesin drejtorin dhe sekretarin e Partisë të atyre ndërmarrjeve në kombinat nga të cilat janë larguar kinezët. Shokët e bënë edhe këtë, dhe të gjithë njerëzit tanë atje u përgjigjën se «vetë kinezët kanë ardhur dhe na kanë thënë se do të ikë filani ose filani» dhe ne u jemi përgjigjur «në asnjë mënyrë nuk duhet të largohen, ne kemi shumë nevojë për ta; prandaj ju lutemi merrni masa të mos largohen».

Duket qartë se kjo është një punë e kurdisur me qëllim. Po diçka tjetër shumë më të rëndë po bëjnë ata në Pekin. Një nga punonjësit kinezë të Ministrisë së Industrisë i thotë atasheut tonë tregtar në Kinë që fabrikën e nikel-kobaltit, që e kemi me kontratë të fillojë dhe të mbarojë në një fazë, «ta bëjmë me dy faza».

Tjetër provokacion i madh ky, që do të shohim ç'rrjedhime do të ketë, se ne do të ngulim këmbë të zbatohet kontrata.

Rafineria e Ballshit mbaroi, vetëm duhej të vinin dy-tre kompresorë, të cilëve u ka kaluar afati i livrimit.

— I kemi në eksperiment, — na thonë.

— Po sa do të presim, kur do të përfundojë eksperimenti? Po sikur të na i bleni në Gjermaninë Perëndimore? — u kemi kërkuar ne.

— Jo, s'kemi devizë, — na përgjigjen kinezët.

— Po e japim ne atë devizë, se nuk është ndonjë gjë e madhe, — u themi ne. Por as këtë s'e pranojnë ata.

Ç'janë këto?! Për ne është e qartë. Këto janë sabotime, presione. Kinezët po ecin drejt bllokadës kundër Shqipërisë. Ne do të bëjmë kujdes, se ata duan të na e hedhin neve fajin.

E DIEL
1 SHKURT 1976

SHËNIM

Më njoftuan se kinezët kanë kërkuar që nga mesi i vitit të vijë te ne ansambli i ushtrisë së tyre dhe, po këtë vit, të vejë atje edhe ansambli ynë. Bisedova për këtë me shokët dhe vendosëm t'u përgjigjemi duke u thënë se parimisht jemi dakord me propozimin e tyre, por vizita të bëhet vitin e ardhshëm e jo sivjet, sepse po përgatitemi për Kongresin e Partisë. Propozimet e tepërta që bëjnë tanët për ardhjen dhe për dërgimin e skuadrave të ndryshme sportive, nuk i pranuan.

TË DEMASKOJMË PIKËPAMJET LIKUIDATORE TË REVIZIONISTËVE

Me Ramizin bisedova që të na sigurohet një kopje e fjalimit të Berlinguerit, botuar në gazetën «Unita», me qëllim që të demaskojmë pikëpamjet e tij revizioniste.

Flitet se edhe Marsheja i Partisë Komuniste Franceze ka deklaruar në radio se partisë së tij, për të shkuar në socializëm, s'ka ç'i duhet më diktatura e proletariatit. Me siguri ky qëndrim do të jetë edhe tezë e Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste revizioniste Franceze. Duhet ta marrim këtë fjalim dhe ta demaskojmë edhe këtë lake revizionist.

ÇËSHTJET ME RËNDËSI POLITIKO-IDEOLOGJIKE NDËRKOMBËTARE DUHEN ZBËRTHYER NË MËNYRË TË POSAÇME PËR BAZËN E PARTISË

Është e vërtetë se për problemet ndërkombëtare organizatat-bazë të Partisë marrin dijeni nëpërmjet shtypit të përditshëm, por ka disa çështje të rëndësishme politike dhe ideologjike, që duhet t'u zërthehen shokëve në mënyrë të posaçme. Për shembull, intervistës së fundit të Titos, të 1 shkurtit, për nevojat e kuadrove e të anëtarëve të partisë, i duhet bërë interpretim, sepse në këtë intervistë vetë Titoja demaskon vetveten dhe bashkë me këtë, edhe regjimin e tij. Këtë herë këtë gjë do ta bëj vetë, por e drejta është se ajo është detyrë e shokëve të agjitpropit¹.

¹ Shih në këtë vëllim f. 265.

DJERSË TË FTOHTA KORRESPONDENTIT TË HSINHUA-SË

Ramizi e plotësoi detyrën që i ngarkova, Xhelil Gjoni, kryeredaktor i «Zërit të popullit», korrespondentit të HSINHUA-së, i cili asistonte në konferencën mbi Kushtetutën dhe e solli vetë problemin «mbi tryezë», i tha:

«Kur gjithë bota flet dhe komenton Projekt Kushtetutën tonë, si është e mundur që shtypi kinez nuk e zë në gojë fare këtë ngjarje, kurse vetëm gazeta jonë, «Zëri i popullit», ka shkruar pesë artikuj të mëdhenj për kushtetutën tuaj, kemi botuar fjalimin e Çan Çun Çiaos etj.? Kjo na habit shumë. (Kinezit i rridhnin djersët çurkë, ai skuqej dhe zverdhej.) Po për vëllimin e 19-të të Veprave të shokut Enver, për të cilin kanë shkruar të gjitha gazetatat e mëdha të botës, përse shtypi kinez e ka injoruar krejtësisht? Në këtë vëllim flitet për luftën e madhe që Partia jonë dhe juaja kanë bërë kundër hrushovianëve. Personalisht (i tha Xhelili) mua më vjen keq dhe një qëndrim të tillë të shtypit kinez s'e gjej miqësor. Ne flasim si kolegë gazetarë».

«Kolegu» kinez s'e hapi gojën fare dhe u zhduk nga salla e konferencës.

INTERVISTË VETËDEMASKUESE E TITOS

Shënime

Më 2 shkurt agjencia jugosllave Tanjug transmetoi intervistën që Titoja i ka dhënë gazetares së «Vjestnikut» të Zagrebit, Dara Janekoviç. Dialogu Tito-Janekoviç vërteton drejtësinë dhe saktësinë e parashikimeve të Partisë sonë për rrugën e zhvillimit të Jugosllavisë titiste. Po hedh, në formë shënimesh, në Ditarin tim Politik, mendimet që më lindën pas leximit të kësaj interviste.

Që kur revizionisti modern dhe agjenti i borgjezisë e i kapitalizmit botëror, renegati Tito, tradhtoi komunizmin, Partia jonë e ndoqi këmba-këmbës veprimtarinë e klikës së tij dhe e demaskoi atë pa mëshirë. Ajo bëri analiza të ndryshme në të gjitha kohët dhe në të gjithë sektorët e brendshëm e të jashtëm ku vepron kjo klikë dhe vërtetoi, në mënyrë marksiste-leniniste, se rryma revizioniste jugosllave ishte vënë në shërbim të plotë të imperializmit amerikan dhe të kapitalit botëror. Kjo bandë, me Titon në krye, i vuri detyrë vetes të shkatërronte socializmin në Jugosllavi, të shkelte mbi gjakun dhe djersën e popujve të këtij vendi, të ndryshonte orientimet marksiste-leniniste të ish-Partisë Komuniste të Jugosllavisë, ta lidhte vendin e vet me kapitalin perëndimor, Partinë Komuniste të Jugosllavisë ta shndërronte në një parti borgjeze dhe vendin ta shiste te kapitali i huaj. E gjithë kjo analizë e drejtë e Partisë sonë u vërtetua nga jeta.

Kjo rrymë antimarksiste, revizioniste mori përpjesëtime të përbindshme me marrjen e fuqisë nga revizionistët e tjerë modernë hrushovianë në Bashkimin Sovjetik, të cilët u solidarizuan me Titon për të luftuar socializmin shkencor, ideologjinë marksiste-leniniste dhe ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe kudo ku ishte e mundur për ta që ta bënin këtë gjë.

Pamja e Jugosllavisë sot ka ndryshuar qind për qind nga ajo e viteve të para pas çlirimit, kur lidhjet e klikës së Titos, që edhe në atë kohë qenë maskuar me «ideologjinë marksiste-leniniste» e me «miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore», pengonin të shiheshin shtrembërimet e theksuara dhe veprimet e dënueshme armiqësore në drejtim të politikës së brendshme të Jugosllavisë, si dhe kundër vendeve të demokracisë popullore e, në veçanti, kundër vendit tonë. Fryma e gjithë këtij fillimi të maskuar i jepte mundësi kësaj bande të fshihte fytyrën e saj përpara popujve të tjerë që ajo synonte t'i shfrytëzonte politikisht dhe ekonomikisht, t'ua nënshtrohte urdhrave dhe diktatit të saj, për të shkuar drejt degjenerimit ku shkoi vetë.

Është shumë mirë që për gjithë këtë degjenerim të brendshëm e të jashtëm të partisë dhe të pushtetit në Jugosllavi dëgjojmë sot edhe nga vetë shkaktari i kësaj katastrofe, renegati Tito, me intervistën që më 1 shkurt 1976 i dha gazetares së «Vjestnikut» të Zagrebit, Dara Janekoviçit. Kjo intervistë ka një karakteristikë të veçantë. Gazetarja në fjalë, me një sërë pyetjesh që i ka drejtuar Titos, e karfos këtë në murin e tradhtisë. Dhe Titoja është i detyruar t'u përgjigjet pyetjeve të saj, ku drejtpërdrejt, se nuk ka si bën ndryshe, ku tërthorazi. Ai herë përpigjet të minimizojë fajet, herë të japë shpresë se «çdo gjë do të ndreqet».

Karakteristikë kryesore e regjimit të renegatit Tito

është se jo vetëm kemi të bëjmë me një regjim tipik kapitalist, por edhe me një regjim kapitalist anarkist. Atë që nuk e vunë dot në zbatim në kohën e tyre dhe në vende të ndryshme Prudonët dhe Bakuninët, e vuri Titoja në Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore. Në shtetin federativ anarkist të Jugosllavisë lulëzojnë sot të gjitha llojet e krimeve, bile atje mungojnë edhe ligjet kryesore të këtij lloj shteti jugosllav, siç e pohon vetë me gojën e tij Titoja.

Në pyetjet që i bën gazetarja Titos në lidhje me vendimet që ka marrë Kongresi i 10-të i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë për të evituar katastrofën përfundimtare dhe krimbjen përfundimtare të regjimit të federatës, Titoja pohon se «**veprimtaria nacionaliste rrezikonte fitoret e revolucionit, rrezikonte jo vetëm shtetin, por edhe partinë**».

Këtë analizë Partia jonë e ka bërë me kohë. Ne parashikuam se revizionizmi do të ngjallte në Jugosllavi, ashtu si edhe në Bashkimin Sovjetik, ndjenjat e shovinizmit të shtetit më të madh brenda Federatës Jugosllave e të kombësive të tjera. Kjo jo për arsye të një apo dy njerëzve, por për arsye të ideologjisë kapitalisto-revizioniste, pse kapitalizmi popujt i shtyp, i shfrytëzon dhe sundon mbi ta me kërbaç. Vetë federalizmi anarkist dhe «struktura e re» që vendosi klika e Titos, vetadministrimi, e krijuan dhe e nxitën këtë konflikt në mes kombësive, në mes republikave. Nuk ka asnjë dyshim se kjo gjendje rrodhi nga ajo ideologji antimarksiste që mbretëronte në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, «**e cila e humbi krejtësisht rolin drejtues dhe edukues**», ajo nuk ishte më një udhëheqje, pse banda e Titos e shkurorëzoi nga ky rol.

Mirëpo Titoja, si antimarksist e që përpigjet të fshehë rolin e tij minues, nuk i shpjegon arsyet politike, ideologjike dhe organizative, të cilat u shkaktuan këto fat-

keqësi popujve të Jugosllavisë. Ai ka menduar dhe mendon se «**uniteti i shtetit socialist jugosllav**» arrihet duke mbajtur fjalime të çmendura, të paqëndrueshme, të gënjeshtërtë dhe të mbështetura në një ideologji antimarksiste. Prirjet centrifugale Titoja i shpjegon me atë se «ekzistonte një synim i fuqishëm i udhëheqjeve të disa republikave që të shkëputen sa më shumë nga udhëheqja më e lartë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë». Mirëpo ai lë në heshtje faktin se kjo shkëputje ishte e natyrshme, pse vetë grupi renegat, me Titon në krye, e dobësoi derisa e zhduku centralizmin demokratik. Për titizmin centralizmi demokratik ekziston në bredhjet e Titos nëpër botë, në bërjen e një politike «të madhe» të përgjithshme të federatës, kuptohet në shërbim të imperializmit amerikan dhe për të siguruar me këtë punë prej spiuni të ardhura në kredi.

Vetë Titoja për këtë çështje pohon: «**Centralizmi demokratik ishte likuiduar pothuaj plotësisht nga fjalori i komunistëve**» dhe vazhdon: «**Në një republikë udhëheqja e partisë ishte zhytur gjithnjë e më shumë në baltën e nacionalizmit**». Kjo republikë, kuptohet, ishte Kroacia, udhëheqjes së të cilës ai i ka vënë etiketën «**nacionaliste-shoviniste**». Edhe udhëheqjen serbe kështu e cilëson ai, por jo me atë forcë që bën për kroatët. Sidoqoftë aty-aty jemi për të gjitha republikat dhe kjo i përket gjithë sistemit që Titoja ka ndërtuar për të likuiduar socializmin dhe për të luftuar marksizëm-leninizmin.

Në intervistë, duke iu përgjigjur gazetares Janekoviç për Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja thotë: «Ne kemi akoma një numër çështjesh të rëndësishme, të cilat një numër jo i vogël i komunistëve nuk i kuptojnë. Në radhë të parë ne vetë, Lidhja e Komunistëve duhet të punojë në mënyrë më të organizuar dhe sistematikisht me qëllim që çdo anëtar i Lidhjes të kuptojë si duhet të

sillet dhe të veprojë, me fjalë të tjera, të kuptojë rolin e tij».

Ja, deri në këtë gradë e ka katandisur klika renegate e Titos Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, duke e kthyer në një organizatë amorfe, apolitike ose, më mirë të themi, e ka mësuar të ndjekë një politikë shkatërruese për jetën e popujve të Jugosllavisë.

Titoja pohon se «Anëtarët e Lidhjes së Komunistëve duhet të jenë të disiplinuar, të ndërtojnë etikën e rendit të ri socialist vetadministrues, të cilën po e krijojmë dhe të mos lejojnë të myken nga psikologjia konsumatore mikroborgjeze dhe të vrapojnë pas dinarit». Vetëm këto fjalë nxjerrin në shesh degjenerimin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Duke iu përgjigjur gazetares Janekoviç lidhur me krizat e mëdha përpara të cilave ndodhet Jugosllavia, Titoja është i detyruar të pohojë se «ato nuk kanë ardhur nga poshtë, nga baza, por nga lart». Ai detyrohet kështu të njohë fajet e udhëheqjes, por, natyrisht, jo fajet e tij. Në çdo fjalim, kur ndërmer ndonjë kritikë, Titoja nuk mungon të thotë «**e kam thënë këtë**» dhe intervista që i jep Janekoviçit, e ka këtë qëllim.

Titoja e shikon qartë katastrofën që kërcënon Jugosllavinë, por kjo katastrofë është kryesisht vepër e tij. Në një vend të intervistës ai thotë: «Prej kohësh dëgjohen dërdëllisje për atë se ç'do të ndodhë në Jugosllavi pas meje (Titos)». Ai vetë e di se ç'do të bëhet. Jugosllavia është e shkatërruar që tani që Titoja është gjallë, por ky, me këtë «**autokritikë**», zë qoshet dhe kërkon t'u thotë atyre që do ta gjykojnë e do ta dënojnë pas vdekjes për atë që ka bërë se «**ja, unë e kam thënë, kam bërë thirrje që të rikthehemi tek e kaluara**».

Titoja hiqet si teoricien, por është tamam një teoricien i revizionizmit modern, një sabotator i normave marksiste-leniniste, ai është një lumpen, me kostume të qëndisura me ar, një idealist. Në intervistën dhënë Ja-

nekoviçit Titoja thotë: «Anëtarët e Lidhjes së Komunistëve duhet t'i ndreqin të gjitha gabimet me autokritikë». Vetë fjala «autokritikë» tingëllon si marksiste, prandaj ai e përdor, por në regjimin aktual jugosllav, në fakt, është në fuqi shprehja e urtë e popullit tonë: «Faji u bë qyrk dhe këtë qyrk asnjëri nuk e vesh». Titoja është idealist gjersa shpëtimin e pret nga «autokritika spontane», duke shpresuar që vjedhësit, vrasësit, grabitësit e matrapazët të dalin vullnetarisht të deklarojnë se kanë vjedhur, kanë bërë matrapazllëqe, janë dënuar të pafajshmit etj., etj. «Kjo autokritikë, — thotë ky pseudomarksist, — na mungon dhe na mungon shumë», prandaj «ne duhet ta zhvillojmë dhe ta kultivojmë atë në çdo organizatë-bazë», sigurisht ashtu siç kultivohet batha (!) mendon ai. Pasi i kujtohet më vonë se ekziston edhe termi «kritikë» në fjalor, pse sigurisht amnezia ia ka sklerozuar trutë, Titoja vazhdon: «Autokritika është më e rëndësishme se kritika dhe unë i jap avantazhe autokritikës». Kjo, me fjalë të tjera, dëshmon për një oportunitizëm me brirë, që me fjalë nuk mungon ta dënojë, por, kur shpreh ato që përmenda më lart, do të thotë: i lini rehat njerëzit të vjedhin, të grabitin; le t'i thonë vetë të gjithë ata burra të mirë çfarë kanë për të thënë, pse u bëheni havale? Këtë mënyrë veprimi, siç e thotë vetë Titoja, e përdor jo për të shpëtuar popujt e Jugosllavisë nga kriza e rëndë ku i ka futur regjimi dhe klika e tij tradhtarë, por që nëpërmjet kësaj autokritike të rritet prestigji i Jugosllavisë dhe ai i Lidhjes së Komunistëve. E gjithë çështja për të varet këtu te prestigji, te fama dhe jo te brendia. Për Titon nuk ka hiç rëndësi që molla është krejt e krimbur brenda, mjaft që lëkura e saj të duket e bukur nga jashtë.

Pyetjeve të Janekoviçit është e zorshme t'u përgjigjet Titoja, pse ajo i bën ato të drejtpërdrejta: **Ç'është kjo Lidhje e Komunistëve që po vepron kështu?**, i thotë

ajo me fjalë të tjera. Dhe Titoja përgjigjet: Lidhja e Komunistëve, që të bëhet ashtu siç duhet dhe ashtu siç ka qenë dikur, duhet «të forcohet ideologjikisht dhe politikisht». Tash na i ra ndër mend Titos të futë marksizëm-leninizmin nëpër shkolla, bile deri në fillore. Ai është i detyruar të njohë se në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë ka akoma mjaft indisiplinim në zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të ndryshme, veçanërisht në disa organizata. Po zbatohen ngadalë ose po shkelen vendimet e kongresit të 10-të. Si konkluzion, që ai e thotë vazhdimisht me fjalë, por që në realitet vepron krejt ndryshe, «duhen ndërmarrë masa akoma më të ashpra deri në përjashtimin nga Lidhja e Komunistëve».

Titoja pohon se Lidhja e Komunistëve e ka humbur shpirtin sulmues politik dhe ideologjik dhe harron se këtë shpirt sulmues asaj ia ka ndaluar dikush dhe me diçka që ka krijuar vetë Titoja për një kohë të gjatë prej dhjetëra e dhjetëra vjetësh. Këtë, natyrisht, ai e fsheh, por gazetarja në fjalë, pavarësisht se është një «admiruese» e këtij renegati, shpreh, si me thënë, opinionin e popujve jugosllavë dhe i thotë këtij «udhëheqësi», që i ka kaluar tiparet e një mbreti feudal, se janë thënë dhe konstatuar, janë marrë shumë vendime e shumë gjëra janë shkruar për të këqijat, për gabimet dhe të metat që janë vërtetuar në regjimin jugosllav. «Megjithatë, vazhdon gazetarja, ekziston përshtypja se gabimet dhe dobësitë po ndreqen shumë ngadalë në praktikën e përditshme». Gazetarja drejtpërdrejt i thotë: «Kjo është vërejtja, e cila dëgjohet nga një numër i madh njerëzish», të cilët thonë se të këqijat vetëm sa konstatohen, por asnjëherë «nuk kalohet përtej konstatimit». Përveç kësaj, gazetarja përmend «rezistencën shumë të fuqishme të forcave burokratike».

Si t'i përgjigjet Titoja kësaj pyetjeje? Ja, po jua japim përgjigjen e tij: «Është e vërtetë se ekzistojnë gjëra

të tilla, por Lidhja e Komunistëve nuk mund, si me magji dhe menjëherë, t'i ndihmojë të gjithë, t'i ndreqë të gjitha gabimet, se janë bërë gabime të mëdha» dhe, në mes të tjerave, përmend si shembull sigurimin, ku, pohon ai, «**ka pasur njerëz që kanë bërë gabime të mëdha**». Por se mos është vetëm sigurimi.

Federata Jugosllave në të katër anët është krimbur nga vjedhjet dhe çfarë vjedhjesh! Gazetarja e «Vjestnikut» është e shqetësuar për këtë gjendje, pse i shqetësuar është gjithë populli, prandaj ajo pyet presidentin e vet: **Si do t'u bëhet halli gjithë këtyre vjedhësve me çizme, se nuk shohim të bëhet gjë kundër tyre?** Dhe Titoja i përgjigjet: «**Komisionet për studimin e prejardhjes së pasurisë në fillim u dukën sikur e morën punën me zjarr**», po pastaj çdo gjë u fik. Pse? Është vetë Titoja që flet: **Komisionet nuk dhanë rezultate «për shkak të lidhjeve familjare, miqësore, territoriale, ose kush mund ta dijë se për çfarë lidhjesh dhe konsideratash të tjera ato kanë mbajtur qëndrime oportuniste dhe nuk e kanë kryer detyrën e tyre**». Dhe, si me habi, vjedhësi i vjedhësve, mbreti i mbretërve, thotë: «**Te ne nuk duhet të ekzistojnë gjëra të tilla**»!. Po ku mund të ekzistojnë gjëra të tilla e njerëz të tillë, kur nuk duhet të ekzistokan në Jugosllavinë kapitaliste, anarkiste? Por, vazhdon Titoja, «**do të gjejmë mënyrën ta kalojmë të gjithë këtë**», vetëm, sipas tij, duhet bërë klasifikimi se kush vjedh shumë, kush vjedh pak dhe kush nuk vjedh, pse ka njerëz që kanë bërë spekulime kolosale, dhe jo vetëm janë pasuruar me punën e të tjerëve e me djersën e ndërmarrjeve jugosllave, por janë bërë miliarderë. Kështu pohon ai me gojën e vet.

Kur gazetarja i thotë se puna e këtyre komisioneve është lënë në harresë, «**Jo, nuk është harruar**, — përgjigjet Titoja, — **do të ndërtojmë komisione të reja dhe do të bëjmë klasifikimin**». Kësaj i thonë: Prit gomar të mbi-

jë bar! Këto ai i thotë sa për të gënjyer popullin, se asgjë nuk po ndryshon në Jugosllavinë revizioniste.

Është ideologjia titiste ajo që ka krijuar një situatë të tillë, duke përgatitur gradualisht terrenin për të zhvilluar të gjitha këto të këqija, këto vese mikroborgjeze kapitaliste. Dhe ja çfarë pohon Titoja vetë: «**Komunistët në fillim nuk kanë qenë tregtarë. Në këtë sektor kanë punuar ish-tregtarët dhe kjo për disa prej tyre ka qenë ideale. Ata kanë ditur si tregtohet, në mënyrë që të fitonin sa më shumë, dhe, në këtë rrugë, ata kanë përgatitur edhe anëtarët e partisë që kanë punuar me ta, të cilët pastaj i kanë kaluar edhe mësuesit e tyre, janë bërë më të këqij nga ish-tregtarët**». Nuk ka si flitet më hapur! Po çfarë të bëjë? Gjendet në pozitë shumë të vështirë ky farë presidenti, i cili më poshtë vazhdon të pohojë për gjendjen në Jugosllavi: «**Ja, tash kemi shumë të arrestuar**», se «**kanë vjedhur me miliarda**». «**Mendoni, thotë Titoja, sa dëme të mëdha na kanë shkaktuar këta njerëz, ato janë të pabesueshme**».

Titoja është detyruar të pohojë vetë se «**tregtia e jashtme e Jugosllavisë ka qenë e tëra në duart e spekulantëve, të cilët kanë ditur mirë se si të vjedhin**». Rroftë parulla false: «**Tregtia është në duart e shtetit**», kurse Titoja e ka vënë atë tërësisht në duart e spekulantëve borgjezë, kapitalistë, të cilët, me metodën e vetadministrimit, japin e marrin me firma të jashtme kapitaliste, harxhojnë kreditë që u jep imperializmi amerikan, marrin për veten e tyre përqindje të majme nga fitimet dhe gjithë këto vlera të mëdha i depozitojnë nëpër bankat e botës kapitaliste për të kaluar jetë të rehatshme dhe luksoze.

Ishte vallë gjë e panjohur për Titon dhe për klikën e tij një situatë e tillë? Tash i pa ai gjithë këto fenomene fantastike? Jo, ai e krijoi vetë këtë situatë, ai punoi për të krijuar një borgjezi të re kapitaliste në Jugosllavi, e

cila duhej ta merrte dhe e mori fuqinë, duke hedhur në dorë ekonominë e financat dhe duke ua shitur vendin imperializmit dhe kapitalizmit botëror. Si pasojë në Jugosllavi u zhvillua inflacioni dhe çmimet u ngjiten e vazhdojnë të ngjiten në qiell. Por është populli që i pëson atje të gjitha këto të këqija.

«Çfarë po bëhet për aprovimin e ligjit të ri federativ për procedurën penale? Duket sikur jemi duke pritur shumë», — e pyeti atë Dara Janekoviçi. Procedura penale në Jugosllavi akoma nuk është vendosur dhe kjo është e qartë pse, sepse regjimi i vetadministrimit mbron kriminelët dhe kriminalitetin, mbron kusarinë dhe korrupsionin. Atëherë si i përgjigjet Titoja kësaj pyetjeje? «**Ligjet, në qoftë se përpilohen me shpejtësi të madhe, nuk janë të mira. Ligjet kryesore themelore që po përgatiten tash, do të jenë të vlefshme për një kohë të gjatë**». Mund të presin popujt jugosllavë akoma më gjatë, sipas Titos, të cilit nuk i është bërë kurrë vonë për ta. Titoja është i detyruar të pohojë se «**aprovimi i ligjeve po zvarritet aq shumë sa po bëhet tepër vonë, kështu kur ligji të aprovohet, ai nuk do të jetë më aktual**». Nuk ka ku vete më qartë!

Më në fund Dara Janekoviçi, që është vetë grua, i thotë Titos se në shoqërinë jugosllave «**ka ligje që janë në dëm të grave dhe të pozitës së tyre në shoqëri dhe përveç kësaj është shumë i vogël kujdesi i regjimit për gratë. Është turp që kemi kaq pak çerdhe, kopshte e karusele për grumbullimin e fëmijëve**». Ç'përgjigje t'i japë Titoja kësaj pyetjeje? Dhe ja çfarë thotë ai: «**Këtë çështje pas luftës e filluam mirë, pastaj menjëherë dinari mori vrull dhe çdo gjë duhej të shikohej nëpërmjet dinarit. Ky ka qenë një gabim i madh yni se lamë shoqërinë tonë dhe gratë në vështirësi, lamë të futet në këtë çështje kisha**». Megjithatë, për sa i përket pozitës së vështirë të gruas në shoqëri, Titoja i thotë gazetares: «**Unë nuk jam plotësisht dakord me ju**». Mirëpo ai flet hipur

majë kalit të artë, prandaj Dara Janekoviçi i përgjigjet: «**Unë këtë jua them si grua, shoku Tito, ju pyetni gratë punëtore**».

Po ku nuk e kanë filluar keq Titoja dhe regjimi i tij! Ai pohon se **nuk ka asnjë listë të kuadrove drejtues, nuk dihet se kush është njëri apo kush është tjetri, nga vjen, si është bërë drejtues, kush e ka shtyrë në poste me përgjegjësi dhe si kanë ndodhur këto?** Dhe mbaron duke thënë: **Do t'i kalojmë këto të gjitha (!)** Ka afro 30 vjet që Jugosllavia ka hyrë në rrugën e shkatërrimit kapitalist dhe të anarkisë si ideologji dhe si realitet në shtet dhe ky renegat mendon të rregullojë gjithë këto të këqija me një të rënë të shkopit magjik titist.

Siç e thashë edhe në fillim, kjo intervistë e Titos jo se hedh ndonjë dritë të re mbi gjendjen e vajtueshme të popujve të Jugosllavisë, të kombësive të ndryshme të saj, këtë ne e dimë, e kemi ndjekur hap pas hapi, e kemi analizuar dhe e kemi dënuar. Partia jonë e ka bërë të qartë prej kohësh këtë gjendje dhe ka luftuar kundër të gjithë atyre që mbronin dhe mbrojnë klikën renegate jugosllave. Por intervista e Titos ka një rëndësi të veçantë pse ai e pohon vetë degjenerimin e plotë të shoqërisë jugosllave, që është rrjedhim i degjenerimit revizionist të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe të të gjithë udhëheqjes së saj. Kjo intervistë u vë kapakun shumë intervistave të tjera, në të cilat Titoja s'mungonte të mburrej si gjel për «drejtësinë e vijës së tij», për rezultatet «e shkëlqyeshme» të kësaj vije, për «ndërtimin e shoqërisë së re dhe të vërtetë socialiste», por në të vërtetë të gjitha këto ishin paradat e një megalomani, të një gënjeshtari e aventurieri që rronte mbi kurrizin e popujve të Jugosllavisë si një monark i shekullit të 17-të dhe që, duke përdorur një frazeologji pseudomarksiste, hyri në shërbim aktiv të shërbimit të fshehtë imperialist kundër botës socialiste, kundër komunizmit.

MAOJA VETË SHKRUAN DHE VETË VULOS

Në Kinë ka filluar një fushatë e re dacibaosh kundër «njerëzve kryesorë të veshur me pushtet», që kanë qenë dënuar nga Revolucioni Kulturor, kanë bërë autokritikë false dhe janë rehabilituar. Këta ish-të dënuar janë përsëri kryesorë, janë pikërisht ata që kanë thënë «nuk ka rëndësi nëse macja është e zezë apo e bardhë, mjafton që ajo ha minj» (thënie e Ten Hsiao Pinit). «Këta njerëz, — shkruhet në dacibao, — në rast se do t'i kundërvihen vijës së Mao Ce Dunit, do ta pësojnë siç e pësoi Liu Shao Cia» etj., etj. Thuhet se 45 dacibao janë vënë në Universitetin e Pekinit për Ten Hsiao Pinin. Ky është «zhdukur nga skena», që kur i lexoi *de profundis*-in Çu En Lait. Agjencitë e huaja të lajmeve flasin se në dacibaot atakohet edhe politika «ekonomiste» e Çu En Lait.

Li Çiani, ministri i Tregtisë, u tha tanëve se Li Hsien Nieni është në spital i sëmurë nga zemra. Pse na e tha këtë? Mos vallë neve na u prish gjiza për këtë revizionist, lake me shumë faqe dhe një nga udhëheqësit kinezë që nuk i ka dashur kurrë Partinë dhe vendin tonë?

Dihet që tash si zëvendëskryeministër i parë nuk del më Ten Hsiao Pini.

Agjencitë e huaja të lajmeve flasin hapur se grupi i majtë, radikal, grupi i Shangait, ka marrë fuqinë. Por ç'po ngjet në realitet, nuk dimë gjë. Disa vjet më parë Maoja e nxori Tenin nga vrima, e rehabilitoi, e bëri nën-

kryetar të Partisë, zëvendëskryeministër, që shkruante e vuloste në emër të Çu En Lait, dhe në kohën kur Çuja ishte në spital, e bëri shef të shtabit të përgjithshëm dhe mbetej vetëm ta bënte edhe «shok të shquar të armëve të timonierit të madh», siç bëri Lin Biao.

Tashti ç'po ngjet? Maoja e rrëzoi përsëri Tenin. Do të ngrejë ndonjë tjetër, derisa ta rrëzojë edhe atë e të sjellë ndonjë Ten tjetër? As që merret vesh ç'bëhet atje, ose merret vesh mirë se Maoja vetë shkruan dhe vetë vulos, vendos cilin dëshiron ai, ul njërin, ngre tjetrin, mban dhe nxit dy vijat në parti dhe në pushtet. Çdo kongres partie që është bërë në Kinë, këtë qëllim ka pasur, dhe Maoja ka vepruar për të rrëzuar një grup që ishte në fuqi e për të ngritur një tjetër. Kjo është një politikë oportuniste, jorevolucionare, jomarksiste-leniniste. Ajo nuk krijon besim; përkundrazi, diskrediton dhe saboton ndërtimin e një sistemi me të vërtetë socialist, të një shteti të diktaturës së proletariatit me një vijë marksiste-leniniste. Vija kineze është një vijë tipike borgjeze e vogël, e pagëzuar me fraza e slogane marksiste-leniniste. Fasada është e kuqe dhe propagandohet si e tillë, po brendia nuk është as e kuqe, as socialiste, dhe për të gjitha këto s'ka si të mos themi se arkitekti i kësaj ndërtese është «timonieri i madh».

DACIBAO KUNDËR TEN HSIAO PINIT

Agjencitë e huaja të lajmeve njoftojnë se në Kinë po vendosen dacibao kundër Ten Hsiao Pinit.

ENIGMË KINEZE, ÇORODITJE MAOISTE

Në Kinë po digjet dhe nën këmbë. Që pas varrimit të Çu En Lait filloi me të madhe fushata kundër të djath-tëve, kundër «njerëzve kryesorë të udhëheqjes që kanë marrë rrugën kapitaliste», kundër atyre që «ishin kundër Revolucionit Kulturor», kundër atyre që «u rehabilituan dhe rifilluan luftën kundër vijës së timonierit të madh». Janë mbushur gazetatat e revistat me artikuj që demaskojnë këtë rrymë, këtë «murtajë». Sipas zakonit kinez, hë-përhë askush nuk cilësohet me emër, por i vënë kapelën «Hrushovi i dytë i Kinës», «Kryesori pas Liu Shao Çisë», «Armik si Liu dhe Lini» etj. Kuptohet që është fjala për Ten Hsiao Pinin. Ky ka një muaj që s'del në skenë, i ra lavdia; pritjet e përcjelljet që bënte ky si zëvendëskryemi-nistër i Çu En Lait tani i bën një tjetër, i quajtur Fen ose Fan, që akoma s'ia kemi mësuar emrin, pse këta ngrihen sot dhe rrëzohen nesër. Kjo është taktika e Maos: as Te-nin s'e demaskon, por as të riun nuk e numëron si krye-ministër.

Për mua është e qartë se me Tenin goditen Çu En Lai, Li Hsien Nieni dhe grupi i tyre. Nga kush goditen? Nga Maoja?! Nuk e besoj. Maoja është oportunist. Thonë janë «të majtët, radikalët», si Van Hun Veni, Çian Çini, Jao Ven Juani dhe Çan Çun Çiaoja. Ka plotësisht mundësi të jetë kështu. Por deri kur dhe sa do ta vazhdojnë këtë fushatë? S'dihet gjë, këtë e di Maoja, i cili deri dje ndiqte

Çunë, kurse tashti u thotë këtyre, «të majtëve»: «Bëjeni ju revolucionin tuaj».

Po çfarë ndryshoi në gjithë këtë rrëmujë? Çfarë po ndryshon? Ndryshojnë njerëzit, ndryshon politika, apo ideologjia? Të gjitha këto shkojnë çdo ditë e më shumë nga e djathta, sidomos politika e jashtme, të cilën e shtyn dhe e udhëheq ideologjia. Asgjë nuk lëviz: amerikanët janë miq të kinezëve, sovjetikët armiq. Por edhe në politikën proamerikane të Maos shihen çudira të paimagjinueshme. Në një kohë kur po zhvillohet «fushata e majtë» dhe Kina zien si kazan, ish-presidenti i Amerikës, Nikson, batakçiu i Uotergejtit, antikomunisti dhe fashisti më i egër, ftohet në Kinë, pritët në aerodrom nga kryeministri me një suitë të madhe prej mijëra njerëzish me flamuj amerikanë, që brohorasin për të!!!

Kjo është enigma kineze, çoroditja maoiste. Gjithë bota nuk e kupton pse bëhet kjo dhe ka arsye të mos e kuptojë, por unë do të jap shpjegimin tim. Maoja s'është në të dhe s'janë në të as shokët që ka afër. Ai mendon se bën një politikë të madhe e të zgjuar. Qëllimi dhe strategjia e tij synojnë: të thellohen kontradiktat midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Bashkimi Sovjetik është, sipas tij, armiku kryesor, prandaj të grumbullojmë forcat kundër tij. Maoja thotë që «lufta në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik do të bëhet në Evropë».

Me Niksonin Maoja ishte më i sigurt se do të zbatohet kjo strategji e tij, por, në fakt, me këtë ai «ka nxjerrë sytë». Ndërsa me Fordin nuk është i sigurt, prandaj e priti ftohtë. Edhe Fordi, nga ana e vet, qëndronte hapur kundër strategjisë së Maos. Atëherë Mao «gjeniali», «për të tronditur Fordin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës», për të bërë me vete të gjitha qeveritë dhe qeveritarët fashistë në Evropë e kudo që janë implikuar

në skandalin e ri të rryshfeteve që kanë marrë nga Niksoni dhe nga qeveria e tij, fton në Kinë Niksonin, të cilin e presin me pompë të madhe, tamam sikur të ishte president. Dhe, në fakt, me këtë që bën Maoja, do të thotë se ai nuk është dakord me akuzat që i bëjnë Niksonit «të mrekullueshëm», dhe se «ju, amerikanë, po të doni ta keni mirë me Kinën, duhet të ndiqni politikën e Niksonit, i cili, edhe pa qenë president, i shtyn koncernet e tij të bëjnë allishverishe të mëdha me Kinën socialiste». Kurse gjithë botës Maoja i thotë: «Ç'më çani kokën! Unë jam përfaqësuesi i një shteti të madh dhe di ç'bëj!»

Shpjegime të tjera s'mund t'u japim dot këtyre gjërave. Arsyetojmë drejt ose jo, këtë do ta tregojë koha.

Për zhvillimin e ngjarjeve në Kinë, unë mund të bëj një deduksion të tillë: **Në radhë të parë Mao Ce Duni nuk është një marksist-leninist konsekuent, megjithëse e kanë quajtur edhe «teoricien», «filozof» bile «klasik» të marksizëm-leninizmit. Ai anon nga e djathta e të majtëve. Në të vërtetë ai nuk është njeri i aksionit.**

Maoja, kur erdhi në krye të partisë, u tregua më i djathtë nga të majtët, pozitat e vërteta të tij ishin centriste, as frenues i majtistëve, as goditës i djathtistëve. Djathtistët, sidomos disa krerë kryesorë të këtij krahu, ai gjoja i skartoi, por njëkohësisht la «të vegjetojnë» në vila, duke u dhënë edhe rroga brenda dhe jashtë vendit, si Van Minit në Moskë. Majtistët i toleroi, derisa ata hodhën në dorë pushtetin. Në periudhën pas çlirimit Liu Shao Çia, Ten Hsiao Pini, Çu En Lai dhe krahu i tyre drejtonin Kinën, partinë, ekonominë, ushtrinë nën bajrakun e Maos, të cilin e bënë perëndi dhe e mbyllën në tempull. Maoja u bë hyjnor, por hapëset e kashtës kishte në dorë. Po Maoja ishte vallë në opozitë me ta? Jo, mendimet e tyre ai i aprovonte, se puqeshin me pikëpamjet e tij.

Këta «majtistë» deshën dhe u përpoqën të vepronin

për të shkuar më larg: «majtistët» na u transformuan në djathtistë. Këta vazhdonin t'u jepnin renta kapitalistëve (të cilët po qëndronin në vende drejtuese), dhe ishin në unitet me hrushovianët. Kjo nuk i pëlqeu Maos, që me fjalë ishte treguar i zellshëm për Hrushovin, por, kur ky nuk ia dha Kinës bombën atomike dhe shkoi në Uashington të lidhte miqësi me amerikanët, atëherë Maoja u revoltua, sepse donte që ai vetë të lidhej me amerikanët. Mirëpo pa se brenda fuqinë e kishte trioja Liu-Ten-Çuja, ndaj Maos i mbetej të ngrinte në «revolucion» hunveibinët, të përfitonte nga fama e tij për të sulmuar «shtabet».

Kështu filloi Revolucioni Kulturor. Liu dhe Teni u demaskuan, kurse Çuja, si «ekuilibrist» që ishte, e braktisi vaporin «Liu-Ten», që po mbytej, dhe ngriti lart «librin e kuq» të Lin Biaos, duke mos ndryshuar asnjë grimë nga pikëpamjet e tij djathtiste. Çuja u tregua se ishte një organizator, ekonomist, politikan, por politikan *versatil*¹. Liut ai i duhej dhe i shërbeu. Pas rrëzimit të Liu-Tenit, Çuja i duhej edhe Maos, kështu që gjatë Revolucionit Kulturor ky e mbajti këtë në krye të qeverisë, bile e ruajti edhe nga sulmet e këtij revolucioni. Gjatë kësaj periudhe kaotike Çuja u tregua manovrues i shkathtët. U bë lëpitkë karshi Maos, Çian Çinit, Lin Biaos dhe njëkohësisht u përpoq të forconte pozitat e veta, gjë që e donte Maoja, sepse s'kishte njeri tjetër të kalibrit të Çusë që t'ia bënte punën.

Në këto kushte, gjatë këtyre ngjarjeve, Çuja grumbulloi rreth vetes gjithë njerëzit e tij, të Liut dhe të Tenit, dhe, duke i bërë temena Lin Biaos, u bë zjarrfikësi i Revolucionit Kulturor. Linit iu ngritën këmbët, kurse Çuja me aparatet mbeti «i parë» pas Maos, që rrinte

¹ Frëngjisht — që ndërron shpesh qëndrim, mendim, i paqëndrueshëm.

brenda në kullë. Çuja u bë i domosdoshëm për Maon edhe për këtë periudhë. Ai e shoi revolucionin, vuri ekonominë në plan të parë, solli kuadrot e tij në fuqi dhe priste vdekjen e Maos, për t'ia hipur kalit me shalë. Mirëpo erdhën disa të rinj në udhëheqje të partisë dhe të shtetit. Çuja i pranoi këta se ishin «barërat» e Revolucionit Kulturor, por shpresonte t'i korrite më vonë. E dinte vallë Maoja ç'ishte Çuja? Unë mendoj se e dinte, por Çuja ishte i nevojshëm për të dhe u përshtatej lëkundjeve politiko-ideologjike të tij.

Të dy, si Maoja edhe Çuja, mendonin për të ardhmen. Maoja, nga ana e tij, solli në udhëheqje disa të rinj që t'i formonte nën drejtimin e kultit të vet. Për Maon këta qenë «krahu i majtë» i lojës së tij ideologjike. Çuja, i prekur nga kanceri, mendoi, gjithashtu, se duhej të linte trashëgimtarë për pastaj. Ishte, pra, e natyrshme që duhej rehabilituar Ten Hsiao Pini, që të ndiqte rrugën e Çusë, si «shefi i vijës së djathtë» i ardhshëm. Maoja e pëlqeu këtë iniciativë të Çusë, sepse e dinte që ai do të vdiste dhe mendoj se në krahasim me Çunë, Teni, që ishte demaskuar nga Revolucioni Kulturor, ishte shumë më pak i rrezikshëm. Kështu Teni mori revanin dhe eci aq shpejt, sa shpejt i vinte fundi edhe Çusë.

Çuja vdiq. Maos i iku një gur nga rruga, të rinjve po ashtu, dhe këta, me «lejen» e Maos, filluan demaskimin e Tenit. «Një revolucion i vogël pa gjak», po me bojë, sepse Maoja e di që të rinjtë duhet të qeverisin së toku me kuadrot e mesëm dhe të moshuar, shumica dërrmuese e të cilëve kanë qenë dhe janë të vijës së Çu En Lait. Pra: «**Hiqni qafe disa kryesorë, dhe pastaj vazhdoni lodrën e vjetër të dy vijave. Po u bënë të majtët shumë radikalë, atëherë lëshojmë të djathtët nga zinxhiri dhe kështu vazhdojmë.**»

E HËNE

1 MARS 1976

SHËNIME PËR DEMASKIMIN E KONGRESIT TË 25-TË TË PK TË BS

Me Ramizin bisedova se duhet filluar studimi i materialeve të Kongresit të 25-të të PK të BS dhe të përgatitet një artikull, si kurdoherë serioz dhe që të demaskojë nga çdo pikëpamje vijën tradhtare antimarksiste të socialimperialistëve sovjetikë. Në artikullin tonë duhet të vihet në dukje qederi i përhershëm i revizionistëve sovjetikë për t'u maskuar me formula gjoja leniniste. Ata përpiqen të tregojnë që rruga e tyre e tradhtisë është «vazhdim konsekuent i teorisë së Marksit dhe të Leninit» dhe duan të thonë që, «në qoftë se te ne nuk ka proletariat, kjo ndodh se ne e kemi kaluar fazën e socializmit dhe jemi në komunizëm»; në qoftë se partia është e gjithë popullit, kjo vjen pse «te ne janë zhdukur klasat»; në qoftë se «pushteti është i gjithë popullit», kjo është për arsye se «në komunizëm s'ka diktaturë të proletariatit dhe as luftë klase» etj.

Përse u shërben revizionistëve sovjetikë e gjithë kjo? Për të maskuar atë që regjimi aktual i tyre është një regjim socialshovinist imperialist, se shteti i tyre është një diktaturë e borgjezisë së re kapitaliste fashiste, pse shtyp çdo gjë e këdo që nuk i bindet kësaj borgjezie fashiste burokrate. «Partia e gjithë popullit» përbëhet nga një shumicë e madhe nëpunësish, domethënë nga burokracia e pakufishme, nga policia, nga sigurimi dhe

sidomos nga ushtria e madhe agresive. Punëtorët në parti zënë vendin e dytë pas nëpunësve, por kjo «punëtori» në parti është «aristokracia punëtore» dhe lake në shërbim të borgjezisë së re revizioniste e të rrjetit të spiunazhit sovjetik, KGB-së.

Duke u bazuar në të dhënat e sovjetikëve, në artikullin tonë duhet të vihet në dukje se, me gjithë manipulimin e shifrave, ekonomia kapitaliste sovjetike po kalon një krizë shumë të rëndë dhe katastrofale. Kjo ekonomi është përfshirë në krizën e madhe botërore dhe, për të dalë prej saj, Bashkimi Sovjetik është futur më thellë në kthetrat e imperializmit amerikan e të kapitalizmit botëror, është krimbur në kredi të huaja. Bujqësia ka dështuar, industria po ashtu, KNER-i shfrytëzon barbarisht satelitët e Bashkimit Sovjetik, i cili bën ligjin, dhe ushtria agresive sovjetike po gëlltit shumën e mëdha të buxhetit për t'u kthyer në një ushtri ala hitleriane, me anën e së cilës synon të dominojë botën.

Këto disfata, këtë krimbje, këtë degjenerim, revizionistët sovjetikë duan ta mbulojnë, si brenda edhe jashtë, me «pompozitetin» skandaloz të paraqitjes, të fryrë, të fryrë si një gjel qafërrjepur. Kongresin e 25-të të PK të BS (kongres në dukje), delegatët e të cilit dukej që janë pasanikë, që hanë e pinë mirë dhe që i fryjnë e i nxjerrin përpara gjokset e mbushura me dekorata, për herë të parë e përshëndeti ushtria. Aty dolën diskutuan oficerë «të bukur» e «të prerë si me thikë», me gjokset plot dekorata. Me këtë revizionistët i thanë kongresit të partisë se «ushtria dominon mbi çdo gjë e mbi këdo, prandaj si ju brenda, edhe ju jashtë, të na e kini frikën!». Hapi marcial i oficerëve tronditi dyshtemenë dhe ngriti në këmbë, në entuziazëm e në duartrokitje, borgjezinë e re, aristokracinë e regjimit që ndodhej në kongres. Ajo e ndjeu veten të sigurt, të sigurta i ndjeu edhe pasuritë që ka vënë.

Artikulli duhet të demaskojë atë që revizionistët sovjetikë kishin ftuar në këtë kongres derrin dhe dosën, që kishin një turi si ata vetë. Kastroja, më mjekër, me gozhup dhe me kokore, u ngjiste bojarëve të carëve, e kështu me radhë dukeshin pjesëtarët e rreth 110 delegacioneve. Të gjithë këta u duheshin hrushovianëve për t'i dhënë «madhështi» kongresit të tyre, për të thënë se Moska «është qendra e botës komuniste» dhe gjithë kjo botë e qelbur revizioniste po u këndon himne hrushovianëve! Natyrisht, Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi shumë, shumë larg këtij gjirizi dhe ajo vazhdon të demaskojë turpin, shantazhin, tradhtinë dhe hegjemonizmin revizionist të socialimperialistëve sovjetikë. Edhe Partia Komuniste e Kinës nuk mori pjesë në këtë kongres.

Artikulli ynë duhet të vërë, gjithashtu, në dukje se Partia Komuniste Franceze, Partia Komuniste Italiane, Partia Komuniste e Spanjës, bënë nga një «diversion»: ato nuk i «rakorduan orët» me Kremlinin. Ky i «kritikoi» pa adresë dhe me dorashka. Ishte e nevojshme ta bënte këtë, se i çirrej krejt maska false. Po këto parti revizioniste «disidente» gjoja nga Moska, me deklaratat dhe me programet e tyre, i thonë Kremlinin: «Çfarë keni, pse shqetësoheni? Ne fillojmë atje ku keni mbaruar ju, ne fillojmë nga tradhtia juaj: ju hodhët tej diktaturën e proletariatit dhe ne atë po bëjmë; ju keni një parti të të gjithë popullit dhe te ju s'ka luftë klase, edhe ne po shkojmë në socializëm (në ëndërr) pa luftë klasash, me reforma dhe me të gjitha partitë e kapitalit, deri edhe me kagularët¹ dhe me kryqet e reja të zjarrra, prandaj s'keni pse revoltoheni».

Artikulli duhet të vërtetojë se si njëra palë, edhe tjetra, bëjnë sikur revoltohen, se kjo rrugë u intereson të dy palëve: edhe revizionistëve të Lindjes, edhe atyre

të Perëndimit. Këta të fundit duan t'i japin prova borgjezisë së vendeve të tyre se kanë hequr dorë nga revolucioni, prandaj kërkojnë një qoshe në diell dhe, nga ana tjetër, duan të tregojnë se «u shkëputëm nga Moska, jemi të lirë, të pavarur».

Revizionistëve sovjetikë u vjen mirë që ky ujë revizionist të përzihet me verën borgjeze kapitaliste, ata shpresojnë të kenë një kolonë të pestë brenda në këto shtete perëndimore (në e hëngërt borgjezia këtë gjellë). Pra bëjnë sikur zihen, sikur kritikohen, por të dy palët duan të dalin dhe, në fakt, kanë dalë në një qafë. Veçse sovjetikëve një diçka nuk u pëlqen, nuk u pëlqen që këta pseudodisidentë të trumbetojnë fort se u shkëputën nga Moska, se nuk është mirë për të dy palët dhe s'i beson kush.

Ne e marrim me mend ç'po luhet në prapaskenën e kongresit të 25-të, ç'komedi, ç'shantazhe, ç'kërcënime, ç'ryshfete e ç'premtime për kredi bëhen. Udhëheqja kryesore e Kremlinin i ka vënë të gjitha delegacionet nën vëzhgim me aparatura dhe me batalione çinovnikësh që japin e marrin me këto delegacione. Tërë ditën zhvillohen «lobet», përpara sofrave të shtruar në mënyrë përrallore, për t'i gënjyer. Ky është mjeti për të ilustruar blufin e bollëkut që revizionistët duan të vërtetojnë se gjoja ekziston në Bashkimin Sovjetik, ku në realitet ndodh e kundërta. Çdo delegacioni i është caktuar që më parë ku do të vejë e ç'do të shohë, kush do t'i flasë e ç'do t'i thotë, pse ata që do t'i presin, as që dinë fare se ku bie vendi i miqve. Agjitpropi mendon, mashtrimi vepron, kërcënimet, rublat, shkopi dhe karota, po ashtu.

¹ Anëtarët e një organizate terroriste (1935-1940).

E MËRKURË

3 MARS 1976*

E SOTMJA ËSHTË E TURBULLT, S'DIHET Ç'DO TË SJELLË E NESËRMJA

Tamtamet më të mëdha po bien në Kinë kundër «Hrushovit të ri të Kinës», kundër «armiqve djathtistë», «agjentëve të Guomindanit», kundër atyre «që kërkojnë të marrin pushtetin», «që kanë krijuar përçarje në Komitetin Qendror të Partisë», «që janë kundër vijës së Mao Ce Dunit» etj. Kush është ky armik? Ten Hsiao Pini, «floriri i vogël», siç e quante Maoja, të cilin Revolucioni Kulturor e demaskoi si «armikun numër dy të Kinës», pas Liu Shao Çisë, dhe që tre vjet më parë Maoja jo vetëm e rehabilitoi, por e emëroi zëvendëskryeministër të parë, bile zëre se kryeministër (sepse Çuja ishte duke vdekur); e emëroi, gjithashtu, anëtar të Byrosë Politike, nënkryetar të partisë dhe shef të shtabit të përgjithshëm. Tash? *Patatras!*¹ U rrëzua kalaja, kulti i Tenit. E rrëzoi Maoja, thonë. Po pse e ngriti dhe e rrëzoi? «Se komplotoi, se gënjeu në autokritikë». «Timonieri i madh» është shumë vigjilent!

Kush sundonte Kinën: Mao Ce Duni e Çu En Lai? Apo drejtonte Partia Komuniste e Kinës? Zor të prononcohesh. Por siç vërteton jeta, më shumë ata të dy sesa Partia Komuniste e Kinës. Maoja ishte bajraku, në fakt Liu vepronte dhe sundonte. Pastaj u rrëzuan Liu-Teni

1 Fjalë onomatopeike (frëngj.) — Pram!

dhe erdhën Lin Biaoja me Çen Po Tanë. U rrëzuan edhe këta, dhe mbretëruan Çuja me Li Hsien Nienin dhe të djathtët, të cilët rehabilituan Tenin dhe shokët e tij. Teni menjëherë u bë i plotfuqishëm! Nga kampi i edukimit u dërgua drejt e në OKB, në Francë e në krye të «botës së tretë». Teni dorëzoi helikopterin sovjetik dhe spiunët, dhe Shqipërinë socialiste e goditi si në ekonomi, ashtu edhe në ndihma ushtarake. Teni ishte ngjitur në re, ai arriti qiellin, por një mëngjes vdiq Çu En Lai. Teni u gjend në fund të shkallëve...!

Filluan atëherë dacibaot, sipas zakonit kinez, pa adresë, po tash së fundi fillon t'i dalë emri edhe «dhëndrit, edhe vjehrrit», edhe Tenit, edhe Çusë, por këtij të fundit në surdinë, sepse Çu En Lai është në fakt kreu i djathtëtëve dhe tepër i nderuar nga borgjezia e brendshme dhe ajo ndërkombëtare, që e kanë quajtur «më i zgjuari, më i sjellshmi, më diplomati fino, më mandarini». Tamtami vazhdon, po edhe Teni vazhdon të mbajë postet që ka. Ai vërtet rri në hije tok me Li Hsien Nienin, por, s'dihet, «floriri i vogël» mund të ribëjë një autokritikë tjetër, dhe «timonieri i madh» ta falë përsëri.

Sidoqoftë, se si do të bëhet, asnjëri s'mund ta përfytyrojë. Politika kineze ka ideologjinë e saj speciale me emër kineze, ka taktikat dhe strategjinë e saj, po ashtu kineze! S'dihet ç'do të sjellë e nesërmja, kurse e sotmja është kaos! Nga një anë populli kinez «lufton» kundër të djathtëtëve, nga ana tjetër u shqye nga gëzimi i papërmbajtur dhe nga entuziazmi i shfrenuar përpara fashistit, ish-presidentit batakçi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Niksonit. Kjo është politika «gjeniale» e Maos. Këtu mund ta humbasësh fare «latinishten»: **Maoja ishte pro Hrushovit, pastaj u bë kundër, aq më shumë kur ai shkoi në Uashington; Maoja më vonë u puth vetë me Niksonin. Çuja që ishte më shumë me Liun dhe me Hrushovin, u bashkua me Maon kundër Hrushovit dhe pro Shteteve të**

Bashkuara të Amerikës. Erdhi Teni, që, si bashkëpunëtor i Liut, duhej të ishte prosovjetik, por u bë proamerikan, sepse duhej të maskohej, të hiqej sikur është në çdo rast me Maon.

Tash ç'do të ngjasë? Ç'të thotë Maoja! Thonë se po marrin fuqinë të majtët, por puthja me Amerikën po bëhet më e pashqitshme, gjoja sepse «është dobësuar e mjera dhe duhet ndihmuar», se sovjetikët po bëhen të rrezikshëm.

Në Kinë aktualisht nuk e njeh qeni të zonë. Shokëve tanë të ambasadës, kinezët u thonë se «studentët shqip-tarë nuk i mbrojmë dot nga reaksioni». Kush e ka, pra, në dorë situatën atje, komunistët apo reaksioni? «Duhet të turbullohet uji që të kullohet», ka thënë Maoja. Atëherë le të presim sa të kullohet!

**E ENJTE
11 MARS 1976**

KONGRESI I REVIZIONISTËVE SOVJETIKË — KONGRESI I DEMAGOGJISË DHE I EKSPANSIONIT SOCIALIMPERIALIST

Erdhi Ramizi dhe më lexoi artikullin që kanë bërë për Kongresin e 25-të të PK të BS në bazë të tezave që i kisha dhënë disa ditë më përpara. E kishin bërë mirë. Unë shtova ndonjë paragraf vetëm për çështjen e internacionalizmit proletar dhe për të folur kundër imperializmit amerikan. Artikulli do të botohet nesër dhe do të ketë titullin: Kongresi i revizionistëve sovjetikë — kongresi i demagogjisë dhe i ekspansionit socialimperialist.

I lexova Ramizit edhe një shkrimin tim mbi internacionalizmin proletar që inkuadrohet në shkrimin mbi revizionizmin francez.

TË DEMASKOJMË PËRDPJEKJET E KINEZËVE PËR T'U PËRZIER NË PUNËT E BALLKANIT

Kinezët po përzihen në punët e Ballkanit dhe kërkojnë të na mësojnë se si duhet të jenë sigurimi dhe bashkëpunimi ballkanik. Dje lexova një artikull të gazetës «Zhenminzhibao» me titullin «Përshëndesim synimet e përbashkëta të popujve ballkanikë», të transmetuar nga agjencia HSINHUA. Pavarësisht kujt i shërben dhe cilat janë qëllimet e vërteta të organizatorëve të saj, Konferencën e Athinës për bashkëpunimin ballkanik artikulli e quan një hap pozitiv. Në të njëjtën kohë, duke lënë në harresë me qëllim qëndrimin tendencioz dhe diskriminues që u mbajt me këtë rast ndaj vendit tonë, në këtë artikull kinezët «e mençur» bëjnë thirrje që «popujt e Ballkanit të kuptojnë se duhet të shtojnë bashkëpunimin dhe të forcojnë aleancën në interes të mbrojtjes së pavarësisë dhe të sigurimit të vendeve të veta».

Bisedova me Ramizin gjerësisht për këtë çështje. I dhashë udhëzime dhe tezat e nevojshme kryesore për të botuar një artikull¹, ku, pa i zënë në gojë, t'u përgjigjemi e t'i hedhim poshtë edhe «sugjerimet» e djallëzuara të kinezëve.

1 «Çfarë e ndihmon dhe çfarë nuk e ndihmon sigurimin dhe bashkëpunimin e vërtetë të Ballkanit». «Zëri i popullit», 23 mars 1976.

VENDIM SHUMË I DREJTË I ASAMBLESË KOMBËTARE TË EGJIPTIT

Agjencitë e lajmeve njoftuan se Asambleja Kombëtare e Egjiptit ratifikoi njëzëri vendimin për anulimin e «Traktatit të miqësisë dhe të bashkëpunimit» egjiptiano-sovjetik.

Masë shumë e drejtë dhe plotësisht në favor të forcimit të pavarësisë kombëtare të Egjiptit nga neokolonialistët socialimperialistë sovjetikë.

ÇFARË E NDIHMON DHE ÇFARË NUK E NDIHMON SIGURIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E VËRTETË TË BALLKANIT

Shikova përfundimisht artikullin për Konferencën Ballkanike të Athinës. Aty u përgjigjemi tërthorazi edhe gjepurave të kinezëve dhe përpjekjeve të tyre për t'u përzier në punët e Ballkanit. Artikulli do të botohet në gazetë më 23 mars me titullin «Çfarë e ndihmon dhe çfarë nuk e ndihmon sigurimin dhe bashkëpunimin e vërtetë të Ballkanit».

KU KA QENË DHE KU PO SHKON KINA?

Kina quhej dhe quhet nga kinezët «Cungo», që në frëngjisht i thonë «*l'Empire du Milieu*» (kështu është quajtur edhe në shekujt e lashtë), që do të thotë «Perandoria e Mesit». Po përse «Perandori e Mesit»? Sepse kinezët për dhjetëra shekuj me radhë (janë zbuluar vlera arkeologjike të 50 shekujve më parë) e konsideronin vendin e tyre «qendrën e botës». Kjo «qendër e botës» ka pasur një kulturë të madhe e të lashtë, jo që kur e konstatoi Marko Poloja; ajo mund të ishte më e vjetër edhe se ajo e egjiptianëve dhe e sumerëve, të cilët konsiderohen si popuj me kulturë më të vjetër në botë.

Është e kuptueshme se kjo fjalë «Cungo», që vazhdon të përdoret dhe tash nga kinezët, nuk është vetëm një emërtim i thjeshtë tradicional, por rrjedhim i formimit të një botëkuptimi mijëravjeçar në të gjitha gjeneratat kineze, që, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, ruhet edhe sot.

Besimet fetare të budizmit dhe të konfucizmit, të cilin Mao Ce Duni u kujtua pas të vjelave ta vinte «në dukje», «ta luftonte» (dhe këtë ai e lidhi me luftën kundër Lin Biaos), e kanë rrënjësuar idenë e «Cungo-së» të kinezët tok me botëkuptimet e tyre fetare mistike e filozofike, me format e tyre të organizimit e të drejtimit, me zakonet e shkruara e të pashkruara. Është e kuptueshme se kultura e vjetër kineze nuk u bë kulturë e popullit ki-

ÇFARË E NDIHMON DHE ÇFARË NUK E NDIHMON SIGURIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E VËRTETË TË BALLKANIT

Shikova përfundimisht artikullin për Konferencën Ballkanike të Athinës. Aty u përgjigjemi tërthorazi edhe gjepurave të kinezëve dhe përpjekjeve të tyre për t'u përzier në punët e Ballkanit. Artikulli do të botohet në gazetë më 23 mars me titullin «Çfarë e ndihmon dhe çfarë nuk e ndihmon sigurimin dhe bashkëpunimin e vërtetë të Ballkanit».

1 -Çfarë e ndihmon
dhe bashkëpunimin e
21 mars 1976.

KU KA QENË DHE KU PO SHKON KINA?

Kina quhej dhe quhet nga kinezët «Cungo», që në frëngjisht i thonë «l'Empire du Milieu» (kështu është quajtur edhe në shekujt e lashtë), që do të thotë «Perandoria e Mesit». Po përse «Perandori e Mesit»? Sepse kinezët për dhjetëra shekuj me radhë (janë zbuluar vlera arkeologjike të 50 shekujve më parë) e konsideronin vendin e tyre «qendrën e botës». Kjo «qendër e botës» ka pasur një kulturë të madhe e të lashtë, jo që kur e konstatoi Marko Poloja; ajo mund të ishte më e vjetër edhe se ajo e egjiptianëve dhe e sumerëve, të cilët konsiderohen si popuj me kulturë më të vjetër në botë.

Është e kuptueshme se kjo fjalë «Cungo», që vazhdon të përdoret dhe tash nga kinezët, nuk është vetëm një emërtim i thjeshtë tradicional, por rrjedhim i formimit të një botëkuptimi mijëravjeçar në të gjitha gjeneratat kineze, që, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, ruhet edhe sot.

Besimet fetare të budizmit dhe të konfucizmit, të cilin Mao Ce Duni u kujtua pas të vjelave ta vinte «në dukje», «ta luftonte» (dhe këtë ai e lidhi me luftën kundër Lin Biaos), e kanë rrënjësuar idenë e «Cungo-së» te kinezët tok me botëkuptimet e tyre fetare mistike e filozofike, me format e tyre të organizimit e të drejtimit, me zakonet e shkruara e të pashkruara. Është e kuptueshme se kultura e vjetër kineze nuk u bë kulturë e popullit ki-

nez, po mbeti kulturë e mandarinëve dhe gjuha e shkruar mbeti privilegj i perandorëve dhe i mandarinëve, i «zotërinjve të luftërave», që shtypnin dhe u pinin gjakun popujve të Kinës.

Shumë herë gjatë historisë Kina u sulmua nga të huajt dhe luftoi kundër tyre, por edhe shumë herë të huajt ndikuan dhe krijuan atje një organizim dhe drejtim të tyre. Por kultura e pushtuesve, duke lënë gjurmë, nuk mundi të asimilonte kulturën e pasur dhe të lashtë kineze. Ngjau, natyrisht, e kundërta.

Feja kishte krijuar në Kinë kultin e vet, kultin e budizmit dhe me të lidhte kultin e «Cungo-së», ngjallte dhe shtonte te kinezët teoritë e Konfucit. Budizmi dhe konfucizmi ngjallën atje ksenofobinë për çdo gjë që ishte e huaj, ashtu siç ngjallën megalomaninë për çdo gjë që ishte e tyre, e «Cungo-së». Çdo gjë pleksej me këto botë-kuptime fetare dhe etike. Këto dhe varfëria e madhe shekullore fshatarin kinez, të shtypur nga perandorët e feudalët, e bënë fatalist, punëtor dhe të disiplinuar, patriot, ksenofob, disi të heshtur, dyshues ndaj të tjerëve, vendas e të huaj. Çdo veprim dhe mendim i tij formulohej dhe bëhej me mënyra të atilla që ishte zor të kuptoje mendimin e vërtetë, dhe të ndiqje fillin e problemit. Me fjalë të tjera, në të menduar dhe në të vepruar, kinezi nuk kishte një mënyrë të hapët, të çiltër, por të alambikuar me shumë kthesa e dredhi dhe mjaft herë këto shenja të karakterit mbrojtës ktheheshin në shprehje të hipokrizisë.

Por, gjatë shekujve, dhe sidomos në kohët tona, karakteri, besimet dhe zakonet e njerëzve ndryshuan, përsuan një evolucion të thellë, por pa humbur krejtësisht tiparet e vjetra. Edhe pas çlirimit përfundimtar nga zgjedha e huaj, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, edhe pas revolucionit të udhëhequr nga Partia Komuniste e Kinës, Kina vazhdoi deri diku të mbetej një

vend «i mbyllur». Nën maskën e regjimit demokratik popullor dhe nën drejtimin dhe udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës e të Mao Ce Dunit, me gjithë përmbysjet që bëri populli i saj, prapë Kina qëndroi në pozita mosbesimi, krijoi «miqësira», por koniunkturale, ia mbylli ose ia mbajti të mbyllura portat kulturës përparimtare botërore dhe çdo gjë, çdo evolucion, u përpoq ta bënte në «vazo të mbyllur». Çdo gjë e huaj, edhe teoria marksiste-leniniste, që u adoptua si «ide udhëheqëse», pësonte ndryshime në forma eklektizmi, gjoja të zbatuara në kushtet e Kinës.

Kultura kineze, edhe pas fitores së revolucionit, nuk pati një zhvillim të vrullshëm, as nuk u bënë spastrime të teorive të vjetra regresive dhe reaksionare, nuk u hodhën si duhej baza të shëndosha për një kulturë kombëtare dhe revolucionare. Fakt është se pas Revolucionit të Madh Kulturor, që ishte një revolucion me qëllime të tjera, u hodhën parulla dhe u krijuan disa «balete revolucionare», që u vlerësuan prej tyre sikur të ishin çdo gjë, sikur të ishin bazat e një kulture revolucionare.

Gjithë kultura kineze ishte dhe vazhdon të jetë nën darën e kulturës së vjetër konfuciste. Ajo që maoistët quajnë «kulturë revolucionare» është propagandë gazetareske e përditshme politike. Shkollat ose qëndrojnë mbyllur, ose në to mësohen njohuri të shartuara. «Kultura» është kufizuar në luftën kundër Kao Ganit, Pin De Huasë, Liu Shao Çisë, Lin Biaos dhe Ten Hsiao Pinit, pa harruar Konfucin, nën mantelin e të cilit kanë futur me këtë rast të gjithë këta bosër.

Është e çuditshme (dhe jo pa arsye) veprimtaria ideopolitike e Partisë Komuniste të Kinës. Kjo ka qëndruar e mbyllur ndaj të huajve, sidomos ndaj partive komuniste dhe punëtoresh motra. Mendoj se kjo ka arsyet e veta, që janë parimore. «Të palarat t'i lajmë brenda dhe të mos na i dinë të tjerët». **Në Partinë Komuniste të Kinës,**

që nga themelimi i saj dhe deri sot, janë bërë gabime në vijë, që kanë lënë gjurmë të thella dhe e kanë bërë partinë të ketë një vijë të paqëndrueshme, ku i theksuar është oportunizmi i djathtë. Por çfarë gabimesh janë bërë në fakt dhe të ç'natyre kanë qenë këto gabime? Për këtë nuk gjen asnjë dokument, asnjë analizë. Gjen artikuj politikë me formula të përgjithshme dhe numërim emrash të «elementëve kryesorë antiparti». **Partia Komuniste e Kinës nuk e ka akoma tekstin zyrtar të historisë së saj.** Gjen shkrime të shkëputura episodike të shkruara pa asnjë përgjegjësi, që sot qarkullojnë, nesër hiqen dhe dalin shkrime të tjera me idera të tjera. Botërisht dihen vetëm raportet e kongreseve të 8-të, të 9-të dhe të 10-të të kësaj partie. Të gjitha këto, ose vetëm këto, konsiderohen të drejta, asnjë pjesë s'është hequr prej tyre, sido që në to ka gabime kolosale. Këto mbulohen të tëra me emrin e Maos, sepse të Maos, të Liut, të Tenit dhe të Çu-së kanë qenë, prandaj, po të spastrohen gabimet në vijë, që janë në to, atëherë ku shkon autoriteti i Maos, i cili ka qenë në krye të Partisë?

Ekzistojnë po ashtu katër vëllime të shkruara nga Maoja gjatë kohës së luftës. Këto u përmbledhën, «u rregulluan dhe u stolisën» si të bazuara në teorinë marksiste-leniniste. Këto shkrime dolën disa vite pas çlirimit të Kinës dhe thonë se janë rregulluar nga filozofi sovjetik Judin që ka qenë ambasador në Kinë. Vepra të tjera të Maos nuk ka. Luftohet me citatet e tij të vjetra eklektike. Ç'ka bërë ky «teoricien i madh» gjatë gjithë këtyre viteve? Ka dhënë mendime, ka folur, ka dhënë zgjidhje për një varg problemesh të mëdha? Pothuajse asgjë nga këto s'ka të botuar. Vetëm **propagandohet maocedunideja berras me marksizëm-leninizmin, bile ka lakenj të Maos që, në radhën e fotografive të klasikëve, kanë futur fotografinë e tij pas asaj të Engelsit dhe para Leninit.**

Ç'rezultton nga gjithë kjo? Një fshehje e së vërtetës

në zhvillimin dhe në luftën e Partisë Komuniste të Kinës dhe një pompim artificial i Mao Ce Dunit. **Megalomania antimarksiste kineze është shpalosur, kulti i Maos është bërë i njëjlojtë me atë të Konfucit.** Çdo gjë që bën Maoja, çdo gjë që thotë ai, është «e drejtë». Të gjithë duhet të binden për çka thotë Mao Ce Duni. S'lejohej arsyesim, por vetëm fanatizëm.

Më lart theksova se në Partinë Komuniste të Kinës janë bërë shumë gabime në vijë, që në fillim. Po në ç'baza u formua në Kinë partia? Nuk dihet gjë. Maoja vetë s'ka shkruar për këtë, ose ka shkruar pak gjëra, por që edhe ato nuk njihen. Në katër vëllimet e Maos, që janë botuar, trajtohen çështje të politikës dhe të vijës së partisë, flitet mbi organizimin e saj, në to Maoja përpiqet të parafrzojë Marksit dhe Leninin, por çdo gjëje i jep ngjyrën e një leksioni teorik, duke synuar të edukojë kuadro, ose të dalë dhe të hiqet si një teoricien i afirmuar. Në to nuk spikatin, ose spikatin fare pak, lufta e gjallë e partisë, luftërat fraksionale, lufta e klasave jashtë dhe brenda partisë. Jo, atje ka gjoja teori të tij, por në të vërtetë ato janë parafrazime të cinguar të Marksit ose të Leninit. Në këto vëllime nuk gjen mendime të Stalinit. **Në Kinë Stalinin e gjen vetëm në një portret, në Tien An Men.**

Shumë fraksione kanë ekzistuar në Partinë Komuniste të Kinës dhe kjo ngaqë vija bazë e partisë nuk ka qenë plotësisht marksizëm-leninizmi. Kështu duhet të ketë qenë që në themelimin e partisë, sepse protagonistët e saj, Maoja, Çu En Lai, Çu Deja, për të mos folur për Li Li Sanët e të tjerë, nuk kanë qenë marksistë të formuar, por këta nuk kanë bërë as përpjekje sa duhet për të përvetësuar marksizëm-leninizmin. Ata e donin çlirimin nacional dhe social të Kinës, por idetë mbi komunizmin dhe ideologjia e tij nuk duhet të kenë qenë të qarta për këta shokë.

Mbyllja në vetvete e Kinës i mbyllte edhe Maon e Çunë në këtë ambient. Këta nuk shikonin jashtë Kinës, dhe me siguri në nocionet e tyre fillestare, që i çonin drejt revolucionit, plekseshin shumë pikëpamje nacionale, borgjeze, demokratike, përparimtare dhe mistike. Për republikën e Sun Jat Senit, për të cilën ata flasin mirë, nuk shohim të shfaqet të paktën mendimi kritik në ndonjë material të qartë të Partisë Komuniste të Kinës. Edhe atëherë, edhe tash, gjërat lihen në mjegull, ka mendime dhe interpretime të çfarëdo lloji, prandaj në to «zgjidh e merr». Më shumë dhe kryesisht janë të huajt që kanë shkruar për këtë epokë revolucionare dhe përparimtare. Për kinezët zgjimi dhe lufta e Kinës fillojnë e mbarojnë me Maon.

Sun Jat Seni ishte një personalitet i madh, që e kuptoi drejt vlerën e miqësisë me Bashkimin Sovjetik të Leninit, i cili i zgjati dorën dhe i dha Kinës ndihmë e përkrahje. Partia Komuniste e Kinës sapo ishte formuar në atë kohë dhe, natyrisht, ndikimi i saj në masat ishte i paktë, ndërsa ndikimi i Sun Jat Senit dhe i Guomindanit ishte i madh. Se si veproi, si u lidh dhe si luftoi Partia Komuniste e Kinës në këto momente, as që mund të flasim me siguri, ose mund të flasim vetëm duke u mbështetur në ato që kanë shkruar të huajt, sepse vetëm ata kanë pasë bërë analiza; mirëpo analizat e tyre udhëhiqen nga parime dhe qëllime të tjera, në të cilat ne nuk mund të mbështetemi. Faktet vërtetojnë se Bashkimi Sovjetik, sa ishin gjallë Lenini dhe Stalini, e ruajtë dhe e zhvilloi miqësinë me Kinën dhe me Guomindanin si në kohën kur rronte Sun Jat Seni, ashtu edhe kur këtë e zëvendësoi Çan Kai Shia.

Komunistët kinezë bashkëpunuan në këtë vijë, por si, sa, ç'kontradikta lindën dhe pse lindën, ne i marrim me mend, se jemi marksistë dhe e dimë ç'përfaqësonte Çan Kai Shia. Një studim dhe një analizë e tillë nga ana

e Partisë Komuniste të Kinës nuk është bërë, të paktën me sa dimë ne. Asnjë histori e popullit kinez nuk është shkruar nga shteti proletar kinez dhe nga Partia Komuniste e Kinës. Çdo gjë që kemi lexuar mbi këtë problem të madh, e kemi lexuar nga historianë, shkencëtarë e sociologë të huaj dhe borgjezë.

Shumë gjëra nuk dimë, por dimë që Partia Komuniste e Kinës trumbeton *in petto*¹ se: Kominterni ka gabuar me Kinën, se Stalini ka gabuar (dhe, sipas Maos, Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik ka njohur gabimin), se Bashkimi Sovjetik ka dhënë direktivën që Partia Komuniste e Kinës të bashkëpunonte me Guomindanin, kur nuk duhej etj., etj. Të gjitha këto thuhën qosheve dhe korridoreve dhe mendoj se kanë për qëllim të ngrenë Maon «që s'ka gabuar kurrë» dhe të ulin Stalinin «që ka gabuar».

Ç'mund të konkludojmë nga gjithë këto gjëra, për të cilat s'ka asnjë analizë? Stalini dhe Kominterni, në vija të përgjithshme, s'kanë gabuar as mbi luftën revolucionare në Kinë dhe as mbi aleancën e Partisë Komuniste të Kinës me Guomindanin. Kurse Maoja dhe Partia Komuniste e Kinës kanë gabuar, këta as që e kanë interpretuar dhe as që e kanë zhvilluar drejt në jetë vijën e Kominternit. Për çlirimin e Kinës kundër kolonizatorëve, kundër Japonisë militariste, duhej aleanca e këtyre dy forcave, komuniste dhe borgjeze përparimtare. Ka mundësi që në këtë luftë, në këto kontakte, njerëz si Bluhëri e të tjerë delegatë të Kominternit, që dolën trockistë dhe u dënuan, të kenë gabuar, por vija e Kominternit për aleancën e forcave përparimtare në Kinë, që luftonin kundër Japonisë, ka qenë e drejtë. Çan Kai Shia tradhtoi, ai u nda nga komunistët, u përpoq t'i likuidonte këta, e dobësoi luftën kundër Japonisë dhe hoqi

1 Italisht — brendapërbrenda, fshehtëazi.

dorë prej saj. Ky është një problem që lidhet me një periudhë të errët e të koklavitur dhe për këtë nuk mund t'i hidhet faji as Stalinit, as Kominternit, siç bëjnë shokët kinezë. «Stalini ka bërë gabime», pretendon Maoja, por, në fakt, është vetë Mao Ce Duni që ka bërë gabime dhe jo vetëm atëherë që do të ketë bërë, por edhe tash ka bërë shumë gabime, të cilat po i shohim bashkë me pasojat e hidhura të tyre. Në Kinë vazhdojnë të thonë se Maoja s'ka gabuar asnjëherë, as dje, as sot dhe as nesër nuk do të gabojë. Për kinezët, kjo është tabu, por është një pohim antimarksist.

Qëndrimi i Maos dhe i shokëve të tij ndaj Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit të lë të dyshosh. Ai nuk ka qenë i drejtë dhe i singertë. Gjatë kohës së luftës çlirimtare të Kinës, ne, të paktën, nuk dimë të jenë manifestuar mërira, sidomos nga ana e Stalinit, e Bashkimit Sovjetik dhe e Kominternit. Kan Sheni, një nga udhëheqësit më të mirë revolucionarë marksistë-leninistë të Kinës, ka qenë përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Kinës në Komintern dhe asgjë për keq nuk ka folur ai në këtë drejtim.

Ne e konsideruam Kinën e pasçlirimit një shtet të demokracisë popullore të udhëhequr nga një parti komuniste e lavdishme, në krye të së cilës ishte një marksist-leninist i madh, që quhej Mao Ce Dun. Si të gjitha vendet tona që u çliruan dhe vendosën rendin e demokracisë popullore, edhe Kina u lidh ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me Stalinin. Më vonë ne mësuam shumë gjëra për peripecitë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të Guomindanit, për «Marshimin e Madh», për miqësinë e Maos me oficerë dhe me gazetarë të huaj, si me amerikanin Edgar Snou e të tjerë, që qëndronin në shtabin e tij; mësuam për kontaktet «e frytshme» të Maos dhe të Çusë me Vandemejerin dhe Marshallin, që organizonin dhënien e ndihmave amerikane Maos dhe Çanit, si dhe

për lobitë kineze në Uashington. Këto natyrisht na bënin përshtypje, por i quanim thjesht taktika dhe jo prirje drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, siç u duk qartë më vonë. Te Maoja ne shihnim një komunist, te partia e tij një parti komuniste, dhe te Kina një vend socialist, mik tonin e, në radhë të parë, të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit.

Sa ishte gjallë Stalini, Maoja vajti një herë në Moskë, ai u takua dhe bisedoi me Stalinin. Ç'biseda bëri, ne nuk dimë gjë, por e marrim me mend se Stalini e ka pritur shumë mirë Maon dhe me siguri i ka pasë akorduar Kinës çdo ndihmë që i ka kërkuar kjo. Vetë Partia Komuniste e Kinës ka deklaruar zyrtarisht se «Si Lenini, edhe Stalini kanë njohur se regjimi carist ka rrëmbyer toka të Kinës, të cilat duhet t'i kthehen se janë të sajat». Këto deklarata kinezët i bënë të njohura, kur Kina hyri në konflikt me revizionistët hrushovianë.

Pra, me sa mund të gjykojmë ne, Stalini e trajtoi Kinën si mike, si vend socialist, çështjen e kufijve ai e trajtoi në frymë marksiste-leniniste dhe Mao Ce Dunin e konsideroi singërisht si shok. Por, në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtoresh që u bë në Moskë në vitin 1957, pra që përpara Mbledhjes së 81 partive, Maoja, për të mbështetur Hrushovin, që po tradhtonte marksizëm-leninizmin, tha haptazi, me përbuzje dhe me ironi, se kur u takua me Stalinin, iu duk vetja «si nxënësi i vogël përpara mësuesit». Me këtë Maoja donte të mbronte dhe mbrojtë në fakt shpifjet e Hrushovit mbi «kultin e Stalinit», i cili gjoja «këtë Mao të madh» e kishte konsideruar si djalkë. Ky ishte një sulm që Maoja bënte kundër Stalinit. Këtë e them me plot bindje, se në takimin tim të parë me Stalinin, kur unë isha aq i ri dhe i emocionuar, Stalini, me atë sjelljen e tij aq të njerëzishme, me dashuri dhe respekt për shokun, më trajtoi si të barabartë dhe biseda e tij aq e ngrohtë e shkriu

menjëherë akullin tek unë. Maoja në atë mbledhje shkoi edhe më tej, ai i dha të drejtë Hrushovit që likuidoi grupin «antiparti» të Molotovit etj., bile e quajti Hrushovin «Lenini i kohëve tona».

Ç'mund të nxjerrim nga këto veprime të Maos?

Se Maoja ishte kundër Stalinit dhe, bashkë me shokët e tij, punonte që të ngrinte kultin e vet. Qëllimi ishte që Stalinit «të rrëzuar dhe të njollosur» nga tradhtarët, Maoja t'i zinte vendin në radhën e marksistëve të mëdhenj në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai mendoj se, për hir të ndihmës që po i jepte Hrushovit në këtë rast, ky do ta favorizonte kultin e ri të Maos dhe Kina do të bëhej qendra e revolucionit. «Fryn era e Lindjes», «Lindja është e kuqe», «Mao Ce Duni është dielli i botës» — këto ishin sloganet që lëshonte atëherë propaganda kineze.

Por nuk ngjau siç mendonte dhe dëshironte Maoja. Revizionizmi sovjetik dhe Hrushovi i treguan atij bërnylin. Maoja dhe maoistët u përpoqën të mos i çonin punët majë më majë, por ato s'mund të zhvilloheshin ndryshe. Atëherë taktika e Mao Ce Dunit ndryshoi. Vazhdoi ngritja në qiell e kultit të Maos si «marksist-leninist i madh», që luftonte kundër revizionizmit modern dhe, në radhë të parë, kundër atij sovjetik, e njëkohësisht edhe kundër imperializmit amerikan dhe borgjezisë reacionare botërore. Një luftë e tillë ishte e drejtë, prandaj ne e përkrahëm dhe kinezët na përkrahën ne. Por, në fakt, ata e përdorën këtë taktikë jo nga pozitë klasore dhe në rrugën marksiste-leniniste. Kinezët me këtë taktikë dëshironin dhe u përpoqën të forconin pozitë e Kinës në lëvizjen komuniste dhe në popujt e botës si një «shtet me të vërtetë socialist, i papajtuëshëm me armiqtë e klasës dhe të popujve që luftonin për çlirim». Ndërkaq Maoja dhe maoistët brenda në partinë e tyre duhej të luftonin fraksionin e djathtë të Liu Shao Çisë, Çu En Lait,

Ten Hsiao Pinit e të tjerë, që, nën hijen e Maos, luftonin për rivendosjen e kapitalizmit dhe kishin synime ta kthenin politikën drejt miqësisë me hrushovianët.

Mao Ce Duni ishte vënë në mes dy zjarresh që, në fakt, i kishte ndezur vetë, me qëllim që të arrinte objektivat e tij, ta kthente Kinën në një fuqi të madhe botërore. Ai u gjend kështu në mes revizionistëve sovjetikë dhe fraksionit të rrezikshëm të Liu Shao Çisë. Atëherë ai shpërtheu Revolucionin Kulturor, për të cilin këtu nuk do të zgjatem, se kam folur e kam shkruar shumë.

Ç'rrugë zgjodhi Maoja (sepse më duket se këtu s'bëhet fjalë për vullnetin e partisë) për të arritur në këto qëndrime jomarksiste? Ai filloi të ndiqte një vijë konformiste. Sa ishte Stalini gjallë, vija e Maos ishte «miqësore» dhe «admiruese» ndaj Stalinit. Në atë kohë kultivohej në Kinë miqësia me Bashkimin Sovjetik. Pas vdekjes së Stalinit Maoja u tregua oportunist dhe u orvat të zinte vendin e Stalinit në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Nga ana e tij filluan edhe lajkat për të gënjyer Hrushovin dhe, natyrisht, lëshoi kritikën kundër Stalinit. Para nesh në Pekin, në vitin 1956, ai mbrojti revizionistin dhe tradhtarin Tito, sepse ishte edhe vetë një revizionist, një liberal, një përkrahës i Hrushovit.

Pas prishjes me Hrushovin, kur Liu dhe Teni ishin në fuqi dhe në vende kyç, në organet qendrore të Kinës u botuan një sërë artikujsh ideologjikë në vijën marksiste-leniniste kundër revizionistëve hrushovianë. Këta artikuj ishin teorikë dhe jo një propagandë e rëndomtë kundër revizionizmit. Kjo ishte një kthesë, natyrisht një kthesë e mirë, se, duke demaskuar teorikisht revizionizmin, edukohej Partia Komuniste e Kinës. Por ajo pati jetë të shkurtër. Artikujt e kësaj natyre u zhdukën nëpër sirtare dhe filloi të dukej një lëkundje në vijë. Partia Komuniste e Kinës nuk vazhdoi ta edukonte më masën e komunistëve në vijën e drejtë marksiste-leniniste, por u

kufizua duke botuar artikuj ideologjikë të Partisë sonë. Neve na vinte mirë për këtë, por nuk donim, dhe mendonim se nuk ishte e drejtë, që Kina ta pushonte polemikën kundër revizionizmit dhe të tërhiqej nga sheshi i luftës. Kjo tregonte përsëri lëkundje liberale në vijën e Partisë Komuniste të Kinës. Botimi i artikujve tanë teorikë në shtypin kinez kishte për qëllim jo të mbështeste vijën tonë marksiste-leniniste, por të krijonte përshtypjen se Partia Komuniste e Kinës nuk kishte ndërruar qëndrim në vijë, të fshihte kthesën liberale që po bënte dhe të linte përshtypjen në opinionin botëror se «jam unë, Kina, që ia diktoj Partisë së Punës të Shqipërisë këta artikuj, këtë vijë». Dhe shtypi borgjez botëror fliste hapur se «Shqipëria është satelite e Kinës», se «Shqipëria është gramafoni i Kinës», se «ato që mendon Kina, ia dikton Shqipërisë dhe kjo i shpreh». Ky ishte një qëndrim jo i ndershëm, jomarksist nga ana e Kinës. Por, derisa propagandoheshin idetë marksiste-leniniste të Partisë sonë, ne thoshim «tymi le të vejë drejt». Mirëpo në Kinë tymi nuk shkonte drejt.

Ra Hrushovi. Përnjëherë doli në dritë vija oportuniste e Maos. Ai mendoi se erdhi koha e tij; prandaj, nëpërmjet Çu En Lait, i cili vrapoi në Moskë, kërkoi që edhe ne të venim të merrnim pjesë në «dasmën» e revizionistëve. Ne e refuzuam kategorikisht këtë hap oportunist, refuzuam, gjithashtu, kategorikisht propozimin kinez «për krijimin e një fronti antiimperialist bashkë me revizionistët». Kjo tregonte dëshirën e zjarrtë të udhëheqësve kinezë për t'u puqur me revizionistët sovjetikë, por si revizionistë synonin që në këtë rrugë ata të dominonin vetë. Kjo nuk u doli.

Plasi Revolucioni Kulturor. Ky revolucion ishte rezultati i luftës në mes dy rrymave të djathta liberale revizioniste, se kush të merrte pushtetin: Maoja apo Liu. Në këtë ndeshje fitoi Maoja, i cili Liun dhe Tenin i aku-

zoi «armiku numër një» dhe «armiku numër dy». Çunë, Maoja e futi në shërbim të tij, sepse ky, ashtu si dhe Mikoja në Bashkimin Sovjetik, ishte shërbëtori i të gjithëve. Maoja na doli si «shpëtimtar», si «revolucionar», se po bënte «revolucion», dhe iu shtua fama si «marksist-leninist i madh», mbasi fitoi mbi Liu Shao Çinë.

Ne e mbështetëm Revolucionin Kulturor dhe ishim e vetmja parti në fuqi në krah të tyre. Vetë udhëheqësit kinezë e njohën këtë mbështetje të madhe dhe e propaganduan shumë.

Natyrisht, Revolucioni Kulturor, siç e kam thënë edhe më parë, nuk mbështetej në një vijë të qartë marksiste-leniniste, se partia që shpartalluar, organizatat e masave, gjithashtu, nuk ekzistonin. Vetëm ushtria me Lin Biao qëndronte pa lëvizur pro revolucionit. Çdo gjë ishte rrënujë, çështja ecte *par inertia*. Çuja, që shkonte nga frynte era, mbante timonin e pushtetit me një dorë dhe me tjetrën tundte «librin e kuq» të Maos, që kishte përgatitur Lin Biaoja. Gjatë Revolucionit Kulturor u shpreh me forcë ksenofobia, derisa u dogjën ndërtesa ambasadash të huaja, u rrahën diplomatët etj. Në krye të këtyre veprimeve të shëmtuara, që u ngjisnin atyre që kishte bërë Suhartoja në Indonezi, ishte edhe vetë Çu En Lai.

Teni dhe Liu me shokë «u mposhtën», por duhej ngjitur ç'që thyer, dhe në fakt ishin thyer shumë gjëra. Këto rregullime i bënte revizionisti Çu En Lai, gjoja me udhëzimet e kryetarit Mao, i cili, në kohën e Revolucionit Kulturor, i shkruante gruas së tij se «shkrimet e mia do t'i përdorin edhe revolucionarët, edhe kundërrivolucionarët». Vetë Maoja pohonte se ai nuk kishte një vijë marksiste-leniniste, por dy dhe dhjetë vija, njëlloj si teoria e «lulëzimit të njëqind luleve».

Partia jonë ka bërë çmos që të forcohej miqësia në mes të dy vendeve dhe të dyja partive tona, por kinezët shumë herë kanë refuzuar të shkëmbejnë delegacione

pune midis partive tona. Çdo delegacion ata e kthenin në delegacion «miqësie» për mitingje në masë dhe për fjalime në bankete me dollira. Ne konstatojmë se **udhëheqësit kinezë nuk e donin një shkëmbim eksperience të partisë së tyre me Partinë tonë, ata u ruheshin debateve politike, ideologjike dhe organizative.** Kjo ishte një derë e mbyllur. Unë, ashtu si edhe shokët e tjerë, në biseda me Çunë dhe me Jao Ven Juanin, gjenim rastin të flitnim për probleme partie, duke marrë shkas nga eksperiencia jonë, por ata vazhdonin me formulat e tyre bajate. Vetëm një herë, Çuja, ky element liberal dhe oportunist, kur erdhi te ne, na bëri një kritikë sikur Partia jonë gjoja nuk zhvillonte luftën e klasave. Kur ne e vumë përpara me fakte, duke i treguar se gjithë jetën Partia jonë ka zhvilluar një luftë klase të ashpër, brenda dhe jashtë vendit, si dhe në vetë gjirin e Partisë, i ndodhur përpara fakteve, ai u detyrua të kërkonte falje se «nuk e njoh si duhet historinë e Partisë suaj».

Po ashtu ne nuk e shihnim të drejtë vijën e izolimit të Kinës në arenën ndërkombëtare. Ne ia kishim shtruar pikëpamjet tona zyrtarisht Li Hsien Nienit, duke arsyetuar se lufta duhej vazhduar e ashpër kundër dy superfuqive, kurse me popujt dhe me shtetet e tjera Kina duhej të hapej, se kështu do të përçanim armiqtë tanë kryesorë dhe do të shqelmonim propagandën e tyre shpifëse kundër vendeve tona. Por kinezët qëndronin në pozitat e tyre dhe nuk ndiqnin këtë rrugë të arsyeshme dhe në interesin e Kinës, tonin dhe të popujve të tjerë të botës. Kinezët na çuditnin me qëndrimet e tyre. Në këtë rast ata nga liberalë tregoheshin sektarë. Liberalizmi dhe sektarizmi janë motër e vëlla. Kina e injoronte krejt Evropën, ruante qëndrime armiqësore me vendet e Azisë dhe, për vendosjen e marrëdhënieve normale me shtetet e ndryshme, kishte vënë përpara kushtin e njohjes së Tajvanit si pjesë e tokës kineze. Kurse për Afrikën dhe

vendet e Amerikës Latine botonin nga një artikull propagandistik një herë në hënë në «Zhenminzhibao». Në arenën ndërkombëtare politika e Kinës ishte e ngrirë, sektare, megalomane, në izolim dhe ksenofobe, si të thuash, deri në «racizëm të verdhë» të padeklaruar.

Kur ne po shqetësoheshim në këtë drejtim, plasën si bombë vizita e fshehtë në Kinë e Kisingerit dhe bisedimet e fshehta të tij me Maon dhe me Çunë. Kina filloi një periudhë të re, një politikë të re, prapë të gabuar, politikën e djathtë në drejtim të afrimit me amerikanët, por që do të shkonte shumë më tej, deri te fashistët Franko në Spanjë dhe Pinoçet në Kili.

U duk qartë se në hapjen e Kinës në marrëdhëniet e saj me shtetet e ndryshme të botës, arsyeja që «pengonte» s'kishte qenë njohja e ishullit të Tajvanit si tokë kineze. Si në mënyrë magjike ky problem u shkri dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës filluan lidhjet dhe marrëveshjet me Kinën, pa bërë, në fakt, asnjë lëshim deri tani për Tajvanin. Lidhjet dhe marrëveshjet e fshehta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vajtjen e Niksonit në Kinë ne i kundërshtuam, si shokë që ishim, duke u folur se kjo miqësi që lidhej nga kinezët me imperializmin amerikan, nuk do të sillte asgjë të mirë përveç së keqe për vetë Kinën, për socializmin dhe për mbarë botën. Letrës sonë për këtë çështje, por edhe për çështje të tjera, siç kam shkruar edhe më përpara, Mao Ce Duni as që denjoi t'i përgjigjej.

Pse ngjau kjo kthesë e Kinës drejt imperializmit amerikan? Për arsye se Maoja dhe Çuja ishin revizionistë, liberalë, oportunistë dhe se politika e tyre ishte një politikë pragmatiste e që synonte ta ngrinte Kinën në një superfuqi. Që të arrihej një gjë e tillë, sipas Maos dhe Çusë, Kina duhej të mbështetej te Bashkimi Sovjetik revizionist ose tek imperializmi amerikan. Lufta në të dy krahët nuk ishte gjë për Maon. Kina, sipas tij, «duhej

të mbështetej te njëra superfuqi, për të luftuar tjetrën dhe asaj t'ia nxirrnin të tjerët gështenjat nga zjarri». Këtë punë bëri edhe Bashkimi Sovjetik. Edhe ky s'pranoi të lidhej me Kinën, sepse, kuptohet, Bashkimi Sovjetik nuk pranonte që të sundohej nga Kina. Maoja, nga ana e tij, s'ia arriti dot qëllimit që Bashkimi Sovjetik t'i shërbente Kinës. Bashkimi Sovjetik u hap drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, superfuqi e pasur, nga të cilat mund të merrte kredi dhe të vendoste kështu hegjemoninë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana e tyre, e pranuan këtë hapje për të rindarë sferat e influencës me Bashkimin Sovjetik dhe për ta dobësuar këtë.

Kina asgjë origjinale nuk bëri. Edhe kjo, duke e parë se qëllimi që kishte ndaj Bashkimit Sovjetik dështoi, u kthye nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga miqësia e vjetër e Maos. Çuja, po, donte famë, donte dominim. Të dy, Maoja dhe Çuja, ishin revizionistë. Ata përgatitën politikën e re. Mirëpo në rrugën e tyre kishte kundërshtarë brenda dhe një nga më kryesorët ishte Lin Biaoja. Atëherë ky duhej eliminuar dhe u eliminua me akuzën si «komplotist që donte të vriste Maon, por që u zbulua, mori avionin dhe u nis për në Bashkimin Sovjetik, nëpërmjet Mongolisë, mirëpo avioni i tij u dogj në stepat mongole». Pra, Lin Biaoja u vra si «agjent i sovjetikëve».

Në Kongresin e 9-të të Partisë Komuniste të Kinës, që u bë kur qe gjallë Lin Biaoja, flitej për luftën në të dy krahët, ndërsa më vonë, në kongresin e 10-të, pas vrasjes së Lin Biaos, asnjë fjalë nuk u tha se ç'politikë të jashtme mbronte Lin Biaoja.

Vrasja e Lin Biaos ishte një peshqesh që u vu në duar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat u kënaqën. U shkri akulli. Tash Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si arbitër i botës, do të manovronin edhe nga Bashkimi Sovjetik, edhe nga Kina, kuptohet, për interesat

e tyre. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dozan dhe vazhdojnë të dozojnë si duhet qëndrimet me të dy, edhe Bashkimin Sovjetik ta dobësojnë e të manovrojnë që edhe Kinën ta përdorin kundër Bashkimit Sovjetik. Dhe kështu ngjet. Kina efektivisht e pushoi luftën kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe intensifikoi deri në absurditet propagandën kundër Bashkimit Sovjetik. Them propagandën, sepse artikuj ideologjikë nga ana e Kinës për demaskim kundër Bashkimit Sovjetik nuk ka. **Vija e Kinës në këto momente është: «Armiku ynë kryesor është Bashkimi Sovjetik». Kush del kundër Bashkimit Sovjetik, është miku i Kinës, qoftë ky edhe fashist.** Kështu, ndërsa ndaj vendit tonë, që lufton në të dy krahët — kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe socialimperializmit sovjetik — Kina po mban qëndrime jomiqësore, shtetet revizioniste proamerikane që bëjnë disa manovra antisovjetike, janë bërë miqtë e Kinës. Këtë qëndrim «e mbajmë për të forcuar dhe për të thelluar kontradiktat», thonë kinezët. Por realiteti tregon se Kina e Maos është dakord me këto shtete, se e tillë është vija e saj revizioniste në ideologji dhe në politikë. Lidhjet e Kinës janë zhvilluar me të gjitha vendet kapitaliste të botës dhe për vete ajo u deklarua zyrtarisht pjesëtare e «botës së tretë». U hapën dyert e Kinës për presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për mbretërit, princërit, princeshat, kryeministrat, senatorët, grupet parlamentare, afaristët, për derrin dhe për dosën. Dyert e Kinës janë mbyllur vetëm për delegacionet zyrtare shqiptare.

Populli kinez ka një dashuri të sinqertë për popullin shqiptar dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë. Revizionistët kinezë nuk kanë guxuar akoma ta atakojnë këtë miqësi. Kuadrot kryesorë të djathtë që, sipas mendimit tonë, në Kinë janë në fuqi dhe kanë pozita të forta, po godasin marrëdhëniet ekonomike që ekzistojnë midis nesh.

Ata nuk po realizojnë kreditë që na janë akorduar, shtyjnë afatet e livrimit të objekteve që ndërtojmë, kanë ulur nivelin e tregtisë, po ngushtojnë në minimum sferën e kontakteve me vendin tonë. Me një fjalë, udhëheqësit kinezë janë futur në rrugën e Hrushovit kundër nesh. Ata mësuan nga bllokada sovjetike, e cila erdhi brutalisht, kurse bllokada e këtyre realizohet ngadalë dhe e mbuluar me qëndrime e deklarata hipokrite, si «jemi miq, jemi të varfër, na kuptoni» etj. E tërë kjo kthesë është e djathtë, revizioniste, socialimperialiste.

Kjo është vija e Maos dhe e Çu En Lait, të cilët rehabilituan Tenin dhe e përgatitën që ky të zëvendësonte Çunë dhe Çuja Maon pas vdekjes së këtij. Por personi «i mesëm» i «Perandorisë së Mesit» vdiq i pari. Me vdekjen e tij «radikalët» nuk e pranuan Tenin dhe filluan demaskimin e tij. Kjo gjë bëri që në Kinë, në parti dhe në pushtet, të dalin në pah dy vija, dy grupe rivale, dhe Maoja ndodhet tash në mes të dy rrugëve. Por ai është plak dhe s'mund të veprojë më. U realizua ajo për të cilën e kishte paralajmëruar ai Çian Çinin dikur në letrën që i dërgonte se edhe reaksionarët, edhe revolucionarët do ta përdorin maocedunidenë.

Pra në Kinë po luftohet, po kush vallë do të fitojë?! Kjo nuk dihet. «Radikalët» kanë në dorë vetëm propagandën, të tjerët kanë në dorë politikën e jashtme, ekonominë dhe ushtrinë, sepse asgjë, në fakt, nuk ka ndryshuar nga kursi i vjetër Mao-Çu-Ten.

Teni është në parti dhe ai po demaskohet, por shokët e tij janë në pushtet, politika me Shtetet e Bashkuara të Amerikës po vazhdon e lulëzon. Kina mbështet, gjithashtu, të gjitha qeveritë dhe shtetet reaksionare. Partia Komuniste e Kinës i këshillon marksistë-leninistët, ngado që janë, të bashkohen me borgjezinë e vendeve të tyre, qoftë kjo edhe fashiste, dhe të mbrojnë aleancat e tyre

reaksionare, vetëm të luftojnë kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Ku po shkon Kina me këtë vijë? Drejt një socialimperializmi të ri, drejt marrjes së fuqisë nga kapitalistët e rinj, por edhe të vjetër, që vija oportuniste e Maos i ka mbajtur në fuqi, i ka ruajtur dhe i ka forcuar.

Në Kinë medoemos ka forca të shëndosha marksiste-leniniste, por unë mendoj se këto nuk mund të identifikohen me të ashtuquajturit radikalë. Këta janë kundër të djathtëve, por janë maoistë, liberalë, për bashkekzistencën e dy vijave në parti. **Vetëm një përmbysje e fortë revolucionare marksiste-leniniste do ta shpëtojë Kinën nga rivendosja e kapitalizmit.**

BIE TEN HSIAO PINI, HIPËN HUA KUO FENI

Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA transmetoi dy komunikata rreth punimeve të KQ të PK të Kinës. Komunikata e parë njofton se KQ ka aprovuar rezolutën që shpall se me propozimin e vetë kryetarit Mao Ce Dun, Hua Kuo Feni emërohet zëvendëskryetar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe kryetar i Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës, pra Huaja gradohet.

Komunikata e dytë njofton se KQ ka aprovuar një rezolutë tjetër ku thuhet se pasi u diskutua incidenti kundërrevolucionar në sheshin Tien An Men dhe sjellja e kohëve të fundit e Ten Hsiao Pinit, natyra e problemit të tij, domethënë e Tenit, «është kthyer në një kontradiktë antagoniste», prandaj Mao Ce Duni ka propozuar dhe Byroja Politike ka rënë dakord që Teni të shkarkohet nga të gjitha postet brenda dhe jashtë partisë «por duke e lënë anëtar partie, për të parë si do të sillet në të ardhmen». Teni, pra, rrëzohet.

Punë kinezësh! Le të shohim edhe ne si «do të sillet» dhelpra Ten në të ardhmen.

PK TË HOLANDËS (M-L) T'I SHPJEGOJMË VIJËN TONË

Ramizi më informoi për bisedën që patën shokët e Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror me të deleguarin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Hollandës (marksiste-leniniste). Ky kishte vënë në dukje se partia e tyre ndodhet në konfuzion dhe përpara dilemës se ç'rrugë të ndjekë: të mbrojë NATO-n dhe të luftojë socialimperializmin sovjetik, armikun kryesor, apo t'i luftojë të dy njëkohësisht. Ai tregoi se kanë shkuar në Kinë dhe atje u kanë shtruar vijën që ndjek Partia Komuniste e Kinës, e cila është për «Evropën e Bashkuar», për Tregun e Përbashkët Evropian etj., domethënë të mbrohet NATO-ja dhe të luftohet socialimperializmi sovjetik. Ne, tha shoku holandez, këto teza i shtruum në komitetin qendror të partisë dhe atje u ngritën shumë mendime: kishte mendime pro pikëpamjes kineze, si dhe kundër kësaj pikëpamjeje. Sekretari i partisë sonë, tregoi ai, ka konkluduar se «ne nuk mund ta mbrojmë NATO-n, se kjo është një armë e imperializmit amerikan dhe e borgjezisë kapitaliste. Punëtorët as që do të na kuptojnë, ca më shumë që ne e kemi luftuar kurdoherë këtë organizatë». Megjithatë, para ca kohësh, vazhdoi shoku holandez, ne botuam një artikull, ku pohonim që «armiku kryesor është socialimperializmi sovjetik». Menjëherë një grup jomarksist-leninist, po që hiqet si i tillë, na sulmoi, duke

na akuzuar se jemi me NATO-n. Përfaqësuesit e këtij grupi shkuan në Kinë dhe, kur u kthyen andej, filluan të flitnin pro NATO-s dhe vetëm kundër Bashkimit Sovjetik.

Partia Komuniste e Kinës i ka futur në konfuzion. I deleguari i Partisë Komuniste të Holandës (marksiste-leniniste) nuk e tha, po me bisedën që bëri linte të kuptohej se kërkonte mendimin tonë.

Ne nuk dimë kush janë këta, por, sidoqoftë, duhet t'u bëjmë të njohur vijën tonë, pa bërë as më të voglin aluzion për Kinën. Në thelb t'u thuhet vija e Partisë sonë e vendosur nga kongresi:

Shqipëria është një vend i diktaturës së proletariatit që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste. Në vendin tonë socialist s'ka klasë borgjeze, ajo është likuiduar si klasë, por ka vetëm dy klasa mike: klasa punëtore që udhëheq dhe fshatarësia kooperativiste në aleancë me të. Në Partinë tonë, sipas teorisë marksiste-leniniste, s'ka dy vija, por një; teoria e luftës së klasave është në veprim si brenda vendit, edhe në parti, dhe kjo duhet të vazhdojë t'i shtypë armiqtë e klasës e të pushtetit të diktaturës së proletariatit.

Në politikën e jashtme vija jonë është e qartë: çdo gjë shikohet në prizmin e marksizëm-leninizmit, në prizmin klasor.

Për Partinë tonë s'ka as dy, as dhjetë botë, por ka proletariatin dhe fshatarësi të varfër e të mesme, ka punonjës demokratë të shtypur dhe, nga ana tjetër, ekzistojnë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia kapitaliste botërore. Këta shtypin proletariatin dhe popujt me organizime dhe organizma të ndryshëm. Ne marksistë-leninistët, proletariati dhe popujt duhet të ngrihemi në revolucion dhe t'i luftojmë armiqtë tanë pa mëshirë. Kjo luftë nuk është as e thjeshtë dhe as e kollajtë, por, për ta zhvilluar atë, duhen qartësi politike e ideologjike dhe organizim i fortë, duhet ta për-

shtatim drejt teorisë tonë në kushtet reale të vendit dhe në kushtet botërore.

Partia jonë, pra, lufton dhe i quan po njëllot të rrezikshme të dyja superfuqitë dhe borgjezinë kapitaliste botërore në çdo vend, prandaj lufta e çdo partie komuniste (marksiste-leniniste) duhet të drejtohet kundër të dyja superfuqive si dhe kundër borgjezisë reaksionare të vendit të vet, duhet të synojë t'i dobësojë këto dhe të shkatërrojë planet e tyre të veçanta e të përbashkëta. Kjo do të bëhet me qartësi ideologjike dhe me organizim. Këtu ndërhyjnë çështja e aleancave, por këto nuk mund të bëhen as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as me Bashkimin Sovjetik dhe as me shtetet që i ndjekin këta. Ne duhet të bëjmë aleancë me ata që i luftojnë superfuqitë dhe ndjekësit e tyre (të shpjegohet aleanca sovjetogjermane që ishte e drejtë, rrethanat dhe vendosmëria e përhershme e Stalinit kundër fashizmit). T'i thuhet shokut holandez se Partia jonë nuk mund të mbështetet te një imperializëm për të luftuar imperializmin tjetër, ajo nuk mund të nxitë luftën botërore grabitqare, por lufton për revolucionin, për të thyer e për të prishur planet e luftërave të imperialistëve. Në qoftë se këta do të arrijnë që ta shpërthejnë këtë luftë grabitqare, ne duhet ta kundërshtojmë, ta kthejmë këtë në luftë civile, në luftë të drejtë, kundër imperialistëve, kundër socialimperialistëve dhe borgjezisë reaksionare.

Më në fund t'i thuhet se kjo është vija jonë e hapët dhe e njohur botërisht. Ne pranojmë të diskutojmë me çdo parti marksiste-leniniste dhe as që dëshirojmë t'ia imponojmë kurrkujt këtë vijë, ashtu sikundër Partia jonë nuk mund të pranojë nga kurrkush një qëndrim që ajo e gjen jo të drejtë dhe të gabuar.

Juve, shokë, t'i thuhet, ju flasim hapur. Në qoftë se gjeni ndonjë gjë të mirë, na e thoni, ato me të cilat s'jeni dakord, prapë na i thoni dhe ne jemi gati t'i diskutojmë.

E MARTË

20 PRILL 1976

HAP I RËNDËSISHËM PËR FORCIMIN E PAVARËSISË SË EGJIPTIT

Shënime për artikull¹

Denoncimi i Traktatit Sovjeto-Egjiptian dhe dëbimi i flotës sovjetike nga Republika Arabe e Bashkuar është një akt që tregon se populli dhe qeveria egjiptiane kuptuan dhe panë qartë rrezikshmërinë e dhënies së koncesioneve për flotat e superfuqive, të cilat përbëjnë rrezik për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Flotat e superfuqive gjejnë momentet e krizës dhe ofrohen gjoja si ndihmë për të mbrojtur interesat e atij vendi që «sulmohet» nga një fuqi tjetër. Ato vijnë të maskuara si mike, por shndërrohen në armike të popujve.

Ne e përkrahëm vendimin e qeverisë së Egjiptit dhe jemi të bindur se populli egjiptian dhe udhëheqësit e tij nuk do të lejojnë në portet e veta asnjë lloj flote të kujtdo superfuqie apo gjoja aleati e miku të maskuar.

Ky veprim i Egjiptit, që është në interes të të gjitha vendeve të Mesdheut, duhet të ndiqet, mendojmë ne, edhe nga të tjerët, në mënyrë që të mos gjejnë vend në portet

¹ «Dëbimi i flotave të superfuqive nga Mesdheu — veprim i rëndësishëm për forcimin e pavarësisë dhe të sigurimit të përgjithshëm». «Zëri i popullit», 30 prill 1976.

e tyre, në çfarëdo forme qoftë, anijet e luftës të luftënxitësve imperialistë e socialimperialistë.

Këto pikëpamje që përbëjnë një aspekt të politikës së jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë, janë shprehur nga ana jonë shumë vjet më parë.

Koha vërteton se mospranimi i flotave të huaja është, njëkohësisht, në interes të vendit që nuk bën koncesione, si dhe në interes të vendeve të tjera, në interes të popujve që dëshirojnë të rrojnë në fqinjësi të mirë me gjithë popujt e tjerë, e veçanërisht me popujt e Mesdheut.

Çdo shtet është sovran e i lirë të bëjë politikën e tij si e mendon ai, si e gjykon ai, për të mbrojtur interesat e vendit të vet. Ne mendojmë se nuk është e lejueshme që mbrojtja e interesave të një vendi të prekë interesat e një vendi tjetër. Ca më shumë nuk pranojmë që për të mbuluar veprime të tilla që rrezikojnë paqen, të gjenden pretekste e të bëhen shpifje kundër atyre shteteve që kanë një politikë korrekte mbrojtjeje, një politikë që është në interes të vendit të tyre dhe të vendeve fqinje me të cilat dëshiron të rrojë në paqe e në fqinjësi të mirë. Ne e kemi shprehur haptazi pakënaqësinë tonë se dhënia e koncesioneve nga ana e jugosllavëve, në çfarëdo kushtesh, luftanijeve sovjetike që qarkullojnë si bisha në Mesdhe, gjoja për t'u riparuar etj., është veprim i rrezikshëm jo vetëm për Jugosllavinë, por edhe për Shqipërinë. Neve nuk na interesojnë kushtet me të cilat i ka dhënë Jugosllavia këto koncesione, por ne dimë se këto anije përbëjnë rrezik të madh për pavarësinë e fqinjëve jugosllavë dhe konkretisht për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Qeveria jugosllave mund të pretendojë ç'të dojë, por, kur në kohë krize revizionistët sovjetikë të vendosin për të sulmuar, e kanë më lehtë të vijnë e të sulmojnë Republikën Popullore të Shqipërisë nga portet e Splitit, të Dubrovnikut, të Kotorrit etj., sesa të vijnë nga Mesdheu

duke kaluar nëpër kanalën e Otrantos. Këtë veprim agresor s'e ndalon dot Jugosllavia. Anijet që mund të gjenden në porte për riparim e vizitë, në momentet e volitshme dalin në det të armatosura dhe sulmojnë Shqipërinë.

Qeveria jugosllave mund të thotë se për këtë lan duart! Por ne s'e lëmë të lajë duart, prandaj po e denoncojmë këtë veprim. Një sulm i socialimperialistëve sovjetikë mund të drejtohet edhe kundër vetë Jugosllavisë, ndoshta jo kur anijet janë në porte, të çarmatosura, por kur të dalin nga portet, të armatosura.

Jugosllavët pretendojnë se i kontrollojnë këto veprime, por ata nuk mundën të kontrollonin një anijen e tyre që sulmoi një anije peshkimi shqiptare dhe vrau edhe kapitenin e saj. Ky është akt i dënueshëm, i cili nuk mbulohet dot me pallavra e justifikime nga ata që kryen krimin. Edhe në këtë çështje, si në të tjerat, jugosllavët nuk mund të lajnë duart.

Edhe sekretari federativ jugosllav për Punët e Jashtme, Miniç, që mbajti një fjalim para oficerëve të garnizonit të Beogradit, akuzoi Shqipërinë. Ne i hedhim poshtë «arsyetimet» e Miniçit, sepse nuk është Shqipëria luftënxitëse, nuk ndjek ajo politikë luftënxitëse. Të tillë janë të gjithë ata që kryejnë veprime kundër saj, janë jugosllavët që përpiqen t'i mbulojnë fajet e tyre.

Ne u themi Bakejve dhe Çakejve që të mos shpifin e të mos sulmojnë Republikën Popullore të Shqipërisë, sepse edhe Shqipëria di të sulmojë dhe, po të fillojë të sulmojë, do ta bëjë këtë me arsye e me të drejtë e atëherë Bakejtë e Çakejtë s'do të dinë ku të futin kokën.

Republika Popullore e Shqipërisë ka mbajtur qëndrim të hapët e parimor; ajo ka respekt për veprimet e drejta të vendeve të ashtuquajtura të paangazhuara apo të botës së tretë, por nuk mund të pranojë që të hiqen si të paangazhuara shtete që janë të lidhura me një mijë fije me imperialistët amerikanë e me socialimperialistët sovje-

tikë e sidomos, në rastin për të cilin po bëjmë fjalë, kur lejojnë e u japin koncesione flotave luftënxitëse të superfuqive që kanë për qëllim të shtypin popujt e të nxitin luftën botërore. Ne i respektojmë e i duam popujt e miqtë, por e kemi zakon t'u flasim hapur e pa dorashka, sepse sinqeriteti është arma më e sigurt dhe e pazëvendësueshme për forcimin e miqësisë dhe të bashkëpunimit të sinqertë midis popujve.

Në qoftë se duam të evitojmë luftën botërore që e shkaktojnë dy superfuqitë, nuk duhet heshtur për veprimet e tilla, pale më t'i inkurajojmë ato.

Në qoftë se Miniçi flet për tregtinë dhe thekson se kjo është ndërhyrje në punët e brendshme, ne i themi se nuk kemi kërkuar asnjëherë llogari se sa e ka tregtinë ai me Bashkimin Sovjetik e me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Fjalët që përhapin ambasadorët jugosllavë se këto veprime u shërbejnë armiqve të përbashkët, të mos na thuhën neve, po atyre që po lidhen aq ngushtë me traktatet e marrëveshjeve me Bashkimin Sovjetik dhe me imperializmin amerikan. Janë larg kohët kur Jugosllavia kërkonte që Shqipëria të bëhej bisht i saj e t'u thoshte amin veprimeve të Jugosllavisë, prandaj mos na thoni që veprimet shqiptare ndihmojnë ata që s'na duan të mirën.

Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë kanë politikën e vet, ajo është e drejtë, sepse është marksiste-leniniste. Ne s'lëvizim nga kjo politikë sikur qiejt të përmbysen. Pikërisht për këtë qëndrim të drejtë, të arsyeshëm e asnjëherë armiqësor për popujt, miqtë, ngado që janë, na duan.

Ne themi që çdo shtet e çdo parti janë të lirë të bëjnë ç'të duan e si të duan. Edhe shteti ynë, i lirë nga

koniunkturat apo zinxhirë të ndryshëm, është i lirë të veprojë si të dojë.

Lenini na mëson se traktatet duhet të jenë të hapura dhe traktatet e fshehta ai i denoncoi. Pra, çdo traktat, i hapët ose i fshehtë, duhet t'i nënshtrohet gjykimit të opinionit të vendit dhe opinionit botëror, për të mirat që ky traktat mund t'i sjellë atij vendi dhe njerëzimit.

Denoncimi i Traktatit Sovjeto-Egjiptian është një hap pozitiv që mbron sovranitetin e Egjiptit, demaskon politikën e socialimperialistëve sovjetikë dhe i çjerr maskën miqësisë së rreme të Bashkimit Sovjetik me popujt arabë, prandaj edhe ne e kemi mbështetur këtë denoncim.

Akti i qeverisë egjiptiane tregon edhe një herë vërtetësinë e tezave të Partisë sonë mbi synimet e politikës imperialiste të Bashkimit Sovjetik ndaj popujve arabë, mbi qëllimin e «traktateve të miqësisë» e të «ndihmave» që socialimperialistët sovjetikë u ofrojnë popujve të tjerë, mbi përpjekjet e tyre për të sabotuar luftën e popullit palestinez e të popujve të tjerë arabë dhe për të vendosur sundimin sovjetik në botën arabe.

Por akti i Egjiptit për denoncimin e Traktatit Sovjeto-Egjiptian nuk duhet mbivlerësuar. Problemi duhet parë në kuadrin e gjithë politikës së Sadatit. Ndërsa ai merr një vendim të drejtë lidhur me marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, afrohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ia hap dyert e vendit imperializmit amerikan, duke krijuar kështu rreziqe të reja për lirinë e pavarësinë e popullit egjiptian dhe të popujve të tjerë arabë.

Zhvillimi i ngjarjeve tregon se popujt arabë duhet të jenë shumë vigjilentë. Ata mund të sigurojnë lirinë e pavarësinë e tyre të vërtetë, çlirimin e tokave të pushtuara nga Izraeli e të drejtat e popullit palestinez vetëm duke iu kundërvënë me vendosmëri politikës agresive hegjemoniste të të dyja superfuqive.

Ditët e fundit Sadati deklaroi se Egjipti u ka hequr sovjetikëve të drejtat për shfrytëzimin e porteve egjiptiane për flotën e tyre ushtarako-detare në Mesdhe. Pas denoncimit të traktatit, pritej që të merrej edhe ky hap.

Qeveria jonë, shumë vjet më parë, qysh në kohën e Naserit, e kishte njoftuar zyrtarisht e në mënyrë miqësore qeverinë egjiptiane për rreziqet që paraqet për pavarësinë e Egjiptit, si dhe për vendet e tjera sovraane të Mesdheut, politika e dhënies së bazave ose e lehtësive portuale në Egjipt flotës ushtarake të socialimperialistëve sovjetikë në Mesdhe. Jeta vërtetoi se asnjë popull nuk mund t'i mbështetë shpresat për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut të vet te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te Bashkimi Sovjetik dhe te flotat e tyre të luftës. Çdo iluzion në këtë drejtim përmban rreziqe reale që shpien në humbjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare.

MAO CE DUNI PRET MIQ EGJIPTIANË

Me gjithë zërat që qarkullojnë rreth sëmundjeve të rënda që kanë prekur Mao Ce Dunin, herë pas here, sidomos pas ndonjë «rregullimi» në udhëheqjen e lartë kineze (rreth dy javë më parë u njoftua rënia e Ten Hsiao Pinit dhe gradimi i Hua Kuo Fenit), ai nxirret në skenë për të pritur ndonjë mik të lartë.

Sot agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi se Mao Ce Duni priti zëvendëspresidentin egjiptian Hosni Mubarak, që ndodhet për vizitë në Kinë edhe pse ky është vetëm zëvendëspresident dhe «udhëheqësi i madh», kryetari i partisë, kryetari i gjithë kryetarëve të Kinës, rregullisht nuk pret personalitete të këtij rangu shtetëror.

**ANALIZË MBI GJENDJEN SHUMË SHQETËSUESE
NË ITALI**

Gjendja në Itali bëhet shumë shqetësuese, jo vetëm për vetë vendin, por edhe për fqinjët e saj. Ne shqiptarët jemi shumë të interesuar për çfarë po ngjet atje dhe për rrjedhimet e këqija që do të rezultojnë nga kjo gjendje.

Qeveritë e ndryshme italiane pas Luftës së Dytë Botërore, pa asnjë përjashtim, për të mos folur për periudhën e fashizmit musolinian, kanë mbajtur vazhdimisht qëndrim armiqësor ndaj Shqipërisë. Qëndrimet e tyre armiqësore kanë qenë të hapura dhe të maskuara. Vitet e para pas Çlirimit të vendit tonë u karakterizuan nga një luftë e pamëshirshme kundër diversantëve që na dërgoheshin nga Italia nëpërmjet detit dhe ajrit. Reaksioni tradhtar shqiptar, që u largua me anijet angleze, u grumbullua në Itali, u organizua dhe u stërvit të vepronte kundër Shqipërisë së re. Pa humbur kohë ai filloi veprimet e veta, por dihet ç'fat pësuan armiqtë. Të gjitha këto veprime armiqësore organizoheshin nga qeveritë italiane të pasluftës, nga armiku i përhershëm i Shqipërisë, Vatikani, dhe nga anglo-saksonët.

Një pjesë e tradhtarëve shqiptarë të arratisur mbetën në Itali, të tjerët u shpërndanë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë, në Belgjikë, në Britaninë e Madhe dhe në shumë vende të tjera, ku i hodhi era e spiunazhit. Qeveritë italiane e ruajtën të paprekur armiqësinë fashiste, borgjezo-kapitaliste kundër Shqipërisë së

re socialiste. Ato e panë se me aktet diversioniste s'mund t'i bënë dot gjë Shqipërisë dhe atëherë filluan të mbanin qëndrim politik «menefregist» ndaj shtetit shqiptar. Për të gjitha qeveritë italiane, pa përjashtim, Shqipëria socialiste nuk ekzistonte.

Midis dy shteteve tona u lidhën marrëdhënie diplomatike, por këto kanë qenë dhe mbetën krejt formale. Vendosja e këtyre marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nga ana e Italisë u arrit, se s'mund të bëhej ndryshe nga ana e saj, pse ishte një shtet i mundur. Por qëllimi i Italisë ishte sidomos të kishte një qendër informacioni në Tiranë, me anën e së cilës të përpiquej të lidhte fijet e këputura të spiunazhit fashist.

Asnjëherë, asnjë qeveri dhe asnjë zyrtar italian nuk njohu veprën barbare të Musolinit kundër Shqipërisë, por të gjithë ata u interesuan që të nxirrnin nga varret mijëra kufoma fashistësh italianë të vrarë nga partizanët tanë në Luftën Nacionalçlirimtare, t'i çonin në varrezat e Barit dhe atje t'i konsakronin si «heronj që kishin luftuar për madhësinë e Italisë». Fashistët, vrasësit, okupatorët, u bënë «heronj» nga qeveritë italiane pseudodemokrate.

Të gjitha qeveritë itallane nuk deshën kurrë të bënin tregti me Shqipërinë, duke menduar se kështu do të na dëmtonin ekonomikisht. Disa shkëmbime të vogla tregtare të këtyre viteve të fundit janë bërë pse ne blinim me devizë disa plugje ose ndonjë makineri të vogël. Tregu me shkëmbime gati nuk ekziston. Njëfarë tregtie që po bëhet, është e njëanshme. Gjithë shtypi italian, pa përjashtim, duke përfshirë edhe atë të revizionistëve të këtij vendi, nuk ka botuar kurrë diçka pozitive për Shqipërinë, veçse kundër.

Por në Itali ne kemi pasur edhe miq, edhe dashamirës që nuk bënë pjesë në qeveri e në pushtet dhe, kur gjenin rastin, flitnin mirë për Shqipërinë socialiste. Megjithëse me zor, ata përpiqeshin dhe kalonin në ndonjë

revistë disa opinione të drejta dhe reale për vendin tonë.

Italia, qëkurse u «çlirua», mbeti nën zgjedhën e imperializmit amerikan. Në këtë vend mbretëruan dhe vazhdojnë të mbretërojnë kaosi dhe degjenerimi i plotë moral, politik, ekonomik dhe ideologjik. Jo vetëm përfaqësuesit e vjetër të partisë fashiste dhe pjella e tyre rrojnë, grabitin dhe janë shpërndarë në të gjitha partitë e borgjezisë, por janë shtuar edhe të tjerë që kanë marrë në dorë frenat e Italisë dhe pasuritë e këtij vendi, të cilat i ndajnë në mes tyre dhe me kapitalin botëror, veçanërisht me atë amerikan.

Partia demokristiane, që pas Luftës së Dytë Botërore po e qeveris, e grabit dhe e shtyp popullin italian. Borgjezia e madhe italiane e korruptuar, nën shenjën e kryqit të Vatikanit, po grabit vendin dhe qëndron në fuqi e mbështetur nga forcat ushtarake amerikane, që kanë në Itali kryeurën e tyre kryesore. «Çizmen italiane» e kanë veshur Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata po u japin shkelma popullit italian dhe qeverive të shitura të këtij vendi. Në qoftë se thuhet që kapitali amerikan ka hyrë deri në grykë të një vendi, ai vend është Italia, pse borgjezia italiane është totalisht e degjeneruar, kozmopolite, e dhënë pas korrupsionit të gjithanshëm. Kjo e ka çuar Italinë në një falimentim të plotë.

«Çlirimi» i Italisë solli krijimin e një numri të tërë partish me tituj «demokratike», «socialiste», «socialdemokrate», «komuniste» etj., etj. Të gjitha këto kishin dhe ruajnë etiketa false, pse, në fakt, që të gjitha i shërbejnë borgjezisë reaksionare. Natyrisht, veprimtarinë e tyre të grabitjes dhe të shitjes së Italisë te të huajt e kanë rregulluar me «ligje» dhe me «kushtetutë», në hartimin e së cilës, të këtij «xhevahiri demokratik», morën pjesë aktive edhe «komunistët» me Toliatin në krye.

Partia Komuniste Italiane nuk bënte përjashtim nga partitë e tjera të borgjezisë, veçse nga emri. Vetë politika

dhe veprimet e saj tregojnë se ajo ka qenë e është një parti antimarksiste dhe revizioniste.

Është e vërtetë që në kohën e regjimit fashist kishte në mërgim komunistë italianë, por brenda nuk është ndier aq sa duhet, po të kemi parasysh forcën që kishte ajo, organizimi klandestin ose veprimtaria ilegale e Partisë Komuniste Italiane. Një shumicë e komunistëve të dalluar gjendeshin të internuar në ishujt. Gramshi, udhëheqësi kryesor i kësaj partie, u burgos dhe vdiq në burg.

Shumë krerë të «komunizmit» italian në ishuj ishin intelektualë të sëmurë. Ai marksizëm që kishin mësuar ata në seminarët e ishujve Lipari, binte më tepër erë nga teoria e Troçki, e Bernshtajnit dhe e komunizmit mëngjërash që e pati kritikuar posaçërisht Lenini në «Sëmundjen foshnjore të «majtizmit» në komunizëm». Këta elementë e treguan pas kapitullimit musolinian se çfarë «komunistësh» ishin.

Udhëheqësi i tyre, Toliati, gjatë gjithë kësaj kohe rronte në Moskë, ai ishte në udhëheqjen e Kominternit. Në këtë post të rëndësishëm Toliati diti të maskonte idetë e tij antimarksiste liberale. Seksioni italian që drejtonte ai nuk ndriti. Toliati u dërgua edhe në Spanjë, ku është e drejtë të thuhet se brigadat «Garibaldi» të organizuara me luftëtarë antifashistë italianë, në të cilat bënë pjesë dhe shokët tanë shqiptarë, qëndruan fort dhe luftuan trimërisht. Kjo tregon se Partia Komuniste Italiane kishte një brumë të shëndoshë, me të cilin mund të bëhej një bukë e mirë, po të mbruhej me kujdes. Por «fara», udhëheqja e saj, ishte socialdemokrate.

Këta «komunistë», me Toliatin në krye, që ishte një intelektual i zgjuar, ambicioz, dinak, por aspak marksist, zunë kryen dhe e organizuan partinë me forma organizative liberale, oportuniste dhe lanë krejt pas dore edukimin revolucionar të klasës punëtore dhe të anëtarëve të partisë. Klasa punëtore italiane ishte e madhe, e vuaj-

tur nga fashizmi e nga lufta, por edhe e çoroditur politiki dhe ideologjikisht. Shumë prej punëtorëve, në ditët e mjerimit të luftës dhe të pasluftës, kujtonin të paktën «koromanen» që hanin në kohën e regjimit musolinian.

Me çlirimin nga fashizmi punëtoria italiane mendoi dhe shpresoi në një drejtësi të thellë shoqërore, ajo mendoi se do ta thoshte më në fund fjalën e saj. Por s'ngjau kështu dhe për këtë fajin e patën «kushtetuta» e famshme që e reklamojnë çdo ditë revizionistët, organizimi i jetës dhe i drejtimit të partive të ndryshme borgjeze, në mes të të cilave edhe ajo «komuniste», që rregulluan jetën borgjeze parlamentare të partive, të shumicës dhe të pakicës, të partive në fuqi e të atyre në opozitë, dhe të gjitha lodrat, dredhitë, gënjeshttrat e demagogjitë etj.

Partia Komuniste Italiane mori në fillim disa dikastere të parëndësishme, që borgjezia e madhe duhej t'ua jepte komunistëve brenda lojës «demokratike», por derisa të arrinte të forconte pozitat, të rimëkëmbte fabrikat, të krijonte ushtrinë e saj, policinë dhe të gjithë rrjetin shtypës. Si i arriti këta objektiva, borgjezia i hodhi jashtë qeverisë ministrat komunistë. Rreziku eventual i sulmit të klasës punëtore u evitua, kjo hyri «në radhë», u inkadrua në sindikata të ndryshme, sipas ngjyrave të partive, dhe filloi kështu loja dhe jo lufta sindikale, filloi lufta për vota, lufta parlamentare.

Në Italinë e pasluftës nuk dëgjohej të flitej veçse për «demokraci», për «liri shtypi dhe fjale», për «reforma», ndërsa prapa të gjitha këtyre formulave konsolidoheshin shteti kapitalist, aparati i tij shtypës, koncertet dhe ndërmarrjet e mëdha private ekonomike. Padronët dhe pronarët e këtyre koncerneve e ndërmarrjeve të mëdha private dërgonin në parlament, për të ligjëruar dëshirat dhe planet e tyre, deputetët e vet të inkadruar në parti të ndryshme borgjeze e socialdemokrate. Kuptohet se këto parti të ashtuquajtura demokratike kishin një vijë të për-

gjithshme në sipërfaqe, por brendapërbrenda tyre kishte korrente të shumta dhe çdo korrent përfaqësonte një padron ose dy padronë. Krizat qeveritare, aq të shpeshta në Itali, janë pasqyra e kontradiktave të thella brenda çdo partie dhe midis partive të ndryshme. Këtë pasqyrë e jep partia demokristiane, e cila dominon si partia më e madhe, por me plot korrente brenda, që përfaqësojnë padronë të ndryshëm. Këtë pasqyrë e japin edhe partitë e ashtuquajtura *centro sinistra* (e majta e qendrës), që lëvizin sipas dividendëve që u jepen nga shteti kapitalist. Të gjitha këto parti ekzistojnë dhe mbrojnë këtë shtet kapitalist, pse ky u siguron edhe atyre qenien dhe fushën e grabitjes.

Edhe Partia Komuniste Italiane ka hyrë me kohë në këtë valle «demokratike». Ajo nuk ka qenë kurrë për revolucionin, ajo ka qenë vazhdimisht një parti që ka qëndruar në pozita reformiste e oportuniste. Partia Komuniste Italiane luftoi dhe lufton që të zhdukë nga anëtarët e saj dhe nga proletariati italian frymën revolucionare, të zhdukë luftën e klasave dhe mendimin e marrjes së pushtetit me violencë nga duart e kapitalistëve. Kështu ajo nuk është veçse një parti socialdemokrate si të gjitha të tjerat, që e kanë lënë në opozitë dhe nuk e qasin në valle, për arsye të qenies më parë në Internacionalen e Tretë. Përveç kësaj, përse të riskojë borgjezia, kur nuk sheh ndonjë rrezik prej saj, sido që ajo ka një fuqi votash të madhe, më të madhen pas demokristianëve?

Bernshtajni në kohën e tij predikonte se nuk është e nevojshme të prishet shteti borgjez; organet e kapitalit, thoshte ai, nuk duhen prishur. Me anën e votës, predikonte Bernshtajni, mund të triumfojë socializmi. Është e njohur lufta e ashpër që i bënë Engelsi dhe Lenini këtij renegati dhe gjithë pasuesve të tij, si Kautskit, Trockit e të tjerëve.

Revizionizmi u bë një fenomen ndërkombëtar, qëllimi i të cilit ishte: luftë kundër marksizëm-leninizmit,

shuarja e luftës së klasave, për të penguar revolucionin dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, për mbrojtjen e kapitalit. Revizionizmi, duke pasur këto synime bazë, merрте, natyrisht, forma të ndryshme, përdorte metoda të ndryshme dhe sillte nga një variant specifik për t'iu adoptuar kapitalit të çdo vendi me anë reformash të ndryshme.

Revizionizmi klasik sot është inkuadruar plotësisht në revizionizmin modern. Teoritë e Bernshtajnit dhe të Kautskit i gjejmë në forma të ndryshme te revizionisti Brauder, te austriaku Bauer e të tjerë dhe te revizionizmi modern, për të cilin bota gjoja ka ndryshuar, kapitalizmi — po ashtu, i gjejmë në revizionizmin titist, në revizionizmin hrushovian, në revizionizmin francez dhe në revizionizmin italian toliatist. Por tani në këtë shkrim na intereson revizionizmi italian.

Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste Italiane, që u mbajt në vitin 1962, shpalli si rrugë të saj për të shkuar në socializëm «rrugën italiane për në socializëm». Cila ishte kjo rrugë? «Reformat e strukturës», domethënë rruga e reformave strukturore, rruga revizioniste, oportuniste, e adoptuar mbi gjendjen e kapitalit monopolist italian. Sipas «reformës së strukturës» toliatiste nuk do të ecej drejt revolucionit, por në rrugë parlamentare do të ecej me reforma graduale, nëpërmjet të cilave, në mënyrë paqësore, do t'i shkëputeshin lëshime kapitalit monopolist. Këto reforma graduale do të bëheshin në rrugën e planifikimit dhe vetëm me armën e parlamentarizmit, me fuqinë e votës, pavarësisht se monopolet kapitaliste kishin në dorë të tyre edhe pasuritë e vendit, edhe armët, edhe drejtimin parlamentar e administrativ.

Me fjalë të tjera, revizionistët italianë mendojnë se mund ta integrojnë kapitalizmin në socializëm pa e shkaktërruar aparatit e shtetit borgjez. Ç'do të thotë e gjithë kjo teori «marksiste-leniniste» e «reformave të strukturës»? Kjo do të thotë të mos jesh marksist, po antimarksist, socialdemokrat.

Kurrë dhe asnjëherë disa forma të kapitalit monopolist nuk mund të kthehen në socializëm, pse format e kapitalit shtetëror janë fuqia e shtetit borgjez. Kush mbron pikëpamjen e kundërt, është revizionist dhe teoria e tij revizioniste i adaptohet kapitalit të vendit jo për ta minuar, por për ta forcuar, për të minuar luftën revolucionare.

Partia Komuniste Italiane, që pas vdekjes së Stalinit, filloi të bëhej një qeder për revizionistët hrushovianë, por jo në atë shkallë dhe në ato forma që u bë qeder, për Hrushovin, Partia Komuniste Franceze. Toliati dhe pasuesit e tij ishin me hrushovianët, ata i ndiqnin me simpati dhe pa i kundërshtuar veprimet e Hrushovit në fushën e brendshme dhe në arenën ndërkombëtare. Toliatistët e pëlqyen kursin revizionist të destalinizimit, ata e duartrokitën hedhjen baltë mbi Stalinin dhe bolshevizmin, duartrokitën kursin hrushovian drejt shkatërrimit të formave socialiste të shtetit sovjetik, ishin pro reformave revizioniste të hapjes drejt shteteve kapitaliste dhe veçanërisht drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Toliatistët, si revizionistë, ishin plotësisht dakord për «bashkekzistencën paqësore» hrushoviane. Kjo ishte ëndërra e tyre e vetme e bashkëpunimit me borgjezinë në planin kombëtar dhe ndërkombëtar. Vendosja e socializmit me anën e votës dhe në rrugën parlamentare ka qenë gjithë dëshira e revizionistëve italianë. Sa për tezën hrushoviane të «partisë së të gjithë popullit» këtë toliatistët e kishin realizuar me kohë, partia e tyre s'kishte asgjë leniniste revolucionare.

Në rrugën ku kishte hyrë partia revizioniste hrushoviane, duheshin «uniteti dhe miqësia» sidomos me Partinë Komuniste Italiane dhe me atë Franceze. Për këtë arsye «nderet» që u bëheshin nga hrushovianët këtyre dy partive ishin të dukshme dhe, tok me «nderet», vinin edhe subvencionet e mëdha nën dorë dhe përqindjet e majme që merrnin «përfaqësuesit tregtarë» (njerëz që punonin për

llogari të këtyre dy partive revizioniste), në tregtinë zyrtare që bënin Bashkimi Sovjetik me Italinë dhe me Francën.

Mirëpo, ashtu siç shpejtonin hrushovianët ta kthenin Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist, ashtu shpejtonin dhe toliatistët të integroheshin në rrethin kapitalist italian. Prandaj Toliati, për t'ia arritur këtij qëllimi të madh, filloi të hidhte vicka të rënda, që kishin për qëllim shpejtimin e degjenerimit të Bashkimit Sovjetik, shpejtimin e zhdukjes së frymës revolucionare jo vetëm në brendi, por edhe në forma, shpejtimin e hapjes së plotë të portave të Bashkimit Sovjetik për kapitalizmin botëror.

Partia Komuniste Italiane dhe Toliati, më parë dhe me forcë, e dënuan Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si «udhëheqëse kryesore» të komunizmit ndërkombëtar. Ata nuk pranuan më që Moska të ishte «qendra», po predikuan haptazi «policentrizmin». Policentrizmi i Toliatit kishte për qëllim krijimin e një blloku të ri revizionist, me Partinë Komuniste Italiane në krye, i cili të vihej përballë bllokut revizionist sovjetik, dhe rritjen e autoritetit të Partisë Komuniste Italiane në sytë e kapitalit italian dhe botëror. Vetëm kështu Toliati mendonte se do të fitonte besimin e kapitalistëve monopolistë italianë, për të hyrë në vallen e këtyre.

Hrushovi e pa rrezikun dhe u përpoq të ruante «unitetin» që shkonte drejt pavarësisë së partive revizioniste, si jashtë dhe brenda Traktatit të Varshavës. Sidoqoftë, ftohja e Partisë Komuniste Italiane me partinë hrushoviane dhe me atë të Toretit u bë e akullt, por toliatistët nuk fituan gjë nga ato që dëshironin. «Policentrizmi» toliatist dhe «uniteti» hrushovian ishin gjëra irrealë. Revizionizmi përçan dhe nuk bashkon.

Toliatistët e vazhduan rrugën e tyre të tradhtisë. Berlingueri lëshoi parullën e «kompromisit historik», natyrisht, me borgjezinë. Ky është vazhdimi dhe varianti «filozofik» i «reformave të strukturës». Me këtë parullë

torolitet udhëheqja revizioniste italiane. Kjo parullë vazhdon të hidhet edhe tash, kur shteti borgjez kapitalist italian është në falimentim. A do ta pranojë kapitali monopolist italian dorën që po i nder Partia Komuniste Italiane? «Pse jo?», thotë Anjeli, president i Konfederatës së Përgjithshme të Industrisë Italiane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, padronë të Italisë, u shprehën se nuk janë dakord për praninë e revizionistëve evropianë në qeveritë e NATO-s. Por Berlingueri, ky latifondist i madh, po i lutet fshehurazi Kisingerit për këtë çështje. Do të shohim tradhtinë e mëtejshme që do të zhvillohet dhe tragjedinë e popullit italian.

Aktualisht ne shohim dy vija të njëllojta, si atë të Partisë Komuniste (revizioniste) Italiane, ashtu edhe atë të Partisë Komuniste (revizioniste) Franceze. Partia Komuniste Italiane vërtet nuk flet aq hapur, siç foli Marsha, i cili hodhi poshtë «diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave», por Berlingueri, ca kohë më parë, në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Italiane (revizioniste), shtjelloi po atë vijë. Duhet thënë se vija e «reformave të strukturës», që janë thelbi i «kompromisit historik», të cilat i predikon Berlingueri, është një vijë e njëjtë me atë të Marshesë, por e përpunuar më parë nga Partia Komuniste Italiane.

Partia Komuniste revizioniste Italiane, para zgjedhjeve të qershorit, është në një dilemë të madhe. Ç'do të bëjë ajo në rast se në vota do të ketë një numër më të madh se demokristianët? Berlingueri, i frikësuar, tha në plenum se «ne duhet të formojmë një qeveri të gjerë, me të gjitha partitë e harkut demokratik, të bëjmë disa reforma të nevojshme, natyrisht në një demokraci të gjerë, dhe të mos dalim nga NATO-ja».

Pse e shtron këtë perspektivë Berlingueri? Pse kjo është vija revizioniste e Partisë Komuniste Italiane, e cila ka frikë të marrë përgjegjësi përpara krizës dhe falimen-

timit, që nuk mund të zhduken me reforma, por duke e marrë pushtetin me dhunë klasa punëtore. Partia Komuniste (revizioniste) Italiane, jo vetëm nuk e do këtë zgjidhje, por ia ka frikën masës së punëtorëve dhe punonjësve të Italisë, të cilët, në rast se kjo parti fiton, do të kërkojnë jo bashkëpunim me padronin, por marrjen e pushtetit. Këtë situatë nuk e do dhe nuk do ta lejojë Partia Komuniste (revizioniste) Italiane, por nuk do ta lërë aspak as borgjezia kapitaliste amerikane dhe ajo italiane. Atëherë dy rrugë do të çelen: ose luftë civile, ose ardhja e fashizmit në fuqi në Itali. Një kompromis antihistorik mund të bëhet në fillim pas zgjedhjeve, në rast se Partia Komuniste (revizioniste) Italiane fiton në vota, por ky «kompromis» do të jetë efemer, i paqenë, për të qetësuar opinionin, derisa të shtrëngohen vidhat. Kapitali nuk i dorëzon kurrë armët, në qoftë se këto nuk ia rrëmben me forcë. Partia Komuniste Italiane nuk është nga ato parti që shkojnë në revolucion. Për tradhtinë e saj, për Toliatin dhe toliatistët kam folur, kam shkruar edhe artikuj në «Zërin e popullit», pa e vënë emrin. Ky variant revizionist toliatist është demaskuar me kohë nga Partia jonë, siç janë demaskuar edhe revizionizmi titist, ai hrushovian, si dhe ai i Partisë Komuniste revizioniste Franceze e i partive të tjera revizioniste të Evropës, të Azisë dhe të Amerikës Latine.

Në situatat aktuale, kur shtetet kapitaliste, imperia- lizmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe aleatët e tyre, janë kredhur thellë në një krizë të madhe ekonomike dhe ushtarake, kriza politike dhe ideologjike shkon paralel me të parat dhe konfondohet e dominon krizën. Për këtë arsye këto fuqi dhe partitë borgjeze, revizioniste e fashiste bëjnë përpjekje t'i shpëtojnë krizës, e cila i detyron të gjithë të hedhin maskën, të lajnë hesapet me njëri-tjetrin, duke u përpjekur gjithsecili në favorin e tij dhe, kuptohet, në kurrizin e popujve e në favorin e kl- ikave kapitaliste revizioniste.

Bashkimi Sovjetik revizionist përpiqet të ruajë aparencat e një shteti «socialist» dhe të një partie «marksiste-leniniste», përpiqet të ruajë «unitetin» qesharak politiko-ideologjik, përpiqet të ruajë «ekuilibrin dhe statuskuonë» në Evropë tok dhe në ujdi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë arsye Bashkimi Sovjetik dhe partia e tij revizioniste përpiqen të organizojnë një mbledhje të partive revizioniste të Evropës, në pamundësi të thërrisin një mbledhje të partive komuniste dhe punëtore (revizioniste) të botës. Mirëpo u ka hasur sharra në gozhdë. Revizionistët e ndryshëm, titistë, italianë, francezë, spanjollë, rumunë e të tjerë duan që, fundi i fundit, mbledhja të bëhet, por të mos vendosë asgjë, ajo të tregojë vetëm se ekziston një përçarje e plotë në politikë, në ideologji etj., etj. Kështu që me këtë mbledhje, edhe në qoftë se bëhet, rusët gjoja mbulojnë fytyrën e ndotur dhe revizionistët e tjerë forcojnë pozitat e tyre antimarksishte, largohen përfundimisht nga teoria e marksizëm-leninizmit dhe i thonë borgjezisë që «ne nuk jemi ata që mund të mendosh ti, ne mendojmë me kokën tonë dhe i shohim situatat e reja ashtu siç i shikon ti».

Imperializmi amerikan, nga ana e tij, edhe mbledhje bën me aleatët e vet, edhe shantazhe me kredi, por edhe me skandalin «Lokhid» demaskon krerët aktualë të partisë demokristiane deri te Leonia¹, të partisë socialdemokrate deri te Saragati, të cilët akuzohen se kanë marrë bakshishe të majme në çeqe. Imperializmi amerikan do t'i ndërrojë kuajt e vjetër të këtyre partive kapitaliste dhe përpiqet të sjellë hajdutë të rinj. Me këtë metodë ai gënjen opinionin se gjoja të vjetërve u kaloi koha dhe të rinjtë do t'ua rregullojnë gjendjen (amerikanët).

Në këtë rrëmuje, në Itali po përgatitet fushata e

¹ Xhovani Leone — në atë kohë president i Republikës së Italisë.

zgjedhjeve, po bëhen kongrese në seri, po shpalosen programe «të bukura», në mes të të cilave edhe ai i Partisë Komuniste (revizioniste) Italiane, i shpallur nga Berlingueri. Ç'premtion Berlingueri në «qiellin e kaltër» ku sundojnë Mafia, politika ekonomike, ushtarake dhe banditeske? As më pak dhe as më shumë, por, «në qoftë se Partia Komuniste Italiane fiton në zgjedhje», atëherë ajo «do të rregullojë ekonominë, do të sulmojë kundër taksave dhe teprimeve burokratike, deficitit i bilancit të pagesave do të pakësohet, si duke shkurtuar importin, ashtu edhe me anën e investimeve, për të rritur prodhimin në bujqësi dhe në industri». «Program ëndërrues madhështor» në një Itali ku sundon kapitali, që ka zënë të gjitha porët e trupit italian. Revizionistët italianë, pa çak pa bamb, me dëshirë dhe me reforma, «do të pakësojnë importin», domethënë do të prishin ekuilibrin e Tregut të Përbashkët Evropian që mban në këmbë: Anjelët, Enët dhe Montedisonët, «do të shtojnë prodhimet», që të mos ua marrë kush, derisa është prishur ekuilibri i koncerneve, dhe këtë do ta prishë Berlingueri me programet e tij, «do të zhvillojnë bujqësinë», «do të shtojnë agrumet», të cilat edhe tash s'ua blejnë, e kështu me radhë gjithë problemet e tjera! «Program gjenial» reformist ky i Partisë Komuniste Italiane, i cili synon jo vetëm «ndryshimin rrënjësor» në Itali, por ai «do të shkaktojë edhe krizën e madhe botërore kapitaliste të të gjitha shteteve perëndimore». «Mrekullia e shekullit» revizionist modern, zhdukja e kapitalizmit vetëm me anën e votës, të reformave dhe të parlamentarizmit!

S'i duhet botës shumë mend të kuptojë tradhtinë e këtyre partive revizioniste, shërbëtore të kapitalit, që ndihmojnë kapitalin të dalë nga kriza, duke u hequr si antikapitaliste. Qëllimi është të marrin një pjesë nga byreku dhe të shpartallojnë revolucionin proletar në të gjithë botën e, në veçanti, në çdo vend ku ka të tillë parti.

DENONCOJMË JUGOSLLAVINË QË U JEP LEHTËSI PORTUALE FLOTAVE USHTARAKE TË SHBA DHE TË BS

Ia dërguam redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» artikullin «Dëbimi i flotave të superfuqive nga Mesdheu — veprim i rëndësishëm për forcimin e pavarësisë dhe të sigurimit të përgjithshëm»¹. Aty përsëritim vendimin e qeverisë egjiptiane për të denoncuar Traktatin Sovjeto-Egjiptian dhe për dëbimin e flotës sovjetike nga portet e Republikës Arabe të Bashkuar dhe, në të njëjtën kohë, denoncojmë Jugosllavinë që u jep lehtësi portuale flotave ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik në portet e saj. Ky artikull është një paralajmërim i rreptë për titistët.

¹ Shih: «Zëri i popullit», 30 prill 1976.

KUJDES PËR ÇËSHTJEN ETNIKE

Shokun Ramiz e sinjalizova që në ekspozitën që do të bëjmë për arkeologjinë dhe etnografinë, të kihet kujdes veçanërisht problemi i popullatave shqiptare që jetojnë jashtë kufijve. Të mos ekspozojmë harta me kufij dhe me bojëra, pse atëherë do të ngrihet një zhurmë e madhe nga revizionistët jugosllavë dhe nga reaksioni grek, gjë që nuk na shërben. Ne duhet vetëm të sinjalizojmë që në këtë apo në atë vend, si në Itali, në Amerikën e Veriut etj., rron populli shqiptar autoktone ose e ngulur në shekuj të ndryshëm.

KINEZËT KËRKOJNË AGREMENT PËR NJË AMBASADOR TË RI QË DERI TASH KA QENË NË MOSKË

Qeveria kineze na kërkon agreementin për dërgimin e ambasadorit të ri. Ky na qenka 60 vjeç, i «Marshimit të Madh», ish-komandant armate a divizioni në Kore dhe para disa muajve ka qenë ambasadori i fundit i Kinës në Moskë.

Se ç'është ky dhe me ç'qëllime e dërgojnë, do ta shohim. Është antisovjetik, por edhe antirevizionist e anti-amerikan, apo është antisovjetik dhe proamerikan? Shih e gjyko, beso e kontrollo.

DY VËREJTJE PËR ORGANET E SHTYPIT

Me shokët sekretarë bisedova për dy çështje që kanë të bëjnë me shtypin:

1) Artikujt kryesorë për politikën botërore gati çdo ditë flasin dhe përsëritin slogane e formula për të dyja superfuqitë, ose një herë për njëren, një herë për tjetrën, dhe kjo punë vazhdon si «kënga kineze» e artikujve ose e simiteve të përditshme kundër Bashkimit Sovjetik, që janë, minimumi, nga tetë faqe. Të tillë artikuj të shtypit tonë e kanë humbur rëndësinë jo vetëm për brenda, por edhe për jashtë. Zëri i Partisë sonë nëpërmjet shtypit, në mënyrë të studiuar, bënte bujë dhe ndiqej, dëgjohej nga e gjithë bota. Agjencitë e huaja artikujt e shtypit tonë i përhapnin, asgjë nuk u kalonte. Tash asnjë s'flet, pse shumë artikuj janë pa vlerë, banalë. Ne duhet ta vazhdojmë luftën tonë kundër imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, siç e bënim më parë, me ashpërsi dhe me seriozitet, por jo siç po e bëjnë disa redaktorë apo bashkëpunëtorë të «Zërit të popullit», që nuk vrasin mendjen, nuk studiojnë, nuk analizojnë, nuk shoshitin ngjarjet që të përcaktojnë se për cilat duhet folur, për cilat jo. Për ato që duhet folur të mos nxjerrim nga një artikull si kinezët, por artikuj që të zënë vend, që t'i japin secilit që e lexon situatën në dorë, pse në këtë mënyrë këta artikuj do të studiohen dhe jo vetëm sa të lexohen dhe autori të kënaqet se ka nxjerrë një simite dhe ka merituar rrogën. Kjo gjendje duhet të përmirësohet.

2) Ne shkruajmë pak për partitë komuniste marksiste-leniniste. Kështu ne nuk e bëjmë si duhet detyrën internacionaliste ndaj tyre. Ato kanë nevojë për ndihmën tonë dhe ne për të tyren. Kjo është ndihma publike, që nuk mund ta bëjmë veçse me anën e shtypit dhe të radios, kurse ato, për Shqipërinë, e bëjnë nëpërmjet shtypit të tyre.

Ne duhet të mendojmë seriozisht në këtë drejtim dhe të veprojmë, por jo me artikuj që prishin punë, por me artikuj që ndreqin, duke mbajtur parasysh dhe luftën e partive motra, format dhe mënyrat se si e zhvillojnë atë, por edhe marrëdhëniet që kemi ne me shtetet ku veprojnë këto parti.

E ENJTE

13 MAJ 1976

KOMPLLOTISTËT DHE TUTORËT E TYRE

Komplotistët Beqir Balluku, Abdyl Këllezi e të tjerë ishin të lidhur në veprimtarinë e tyre armiqësore me njëri-tjetrin, si dhe me sovjetikët e me jugosllavët, po mundet edhe me të tjerë.

Beqir Balluku, Abdyl Këllezi dhe Hito Çakoja kanë pohuar lidhjet e vjetra që kanë pasur me jugosllavët, Beqir Balluku ka pohuar se Titoja ka pasë biseduar me të për ardhjen dhe vendosjen e një divizioni jugosllav dhe për njësitë ndihmëse teknike në Shqipëri, para prishjes përfundimtare me jugosllavët. Ai pohoi, në proces, se me gjithë refuzimin tim për ardhjen e këtij divizioni, kishte dhënë urdhër që të përgatiteshin vendet për këtë forcë pushtuese. Kjo e bën të qartë se ai ka qenë agjent i jugosllavëve.

Pas prishjes me këta, Beqir Ballukun, Abdyl Këllezin dhe Hito Çakon i gjejmë të përzier në grupet antiparti dhe pro titizmit. Më vonë Beqiri duhet të jetë bërë agjent i dyfishtë, edhe i sovjetikëve. Këtë e vërtetojnë sidomos marrëdhëniet dhe bisedat që ai ka bërë me Konjevin¹, pasi sovjetikët filluan të prisheshin me Kinën.

Beqir Balluku, Abdyl Këllezi, Hito Çakoja dhe të tjerë, kur filloi lufta kundër revizionistëve jugosllavë, mblodhën këmbët dhe, në kohën që hrushovianët hiqeshin si antititistë, u bënë prosovjetikë.

¹ Ivan Konjev, mareshal i Bashkimit Sovjetik.

Taktika e Beqir Ballukut dhe e Abdyl Këllezit, për të fshehur gjurmët e veprimtarisë së tyre armiqësore, ishte që në dukje të tregoheshin sikur ndiqnin rrugën e udhëheqjes së Partisë. Kur ne filluam luftën kundër hrushovianëve, ata ndiqnin gjurmët tona dhe na mbanin ison, duke pritur momentet e përshtatshme. Si Beqiri, ashtu edhe Abdyl, Hitoja dhe Petriti, njeriu i sovjetikëve, shanin, kritikonin dhe i tallnin sovjetikët më shumë se ne. Beqiri i tallte ata aq shumë sa që u bë loja jonë për të përqeshur sovjetikët. Deri këtu këta armiq përpiquehshin të jepnin përshtypjen se ishin dakord me vijën e Partisë, por, nga ana tjetër, filluan sabotimin sistematik e me plan të direktivave në ushtri, në ekonomi etj. Ata përdorën në shkallë të gjerë demagogjinë, gënjeshtren dhe komprometimin e vartësve të tyre, që edhe këta të mos e ngrinin zërin. I gjithë ky sabotim shkonte në dëm të atdheut dhe në favor të titistëve e të sovjetikëve, që i manipulonin dhe i udhëzonin.

Më vonë doli problemi kinez. Sa kohë që udhëheqësit kinezë qëndronin në vijë, Beqiri me Abdylin ndiqnin vijën e udhëheqjes, por, kur Partia Komuniste e Kinës filloi të bëjë gabime dhe ne filluam t'i kritikonim këto gabime, atëherë Beqiri, Abdyl, Hitoja, Petriti dhe të tjerë u bënë antikinezë të tërbuar.

Tash duket qartë se, kur udhëheqja jonë përpiquej të ruante miqësinë me Kinën dhe kritikant t'i bënte nga ana parimore, këta armiq menduan se kishte ardhur momenti që udhëheqja të prishej me Kinën dhe menduan t'i hidhnin zjarr «qëndrimin antikinez» dhe të përgatitnin aktivisht komplotin e kurdisur me kohë me jugosllavët dhe me sovjetikët. Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi nga njëra anë shanin sovjetikët, titistët dhe kinezët, nga ana tjetër manovronin me të tria palët.

Me siguri Beqiri dhe Abdyl do ta kenë vënë në dijeni plotësisht Çu En Lain për kritikant tona në adresë të

tyre dhe për «frymën» tonë antikineze. Këta armiq vepronin në dy tablotë: përpara nesh shanin kinezët dhe, kur ishin me këta, na shanin ne e kjo bëhej për përgatitjen e komplotit. Kina u ftoh çdo ditë e më shumë me ne. Çu En Lai u egërsua dhe e këshilloi Beqirin që, në rast agresioni, ne, që në fillim, të bënim luftë partizane dhe të bashkoheshim me jugosllavët dhe me rumunët. Kur Beqiri na e parashtrroi këtë ide të Çusë, ne ia hodhëm poshtë si armiqësore dhe e dënuam. Atë «e dënoi» edhe Beqiri sa për sy e faqe, se s'mund të bënte ndryshe, por në fshehtësi ai filloi organizimin e komplotit sipas këshillave të Çu En Lait, që donte të na shtynte të hidheshim në prehrin e Titos dhe të sovjetikëve. Abdyl Këllezi me shokë po vepronin në ekonomi, sabotonin në sektorin e naftës, në industri e gjetkë, duke u përpjekur të ecnin në drejtim të vetadministrimit jugosllav. Ata po përgatitnin puçin përfundimtar.

Përpara Kongresit të 7-të të Partisë, Abdyl më paraqiti një listë kolosale për kërkesat që do t'i bënim Kinës. Kjo bëhej me qëllim që të na refuzohej dhe ne të zemëroheshim me udhëheqësit kinezë. I thashë Abdylit: «Ju nuk jeni në vete, këto kredi Kina nuk do të na i japë kurrë, prandaj i krihni mirë këto lista». Ai zbriti vetëm disa milionë.

Kur më vonë Adili vajti në Pekin, Çuja, që ndodhej në spital, mezi e priti dhe ia paraqiti shumë të vështirë gjendjen e Kinës për të na dhënë kredi. Bile ai shkoi deri aty sa t'i bënte edhe Adilit të njëjtin propozim që i kishte bërë mikut të vet, Beqirit, për luftë partizane e për lidhje me jugosllavët e rumunët. Me këtë qëndrim, Çuja hallin e kishte gjetiu, t'i thoshte Adilit: «Lini ose mos i pushkatoni» komplotistët (Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi etj. në këtë kohë ishin në burg), «ndryshe s'ju japim kredi». Vetëm përpara vendosmërisë sonë Kina na dha një kredi shumë të vogël.

Janë, pra, të qarta tradhtia dhe lidhjet e Beqir Ballukut e të Abdyl Këllezit me shokë me kinezët.

Titistët, revizionistët sovjetikë dhe grupi i Çu — Ten Hsiao Pinit ishin në një vijë me komplotistët për të rrëzuar diktaturën e proletariatit dhe për të likuiduar udhëheqjen e Partisë sonë.

E HËNË
24 MAJ 1976*

SJELLJE TË KËQIJA TË AMBASADORIT KINEZ NË TIRANË

Më lajmëruan se ambasadori kinez, Liu Xhen Hua, që do të largohet më 29 të këtij muaji, po bën vizita an-dej-këtëj nëpër objektet që ndërtohen, dhe njerëzve tanë u shtron darka etj. Ai po sillet keq dhe jo miqësisht. Por e çuditshme është se këto sjellje të papëlqyera ai po i bën në momentin e lamtumirës. Duket sikur dëshiron t'i acarojë marrëdhëniet, ose të paralajmërojë acarime të mëtejshme. Ai s'flet fare për luftën që po i bëhet në Kinë Ten Hsiao Pinit. Neve nuk na priset puna për këtë, vetëm se kështu ai tregon që është njeriu i Tenit. Do të tregojë se di çdo gjë, se e njeh punën e minierave, sepse ka hyrë «një herë në Kinë në një minierë». Me cilindo dhe kudo që shkon, ai kritikon çdo punim tonin, që nga fortifikatat ushtarake dhe deri te «një copë hekur» e hedhur në një qoshe. Për të gjitha këto ai shpif dhe do që të tregojë se njerëzit tanë nuk punojnë mirë. Ambasadori kinez flet haptazi, bile deri përpara Adil Çarçanit e Spiro Kolekës, thotë se është në dijeni për çdo gjë. Me fjalë të tjera, me gojën e tij pohon se është rezident i siguri-mit kinez në Shqipëri dhe ka krijuar agjenturë me specialistë kinezë.

Shokët po i përgjigjen si e meriton këtij revizionisti, që fshihet nën petkun e ambasadorit të Kinës.

E PREMTE
28 MAJ 1976*

MAO CEDUNIDEJA

Ekzistojnë shtete socialiste, por partitë komuniste dhe punëtore që i udhëheqin këto, nuk qëndrojnë të gjitha në pozita të vërteta marksiste. Në to ka elementë shumë të theksuar antimarksistë. Një gjendje e tillë është edhe në Kinë. Në këtë vend udhëheq maocedunideja, që nuk është zbatimi konsekuent i marksizëm-leninizmit. Në të ekzistojnë ide fundamentale të gabuara, oportuniste, bile edhe revizioniste të maskuara. Maocedunideja, që udhëheq Kinën, s'lufton për revolucionin, për unitetin e proletariatit, dhe, pa e quajtur Kinën një «shtet të madh» dhe vetëm një «ide universale» që zëvendëson marksizëm-leninizmin, në fakt ajo një gjë të tillë bën. Kush nuk ndjek maocedunidenë dhe nuk e identifikon këtë me marksizëm-leninizmin, ai për kinezët nuk është marksist-leninist ose nuk konsiderohet si i tillë. Maocedunideja ka krijuar një turbullirë të madhe në radhët e proletariatit kinez dhe atij botëror.

Brenda në Kinë ekziston anarkia, ekzistojnë dy apo njëzet vija në parti dhe në popull. As që dihet se kush e ka dhe kush do ta marrë atje pushtetin. Partia Komuniste e Kinës nuk është e ndërtuar e nuk bazohet në parimet dhe normat marksiste-leniniste. Diktatura e proletariatit atje nuk vepron.

Kjo turbullirë e Kinës ka kaluar dhe po kalon edhe në pjesë të proletariatit botëror, edhe në parti komu-

niste marksiste-leniniste. Shumë nga këto parti nuk pajtohen as me maocedunidenë, as me veprimet e Kinës, por nuk shprehen haptazi. Vepron kulti i shtetit të madh, që njihet si «proletar», por nuk është i tillë; vepron kulti i Maos, që është Mao Ce Dun dhe asgjë tjetër, dhe sidomos nuk është as Marks, as Engels, as Lenin dhe as Stalin.

Lakenjtë pseudomarksistë, të infiltruar në radhët e disa partive komuniste marksiste-leniniste, e ekzaltojnë kultin e Maos dhe e vënë këtë në krye të odës. Borgjezia, gjithashtu, e njej vlerën e Kinës, të Maos, të maocedunidesë dhe e propagandon atë. Çdo grupi revolucionar, çdo parti komuniste marksiste-leniniste, bile dhe çdo grupi anarkist, si ai i Sartrit etj., borgjezia u vë etiketën maoistë. Kinës dhe Maos u pëlqen kjo. Me të gjithë ajo mban lidhje dhe i ndihmon vetëm sepse ata mburrin Maon dhe ndjekin politikën e tij të çoroditur dhe të turbullt. Antisovjetizmi është bërë i vetmi lajtmotiv i udhëheqjes kineze dhe kjo jo mbi baza të drejta ideologjike, por nën flamurin e maocedunidesë për të dominuar proletariatin dhe botën «komuniste».

Në këto kushte dhe me këto ide, Partia Komuniste e Kinës ka ndaluar thirrjen e partive komuniste marksiste-leniniste në kongreset e saj, ajo ka adoptuar vetëm takime dypalëshe me çdo parti komuniste marksiste-leniniste, të cilave u propagandon maocedunidenë dhe i këshillon të sulmojnë Bashkimin Sovjetik, por jo Shtetet e Bashkuara të Amerikës; u predikon atyre bashkëpunimin me borgjezinë reaksionare të vendit, deri edhe me Francon e me Pinoçetin.

Maoja dhe maoizmi janë bërë një pengesë nga më seriozet për unitetin e proletariatit botëror dhe të partive të reja komuniste e punëtore marksiste-leniniste. Prandaj kësaj së keqeje tjetër të maskuar i duhet kundërvënë në çdo gjë teoria jonë e pagabuar, marksizëm-leninizmi.

Pavarësisht se Partia Komuniste e Kinës është një

parti e madhe, marksizëm-leninizmi nuk njih parti të vogël e parti të madhe, kështu që Partia jonë konsiderohet e barabartë me të dhe, kur Partia Komuniste e Kinës gabon, sikurse po gabon, Partia jonë jo vetëm që nuk e ndjek në idetë dhe në rrugët e saj të gabuara, por edhe e lufton, tash jo drejtpërdrejt, por tërthorazi, me anën e qëndrimeve të saj të hapëta dhe publike, nëpërmjet të cilave që të gjithë e dallojnë qartë se ku qëndrojnë divergjencat në mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Në rast se Partia Komuniste e Kinës nuk rektifikon vijën dhe vazhdon më tej në rrugën e saj të gabuar, Partia e Punës e Shqipërisë, në interes të revolucionit proletar, duhet të polemizojë edhe hapur me të.

12 QERSHOR 1976*

VIJA E KINËS ËSHTË E DJATHTË

Edhe kinez sikur të jesh, është zor ta kuptosh politikën e brendshme dhe të jashtme të Kinës. Ajo nuk ka një bosht të qëndrueshëm, lëkundet sa në një anë, aq edhe në anën tjetër. Ka momente që gjen njëfarë stabiliteti centrist, pastaj, sipas rrethanave dhe koniunkturave të brendshme, ndryshojnë edhe qëndrimet e jashtme. Ka momente që këto qëndrime, duke i parë në prizmin e teorisë marksiste-leniniste, i gjykon se janë të drejta, kur përnjëherë balanca anon nga liberalizmi ose nga sektarizmi.

Të gjitha këto qëndrime pa bosht i shoqërojnë fjalë, artikuj, citate të Maos. Citatet e Maos përdoren «për çdo gjellë» dhe për çdo qëndrim, të djathtë e të majtë. Maoja dhe idetë e tij përshtaten dhe të gjithë e përdorin «autoritetin» e tij e cilido bën punën e vet. Pra «lufta e klasave» zhvillohet, por në bazë të ç'ideologjie? Në bazë të «marksizëm-leninizmit», thuhet, por realiteti në Kinë nuk tregon një gjë të tillë, sepse vetë Maoja ka predikuar «le të lulëzojnë të njëqind lulet». Po të «njëqind lulet», natyrisht, s'kanë të njëjtën «bojë».

Maoja mori anën e Hrushovit, e mbrojti dhe e lavdëroi atë, sa të mëkëmbej dhe të forconte pozitën. Pra, në këto situata e me këto mendime Maoja dhe Liu Shao Çia ishin dakord me njëri-tjetrin dhe që të dy ishin të djathtë. Ky qëndrim i tyre u duk edhe në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës në vitin 1956. Ai ishte një kongres djathtist, që bile i tregonte edhe Hrushovit rrugën se si duhej të vepronte. Mirëpo Hrushovi u forcua dhe menjëherë sulmoi të ashtuquajturin kult të

Stalinit. Me një të shtënë ai synonte të vriste dy zogj: brenda të zëvendësonte «kultin e Stalinit» me kultin e tij, po ashtu edhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare të ishte vetë i parë dhe askush tjetër, pra, kuptohet as Maoja. Kurse ky kishte shpresë që pas kësaj të ndërroheshin rolet: Hrushovi «të ishte nxënës i Maos», mirëpo Hrushovi e kuptoi situatën dhe mori një kurs tjetër, ndërroi dyfekun nga një sup te tjetri.

Maoja filloi të mbante kështu qëndrime gati «marksiste-leniniste». Në Mbledhjen e 81 partive në Moskë kinezët u detyruan t'i bënin ndryshime fjalimit të tyre dhe ta akordonin me tonin. Themë se ata filluan të mbanin qëndrime gati «marksiste-leniniste» sepse më vonë në kongreset 21, 22, 23 të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, maoistët u orvatën për të arritur në pajtim. Por, ndërkaq, hrushovianët kishin marrë frerën në dhëmbë, dhe ishte në këto kohë që Maoja dhe maoistët filluan polemikën. Ne, natyrisht, ishim të kënaqur, sepse shihnim se Maoja «filloi t'i shikonte drejt situatat». Ishte koha e një miqësie të madhe të Kinës me ne.

Mirëpo, gjatë kësaj kohe po ndiheshin lëkundje të reja në Kinë. Liu Shao Çia, Ten Hsiao Pini dhe të tjerë pasues të tyre, siç u tha, donin të merrnin fuqinë dhe të hynin në «aleancë me Bashkimin Sovjetik». Këtë aleancë e filluan së toku, por për revizionistët hrushovianë, siç duket, Liu ishte më i pranueshëm sesa Maoja. Atëherë ky, duke parë se çdo gjë ishte në duart e Liut dhe të shokëve të tij, anoi nga e majta dhe lëshoi thirrjen: «Sulmoni shtabet!». Filloi Revolucioni Kulturor dhe Liu ra nga fronti. Megjithatë njerëzit e tij qëndruan atje ku ishin. Të gjithë këta u bënë maoistë, duke pasur Maon në krye. Çuja ishte kreu i pushtetit dhe i ekonomisë, Lin Biaoja shefi i ushtrisë. Partia në këtë kohë ishte e shkatërruar dhe çdo gjë ishte rrëmuje, vetëm emri i Maos dëgjohej. Nën këtë emër të gjithë e gjithsecili punonin për pushtet.

Maoja gjoja mbante «balancën midis të majtëve dhe të djathtëve». Asnjë palë nuk ishte marksiste-leniniste. Lin Biaoja u likuidua, Çu En Lai mbeti «nënmbreti i Kinës» dhe Maoja si kurdoherë «arbitri».

Nga konfuzionet e njëpasnjëshme u arrit gjoja në një stabilitet, por antimarksist. Kina u lidh me imperialistët amerikanë kundër sovjetikëve, dhe ky pozicion e çoi atë më tej në rrugën antimarksiste, djathtiste.

Është e kuptueshme që kinezët dhe Maoja s'mund të ishin dakord me ne. Dhe këtë ata e kanë treguar dhe po e tregojnë me vepra. Ne ruajmë gjakftohtësinë. Timoni në vijën e Kinës është kthyer nga e djathta dhe Maoja e Çu En Lai rehabilituan Ten Hsiao Pinin dhe ky nga «armiku numër dy» u bë zëvendëskryetar i Partisë Komuniste të Kinës dhe ndërkohë po përgatitej t'i zinte vendin Çu En Lait. Çuja vdiq dhe Teni s'u bë dot kryeministër, por u quajt revizionist, tradhtar. Ç'nuk është thënë e ç'nuk po thuhet kundër tij! Akuza të çuditshme. Duken të drejta, por bëhet pyetja: Ku ka qenë Maoja që e rehabilitoi këtë njeri? Por edhe mbas akuzave që po i bëhen Tenit, nuk po duket asnjë qëndrim pozitiv marksist-leninist në politikën e jashtme dhe të brendshme të Kinës. Prapë konfuzion i madh. Hua Kuo Feni thotë që në politikën e jashtme të Kinës nuk do të ketë asnjë ndryshim, bile do ta forcojmë edhe më shumë drejtimin e mëparshëm.

Në shtyp Teni akuzohet edhe për centralizim, edhe për decentralizim, akuzohet se do të modernizojë industrinë me teknologjinë e huaj, kurse vija e Maos është të ndërtohet socializmi me forcat e veta, në një kohë që në Kinë kombinatet të mëdha moderne po ndërtohen nga amerikanët, nga japonezët, nga gjermanoperëndimorët. Kush i ka lejuar gjithë këto? Vetëm Ten Hsiao Pini?! Po Çu En Lai ç'ka bëre?! Po Maoja nuk i ka aprovuar këto? Jo, thuhet, Maoja s'ka aprovuar asgjë, kurse në të vërtetë është ai që e ka drejtuar çdo gjë në Kinë.

NJË MBLEDHJE E FTOHTË PËR TË MJELUR DHITË SHTERPA

Në këtë muaj të nxehtë të qershorit u bë një mbledhje e ftohtë në Berlinin Lindor të Republikës Demokratike Gjermane¹. Dy vjet të tërë me radhë u punua intensivisht nga ana e sovjetikëve për të sjellë «në vathë» dhe për të mjelur dhitë shterpa. Ishte mbledhja e partive revizioniste të Evropës.

Revizionistët sovjetikë vunë gjithçka në lëvizje, gënjeshtrën, mashtrimin, shantazhin, paratë, ryshfetet, preSIONET ekonomike, që partitë revizioniste të Evropës Lindore, si dhe ato të Evropës Perëndimore, të viheshin në një radhë nën drejtimin e mareshal Brezhnjev. Dy, për të mos thënë dyzet, po përplaseshin dhe, natyrisht, nuk binin dakord. Ishin gange të ndryshme, kishin interesa dhe qëllime të ndryshme, gjithsecili kishte zonën e tij të veprimit dhe në këtë zonë secili dëshironte të bënte dhe bënte si të donte, me përjashtim të partive revizioniste të Evropës Lindore, të cilat, donin, s'donin, do t'i binde-shin padronit sovjetik.

Këtë stan gangsterësh asgjë ideologjike nuk e lidhte me njëri-tjetrin, vetëm ligji «*du milieu*», ligji i xhunglës.

¹ «Konferenca e partive komuniste e punëtore të Evropës mbi paqen, sigurimin, bashkëpunimin dhe progresin shoqëror në Evropë».

Asnjë parti s'kishte asgjë komuniste, por të gjitha hiqeshin «komuniste». Idetë bazë të marksizëm-leninizmit partitë revizioniste perëndimore dhe ato lindore i kishin hedhur tej me kohë, por, ndërsa ato të Perëndimit e çorën krejt maskën, ato të Lindjes u përpoqën që të ruanin disa maska. Ky ishte një kundërshtim, jo në thelb, por në formë dhe kishte arsyet e veta.

I gjithë ky grupim revizionist i kishte prerë krejt urat me marksistë-leninistët. Ata të gjithë e dinin këtë dhe, në përgatitjet për mbledhjen dhe në vetë mbledhjen, doli se nuk luftohej për parimet, por për diçka tjetër.

Revizionistët sovjetikë donin ta bënin mbledhjen për të ngritur prestigjin e tyre, që ka rënë përtokë, për t'i thënë botës komuniste dhe kapitaliste se Bashkimi Sovjetik qëndron kurdoherë në «udhëheqjen» e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se ai bën ligjin dhe se komunizmi ndërkombëtar «është monolit» rreth Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e Brezhnjev. Për ta vetëm Kina dhe Shqipëria kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, prandaj teza revizioniste sovjetike dhe e satelitëve të tyre të Lindjes ishte që të dënoheshin partitë tona. Ky objektiv s'u ndezi, jo se partitë revizioniste të Perëndimit nuk ishin kundër nesh, por se ato ndiqnin qëllime të tjera. Po të mbajmë parasysh qëllimet e revizionistëve sovjetikë, ata donin që partitë revizioniste të Perëndimit të mos shkëputeshin nga Moska, pse e dobësonin këtë si një superfuqi botërore, e zhvishnin këtë dhe veten e tyre nga një shantazh i mundshëm kundër fuqive imperialiste dhe borgjezive reaksionare kombëtare. Moska, partitë revizioniste të Evropës Perëndimore dhe, tok me to, lëvizjen komuniste ndërkombëtare, i donte si një armë shantazhi dhe, njëkohësisht, si vegla për kompromise. Për të ky «unitet» le të ishte edhe fals, por vetëm të ekzistonte. Këtë nuk e arriti dot. Revizionizmi nuk bashkon, por përçan; ai është një rrymë ideologjike kapitaliste që mbron interesat kapitalistë të borgjezisë së vet.

Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, me tradhtarin Tito në krye, revizionistët italianë, francezë e spanjollë luftuan dhe bënë të fitojnë qëllimet e tyre. Titoja, i pari hoqi vallen e «pavarësisë» nga Moska. Këtë valle ai e kishte filluar me kohë dhe ne e kemi demaskuar katërcipërisht qëllimin e saj. Dalngadalë ai lëshoi rrënjë të thella, dolën hapur dishepuj të tij besnikë, si Berlingueri, Marsheja dhe Karriljoja, por edhe të tjerë akoma të maskuar, si Giereku, Honekeri, Husaku, Çaushesku e të tjerë. Të parët u shkëputën nga Moska. Në fakt, ideologjikisht ata janë në një vijë, por, ndërsa Titoja është në fuqi, partitë revizioniste të Perëndimit duan të bashkohen me borgjezinë e tyre për t'u futur në pushtetin borgjez.

Partitë revizioniste të Perëndimit shkëputjen nga Moska e kanë me gjithë mend, s'ka asnjë manovër nga ana e tyre; ato duan dhe veprojnë që të fitojnë besimin e kapitalit kombëtar, ato u deklaruan haptazi kundër internacionalizmit proletar etj. Tash ata janë në rrugën e dhënies së provave të besnikërisë së tyre ndaj borgjezisë. Titoja po bën «politikën e madhe», të një myflizi. Ai hiqet si arkitekti i «politikës së madhe ndërkombëtare», si «udhëheqësi» i njëfarë bote të paangazhuar, jep «mend» andej e këndeje dhe po andej e këndeje ha para, ryshfete dhe Jugosllavinë e ka bërë skllave të kapitalit të huaj.

Titon e propagandojnë si fitimtarin e mbledhjes revizioniste të Berlinit, e cila po trumbetohet si një mbledhje e unitetit. Por ajo ishte një mbledhje që vulosi tradhtinë e plotë të revizionistëve modernë ndaj marksizëm-leninizmit dhe vërtetoi të gjitha tezat tona të drejta për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe për luftën kundër revizionizmit modern.

Bashkimi Sovjetik vazhdon avazin e vjetër edhe pas mbledhjes përçarëse në Berlin, të cilën e trumbeton si një «fitore» të Brezhnjevit, si «fitore» të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të partive të tjera, si

një «armë kundër imperializmit amerikan», i cili literalisht e mban me bukë e me kredi.

Shkatërrimi i revizionistëve do të shkojë më tej. Ditë më të errëta i presin tradhtarët e marksizëm-leninizmit. Proletariati ndërkombëtar dhe popujt po shohin e çdo ditë do të shohin më mirë dhe do të veprojnë.

NË KINË NUK VEPROJNË AS PARTIA, AS SHTETI I PROLETARIATIT

Në Kinë vazhdon avazi i kritikave të gjata e të përsëritura kundër Ten Hsiao Pinit, sikur ky të ishte i vetmi armik i brendshëm i partisë. Por, megjithatë, edhe ky armik «kaq i lig, kaq i poshtër, kaq dinak» po mbahet në parti dhe nuk po përjashtohet. Përse? Sepse nuk është vetëm, por ka influencë të madhe, brenda dhe jashtë partisë. Ten Hsiao Pini ishte dora e djathtë e Çu En Lait, ai ishte përgatitur prej tij që ta zëvendësonte dhe, nën flamurin e Mao Ce Dunit, ta çonte Kinën në rrugën oportuniste liberale dhe ta transformonte atë në një fuqi të madhe kapitaliste burokratike. Maoja dhe Çuja ishin dakord me idetë e njëri-tjetrit, të cilat i maskonin me formula marksiste-leniniste. Maoja i shpallte idetë e tij, Çuja i zbatonte këto në interesin e të dyve. Lufta fraksioniste në Partinë Komuniste të Kinës e kishte burimin pikërisht në këto ide liberale, të cilat zhvilloheshin me intensitet të ndryshëm.

Liu Shao Çia ishte dakord me Maon në problemet kryesore, po ai i kapërceu kufijtë, arriti të ketë një fuqi të konsiderueshme për veten dhe për njerëzit e tij, ai sundonte në parti, në ushtri dhe në ekonomi. Maoja mbahet në gojë, për të flitej, «ai ngrihej në qiell», po fuqia e tij ishte dobësuar, këtë e kishin të tjerët, Liu Shao Çia, Çuja, Teni dhe të tjerë.

Një rrugë i mbetej Maos: të rimerrte fuqinë. Që ta merrte këtë, atij i duhej të mbështetej te rinia «romantike», që «adhuronte» Maon, dhe te Lin Biaoja, të cilin e bëri zëvendësin e tij, domethënë të mbështetej tek ushtria. Këtu e ka burimin Revolucioni Kulturor, që nuk bëri gjë tjetër, veçse likuidoi grupin e Liu Shao Çisë. Çu En Lain Maoja e ruajti, se i duhej për më vonë, dhe sepse ai ushqente të njëjtat pikëpamje si të Maos. Çuja ishte një zhiruetë që kthehej nga frynte era. Mirëpo piruetat Çusë ia forcuan pozitat, ato bënë që të grumbulloheshin rreth tij të gjithë të djathtët, të moderuarit dhe të majtët. «Revolucioni i Madh Kulturor», në fakt, bëri shumë zhurmë. Atë e propaganduan shumë, por ai ishte «një paradë gardistësh të kuq» për të treguar «forcën» e Maos dhe për të konsakruar se maocedunideja zëvendësoi marksizëm-leninizmin. Në fakt, këto ide e kishin pushtuar me kohë Kinën, por, me këtë rast, iu dha një shtytje që ato të «dominonin botën».

Anarkia, konfuzioni, dy vijat, «njëqind lulet», dhe njerëzit e çdo kallëpi e të çdo ideje, nën mbulesën e maocedunidesë, qëndronin të palëkundur, zhvilloheshin, forconin pozitat. Luftohej për pozita, për fuqi dhe jo për socializmin. Në këtë fazë mori supremacinë Çu En Lai, i cili, tok me Maon, «kurdoherë me Maon» dhe «pas Maos», e likuidoi Lin Biaon.

Filloi epoka e Çu En Lait: epoka e miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pse jo? Çuja e çmonte «shkathtësinë» e Hrushovit, prandaj ndoqi mësimet e tij për aleancat dhe mendonte: «Të miqësohemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të dobësojmë sovjetikët, të ndjekim rrugën e Hrushovit për të modernizuar dhe për të armatosur Kinën, të bëhemi edhe ne fuqi e madhe». Dhe kjo politikë po vazhdon.

Çuja mendoi se ishte në kulmin e fitores: Maon plak ai e kishte në xhep, sepse do të vdiste me sot me nesër;

në udhëheqje ai kishte disa kundërshtarë, por forca e tij ishte e madhe dhe ata do t'i vinte në gjunjë. Për këtë qëllim thirri në ndihmë Ten Hsiao Pinin dhe e mësoi këtë si të vepronte, si të manovronte, si ta merrte fuqinë. Çuja e dinte se do të vdiste nga kanceri; megjithatë pati tre vjet e gjysmë kohë sa ta «dhaskalepste» Tenin.

Mirëpo Teni nuk ishte aq i zhdërvjellët si Çuja, ai u deh nga fuqia dhe nxori shpatën e «diktatorit». «O unë, o ju», — tha Teni. Natyrisht Maos nuk i erdhi mirë për këtë veprim të shpejtuar të Tenit, i cili po ia prishte politikën oportuniste të të dy vijave, bashkekzistencën e tyre. Dhe Teni ra. Megjithatë fuqia e tij qëndron në këmbë, Teni po ashtu qëndron në parti.

Gazetat e Kinës gjijnë çdo ditë me dhjetëra artikuj, «duke demaskuar» Tenin dhe deviacionin e djathtë. Po s'dallohet kush është i djathtë dhe kush është i majtë. Të dyja palët janë në fuqi, janë në vendet ku kanë qenë, bëjnë secili më vete e secili për vete punën e vet dhe lexojnë psallmet e gazetave, saqë të dyja palët janë mërzi-tur. Maoja i ka «këshilluar të majtët» që «të mos i godasin të djathtët», por t'i edukojnë (siç edukuan Tenin!), të mos goditen se «do të ngjasin turbullira në Kinë dhe do të përfitojë armiku». Që këto direktiva janë dhënë, është e sigurt. Këtë e vërteton gjendja që po zhvillohet.

Po ashtu gazetat kineze kanë publikuar se Maoja ka thënë: «Në parti qëndron armiku». Atëherë pyesim: Kush është ky armik? Si duhet luftuar? Ç'po bëhet kundër këtij armiku? Zëvendësministri i Jashtëm kinez, Y Khan, i pyetur nga ambasadori ynë në Pekin për këtë çështje, u përgjigj: «Ky është një mendim i thellë i kryetarit Mao dhe do të duhet një kohë që të kuptohet mirë». As na çudit fare kjo gjë! Mao Ce Duni e ka shkaktuar turbullirën dhe pështjellimin në parti dhe as veprohet konkretisht që të kullohet llumi që ka ngarkuar

rrotat e «makines» së partisë dhe të diktaturës së proletariatit në Kinë.

Në këtë vend as partia, as shteti i proletariatit nuk veprojnë, atje po bëhet një luftë «me pambuk» dhe me formula nëpër gazeta. Partia dhe populli e shohin se situatat atje janë të tilla që të djathtët, të moderuarit, oportunistët, miqtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë më të fortë dhe, në mos sot, nesër do ta marrin fuqinë. Presin sa të vdesë Maoja, për të cilin vetë deklaruan se tash e tutje nuk pret më njeri. Ç'do të thotë kjo? Të dyja palët fshihen pas ekzistencës së tij, nuk dalin hapur. Kjo ka për qëllim që të mos irritohen masat. Me të vdekur Maoja, atëherë të dy ose të gjashtë palët, me flamurin e Maos, do të luftojnë për të marrë pushtetin. Koha që kalon në këtë amulli, është në favor të reaksionit.

Ne, në të kaluarën, kemi pasë menduar se Maoja mendonte dhe vepronte si marksist, por shihnim se bëheshin edhe gjëra jo në rrugë të drejtë. Mendonim se këto s'i bënte Maoja, ose që ishin taktika. Por ka kohë që gjërat për ne po bëhen më të qarta: Maoja nuk i ka qëndruar besnik marksizëm-leninizmit. Po të mos ishte udhëheqës i Kinës së madhe, atij do t'i kishte dalë boja më parë. Interesat e Kinës dhe të lëvizjes komuniste botërore kërkonin që në këtë çështje të ecej me kujdes, por kujdesi i arsyetuar i kapërceu kufijtë, dhe, në rast se në Kinë nuk fiton ajo pjesë revolucionare e partisë që i qëndron besnike teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit dhe jo maocedunidesë, Kina do të rrëshqasë patjetër në pellgun e hapët revizionist. Ajo do të ecë në rrugën e një shteti të madh kapitalist. Idetë e Mao Ce Dunit e kanë në themel këtë prirje teoriko-politike, këtë stil dhe metodë pune. Kina e Maos, që hiqet socialiste, ka mbeturina të mëdha mistike të moderuara. Atje është krijuar një frymë dhe një disiplinë në filozofi, në punë, në jetë, që me zor do të lëvizet nga konceptet e

vjetra konfuciste dhe nga maocedunideja, amalgamë e marksizëm-leninizmit, kapitalizmit, anarkizmit dhe gjithë influencave të imperializmit dhe të revizionizmit modern.

Lufta nacionalçlirimtare e çliroi Kinën, por gjithë periudha pas kësaj lufte nuk ka qenë e qartë, ku të dukej si një fill i kuq dhe të zbatohet me konsekuencë marksizëm-leninizmi revolucionar. Idetë oportuniste, bashkëpunimi i ngushtë me partitë e borgjezisë etj., mbizotëruan në politikë, në ideologji, në organizimin e ekonomisë, në atë të pushtetit dhe të ushtrisë; vazhduan favorët për kapitalistët, dhe këta u lanë të qetë të zhvillonin aktivitetin e tyre të mëparshëm, të fitonin, të ndërrojnë mënyrat e jetesës dhe të punës për t'u treguar «të nënshtruar»; por këta u bënë dhe u kthyen në administratorë e financiarë të zotë, u bënë mbështetja e oportunistëve. Ata kanë pasur në krye Liu Shao Çinë, Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin e të tjerë, dhe Mao Ce Dunin në njëfarë shkalle.

Kina na rezervon shumë të papritura që, po të reflektosh thellë, nuk janë «të papritura». Shumë gjëra do të na shohin sytë e do të na dëgjojnë veshët.

E MARTË
6 KORRIK 1976

VDIQ ÇU DEJA

Agjencia HSINHUA njoftoi vdekjen e Çu Desë, anëtar i Byrosë Politike të PK të Kinës dhe kryetar i Komitetit të Përherëshëm të Asamblesë Kombëtare Popullore të Kinës. Do të dërgojmë një telegram ngushëllimi.

TË PRESIM ME NGROHTËSI ANSAMBLËT KOSOVARE QË VIJNË NË VENDIN TONË

Po më tërheq vëmendjen se nuk po shkruhet për korin e Prishtinës «Kolegium Kantorum».

I thashë Ramizit se shokët që merren me propagandën e shtypin, o kanë frikë të marrin përgjegjësi, o s'mendojnë fare. Vjen një kor nga vëllezërit tanë kosovarë, që digjen për Shqipërinë, e mbahet heshtje, ndërsa tanët, kur venë në Kosovë, i presin si «perëndinë», çahen nga entuziazmi kur këndojnë artistët tanë dhe manifestojnë në një mënyrë të atillë, saqë UDB-ja i arreston. Si do t'i inkurajojmë ne shqiptarët e Kosovës për patriotizmin e tyre të madh shqiptar, për zhvillimin e tyre kulturor? Si do t'ua tregojmë ne dashurinë tonë, kur ata futen në burgje, sepse dëgjojnë këngët tona, kurse shtypi ynë nuk shkruan për ta? Prandaj të ndryshojë që tash ky qëndrim pasiv, apolitik. Kudo që të vejë kori, ta presin me ngrohtësi, me duartrokitje.

I propozova Ramizit që, para se të largohet ky ansambël, të japë një shfaqje të fundit në Tiranë¹, gjatë së cilës pjesëtarët e tij mundësisht të këndojnë së toku edhe me këngëtarët e artistët tanë, këngë patriotike nga tonat, po ku nuk flitet për mua. Në këtë shfaqje të asis-

¹ Shih në këtë vëllim, f. 376.

tojë edhe Ramizi me ministren e Arsimit dhe të Kulturës dhe me punonjës të frontit të kulturës; kështu që kjo pjesëmarrje të marrë karakter politik dhe kulturor dhe jo qeveritar. Në antrakt Ramizi të takohet me përfaqësues të ansamblit dhe t'i urojë, pastaj ai mund të vejë edhe në skenë. Kështu besoj se bëhet mirë.

DURRËS, E SHTUNË

17 KORRIK 1976*

POLITIKË PA PARIM E SHTETIT TË MADH KINEZ

U takova me ambasadorin tonë në Pekin, i cili erdhi për të marrë pjesë në punimet e Plenumit të Komitetit Qendror, që do të mbahet pasnesër, më 19 korrik. Gjendjen reale të Kinës ai e paraqit shumë të turbullt, kurse, sipas shtypit kinez, kjo gjendje paraqitet «e shkëlqyer». «Euforia» vazhdon në dukje, por kjo është një paraqitje e rreme. Vetëm një gjë shkon mirë: furnizimi i popullit me mallra ushqimore dhe industriale. Kjo mund të jetë si rrjedhim i punës që është bërë dhe i disiplinës në punë që e karakterizon popullin kinez, por në këtë çështje mundet që influencon edhe fuqia blerëse e vogël e popullit. Tregu fshatar, një, dy a tri herë në javë, është shumë i zhvilluar në të gjithë Kinën. Tregtohen nga shteti të tilla prodhime, si grurë, pula, derra, zorzavate e çdo gjë, apo i kanë lënë të lira kooperativat të vetadmindistrojnë prodhimet? Mendoj se do të jetë kjo e fundit.

Lufta politike, ideologjike dhe organizative del ashtu siç e kemi gjykuar ne. Përleshja dhe përgatitjet për përleshje më të mëdha vazhdojnë në ethe. Po demaskohet Ten Hsiao Pini dhe rryma e djathtë; por edhe miqtë e Tenit, nga ana tjetër, duke mos hequr asnjë presje nga mendimet e tyre, kanë adoptuar parullën e përgjithshme, por nuk bëjnë autokritikë, ata qëndrojnë në pikëpamjet e tyre të djathta, sidomos në pushtet, në ushtri, në ekonomi, por edhe në parti. Të gjithë përpiqen të forcojnë

pozitat për marrjen e pushtetit kur të vdesë Maoja, i cili, sipas ambasadorit tonë, s'e ka të gjatë. Flitet se bëhen arrestime, por këta që futen në burg nuk njihen, janë kuadro të mesëm dhe të ulët. Të mëdhenjtë djathtistë qëndrojnë në vendet ku kanë qenë, herë zvirdden, herë dalin në shesh e nxirren në gazetë për të dhënë ndonjë përshtypje se ekziston harmonia.

Të djathtët duken se janë më të fortë, ata kanë shumë kyçe në duar dhe i përdorin ato, kurse «të majtët» kanë vetëm shtypin në dorë dhe fshihen pas emrit të Maos.

Ksenofobia është e madhe edhe ndaj nesh, shqiptarëve. Të gjithë vëzhgohen, ruhen, nuk venë dot as në kinema, as në restorant, veçse të shoqëruar dhe vetëm në ato vende ku caktohen. Kinezët, sipas atyre që thonë vetë, arrestohen, në qoftë se shoqërohen me ndonjë të huaj.

Bëjnë shumë ndërtime, kudo ngrihen grataçiele dhe kombineate të mëdha moderne. Marrin kredi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Japonia, nga Republika Federale e Gjermanisë, nga Franca etj. Kreditë merren në dy mënyra: ose për pesë vjet nga këto shtete, ose nga bankat private kapitaliste, të cilat financojnë investimet dhe borxhi u kthehet pas një kohe më të gjatë dhe me përqindje fitimi. Hong-Kongu është bërë qendra e financimit kapitalist për Kinën.

Për ne, për Shqipërinë, opinioni në popullin kinez është i mirë, por krahas nesh ngrihet në qiell ylli i Rumanisë sidomos, dhe ai i Jugosllavisë. Udhëheqjet e këtyre dy vendeve, si dy agjentura të imperialistëve dhe të revizionistëve, po luajnë një rol të madh gërryes ndaj atij pak socializmi që mund të ketë mbetur në Kinë. Revizionistët rumunë dhe jugosllavë punojnë për shkatërrimin e Kinës nën maskën e antisovjetizmit.

Për marrëdhënie politike të mira me ne as që mund

të flitet, çdo gjë është maskë, fasadë. Fjalë «të mira» e slogane, por pa përmbajtje. Në masat e popullit është ca ndryshe, por jehona e miqësisë sonë mbytet si zjarr kashte, shuhet nga zjarrfikësit e shumanshëm dhe të shumëngjyrshëm. Por në Kinë ne kemi edhe miq. Ambasadorit tonë i kanë thënë se në udhëheqjen e lartë kineze po diskutohet për çështjen e Shqipërisë. Ka udhëheqës që kanë ngritur çështjen: «Pse pengohen furnizimet dhe pse nuk mbahen angazhimet që janë marrë ndaj Shqipërisë? Pse silllemi kështu me Shqipërinë, miken tonë, kurse me vende që porsa u njohëm, tregohemi të gatshëm?!». Një funksionar i drejtorisë së investimeve me botën e jashtme i ka thënë po ashtu një shokut tonë: «Kemi marrë urdhër që për çdo gjë për të tjerët mund të diskutojmë, por për problemet e Shqipërisë jo, se ato i studion udhëheqja».

Të tilla paraqiten me pak fjalë disa aspekte të Kinës. Ne i kemi ndjekur të gjitha këto rrjedhime dhe evolucione. Politika e jashtme e Kinës nuk ka ndryshuar asnjë grimë nga ajo e para: miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër të cilave pothuajse nuk flitet fare; me sovjetikët bëhet vetëm luftë politike dhe jo demaskim ideologjik; miqësi deri edhe me fashistët, mjaft që të thonë një fjalë kundër Bashkimit Sovjetik. Politikë pa parim, antiproletare, antimarksiste, revizioniste e një «shteti të madh» që është duke u ngritur.

DURRËS — POGRADEC
E MARTË, 27 KORRIK 1976

NGJARJE HISTORIKE PËR SHKENCËN BOTËRORE

Më 20 të këtij muaji amerikanët hodhën për herë të parë një sondë në Mars, e cila bëri një ulje të butë. Kjo është një ngjarje me të vërtetë historike për shkencën botërore. Pamë edhe fotografitë e para, shumë të qarta, të transmetuara nga televizioni italian. Sipas të dhënave të shkencëtarëve amerikanë, temperatura në këtë planet është shumë e ulët, ka pak oksigjen, ka azot dhe nuk duket të ketë ujë. Sonda, natyrisht, porsa ka filluar nga veprimet dhe nga transmetimi i të dhënave. Në fotot e qarta dukej toka e butë, pa pluhur si ajo e hënës, dukeshin gurë të vegjël e të mëdhenj të thyer, dukej «rigola» që kishin bërë këmbët e sondës kur u ul, dukeshin qielli dhe horizonti pa re.

Shkencëtarët thonë se planeti i Marsit është i ftohtë, por ka ndryshime në temperaturë natën dhe në drekë, me orën e Marsit. Çështja më me rëndësi është gjetja dhe vërtetimi nëse ka jetë apo jo në Mars. Flitet për jetë mikrobiane, po, në ka, si paraqitet kjo? Shkencëtarët thonë se mund të ketë jetë edhe në kushtet e Marsit, pse e krahasojnë këtë me disa mikrobe të tokës që rrojnë në disa kushte artificiale, ku nuk duket e mundur të ekzistojë jeta. Ata thonë se nuk dihet gjë e saktë dhe do të prononcohen kur të marrin të dhëna.

Tash kanë vënë në lëvizje një dorë kazme e lopate prej floriri që çan tokën e Marsit, e shkrifëron atë dhe e

kalon pastaj në një laborator të vogël prej 40 cm (që ka kushtuar, sipas të dhënave, 50 milionë dollarë). Ky laborator formohet me kompartimente të ndryshme brenda. Nga çdo lopatë do të hidhet në të nga një lugë çaji tokë dhe do të analizohet, për të parë me këtë a ka jetë atje, në ç'forma paraqitet dhe do ta komunikojnë. Me siguri do të komunikojnë edhe shumë të dhëna të tjera.

Sa keq që këto shpikje dhe këto të dhëna me vlera historike në kozmologji janë në duart e imperialistëve amerikanë dhe do të shfrytëzohen prej tyre jo në interesin e popujve e të shkencës, jo në shërbim të njerëzimit!

POGRADEĆ, E ENJTE

29 KORRIK 1976*

ME NE KINEZËT NDJEKIN TAKTIKËN «HIQ E MOS E KËPUT»

Kina po e aktivizon shumë propagandën e saj në favor të Jugosllavisë, për të mos folur për Rumaninë, me të cilën, në të gjitha drejtimet, tregon një unitet mendimi politik, ideologjik, partie dhe shtetëror. Delegacionet e këtyre dy vendeve venë dhe vijën në Kinë me shumicë dhe janë të çdo natyre. Jugosllavia dhe Kina kanë vendosur edhe marrëdhënie partie, por për oportunitet i kamuflojnë, se edhe për kinezët nuk është mirë, por edhe jugosllavëve tani për tani nuk u leverdis një kontakt i hapët partie me kinezët.

Titoja, në mënyrë të maskuar, punon për të minuar marksizëm-leninizmin në Kinë, siç po bën kudo ku gjen terren. Kinezët pranojnë edhe ofeza nga jugosllavët, e kam fjalën në format diplomatike të pritjes. Këtu të dyja palët kanë rënë në ujdi: titistët kanë hall të mos i zemërojnë sovjetikët dhe kinezët kanë besim të plotë në taktikat dhe në strategjinë «antisovjetike» të titistëve. Prandaj që nga kryeministri Bijediç, Mahmut Bakalli dhe Kosta Nagi venë e priten përzemërsisht në Kinë, bile kinezët i çojnë edhe në kufi me sovjetikët për të parë nyjet strategjike kineze. Shokët tanë nuk i kanë çuar asnjëherë në këto vende. Mahmut Bakallin e pritën me pekule si «birin» e Kosovës shqiptare.

Kinezët, që janë në kundërshtim me vijën e Partisë

dhe të shtetit tonë, na kanë rekomanduar haptazi që ne të lidhemi në aleancë me Jugosllavinë (këtë Çu En Lai ia ka thënë Beqir Ballukut), domethënë ringjallën historinë e vjetër, ëndrrën e titistëve që Shqipëria të bëhet republikë e shtatë e Jugosllavisë. Gazetat kineze çdo ditë kanë lajme mbi Jugosllavinë, mbrojnë politikën e saj, mburrin haptazi Titon me terma plot lëvdata. Mao Ce Duni as që ka ndryshuar mendimin për Titon që atëherë kur na tha se «Titoja s'ka faj, por faj kanë pasur Stalini dhe Kominterni». Por Stalini ishte dhe mbetet një marksist i madh, kurse Titoja dhe Maoja janë të një boje, por jo të kuqe.

Ndonjëherë, kur të dalë sheshit çfarë ka qenë në të vërtetë Maoja, do të shtrohet pyetja se pse ne e kemi cilësuar këtë «marksist-leninist i madh»? Është e vërtetë se ne e kemi thënë këtë, por jo me bindje të plotë. Po atëherë mos kemi qenë vallë oportunistë? Jo, ne u kemi dashur kurdoherë të mirën popullit kinez, Partisë Komuniste të Kinës, që haptazi mbronin Stalinin, i kemi dashur të mirën edhe Maos vetë.

Kinezët dhe Maoja luftuan, por vija e tyre e pasqirimit kishte elemente të theksuara oportuniste, liberale. Ne mendonim se këto qëndrime do të ishin të përkohshme. Pas vdekjes së Stalinit, Maoja u duk «i moderuar» në kritikën kundër Stalinit, por entuziast ndaj veprimeve të Hrushovit. Më vonë ai i ngriti boritë kundër Hrushovit dhe ne menduam se erdhi në normë, por këto veprime bëheshin për motive të tjera koniunkturale dhe ideologjike që e shtynin në këtë *volte-face*¹. Kur nisi Revolucioni Kulturor, Partia jonë mendoi se duhej t'i mbronim me të gjitha forcat Kinën dhe Maon, që kërcënoheshin nga reaksioni dhe revizionistët. Ne vazhduam ta quanim

¹ Frëngjisht — kthesë e plotë, ndryshim i papritur i mendimit, i qëndrimit.

atë «marksist-leninist i madh», por ishim kundër ngritjes në qiell të kultit të tij, që trumbetohej në mënyrë të neveritshme nga kinezët. Ne refuzuam të flitnim dhe të botonim budallallëqet e mëdha të kinezëve. Mendimet e mia për këto qëndrime jomarksiste të kinezëve dhe të Maos i kam shprehur me hollësi në shënime të veçanta për Kinën.

Veçanërisht pas Revolucionit Kulturor, politika e jashtme e Kinës dhe veprime të tjera të Partisë Komuniste të Kinës ranë në kundërshtim me vijën tonë. Ne kishim adoptuar një taktikë të drejtë dhe vija jonë shpallej botërisht për çdo problem. Kjo binte në kundërshtim me vijën e Partisë Komuniste të Kinës, të shtetit kinez dhe të Maos. Të gjithë e shikonin këtë divergjencë, por me këtë ne mendonim të ndikonim për të mirë te Kina, që kjo të ndryshonte qëndrim. Ne i bëmë dhe letra zyrtare Mao Ce Dunit, por ky as që na u përgjigj fare. Përkundrazi, kinezët na pakësuan ndihmat në minimum dhe me parulla e slogane duan të japin përshtypjen se asgjë s'ka ngjarë në marrëdhëniet midis dy partive dhe dy vendeve tona, kurse, në fakt, ka ngjarë një gjë e madhe, por kinezët me ne ecin sipas taktikës «hiq e mos e këput».

VEPRIM QË IA ARRITI QËLLIMIT TË TIJ TË MIRË

Më njoftuan për atmosferën e ngrohtë që ishte krijuar gjatë takimit që ministrja e Arsimit dhe e Kulturës pati me disa përfaqësues të grupit të korit të Prishtinës «Kolegium Kantorum». Në të vërtetë unë i kisha sugjeruar Ramizit që të organizohej një koncert i përbashkët, jo zyrtar, në të cilin të këndonin pjesëtarë të këtij grupi dhe këngëtarë nga tanët. Në koncert të asistojnë edhe Ramizi dhe shoqja Tefta Cami.

Këtë sugjerim unë e bëra që kosovarët ta merrnin vesh se sa i do populli shqiptar vëllezërit, bijtë dhe bijat e tij të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi ku banojnë shqiptarët; e bëra po ashtu që ta kuptonin edhe titistët se ç'qëndrim mbajmë ne, kur ata burgosin dhe persekutojnë të rinjtë dhe të rejtat shqiptare, që manifestojnë qenien e tyre si shqiptarë dhe dashurinë e tyre për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Por koncerti i përbashkët nuk u bë, sepse ambasada jugosllave nuk i lejoi këngëtarët kosovarë të merrnin pjesë në një shfaqje të përbashkët me këngëtarët e artistët tanë. Ambasada jugosllave u tmerrua, u frikësua dhe u bënte presione kosovarëve të mos manifestonin dashurinë e tyre për popullin shqiptar, për Shqipërinë. Me orë të tëra gjithë pjesëtarët e këtij grupi i mbanin në ambasadë ku «i këshillonin».

Kur pjesëtarët e grupit janë takuar me shoqen Tefta,

janë gëzuar pa masë, janë entuziazmuar dhe kanë thënë «s'do ta harrojmë kurrë pritjen që na bëtë, por mendoni se do të kthehemi në Kosovë dhe atje mund të marrim masa. Ju lutemi na kuptoni».

NJË ÇËSHTJE QË DUHET TË ISHTE MENDUAR MË MIRË MË PËRPARA

Dje mbrëma u dërgova fjalë shokëve në Tiranë që t'i dërgonin Mao Ce Dunit një telegram ngushëllimi të ngrohtë nga unë, nga Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe nga Kryeministri, për tërmetin e madh që ra këto ditë në Pekin, në Tanshan dhe në Tiencin e që, siç e deklaruan edhe vetë kinezët, ishte jashtëzakonisht i rëndë, me dëme në njerëz e në materiale. Agjencitë e huaja thonë se qyteti i Tanshanit, sidomos, është shkatërruar i gjithë. Ky qytet ka një milion e gjysmë banorë. I gjithë Pekini do të qëndrojë jashtë, në rrugë e në çadra, se parashikohet edhe një tërmet tjetër i fortë.

Por në emisionin e fundit të lajmeve të televizionit tonë dëgjova se një telegram i tillë i ishte dërguar Hua Kuo Fenit nga shokët e Qeverisë. Me sa duket sugjerimi im shokëve u ka shkuar vonë, prandaj dërguan këtu ministrin e Punëve të Jashtme me një projekttelegram nga ana ime për Mao Ce Dunin.

I thashë atij se një telegram i dytë nuk duhet bërë, mbasi nuk shkon dhe kinezët mund të thonë pse na dërguan dy telegrame dhe jo një. Do të ishte drejt që këtë çështje ju ta kishit menduar më mirë përpara. Unë mendoj që tash të mjaftohemi vetëm me telegramin që është dërguar. Por, i thashë atij, Hysniu të thërresë këshilltarin e ambasadës së Republikës Popullore të Kinës dhe t'i

thotë nga ana ime se «shoku Enver ndodhet me pushime, ku mori vesh me hidhërim të thellë për fatkeqësinë e madhe që shkaktoi në Kinë tërmeti. Ai ishte shumë i shqetësuar dhe më lajmëroi t'ju thërres dhe t'ju lutem t'u transmetoni nga ana e tij shokut Mao Ce Dun dhe popullit vëlla kinez ngushëllimet e tij të përzemërta. Ai merr pjesë në hidhërimin dhe në fatkeqësinë që ju ngjau dhe me gjithë zemër solidarizohet me përpjekjet e mëdha që po bëjnë gjithë populli kinez dhe Partia Komuniste e Kinës për t'i kapërcyer këto fatkeqësi. Populli ynë është pranë popullit kinez si në ditë të mira, edhe në të vështira».

POGRADEC, E MARTË

17 GUSHT 1976*

NË KINË KA PASUR «NJËQIND RRYMA» DHE «NJËQIND SHKOLLA»

Shokët shpesh më pyesin: Sa rryma ideologjike ka pasur në Kinë në kohën e Revolucionit Kulturor dhe Maoja i çfarë rryme ishte? Natyrisht është e nevojshme që unë t'ua them shokëve mendimin tim, aq sa mund të jetë i drejtë, veç këtë mendim nuk mund ta jap kuturu, por duke u bazuar në ato që kanë ndodhur në Kinë dhe duke u përpjekur që këto të dhëna t'i analizoj në prizmin e materializmit dialektik dhe historik.

Ngjarjet e Kinës i kam ndjekur vazhdimisht me kujdes dhe për çdo ndodhi kam nxjerrë konkluzionet e mia, të cilat i kam hedhur në kohën e duhur në kartë. Këtë e kam bërë sepse Kina dhe Partia Komuniste e saj kishin një mision të madh në botë dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Në Kinë ka pasur «njëqind rryma» dhe «njëqind shkolla». Këtë e ka thënë vetë Mao Ce Duni, i cili ka pasë hedhur moton: «Le të lulëzojnë njëqind lulet, le të konkurrojnë njëqind shkollat». Kjo është si një e një bëjnë dy. Pra, Mao Ce Duni jo vetëm pranonte «njëqind rryma dhe njëqind shkolla» në socializëm, por këto i lejonte të zhvilloheshin në «bashkekzistencë paqësore». Kuptohet vetiu se teoria e «njëqind luleve dhe e njëqind shkollave» është revizioniste. Revizionistët modernë aktualë thonë se «duhet të vemi në socializëm me të gjitha partitë, edhe

me ato të ekstremit të djathtë», domethënë me fashistët.

Këtë ide Mao Ce Duni e vë në praktikë në një kohë kur Partia Komuniste e Kinës ka marrë fuqinë dhe «udhëheq ndërtimin e socializmit».

Siç e ka zakon, «timonieri i madh» flet nga «maja e Olimpmit» si t'i fryjë në kokë. Në një moment në kokën e tij fryn një mendim tjetër: ai i zhdukjes së «njëqind luleve dhe të njëqind shkollave», sikur zhdukin barërat e këqija. Por, natyrisht, kjo «zhdukje» nuk varej më nga «koka e Zeusit». «Njëqind shkollat dhe njëqind lulet» vazhduan të zhvilloheshin, por në dy «kopshte»: në «kopshtin» e Liu Shao Çisë dhe në «kopshtin» e atyre që bënë Revolucionin Kulturor.

Liu Shao Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Pen Çeni e të tjerë ishin të krahut të djathtë në Partinë Komuniste të Kinës. Ky grup kishte grumbulluar të «njëqind lulet dhe njëqind shkollat» nën ombrellën e tij dhe sundonte Kinën. Pjesëtarët kryesorë të këtij grupi kishin hedhur në dorë partinë, ushtrinë, pushtetin, ekonominë dhe organizatat e masave, kurse «Zeusi» në Olimp mbante hapëset e kashtës. Një ditë ai u zgjua dhe tha: «Këta do të më rrëzojnë», prandaj u mbështet te grupi që përbëhej nga Kan Shen, Lin Biaoja, Çen Po Taja e të tjerë dhe shpërtheu Revolucionin Kulturor, duke dhënë urdhër: «Sulmoni shtabet!», domethënë grupin e djathtë. Por ky revolucion nxori edhe udhëheqës të rinj: Çan Çun Çiaon, Van Hun Venin, Çian Çinin, Jao Ven Juanin e të tjerë.

Dhe Revolucioni Kulturor, me «gardistët e kuq» dhe me miliona ushtarë të veshur civilë nga Lin Biaoja, sulmoi shtabet dhe fitoi. Çu En Lai ndërroi këmishë, rrëshqiti si ngjalë dhe iu nënshtrua Maos, prandaj qëndroi në vend i paprekur, shpëtoi nga spastrimi. Si «u shpëtua situata», Maoja u ngjit në «Olimp» dhe Çuja filloi të organizojë punën në «tokë». Çusë i duhej të likuidonte Lin Biao, prandaj se si ngjau, se si u bë, u thur intrigë a u

bë komplot, Lin Biaoja u likuidua. Kurse Kan Shen u sëmur dhe vdiq. Çusë i mbetej kështu të likuidonte të rinjtë. Për këtë ai punoi me sistem dhe u ndihmua nga Maoja, grumbulloi të gjithë të djathtët, gjoja nën flamurin e Maos, rehabilitoi Ten Hsiao Pinin dhe e ngriti këtë në pedestal. Maoja, si nga një lozhë teatri, shikonte se si «rriheshin njerëzit në parterin e teatrit dhe priste kush do të kishte epërsinë».

Maoja ka qenë e është një centrist, një sehirxhi, marksist-leninist à l'eau de rose¹, siç thuhet në gjuhën franceze.

«Timonieri i madh» do të jetë «i paanshëm» në gjykime, ai do të veprojë si borgjezia në dhënien e «drejtësisë», që simbolizohet nga një grua «e bukur», së cilës i kanë mbyllur sytë me një bandazh dhe i kanë vënë në dorë një peshore «jashtëzakonisht të përpiktë», që të duket «e paanshme».

Se si do të zhvillohet tash kjo situatë, do të shohim. E kemi për detyrë partie ta ndjekim dhe të jemi vigjilentë.

¹ Frëngjisht — me ujë trëndafili.

E MARTË
24 GUSHT 1976*

KINEZËT PO NA KRIJOJNË VËSHTIRËSI

Shokët e delegacionit të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, që është në Kinë, na lajmërojnë për vështirësitë që na kanë krijuar kinezët dhe për shtyrjen e afatit të ndërtimit ose të përfundimit të disa veprave të Kombinatit Metalurgjik. Për këtë ata nxjerrin si pretekst tërmetin e madh që ra në korrik të këtij viti në Tanshan, Fenan, i cili, megjithëse, siç thonë, duket se ka qenë shumë i rëndë, s'ka lidhje fare me këto objekte.

Unë mendoj t'i pranojmë ato propozime që janë të arsyeshme, kurse për të tjerat që na i shtyjnë pa data, pala jonë t'u thotë se ne s'jemi dakord, por s'kemi ç'ju bëjmë; «arsyen» e tërmetit, që gjoja i detyroka ata të na i shtyjnë këto vepra, ne nuk e pranojmë. Për të tjerat të firmosim protokollin, pa zënë në gojë tërmetin. Po të ngulin këmbë për këtë, t'u thonë se ne nuk e firmosim protokollin dhe të kthehen në Shqipëri, pasi t'u lënë një letër.

Sot takova ambasadorin tonë në Pekin, se nesër ai do të kthehet në detyrë. Natyrisht, biseduam për gjendjen në Kinë dhe se në ç'shikallë janë marrëdhëniet tona me kinezët.

I bëra atij një përmbledhje për atë që mendojmë ne për vijën politike dhe ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës. Ne ndjekim vijën tonë të pavarur e të hapët dhe, megjithëse nuk bëjmë fjalë asnjëherë për vijën kineze,

gjithë bota i shikon kontradiktat e vijës së Partisë sonë me atë të Partisë Komuniste të Kinës. S'ka asnjë dyshim që këtë e shohin edhe kinezët, të cilët nuk janë dakord me vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë. Ata janë ftohur, bile janë zemëruar me ne. Hapur nuk tregojnë gjë, por, në fakt, veprojnë kundër nesh, duke na bërë presione. Ata ngadalësojnë e sidomos na shtyjnë realizimin e veprave, po ashtu nuk na japin kreditë dhe nuk realizojnë marrëveshjet ekonomike, të konkretizuara me kontratat që kemi firmosur. Kinezët kanë pasë menduar se ne do të ishim në mëshirën e tyre. Ata kanë dëshiruar dhe dëshirojnë që të jemi të varur nga ata dhe të ndjekim kursin e tyre antimarksist. Mirëpo kjo nuk ngjau dhe nuk do të ngjasë. Sidoqoftë, kinezët, me pikëpamjet e shtetit të madh, mendonin se ne do t'i ndiqnim në vijën e tyre proamerikane, proreaksionare. Ata mendonin, gjithashtu, se ne do të mbronim Tregun e Përbashkët Evropian, «Evropën e Bashkuar», Titon, Çausheksun, Pinoçetin dhe Frankon. Por hesapet i kanë bërë pa haxhinë!

Ashtu si sovjetikët, edhe udhëheqja kineze ka filluar nga presionet kundër nesh. Së pari, nisën nga presionet ekonomike, por nuk vepruan me mënyrat e sovjetikëve. Kinezët nuk na i prenë kreditë, por na i shtynë, na i pakësuan. «S'kemi, jemi të varfër», na thonë, dhe këto thënie të tyre i mbulojnë me parulla hipokrite si «jemi miq», «miqësia jonë është e pathyeshme» e plot pallavra të tilla. **Të gjitha këto ndodhin sepse vija e tyre, në politikën e jashtme dhe të brendshme, nuk bazohet në marksizëm-leninizmin, por në maocedunidenë, që nuk puqet me vijën e Partisë sonë, as në ideologji, as në politikë, as në organizim. Maocedunideja është një rrymë oportuniste, liberale.** Dhe kjo duket qartë në të gjitha qëndrimet dhe veprimet e udhëheqësve kinezë.

Kinezët (flas për udhëheqjen dhe jo për popullin e

për masën e komunistëve) janë dinakë dhe hipokritë. Kur ta kanë nevojën, të lajnë e të lyejnë; kur s'ta kanë nevojën dhe nuk je dakord me ta, të lënë në rrugë. Kur ne luftonim kundër Hrushovit, kinezët nuk na mbrojtën, por «ruanin edhe dhinë, edhe lakrën», sepse anonin nga mendimi që Hrushovi do ta pranonte Maon si shef suprem. Kur panë se Hrushovi ua vuri kufirin te thana, Maoja dhe shokët e tij u bënë të zjarrtë me ne, prandaj vendi dhe Partia jonë u propaganduan shumë në popullin e tyre. Kjo ishte një fitore dhe përsëri edhe tash mbetet si një fitore e madhe për ne. Këtë fitore udhëheqja kineze edhe tash nuk guxon ta atakojë, por e gërryen si miu, nën dhe.

E etur për hegjemoni, si një fuqi e madhe, Kina, pas likuidimit të Lin Biaos, mori kursin proamerikan, prope-rëndimor, për të luftuar kundër Bashkimit Sovjetik. Ajo po mbështetet te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe këto po mbështeten te Kina, e cila synon të pëlçasë lufta me Bashkimin Sovjetik.

Në qoftë se në Kinë nuk ndodh një kthesë rrënjësore me drejtim marksist-leninist, revolucionar, marrëdhëniet shqiptaro-kineze do të dobësohen për fajin e udhëheqësve kinezë.

Hapur kundër nesh ata mund të mos dalin, por presionet ekonomike me siguri do t'i vazhdojnë. Ne, natyrisht, do të marrim masa dhe me forcat tona (dhe kemi forca) do t'i përballojmë sabotimet që mund të na bëjnë kinezët.

Në Kinë mbretëron kaosi, lufta ndërmjet dy vijave. Se kush është më i fortë dhe kush do të fitojë, është vështirë ta themi. Mund të bihet në ujdi oportuniste dhe pas Maos të përgatitet një «Mao» i ri, që të bëjë dozimin dhe balancimin e vijës, pajtimin e të papajtueshmëve, «shkuarjen» në socializëm me «njëqind lule», me shumë vija dhe në harmoni për paraqitjen e Kinës hegjemoniste me bojë trëndafili.

E HËNË

30 GUSHT 1976*

KJO GJENDJE NUK ËSHTË AS NORMALE, AS REVOLUCIONARE

Lajmet që vijnë nga Kina, i përngjasin gjëmimit që vjen nga fundi i detit, i cili, megjithëse nuk duket, në fakt, ekziston. Në sipërfaqe duket se po bëhet një propagandë e përditshme kundër Ten Hsiao Pinit, propagandë e shfrenuar, por, për se flitet kundër tij dhe çfarë thuhet, këtë e mbajnë mbyllur në parti. Një gjendje e tillë nuk është aspak normale, nuk është revolucionare.

Propaganda kundër të djathtëve sipas sloganit të Maos se «borgjezia është brenda në parti», zien, mirëpo kjo e djathtë, kjo borgjezi po bën qejf të plotë në vendet me rëndësi që ka zënë. Një gjendje e tillë nuk është aspak normale, nuk është aspak revolucionare.

Flitet me të madhe për luftën e klasave, flitet e shkruhen artikuj për diktaturën e proletariatit, por as lufta e klasave nuk shihet që të zhvillohet dhe as diktatura e proletariatit nuk duket të veprojnë, se nuk po i godet armiqtë. Një gjendje e tillë nuk është aspak normale, nuk është aspak revolucionare.

Duket se rrymat kundërshtarë kanë zënë kolltuqet dhe një palë ka në dorë mikrofonat e shtypin, kurse pala tjetër ka ekonominë dhe pushkën. E para duket nervoze, e dyta e qetë, natyrisht, sepse ka pushkën. Maoja as duket gjëkund të dalë të flasë, të japë tonin, të japë direktiva. Vetëm nga mikrofonat e gazetat lëshohen e shkruhen

disa parulla të tij, të tëra si thika me dy presa, të tëra lehtësisht të përdorshme edhe nga të majtët, edhe nga të djathtët. As që vihet në dukje se kur i ka thënë Maoja këto parulla e slogane, ç'e kanë pasë shtyrë t'i thotë dhe kundër kujt i ka thënë. Asgjë. Këto u ngjajnë parabolave të evangjelistëve.

Siç shihet, s'do të ketë të ardhme të mirë Kina. Mendoj se atje do të ketë «tajfune», siç thonë kinezët. Mirëpo kë do të përlejë furtuna: të majtët apo të djathtët, reaksionarët e Çusë, të Tenit, të Li Hsien Nienit, apo udhëheqësit e rinj, Van Hun Venin me shokë?

Sot, në sipërfaqe duken të fortë udhëheqësit e rinj, por valët e nënujshme ziejnë në oqeanin e madh kinez, dhe, siç ma merr mendja, njerëzit e Çusë e të Tenit, në mos hapur, kanë mbështetjen e Maos, sepse idetë e tij oportuniste dhe liberale janë një ndihmë kolosale për ta. Mjafton për këta që të mos i ngasë kush, pa le të grijë «megafoni». Të djathtët presin vdekjen e Maos dhe me siguri do të veprojnë.

**KINEZËT PO SHKELIN ANGAZHIMET PËR
OBJEKTET E METALURGJIKUT**

Në një radiogram nga Pekini që lexova sot, thuhet se kinezët nuk pranojnë të tërhiqen në asnjë pikë nga çështjet e padrejta që avancojnë lidhur me nënshkrimet e protokolleve dhe me furnizimin në kohë, siç janë angazhuar më parë, për objektet e Kombinatit Metalurgjik. Ata, siç duket, kërkojnë të na frikësojnë me mosrealizimin e detyrimeve për Kombinatin Metalurgjik. Me pretekstin e tërmetit që ra në Kinë, ata duan të bëjnë një kthesë prej 180 gradësh në marrëdhëniet e miqësisë me vendin tonë. Miqësia për ata, siç kuptohet, ka pasur objektiva të tjerë, për të kaluar radhën kur ishin në vesh-tirësi, kurse nga ana jonë kjo ka qenë një miqësi e sinqertë.

**SHANTAZHE DHE BLOKADË EKONOMIKE
TË KINËS KUNDËR SHQIPËRISË**

Veprimet jomiqësore, për të mos thënë armiqësore, të Kinës ndaj vendit tonë po shtohen vazhdimisht. Materiale të importit dhe të eksportit kinezët po i ngadalësojnë në mënyrë të hapët, skandaloze për të dëmtuar ekonominë tonë dhe për të na vënë në vesh-tirësi.

Deri në muajin gusht eksportin e tyre për ne kinezët e kanë realizuar vetëm 22 për qind, kurse në eksportin për ta mbi 80 për qind.

Importet që presim nga Kina janë materiale të para për industrinë tonë, të gjitha të kontraktuara në mënyrë zyrtare me klering. Mallrat tona janë dërguar të gjitha, kështu që, në qoftë se nuk gabohem, me Kinën ne kemi një bilanc aktiv në favorin tonë. Kjo është e turpshme nga ana e kinezëve dhe është e qartë se ata po na sabotojnë. U detyruam t'i themi ambasadorit tonë në Pekin, që të marrë kontakt me ministrin kinez të Tregtisë së Jashtme, Li Çianin, dhe të protestojë para tij. Dhe ai mori kontakt, ia parashtroi atij gjendjen me hollësi dhe iu «lut» që të marrin masa urgjente dhe të na nisnin mallrat. Vaporët tanë, si «Vlora», rrinë nga 120 ditë në portet kineze për t'u ngarkuar, gjë që mund të bëhet brenda 5 ditëve.

Zoti Li Çian e dëgjoi ambasadorin tonë, por bëri sikur nuk ishte në dijeni (gjë që është një gënjeshtëri e

ulët), i premtoi se do të interesohej dhe nga java që vjen do t'i përgjigjej.

Kinezët po përdorin ndaj nesh metoda të urryera tregtare, që asnjë vend kapitalist dhe revizionist nuk i praktikon. Kina me Shqipërinë «mike» marrëveshjet tregtare i nënshkruan në dy etapa: një pjesë të tyre në gjashtëmujorin e parë dhe pjesën tjetër në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Kjo do të thotë që mallrat, që kontrahohen në gjashtëmujorin e parë, të vijnë nga fundi i vitit, dhe ato të gjashtëmujorit të dytë, nga gjashtëmujori tjetër i vitit të ardhshëm. Sipas kësaj praktike ne ua livrojmë kinezëve mallrat tona brenda vitit, kurse të tyre ata na i sjellin brenda një viti e gjysmë e më shumë. Prandaj mallrat e gjashtëmujorit të dytë të këtij viti as që kanë filluar të vijnë fare nga Kina. Kërkesës së ambasadorit tonë që të shkojnë në Kinë për bisedime grupet shqiptare të punës, Li Çiani iu përgjigj: «Të shohim nëse mund t'i presim dot para muajit dhjetor». Me fjalë të tjera, me këtë ai do të thotë që tregtia me Kinën, të cilën ata e kanë zbritur deri në 30 për qind në vit, në krahasim me ç'ishte përpara, të zbresë edhe më poshtë, në 15 për qind në vit. Kjo hapur është armiqësore.

Nga ana tjetër, delegacionit të industrisë që ka shkuar në Pekin për çështjet e Kombinatit Metalurgjik, ka gati tre muaj që kinezët po i bëjnë shantazhe dhe presione arrogante. Ata, me fjalë të tjera, nuk duan të na livrojnë reparte të rëndësishme të kombinatit, prandaj nuk përcaktojnë asnjë datë, duan të na lënë shpatën e Damokleut mbi kokë. Dhe të gjitha këto synime përpiqen t'i mbulojnë me fraza se «nuk e kemi përvetësuar teknologjinë e asaj dhe të kësaj». Të gjitha këto janë gënjeshtër, sepse në programin e punës që na kishin dërguar më parë, shënohej se delegacioni i tyre «do të asistojë në prodhimin e parë të llamarinës» etj.

Përveç kësaj, protokollet që do të nënshkruajmë, ki-

nezët përpiqen të na i imponojnë si të duan ata dhe ngjulin këmbë që të vihet edhe çështja se «tërmeti që ngjau në Kinë mund të vështirësojë livrimet dhe miqtë shqiptarë duhet të na kuptojnë» etj. Në bisedimet, që u zhvilluan nga të dyja palët, përpara pretendimeve të tyre arrogante, se «ne e kemi të drejtën të flasim, se jemi furnizuesit», tanët iu përgjigjën si duhet, se «ne nuk nënshkruajmë protokollet veçse për ato gjëra për të cilat kemi rënë dakord. Në rast se ju doni të shënoni në aneks pikëpamjet tuaja, edhe ne po ashtu do të shënojmë pikëpamjet tona». Kinezët u tronditën, kur shokët tanë u thanë kështu dhe kërkuan «të ribisedojmë që të mos kemi divergjencë». Kështu ka ngelur kjo punë.

Nga ana tjetër, zëvendësministri i Jashtëm kinez, Y Xhani, i tha ambasadorit tonë që ne të pranojmë të vijnë delegacione të miqësisë, të kulturës etj. gjatë këtyre muajve, por të gjitha këto kinezët i bëjnë për të fshehur veprimet e tyre armiqësore dhe për t'u paraqitur me veprime pseudomiqësore, pra, përpiqen të ruajnë aparenat, kur, nga ana tjetër, po minojnë miqësinë.

Për ambasadorin e ri kinez që ka muaj e s'po vjen, se gjoja ka qenë sëmurë, Y Xhani tha se do të vijë nga 15 shtatori. «Ai prapë nuk është mirë, tha Y Xhani, sidoqoftë do të vijë, pastaj do të shohim, se mund të kthehet prapë në Kinë të pushojë», përfundoi ai.

Ç'dalin nga të gjitha këto të këqija që po na bëjnë revizionistët kinezë? Po ato poshtërsira që na bënë edhe revizionistët sovjetikë, me një ndryshim: se sovjetikët i prenë marrëdhëniet me ne në mënyrë brutale, kurse kinezët shkojnë me dredhira dhe me «hiq e mos e këput». Taktika e tyre është «këpute ti, por jo ne». Ku e kanë hallin me këtë taktikë revizionistët kinezë? Ata e shohin se Partia jonë ndjek hapur një rrugë të drejtë, marksiste-leniniste, mirëpo kinezëve nuk u pëlqen kjo rrugë, ata dëshirojnë që ne të ndjekim rrugën e tyre revizioniste

dhe tradhtare. Ne nuk do ta bëjmë kurrë këtë, por vazhdojmë dhe do të vazhdojmë të ndjekim rrugën tonë të drejtë, që është në kundërshtim me të tyren. Ata janë të pafuqishëm të na imponojnë neve dëshirat dhe vijën e tyre, ndaj përpjekjet që bëjnë u demaskohen.

Kinezët, pra, kanë filluar nga shantazhet dhe presionet ekonomike, me qëllim që të na trembin e të na përkulin. Por, me gjithë qëndrimet tona, ata s'kanë vënë mend dhe po mendojnë e po veprojnë si një shtet i madh revizionist. Siç kam shkruar edhe më parë, Çuja bisedoi me Beqir Ballukun që të bënte atë që bëri. Të njëjtën gjë ka pasë bërë ai edhe me Abdyl Këllezin. Kinezët me siguri janë zemëruar në kulm që ne i qëruam miqtë e tyre, dhe pikërisht kur ne i qëruam tradhtarët, ata filluan t'i shtojnë presionet ekonomike.

Tash ne do të bëjmë Kongresin e 7-të të Partisë. Ata e marrin me mend që ne do ta shpalosim aty vijën tonë, vijë kjo që do të jetë e hapët, në kundërshtim me atë të kinezëve, pa iu referuar aspak drejtpërdrejt atyre; por gjithë botá do ta ketë të qartë se midis dy partive tona ka kontradikta parimore për një varg problemesh kyç.

Të gjitha ato që përmenda më lart, kinezët i bëjnë si presion që ne të mos flasim në Kongres për vijën tonë të kristaltë. Por ata qorrespen dhe do ta pësojnë. Ne nuk trembemi nga kurrkush. Ne jemi në rrugë të drejtë, ata le të dridhen!

Kuptohet edhe arsyeja përse ata duan të dërgojnë delegacione «miqësore» para Kongresit. Kjo është një hile kineze, me të cilën ata duan të thonë: «Ju me gurë, ne me lule».

Po kështu shpjegohen edhe ato që Y Xhani na thotë për ambasadorin kinez, se «mund të rikthehet në Kinë». Ai bën këtë aluzion: «Në rast se ju vazhdoni në rrugën tuaj, ne e heqim ambasadorin», nën pretekstin se «është i sëmurë» dhe marrëdhëniet midis dy vendeve bien atë-

herë përtokë, ashtu si me revizionistët e tjerë. Këtë arsyetim bëjnë revizionistët kinezë, por ata nuk mendojnë se neve s'na prishet asnjë punë për këtë, malet tona më të larta. **Ne duam, jemi përpjekur dhe do të përpiqemi të kemi miqësi me Kinën, por miqësi në rrugën marksiste-leniniste dhe në asnjë rrugë tjetër. Miqësinë nën skllavëri, nën presione, nën shantazhe, qoftë të Kinës, qoftë të kujtdo tjetër, ne e shqelmojmë.** Udhëheqësit kinezë veprojnë si udhëheqës të një «shteti të madh». Ata mendojnë se «shqiptarët u prishën me Bashkimin Sovjetik, sepse na kishin ne, po ta prishin edhe me ne, ata do të venë prapë te sovjetikët», prandaj thonë: «Ose me ne, ose me sovjetikët, njësoj është, shqiptarët u likuiduan». Por, na marrshin të keqen! Ne do të luftojmë kundër të gjitha këtyre plehrave, pse jemi marksistë-leninistë shqiptarë dhe në rrugën tonë të drejtë do të fitojmë kurdoherë!

E MARTË
7 SHTATOR 1976

SHËNIM

I bëra një radiogram ambasadorit tonë në Pekin që të protestojë pranë kinezëve për vonesat që na shkaktojnë për objektet tona industriale.

E ENJTE
9 SHTATOR 1976*

VDIQ MAO CE DUNI

Sot u njoftua vdekja e shokut Mao Ce Dun. Vdekja e tij, sidomos në këto situata të turbullta, na hidhëroi e na shqetëson. Ajo është një humbje e madhe për Kinën.

Mao Ce Duni, sipas mendimit tim, ka qenë një revolucionar, një personalitet me rëndësi jo vetëm për Kinën, por dhe në shkallë ndërkombëtare.

Mao Ce Duni udhëhoqi Partinë Komuniste dhe popullin e madh kinez në fitoren e madhe të çlirimit të Kinës nga robëria e pushtuesve dhe nga klika reaksionare e Guomindanit. Ky qe një realizim me rëndësi të madhe historike si për popullin kinez, ashtu edhe për kampin e socializmit dhe për popujt që luftonin e luftojnë për çlirim.

Nën udhëheqjen e Maos filloi ndërtimi i socializmit në Kinë. (Të paktën kështu kemi pasur bindjen deri në ditët aktuale, kur po shohim se ky «ndërtim» është bërë me zigzage.) Sipas mendimit tonë, që tani ka ardhur puna të shtrohet pyetja: Kush do të fitojë në Kinë, socializmi apo kapitalizmi? Prandaj vdekja e Mao Ce Dunit bën të lindin te ne edhe shqetësime të mëdha për të ardhmen e popullit kinez dhe për rrugën që do të ndjekë Kina pas vdekjes së tij. Sigurisht, ne nuk mund të prononcohemi dot tani, koha do të na sqarojë. Dalshim ne të gabuar, por rrjedha e kësaj vije, që revizionistët kinezë e quajnë maocedunide dhe që nuk ka asgjë të përbashkët me

marksizëm-leninizmin, nuk do të sjellë asgjë të mirë për Kinën.

Mao Ce Duni, si mendimtar e filozof, si udhëheqës revolucionar demokrat i popullit kinez, është një personalitet historik, por historia dhe analiza marksiste-leniniste e situatës në Kinë do të sqarojë se ai ishte një filozof me kulturë të gjerë, por jo marksist-leninist. Ai ishte i imprenjuar thellësisht nga filozofia e vjetër kineze e Konfucit etj., dhe në veprën e tij, si eklektik që ishte, marksizëm-leninizmi ka depërtuar vetëm në formë parimesh e idesh të cunguara.

Pikërisht eklektizmi i tij filozofik e bënte Maon të ishte, si të thuash, një moderator për rrymat e ndryshme që kanë ekzistuar vazhdimisht në Kinë dhe që ai i lejonte, i inkurajonte dhe i vinte në «përplasje» gjoja dialektike. Mirëpo një veprim prej moderatorit mund të influenconte edhe për mirë edhe për keq, por, sidoqoftë, një gjë e tillë mund të vepronte sa ishte gjallë vetë Maoja. Tash ai vdiq. A do të qëndrojë Kina e kuqe, dhe kjo e kuqe të kthehet në një të kuqe të vërtetë, të zjarrtë, revolucionare, marksiste-leniniste?

Ne, me gjithë sinqeritetin komunist, e dëshirojmë dhe e urojmë me gjithë shpirt këtë gjë, se kjo është për të mirën e Kinës, të revolucionit, të socializmit e të komunizmit.

Ne, komunistët shqiptarë, do ta kujtojmë me respekt Mao Ce Dunin për anët e mira të tij, për ato mendime pozitive dhe për veprimtarinë e gjatë revolucionare, por për sa u përket atyre pikëpamjeve e qëndrimeve politike, ideologjike, organizative që ne i gjejmë se kanë qenë të gabuara dhe jomarksiste, nuk kemi ndenjtur dhe nuk do të rrimë pa i vënë në dukje dhe pa i kritikuar. Leninizmi na mëson të jemi kurdoherë të drejtë, objektivë dhe jo subjektivë, as dhe sentimentalë.

Pavarësisht nga mospajtimi me të në shumë gjykime,

vdekja e Mao Ce Dunit na hidhëroi edhe sepse ai ishte treguar vazhdimisht një mik dhe dashamirës i vendit tonë socialist dhe i Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe kjo, si komunistë e internacionalistë që jemi, nuk duhet injoruar. Mund të them se Mao Ce Duni në udhëheqjen kineze ka qenë personi kryesor dhe vendimtar që e ndihmoi Republikën Popullore të Shqipërisë me kredi ekonomike dhe ushtarake, dhe e akordoi këtë ndihmë në frymë internacionaliste. Edhe Partia jonë në këtë frymë e ndihmoi, qëndroi përkrah Kinës dhe e mbrojti Maon, si në kohë të mira, ashtu edhe në kohë të vështira, sidomos kundër sulmeve të revizionistëve hrushovianë, si dhe gjatë Revolucionit të Madh Kulturor.

Me të dëgjuar për vdekjen e tij, ne vendosëm të dërgonim një delegacion partie e qeverie, por në deklaratën që bëri udhëheqja kineze, lexuam se nuk do të pritëshin delegacione të huaja për të marrë pjesë në ceremonitë e organizuara me këtë rast.

Natyrisht, ne morëm masa për dërgim mesazhesh ngushëllimi e vendosje kurorash në Pekin, për organizim vizitash e dërgim mesazhesh ngushëllimi në ambasadën kineze në Tiranë nga udhëheqja e Partisë, e shtetit, e organizatave të masave, e institucioneve arsimore, kulturore e shkencore, si dhe delegacionesh të kolektivave punonjës nga Tirana e nga disa ndërmarrje industriale dhe kooperativa bujqësore të rretheve të tjera.

NGUSHËLLIME NË AMBASADËN KINEZE

Bashkë me shokët e tjerë të udhëheqjes shkuam në ambasadën kineze, ku paraqitëm ngushëllime për vdekjen e Mao Ce Dunit.

FIJET E KOMPLOTTIT ÇOJNË EDHE NË KINË

Thirra ministrin e Punëve të Brendshme, Kadri Hazbiun, bisedova me të dhe ai më raportoi mbi zhvillimin e mëtejshëm të hetimeve rreth Abdyl Këllezit dhe tradhtarëve të tjerë. Si konkluzion, del se tradhtia e tyre është katërcipërisht e vërtetuar, këtë e kanë pohuar edhe vetë të akuzuarit. Ata, me gojën e tyre, thonë se të gjitha veprimet e tyre i kanë bërë me ndërgjegje të plotë, sepse kanë qenë armiq të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të socializmit.

Një gjë tjetër me rëndësi që del nga zhvillimi i hetimeve të këtyre tradhtarëve është çështja se Kiço Ngjela, duke pohuar tradhtinë e tij, shpjegon se në këtë rrugë e ka futur Abdyl Këllezi. Koço Theodhosi ka pohuar, gjithashtu, se «unë, nga origjina dhe prejardhja kam qenë armik i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i socializmit me kohë», dhe ka shtuar se «u aktivizova këto vitet e fundit nga Abdyl Këllezi, i cili edhe më diktonte si të veproja. Ai, për shembull, më «kritikonte» në Qeveri, kurse jashtë më thoshte: «Hajde se e rregullojmë këtë ose atë çështje» dhe, në fakt, e rregullonim, por në rrugë armiqësore».

E këshillova ministrin që këtë çështje ta thellojmë, jo më për të vërtetuar gjërat e njohura e të provuara, por për të hetuar ato çështje për të cilat jemi të bindur dhe që komplotistët nuk duan t'i pohojnë drejtpërdrejt,

megjithëse nga thëniet e tyre nënkuptohen qartë. Të thelloket hetuesia që:

1) Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e të tjerët, para fakteve të pakundërshtueshme e të plota, të pohojnë me gojën e tyre se bashkë me Beqir Ballukun, Hito Çakon e Petrit Dumen ishin të lidhur dhe së toku koordinonin veprimtarinë armiqësore.

2) Të zbulohen lidhjet e mundshme kryesore që këta armiq e tradhtarë kanë lënë pas dhe që me siguri ekzistojnë. Duhet vigjilencë revolucionare nga Partia dhe vëzhgim i kujdesshëm e i thellë nga organet e Sigurimit të Shtetit.

3) Të zbulohet, gjithashtu, me kë kishin lidhje jashtë këta komplotistë dhe si i mbanin këto lidhje. Kjo çështje ka rëndësi të madhe për ne, ta dimë dhe ta vërtetojmë, veç të tjerave, edhe duke e pohuar ata vetë me gojën e tyre.

Për këtë, pikën e tretë, ministri më tha se lidhjet me agjunkturën jashtë duhej t'i mbanin me njerëzit e tregtisë së jashtme, me Kiço Ngjelën, me Vasil Katin e të tjerë. Ai nënkuptonte lidhjet agjenturore me jugosllavët ose me sovjetikët. Ka plotësisht mundësi të jetë edhe kështu, por kjo nuk është një lidhje e atillë që Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi mund të mbanin në mënyrë serioze, në rang të lartë, për një punë kaq të rrezikshme që po përgatitnin të kryenin këta tradhtarë.

I thashë ministrit se sovjetikët dhe jugosllavët punonin në mënyrë subversive për të ndryshuar rendin socialist të vendit tonë dhe, me siguri, ishin në dijeni që këta tradhtarë po organizonin një komplot dhe mund që kishin lidhje me ta. Kjo është një rrugë e mundshme, por, gjithashtu, i vura në dukje që të mos harrojmë dhe lidhjet e tjera të këtyre tradhtarëve, lidhjet me revizionistët kinezë, dhe pikërisht me të plotfuqishmin Çu En Lai. Për këtë rrugë ne kemi të dhëna konkrete që flasin për veprimtari armiqësore nga ana e Çu En Lait.

Udhëheqja kineze ishte në kundërshtim me vijën e Partisë sonë. Për këtë unë nuk mendoj të zgjatem, por dua të vë në dukje se kinezët nuk na kthyen dot në rrugën e tyre të gabuar dhe ndërmorën punën armiqësore kundër nesh. Çuja ka pasë zgjedhur Beqir Ballukun dhe Abdyl Këllezin si elementët kryesorë për të vepruar. Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi na kanë pasë raportuar në Byronë Politike që Çu En Lai u kishte thënë se «Shqipëria duhet të ndërtojë një mbrojtje elastike dhe, në rast se sulmohet, të heqë dorë nga mbrojtja frontale, të kalojë menjëherë në mal, të hidhet në luftë partizane dhe të merret vesh me jugosllavët e me rumunët, me të cilët të organizojë një mbrojtje të përbashkët».

Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi e thanë këtë «porosi» të Çusë në Byronë Politike për të tatuar pulsën tonë, por edhe për të mbjellë farën e përçarjes. Kur Beqir Balluku dhe Abdyl Këllezi panë se ne e shkëlmuam këtë tradhti të Çusë, natyrisht, për sy e faqe, ata u bashkuan me ne, por, në realitet, edhe Beqiri, edhe Abdyli kishin mbetur dakord me Çunë që të vepronin për të përmbysur gjendjen ekzistuese në vend. Me siguri Çuja u ka thënë atyre se do t'i ndihmonte, në fillim duke na bllokuar ekonomikisht, me qëllim që të na gjunjëzonte dhe, kur tradhtarët të merrnin fuqinë, atëherë do të rifillonte ndihma nga ana e Kinës. Beqir Balluku punoi për «planin Çu En Lai në ushtri»¹. Dihen tezat e tij dhe si veprroi ai. Nga ana e vet, Abdyl Këllezi veprroi për decentralizimin e ekonomisë, për vendosjen e vetadministrimit titist. E gjithë kjo veprimtari e rrezikshme, që vërtetohet, ishte zbatimi i orientimit të Çu En Lait. Pra, me këtë vijë tradhtare dobësohej mbrojtja nga brenda, dobësohej

¹ Orientimi vetëm për luftë partizane, në rast se Shqipëria sulmohej nga jashtë, dhe për t'u lidhur me jugosllavët dhe rumunët.

ekonomia dhe hidheshin hapat për vetadministrimin revizionist titist, kurse nga jashtë ky aktivitet armiqësor ndihmohej nga veprimtaria armiqësore e kinezëve. Këta filluan një tjetër kurs ekonomik kundër nesh: ngadalësuan ndërtimin e veprave, s'na dhanë kredi dhe as armatime. Kjo ishte ndihma nga jashtë që u vinte tradhtarëve, të cilët vinin në korent Çunë se si zhvillohej puna.

Me siguri këtë veprimtari e dinin edhe titistët, edhe revizionistët sovjetikë, të cilët ishin dakord me planin e Çusë dhe e gjenin si të vetmin plan të mundshëm në këto momente, pa ndërhyrje nga ana e tyre. Kush ua kishte thënë këtyre këtë plan? Beqir Balluku, Abdyl Këllezi, Hito Çakoja, Kiço Ngjela dhe të tjerë, por mundet edhe Çuja me shokët e tij revizionistë.

Komploti u zbulua dhe komplotistët u arrestuan. Menjëherë filloi dhe po vazhdon kundër nesh bllokada ekonomike nga ana e Kinës, e cila do të shkojë edhe më tej. Për ne fijet e kompleteve janë të qarta, por porosita që hetuesia të vazhdojë hetimin dhe t'i pyesë Abdyl Këllezin, Koço Theodhosin, Kiço Ngjelën e të tjerë, për të gjitha ato fakte që janë të pakundërshtueshme, por që ata duhet t'i pohojnë gjerësisht me gojën e tyre.

Fakt është që ne mendonim (dhe mendonim drejt), se tradhtarët do të ndihmoheshin nga jashtë dhe do të vepronin kur të pijej situata për ta. Do të vinte sulm dhe ndihmë për ta nga Jugosllavia dhe nga Bashkimi Sovjetik? Sigurisht që po, por jo më parë se ata të përgatitnin terrenin dhe të bënin puçin. Por, për të realizuar këto qëllime, duhej të vinte, dhe u erdhi në fakt, më parë, ndihma e kinezëve, e Çu En Lait.

Po të fitonin komplotistët, kush do të fuste duart këtu, në vendin tonë? Të gjithë, në harmoni dhe në divergjenca, sepse tradhtarët ishin agentë edhe të sovjetikëve, edhe të jugosllavëve, edhe të kinezëve, edhe të amerikanëve. Të tilla janë lidhjet e komplotistëve.

Koço Theodhosi ka thënë në hetuesi se, përveç Abdyl Këllezit, tek ai ka bërë presion edhe Pirro Gushoja. Ky duhej të ishte agent i amerikanëve, të cilit çdo muaj i vinin dollarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga banka ku gjoja i kishte depozituar babai i tij emigrant, por të lejuara nga departamenti i shtetit. Pirro Gushoja, i siguruar nga kjo anë, ushtronte ndikim të madh jo vetëm mbi Koçon, por edhe mbi Beqir Ballukun e Lipe Nashin (i cili bëri tratativat me firmën amerikane për makinën që dihet). Koço Theodhosi në Plenumin e Komitetit Qendror u mundua të dredhonte, por më në fund u gjend ngushtë dhe pohoi se, me të ardhur Lipe Nashi nga Berlioni, kishte shkuar menjëherë në Fier dhe atje bënë mbledhje (që nuk ishte vendi) me Lipen dhe me Pirro Gushon. Pirro Gushoja thirrej, gjithashtu, në mbledhje të veçanta që bënte Beqir Balluku në Fier me disa kuadro ushtarakë, ku diskutonte «tezat e tij» antimarksisiste, pjesëmarrjen e të cilit në to asgjë nuk e arsyetonte, veçse qenia në një komplot. Tash së fundi mësova se edhe Vasil Kati e ka pasur babanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por të gjitha këto mund t'i lidhnim edhe me një veprim në shkallë ndërkombëtare, që duhet ta ketë burimin te Kina, te Çu En Lai, te politika proamerikane e kinezëve.

E dimë kthesën 180° të politikës së Kinës drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dihet edhe politika jonë dhe kundërshtimi zyrtar që bëmë në Kinë. Afërsisht në këto kohë, kur Çuja, Beqir Balluku, Abdyl Këllezi e kompani po vepronin nën rrogëz, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia bënë jo një herë, por dy herë deklarata zyrtare se «ishin gati të vendosnin marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë». Ishte një fakt pa precedent ky, që këto dy shtete imperialiste arrogante t'i luteshin Shqipërisë «të lidhte marrëdhënie me to». Nuk ka asnjë

dyshim se këtu ishte dora e Çu En Lait, pra s'ka dyshim që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin në dijeni se ç'organizonte Kina kundër Shqipërisë socialiste, të cilën donte «ta pajtonte» një herë me Shtetet e Bashkuara, pastaj të tjerat, mendonte Çuja, vinin njëra pas tjetrës.

Mirëpo ne ia shkëlmuam planet. Ai e vazhdoi planin e tij të egër, por, me zbulimin dhe me dënimin e komplotistëve, ne bëmë që edhe ky plan t'i dështonte plotësisht. Shqipëria jonë socialiste, brenda tri dekadave, në sajë të vigjilencës së Partisë, të unitetit të saj ideologjik të brendshëm dhe të unitetit me popullin, ka shpëtuar nga tri komplete të mëdha që rrezikonin qenien e saj si shtet socialist i pavarur dhe sovran.

Këto tri komplete erdhën njëra pas tjetrës: nga jugosllavët, nga sovjetikët, pas vdekjes së Stalinit, dhe nga kinezët. Që të tria këto shtete, të nisura nga pozita të fshehta antimarksiste, komplotonin kundër Partisë sonë marksiste-leniniste dhe socializmit në Shqipëri, duke e filluar veprimtarinë e tyre me një armiqësi të egër, të maskuar me pseudomiqësi dhe me pseudoteori marksiste-leniniste.

Nën parullat e «internacionalizmit proletar dhe të miqësisë së singertë» jugosllavët filluan gjoja të na «merrnin nën sjetull» dhe të na «mbronin si ajo nëna e mirë që interesohet për foshnjën sa të mëkëmbet». Kështu jugosllavët revizionistë, me Titon në krye, që u demaskuan ç'tradhtarë ishin, infiltruan te ne, organizuan rrjetin e tradhtarëve, flitnin se po na ndihmonin në çdo drejtim, por, në fakt, na rropën në fukarallëkun tonë, na sabotuan naftën dhe rindërtimin, na grabitën ushqimet dhe prodhimet bujqësore, u orvatën të rrëzonin udhëheqësit marksistë-leninistë të Partisë, punuan ta bënin Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe, më në fund, u përpoqën të na pushtonin edhe ushtarakisht. Por plani i tyre djallëzor dështoi, Partia e Punës e Shqipërisë

e shpëtoi atdheun nga një rrezik i madh. Titizmi ishte revizionizmi modern, një agjunkturë e imperializmit dhe e borgjezisë kapitaliste reaksionare.

Pas titistëve, vendit tonë socialist dhe Partisë sonë, pas vdekjes së Stalinit, iu turr revizionizmi sovjetik, po aq i egër dhe dinak sa edhe titizmi. Edhe ky veproi nën maskën e «miqësisë së madhe» e të «internacionalizmit proletar», edhe ky luajti rolin e «dados së mirë». Ndihma ekonomike dhe ajo e paktë ushtarake që na u dha, u realizuan nga Stalini, sepse, me të vdekur ky, filluan menjëherë sulmet e Hrushovit e të Mikojanit me shokë kundër Partisë sonë. Çdo gjë merrte formën se «na donin të mirën». «Ç'ju duhet juve industria, ç'ju duhet juve të çani kokën të bëni bukën, bukën jua japim ne, ju mbillni pemë, agrume, zarzavate». Edhe naftën ata na e sabotuan, specialistët e tyre na fshihnin çdo gjë dhe të gjitha ia raportonin Moskës. Ne na kritikonin se «nuk dinim të ndërtonim, nuk dinim të rritnim bagëtitë, nuk dinim të qeverisnim, përderisa lejonim që fshatarët të mbanin qen në shtëpi, të cilët hanin bukën kot»!

E tërë kjo veprimtari shoqërohej me krijimin e agjunkturës së hrushovianëve brenda vendit tonë. Ata synonin që portet, aerodromet, ushtria, ekonomia jonë dhe çdo gjë tjetër të ishte nën drejtimin e tyre, kurse ne të ishim një koloni e revizionistëve sovjetikë, të ktheheshim në një plasdarm për ta dhe populli ynë të bëhej skllav i tyre. Mirëpo Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli ynë u rezistuan këtyre armiqve të tërbuar, ua çorën maskën dhe i shporrën nga atdheu. Partia jonë e shpëtoi kështu për të dytën herë Shqipërinë socialiste nga planet skllavëruese të revizionizmit modern, nga socialimperializmi i ri, po aq i egër sa edhe imperializmi amerikan dhe agjuntura e tij, revizionizmi titist.

Sulmi i tretë, pra komploti i tretë kundër vendit tonë, është ai i kinezëve që e kam analizuar. Edhe ky

është një komplot i egër revizionist socialimperialist që sulmon Shqipërinë socialiste, Kinën socialiste dhe revolucionin. Edhe ky komplot revizionist modern paraqitet me parulla pseudomarksiste, pseudosocialiste, pseudomiqësore. Revizionizmi kinez, pas vdekjes së Stalinit, u përpoq të merrte nën tutelë hrushovianët, u përpoq të ruante miqësinë me revizionistët, u përpoq të shuante polemikën dhe të «pajtonte Shqipërinë me Hrushovin». Të gjitha këto u dështuan revizionistëve kinezë, ndërsa brenda u zhvilluan përlëshje të mëdha që vinin në rrezik vetë Kinën. Shqipëria socialiste ishte i vetmi vend në botë që e mbrojti deri në fund Republikën Popullore të Kinës dhe Partinë Komuniste të Kinës. Kina për një kohë u izolua dhe në këto kushte të vështira për të i vetmi mik dhe aleat besnik ngeli Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë.

Kina e ndihmoi ekonomikisht Shqipërinë, por kjo ndihmë u dha me zor, se do të ishte gabim dhe revizionistët kinezë do të demaskoheshin, po të bënin ndryshe, në një kohë që Shqipëria e ndihmonte moralisht Kinën me të gjitha fuqitë që kishte dhe sinqerisht. Megjithatë, Çu En Lai mbajti në çdo kohë një qëndrim jomiqësor ndaj vendit e Partisë sonë dhe më në fund i hodhi maskat. Ai përdorte vazhdimisht po ato formula të sovjetikëve: «Ç'ju duhet juve kaq industri, ju nuk ndërtoni mirë, ju nuk zhvilloni luftën e klasave, ju braktisët fshatin» etj., kur ne, në fakt, bënim të kundërtën e atyre që pretendonte ai. Ai prish, dhe ne ndreq. Çuja kishte plane djallëzore revizioniste për Kinën, për Shqipërinë dhe për vende të tjera.

Revizionistët kinezë dështuan me Shqipërinë, sepse Partia e Punës e Shqipërisë vigjilonte. Ajo pa se Kina e ktheu miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ndërmoi veprime të tjera të këqija. Ne ua kundërshtuam këto veprime haptazi. Atëherë Çu En Lai organi-

zoi bllokadën ekonomike kundër nesh dhe nxitu puçistët në komplotin e tyre. Po ne këtyre u ramë kokës.

Çuja vdiq, Teni, që ai solli në fuqi, u qërua. Kina tash ndodhet në kaos. Do të shohim si do të zhvillohet situata, por asgjë për ne nuk është e papritur dhe asgjë nuk na tremb.

NJË VENDIM I PK TË KINËS QË DËMTON MARRËDHËNIET INTERNACIONALISTE MIDIS PARTIVE KOMUNISTE

Ambasadori i ri kinez ka kërkuar të takohet sot me Ramiz Alinë. Nuk dihet për ç'punë, por parashikojmë se vjen t'i japë përgjigje negative për ftesën që bëme ne për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin e 7-të të Partisë¹.

Në këtë rast Ramizi duhet t'i thotë, dhe për këtë ne ramë dakord, që ne nuk e gjejmë të drejtë vendimin e tyre për të mos marrë pjesë reciprokisht në kongreset e partive tona. Ky është një minus në forcimin e marrëdhënieve internacionaliste që lidhin partitë komuniste dhe punëtoresh marksiste-leniniste të vërteta.

¹ Ambasadori dorëzoi përgjigjen e KQ të PK të Kinës në të cilën njoftohej se nuk do të dërgohej delegacion në Kongresin e 7-të të PPSH në bazë të një «vendimi të marrë më përpara për të mos marrë pjesë në kongreset e partive të tjera dhe për të mos ftuar delegacione në kongreset e PK të Kinës».

TRAGJEDIA E KINËS

Tragjedi e madhe në Kinë. Ato që parashikonim se do të ngjishnin në Kinë, pas vdekjes së Mao Ce Dunit, ndodhën dhe bile ngjarjet u zhvilluan me një shpejtësi të rrufeshme. Mendonim se të dy korrentet, edhe të djathtët, edhe të majtët, do të vazhdonin «të bashkëjetonin në divergjenca», ashtu siç kishte bërë gjithë jetën Maoja dhe siç i këshillonte bashkëpunëtorët të vepronin edhe pas vdekjes së tij, e kurdoherë. Vetëm se «timonieri i madh» i dy ose më shumë vijave kishte krijuar një autoritet të atillë, që mund të mbante zigarenë në dorë. Por çfarë zigareje? Asnjëherë të vërtetë dhe konsekuente marksiste-leniniste.

Mao Ce Duni fliste me formula revolucionare për «revolucionin», për «luftën e klasave» dhe për çështje të tjera parimore, por në praktikë ai ishte një liberal, një ëndërrues, një centrist në drejtim të manipulimit dhe të balancimit të korrenteve të ndryshme që bënin pjesë dhe intrigonin në Partinë Komuniste të Kinës dhe në shtetin kinez. Mao Ce Duni, me të tilla karakteristika, influencojë kollaj nga njëri ose nga tjetri korrent; një herë mbështeste njërin, një herë tjetrin.

Çka është e vërtetë dhe e dukshme, Çu En Lai ishte «Jagoja» më i madh i dramës shekspiriane kineze. Ai ishte i djathtë, ishte një mandarin, ishte borgjez, ishte pseudomarksist. Në manipulimet që bënte Maoja, Çu En

Lai ka manovruar me mjeshtëri. Kur mbytej vapori i një korrenti reaksionar, ku Çuja ishte brenda, ky linte me të shpejtë vaporin dhe fshihej nën flamurin e Maos.

Duhet ritheksuar se Maoja vë në dukje në revolucion rolin primordial të fshatarësisë dhe në këtë drejtim del që ai nuk është dakord me rolin udhëheqës dhe hegjemon të klasës punëtore. Idetë e tij të lëkundshme, siç janë ato mbi fshatarësinë, pasqyrohen në të gjithë vijën liberale të Mao Ce Dunit.

Maoja, në teori, pranonte disa parime bazë të marksizmit. Në shkrimet e tij zyrtare këto parime dhe disa çështje të tjera, në përgjithësi, janë formuluar drejt. Por në praktikë Maoja ka formuluar e ka mbrojtur teza jo-marksiste siç është teza që theksohet edhe në nekrologjinë e tij: «Fshati duhet të rrethojë qytetin». Nekrologjia thekson se «pa vepruar kështu, nuk mund të bëhej revolucion!» Kjo do të thotë që revolucionin proletar duhet ta udhëheqë fshatarësia. Kjo tezë është antileniniste.

Por Maoja ka parashtruar edhe teza e pikëpamje të tjera, me të cilat ne s'kemi qenë dhe s'jemi dakord. Ai ka shkruar shumë për luftën e klasave, për kontradiktat etj., por lufta e klasave në Kinë, sidomos në praktikë, nuk është bërë e ashpër dhe me konsekuencë. Edhe në këtë drejtim Maoja është treguar liberal dhe moderator. Ai lejonte të merrnin fuqinë dhe të zinin rrënjë të thella në parti, në pushtet e kudo elementë të djath-të revizionistë. Maoja bashkëjetonte me ta, i bënte sehir, shumë herë i aprovonte. Më në fund ai rrëzonte disa krerë të këtyre rrymave, por bazën e tyre e linte të paprekur. Autoriteti i tij i krijuar gjatë luftës dhe pas fitores bënte që fraksionet «të dështonin», por zgjidhja mbetej në mes të rrugës dhe gjendja vazhdonte kurdoherë e moderuar, liberale. Mao Ce Duni ishte një centrist, ai mbante afër njerëz të rrymave të ndryshme që quheshin marksistë, por që nuk ishin të tillë dhe luftonin në

vijën e tyre, nën ombrellën e Mao Ce Dunit. Kur këta e prishnin ekuilibrin, Mao Ce Duni ndërhynte dhe «vinte rregull».

Në mendimet dhe në veprimet e Maos kishte paqëndrueshmëri, dhe unë mendoj se interpretimi dhe zbatimi i marksizmit nga ana e tij është bërë disi në mënyrë fantaziste, si t'i pëlqente atij. Kjo, natyrisht, «shpjegohej» e «justifikohet» me «kushtet e Kinës».

Maoja, edhe shumë vjet pas çlirimit, nuk i përmbysi bazat e klasave të pasura e shfrytëzuese kapitaliste si në qytete, ashtu edhe në fshatra dhe nuk i likuidoi privilegjet e tyre, duke pretenduar se «kjo ishte një taktikë derisa të stabilizonte gjendjen». Por kjo «taktikë» nuk duhej kthyer në teori dhe në strategji, sipas së cilës kapitalistët «të integrohen në socializëm», të marrin dividende dhe kjo gjë të vazhdojë me dhjetëra vjet, siç po ngjet akoma në Kinë. Këta kapitalistë na janë kthyer në «komunistë» dhe janë bërë një pjesë e «borgjezisë në parti», për të cilën flet Maoja.

Edhe Partia Komuniste e Kinës nuk i ka të qarta parimet bazë të teorisë marksiste-leniniste; përkundrazi, i ka zëvendësuar me idetë eklektike të Maos. «Borgjezia është në parti dhe ju nuk po e shikoni», — thotë Maoja. Dhe kjo është e vërtetë. Mirëpo kush e ka lejuar këtë borgjezi të rrojë këmbëkryq në parti? Këtë e ka lejuar vetë Maoja me idetë e tij, e ka lejuar mungesa e një ndërtimi të drejtë organizativo-politik dhe ideologjik marksist-leninist të partisë. Maoja lejoi lulëzimin e shumë vijave, të oportunizmit, të praktikizmit dhe të liberalizmit.

Në «kthesat» e Partisë Komuniste të Kinës, Mao Ce Duni nuk është mbështetur te partia, por tek ushtria, tek inteligjencia dhe te studentët. Në këto «kthesa» punëtorja dhe fshatarësia ose kanë qenë në dorë të kundërrivolucionarëve, ose kanë qëndruar mënjane.

Shtrohet pyetja: Pse Maoja nuk u bënte thirrje në

momente të vështira partisë, klasës punëtore dhe fshata-rësisë? Sepse ato forca ose nuk do t'i bindeshin, ose ai nuk i llogariste, se do të derdhej gjak. Në një kohë kur Maoja bërtiste: «Pushteti lind nga gryka e pushkës», reaksioni po e rrëmbente këtë pushtet.

Revolucionin Kulturor, thonë se e shpërtheu dhe e udhëhoqi Maoja, i cili ngriti miliona hunveibinë me pa-rullën: «Sulmoni shtabet!». Kurse ushtria dhe Lin Biaoja, thonë, lidhën duart. Mirëpo faktet flasin krejt ndryshe. Lin Biaoja ishte në krye të revolucionit bashkë me Maon, Kan Shenin, Çen Po Tanë, Çian Çinin, Jao Ven Juanin, Çan Çun Çiaon e të tjerë. Sipas të dhënave që kemi, Lin Biaoja dy milionë ushtarë i veshi civilë. Me këta «gardistë të kuq» ai sulmoi shtabet dhe i theu, kurse meritat, të gjitha, i mori Maoja. Ky shpëtoi Çu En Lain e shumë të tjerë dhe Ten Hsiao Pinin e konservoï në vilë.

Mirëpo Çuja manovroi shumë mirë dhe një mëngjes Lin Biaoja na u bë «tradhtar, agjent i sovjetikëve dhe komplotist kundër jetës së Maos». Dhe, gjoja për t'i vër-tetuar këto, u tha se Lin Biaoja mori një avion, me të cilin u arratis në Mongoli, ku «avioni u dogj». Të gjithë ata që ishin brenda, u vranë. Thuhet se Çuja dhe Maoja genë vënë në dijeni, por Maoja paska thënë: «Le të ikë!» Gjëra të çuditshme!

Pra, Lin Biaoja, si element i rrezikshëm për Çunë, u likuidua. Bashkë me të, pësoi të njëjtin fat edhe Çen Po Taja. Po Revolucionin Kulturor si ta likuidonte? Kjo ishte e zorshme për Çunë, se prekej Maoja, prandaj për të vazhdoi të flitej si më parë. Kan Sheni u plak e u sëmur rëndë, por mbetën të tjerët, të rinjtë, si Çian Çini dhe Van Hun Veni me shokë. Këta e filluan dhe e vazhduan revolucionin, por, natyrisht, aq sa i lejonte «kryetari». Maoja i ndau rolet. Të majtëve u la në dorë shtypin dhe radion, kurse të djathtëve, me Çu En Lain, u la pushtetin, ekonominë, ushtrinë dhe sigurimin. Nga kjo kuptohet

qartë se si e shikonte revolucionin dhe ndërtimin e socializmit «timonieri i madh».

Maoja dhe Çuja ndërtuan edhe politikën e jashtme. Politika e jashtme kineze e Maos dhe e Çu En Lait ka genë e mbeti një politikë jomarksiste, jorevolucionare, ajo është një politikë fluide, që merr formë nga koniun-kturat politike ndërkombëtare dhe zë pozita të rrezikshme për socializmin dhe revolucionin.

Gjatë kësaj kohe Çuja punonte për të lënë zëvendësin e tij dhe tok me Maon nxorën në skenë «Hrushovin numër dy» të Kinës, të cilin e bënë zëvendëskryeministër të parë, zëvendëskryetar të partisë etj. Tre vjet me radhë, sa ishte sëmurë e derisa vdiq Çu En Lai, Teni mori forca. Mirëpo, siç duket, të majtët ua vunë këmbët në një këpucë «timonierit» dhe Tenit. Këtij të fundit i ngritën këmbët dhe filloi demaskimi i tij. «Timonieri» atëherë manovroi «me gjenialitet» dhe, sipas zakonit të tij të dozimit të korrenteve, sa ishte gjallë, solli në fuqi Hua Kuo Fenin, njeri deri tash i panjohur, udhëheqës i siguri-mit të shtetit dhe i moderuar me fjalë, por i djathtë me vepra.

Maoja vdiq dhe në Kinë ndodhi tragjedia e madhe. Sapo kishte mbyllur sytë «timonieri», e djathta, me Hua Kuo Fenin në krye, bëri puçin dhe qëroi Çian Çinin, Van Hun Venin, Çan Çun Çiaon dhe Jao Ven Juanin. Këta të katër u arrestuan. Sot të djathtët, duke përdorur fjalët e Maos, po vrasin, po burgosin të majtët e revolu-cionarët, po rehabilitojnë të djathtët e dënuar dhe ku-ndërrevolucionarët.

Nuk mund të imagjinohet kurrë se si fjalët e një «revolucionari marksist-leninist» mund të shërbejnë edhe në dobi të kundërrevolucionarëve, siç po ngjet në Kinë me të thënat e Maos!

Ç'nuk po thotë për Kinën shtypi borgjez kapitalist! Se radikalët me Çian Çinin në krye «komplotuan», se

gjoja nipi i Maos e kishte kthyer trupin e Maos të sëmurë nga ana e majtë, kundër këshillave të doktorëve etj., etj., dhe me këtë, gjoja, duan të vërtetojnë se «këta komplotistë vranë edhe Maon». «Lin Biaoja u orvat të vriste Maon tri herë», u trumbetua disa vjet përpara, kurse tash po trumbetohet se «komplotistët e vranë Maon dhe se donin të vritnin edhe Hua Kuo Fenin». Por komplotistët e vërtetë janë njerëzit e Çu En Lait, të Li Hsien Nienit, të Ten Hsiao Pinit, të Hua Kuo Fenit e të tjerë.

Asgjë nuk po botojnë zyrtarisht këta komplotistë, por po përgatitin dalngadalë masat që ta hanë këtë trillim tragjik. **Reaksioni kinez, i veshur me maska, hiqet si «revolucionar dhe marksist-leninist» dhe nën këtë maskë po grin revolucionarët dhe komunistët. Hrushovianët e Kinës po vrapojnë me nxitim të forcojnë pozitën.** Ata përpiqen të forcojnë pozitën me terror dhe me siguri do të arrijnë në atë që jo vetëm nuk do ta citojnë më Maon, por edhe ato që ky ka lënë me ndonjëfarë vlere, do t'i shkelin me këmbë. Me transformimin e Kinës në një vend kapitalist do të ngrihet figura e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait, e Pen Çenit, e Ten Hsiao Pinit e të tjerë.

E MËRKURË

13 TETOR 1976*

KAOS I MADH NË KINË

Kaos i madh në Kinë. Ka dy-tri ditë që agjencitë perëndimore dhe revizioniste të lajmeve thonë se në Kinë është bërë një grusht shteti dhe kanë ardhur në fuqi «të moderuarit», siç i quajnë Hua Kuo Fenin dhe shokët e tij, me të cilët është dukur edhe Li Hsien Nieni. «Të moderuarit» për ne janë partizanët e Çu En Lait, janë ata revizionistë që ideologjinë marksiste-leniniste e kanë shkelur gati në të gjitha çështjet, duke u maskuar me një demagogji shurdhuese. Ata kanë zbatuar dhe po zbatojnë një politikë shoviniste të shtetit të madh, ndjekin një politikë të jashtme proamerikane. Kjo politikë që ka ndjekur Çu En Lai, ishte njëkohësisht edhe politika e Maos.

Nuk mund të ndahet Maoja nga Çu En Lai. Ata kanë vepruar së toku. Të dy ishin liberalë dhe përpiqeshin që, nën maskën e marksizëm-leninizmit, të krijonin një fuqi të madhe dhe të bënin një «politikë të madhe» në arenën ndërkombëtare, të përshtatshme me madhësinë e Kinës. Me fjalë të tjera, ata synonin që **Kina të bëhej një forcë ndërmjetëse që të balanconte peshën e dy superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik.**

Siç kam shkruar edhe në shënime të tjera të këtij ditari, Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë udhëheqja kineze e partisë dhe e shtetit, e cila kurdoherë ka luftuar nën flamurin e Mao Ce Dunit, kanë qenë kundër

Stalinit, kundër Bashkimit Sovjetik leninist, kundër Partisë Bolshevike dhe kundër Kominternit, por të gjitha këto qëndrime të tyre i mbanin të maskuara. Më vonë, pas vdekjes së Stalinit, këto qëndrime dhe pikëpamje që i ushqenin dolën në shesh. Udhëheqja kineze kishte për qëllim që të ndihmonte Hrushovin dhe hrushovianët për t'u mëkëmbur pas grushtit të shtetit që bënë ata në Bashkimin Sovjetik për të rrëzuar idetë e marksizëm-leninizmit. Qëllimi i Mao Ce Dunit, i Çu En Lait e i të tjerëve ishte njëkohësisht që, me ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Kina të bëhej një fuqi e madhe dhe Mao Ce Duni të zinte vendin pas Leninit, domethënë të hynte në radhën e klasikëve të mëdhenj të cilët, sipas tyre, ishin Marksi, Engelsi, Lenini, Mao Ce Duni. Për këtë gjë, natyrisht, ai duhej ta përkëdhelte Hrushovin dhe ta ndihmonte. Këtë e bëri jo vetëm fshehtëzi, por edhe haptazi; jo vetëm nëpër kuluare, por edhe përpara mbledhjeve ndërkombëtare të partive komuniste dhe punëtorë, ku asistonim edhe ne. Në dëgjuam me veshët tanë çfarë tha Mao Ce Duni për veprimet e Hrushovit. Vetëm mburrje.

Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e ngjarjeve, nuk ndodhi ashtu si mendonte Mao Ce Duni. Hrushovi ishte me të vërtetë një kloun, antimarksist dhe intrigant i madh, por nuk ishte aq budalla sa ta fuste Bashkimin Sovjetik nën sjetullat, nën krahët e Kinës dhe të Mao Ce Dunit. Përkundrazi, ai donte dhe punoi që Bashkimi Sovjetik të bëhej një fuqi imperialiste me një potencial të madh luftarak dhe të kthehej kështu në një partner të fortë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me të cilat të ndanin botën e ta shfrytëzonin për interesat e tyre.

Pra, me gjithë përpjekjet që bënë, Mao Ce Dunit dhe Çu En Lait nuk u doli ëndrra. Të dy ëndërruan, me një fjalë, me sy hapur. Atëherë, siç e kam shpjeguar edhe herë të tjera, ata bënë një kthesë. 180 gradëshe, kthyen

«bateritë e topave» kundër Bashkimit Sovjetik revizionist, gjë që na interesonte edhe neve, por njëkohësisht ata kthyen fytyrën nga imperializmi amerikan dhe i ndërën dorën presidentit fashist, Niksonit. Pra ëndrra tjetër e Mao Ce Dunit dhe e Çu En Lait ishte që, në bashkëpunim të ngushtë me imperializmin amerikan dhe duke u mbështetur te ky, Kina të bëhej një fuqi e madhe social-imperialiste.

Nuk do të zgjatem në lidhje me çështjen e **Revolucionit Kulturor etj., etj.**, sepse kam folur shumë në shënimet e mia, vetëm dua të them se një gjë është e sigurt: **Mao Ce Duni dhe Çu En Lai janë ata që kanë kurdisur planin e likuidimit të Lin Biaos, të Çen Po Tasë e të tjerë.** Ne dyshuam shumë në fillim për këtë veprim të papritur të Lin Biaos, që Mao Ce Duni, Çu En Lai dhe gjithë propaganda kineze e paraqitën tradhtar, sikur Lin Biaoja ka dashur të bënte komplot për të zhdukur Mao Ce Dunit dhe për t'i zënë këtij vendin. Por, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e ngjarjeve aktuale, ne shohim se komplotet në Kinën e Mao Ce Dunit janë një praktikë e zakonshme, gjë që do të thotë se puna e Partisë Komuniste të Kinës rezulton të jetë shumë e dobët dhe jo në binarët e marksizëm-leninizmit. **Në propagandën e kësaj partie ka plot fjalë të tilla, si: «revolucionarë», «marksiste-leniniste», «proletariat» etj., por, në fakt, shohim se Mao Ce Duni, i cili hiqej si «marksist-leninist i madh», jo vetëm që nuk rezulton të jetë i tillë, por ai është shkaktari i gjithë këtyre fenomeneve negative, që kanë ngjarë dhe po ngjasin në Kinë.**

Ngjarjet në lidhje me Liu Shao Çinë, Lin Biaon, Ten Hsiao Pinin e tash grushti i fundit që ndodhi në Kinë, janë rezultat i një vije liberale oportuniste jomarksiste të Mao Ce Dunit. Ky ka lejuar dobësi të theksuara në vijën organizative dhe politike të Partisë; ka lejuar të lulëzojnë në parti e në popull dy e më shumë vija; ka bërë

gjoja së fundi luftë kundër Konfucit. Por, duke pasur një vijë të shtrembër parimore për çështjet bazë të diktaturës së proletariatit, lufta e klasave, qoftë kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, qoftë kundër mbeturinave mikroborgjeze, fesë etj., etj. në Kinë ka qenë inekzistuese, ose është bërë me fushata për të rrëzuar njërin e për të ngritur tjetrin, për të rrëzuar e rirëzuar njërin e për të ngritur a ringritur tjetrin.

Liu Shao Çinë dhe Ten Hsiao Pinin, që kishin gabuar shumë herë në jetën e tyre, Maoja i mbajti përkatësisht nënkryetar dhe sekretar të përgjithshëm të partisë, derisa në kohën më të zjarrtë të Revolucionit Kulturor, i cilësoi «Hrushovi numër një» e «Hrushovi numër dy i Kinës». «Hrushovi numër dy», Ten Hsiao Pini, u thirr nga Mao Ce Duni e u ngrit prapë në të gjitha funksionet që kishte, bile u bë nënkryetar i Partisë (natyrisht me bekimin, të mos themi me sugjerimin, e Çu En Lait). Ndoshta këtë «fat të lumtur» do të kishte dhe Liu Shao Çia, po të mos kishte vdekur. (Por edhe pas vdekjes, ndoshta, miqtë e tij nuk do ta harrojnë.) Këto ngjitje e zbritje të armiqve në poste të larta shtetërore e partie, si dhe shumë akte të tjera të shëmtuara, nuk janë veprime marksiste-leniniste.

Të mos zgjatemi, agjencitë e huaja të lajmeve ka dy-tri ditë që flasin se Hua Kuo Feni ka marrë fuqinë në Kinë. Hua Kuo Feni, i cili ishte udhëheqësi i sigurimit të shtetit dhe ministër i Brendshëm, zëvendësoi Ten Hsiao Pinin. Ky i fundit ishte dënua nga Revolucioni Kulturor. Sipas udhëheqësve kinezë, çdo gjë që ka bërë Revolucioni Kulturor është «e drejtë» dhe mbrohej me pasion nga Mao Ce Duni e nga gjithë adeptët e tij. Është e vërtetë se ky Revolucion Kulturor kishte edhe njerëz që, duke ruajtur flamurin e Maos, thoshin se dëshironin të forconin pozitën komuniste të Kinës. Mirëpo në këtë revolucion kishte edhe armiq të fortë dhe të shumtë, që, siç e kam shkruar shumë herë në këtë ditar,

grumbulloheshin rreth Çu En Lait. Ky u bashkua fort me Maon dhe intrigoj tek ai. Maos i nevojitej Çu En Lai. Kjo do të thotë se Mao Ce Duni kurdoherë mendonte dhe vazhdonte të bënte një politikë të balancimit dhe një nga këta që mund ta bënte këtë politikë balancimi, derisa Mao Ce Duni të ishte gjallë, ishte Çu En Lai. Ky i adaptohej Maos, se i kuptonte fare mirë psikologjinë dhe pikëpamjet e tij jomarksiste. Çuja diti të grumbullojë rreth vetes dhe të vërë në pozita kyç në pushtet, në ushtri, në parti, deri në komitetin qendror, elementë antimarksistë, njerëz që, në momentin e përshtatshëm, të merrnin fuqinë në dorë dhe të likuidonin elementët e shëndoshë. Për këtë qëllim Mao Ce Duni dhe Çu En Lai rehabilituan gati të gjithë ata elementë që gjoja qenë persekutuar. Në të vërtetë, këtu nuk është fjala për njerëz të persekutuar, por për ata që qenë dënua.

Çu En Lai, që me siguri kishte dijeni të plotë për sëmundjen e tij të kancerit, e përgatiti për tre vjet rresht Ten Hsiao Pinin, që do ta zëvendësonte dhe, kur pluhuri i Çusë u shpërnda në të gjithë Kinën, Ten Hsiao Pini mbajti *De profundis*-in e Çu En Lait. Mirëpo ky *De profundis* ishte edhe i veti. Teni nuk u bë dot kryeministër, se u skartua dhe u demaskua si revizionist dhe armik i socializmit etj., etj. Filloi kështu një fushatë e rreptë kundër tij, fushatë e drejtë, por vetëm me shtyp, me radio, me propagandë dhe me emrin e me flamurin e Mao Ce Dunit. Siç duket, Çian Çini, Jao Ven Juani, Van Hun Veni dhe Çan Çun Çiaoja kishin në dorë vetëm shtypin. Kur filloi kjo fushatë, Mao Ce Duni ishte akoma gjallë dhe mendohej se këta të katër kishin edhe mbështetjen e tij.

Por e kishin vallë këta katër elementë atë fuqi në popull, në parti dhe në ushtri për ta vazhduar në praktikë Revolucionin Kulturor, për të spastruar, me fjalë të tjera, radhët e partisë, të pushtetit dhe të ushtrisë nga

elementët e reaksionit, të cilët vepronin të maskuar nën petkun e komunistëve, nga njerëzit e Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit, Çu En Lait dhe të Pen Çenit? Bindja jonë ka qenë se ata të katër nuk e kishin këtë fuqi. **Këta ishin kuadro të rinj me vullnet, por tepër të papjekur, kurse ujqit e vjetër në Partinë Komuniste të Kinës kishin hedhur rrënjë të thella dhe këto rrënjë ishin ushqyer nga ideologjia jomarksiste-leniniste e Mao Ce Dunit, i cili mendonte se, në mos ai, mendimet e tij, do të rronin me shekuj.**

Pra, këta katër udhëheqës bënë vetëm propagandë. Ten Hsiao Pini e eliminuan nga udhëheqja, mirëpo Mao Ce Duni, që akoma ishte gjallë, këshillonte palët në konflikt të ecnin «urtë e butë e plot tigani», «të mos ziheshin me njëri-tjetrin», «të merreshin vesh me njëri-tjetrin» dhe «të linin grindjet». Të gjitha këto parulla ishin të çuditshme, jorevolucionare dhe lëshoheshin nga një njeri që hiqej si «marksist-leninist i madh». Mao Ce Duni e quante veten marksist, por ai ishte një «marksist» me pikëpamje mikroborgjeze. Derisa ai mendonte, shkruante dhe vepronte duke vënë fshatarësinë si «faktorin kyç të revolucionit», të cilin nuk mungonte ta quante «proletar», në pikëpamjet e tij ideologjike dhe politike nuk mund të pasqyroheshin veçse tiparet mikroborgjeze të fshatarësisë, siç janë lëkundjet e saj djathtas e majtas. Pra, Maoja bashkohej herë me një grup ose me një shtet dhe herë me një tjetër. Të nesërmen braktiste këta dhe bashkohej me të tjerë. Nën ombrellën e Maos rronin dhe vepronin të gjithë: borgjezë, kapitalistë, proletarë, dhe Maoja ishte i kënaqur për popullaritetin e tij. Ai përdorte në thëniet dhe në shkrimet e tij edhe ide e citate të Marksit e të Leninit, por këto ishin fasadë. Idetë e Marksit dhe të Leninit të shprehura në shkrimet e Maos, po të studiohen me kujdes, do të vërehet se janë redaktuar sikur i ka pjellë ky nga koka e tij.

Maoja predikonte pajtimin, por, nga ana tjetër, bërtiste: «Çfarë kërkonte? Nuk e shikoni se armiku është brenda në parti?». Por ky armik brenda në parti duhej goditur për vdekje. A e bëri Maoja këtë? Jo, ai nuk veproi kështu. Këtë frazë vetëm sa e thoshte, se në praktikë ai zbatonte parullat: «Mos u grindni», «pajtohuni», «mos bëni komplete» dhe, nga ana tjetër, thoshte: «Jini kundër revizionizmit», «jini pro marksizmit»! Pra që të gjithë në Kinë, marksistë e antimarksistë, përdornin këto fraza të Mao Ce Dunit. **Ky, me siguri, nuk lejoi që elementët e shëndoshë të merrnin fuqinë dhe ta vendosnin Kinën në binarë të drejtë.**

Në këtë kaos të madh, ne e kemi të vështirë të afirmojmë, por nga sa kemi parë se çfarë ndodhi dhe si ndodhi në Kinë, mund të themi se elementët e rinj dukeshin më përparimtarë nga grupi i Çu En Lait. Kështu që Mao Ce Duni «për të pajtuar» njerëzit dhe duke e parë veten mjaft të sëmurë e afër vdekjes, para se të shkonte «te zoti», siç i kishte thënë Edgar Snout, gjeti «zgjidhjen e përshtatshme», vuri Hua Kuo Fenin në krye të punëve. Kush ishte ky Hua Kuo Feni? Njeri pa autoritet të madh dhe i panjohur. **Mirëpo atë e njihte Mao Ce Duni dhe e pranonte krahu i djathtë që kishte shpresa te ky njeri, se të paktën ky do të ishte i moderuar. Dhe ky erdhi në udhëheqjen e lartë pa u zgjedhur. Pas vdekjes së Çu En Lait ai u bë kryeministër dhe zëvendëskryetar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Kjo do të thoshte se, pas vdekjes së Maos, do të ishte, sigurisht, ky që do të bëhej kryetar i partisë.**

Nuk kaluan shumë kohë nga këto operacione të alambikuara dhe Mao Ce Duni vdiq. U mbajt zi, u vunë nëpër krahë shirita dhe nuk kaluan as dy-tri javë, ose e shumta një muaj (hajde llogariti këto gjëra), dhe plasi kaosi i madh në Kinë, plasi ajo që parashikonim.

Çfarë parashikonim ne? Ne parashikonim që të dy

korrentet e dukshme do të ndesheshin me njëri-tjetrin se kush e kush të merrte fuqinë (dhe mendonim kështu se fuqinë e kishin në dorë të djathtët, partizanët e Çu En Lait, për arsytet që tregova më lart, kurse kundërshtarët e tyre kishin në dorë vetëm shtypin dhe propagandën, prandaj, në rast se vihej çështja se kush do të merrte fuqinë, këtë do ta merrnin elementët jorevolucionarë), por mendonim, gjithashtu, se mund të zgjatej ca «mbretëria» e Mao Ce Dunit. Por ky, Hua Kuo Feni, që mbante në dorë zigarenë, nuk ishte Mao Ce Dun. Huaja ishte larg autoritetit që kishte krijuar Maoja në Kinë dhe në botë. Hua Kuo Feni e tregoi fytyrën çfarë ishte. Para tri ditësh agjencitë e huaja të lajmeve kanë njoftuar se një mëngjes ai arrestoi në shtëpitë e tyre Çian Çinin, Jao Ven Juanin, Van Hun Venin dhe Çan Çun Çiaon, domethënë gjithë elementët kryesorë të krahut të majtë, të cilët ata i quajnë «radikalë». Fuqinë e morën në dorë Hua Kuo Feni me Li Hsien Nienin, ish-dora e djathtë e Çu En Lait. Gjithashtu ka zëra se Ten Hsiao Pini u soll në Pekin dhe, në qoftë se hëpërhë nuk bëhet zëvendëskryeministër, prapëseprapë rruga që po merr Kina duhet ta sjellë medoemos Ten Hsiao Pinin në një post me rëndësi, mundet dhe sekretar të përgjithshëm të partisë, detyrë, të cilën ai e ka kryer që në kohën e Liu Shao Çisë e të Mao Ce Dunit dhe ka pasur eksperiencë.

Pra, aktualisht Kina rron në momente të vështira dhe jo vetëm Kina. Në rast se të gjitha ato që thonë agjencitë e huaja për Kinën janë të vërteta, kjo do t'u shkaktojë një dëm kolosal revolucionit botëror dhe socializmit. Vetë Kina do të ecë drejt rrugës së fuqisë së madhe socialimperialiste. Ajo do të mbështetet aktualisht te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por nuk është çudi që, më vonë, ajo do të bëjë po atë politikë që po bën Titoja, domethënë, për t'ia arritur këtij objektiv, t'i nderë dorën edhe Bashkimit Sovjetik. Kjo, gjitha-

shtu, është një fitore për Bashkimin Sovjetik, pavarësisht se Kina tani bën një propagandë «shurdhuese» kundër revizionizmit modern hrushovian. Këtë propagandë nesër dalngadalë ajo mund ta ulë. Duke u bërë Kina një fuqi e pavarur, me një industri të madhe, që po rritet me teknologjinë amerikane, me një sasi bombash atomike inferiore nga ato të Bashkimit Sovjetik, por me një ushtri të madhe numerikisht dërrmuese në krahasim me atë të Bashkimit Sovjetik, ka të ngjarë, dhe mendoj se kështu mund të ndodhë, që në botë të krijohen tri superfuqi dhe që të tria do të dëshirojnë të kenë zonat e tyre të influencës. Kontradiktat, natyrisht, do të shtohen midis tyre, do të vijë një kohë që ato të acarohen dhe ne do të asistojmë në këtë acarim, i cili mund të çojë edhe në një luftë tjetër botërore.

Ç'do të bëjë tani populli kinez? Do të ngrihet vallë, apo do të pranojë me apati përrallat e Hua Kuo Fenit e të Mao Ce Dunit? Do të jetë ai dakord me eliminimet që po bëhen në Partinë Komuniste të Kinës? Do ta pranojë Shangai, nga i cili kanë dalë gjithë këta elementë, këtë gjendje, që Hua Kuo Feni, Ten Hsiao Pini dhe Li Hsien Nieni me shokë të dominojnë në Pekin, të bëjnë ligjin në Kinë dhe ta çojnë këtë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose drejt Bashkimit Sovjetik? Ky është një problem që duhet ta vëzhgojmë.

Vallë ka mundësi që në Kinë të ngjasin turbullira? Ka mundësi. Në Bashkimin Sovjetik Nikita Hrushovi veproi më me prurë, nuk i precipitoi në këtë mënyrë punët. Pas vdekjes së Stalinit kaluan disa vjet dhe veprimtarinë e tij kundërrevolucionare ai e ndërmoi në mënyrë «të butë», shkarazi, u mori krahët armiqve të tij, përgatiti opinionin e brendshëm dhe të jashtëm dhe, më në fund, spastroi ata elementë gjoja progresistë, por që nuk u treguan as progresistë, as drejt. Sidoqoftë Hrushovi e spastroi rrugën jo brenda një muaji, siç po bën Hua

Kuo Feni. Populli sovjetik u përgatit me një demagogji të madhe për atë kthesë regresive që do të ndodhte, dhe ngjarjet që u zhvilluan, ai i quajti si gjëra normale, që bëheshin «brenda normave leniniste të partisë». Ai nuk e pa të vërtetën, sepse nuk e lanë ta shikonte atë. Kurse klika e djathtë revizioniste në Kinë po vepron me shpejtësi, me ngut, kështu që një veprimtari e tillë ka mundësi që të krijojë reaksion në popull. Populli kinez u ngrit në Revolucionin Kulturor, natyrisht, sepse i bëri thirrje Maoja, por, në fakt, u ngrit dhe goditi. **Po të mos e kishte frenuar Maoja, ky revolucion do t'i kishte spastruar të gjitha këto qelbësira që tash vijnë në fuqi.** Populli kinez përsëri mund ta bëjë një gjë të tillë. Sa do ta bëjë, kjo nuk dihet dhe a do ta bëjë, as këtë nuk mund ta themi me siguri, se popullin kinez e kanë fanatizuar me emrin e Mao Ce Dunit.

Sipas agjencive të huaja të lajmeve, të gjithë thonë se elementët e krahut të djathtë, me Hua Kuo Fenin në krye, **pretendojnë se kanë shtypur një «grusht shteti» të kryesuar nga Çian Çini, Jao Ven Juani e të tjerë. Ky është një bluf.** Sipas agjencive të huaja, Hua Kuo Feni ka deklaruar se këtë «grusht shteti», «katërshtja» e përgatiti «duke shtrembëruar mendimet e Mao Ce Dunit». Kjo do të thotë se «gjithë propagandën kundër Ten Hsiao Pinit, pro diktaturës së proletariatit etj., etj., e ka shtrembëruar ky grup komplotistësh». Janë, pra, këta, sipas Hua Kuo Fenit, që «kanë shtrembëruar idetë e Mao Ce Dunit». Hua Kuo Feni do ta propagandojë në popull citatin e Mao Ce Dunit: «Mos komplotoni!». Po kush komplotoi? «Çian Çini me shokë», — do të thonë Hua Kuo Feni, Li Hsien Nieni, Ten Hsiao Pini e të tjerë, të cilët duan të paraqiten sikur po shpëtojnë Kinën nga të tillë «elementë reaksionarë», që shkelin idetë e Mao Ce Dunit, flamurin e të cilit po e tundin fort, se kështu ua do puna.

Në qoftë se populli kinez do ta hajë këtë manovër,

atëherë në Kinë nuk do të ketë kryengritje. Po nuk e hëngri, populli do të ngrihet dhe atëherë do të ketë luftë civile. Në Revolucionin Kulturor u përleshën edhe populli, edhe punëtorë, pavarësisht me cilin grup ishin. Edhe në ushtri qëlluan me top e me mitraloz njëri-tjetrin dhe janë vrarë njerëz. Gjë më shumë nuk dimë. Të shohim më vonë.

Por një gjë mund të themi me siguri: kjo që ndodhi në Kinë është një katastrofë për të dhe një dëm i palllogaritshëm për revolucionin botëror, për komunizmin. Imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare fërkojnë duart. Kjo katastrofë është një vepër e tyre. Ata që sollën një situatë të tillë në Kinë, janë bashkëpunëtorë të tyre, siç ishin dhe siç janë bashkëpunëtorë të tyre edhe Hrushovi, Brezhnjevi, Suslovi, si dhe gjithë banda revizioniste e Titos dhe e një sërë kundërrevolucionarësh e lakinjsh të tyre në botë.

Për sa na përket neve, shqiptarëve, natyrisht ne e kemi të qartë se situata e krijuar në Kinë nuk na sjell të mira, po vështirësi. Këtë situatë ne e kishim parashikuar me kohë, që më 1960, kur udhëheqësit kinezë gjoja na mbrojtën kundër hrushovianëve. Ne e pamë se ata ishin të lëkundshëm dhe në të vërtetë nuk na mbrojtën kurrë. Ata, me Çu En Lain në krye, u përpoqën që sovjetikët të shuanin polemikën kundër nesh dhe të mbyllej kjo çështje. Mirëpo Hrushovi, si një *potentat*¹, nuk pranonte të përulej përpara shqiptarëve. Ai nuk e pranoi këtë teze të Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit. Çu En Lai me Mao Ce Dunin kishin shpresa të mëdha se Hrushovi do t'u jepte bombën atomike dhe do t'i ndihmonte ekonomikisht që Kina të bëhej një fuqi e madhe, prandaj, edhe kur konflikti u hap, ata u përpoqën ta zbutnin. Këto çështje i kam shkruar në ditar dita me ditë gjatë zhvillimit të ngjarjeve dhe nuk janë përfundime që nxjerr tash.

1 Frëngjisht — njeri që merr qëndrim të një autoriteti sovran.

9 Pra kjo situatë ne nuk na gjeti të papërgatitur. Ka disa vjet, dhe veçanërisht gjatë pesëvjeçarit që kaloi, që Çu En Lai ka vepruar kundër nesh. Në çështjet ekonomike ai na ka sabotuar. Këtë sabotim ne e kemi parë konkretisht dhe kemi luftuar kundër tij. Çuja është gjendur në një situatë që nuk kishte çfarë të bënte tjetër veçse të adoptonte metodën e shtyrjes së realizimit të veprave, meqenëse nuk mund të zbatonte atë të prerjes së kredive. Çu En Lai nuk ndoqi taktikën e Hrushovit, që preu përnjëherë urat me ne, por ndoqi këtë taktikë: të mos na dërgonte në kohë makineritë e veprave me rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë sonë, të cilat duhej të kishin mbaruar dy vjet apo dy vjet e gjysmë më parë. Për këtë arsye, ato akoma nuk kanë mbaruar. Kjo jo për shkak se Kina është «e varfër» e përralla të tjera që thonë revizionistët kinezë. Jo, këto qëndrime vinin dhe vijnë nga arsye politike: Çu En Lai me Mao Ce Dunin shikonin që Shqipëria qëndronte në pozitat e veta marksiste-leniniste dhe kishte, siç ka, një politikë të saj të pavarur, për të cilën shprehet haptazi, pa druajtje nga kurrkush, gjë që nuk u pëlqente dhe nuk u pëlqen kinezëve.

Kinezëve nuk u pëlqente, gjithashtu, që Shqipëria e vogël, po mbronte Kinën e madhe në arenën ndërkombëtare. Mundet që vetë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai mbrojtjen e Kinës nga ana jonë e konsideronin si një turp, se, sipas gjykimit të tyre, si mundej që një vend i vogël të mbronte një vend të madh? Sidoqoftë ajo që bëhej nga ne ishte një mbrojtje të cilën ata nuk mund ta mohonin, por atyre nuk u pëlqente një situatë e tillë.

Kohët e fundit u duk qartë se udhëheqësit kinezë na bënë presione të hapëta e të drejtpërdrejta që të shpëtonin Beqir Ballukun dhe Abdyl Këllezin, të cilët ishin bashkëpunëtorë të tyre në komplotin e kurdisur kundër Shqipërisë, për të rrëzuar udhëheqjen tonë. Por ata nuk ia arritën dot qëllimit, prandaj edhe i shkurtuan jashtëza-

könisht ndihmat e tyre ekonomike, gjithashtu edhe ndihmat ushtarake, se tjetër gjë nuk kishin çfarë të na bënin.

Pra, ne jemi të përgatitur në këtë drejtim. Jemi të përgatitur, sepse Partia jonë ka kaluar gjithë këto dallgë dhe është kalitur. Ajo nuk ka frikë se mbetet vetëm. Dhe, në fakt, në këtë rast, ne vetëm mbetemi e bëjmë një politikë unikale marksiste-leniniste, si një parti në fuqi, e cila është në kundërshtim me imperialistët amerikanë, me socialimperialistët sovjetikë, me socialimperialistët kinezë, me borgjezinë reaksionare dhe me djallin e me të birin. Por Shqipëria dhe Partia e Punës qëndrojnë në të patundura e kështu do të qëndrojnë vazhdimisht.

Tashti, ekipi që erdhi në fuqi në Kinë, do ta vazhdojë më hapur armiqësinë kundër nesh? Do të shohim. Ne do të jemi vigjilentë dhe vigjilenca jonë duhet të jetë e madhe. Interesi ynë e do që, edhe duke ndjekur ata metodën e tyre të shtyrjes së realizimit të plotë të këtyre veprave, nga ana jonë ne të mos i ndezim zjarret me ta, por të mbajmë vijën tonë marksiste-leniniste dhe të mos shkelim mbi parimet, pavarësisht se Kina mund të na presë kreditë. Le ta bëjë ajo këtë, ne do të rrojmë me forcat tona, do të punojmë me thonj e me dhëmbë, do të rrojmë, e do të rrojmë më mirë. Ne do të kemi njëkohësisht mbështetjen e gjithë botës përparimtare, të të gjithë marksistë-leninistëve të vërtetë, të gjithë proletariatit dhe të revolucionarëve në botë, të cilët do të shohin se si një vend i vogël i qëndron besnik marksizëm-leninizmit, nuk trembet, por ecën përpara, rron dhe përparon. Kështu do të ngjasë.

Natyrisht, qëndrimi armiqësor i Kinës kundër nesh do t'i kënaqë armiqtë tanë, ata do ta shtojnë veprimtarinë e tyre si jashtë, edhe brenda vendit kundër shtetit dhe Partisë sonë, por ne jemi një forcë e madhe që edhe armiqve të jashtëm do t'u bëjmë ballë me sukses, edhe armiqtë e brendshëm do t'i shtypim. Prandaj duhet të

presim me gjakftohtësi, t'i ndjekim si kurdoherë me vëmendje situatat në botë, veçanërisht të ndjekim situatat në Kinë.

Një herë ne duhet të presim të vërtetohen ose jo ato që thotë shtypi botëror, se asgjë nuk thuhet nga shtypi zyrtar në Kinë. Zaten, kinezët një metodë të tillë ndjekin. Qoftë kur likuiduan Liu Shao Çinë, ashtu edhe kur likuiduan Lin Biao e më vonë Ten Hsiao Pinin etj., etj., u desh një kohë e gjatë sa të flitnin haptazi ku e kishin hallin. Ka shumë mundësi që edhe në këtë rast të ngjasë e njëjta gjë, sepse që nga Çian Çini e deri te Çan Çun Çiaoja, pavarësisht se janë relativisht të rinj, ata janë personalitete. Megjithatë, mendoj se ne duhet të jemi shumë prudentë, të mbrojmë vijën tonë dhe të mos hapim polemikë me kinezët, në qoftë se vërtetohen këto që fliten nga shtypi botëror. **Ne nuk duhet të hapim polemikë për aq kohë sa ta shohim të arsyeshme se nuk po sulmohet publikisht vija jonë marksiste-leniniste, se ndryshe në atë moment bateritë duhet t'i kemi si kurdoherë ngritur.** Por edhe interesin ekonomik duhet ta shikojmë, pavarësisht se kinezët mund t'i ngadalësojnë furnizimet që duhet të na dërgojnë, sipas kontratave të firmuara që ekzistojnë. Ne, pra, duhet të jemi prudentë dhe njëkohësisht vigjilentë, të ndjekim me kujdes se ç'rrugë do të marrin punët në Kinë.

Në Kinë çdo gjë është e papritur. Në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër ngjasin gjithë këto gjëra dhe të tërave u ngjitin etiketën «grusht shteti», «puç», «komplete kundër jetës së Mao Ce Dunit» etj., etj. Nesër mund të vërtetohen ngjarje të tjera, prandaj këtu, brenda vendit tonë, duhet të jemi vigjilentë ndaj specialistëve kinezë. Punonjësve të ambasadës kineze në Tiranë ne do të vazhdojmë t'u flasim sinqerisht për miqësinë e popullit dhe të Partisë sonë me popullin kinez dhe me Partinë Komuniste të Kinës në baza marksiste-leniniste, megjithatë nuk

e dimë çfarë njerëzish janë si funksionarët e ambasadës, ashtu edhe specialistët kinezë që punojnë në vendin tonë.

Nga informatat që kemi rezulton se ambasadori i tyre i sotëm, i cili ka qenë edhe në Moskë, është një nga elementët e kritikuar nga Revolucioni Kulturor. Pra, ky duhet të jetë njeriu i Ten Hsiao Pinit, i Liu Shao Çisë e i Çu En Lait, i djathtë. **Ai nuk ka ardhur te ne për të ndihmuar vendin tonë, por për të sabotuar, për të intriguar, për t'u informuar jo si mik, po në shërbim të të djathtëve që erdhën në fuqi në Kinë. Ai ka ardhur me qëllime jo të mira, prandaj ka mundësi që ai dhe kinezët të fillojnë të futin hundët në punët tona të brendshme.**

Ne nuk mund t'i ndalojmë dot punonjësit e ambasadës kineze që të mos venë në ndërmarrje të ndryshme, ku punojnë specialistë kinezë, për të marrë kontakt me ta. Sidoqoftë, sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, kryeinxhinierët, drejtorët e instituteve, të fabrikave e të kombinateve ku punojnë specialistë kinezë, duhet të jenë vigjilentë, të ruhen, sepse ne e kemi pësuar shumë herë, nga titistët, nga revizionistët sovjetikë e mund ta pësojmë edhe tash nga kinezët.

Interesi i madh i atdheut dhe i Partisë e do që në këto momente të paqëndrueshme e kaotike për Kinën dhe të rrezikshme për revolucionin botëror, veçanërisht për Shqipërinë socialiste, ne të forcojmë situatën brenda në Parti, të forcojmë unitetin e radhëve të saj, të forcojmë unitetin e Partisë me popullin, ta bëjmë më aktive përgatitjen për mbrojtjen e vendit dhe të jemi vigjilentë, të realizojmë me sukses, bile edhe të tejkalojmë planet tona ekonomike. Kjo është detyrë themelore për ruajtjen e pavarësisë, të lirisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë. Të gjithë duhet të mendojmë — dhe këtë duhet t'ua bëjmë të qartë, në një mënyrë ose në një tjetër, Partisë, komunistëve, mbarë popullit — se Shqipëria socialiste është e fortë si brenda, edhe jashtë kufijve të saj. Jashtë,

vendi ynë ka miq të shumtë dhe besnikë. Këta miq janë jo vetëm revolucionarët e përparimtarët, por edhe njerëz që, pavarësisht se janë në kundërshtim me rendin tonë ekonomik-shoqëror, kanë respekt për politikën e Shqipërisë socialiste dhe për kurajën e shtetit tonë.

QË RESPEKTI TË JETË RECIPROK

Më thanë se ambasadori i ri kinez ka kërkuar që të vijë më 16 tetor në shtëpi të më urojë për ditëlindjen dhe, me këtë rast, të më sjellë një shportë me lule. Ky zakon ka qenë praktikuar edhe nga ambasadorë të tjerë të RP të Kinës, por mendova se është më mirë të lihet në heshtje kjo kërkesë. Në rast se ambasada kineze e përsërit kërkesën, porosita t'u thonë që shoku Enver, duke qenë shumë i zënë me punë, këtë vit nuk po e praktikon më pritjen e vizitave me rastin e ditëlindjes.

Mendoj se në këto momente të turbullta dhe pas qëndrimeve kaq përbuzëse ndaj Komitetit tonë Qendror nga ana e udhëheqjes kineze dhe nga ana e vetë Mao Ce Dunit, të cilët nuk u janë përgjigjur asnjë mesazhi që i kemi dërguar dhe as ftesës së Komitetit Qendror për pjesëmarrjen e Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin e Partisë sonë, por vetëm dërguan ambasadorin e tyre që na komunikoi në emër të drejtorisë së jashtme falëmeshëndetet e Komitetit Qendror të Partisë së tyre, më duket se duhet të ruajmë edhe ne autoritetin e Partisë sonë. Kinezëve duhet t'u lëmë të kuptojnë mirë se marrëdhëniet tona me ta duhet të jenë korrekte dhe në barazi të plotë.

KINEZËT PENGOJNË IMPORTIN TONË

Ambasadori ynë në Pekin ka afro dy javë që ka marrë takim me ministrin e Tregtisë së Jashtme të Kinës, Li Çianin, të cilit i kishte kërkuar arsytet përse importi ynë nga Kina për vitin 1975 nuk është realizuar për një vlerë prej 40 milionë juanësh, kurse eksporti ynë i po këtij viti është realizuar plotësisht. Ai i vuri atij në dukje se Kina po na nxjerr shumë pengesa dhe vështirësi në realizimin e planit tonë pesëvjeçar dhe, gjithashtu, se bisedimet tregtare për vitin 1976 as që kanë filluar — dhe në fakt gjatë këtij viti midis Shqipërisë dhe Kinës nuk po bëhet tregti. Ambasadori ynë theksoi se ky veprim nuk është i drejtë dhe me këtë mënyrë ne nuk jemi dot në gjendje të rezervojmë eksportin.

Li Çiani e dëgjoi dhe i tha se «Nuk jam në dijeni (në fakt ai gënjente), po do të informohem dhe do të të thërrres».

Kaluan, pra, dy javë dhe ambasadorin tonë e thirri zëvendësministri i Tregtisë së Jashtme, i cili i tha në emër të Li Çianit:

«Ne kemi gabuar, jemi borxhlinj ndaj jush; prandaj do t'i aktivizojmë tregtinë dhe ndërmarrjet dhe do të përpiqemi që deri në fund të vitit t'ju dërgojmë mallrat, me përjashtim të disa makinave, si traktorë etj. Kjo ka ardhur, i tha ai, për shkak të vijës sonë të gabuar. Për sa u përket kontraktimeve për vitin 1976, këto do t'i

realizojmë nga muaji nëntor ose dhjetor, nëse do ta kemi rregulluar planin tonë» dhe, për ta sheqerosur, i tha se «tratativat do t'i bëjmë më përpara me ju». Këto tha zëvendësministri i Tregtisë së Jashtme kineze. Të gjitha janë profkë dhe gënjeshtër.

Li Çiani është një nga armiqtë kryesorë të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ajo që po bëjnë kinezët kundër nesh është një sabotim, një bllokadë ekonomike. Ky veprim sabotues mbështet hapur komplotin e Beqir Ballukut, Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit dhe Kiço Ngjellës. Ata e bënin këtë për presion kundër nesh, për të varfëruar tregun tonë dhe për të ngadalësuar prodhimin, e bënin që të krijonin pakënaqësi në popull kundër Partisë dhe pushtetit tonë. Por këta sabotatorë dhe komplotistë nuk ia arritën dhe nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit. Mallrat e eksportit tonë janë të tilla që i merr kushdo, prandaj ne nuk na bllokun dot Kina, ashtu siç nuk na bllokuan dot as Bashkimi Sovjetik, as revizionistët e tjerë dhe shtetet kapitaliste. Ne duam të bëjmë tregti me Kinën dhe do të përpiqemi të bëjmë, por në kushte të barabarta dhe jo kështu siç po veprojnë revizionistët kinezë.

E PREMTE

22 TETOR 1976*

KUSARI BËRTET: «KAPENI KUSARIN!»

Hua Kuo Feni mori frenat e partisë në dorë, duke u emëruar edhe kryetar i partisë, edhe kryetar i komisionit ushtarak pranë komitetit qendror. Këtë emërim ia komunikuan ambasadorit tonë. Këto ditë, me siguri, veprimet do të konfirmohen me vendime të Komitetit Qendror.

Hua Kuo Feni erdhi në fuqi me puç ushtarak, të përgatitur që më parë. Çu En Lai ishte arkitekti i komplotit. Ai, pasi qëroi Lin Biaon, tok me Maon dhe me ndihmën e tij, jo vetëm punoi «për të qetësuar» gjendjen, por ndërroi edhe politikën e Kinës. Maoja ishte flamuri, kurse Çuja, në krye të reaksionit, organizoi çdo gjë, që kjo politikë të mbrohej edhe nga të majtët. Çuja i përgatiste këto sa ishte Maoja gjallë, që, pas vdekjes së tij, ai të kishte në dorë të gjitha pozitat kyç, sidomos ushtrinë dhe sigurimin, dhe kësaj ia arriti. Të majtët bënë zhurmë me radio dhe me shtyp, kurse Çuja i la këta të lirë që të lllomotitnin. Ai, me pëlqimin e Maos, rehabilitoi Ten Hsiao Pinin, mikun e tij të vjetër. Çuja e dinte se do të vdiste shpejt dhe me siguri u ka këshilluar bashkëpunëtorëve të vet që, sa të ishte Maoja gjallë, të jenë prudentë dhe, me të vdekur ai, atëherë të merrnin fuqinë.

Kur vdiq Çuja, Maoja ishte akoma gjallë. Rregullisht duhej të bëhej Teni kryeministër, por atë nuk e pranuan të majtët. Atëherë «timonieri i madh» u gjend në dilemë. Ç'të bënte? Thirri Hua Kuo Fenin, shefin e siguri-

mit dhe pjesëtarë të tjerë të komplotit të përgatitur nga e djathta, me Çunë në krye. Po kur Maoja vdiq, atëherë Hua Kuo Feni shkeli sustën e komplotit dhe bëri puçin. Në mënyrë fashiste, ai eliminoi kryesorët e krahut të majtë. Hua Kuo Feni dhe komplotistët bërtitën: «Shtypëm komplotistët, mafian e Shangait», morën në dorë edhe mikrofonin, radion e shtypin dhe filluan fushatën e madhe. Kjo është gjithçka. Kusari bërtet: «Kapeni kusarin!».

Komploti i Beqir Ballukut dhe i Abdyl Këllezit ishte i sinkronizuar me komplotin kinez. Çuja përgatiste që njëkohësisht me ndryshimet në Kinë të ndryshohej situata edhe në Shqipëri, për realizimin më lehtë të planeve të tyre lidhur me lëvizjen punëtore e komuniste dhe me marrëdhëniet tona e ato ndërkombëtare. Por Partia jonë e zbuloi dhe e likuidoi puçin e Beqir Ballukut dhe të Abdyl Këllezit.

E SHTUNË
23 TETOR 1976*

KËSHTU DUHET TË KETË NDODHUR ME «KATËRSHEN»

Duke lexuar me vërejtje një informacion mbi një qarkore të KQ të PK të Kinës, sipas mendimit tim, del se të tëra ato që thonë kinezët, janë profka dhe gënjeshtër.

Në tetor 1974, shkruhet në këtë qarkore, Van Hun Veni paska vajtur te Mao Ce Duni dhe paska «akuzuar» Çu En Lain. Sipas meje, Van Hun Veni ka bërë shumë mirë dhe një gjë e tillë është e lejueshme nga ana e normave të partisë.

Çdo anëtar i komitetit qendror, bile çdo anëtar partie, ka plotësisht të drejtë të shkojë te kryetari ose te sekretari i parë i komitetit qendror të partisë dhe t'i shfaqë atij mendimin e vet për një anëtar të udhëheqjes ose për cilindo komunist, në çfarëdo funksioni që të jetë ky. Ky veprim konsiderohet rregull partie. Në praktikën e përditshme shumë njerëz, anëtarë partie ose persona pa parti, i drejtohen komitetit qendror, kryetarit ose sekretarit të parë të komitetit qendror me letra me firmë ose edhe anonime, duke e informuar atë për konstatime e probleme të ndryshme si edhe për veprimtarinë e atyre njerëzve që bëjnë gabime.

Kështu, një anëtar i udhëheqjes së partisë, siç ishte Van Hun Veni, duke shkuar te kryetari i Komitetit Qendror për të kritikuar veprimet e një anëtari të Byrosë

Politike, nuk mund të konsiderohet se ka bërë ndonjë faj dhe ca më shumë komplot, përkundrazi një gjë e tillë është diçka e rregullt. Vetëm ata që dëshirojnë që veprimtaria e tyre jo e rregullt apo gabimet që kanë të mos u njihen nga udhëheqja mund të mendojnë dhe ta cilësojnë këtë gjë ndryshe. Në mënyrë të veçantë, në rastin e Mao Ce Dunit, i cili qëndronte i mbyllur në zyrë dhe priste që të tjerët t'i vinin dhe t'i shfaqnin mendime për punët dhe për njerëzit, qofshin këto kolektive ose individuale, të veçanta, një veprim si ky që ka bërë Van Hun Veni, ishte krejt normal. **Prandaj akuza që i bëhet Van Hun Venit, është pa baza dhe e dënueshme. Për ne është e qartë se kjo bëhet me ligësi nga ata që e kanë trilluar.**

Si nënkryetar i Komitetit Qendror, Van Hun Veni, siç thashë, kishte plotësisht të drejtë të shkonte te Mao Ce Duni si kryetar i Komitetit Qendror të Partisë dhe t'i shprehte këtij mendimin për një anëtar të Komitetit Qendror. Mirëpo udhëheqësit aktualë kinezë e akuzojnë rëndë Vanin, si «komplotist». Duke e njohur cili ishte Çu En Lai dhe çfarë veprimtarie zhvillonte ai, mendoj se Van Hun Veni ka bërë shumë mirë që ka vajtur dhe i ka folur Mao Ce Dunit për Çunë. **Me këtë na bëhet e qartë se ata që akuzohen tani nga Hua Kuo Feni me shokë, kanë pasur një pikëpamje të njëjtë dhe të drejtë për Çu En Lain, për veprimet, për krimet dhe për intrigat e tij.**

Informacioni nga Pekini nuk thotë gjë, po ka mundësi që Van Hun Veni të ketë shkuar te Maoja për të kritikuar Çu En Lain, pasi është konsultuar me shokët e tjerë për t'i shprehur pikëpamjen e përbashkët për të.

Për ne është e qartë se Van Hun Veni nuk duhet të jetë mjaftuar me kaq. Këtë përçapje lidhur me veprimet në rrugë jo të drejtë marksiste-leniniste nga ana e Çu En Lait, ai e ka bërë edhe zyrtarisht. **Fakti që këtë pro-**

blem ai e shtroi haptazi edhe në Plenumin e 10-të të Asamblesë Legjislativë, siç përmend qarkorja që na është bërë e njohur, vërteton se as Van Hun Veni, as shokët e tij, që po persekutohen tani atje, nuk vepronin aspak si «komplotistë», por, përkundrazi, si të tillë kanë vepruar këta që erdhën në fuqi.

Elementët e së majtës, sipas mendimit tonë, kanë reaguar drejt, por kundërrevolucionarëve nuk u ka ardhur për hosh ndërhyrja e Van Hun Venit, prandaj kanë kundërvepruar. Siç del, Maoja nuk i ka pranuar propozimet e akuzat e elementëve të së majtës dhe, jo vetëm kaq, por, sipas asaj që thuhet në qarkore, Maoja e paska qortuar Van Hun Venin për propozimet e tij, të cilat ia rrëzoi.

Kjo tregon se Mao Ce Duni, së bashku me Çu En Lain e grupin e tij, mbështetnin elementët e djathtë revizionistë dhe reaksionarë, të cilët qëndronin të struktur në aparatet e Partisë dhe të shtetit ose që u rehabilituan prej tyre, si Ten Hsiao Pini. Kundërshtimet e Van Hun Venit, Jao Ven Juanit, Çian Çinit dhe Çan Çun Çiaos, siç del dhe nga analiza e qarkores, kanë qenë plotësisht të justifikueshme.

Në një informacion që vjen nga një burim kinez, thuhet se Çian Çini kishte kohë që e kundërshtonte Çu En Lain në veprimtarinë e tij revizioniste dhe kapitulluese. Jo vetëm kaq, por ajo vinte, gjithashtu, në dijeni Maon për pikëpamjet e saj mbi Çu En Lain dhe një gjë e tillë ishte e drejtë. Por tani na del, sipas qarkores që na bëhet e ditur, se Mao Ce Duni e paska kritikuar Çian Çinin si «ambicioze», se i çante atij kokën duke i servirur «çështje të vogla» dhe jo probleme të mëdha. Nga kjo mund të dalim në konkluzionin se çdo kritikë që bëhej nga të tjerët kundër Çu En Lait, ishte e papranueshme nga ana e Mao Ce Dunit. Maoja e mbronte revizionistin Çu En Lai.

Lind pyetja: Çfarë komploti ka këtu? Nuk paskan të drejtë disa anëtarë të Byrosë Politike të ngrihen dhe të shfaqin haptazi në Komitetin Qendror një mendim, të bëjnë një propozim, makar edhe të kritikojnë një person si Çu En Lain apo cilindo tjetër anëtar të udhëheqjes qoftë? Ne, duke u bazuar në normat e Partisë, nuk shohim asnjë shkelje, përkundrazi konstatojmë dogmatizëm dhe autoritarizëm jomarksist nga vetë Maoja, i cili i kritikon për «dogmatizëm» këta elementë të guximshëm. Komplotistët e marrin si një armë në favor të tyre atë që thotë Maoja, se kundërshtarët e tyre janë «dogmatikë», por i tillë është vetë Mao Ce Duni, i cili i detyronte shokët të vepronin vetëm ashtu si thoshte dhe si vendoste ai.

Më vonë, më 3 shkurt, Çan Çun Çiaoja, — thuhet në qarkore, — paska shkruar një artikull, me të cilin ka kundërshtuar në mënyrë të tërbuar propozimin personal të Maos. Se çfarë propozimi është ky dhe për cilën çështje është fjala, këtë nuk e kemi të qartë; po, sipas pucistëve, edhe në këtë rast duhej prapë t'i mbyllej goja atij që guxonte të kritikonte, se, për gjërat që vendoste Maoja, nuk duhej kritikuar. Mbase këtu bëhet aluzion për sjelljen në udhëheqje të Ten Hsiao Pinit ose të kujtdo tjetër, që qarkorja nuk e përcakton. Ka mundësi që pikërisht për të kritikuar këtë propozim ka botuar artikullin Çan Çun Çiaoja, artikull që, sigurisht, nuk ka qenë i mbështetur në mësimet e Maos etj. Në qarkoren e fundit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës botimi i këtij artikulli konsiderohet krim, mbasi kundërshtohet Maoja.

Ky kundërshtim mundet që kishte të bënte edhe me emërimin e Hua Kuo Fenit në funksionin që kishte menduar Maoja si nënkryetar të partisë dhe kryetar të Këshillit të Shtetit. Kjo do të thotë se të katër shokët e udhëheqjes që u dënuan nuk e kanë pranuar propozimin

e Mao Ce Dunit për caktimin e Hua Kuo Fenit në postet që iu ngarkuan dhe, mbase, për një gjë të tillë, ata kanë shprehur pikëpamjen e tyre publikisht në këtë artikull. Kjo konsiderohet, gjithashtu, nga puçistët si një «komplot», gjë që, natyrisht, nuk mund të pranohet, sepse komploti nuk bëhet në këtë mënyrë.

Një ambasador i Kinës në një shtet perëndimor, pasi i foli ambasadorit tonë për «komplotin e të katërve», duke e informuar gjoja në konfidencë, u shpreh kështu: «Po ta them në intimitet se Çan Çun Çiaoja është agjent i Guomindanit dhe se të katër komplotistët Mao Ce Duni që më përpara i njihite ç'njerëz të këqij ishin, por ai i lejoi vetë që të vinin në Pekin dhe të caktoheshin në Komitetin Qendror, deri edhe në Byronë Politike». Ç'nuk trillojnë për këta të katër! Po dhe çfarë leshkosh janë!! Nuk e kuptojnë se kështu demaskojnë vetë Maon? Apo e bëjnë këtë me qëllim, pikërisht si revizionistë e reaksionarë që janë, të «shkurorëzojnë» Maon për ato që kanë pësuar nga lëkundjet e tij dhe për planet e tyre ultrarevizioniste e reaksionare në të ardhmen. Ec e merrri vesh këto kinezëri!

Veçanërisht Çian Çinin revizionistët puçistë kanë arritur ta cilësojnë «grua të rrugëve» dhe shpërndajnë kundër saj broshura, në të cilat shkruhet me terma aq të ndyrë, sa e quajnë «putanë». Bëhet pyetja: Si mund të qëndronte për 33 vjet me radhë kjo «putanë» grua e Mao Ce Dunit, të lindte fëmijë me të, të zgjidhej anëtare e Komitetit Qendror dhe e Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Kinës? Ku ishin këta «trima» që tani shpifin të tilla monstruozytete, sa as literatura më e ndyrë pornografike e Perëndimit nuk është në gjendje të shkruajë në një mënyrë të tillë? Kuptohet vetvetiu se vetë këta njerëz janë agjentë të imperializmit dhe me anën e Çian Çinit përpiqen të diskreditojnë personalisht Maon, gjoja duke ruajtur flamurin e tij, natyrisht derisa

të kapërcejnë lumin. Edhe ato pak gjëra të mira që ka bërë Maoja për Kinën, revizionistët puçistë po ia njollosin me të tilla veprime.

Më poshtë në qarkore puçistët vazhdojnë të bëjnë akuza të përgjithshme në adresë të elementëve të majtë, sepse këta po punonin për të prishur planet komplotuese të krahut revizionist, me Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin, Hua Kuo Fenin e të tjerë. Këto akuza në seri janë për gjëra fare të kota, të shpifura, për gjëra të rëndomta. Këto, sipas mendimit tim, janë vënë në qarkore nga ana e puçistëve me Hua Kuo Fenin në krye, se ata nuk kanë çfarë akuze tjetër të vënë, që t'i nxjerrin si «komplotistë» udhëheqësit e krahut të majtë. Të gjitha veprimet dhe lufta që po bënin këta kundër reaksionit, u prishte qetësinë revizionistëve, të cilët i mbështeste Maoja. Revizionistët kishin krijuar një bazë të fortë në parti dhe në shtet. Ata kishin në dorë kyçet dhe vendosnin kudo njerëzit e tyre. Në këtë gjendje të favorshme që kishin krijuar për veten e tyre, ata nuk donin që të trazoheshin nga të tjerët. Mirëpo qetësinë atyre ishin duke ua prishur «të majtët» me artikuj dhe me forma të tjera, duke përfshirë edhe një sërë kritikash. Të gjitha këtyre revizionistët u vinin ngjyrën e një «komploti». Komplotin revizionist që këta e kishin përgatitur me kohë vetë, përpiqen t'ua hedhin atyre personaliteteve që po i quajnë radikalë, po që neve, me kaq sa dimë, na duket se ishin në pozita më të shëndosha, me gjithë gabimet e të metat që mund të kenë.

Unë shpreh bindjen se Çu En Lai, i mbështetur nga Maoja, kishte arritur të grumbullonte rreth vetes gjithë revizionistët dhe reaksionin, me një fjalë tërë partizanët e Liu Shao Çi tradhtarit. Ai i futi këta të gjithë me radhë e gradualisht në aparatet e partisë, të shtetit, të ushtrisë dhe kudo. Pasi ia arriti këtij qëllimi, Çu En Lai iu vu punës për të spastruar njërin pas tjetrit gjithë kun-

dërshtarët, prandaj kurdisi në fillim çështjen e Lin Biaos, që ishte kundërshtari kryesor i tij. Me kurthin që ai i ngriti Lin Biaos, e likuidoi këtë. Pas këtij iu vu punës për të likuiduar kundërshtarët e tjerë që kishte nxjerrë Revolucioni Kulturor, me Kan Shenin dhe të tjerë në krye. Por Kan Shenin u sëmur dhe vdiq, ndërsa para Lin Biaos u likuidua Çen Po Taja.

Mbeteshin tani këta të katër, Van Hun Veni, Jao Ven Juani, Çian Çini dhe Çan Çun Çiaoja, të cilët ishte e zorshme për Çu En Lain që t'i eliminonte. Por, si një organizator e komplotist i madh revizionist që ishte, duke pasur mbështetjen e Maos, Çu En Lai arriti të rehabilitonte dhe të sillte përsëri në udhëheqje Ten Hsiao Pinin, të cilin punoi me të madhe ta përgatiste si zëvendës të tij. «Katërshja» do ta ketë kundërshtuar menjëherë rehabilitimin e Ten Hsiao Pin revizionistit, por ngritja e tij do t'i jetë imponuar nga Maoja. Jam i bindur se të katër këta nuk duhet ta kenë pranuar ardhjen e Ten Hsiao Pinin në udhëheqje të partisë dhe të shtetit. Atyre duhet t'u ketë thënë Maoja që të bëhet siç propozonin Çuja me shokë.

Mendoj se Çuja duhet t'i ketë këshilluar bashkëpunëtorët e tij që, sa të ishte Maoja gjallë, të mos vepronin. Mirëpo, pas vdekjes së Çusë, vepruan këta të katër, kështu që, në sajë të rezistencës së këtyre, Teni nuk u emërua dot në vendin e Çusë si kryetar i Këshillit të Shtetit. Lindi kështu nevoja që të zhvillohej më tej Revolucioni Kulturor. Mirëpo Maoja, duke qenë në kundërshtim me këta të katër, thirri Hua Kuo Fenin, të cilin e bëri nënkryetar të partisë, e vuri edhe në krye të qeverisë. Maoja e dinte mirë se Hua Kuo Feni ishte partizan i Çu En Lait. Këtë gjë e dinin mirë, gjithashtu, edhe Van Hun Veni, Çan Çun Çiaoja, Çian Çini dhe Jao Ven Juani, prandaj këta duhet ta kenë kundërshtuar ardhjen e Hua Kuo Fenit në udhëheqje, por sjelljen

e tij si nënkryetar të partisë dhe kryetar të Këshillit të Shtetit ua ka imponuar Maoja.

Pas vdekjes së Maos «katërshja» duhet ta ketë kundërshtuar përsëri ardhjen e Hua Kuo Fenit në krye të partisë dhe të shtetit, por ky kundërshtim është konsideruar «komplot» nga ana e revizionistëve. Duke i cilësuar këta të katër si njerëz «që kanë luftuar kundër partisë, që kanë kundërshtuar Mao Ce Dunin dhe vendimin që mori vetë ai për sjelljen e Hua Kuo Fenit në krye», pa mbledhur as Komitetin Qendror, as Byronë Politike etj., etj., i arrestuan. Mendoj se kështu duhet të jetë realiteti, ndryshe nuk ka si kuptohen ngjarjet që kanë ndodhur.

Duke lexuar informacionin që na erdhi, duket qartë se çfarë shpifjesh dhe akuzash false janë kurditur kundër «katërshes». Tradhtarët revizionistë i akuzojnë ata se «kanë biseduar me dhjetëra herë me njerëz të huaj, kanë mbajtur lidhje me ta», pa i përmendur me emër cilët janë. Këta harrojnë se, duke filluar që nga vetë Maoja e Çu En Lai dhe gjithë pjesëtarët e tjerë të grupit revizionist, janë takuar e kanë biseduar kushedi sa herë me të huaj të kalibrave të tillë si Kisingerët, Niksonët, me derrin dhe me dosën, me ditë dhe me net të tëra. Dhe, që të mos i akuzojnë për këto takime që i dinte gjithë bota, revizionistët akuzojnë «katërshen» se paskan biseduar me njerëz të huaj! Me këtë ata duan të thonë se këta të katër «ishin agjentë të të huajve». Kështu e cilësojnë ata takimin e Çian Çinit me një gazetare a shkrimtare amerikane që shkruan për të.

Me këta të katër, revizionistët veprojnë njëloj sikurse vepruan me Lin Biaon, duke i akuzuar si «agjentë», por se të kujt, këtë nuk e thonë. Me siguri që do ta thonë nesër dhe, në këtë drejtim, ka shenja që tani sikur kanë qenë «agjentë të sovjetikëve», ashtu sikurse thanë për Lin Biaon. I njëjti ambasador kinez, që përmenda pak

më parë, i ka treguar ambasadorit tonë, përveç sa thashë, edhe se «këta të katër, hëpërhtë, nuk mund ta themi se janë agjentë të sovjetikëve, por asgjë nuk na siguron për këtë, dhe nesër ne mund të zbulojmë se janë njerëzit e tyre». Me siguri revizionistët kinezë, pasi të kurdisin dokumente false, kanë për ta thënë edhe këtë.

Nga ana tjetër, po ky ambasador kinez e informoi ambasadorin tonë se «Perëndimi i cilëson të katër komplotistët si radikalë të majtë, po nuk është ashtu», se, sipas tij, «ata janë ekstremistë të djathtë, por të fshehur nën petkun e radikalëve të majtë». Natyrisht, ata nuk thonë dot se këta të katër janë agjentë të amerikanëve, sepse vetë e kanë grurë me imperialistët janki.

Kuptohet, megjithëse jo drejtpërdrejt, që puçistët, me Çu En Lain në krye, kanë qenë kundër Revolucionit Kulturor. Bile ata e atakojnë këtë revolucion, që demaskoi shtabet e reaksionit brenda në parti, kur pohojnë se Maoja ka kritikuar Çian Çinin dhe tre të tjerët, sepse «gjatë zhvillimit të Revolucionit Kulturor u kanë vënë kapele në kokë disa udhëheqësve» etj., etj. Me këtë duan të thonë se përkrahësit e Revolucionit Kulturor kanë goditur partinë, i akuzojnë ata se «kanë bërë krime» që u kanë vënë kapele në kokë kundërrevolucionarëve, se «kanë rrëzuar kë të mundnin» etj., etj.

Duket se, menjëherë pas vdekjes së Maos, katër të akuzuarit duhet të kenë ngritur çështjen se cili do të zgjidhej në udhëheqjen e re. Mirëpo, për puçistët e Hua Kuo Fenit kjo konsiderohet «intrigë», «komplot». Po përse na qenka intrigë apo komplot derisa ata e kanë kundërshtuar zgjedhjen e Hua Kuo Fenit si udhëheqës kryesor, qysh kur ishte gjallë Maoja?

Akuzat e puçistëve janë aq banale saqë, për të bindur të tjerët, mundohen të gjejnë qimen në vezë. Ja çfarë thonë këta në qarkore: Maoja, në prill të vitit 1976, ka theksuar se «duhet ecur sipas kursit të së kaluarës»,

kurse këta të katër e paskan «shtrembëruar» këtë, duke përdorur formulën «të veprojmë sipas kursit të përcaktuar». E ku qëndron këtu ndryshimi? Zor ta dallosh, por, po të mendosh thellë, edhe thënia e Maos «të ndjekim kursin e së kaluarës» përmendet me qëllim nga revizionistët. Kjo duhet marrë me mend se me kursin e vjetër kuptohet vija e ndjekur prej Maos, Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinit me shokë në të gjitha drejtimet. Sipas këtyre, «elementët më të mirë janë njerëzit e rivendosur në pushtet dhe në parti, e jo ata që kanë dalë nga Revolucioni Kulturor». **Ky revolucion për puçistët tani mori fund, prandaj bëjnë thirrje «të drejtohem i nga kursi i vjetër, të mos ngrihet krye kundër atyre që u rehabilituan, se ata janë më të mirët».**

Pra, ngritjen e problemit të zgjedhjes së udhëheqjes së re nga ana e «të majtëve», renegatët e cilësojnë «krim». Me këtë shpjegohet edhe shfrytëzimi i thënies së Maos «bashkohu dhe mos u përçaj... mos komploto dhe mos intrigo!». Të tëra këto që thotë Maoja, puçistët i përdorin për të mbrojtur këtë kurs dhe akuzojnë «katërshën» sikur ka shtrembëruar thëniet e Maos. Në fakt, këtë parullë Maoja e ka hedhur që në kohën e Revolucionit Kulturor, kurse puçistët aktualë përpiqen të vërtetojnë sikur ai e paska thënë tani dhe posaçërisht kundër këtyre të katërve. Shihet qartë hileja e puçistëve për të gënjyer masat e gjera të partisë dhe të popullit, derisa përpiqen të bindin njerëzit sikur Maoja e paska thënë këtë gjë tani. Sidoqoftë e ka lëshuar Maoja tani apo gjatë Revolucionit Kulturor këtë thënie, prej saj nuk del si duhet fryma revolucionare dhe klasore.

«Mos komploto», thotë Maoja, po në realitet cilët janë ata që komplotojnë? Po të analizosh veprimtarinë e këtyre të katërve del se këta s'kanë bërë komplot. Ata që kanë dashur ta ndryshojnë fare regjimin në Kinë, dhe këtë ndryshim janë përpjekur ta realizojnë, janë Liu Shao

Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Pen Çeni e të tjerë. Disa prej tyre ishin mënjanuar gjatë Revolucionit Kulturor, por erdhën përsëri në fuqi, prandaj duheshin demaskuar dhe luftuar për veprimtarinë kundërrevolucionare që po zhvillonin. Po kush do t'i luftonte ata? Natyrisht, elementët revolucionarë me një parti marksiste-leniniste. **Mirëpo njerëzit që kishin fuqinë në dorë në Kinë, siç ishin Çu En Lai me shokë, të cilët nuk i kishte fshirë dot vala e Revolucionit Kulturor dhe që dëshironin ta mbanin e ta përjetësonin këtë fuqi, i akuzojnë elementët e së majtës si «komplotistë». Puçistët e shfrytëzojnë këtë shprehje për të mbrojtur veten e tyre. Tani të tërë këta kanë ardhur në fuqi dhe e akuzojnë «katërshen» si shkelëse të direktivave të Maos.**

I akuzojnë, gjithashtu, këta të katër se kanë shkruar një artikull kundër revizionizmit, ku bëhet thirrje për të vepruar «sipas kursit të përcaktuar nga kryetari Mao». Ky artikull konsiderohet si një sulm antiparti kundër Komitetit Qendror. Shumë mirë kanë bërë këta të katër që e kanë sulmuar Komitetin Qendror, në qoftë se ky ka qenë në rrugën revizioniste. Në artikull, duke shtruar luftën kundër pragmatizmit, flitet edhe kundër revizionizmit. Pragmatizmi dihet se përfaqësohej nga Çu En Lai, nga metoda e veprimtarisë së tij. Zbatimi i pragmatizmit nga ana e tij do të thotë veprimtari kundër marksizëm-leninizmit.

Në një bisedë që ka bërë me shokët tanë, kur këta kanë qenë në Pekin, Mao Ce Duni u ka thënë këtyre: «Në qoftë se revizionistët ndonjëherë do të uzurpojnë udhëheqjen në Kinë, marksistë-leninistët e vendeve të tjera duhet po kështu t'i demaskojnë me vendosmëri këta revizionistë dhe të bëjnë kundër tyre luftë, duhet ta ndihmojnë klasën punëtore dhe masat e popullit të Kinës të luftojnë kundër revizionizmit».

Çan Çun Çiaon e akuzojnë se ka mbajtur një mble-

dhje me komisarët e ushtrisë etj., ku ka vënë në dukje si çështje të dorës së parë luftën kundër pragmatizmit, dhe këtë ide ai e ka mbrojtur në këtë mbledhje. Se si e ka bërë këtë, ne nuk dimë gjë, por duket se ka theksuar që ne, marksistët, duhet ta mbrojmë teorinë marksiste-leniniste, por njëkohësisht edhe ta zbatojmë në praktikë, dhe këtë ta bëjmë jo duke hedhur poshtë parimet e saj. Sipas puçistëve, «Çan Çun Çiaoja me shokë e kishin hedhur poshtë marksizëm-leninizmin». Edhe kjo është një akuzë tjetër e rreme që u bëhet atyre.

Maoja ka thënë se «për të mbrojtur marksizmin, duhet të shkosh edhe kundër rrymës». Në fakt Van Hun Veni, Çan Çun Çiaoja, Çian Çini dhe Jao Ven Juani, parësisht nga kundërshtimet e forta të revizionistëve, kanë luftuar kundër revizionizmit. Janë pikërisht këta që i goditën revizionistët brenda radhëve të partisë, kurse puçistët i akuzojnë për «tradhti ndaj Maos, Komitetit Qendror, revolucionit» etj.

Elementët e «katërshes», sipas revizionistëve, «kanë shtrembëruar strategjinë e Maos në luftën kundër Lin Biaos dhe Konfucit». Po cila është kjo strategji e Maos? Këtë revizionistët nuk na e thonë. Në qoftë se ata të katër e «kishin shtrembëruar këtë strategji», po këta me Maon në krye ku qenë? Përse nuk e ngritën në kohë këtë çështje? Derisa ishte puna kështu, përse nuk thirrën një mbledhje të udhëheqjes për t'u ngritur këmbët atyre që po bënin «shtrembërime»? Derisa Lin Biaos dhe Çen Po Tasë ua ngritën këmbët, nuk ua ngrinin dot vallë edhe këtyre? Pse nuk vepruan, gjithashtu, që atëherë kundër Çian Çinit? Po këtë ata nuk e bënin dot, se në kohën e Revolucionit Kulturor ishin, me nder, të ...

Kundër Çian Çinit puçistët thonë një mijë gjëra. Revizionistët nxjerrin sikur Maoja i paska thënë në këtë dhe në atë kohë që «ti je ambicioze, ti kërkon të marrësh fuqinë, ti je e tillë e ti je e atillë, ti mbron një pakicë, ju

jeni një katërshe» etj., etj. Mirëpo këto çështje, sipas tyre, kishin dalë në shesh vite më parë dhe, Maoja, siç thuhet në qarkore, i paska thënë këto gjëra edhe në mbledhje. Derisa qenka kështu, është e çuditshme përse nuk është mbajtur qëndrim si ndaj Çian Çinit, ashtu dhe kundër tre të tjerëve? «Ja, shiko, ti ke gabime», i paskësh thënë Maoja Çian Çinit, «po shokët nuk t'i vënë në dukje këto. Ti merresh me gjëra të vogla, me të cilat vjen e më shqetëson mua dhe nuk më flët për gjërat e mëdha». Këto i digjnin Maos.

Sipas puçistëve, «katërshja» «ka bërë krime që në kohën e demaskimit të Lin Biaos, duke hedhur tri shigjeta. Shigjeta e parë ishte ajo kundër Lin Biaos, e dyta kundër Konfucit dhe e treta kundër hatëreve», ose «futjes nga dera e pasme». Po kjo ç'do të thotë? Përse e nxjerrin këta tani çështjen e luftës kundër hatëreve? Përse u djeg kjo? Cilët ishin vallë ata që bënë hatëre? Më siguri ata që kishin fuqinë në dorë, duke filluar që nga Çu En Lai, në radhë të parë, e deri të Ten Hsiao Pini, që kishin grumbulluar rreth vetes në vendet kyç njerëzit e tyre dhe bënë hatëre politike, ekonomike etj. Shiko se çfarë akuzash bëjnë revizionistët! Ata i akuzojnë të tjerët, sepse janë të krimbur vetë. Shigjeta që i atribuojnë «katërshes» për Maon, për Çunë dhe për shokët e këtij, është futur apostafat për të dobësuar dy shigjetat e para kundër Lin Biaos dhe Konfucit. Të tilla gjykime sofistike bëjnë puçistët.

Edhe në këtë rast të njëjtat taktika përsëriten. Për Lin Biaon revizionistët thanë se «donte të zëvendësonte Maon». Edhe për Çian Çinin thonë se ajo «është orvatur si Lini, që të merrte në dorë udhëheqjen e partisë!» Këto akuza puçistët i kanë rregulluar në mënyrë të tillë, që sapo t'i lexosh, pa u thelluar në gjithë këto trillime, mund të thuash: «More, po këta të katër paskan qenë me të vërtetë kriminelë të mëdhenj!». Por, po të thellohesh ve-

tëm pak, del vetiu pyetja: Kur Çian Çini ishte kaq e keqe dhe disa herë Maoja e kishte kritikuar kaq rëndë, përse nuk e përjashtuan të paktën nga udhëheqja? S'ka dyshim se Çian Çini ia vinte në dukje Maos mashtrimet e mëdha që bëheshin në prapaskenë nga ana e revizionistëve, i bënte vërejtje nga ana e saj, **por Maoja, nga Olimpi, nuk lejonte të prekeshin mendimet e tij «të pagabueshme».**

Njëllor si Lin Biaoja akuzohet, gjithashtu, Van Hun Veni, sikur «donte ta zëvendësonte Maon, si Çian Çini që synonte të udhëhiqte partinë».

Të gjitha këto tregojnë se të djathtët, të përkrahur nga vetë Maoja, kanë luftuar për një kohë të gjatë për të mbajtur me çdo kusht fuqinë në duart e tyre.

Të katër «të majtët» akuzohen se «janë hedhur në luftë kundër empirizmit» (kuptohet, kundër Çu En Lait) dhe goja «nuk luftonin kundër revizionizmit». Edhe kjo është një shpifje. Empiristët në Kinë janë njëkohësisht revizionistë dhe këta janë Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjerë. Është e kuptueshme se revizionistët e sipërpërmendur, me luftën që i bëhej empirizmit nga ana e të majtëve, janë prekur në kallo.

Revizionistët në qarkore vënë në dukje edhe thënien, sipas së cilës «Maoja kërkon disiplinë dhe bindje», dhe kjo thënie, për të djathtët, në kushtet e tanishme është e padiskutueshme dhe duhet të zbatohet.

Konkluzioni i tyre është që «katërshja» dhe pasuesit e saj janë «borgjezia në parti», siç e ka thënë Mao Ce Duni, sipas puçistëve, kurse këta vetë, me Hua Kuo Fenin në krye, janë «marksistë-leninistë».

Lëre pastaj që asnjë fjalë, as më të voglën akuzë, nuk bëjnë në qarkore për Ten Hsiao Pinin. Kësaj radhe këtë nuk e zënë fare në gojë.

TË PËR PJETAT E HUA KUO FENIT

Agjencia HSINHUA njoftoi se në Pekin u mbajt dje një miting në sheshin Tien An Men për të përshëndetur ardhjen e Hua Kuo Fenit në postin e kryetarit të KQ të PK të Kinës dhe të kryetarit të komisionit ushtarak të tij.

Thonë se në këto poste, që janë kulmet e udhëheqjes kineze, e ka caktuar vetë Maoja përpara se të vdiste.

PRITA DELEGACIONET E PARTIVE KOMUNISTE (M-L) QË DO TË MARRIN PJESË NË KONGRESIN E 7-TË TË PPSH

Në orën 11 paradite prita në selinë e Komitetit Qendror të Partisë delegacionet e partive komuniste (marksiste-leniniste), që kanë ardhur për të marrë pjesë në Kongresin e 7-të të Partisë dhe në festën e 35-vjetorit të themelimit të saj nga të gjitha kontinentet. Ishin rreth 31-32 delegacione. Kishte midis tyre edhe përfaqësues të grupeve marksiste-leniniste e të ftuar të tjerë si gazetarë e publicistë marksistë-leninistë.

I përshëndeta ngrohtësisht dhe i falënderova për ardhjen në vendin tonë. U thashë se ardhja e tyre për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 7-të të Partisë dhe në festimet e 35-vjetorit të themelimit të saj, nuk është aspak një çështje formale. Partia jonë mendon se ato parti që kanë mundësi objektive të marrin pjesë në kongreset e partive marksiste-leniniste motra duhet të marrin pjesë, sepse ajo është e nevojshme dhe e domosdoshme, është shprehje e internacionalizmit proletar në fushën e ideologjisë dhe të praktikës dhe në luftën revolucionare.

Me shokët dhe miqtë zhvillova një bisedë të ngrohtë. Takimi kaloi shumë mirë. U ngritën doli.

TAKIM ME SHOKËT E PARTIVE KOMUNISTE QË NDODHEN NË KONGRESIN E PARTISË SONË

Sot në mëngjes, pas seancës së parë të Kongresit të 7-të të Partisë, në pushim, shkova e u takova me shokët e partive komuniste motra. U ula me ta, i falënderova për ndihmën që na japin, për marrëdhëniet midis nesh dhe me këtë rast shpjegova idenë tonë të bashkëpunimit nëpërmjet takimeve të ndryshme, ose duke gjetur apo propozuar forma të tjera efikase. U folta shokëve edhe për punimet e Kongresit dhe për probleme të jetës së vendit tonë.

Prania juaj, u thashë shokëve në fund, na gëzon pa masë, kurse largimi juaj nga Shqipëria do të na mërzhitë. Ne dëshirojmë që komunistët shqiptarë dhe Shqipëria t'ju lënë përshtypje të mira, që ju të vini më shpesh në vendin tonë, çdo vit, në mos edhe më shpesh e jo si deri tani; një herë në pesë vjet.

Në diskutimet ose në përshëndetjet e tyre diçka nga delegacionet e partive motra, emrin tim e vunë krah për krah marksistëve të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Kjo më prishi gjithë gëzimin e madh që kisha, se më vunë në një vend që nuk e meritoj asnjëherë. Askush nuk mund të vihet kurrë krahas këtyre mësuesve të lavdishëm të proletariatit botëror, prandaj, me anën e shokut Ramiz, iu luta shokëve që një gjë e tillë të mos botohej ashtu dhe shokët pranuan. Tash jam i qetë.

T'IA THEM SHOKUT AMAZONAS PIKËPAMJET TONA NDAJ VIJËS POLITIKE E TEORIKE TË KINËS

Bisedova me shokun Hysni për vënien në dijeni të shokut Amazonas, dhe vetëm atij, për pikëpamjet tona ndaj politikës së Kinës dhe rrugës së gabuar teorike që ndjekin udhëheqësit kinezë. Edhe në këtë rast ne i qëndrojmë parimit tonë që të mos flasim për një parti me të tjerë, pa qenë ajo e pranishme, por mendojmë se shoku Amazonas duhet të vihet në dijeni, sepse kinezët po ecin gjithnjë më thellë. Partia Komuniste e Brazilit do ta gmojë këtë qëndrim tonin.

Shkaqet që na shtojnë të bëjmë këtë hap:

1) Ne folëm në raport për politikën tonë të jashtme pa e zënë asnjëherë në gojë emrin e Kinës, por qëndrimet e kësaj, që njihen, bien në kundërshtim me tonat.

2) Kinezëve u kemi bërë propozim për takim në nivel të lartë që t'i bisedojmë qëndrimet tona, por ata kanë refuzuar vazhdimisht.

3) Parashikojmë se kinezët do të zhvillojnë punën e tyre revizioniste.

4) Duke u shfaqur më hapur, kemi besim se do të forcojmë bindjen te Partia Komuniste e Brazilit, se kemi bërë çdo përpjekje që Kina të mos ecte në këtë rrugë. Do t'u themi se hapur këto çështje ne nuk i kemi thënë dhe nuk do t'i themi, veçse në qoftë se punët do të rrokullisen.

QËNDRIM OPORTUNIST I HILLIT

Hilli i Australisë i dorëzoi shoqëruesit një letër të hapur që t'ia jepte ambasadorit kinez në Tiranë. Në këtë letër i thoshte se «Ambasadori i Kinës në Paris e vuri në dijeni dhe për mitingun e madh në Pekin dhe për dënimin e të katërve. Jam dakord me çdo gjë». Këto i shkruante Hilli ambasadorit dhe neve ai na thotë në mënyrë të hapët se ky është qëndrimi i tij, që do të thotë se nuk është dakord me pikëpamjet tona.

S'qenka gjë edhe Hilli, një oportunist. Ai dukej serioz, por nuk qenkësh i tillë.

TRE ANTIMARKSISTË TË TËRBUAR

Brezhnjevi, kreu i socialimperializmit sovjetik, po përgatitet të vejë të vizitorjé miqtë dhe lakenjtë e tij, Çaushekun e Rumanisë dhe Titon e Jugosllavisë.

Të dy këta, si Çaushesku, ashtu edhe Titoja, kanë shumë gjëra të përbashkëta. Që të dy janë antimarksistë të tërbuar, që të dy janë kundër interesave të popujve të tyre. Ata janë borgjezë fodullë që kanë krijuar një borgjezi të re në një shtet borgjez kaotik, anarkik. Titoja, më shumë dhe më parë nga Çaushesku, ngriti në qiell kultin e tij, aq shumë i nevojshëm për të rivendosur «monarkinë titiste», lukset dhe etiketat e saj, për të vendosur gardën e tij pretoriane brenda diktaturës së egër fashiste gjakatare të filluar tok me Rankoviçin dhe, më vonë, me elementë të tjerë besnikë. Tito renegati mori famë dhe u pompua nga ana e borgjezisë, kur doli hapur kundër socializmit dhe Stalinit.

Imperializmi dhe borgjezia e ngritën në qiell këtë «kalë të Trojës» në lëvizjen komuniste, por që iu çor maska. Borgjezia e bëri Titon agjentin e vet kundër komunizmit, ajo i dha kredi të panumërta e të vazhdueshme dhe e këshilloi që t'i ruante format, por të ndërronte krejt brendinë e strukturës dhe të superstrukturës së shtetit jugosllav. Titoja krijoi dhe perfeksionoi një strukturë antisocialiste që lejonte të pasurohej borgjezia e re, që furnizuesit e kapitaleve t'i siguronin këto e të ar-

dhurat prej tyre dhe superstruktura jugosllave t'i adaptohej plotësisht këtij ndryshimi rrënjësor. Duhet njohur që Titoja dhe grupi i tij me borgjezinë e re e vërtitën shumë mirë këtë tradhti.

Renegati dhe tradhtari Tito u bë një mbret pa kurorë, por një mbret që ruante, ose që përpiquej të ruante apelacionin marksist, por që këtë nuk ia besonte kush. As ai, as Lidhja e tij e Komunistëve s'kishin asgjë marksiste. Kjo Lidhje ishte zhveshur nga roli, nga ideologjia, nga organizimi i një partie marksiste-leniniste. Ajo ekzistonte vetëm si emër dhe shërbente për të edukuar komunistët e njerëzit që të korruptoheshin, të spiunonin, të grabitnin.

Titoja u fry e u fry si një gjel dhe ndërronte katër herë ditën rrobat. Ai u pompua si «një politikan i madh», tek ai venin njerëzit «e mëdhenj» të borgjezisë për të «marrë këshilla» ose për t'i kërkuar t'u bënte komisione me pagesë. Titoja u bë një matrapaz shëtitës i imperialistëve dhe i borgjezisë kapitaliste, ai kishte në dispozicionin personal vagonë treni luksozë, avionë, anije, deri edhe lopë speciale. Ai besoi me gjithë mend se u bë «njeriu më i madh i botës», diplomati që lëvizte politikën në gishtat e tij, por, në realitet, ai ishte një marionetë që lëvizte me fill nga Uashingtoni.

Por me plakjen e këtij «kali» amerikan u ul edhe vlera e tij. Brenda në Jugosllavi opozita kroate shpërtheu, serbomëdhenjtë manifestonin më me forcë kundërshtimet, filluan gjyqet e «ustashëve», të «informbyroistëve» dhe të opozitave të tjera. Froni i Titos po tronditej, ai dhe grupi i tij u trembën, grumbulluan UDB-në e ushtrinë dhe goditën, por jo shumë fort, se nuk ishin më të fortë. Titoja filloi atëherë të bredhurat në vend për të bërë «autokritikë», për t'u bërë thirrje false «normave të partisë të kohës së luftës»; ai kërcënoi dhe bëri të tjera profka, por koha e tij «e bukur» e tradhtisë dhe e forcës kishte perënduar.

Tash flitet se ç'do të bëhet Jugosllavia pas vdekjes së Titos. Ky është një maskë, një kadavër, që gjoja përgatit pasardhësit dhe vazhdimësinë e regjimit. Imperializmi amerikan dhe ai sovjetik po punojnë edhe nën rrogos edhe hapur. Këta kanë përgatitur në Jugosllavi klanet dhe agjenturat e tyre. Një herë njëri, një herë tjetri e përkëdhelin neutralitetin e Jugosllavisë, por ndonjëherë tjetër edhe e kërcënojnë. Karteri thotë se «Jugosllavia është zonë influence e Rusisë» dhe Brezhnjevi në këtë rast ngrihet dhe fryhet si gjel. Një herë Brezhnjevi thotë se nuk e sulmoj Jugosllavinë, po nuk më thirri kush, atëherë «balerina» do të bjerë në plehra të qelbura.

Revizionistët hrushovianë kanë përdorur një mijë manovra me Titon: buzëqesh, hidhërohu, lavdëroje, shaje, ndihmoje, kërciti dhëmbët. Titoja, duke menduar se bënte politikë, por, në fakt, politikën e dorës së nderur dhe të qeses së hapët, mbështetej te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe lëvrinte, por «ngjala» lëvrinte në ujërat e qelbura amerikano-sovjetike. Sovjetikët, natyrisht, punonin dhe punojnë. Ata kanë marrë shumë koncesione nga Titoja, bile edhe ushtarake. Tani Brezhnjevi vete të marrë koncesione të tjera. Me buzëqeshjen e tij prej kali, ai do ta frikësojë Titon. Ky hiqet sikur nuk trembet, ka akoma besim në «manovrimet e tij diplomatike», por këto janë venitur. Titon tok me klikën e tij i pret vdekja. Vetëm rezistenca e popullit mund ta shpëtojë Jugosllavinë nga katastrofa.

BRATISLAVË 1968

I dhashë Ramizit disa teza të zgjeruara për një artikull në «Zërin e popullit» me rastin e vajtjes së Brezhnjev-it te Titoja në Beograd. Artikulli të botohet nesër dhe të ketë për titull: «Bratislavë 1968»¹ dhe të mbyllet me fjalët e Julius Fuçikut: «Njerëz, jini vigjilentë!». Ky artikull të shkruhet kundër Brezhnjev-it dhe Titos dhe as të mos zihet fare në gojë Jugosllavia. T'i biem samarit, që të dëgjojë gomari.

¹ Shih: «Zëri i popullit», 16 nëntor 1976.

NJË LETËR QË NUK DUHET BËRË

Sot Mehmet Shehu, që sapo është kthyer nga Vlora, pse ishte në Sazan, më propozoi t'i shkruante një letër Hua Kuo Fenit ku t'i thoshte: «Shoku Enver Hoxha i kishte dërguar një mesazh Mao Ce Dunit dhe nuk kishte marrë përgjigje, që kemi dërguar dy letra zyrtare nga ana e Qeverisë, ku thoshim se ishim të pakënaqur që nuk na u akorduan kreditë që kërkuam, prandaj ju lutemi që të rishqyrtohen përsëri kërkesat tona» etj.

Të them të drejtën nuk e prisja një propozim të tillë dhe i thashë: «Në asnjë mënyrë ne jo vetëm nuk duhet ta bëjmë një gjë të tillë, por as ta mendojmë, pse ky veprim do të jetë një gabim i rëndë për ne. Po ta bëjmë këtë ne ulim dinjitetin e shtetit tonë dhe pranojmë tezat e grupit të Hua Kuo Fenit, sipas të cilit «është katërshtja» që i ka shkaktuar këto gjëra dhe që është po kjo «katërshe», që «sobotoi rëndë edhe ekonominë kineze». Po të bëjmë këtë, atëherë ne pranojmë që Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Li Hsien Nieni dhe Hua Kuo Feni janë burra të mirë, kurse mendimi ynë është krejt i kundërt, se këta janë revizionistë dhe armiqtë tanë, se janë këta dhe askush tjetër që nuk na i akorduan kreditë e kërkuara e që na kanë bërë edhe gjëra të tjera. Personalisht ne në punë nuk i njohim të katërt, por, derisa ata akuzohen nga këta njerëz të ligj që i njohim mirë, kjo do të thotë se «katërshtja» ishte në ujëra më të pastra».

— Po ç'fitojmë ne, — e pyeta Mehmet Shehun, — po ta bëjmë këtë letër nga ana jote? Si mendon, do të na japin kredi?

— Jo, — u përgjigj ai, — po ta kemi dhe këtë dokument.

— Po pse pak dokumente kemi depozituar ne në Pekin? Le t'i hapin ato, po të duan dhe le t'i lexojnë, po janë vetë këta që i hodhën ato në shportë. Prandaj, — vazhdova t'i them Mehmetit, — ne nuk duhet të nderim dorën dhe me këtë letër t'u japim vetë ne të drejtë mjeshtërye të pugistëve që të thonë se ndërruam mendim dhe të na përgjigjen siç na përcollën me fjalët se «më vonë, kur ta kemi rregulluar ekonominë tonë kineze që na e ka sabotuar «katërshtja», do t'i rishikojmë kërkesat tuaja». Në asnjë mënyrë nuk duhet ta futim Partinë tonë në këtë rrugë. Ata mund të bëjnë vetë çfarë të duan, të na japin ose jo këto që na kanë akorduar, të na i shtyjnë, apo të na i shtojnë (gjë që nuk do të ngjasë) dhe kjo është punë e tyre. Ne do të protestojmë, në rast se do të na i shtyjnë këto që na kanë dhënë, do të pranojmë, në qoftë se i rishikojnë kërkesat tona, por në asnjë rast nuk duhet të kërkojmë dhe të pranojmë tezat dhe pikëpamjet e tyre antimarksiste.

Mehmeti, ashtu sikurse ka bërë edhe herë tjetër, pranoi se kishte menduar gabim.

BISEDE MIDIS SHOKËSH INTERNACIONALISTË

Sot bëra një takim me shokët Amazonas, Arruda dhe me dy shokë të tjerë brazilianë, që kishin ardhur te ne si delegacion i partisë së tyre në Kongresin e 7-të të Partisë sonë. Nga ana jonë ishte Ramizi.

Takimi ishte jashtëzakonisht i ngrohtë, i hapët, folëm si shokë internacionalistë. Amazonas është udhëheqësi kryesor i Partisë Komuniste të Brazilit, parti e lavdishme, shumë parimore dhe me autoritet të madh në partitë komuniste marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine. Amazonas është një komunist i moshës sime, ka 40 vjet anëtar partie, është shumë i zoti, i përgatitur teorikisht dhe njeri i aksioneve luftarake revolucionare. Fola unë (ekziston me shkrim fjalimi im), foli edhe Amazonas, me ngrohtësi të madhe dhe me admirim për Kongresin tonë (ekziston stenogrami). Shkëmbyem mendime mbi shumë probleme për partitë, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për politikën botërore. Në të gjitha problemet kishim unitet të plotë.

Hëngrëm bukë së toku. Nesër ata do të nisen për në Vlorë, për të pushuar dhe për të marrë pjesë në festat tona të 28 dhe 29 Nëntorit.

LUFTE PËR PUSHTET

Nuk ka asnjë dyshim se në Kinë, pas vdekjes së Maos, situata ngeli kaotike dhe partia, e pajisur me një teori eklektike, gjendet e përçarë.

Dihet se, sa ishte gjallë Maoja, grupi i djathtë i Çu En Lait dominonte. Maoja si «timonier» drejtonte «me centristët» dhe frenonte edhe të djathtët, edhe të majtët, të cilët qëndronin me «thika zhveshur» kundër njëri-tjetrit.

Në grupin e Çusë, pas këtij, vinte Ten Hsiao Pini, që do ta zëvendësonte. Këtë veprim e pranonte Maoja, mirëpo e kundërshtonte e majta. Sa vdiq Çuja, Maoja u gjend në udhëkryq. Ai nuk iu imponua dot të majtëve dhe këta filluan demaskimin e Tenit që kur ishte Maoja gjallë. Maoja mundi ta mbante Tenin në parti, po e djathta rrezikohej. Atëherë Mao zigarexhiu nxori nga mesi centristin Hua Kuo Fen, të cilin e emëroi zëvendëskryeministër dhe zëvendëskryetar të parë të partisë. E majta nuk ishte dakord as edhe me këtë vendim të Maos. Gjatë kësaj periudhe, që zgjati afër një vit, centristët bënë aleancë me djathtistët dhe vendosën që, pas vdekjes së Maos, Hua Kuo Feni të bëhej kryetar i Partisë Komuniste të Kinës, bile, edhe para se të vdiste ky, të bëhej kryeministër dhe kryekomandant i ushtrisë. Dhe kështu u bë. Me të vdekur Maoja, Hua Kuo Feni dhe ushtria arrestuan krerët e të majtëve dhe, pa mbledhur as Byronë Politike, as Komitetin Qendror, ai i mori titujt.

Por, për të djathtët dhe për njerëzit e Çu En Lait dhe të Ten Hsiao Pinit, Hua Kuo Feni ishte i përkohshëm, sa të realizohej puçi e të demaskohej «katërshtja», pastaj t'ia linte vendin dikujt tjetër më të fortë, një personaliteti të të djathtëve, që kishte pasur edhe miratimin e Maos, edhe të Çusë. Ky ishte Ten Hsiao Pini.

Hua Kuo Feni bëri hapat e parë, duke pretenduar se «e kishte caktuar Maoja». Atij iu ëmbëlsuan vendi dhe titujt. Me «demaskimin» banal dhe shpifës të «të katërve», Huaja mendoi se i forcoi pozitat, por me siguri nuk ndodh kështu. E djathta do Tenin. Edhe Huaja e do Tenin, por me siguri kërkon që ky të bëjë njëfarë autokritike para se ta rehabilitojë, dhe pastaj t'i japë një post, por jo atë të kryetarit të partisë. Mirëpo Teni dhe përkrahësit e tij nuk e pranojnë një gjë të tillë, prandaj e kanë bllokuar Hua Kuo Fenin. Ky qëndron në krye ilegalisht dhe nuk mbledh dot as Komitetin Qendror, pse atje ka të majtë, ka centristë, ka edhe të djathtë, edhe njerëz të bojërave të tjera. Atëherë Teni i bën presion Huasë dhe ky Tenit. Huaja vazhdon «të kritikojë» (oh! fare butë) disa gabime të djathta të Tenit, derisa të arrijë që ky të bëjë si do Huaja. Por Teni «është kokëfortë», ai do gjithë pushtetin dhe nuk pranon më pak. Këtu qëndron konflikti.

Hua Kuo Feni lufton të qëndrojë në fuqi me një pjesë të ushtarakëve që e mbështetin, dhe manovron me ta. Ai bëri mbledhjen e kryesisë së Asamblesë Kombëtare Popullore, ku çështja e vetme për Huanë ishte caktimi i gruas së Çu En Lait si nënkryetare e Asamblesë Popullore. Këtë kandidaturë Huaja e paraqiti «sikur i kishte thënë Maoja para një viti se gruan e Çusë duhej ta emëronte në këtë vend». Thuhet se grua e Çusë është motra e Ten Hsiao Pinit. Me këtë manovër Huaja do t'u tregojë popullit dhe të djathtëve se ai «ka pasur besimin e Maos», se Maoja i tha «të likuidonte të majtët», se

Maoja i tha «kur je ti në krye, unë vdes i qetë», se Maoja i tha «cakto gruan e Çusë në këtë post të lartë». Me këtë veprim të fundit Hua Kuo Feni përpigjet të bëjë me vete një pjesë të grupit të djathtë, njerëz të Çu En Lait.

Me fjalë të tjera, në Kinë lufta për pushtet jo vetëm nuk ka mbaruar, por sa ka filluar. Këtu rol vendimtar do të luajë ushtria dhe nga ky rol varet nëse do ta ketë pushtetin në dorë Hua Kuo Feni, Ten Hsiao Pini ose ndonjë djathtist tjetër i fortë si Teni.

Në këtë mes Partia Komuniste e Kinës nuk luan asnjë rol, ose luan një rol formal, sa për të miratuar në mbledhjet e saj formale çka vendosin puçistët lart. Partia Komuniste e Kinës, siç po duket, ka vetëm emrin dhe fasadën. Ajo ka dalë në botë dhe në lëvizjen komuniste si një parti «me një vijë revolucionare, marksiste-leniniste, me një strukturë të një partie të tipit të Leninit». Por faktet treguan se nuk ishte e tillë. Populli kinez luftoi, komunistët me Maon dhe të tjerë luftuan, por kjo ishte një luftë nacionalçlirimtare që nuk konsolidoi as partinë në normat marksiste-leniniste, as pushtetin në formën e diktaturës së proletariatit. Edhe algjerianët luftuan si nacionalistë, por këta e bënë spastrimin e armiqve të tyre, kurse komunistët kinezë jo. Dhe prandaj vuajnë.

E MËRKURË
1 DHJETOR 1976

SHOKUT AMAZONAS I FOLËM PËR MOSMARRËVESHJET TONA ME KINEZËT

Takova shokët brazilianë, Amazonas dhe Arruda. Me mua ishte edhe shoku Ramiz. Vendosëm që t'u flitnim shokëve brazilianë në mënyrë konfidenciale për mosmarrëveshjet kryesore parimore që kemi ne me Partinë Komuniste të Kinës. Pas meje folën edhe Amazonas, edhe Arruda. Ata ishin dakord me ne dhe na thanë se kinezët u kishin punuar edhe atyre shumë gjëra të këqija.

Maoja i tha «kur je ti në krye, unë vdes i qetë», se Maoja i tha «cakto gruan e Çusë në këtë post të lartë». Me këtë veprim të fundit Hua Kuo Feni përpigjet të bëjë me vete një pjesë të grupit të djathtë, njerëz të Çu En Lait.

Me fjalë të tjera, në Kinë lufta për pushtet jo vetëm nuk ka mbaruar, por sa ka filluar. Këtu rol vendimtar do të luajë ushtria dhe nga ky rol varet nëse do ta ketë pushtetin në dorë Hua Kuo Feni, Ten Hsiao Pini ose ndonjë djathtist tjetër i fortë si Teni.

Në këtë mes Partia Komuniste e Kinës nuk luan asnjë rol, ose luan një rol formal, sa për të miratuar në mbledhjet e saj formale çka vendosin puçistët lart. Partia Komuniste e Kinës, siç po duket, ka vetëm emrin dhe fasadën. Ajo ka dalë në botë dhe në lëvizjen komuniste si një parti «me një vijë revolucionare, marksiste-leniniste, me një strukturë të një partie të tipit të Leninit». Por faktet treguan se nuk ishte e tillë. Populli kinez luftoi, komunistët me Maon dhe të tjerë luftuan, por kjo ishte një luftë nacionalçlirimtare që nuk konsolidoi as partinë në normat marksiste-leniniste, as pushtetin në formën e diktaturës së proletarietit. Edhe algjerianët luftuan si nacionalistë, por këta e bënë spastrimin e armiqve të tyre, kurse komunistët kinezë jo. Dhe prandaj vuajnë.

E MËRKURË
1 DHJETOR 1976

SHOKUT AMAZONAS I FOLËM PËR MOSMARRËVESHJET TONA ME KINEZËT

Takova shokët brazilianë, Amazonas dhe Arruda. Me mua ishte edhe shoku Ramiz. Vendosëm që t'u flitnim shokëve brazilianë në mënyrë konfidenciale për mosmarrëveshjet kryesore parimore që kemi ne me Partinë Komuniste të Kinës. Pas meje folën edhe Amazonas, edhe Arruda. Ata ishin dakord me ne dhe na thanë se kinezët u kishin punuar edhe atyre shumë gjëra të këqija.

NJË DELEGACION YNI TË MARRË PJESE NË KONGRESIN E PP TË VIETNAMIT

I thashë Ramizit të zgjidhen dy shokë që të shkojnë në Vietnam, ku më 14 dhjetor do të mbahet Kongresi i Partisë së Punonjësve të Vietnamit. Atje, në përshëndetje, shokët tanë të flasin kundër imperializmit amerikan, revizionizmit modern dhe hegjemonizmit. Në qoftë se i provokojnë revizionistët, t'i sikterisin dhe, në qoftë se e teprojnë, atëherë t'u drejtohen vietnamezëve dhe t'u thonë se po e lënë kongresin dhe do të kthehen të flasin në mbyllje të tij.

PARTI E ÇORODITUR

Çështjen e Partisë Komuniste të Kinës mund ta quajmë diçka misterioze. Në pamje ajo duket si një parti legale dhe e tillë është. Ajo është një parti në fuqi, ka politikën, shtypin dhe organizimin e saj. Thuhej se çdo gjë udhëhiqej nga marksizëm-leninizmi dhe tani kësaj parulle i është shtuar edhe maocedunideja. Mirëpo, me gjithë këto, Partia Komuniste e Kinës është një parti që rron dhe vepron si në ilegalitet. Kongreset e saj janë bërë të rralla; mbledhjet e Komitetit Qendror dhe ato të Byrosë Politike bëheshin, gjithashtu, të rralla dhe në fshehtësinë më të madhe, sikur të ishte kohë lufte. Vetëm kongresi i 8-të u bë i hapur, u thirrën delegacione nga partitë motra, u lejua shpërndarja e raporteve. Edhe kongresi i fundit, ku folën Çu En Lai dhe Van Hun Veni, u bë gjysmë i hapur, por nga asnjë parti motër nuk u thirr delegacion për të marrë pjesë. Çdo gjë tjetër qëndron në errësirë. Vetëm «Zhenminzhibaoja» shkruan artikuj propagandistikë të gjatë, saqë zor t'i lexojë kush, se ata janë mbushur me formula, me citate, me slogane të njëllajta, që i ka thënë Mao Ce Duni para çlirimit. Zor, shumë zor, të marrësh vesh, a u bë ndonjë plenum, kush foli, ç'probleme shtroi dhe ç'vendime mori. Asnjëherë dhe asgjë s'pipëtin, veçse disa udhëzime të përgjithshme që edhe këto nuk dihet se kush i ka formuluar. Flitet për bujqësinë, për Taxhain, lidhen këto me ndonjë citat të Maos dhe bëhet propagandë!

Përshtypja jonë është se Partia Komuniste e Kinës rron me slogane dhe vepron me urdhra. Jashtë, me ne dhe me të tjerët, deri edhe njerëzit e udhëheqjes kineze, me përjashtim të Çu En Lait, flasin me citate e me slogane edhe për situatat më të ndryshme e më të ndërlikuarat. Duket sikur u është dhënë «parulla e heshtjes», «asgjë të mos shiti, por përpiquni të bleni». Kjo mund të jetë e vërtetë dhe diçka ka në këtë mes, domethënë ose ruhet një konspiracion i sëmurë edhe ndaj shokëve dhe miqve, ose është një edukatë aq e rëndomtë nga ana e partisë, saqë askush nuk di gjë tjetër veçse formula që i servirin me shtyp e me radio. Të dyja janë të vërteta.

Fakti i pamohueshëm është se Partia Komuniste e Kinës me këtë kryetar «të madh» dhe me këta udhëheqës «të shquar», akoma sot e kësaj dite nuk ka të shkruar dhe të aprovuar zyrtarisht historinë e partisë. Jo, kjo nuk ekziston! Ku e mësojnë brezat në Kinë historinë e partisë së tyre komuniste, me të mirat dhe me gabimet e saj? Asgjëkund. Të paktën bota nuk ka asgjë në dorë. Mos kanë ndonjë Histori të Partisë Komuniste të Kinës që e mbajnë konspirative? Është e pamundur një gjë e tillë. Atëherë pse nuk shkruhet? Nuk kanë njerëz, apo nuk kanë mjete? Asnjëra nga këto nuk mund të jetë. Po atëherë? Është e zorshme ta shkruajnë historinë e partisë së tyre, sepse është e zorshme për ta që të analizojnë vijën dhe luftën e saj. Është e zorshme për ta që të përcaktojnë dhe të analizojnë në prizmin e marksizëm-leninizmit etapat që ka kaluar, ngjarjet, ndryshimet dhe arsyet e tyre, rolin e këtij ose të atij udhëheqësi a grupi etj. Ata që duhet të bëjnë këtë, po ta shkruajnë një dokument të tillë, duhet të marrin përgjegjësinë për përmbajtjen e tij, se bota do t'i gjykojë dhe do t'i shohë si në pasqyrë. Ata që mund ta shkruajnë, nuk e shkruajnë dot në prizmin e marksizëm-leninizmit, sepse nuk janë të tillë, sepse janë oportunistë, pragmatistë dhe të kredhur

për dhjetëra vjet me radhë në fraksione e në komplete, sepse kanë qenë në një paqëndrueshmëri politike dhe ideologjike të habitshme. Nuk ka si kuptohet ndryshe fakti që historia e një partie të tillë komuniste, që është e pasur me ngjarje, me të mira dhe me të këqija, me kaq punë fraksioniste, akoma të mos ketë dalë në dritë e të shërbejë si një përvojë e madhe për komunistët kinezë, për popullin kinez dhe për të tjerë.

Jo vetëm kjo, por as historia e luftës së madhe çlirimtare të Kinës nuk është shkruar dhe vazhdohet të mos shkruhet. Flas për një histori shkencore dhe jo për shkrimet të shkëputura, ku faktet shkruhen si legjendat e kreshnikëve të mesjetës dhe kryekreshniku është kryetari Mao. Ne e dimë se luftë është bërë, po atëherë pse nuk shkruhet kjo histori e pasur ku të studiojnë njerëzit? Sipas mendimit tim, arsyet janë të njëjta me ato që thashë edhe për historinë e partisë.

Partia Komuniste e Kinës nuk ka pasur kurrë një bosht marksist-leninist. Njerëz të ndryshëm, të cilët nuk edukoheshin as me teorinë marksiste-leniniste dhe as nga ngjarjet, ngriheshin dhe bënin një politikë të rastit, «të pavarur» si «komunistë» në një «parti komuniste» që nuk kishte një bosht marksist-leninist.

Të tillë njerëz vinin në udhëheqje, bëheshin karrieristë, luftonin të akaparonin pushtetin dhe binin në konflikt me grupime të tjera që nuk ishin as ato parimore. Rivalitetet dhe ndeshjet midis fraksioneve quheshin luftëra dhe, sipas sloganeve kineze, luftëra të tilla që ka zhvilluar Mao Ce Duni, kanë qenë 10 a 11. Këto 10 luftëra numërohen edhe me emrat e fraksionistëve, por vetëm kaq. Në mënyrë simpliste thuhet se ata «ishin kundër vijës së Mao Ce Dunit», se «Mao Ce Duni i likuidoi» etj. Por Mao Ce Duni nuk i likuidoi fraksionistët as fizikisht, as ideologjikisht, sepse ai predikoi deri në fund «njëqind shkollat». Për ndonjë grup që likuidoi, mund

të dalim me përfundimin se Maoja e bëri këtë, sepse rrezikohej pushteti i tij personal.

Pra, partia në Kinë ishte organi i disa njerëzve që luftonin të ruanin pushtetin e tyre dhe jo një parti e proletariatit, kurse pushteti që ata ruanin, ishte pushteti i tyre dhe jo ai i diktaturës së proletariatit.

Si ishte organizuar, si punonte dhe si edukohej kjo parti? Edhe kjo për ne ishte dhe mbetet një mister. Asnjëherë nuk na u tha gjë, asnjë eksperiencë nuk na u dha, asnjë delegacion me të vërtetë partie nuk u pranua nga ata për të vajtur në Kinë. E kundërta ngjiste me ne. Ne pa rezerva u shpjegonim kinezëve se si i zgjidhte Partia jonë organizativisht detyrat politike dhe ideologjike. Ata kurrë nuk e bënë një gjë të tillë. Puna në Partinë Komuniste të Kinës duhet të ishte shumë e dobët. Në dukje, në numër, ajo është një parti e madhe por brenda është e çoroditur, sepse e çoroditur ka qenë udhëheqja dhe vija e saj.

Fraksionistët e panumërt që vegjetonin në parti bënin edhe pöshtë një punë fraksioniste. Në parti një herë hipte njëri fraksion dhe zbriste tjetri, pastaj ndodhte e kundërta. Kjo lojë po bëhej e rrezikshme. Njerëz të rinj nga radhët e punëtorëve dhe të klasave të tjera ngriheshin, vinin në parti, kishin entuziazëm dhe hov revolucionar, por puna për edukimin e tyre çalonte. Të tërë i kanalizonin në idealizimin e udhëheqësit kryesor që «nuk gabonte kurrë». Të gjithë, duke përfshirë edhe fraksionistët, luftonin nën rrogëz me flamurin e Maos. Ç'mund të themi për gjithë ata udhëheqës, të vjetër e të rinj, që janë dënuar këto vitet e fundit, për Lin Biaon, Çen Po Tanë, Çian Çinin, Jao Ven Juanin, Çan Çun Çiaon dhe Van Hun Venin? Për ta na kanë folur si për njerëz të mirë dhe, me sa i kemi njohur, na janë dukur të tillë. Ndër udhëheqësit kinezë Kan Sheni na është dukur si një revolucionar i vendosur, shok serioz, me formim mark-

sist-leninist dhe më internacionalist nga udhëheqësit kinezë që kemi njohur. Tash të gjithë këta akuzohen rëndë si «djathtistë dhe imoralë në kulm», përveç Kan Shenit, i cili vdiq, por që dihet se ishte përkrahësi i të majtëve.

Ç'dimë ne për këta shokë që mund të kenë bërë edhe ndonjë gabim në këtë kaos dhe në këtë rrëmujë idesh dhe veprimesh të çrregullta që kanë ngjarë në Kinë? Ne dimë pak gjëra për ta. Ata luftonin në Revolucionin Kulturor, «sulmuan shtabet» e revizionistëve e të reaksionit, sulmuan Liu Shao Çinë. Ata ishin kundër revizionistëve sovjetikë dhe imperializmit amerikan. (Sa ka qenë Lin Biaoja me sovjetikët, këtë s'e dimë, s'mund të vëmë dorën në zjarr.) Ata donin t'i venin deri në fund këtij revolucionit. Maoja dhe Çu En Lai me të djathtët i penguan. Ç'edukatë marksiste-leniniste kishin këta njerëz? Atë të gjithë partisë, por si duket kishin arritur në mendimin se ky zinxhir që po e mbyste Kinën, duhej dërrmuar. Mos luftonin dhe këta për pushtet? S'mund të themi, por as dorën në zjarr nuk e vëmë.

Me të tjerët, të cilët kishin Çunë në krye, ne jemi ngrënë për çështje parimore dhe kemi luftuar kundër tyre, sepse i kemi njohur mirë cilët ishin.

Kjo që ngjau tash në Kinë nuk është veçse një përsëritje e luftës fraksioniste që përmenda më lart, por kjo luftë ngjau pas vdekjes së Maos, i cili e kishte lënë të djathtët të forcohej dhe të kishte frenat në dorë për të dobësuar anën revolucionare. Maoja nuk mundi ta luajë dot më politikën e tij të zigaresë, prandaj reaksioni goditi elementët e majtë dhe kësaj here reaksioni do t'i vejë çështjes deri në fund.

Ne kemi qenë dhe jemi me revolucionin dhe me revolucionarët dhe shpresojmë e duam që revolucionin në Kinë të mos udhëhiqet më nga «flamuri i maocedunidesë», por nga idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Vetëm kështu do të fitojë revolucionin në Kinë.

UDHËHEQJE E PASTABILIZUAR

Udhëheqja e re kineze noton në një kaos të papërshkrueshëm politik, ideologjik dhe organizativ. Nuk po duket asnjë lloj stabiliteti, qoftë edhe në rrugën e gabuar ku ka hyrë Hua Kuo Feni. Të tërë hiqen dhe afirmohen si ndjekësit e vijës së Maos, por kjo nuk është e vërtetë. **Vija jomarksiste-leniniste e Maos dukej sikur ishte stabël, por ajo as ishte e tillë dhe as mund të ishte.** Po përse nuk mund të ishte? Për arsye se Maoja nuk zbatonte teorinë marksiste-leniniste në politikë, në ideologji dhe në organizimin e shtetit të diktaturës së proletariatit. Dhe këto ishin si rezultat i asaj që Maoja as nuk e kishte ndërtuar Partinë Komuniste të Kinës, as nuk e kishte edukuar atë si një parti marksiste-leniniste.

Maoja si teoricien nuk ishte marksist. Sipas tij, forca udhëheqëse e revolucionit ishte fshatarësia dhe jo proletariati. Këtë dhe sindikatat ai i dekonsideroi deri në fund, derisa Çan Kai Shia i goditi rëndë në kundërrevolucionin e Shangait. Më vonë dhe derisa vdiq, Maoja e konsideronte të ashtuquajturën botë të tretë si «forcën më të madhe lëvizëse kundër imperializmit dhe socialimperializmit». Ky është filli i zi i vijës oportuniste jomarksiste të Maos, që shprehej me fjalët «fshati të rrethojë qytetin» dhe «Kina bën pjesë në botën e tretë». Sipas teorive antimarksiste të Maos del konkluzioni antimarksist se atje ku kapitalizmi ka zhdukur fshatarësinë dhe i ka kthyer

fshatarët në njerëz pa punë ose në punëtorë robër të koncerneve kapitaliste, perspektiva që proletariati të ngrihet në revolucion, është e mbyllur.

Maoja, i cili trumbetohet si një «marksist-leninist i madh», nuk është veçse një eklektik, një pragmatist dhe si i tillë është një oportunist. Të shkosh drejt teorisë «të lulëzojnë njëqind lule, të konkurrojnë njëqind shkolla», ky është pikërisht thelbi i pragmatizmit më oportunist, që të çon në pluralitet partish, në minimin e rolit udhëheqës të Partisë Komuniste të Kinës në revolucion dhe në ndërtimin e socializmit, pra, në restaurimin e kapitalizmit. Kjo nuk mund të jetë një taktikë ose dredhi, siç duan të thonë disa, që përpiqen t'i ruajnë me zjarr Maos ngjyrën e kuqe, se gjoja Maoja e ka hedhur këtë parullë që të shohë «ku fle lepuri» dhe, me një të shtënë, «të vrasë të gjithë lepujt». Jo, Maoja, as i ka goditur ndonjëherë dhe as që do t'i godasë kurrë me teoritë e tij armiqte e klasës. Lufta e klasave, diktatura e proletariatit, partia e proletariatit në Kinë nuk kanë ekzistuar dhe nuk kanë vepruar kurrë si duhet në rrugën marksiste-leniniste. Në fakt këto kanë qenë parulla dhe vetëm parulla, pse atje kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë «njëqind shkollat».

Mao Ce Duni ka thënë: «Mjaftojnë 10 veta në Komitetin Qendror që ta kuptojnë ç'është marksizmi». Vetëm kjo thënie është e mjaftueshme për të parë humnerën dhe domethënien e «Julëzimit të njëqind luleve e të njëqind shkollave». Në parti, ka thënë Maoja, «ka tri korrente, pra tri grupime: të majtët, centristët dhe të djathtët». Me këtë Maoja vërteton vetë me gojën e tij ekzistencën e «njëqind shkollave», të cilat janë grumbulluar në tri grupet dhe në tri vijat e partisë, që praktika kineze i redukton në dy vija.

Gjatë viteve të «hopit të madh» ai predikoi se brenda 30 vjetëve mund të ndërtohet komunizmi. Pastaj, kur

kjo politikë dështoi, hoqi dorë dhe «e shtyu» fitoren e socializmit me dhjetëra mijë vjet.

Ai shkruante, gjithashtu, se «çdo 7 vjet do të bëhet nga një revolucion, do të vijë në djathtë, pastaj do të vijë në majtë e kështu me radhë gjatë dhjetë mijë vjetëve». E gjithë kjo teori, që e praktikonte Mao Ce Duni, është tipike mikroborgjeze fshatare, kjo ka shkaktuar gjithë këtë kaos të madh, ose më mirë të themi, me mbështetjen e Mao Ce Dunit, e djathta aktualisht ka marrë fuqinë dhe vepron, gënjen, shtyp dhe diskrediton nën flamurin e Maos.

Maoja ka folur kundër «kultit të Stalinit», por ai lejoi të krijohet për të një kult që merrte pamje skandaloze, dhe kultivonte në masat e gjera të Kinës një adhurim pothuaj krejt fetar, si ndaj një perëndie. Pranimi nga ai i fryrjes së shfrenuar të kultit të tij, që arriti kulmin gjatë Revolucionit Kulturor në fjalimet e stratagjemat e Lin Biaos me shokë, sa arritën të vënë shenjën e barazimit ndërmjet marksizëm-leninizmit dhe maocedunidesë e të deklarojnë që «maocedunideja është marksizëm-leninizmi i ditëve tona», nuk dëshmon për modesti... (të mos themi më shumë). Për të djathtët, që kanë marrë fuqinë në dorë, kulti i Maos ka qenë një pengesë e madhe kur ai ishte gjallë, por edhe tash që vdiq, «fama e tij» qëndron dhe i pengon. Prandaj e djathta do ta luftojë këtë pengesë, derisa ta kthejë në një hije, pra, derisa ta zhdukë fare mitin e Maos. Sa ishte gjallë Maoja, nuk guxonin të vepronin as të majtë në rrugën revolucionare dhe as të djathtët në rrugën e tyre të hapët kundërrevolucionare. Këta të fundit tash me Hua Kuo Fenin e morën fuqinë në parti dhe në shtet me forcë, me puç. E djathta i ka vënë në shërbim të saj «centristët» dhe po godet e do të godasë akoma më me forcë të majtën. «Katërshen» e arrestoi, ka arrestuar edhe shumë kuadro të tjerë kryesorë, që në nuk i njohim. Pjesën tjetër të të majtëve do

t'i frikësojë, do t'i godasë, do t'i komprometojë dhe **Hua Kuo Feni ose ndonjë tjetër reaksionar më i egër se ai do të vijë në fuqi për të vendosur diktaturën fashiste dhe për të bërë restaurimin e kapitalizmit në Kinë.**

E djathta në veprimtarinë e saj brenda vendit do të luftojë gjoja nën flamurin e Maos, sa të krijojë një Mao të saj. Citatet e Maos do të jenë në rendin e ditës, sepse janë mendimet e një udhëheqësi oportunist, pseudokomunist, pragmatist, ëndërrues dhe idealist. Pikëpamjet e Maos u mbiquajtën maocedunide dhe propaganda kineze, jo pa qëllim, krijoi formulën «marksizëm-leninizëm bars maocedunide». Kjo është një formulë antimarksiste si në teori, ashtu edhe në praktikë, sepse maocedunideja jo vetëm nuk është marksizëm-leninizmi, por është e kundërta e tij në shumë çështje thelbësore teorike dhe në zbatimin praktik të saj.

Pse bëhej kjo? Kjo bëhej për të luftuar marksizëm-leninizmin si teori dhe si praktikë revolucionare, për ta ruajtur atë si një formulë kufomë, siç bëjnë revizionistët modernë. Në vend të tij **kinezët nxorën maocedunidenë, që është një teori dhe praktikë jorevolucionare.** Ky veprim është antimarksist, kundërrevolucionar dhe revizionist. **Kjo tregon qartë natyrën hegjemoniste në politikë dhe në ideologji të një shteti të madh dhe të një partie të madhe në numër, por jo marksiste-leniniste.**

Maocedunidenë e djathta do ta ruajë për të propaganduar në botë antikomunizmin dhe Maon do ta ruajë të balsamosur në mauzole. Kështu, e djathta kineze vuri Maon në mauzole, për ta ngritur në një rang me Leninin e madh. Pra tash, sipas kinezëve, ka «dy Leninë», «dy komunizma» dhe «dy shtete socialiste». Dualitet i dy vijave si në parti, ashtu edhe në botë. Kështu komunistët e botës duhet të zgjedhin ose marksizëm-leninizmin, ose maocedunidenë. Revizionistët sovjetikë thonë: «Ne jemi leninistë». Revizionistët kinezë thonë: «Ne jemi maoistë».

Por që të dyja palët i marrçin të kegen Marksit dhe Leninin, që të dyja palët janë armiqtë e tyre, janë rrenegatë të komunizmit. Marksi dhe Lenini u përkasin komunistëve të vërtetë, u përkasin revolucionarëve të botës.

Por, siç thashë edhe më lart, citatet e Maos janë me dy presa. Përveç atyre që janë të njohura, e djathta përdor citate të tjera të Maos, të thëna ose të pathëna, të cilat i ujdin dhe i rregullon si do vetë, si t'i shërbejnë më mirë asaj. Ku gjenden këto të thëna dhe të pathëna të Maos? Në erë, në kujtesën e njerit e të tjetrit, apo në procesverbale të zbardhura e të pazbardhura? Tash mori vendim Hua Kuo Feni dhe krijoi komisionin për botimin e veprave të Maos. Bota mbarë njeh vetëm 4 vëllimet e Mao Ce Dunit, të shkruara para çlirimit. Pas çlirimit nuk ka pothuaj asgjë të botuar, asnjë referat, asnjë fjalim të Maos. E çuditshme!! Pse kryetari Mao, të cilit i ngrihej kulturi në qiell, nuk linte të nxirrej në dritë asgjë nga xhevahiret e tij?! Por vallë këto ishin xhevahire apo qymyr dhe hi?! Tash këto xhevahire do të na i nxjerrë në dritë Hua Kuo Feni, por kur dhe si, kjo nuk dihet. Ai do t'ia japë botës t'i hajë «fletët e lëpjetës» dhe me to «të edukohen» e «të mbushin kokën» partizanët e teorisë së «botës së tretë», pse, sa për komunistët e vërtetë, ata nuk do t'i hanë!

Puçin që bëri e djathta, ua ngarkon të majtëve, të cilët i cilëson «të djathtë, fashistë, revizionistë» etj. Ten Hsiao Pinin, që është i djathtë dhe si të tillë të majtët e luftuan me tërbim, Hua Kuo Feni për oportunitet vazhdon ta quajë të djathtë, duke e hequr veten centrist, si Maoja. Kuptoje, po të duash, këtë logjikë «gjeniale» të kryetarit të ri. Ky e quan «katërshen» sikur ajo ka shtrembëruar mendimet e Maos, gjë që ai po e bën vetë.

Kryetari i ri dhe shokët e tij të djathtë, në mungesë të akuzave politike kundër «katërshes», përdorin shpifje personale nga më të ndyrat, nga më imoralet. Kur s'ke

argumente, je i detyruar të përdorësh gjëra të ndyra, o Hua Kuo Fen! Edhe borgjezia dhe reaksioni, kur dënon komunistët, përdor kundër tyre vetëm akuza politike, kurse e djathta në Kinë po tregohet më reaksionare se reaksioni i zi.

Po pse e djathta ka ngritur gjithë këtë llum? Këtë ajo e bën se është në pozita krejt reaksionare, e bën për të diskredituar deri në fund Maon dhe për të arritur në pikëpamjen që «si ishte e mundur që Maoja të kishte për grua një kurvë, të kishte në Byronë Politike agjentë të Guomindanit dhe të sovjetikëve, të kishte konspiratorë, atentatorë» etj. E djathta synon njëkohësisht të impresionojë me këto ndyrësira popullin e thjeshtë dhe të ndershëm kinez. Me një të shtënë, ajo përpiqet të vrasë dy zogj.

E djathta, me paturpësinë më të madhe, për të gjitha të këqijat që ka bërë vetë në pushtet, në ekonomi, në ushtri e kudo, thotë se faji është i «katërshes». Por gjithë bota e di që pushteti, ekonomia, ushtria dhe partia ishin në duart e të djathtëve, të Çu En Lait, të Jeh Çien Jinit, të Li Hsien Nienit dhe të bandës së tyre.

Ky kaos në Kinë do të vazhdojë. Po revolucionarët a do të heshtin, a do të gjuhëzohen para kësaj bande kriminelësh? Koha do ta tregojë. Tash për tash, në këtë gjendje kaosi, në mendjen e kinezëve e në radhët e komunistëve të thjeshtë ekzistojnë frika, pasiguria, konfuzioni politik, ideologjik, ekonomik e organizativ.

PËR PROBLEMET E JASHTME DUHET PUNUAR NË MËNYRË MË TË SHKATHËT

Me shokun Ramiz bisedova se drejtoria e propagandës e Komitetit Qendror të Partisë nuk duhet t'i lërë gjërat për orët e fundit, ose të presë përherë sa t'i thuhet apo t'i sinjalizohet: «Bëj këtë, bëj atë». Shokëve të këtij sektori duhet t'u punojë koka, bile të parashikojnë me kohë çfarë duhet të bëjnë dhe t'i përgatitin me kohë.

Në Greqi u hap java e poezisë shqiptare, që pati sukses, mirëpo nuk kam parë të vihet diçka në gazetë për këtë ngjarje në rubrikën «Aktivitete për vendin tonë». Pse kjo neglizhencë?

Po përgatitet java e filmit shqiptar po në Greqi. Kjo, gjithashtu, është një ngjarje me rëndësi për ne dhe ku se, në Greqi, pikërisht në këtë vend, i cili, për fajin e tij, vazhdon të ruajë «gjendjen e luftës» me ne. Asgjë nuk shkruhet te ne për këtë ngjarje artistike.

Çështja tjetër që duhet të mendohet është se si do t'u përgjigjemi nga ana jonë këtyre manifestimeve të grekëve.

Një problem i dytë: Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) dhe Partia Komuniste e Argjentinës bënë një deklaratë të mirë. Ne ç'do të bëjmë, apo ta quajmë të mjaftueshëm vetëm botimin e këtij lajmi në gazetë? Kjo nuk është e mjaftueshme. Ne duhet ta përkthejmë, ta botojmë dhe ta japim edhe me radio të gjithë

komunikatën. Të bëjmë, gjithashtu, një artikull politiko-ideologjik për të, duke vënë në dukje vijën revolucionare të këtyre dy partive.

Problem tjetër është përgatitja për shtypjen dhe propagandimin në shumë gjuhë të huaja të deklaratës së tetë partive komuniste (marksiste-leniniste) të vendeve të Amerikës Latine dhe shoqërimin e kësaj deklaratë me një artikull të rëndësishëm teorik nga ana jonë.

Shokut Ramiz i theksova se me këtë rast për këto dy probleme, për lidhjet, zhvillimin e tyre, takimet, shkëmbimin e eksperiencës midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive komuniste (marksiste-leniniste) të botës, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve tregtare dhe kulturore me vendet e botës, dhe veçanërisht me fqinjët, duhet të ndiqet dhe të zhvillohet e planëzuar vija e Kongresit të 7-të të Partisë.

Duke ndjekur këto orientime, nuk duhet të bëjmë veprime të rastit, por të studiuara, të planëzuara dhe të shkallëzuara në bazë të interesit reciprok dhe të një politike të zgjuar, të shkathët marksiste-leniniste dhe jo të ngurtë. Si drejtoria e jashtme e Komitetit Qendror të Partisë, edhe Ministria e Punëve të Jashtme të Punojnë, të planëzojnë, të propozojnë dhe, pasi të vendosin, të vënë në lëvizje njerëz që të përgatiten.

NOTË KINEZE PA ADRESË DHE PA FIRMË

Ambasadori ynë në Kinë u prit dje nga Li Hsien Nieni, i cili i dorëzoi një «notë verbale», ashtu siç mund t'i drejtohet një protestë, nga ana e një ministrie të jashtme, një qeverie tjetër. Por të paktën notat verbale ministriale kanë edhe adresa, kurse «nota» e kinezëve nuk kishte as adresë, as firmë. Në esencë në të thuhet: «Shoku Hua Kuo Fen thotë se në Kongresin e 7-të të PPSH u sulmuan publikisht me aluzion vija e Partisë Komuniste të Kinës dhe idetë strategjike të Mao Ce Dunit për disa probleme të rëndësishme, sidomos të gjendjes ndërkombëtare. Këto ai nuk i quan të drejta, të bazuara në marksizëm-leninizmin, sepse dëmtojnë miqësinë, unitetin e lëvizjes, zbulojnë para armiqve divergjencat midis dy partive motra» etj. Përmendet letra jonë e vitit 1964 (për kufijtë kino-sovjetikë), për të cilën Mao Ce Duni ka thënë se nuk do të na përgjigjej, mbasi s'donte të zhvillonte polemikë, prandaj edhe ata «nuk do të japin përgjigje për akuzat» etj. Kjo është një përmbledhje që na jep ambasadori për dy faqet e «notës verbale» që do të na e dërgojë nesër me avion.

Është e para herë që revizionistët kinezë po sulmojnë hapur Partinë e Punës të Shqipërisë me një «dokument» që nesër mund ta mohojnë. Kinezët nuk lënë kurrë dokument zyrtar. Udhëheqja revizioniste e tanishme kineze është në pozita të vështira brenda dhe jashtë vendit. Gje-

ndjen e brendshme e kam shpjeguar shumë herë, kurse politika e jashtme e Kinës po pëson disfatë.

Udhëheqja kineze brenda vendit akuzon «katërshen», të cilën e lidh me Lin Biaon, dhe të gjithë i quan fajtorë për të gjitha të këqijat, i cilëson si agjentë të sovjetikëve etj. Jashtë vendit me këtë «notë» ajo akuzon Partinë e Punës të Shqipërisë se gjoja atakon strategjinë e Maos, domethënë «disfatën jashtë Kinës» ia shkaktojmë ne, pra ne jemi «kundër strategjisë së Maos», ne «ndihmojmë sovjetikët». Sipas tyre ne jemi «në një bllok me katërshen dhe me Lin Biaon». Të gjitha këto janë aluzione që synojnë të na trembin ne, për të ndjekur vijën e tyre, se «përndryshe do të marrim masa më tej, do t'ju presim kreditë» dhe të tjera kërcënime të kamufluara. Logjika e tyre revizioniste i çon udhëheqësit aktualë kinezë të mendojnë se «ata na mbajnë shpirtin gjallë», se «Shqipëria socialiste rron në sajë të tyre», se «po na lanë ata, ne do të lidhemi me superfuqitë dhe propaganda e tyre do të vërtetohet» etj. **Të gjitha këto janë të ngjashme si dy pika uji me veprimet e revizionistit Hrushov dhe të adeptëve të tij kundër nesh!**

Ne duhet t'u përgjigjemi dhe t'i demaskojmë provokatorët me pikëpamjet e tyre shoviniste të shtetit të madh, puçistët, revizionistët dhe antimarksistët kinezë.

Letrën që do t'u dërgojmë ne, në kundërshtim me notën e tyre verbale, t'ua bëjmë zyrtare nga ana e Komitetit Qendror dhe t'u themi:

E para, PPSH është një parti marksiste-leniniste e pavarur dhe është vetë ajo që formulon vijën e saj nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste, në bazë të analizave reale të gjendjes së brendshme dhe të jashtme. PPSH nuk bën pazarllëqe me parimet marksiste-leniniste, ajo udhëhiqet nga një strategji e saj që e cakton vetë dhe formulon taktikat e përshtatshme për këtë strategji. PPSH nuk lejon që dikush tjetër t'i imponojë asaj një strategji që e

gjykon jo të përshtatshme. Ajo në bazë të normave të saj marksiste-leniniste, pranon që parti motra marksiste-leniniste mund t'i bëjnë kritika dhe të diskutojë me to për shumë probleme dhe anasjelltas këtë të drejtë e ka edhe PPSH ndaj partive të tjera motra.

E dyta, PPSH vijën dhe strategjinë e saj kurdoherë i ka shpallur hapur dhe kritikuar kundër armiqve i ka bërë e i bën me adresë dhe kurrë me aluzione e prapa krahëve. Prandaj Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti Qendror i saj hedhin poshtë me vendosmëri akuzat e Hua Kuo Fenit dhe të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës që u bëjnë Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Kongresit të 7-të të saj, se gjoja sulmuan vijën e PK të Kinës etj. Përkundrazi, Partia e Punës e Shqipërisë foli me ngrohtësi për miqësinë me Kinën etj. Jeni, pra, ju, që sulmoni Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Kongresin e 7-të të saj.

E treta, meqenëse ju na akuzoni, detyra e PK të Kinës është të na thotë se në cilat «probleme të rëndësishme» kemi sulmuar ne Partinë Komuniste të Kinës dhe strategjinë e Mao Ce Dunit e të na vini qartë në dukje këtë strategji tuajën, që të mundim të gjykojmë nëse jemi ne apo ju që e keni drejt dhe kush sulmon njëri-tjetrin, në qoftë se flitet për sulme. Ne e presim një gjë të tillë dhe nuk pranojmë thënien tuaj që nuk do t'u përgjigjeni sulmeve që gjoja u paska bërë Partia jonë, pse «s'doni të hapni polemikë». **Në të vërtetë me këtë që bëni, jeni ju ata që hapni polemikën.** Një qëndrim i tillë i shokut Hua Kuo Fen dhe i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Kinës është i papranueshëm për ne dhe këtë do ta konsiderojmë si një fakt që ju nuk pranoni ballafaqimin e mendimeve dhe zhdukjen e mosmarrëveshjeve ose të divergjencave, në qoftë se ka, siç po pretendoni. Në formë shoqërore, ne ju themi se duhet absolutisht të bëhet një gjë e tillë. Asnjëra nga partitë tona, as Partia

e Punës e Shqipërisë dhe as Partia Komuniste e Kinës, nuk mund të pranojnë mendime dhe vendime të njëanshme.

Në mes të dyja palëve tona ekzistojnë dy deklarata të firmuara, njëra më 1964 dhe tjetra më 1966, në të cilat thuhet se për çështje strategjike duhet të bëjmë konsultime. Këto deklarata ju i keni shkelur edhe për probleme kardinale, për të cilat nuk keni bërë konsultime me Partinë tonë; ne nuk jemi pyetur fare dhe nuk jemi vënë në dijeni nga ana juaj, ose jemi vënë para faktit të kryer.

Ju përmendni në «notën» tuaj letrën tonë të vitit 1964. Ne mendonim dhe mendojmë se kjo letër ka një rëndësi të madhe politike, ideologjike dhe strategjike, sepse ajo që ngrinim ne, dukej sikur ishte një çështje juaja, dhe në realitet juaja është, por që na përkiste edhe neve, edhe revolucionit botëror. Ju nuk na vutë në dijeni ne si parti motër, kurse ne në mënyrë shumë shoqërore ju shprehëm mendimin tonë. Dhe kjo çështje mbeti në mes dy partive tona. **Sigurisht ju që e përmendni këtë letër, keni qëllimet tuaja aktuale ose të perspektivës, por ne ju sigurojmë se ajo letër në asnjë rast dhe në asnjë kohë nuk do t'i shërbejë askujt për ta përdorur kundër PPSH. E kundërta do të ngjasë.**

Por nuk është kjo e vetmja letër që i kemi drejtuar ne Komitetit Qendror të PK të Kinës dhe shokut Mao Ce Dun. Edhe të tjerat kanë qenë për çështje të mëdha të strategjisë dhe të taktikës. Këto kanë qenë letra shoqërore, të hapëta dhe të sinqerta.

Një letër tjetër ju është dërguar nga ana jonë në datën 6 gusht 1971, me të cilën dënonim vendimin tuaj për të pritur në Kinë presidentin amerikan Nikson. Kjo u bë se ne u vumë përpara një fakti të kryer, që nuk e lejonte as miqësia e madhe në mes dy partive tona dhe as deklarata e përbashkët. Veprimi juaj ishte për një problem me rëndësi të madhe ndërkombëtare. Por edhe kjo

letër jona mbeti, gjithashtu, pa përgjigje nga ana juaj. Partia e Punës e Shqipërisë vazhdoi strategjinë dhe vijën e saj dhe njëkohësisht shkoi duke e kalitur miqësinë shqiptaro-kineze.

Një letër iu dërgua Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, e firmuar nga Sekretari i Parë i saj, më 12 nëntor 1975, po edhe kjo mbeti pa përgjigje, kurse veprimet nga ana juaj shkuan drejt acarimit. Megjithatë, këto çështje ne i mbajtëm dhe po i mbajmë brenda nesh.

Kurse Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë propozimit të një çështjeje me rëndësi të madhe strategjike («fronti antiimperialist edhe me revizionistët») të bërë nga ana e Liu Shao Çisë në datën 27 qershor 1962 iu përgjigj negativisht dhe ia hodhi poshtë.

Në datën 29 tetor 1964 propozimeve të shokut Çu En Lai për çështje strategjike (të shkonim në Moskë pas rrëzimit të Hrushovit) ne iu përgjigjëm negativisht dhe i hodhëm poshtë.

Në datën 15 qershor 1975 propozimin e Çu En Lait, të përsëritur dy herë rresht në dy data të ndryshme, për aleancë me Jugosllavinë e me Rumaninë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e ka pranuar dhe e ka hedhur poshtë. Por këto gjëra kanë mbetur ndërmjet nesh, për hir të miqësisë marksiste-leniniste midis dy partive dhe dy popujve tanë.

Të gjitha këto dhe të tjera ne i kemi bërë në rrugë normale, në bazë të normave marksiste-leniniste. Këto ishin të domosdoshme të bëheshin, pse duhej t'i sqaronim çështjet dhe të kalitnim miqësinë.

Në asnjë rast ne nuk kemi folur prapa krahëve, por hapur, asnjëherë nuk e kemi sulmuar botërisht dhe me aluzione Partinë Komuniste të Kinës, siç pretendoni ju, asnjëherë nuk kemi hyrë në polemikë, por, duke mos na

u dhënë nga ju asnjë mundësi tjetër, çdo gjë jua kemi thënë me mesazhe të brendshme në frymë shoqërore.

Për ne miqësia në rrugën marksiste-leniniste me Kinën motër dhe me Partinë Komuniste të Kinës ka qenë dhe është e shtrenjtë. Në Kongresin tonë të 7-të kjo u afirmua plotësisht dhe vija e Kongresit është vija e Partisë. Komiteti Qendror dhe Partia jonë nuk lëvizin për asnjë grimë nga kjo vijë, dhe është për këtë gjë që ne e ripohojmë për t'i dhënë përgjigje notës suaj verbale.

E para, miqësinë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar me Partinë Komuniste të Kinës dhe me popullin kinez ne do ta kalitim më tej. Nga ana jonë ne do të luftojmë në rrugën marksiste-leniniste për të kapërcyer çdo pengesë që do të vënë armiqtë në rrugën tonë të miqësisë. Miqësia në mes nesh është shumë e nevojshme si për ne, edhe për ju e për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

E dyta, presim shpjegimet nga ju se ku ju kemi sulmuar dhe cila është strategjia dhe taktika juaj për këto çështje që gjykoni se «ju sulmuam tërthorazi në Kongresin e 7-të të PPSH».

P.S. Ia dhashë disa nga këto teza shokut Ramiz për hartimin e përgjigjes lidhur me «notën» që na dorëzoi Li Hsien Nieni në emër të Hua Kuo Fenit dhe të Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Kinës.

**E SHTUNË
11 DHJETOR 1976**

**KINEZËT NA NXJERRIN PENGESA TË REJA NË
FUSHËN E MARRËDHËNIEVE TREGTARE**

Me shokët sekretarë të Komitetit Qendror bisedova për problemin e tregtisë. I bëra një pyetje shokut Prokop [Murra] për rezultatet e bisedimeve të delegacionit tregtar që shkoi në Kinë. Ç'u arrit?

Të dhënat që më kanë dhënë, kanë qenë kontradiktore dhe çështjet tregtare me të gjitha shtetet, veçanërisht me Kinën, kanë edhe anën e tyre politike dhe jo vetëm tregtare.

Siç e dimë, kinezët, duke mos qenë dakord në vijë me ne, na kanë nxjerrë pengesa, të cilat po shtohen. Ata nuk duan të kontraktojnë për klering veçse në fillim të vitit dhe në gjashtëmujorin e parë. Kjo do të thotë, në fakt, të të furnizojnë me vonesë, të të frenojnë zhvillimin e ekonomisë, realizimin e planeve dhe të të ulin mirëqenien. Ky është një veprim i keq.

E dyta, ata nuk na sigurojnë ato mallra që kërkojmë dhe për këtë japin shumë arsye që nuk qëndrojnë, por s'ke ç'u bën (dhe këtë do ta shpjegoj më poshtë).

E treta, ata s'na pranojnë të gjitha llojet e mallrave që u ofrojmë ne dhe, me këtë, e ulin nivelin e tregtisë midis dy vendeve tona.

E katërta, mallrat nuk na i livrojnë në kohë dhe, për këtë, përpiqen të gjejnë «arsye», dhe tash këto arsye janë: «tërmeti», «sabotimi i katërshes» etj.

E pesta, kinezët nuk pranojnë çmimet stop, por çmimet e koniunkturës ndërkombëtare. Kjo u leverdis atyre dhe jo neve.

Të gjitha këto çështje tregtare ne nuk duhet t'i marrim «majë më majë» me ta, pse disa herë Li Çiani na ka «këshilluar» siç na «këshillonte» Mikoiani: «I shisni gjetkë». Kjo, natyrisht, është armiqësore nga ana e tij dhe ne s'e bëjmë një gjë të tillë, pasi për ne Kina është një treg i madh, që është treguar miqësor, por që tash është acaruar. Me Kinën ne kemi edhe interesa të tjerë, janë kreditë që ajo na ka akorduar dhe që duhet t'i realizojmë me përpjekje, por pa koncesione ideologjike.

Nga ana tjetër, që të bësh tregti me të tjerë, duhet të luftosh dhe t'i gjesh këto tregje. Në këtë drejtim bëhet shumë pak dhe kjo është me plot rreziqe, prandaj mendoj se Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Qeveria duhet të jenë shumë të kujdesshme në çështjet tregtare me kinezët. Ne nuk duhet ta humbasim tregun kinez për ato arsye, metoda dhe kohë livrimi që caktojnë kinezët. Duhet të diskutojmë, t'i zbutim afatet e livrimit, pranimin e kërkesave tona dhe blerjen e dërgimin e llojeve të mallrave që na duhen. Lënia pezull nga ana e tyre e çmimeve stop bën që kinezët, përveç arsyeve ideologjike, të mos na i livrojnë mallrat me kohë, pse i shesin gjetkë me çmime më të larta ato që do të na i jepnin neve. Çështja e çmimeve duhet të rregullohet, pse ne nuk mund të veprojmë me ta siç bëjmë me shtetet revizioniste, ku saldoja është pozitive për ne dhe ne u ndalojmë furnizimet dhe nuk u paguajmë ratat. Kurse kinezët ratat që u detyroheshim, na i kanë shtyrë deri në 1980. Kjo ishte në favorin tonë.

Për këto probleme nuk duhet të ecet me gjaknxehtësi. Kjo nuk do të thotë të bëjmë koncesione ideologjike. Ne duhet të ecim të matur, të bëjmë përpjekje më të mëdha që në tregtinë me Kinën të zbuten pengesat, por

pengesa do të ketë vazhdimisht. Duhet të mendojmë me gjakftohtësi edhe për pengesat që do të shtohen në të ardhmen. Ne duhet të çajmë në tregti në vende të ndryshme, mirëpo kjo punë nuk po bëhet, thuhën slogane, por tregtia me fjalë në oda nuk bëhet. Duhet të përpiqesh, ta reklamosh mallin, të jesh i rregullt, të balancosh furnizimet në mes shteteve të ndryshme, prandaj parulla e madhe e Partisë «të punojmë si në rrethim», duhet kuptuar drejt, në mënyrë dialektike. Ne duhet të mbështetemi në forcat tona, të krijojmë bollëkun dhe, në të njëjtën kohë, ta çajmë rrethimin.

Vija e Partisë për këtë çështje ka qenë e drejtë. Ne nuk do të biem në autarki, do të bëjmë dhe po bëjmë tregti me shumë shtete. Me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Sovjetik e të disa shteteve fashiste, ne kemi marrëdhënie diplomatike dhe zhvillojmë marrëdhënie kulturore me shumë vende nga të katër anët e botës. Sot në botë, në marksistë-leninistët, në popujt, në elementë përparimtarë dhe në shumë shtete e qeveri është krijuar një simpati e madhe për vendin tonë. Këtë duhet ta shtojmë dhe jo ta dëmtojmë. Të jemi të vendosur në vijën e Partisë sonë, por jo të bëhemi fodullë, arrogantë, mendjemëdhenj. Të gjitha këto janë shumë të rrezikshme, si brenda, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Armikut t'i qëndrojmë dhe t'i biem kokës, me të lëkundurit ka edhe taktika, në mos afrimi, neutralizimi dhe bashkëpunimi në tregti.

E HËNË

13 DHJETOR 1976*

LAKENJTË E KINEZËVE DO TË DËSHTOJNË

Kryetari i Partisë Komuniste të Australisë (marksist-leniniste), Eduard Hill, i cili mori pjesë në Kongresin e 7-të të Partisë sonë dhe shprehu «kënaqësinë» e foli «mirë» në Kongres, pasi u largua nga vendi ynë i dërgoi një letër ambasadorit tonë në Paris për shokun Ramiz. Letra u dorëzua nga gruaja e Hillit, duke i thënë se «janë disa vërejtje të Hillit mbi Kongresin e 7-të të PPSH».

Siç po duket, ky «komunist», që ne e kemi çmuar si një shok të mirë dhe objektiv, nuk ka pasur as kurajën më të vogël të bisedonte me ndonjë nga ne, por «vërejtjet» i bëri me letër. Mirëpo këto «vërejtje» të tij janë sulme, shpifje dhe provokime kundër Partisë sonë, që ai i ka bërë nga deduksionet e veta, ose i ka marrë nga kinezët, duke u bërë masha e tyre.

Letrën ne akoma nuk e kemi marrë, por ambasadori na dërgoi me radiogram mendimet kryesore të shprehura në të. Hilli thotë:

a) «Pse Partia e Punës e Shqipërisë është për të organizuar mbledhje edhe me shumë parti, kurse Kina nuk është për një gjë të tillë?».

Kjo as meriton koment nga ana jonë. Psenë ne e kemi thënë.

b) Pse nuk u deklarua nga ne në Kongres se Kina nuk është për mbledhje shumëpalëshe të partive?

Edhe kjo është aq provokuese, sa edhe absurde. Por duhet të ketë qëllime më të thella që ai i gre këto.

c) Megjithëse ne e shpjeguam pse mund të bëhen mbledhje edhe të shumë partive, ky revizionist del me përfundimin se këtë gjë ne e bëjmë që «të sjellim Kinën në rrugë të drejtë».

Ç'koment mund t'i bësh kësaj shpifjeje? Ai do që të na akuzojë ne se «mbajmë bajrakun».

ç) «Mao Ce Duni është marksist-leninist i madh, këtë e ka treguar dhe e tregon historia». Sipas tij çdo gjë që ka bërë dhe ka thënë ai, është «thagmë», dhe shton se «Maoja duhet vënë pas Marksit dhe Leninit». Kush ia kundërshtoi atij që ta vërë? Por ne, nga ana jonë, vëmë Marks-in, Engels-in, Lenin-in dhe Stalin-in. Ky përsëri është provokim, dhe me këtë Hilli kërkon të na imponojë neve maocedunidenë. Megjithatë, akuzon pa baza e pa fakte se «Partia e Punës e Shqipërisë kërkon t'u imponojë mendimet e saj edhe të tjerëve».

d) Hilli shpif se në Kongres ne paskemi bërë diskriminacion ndaj partive të Vietnamit, Koresë dhe Laosit dhe shton se, në lidhje me këto parti, ka shumë gjëra për të thënë, sepse nuk është dakord me to.

dh) Hill «komunisti» nuk është dakord me vlerësimin që Partia jonë i bëri Kominternit dhe gjoja analizon (në një faqe) se Dimitrovi «ka gabuar» dhe «është kritikuar nga Stalini».

Sa i ulët është ky njeri që, për të nxirë veprën e Kominternit, thotë se Torezi, Toliati, Dykloi, Sharki (që të tërë tradhtuan) erdhën rastësisht në Komintern! Ai mohon, me fjalë të tjera, rolin që ka luajtur Kominterni në forcimin e partive komuniste të botës dhe tërthorazi do të thotë: «Ja, ato parti që ndihmoi Kominterni, tradhtuan».

Ambasadori ynë thotë, gjithashtu, se Hilli jep edhe konsideratat e tij «për situatën ndërkombëtare», të cilat vijjnë në kundërshtim me analizën e Kongresit tonë. Por të gjitha këto çështje do t'i sqarojmë më mirë, kur të marrim letrën e tij. Unë mund të them vetëm këtë se

Hilli vepron si revizionist dhe si provokator. Ne asgjë-kundi nuk përdorim asnjë kritikë për Kinën dhe as për Maon, asnjëherë nuk kemi folur për ta me Hillin. Ato çka folëm në Kongres, folëm edhe në një bisedë që patëm me të, një apo dy vjet më parë, ku as Kinën, as Maon, nuk i zumë fare në gojë për keq veçse për mirë. Hilli, si herën e parë, edhe të dytën, u tregua hipokrit, nuk guxoi të shfaqte mendimet e tij dhe të diskutonim shoqërisht. Siç po del, ai kishte ardhur «për të blerë» dhe për të çuar në Kinë. Këtej, siç duket, Hilli ka pasë marrë edhe drejtimet e veprimit të tij. Ai është vënë që të provokojë, që ne të hapim polemikën me të për një parti të tretë, për Partinë Komuniste të Kinës. Ne nuk biem në atë batak. Kjo manovër e tyre trockiste është e njohur për ne që në kohën e Hrushovit, i cili vinte Zhivkon dhe Kadarin të na provokonin.

Duket taktika e kinezëve. Ata na bënë neve «një notë verbale», me të cilën na akuzojnë se «kemi sulmuar vijën e Partisë Komuniste të Kinës dhe strategjinë e Mao Ce Dunit» dhe kaq, duke theksuar se «nuk do t'u përgjigjemi akuzave, se nuk duam të futemi në polemikë». Kurse, nga ana tjetër, përdorin Hillin, mundet edhe të tjerë, me anën e të cilëve ne të bëjmë polemikë për çështjen e Kinës. Kjo ka për qëllim të çajë lëvizjen revolucionare dhe unitetin e partive komuniste marksiste-leniniste. Një gjë të tillë ata e kanë bërë me kohë me një numër partish komuniste marksiste-leniniste, me të cilat i kanë prishur lidhjet dhe këto lidhje i mbajnë me turli grupe provokatorësh që vetëquhen «maoiste». Nga ana tjetër, duke bërë këtë lojë, ata përpiqen të izolojnë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe të ulin autoritetin e saj të madh.

Ne duhet të jemi vigjilentë në këtë drejtim, të ruhem nga provokatorët, dhe të mbrojmë me të gjitha forcat vijën e drejtë të Partisë sonë dhe pastërtinë e marksizëm-

-leninizmit. Kinezët revizionistë dhe lakenjtë e tyre do të diskreditohen dhe do të dështojnë.

Ne duhet t'i përgjigjemi letrës së Hillit, duke i thënë se nuk do të ketë kurrë përgjigje nga ne për çdo çështje që ka lidhje me një parti të tretë motër. Ne do t'i rrëzojmë një nga një pikëpamjet e tij antimarksiste. Këtë do ta bëjmë me ton shoqëror, siç ka vepruar kurdoherë Partia jonë, dhe me këtë t'i tregojmë se ai nuk ka të drejtë që përmend diku fjalën «me pasion», siç na akuzoi Hrushovi. Për ato çështje për të cilat ai ka një mendim të tij, është i lirë ta ruajë dhe ta mbrojë atë mendim.

E ENJTE
16 DHJETOR 1976*

AGJENTËT E KINËS PO I NXJERRIN VESHËT

Duke u bazuar në një përmbledhje të shkurtër që ambasadori ynë në Paris i bëri letrës së kryetarit të Partisë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste), E. Hillit, në Ditarin tim kam bërë disa shënime. Në përgjithësi, këto u përgjigjen çështjeve që pasqyrohen në përkthimin e përmbledhur që na dërgoi ambasadori.

Tash na ra në dorë gjithë materiali i dërguar prej Hillit. Ai shoqërohet me një letër të shkurtër drejtuar shoqut Ramiz. Ky material prej 15 faqesh është shkruar me një stil konciz, me një ngjyrë gjoja teorike, me citate etj. dhe në një kohë rekord prej një dite, pas largimit të Hillit nga Tirana në Londër. Kjo të lë të dyshosh shumë se materiali duhet të jetë përgatitur prej tij ose prej ndokujt tjetër që më përpara, bile disa nga «tezat» e tij kryesore edhe përpara se Hilli të vinte në Kongresin tonë. Materialin, sa mbërriti Hilli në Londër, do ta ketë gjetur të gatshëm dhe, të nesërmen, e ka përcjellë menjëherë me gruan e tij në Paris për t'ia dorëzuar ambasadorit tonë.

Qëllimet e autorit, të cilat i kam shprehur në këtë Ditar, përpara se të na vinte teksti i plotë i materialit, pavarësisht se përkthimi ishte i dobët dhe ambasadori ynë na dërgoi vetëm një përmbledhje të tij, janë të kuptueshme për ne. Tani, duke e lexuar tekstin e tij të plotë, del akoma më qartë se thelbi kryesor i pikëpamjeve të Hillit qëndron në atë që Partia e Punës e Shqipërisë nuk paska

pasur të drejtë të shtronte pikëpamjet e veta në Kongresin e 7-të për sa i përket lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ai lë të kuptohet në material se nuk i përkiste Partisë së Punës të Shqipërisë ta bënte një gjë të tillë.

Hilli na shkruan se në raportin e Komitetit Qendror të Partisë sonë ne i bëjmë një analizë veprimtarisë së Kominternit, analizë që, sipas mendimit të tij, nuk qenka e drejtë. Lidhur me këtë çështje, jo pa qëllim, ai lë në heshtje atë që theksojmë ne në raport, se aty nuk kemi aspak për qëllim të bëjmë analizën e veprimtarisë së Kominternit, por dëshirojmë të themi vetëm se përpara rrezikut të madh që u kërcënohet partive komuniste marksiste-leniniste nga ana e revizionizmit modern dhe dy superfuqive, ato duhet medoemos të bëjnë mbledhje jo vetëm dypalëshe, por edhe shumëpalëshe, ku të diskutohen problemet e përbashkëta. Vumë, gjithashtu, në dukje se, me punën që pati bërë në kohën e vet, Kominterni kontribuoi shumë në forcimin e partive të reja marksiste-leniniste. Më së fundi në raport ne theksuam qartë se nuk është në asnjë mënyrë koha që të krijohet sot një organizatë e tillë ndërkombëtare si ajo e Kominternit. Ne nuk kemi qenë, as nuk jemi për një gjë të tillë, por mbledhjet e përfaqësuesve të partive marksiste-leniniste duhet të bëhen një praktikë e zakonshme.

Nga ky konkluzion i bërë prej nesh, Hilli del me mendimin se pikëpamja jonë për të bërë mbledhje shumëpartish, ka për qëllim «të sjellë në rrugë të drejtë Partinë Komuniste të Kinës». Hilli sikur na tërheq vërejtjen që ne mendojmë se Partia Komuniste e Kinës po devijon. Për këtë ai nuk ka asnjë fakt, sepse në Kongresin tonë ne nuk e atakojmë Partinë Komuniste të Kinës, pavarësisht nga mendimet që kemi për shumë pikëpamje dhe qëndrime të saj. Përkundrazi, është Hilli ai që atakon me këtë rast Kominternin, duke e akuzuar se ai ka bërë gabime të rënda, të cilat, sipas tij, i paska njohur edhe

Lenini. Ai na akuzon edhe ne duke na thënë se nuk mund të shfajësohet Kominterni me aq pak sa folëm ne për të në Kongresin e 7-të të Partisë sonë, ku pohojmë se nuk përjashtohet që ai të ketë bërë gabime. Zoti Hill do të dëshironte që në raport ne t'i analizonim se ku kanë qenë gabimet e Kominternit dhe sa të rënda kanë pasë qenë ato. Por nuk ishte aspak rasti ta bënim ne një gjë të tillë. Megjithatë Hilli e ka qëllimin gjetkë.

Njëkohësisht me Kominternin Hilli atakon edhe Dimitrovin. Sipas tij, Dimitrovi paska bërë gabime, se fjalimi i tij i famshëm qenka kritikuar nga Stalini, mbasi atje nuk flitej për diktaturën e proletariatit. Siç dihet, Dimitrovi në këtë fjalim zhvilloi tezën e luftës kundër fashizmit. Ai foli për nevojën e krijimit të fronteve popullore me elementë dhe parti progresiste, me qëllim që t'i pritej hovi rrezikut të fashizmit gjerman dhe italian që në atë kohë bëhej kërcënues për popujt. Ne gjer më sot nuk dimë që Stalini ta ketë kritikuar fjalimin e Dimitrovit për këtë çështje.

Nga ana tjetër, Hilli del me përfundimin se Dimitrovi me këtë fjalim «ka shkaktuar konsekuenca të mëvonshme në devijimin dhe në degjenerimin e partive marksiste-leniniste» dhe përmend këtu ish-udhëheqësit e këtyre partive, si Toliatin, Torezin, Harri Politin, Sharkin e të tjerë. Ai harron se fjalimi i Dimitrovit pati bërë një jehonë jashtëzakonisht të madhe në atë kohë në të gjithë botën, harron se ai u dha një hov të madh luftës kundër fashizmit dhe krijimit të fronteve popullore në Francë e veçanërisht në Spanjë, të cilat u rezistuan politikisht dhe me armë fashizmit gjerman edhe atij italian. Hilli harron, gjithashtu, se këto fronte dhe luftën që propagandonte Kominterni kundër fashizmit i organizonin partitë komuniste të Perëndimit. Më vonë, kur vendet e tyre u pushuan nga nazifashizmi, borgjezia reaksionare e këtyre vendeve kapitulloi dhe në mal nuk dolën dhe nuk luftuan

veçse partizanët francezë dhe ata italianë. Ai harron të thotë se në luftën e Spanjës as Toliati, as Dykloi, as Martia, as Longoja nuk tradhtuan, por luftuan kundër fashizmit në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e Kominternit.

Kështu kritika e Hillit kundër Kominternit, që paraqitet gjoja reale dhe e bazuar, është një filluskë sapuni. Ai e lufton Kominternin se mendon që ne synojmë të marrim flamurin e tij dhe të organizojmë partitë marksiste-leniniste të botës kundër Partisë Komuniste të Kinës. Kjo duket në kundërshtimin që ai i bën idesë që hodhëm në në Kongres për mbledhje shumëpalëshe. Sipas tij, mundet dhe duhet të bëhen vetëm mbledhje dypalëshe.

Hilli, gjithashtu, del kundër Partisë sonë edhe për një çështje tjetër. Sipas tij, partitë marksiste-leniniste motra të mos ftohen në kongreset e njëra-tjetrës. Argumenti «teorik» që sjell ai kundër kësaj praktike është se këto parti, në kongresin e partisë që i thërret, vihen në pozita të vështira përpara pikëpamjeve të partisë mikpritëse dhe nuk qenkan në gjendje të shprehin aty për aty mendimet e tyre për to. **Pra, sipas tij, as mbledhjet shumëpalëshe të partive marksiste-leniniste nuk janë me vend, po ashtu në kongresin e një partie motër nuk duhet të marrin pjesë përfaqësues të partive të tjera.** Këtëj Hilli del me konkluzionin se personalisht ai dhe partia e tij janë kundër praktikave të tilla, dhe, po ta dinte se në Kongresin tonë të 7-të do të shtroheshin ato probleme që u shtruan, ai do të mendohej para se të vinte që të merrte pjesë në këtë Kongres.

Historikisht çështja me Hillin qëndron kështu: **Një vit e gjysmë a dy vjet më parë, me saktësi nuk e për-caktoj dot, ne kemi pasur një bisedim dypalësh me të, gjatë të cilit shtjelluam të gjitha ato pikëpamje që shtruan edhe në Kongresin e 7-të të Partisë sonë. Ai nuk foli veçse 10 minuta dhe as i preku fare çështjet kardinale që**

shtruan ne me këtë rast me të dhe që përbënin vijën e Partisë sonë, të cilën ne e shtruan edhe në Kongres. Pra blofi i tij është i qartë. Hilli në atë kohë ose ka pasur frikë, ose nuk ka dashur të shprehë haptazi pikëpamjet e tij kundër Partisë sonë dhe i kaloi çështjet pa mbajtur asnjë qëndrim. Kështu që teza e tij se është për bisedime dypalëshe nuk qëndron, sepse edhe në bisedimin dypalësh që bëmë ne së bashku me të, ai nuk shfaqti nga ana e vet asnjë mendim kritik kundër pikëpamjeve të Partisë sonë.

Hilli shqetësohet pse nuk ndjekim vijën politike, ideologjike dhe organizative të Partisë Komuniste të Kinës, pse dalim nga radha me të. Sipas tij, ne duhet të jemi të bindur në vijën e kësaj partie. Personalisht ai përpiqet të hiqet si «shumë independent», me duar «të zgjidhura», kurse të gjitha partitë e tjera komuniste marksiste-leniniste motra që dërguan përfaqësuesit e tyre për të marrë pjesë në Kongresin e Partisë sonë dhe që shprehën fjalët më të mira për vijën e saj, ai i konsideron si parti lake. Qëndrimi që mbajtën ato parti në Kongresin e 7-të të Partisë sonë, sipas Hillit, nisej vetëm nga qëllimi për t'i bërë qejfin Partisë së Punës të Shqipërisë. Me fjalë të tjera, Hilli do që të tregojë se, edhe ato që ai vetë tha personalisht në Kongresin tonë, nuk përfaqësojnë mendimet e tij, sepse mendimet e tij të vërteta janë të shprehura në materialin që na dërgoi nga Londra, ku thotë se nuk pajtohet me shumë pikëpamje bazë të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Hilli ka pikëpamjen se çdo parti duhet të bëjë kongresin e saj, por, sipas tij, ajo nuk duhet të flasë atje veçse për misrin, për kungujt dhe për kastravecat, e jo të mbajë qëndrime politike dhe ideologjike, jo të shfaqë mendime kritike ndaj njërës ose tjetrës. Kjo do të thotë se partia që bën kongresin, duhet të mos jetë e sigurtë në shprehjen e pikëpamjeve të saj marksiste-leniniste. **Hilli dëshiron që të gjitha partitë marksiste-leniniste të botës**

të ndjekin pa asnjë kundërshtim vijën e Partisë Komuniste të Kinës. Për të, vetëm në këtë rast, çdo gjë është në rregull nga ana e atyre partive.

Nga njëra anë, Hilli hiqet si mbrojtës i pikëpamjes se çdo parti ka të drejtën të shprehë mendimet e veta; nga ana tjetër, ai bie në kontradiktë me veten, kur thotë se partia nuk ka asnjë të drejtë t'i shpallë botërisht mendimet e saj. Fakt është se në materialin që na dërgon, ai kritikon kapitullin e pestë dhe të gjashtë të raportit të Komitetit Qendror të Partisë sonë, ku bëhet fjalë për situatën ndërkombëtare dhe për disa probleme të lëvizjes komuniste botërore. **Kjo u djeg shumë atij dhe miqve të tij. U djeg, nga njëra anë, për arsye se, siç e dimë, në këta dy kapituj parashtrohet gjerësisht dhe qartësisht vija jonë marksiste-leniniste, e cila bie në kundërshtim me shumë pikëpamje të Partisë Komuniste të Kinës, megjithëse nga ana jonë në asnjë vend nuk flitet me emër kundër kësaj partie.** Nga ana tjetër, Hilli nuk është dakord që një parti si jona të marrë mundimin të thotë mendimin e saj për luftën që bëjnë e duhet të bëjnë partitë e tjera marksiste-leniniste, për metodat e punës së tyre, për aleancat e tyre në luftën që bëjnë dhe për të tjera probleme që dalin nga përvoja e fituar.

Hilli thotë se pjesëmarrja e partive të tjera në kongreset e partive motra i komprometon ato. Ky është një bluf. Një praktikë e tillë ato nuk i komprometon aspak. Ja, për shembull, u komprometuan gjë partitë e Vietnamit, të Koresë apo të Laosit në Kongresin e Partisë sonë? Jo! Delegacionet e tyre i shprehën pikëpamjet që kishin fare lirisht në Kongres dhe ne mendojmë se, po të kishin kundërshtime me Partinë tonë, fare lehtë ato mund të kërkonin edhe takim me udhëheqësit tanë, ku të shpjegoheshin për mendimet e kundërta që mund të kishin me ne. Ato nuk e bënë këtë. Në rast se kanë pasur gjë për të thënë e nuk e thanë, për këtë faji nuk është yni.

Ne jemi dakord se, siç thotë Hilli, gjatë zhvillimit të Kongresit këto vërejtje nuk mund të bëhen, por nuk kemi kundërshtim që, në qoftë se dikush nuk dëshiron të bëjë elozhe për veprimtarinë dhe për qëndrimet e partisë mikpritëse, le të mos bëjë. **Zaten Partia jonë nuk i dëshiron elozhet e tepruara që i bëhen, por kërkon të flitet realisht për veprimtarinë e saj.** Bile në qoftë se ndonjëri do të kishte vërejtje për të na bërë, siç thashë më sipër, fare lehtë mund të kërkonte një takim me ne dhe të bëheshin sqarime në mënyrë dypalëshe për çështjet që e preokupojnë. **Këtë gjë as Hilli nuk e bëri.**

Ai pretendon se pjesëmarrja në punimet e kongresit të një partie i vë në pozita të vështira partitë e tjera komuniste të ftuara, por, ne mendojmë se nuk i vë aspak në vështirësi, përkundrazi përfitimet nga pjesëmarrja në këto raste mbizotërojnë. **Këto përfitime i përcakton edhe Hilli, por ai i nënvleftëson këto dhe mbivlerëson shumë pikëpamjen që kërkon të mbrojë, sipas së cilës nuk u duhen bërë ftesa partive të tjera në kongrese. Kjo do të thotë të bësh kongres në një vazo të mbyllur, që të mos të marrë vesh njeri ç'mendon. Dëshira e zjarrtë e revizionistëve modernë, e sovjetikëve, njëkohësisht edhe dëshira e zjarrtë e imperialistëve është që këta të lihen të gjithë në rehati, të mos flitet nga ana jonë për veprimtarinë që zhvillohet kundër komunizmit, kundër popujve, kundër vendeve socialiste. Ky është i tërë përfundimi që mund të nxirret nga një trajtim i tillë antimarksist i këtij problemi që ngre Hilli në materialin që na dërgon, në të cilin ai merr pozicion të hapët kundër Kongresit të 7-të të Partisë sonë.**

Në lidhje me këtë çështje Hilli përpiqet të shtrembërojë realitetin për sa i përket qëndrimit të Çu En Lait në Kongresin e 22-të të partisë revizioniste sovjetike. Në të vërtetë Çu En Lai në Kongresin e 22-të kërkoi të pushohej polemika kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, gjë

që ishte e padëshirueshme nga ana jonë dhe nga shumë të tjerë. Drejtësinë e qëndrimit të Partisë sonë tashmë e ka vërtetuar koha. Çu En Lai, gjithashtu, u largua nga Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në shenjë proteste jo për arsye se aty u sulmua Partia e Punës e Shqipërisë, por sepse ekzistonin mosmarrëveshje për probleme të brendshme strategjike të mëdha në mes Partisë Komuniste të Kinës dhe asaj të Bashkimit Sovjetik, siç janë mosdhënia e bombës atomike Kinës, problemi kufitar me Indinë etj., etj. Qenë pikërisht këto probleme midis të dyja palëve që e bënë Çu En Lain të largohej nga Kongresi i 22-të. Këto preokupacione e shpresa e bënë atë më vonë, pas rrëzimit të Hrushovit më 1964, që të kërkonte të shkante përsëri në Bashkimin Sovjetik dhe të lidhte miqësi me revizionistët sovjetikë. Prandaj shembujt dhe tezat e Hillit nuk kanë asnjë vlerë, as historike, as teorike, as praktike.

Sipas Hillit, një parti, kur ka ndër mend të shtrojë një problem me karakter ndërkombëtar që i intereson gjithë lëvizjes komuniste në botë, duhet të bëjë më parë një xhiro të madhe, të marrë kontakte e të zhvillojë biseda të dyanshme me një numër të madh partish marksiste-leniniste dhe vetëm në rast se do të bien dakord për këtë ose për atë çështje, atëherë mund ta shtrojë këtë ose atë problem në kongresin e vet, kurse, në qoftë se do të gjejë kundërshtime, nuk duhet ta shtrojë fare. **Kjo është një nga pikat kryesore të kritikave absurde dhe antimarksiste të këtij provokatori revizionist australian, i vënë apostafat nga revizionistët kinezë për të provokuar Partinë e Punës të Shqipërisë.**

E thashë më parë se Partia Komuniste e Kinës dhe provokatori Hill nuk deshën dhe nuk duan që Partia e Punës e Shqipërisë të shprehë pikëpamjet e veta se si duhet forcuar uniteti ndërkombëtar i komunistëve dhe i proletarëve. Ata janë në kundërshtim me këtë. **Mirëpo**

uniteti internacionalist i proletariatit dhe i partive marksiste-leniniste është një problem i madh i marksizëm-leninizmit. Edhe Partia Komuniste e Kinës e ka hedhur këtë parullë, por, në fakt, në praktikë është kundër saj dhe e lufton. Këtë moto të madhe ajo e ka inkuadruar në unitetin e «botës së tretë», ku është inkluduar edhe vetë. Ne nuk mund të pajtohemi me asnjë pikëpamje të tillë, as me qëndrimin që mbahet.

Me pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës mbi «botën e tretë», ne jemi në kundërshtim, pse ato janë antimarksiste, janë pikëpamje revizioniste. Ne e trajtuam këtë problem në Kongresin e 7-të në prizmin klasor, në bazë të ideologjisë sonë, të marksizëm-leninizmit. Parullën e «botës së tretë» e kanë përdorur që përpara vitit 1960 edhe Hrushovi, edhe Titoja, me emra të ndryshëm, si «vendet e paangazhuara» etj., që Partia jonë i ka luftuar si nocione, si grumbullime të shikuara e të sajuara jashtë kriterit klasor. Partia jonë e shpjegoi në Kongresin e 7-të se ajo është për mbrojtjen e të gjitha shteteve që janë shpallur të lira dhe të pavarura, por që në fakt ekonomikisht dhe politikisht janë të varura. Pak shtete të «botës së tretë» mund të quhen të pavarura, sepse, në fakt, në një mënyrë ose në një tjetër, secili prej tyre është i varur nga kjo ose ajo fuqi imperialiste. Edhe në qoftë se quhet i pavarur politikisht, është i varur ekonomikisht, dhe, sipas mësimëve të klasikëve tanë të shkencës marksiste-leniniste, po të jesh i varur ekonomikisht, s'mund të jesh i pavarur as politikisht. Ne jemi për mbrojtjen me të gjitha forcat tona të këtyre shteteve dhe jeta ka treguar se luftën në mbrojtjen e tyre ne e kemi bërë vazhdimisht e me vendosmëri, por ne nuk mund të jemi dakord me konkluzione të tilla «teorike», që ka arritur Partia Komuniste e Kinës. Pikërisht këtu qëndron një nga kundërshtimet tona kryesore me të.

Kundërshtimet tona kryesore me kinezët janë për çë-

shtje që lidhen ngushtë njëra me tjetrën: për çështjen e «botës së tretë», për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj dy superfuqive dhe për «internacionalizmin proletar», domethënë për forcimin e unitetit të partive komuniste marksiste-leniniste. Partia Komuniste e Kinës, sipas mendimit tonë, i shikon këto çështje në rrugë oportuniste, revizioniste, kurse ne i shikojmë në rrugën marksiste-leniniste. Ne jemi për internacionalizmin proletar, për forcimin e unitetit me partitë marksiste-leniniste, si dhe për një ndihmë sa më të madhe e të vazhdueshme për të gjitha vendet e së ashtuquajturës botë e lirë dhe e pavarur, por që në fakt është e varur dhe nën influencën e kapitalit amerikan, sovjetik etj. Që këto vende të mund të arrijnë në çlirimin e plotë të tyre, siç thotë Lenini, duhet të luftojnë më përpara armikun në vendin e vet, pastaj edhe armikun e jashtëm. Ne themi se duhet luftuar me të gjitha forcat revizionizmi modern, duhet luftuar, gjithashtu, edhe borgjezia reaksionare, që e var lirinë dhe pavarësinë e vendit të vet në qafën e imperializmit amerikan ose të socialimperializmit sovjetik. Prandaj ne mendojmë se është e domosdoshme të luftohet me të dyja këto superfuqi, kurse kinezët nuk e shikojnë çështjen në këtë platformë.

Një çështje tjetër që shtjellon Hilli, është konkurrenca që gjoja, pa e shpallur, po bëhet në mes Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Viktimat e kësaj loje qenkan të gjitha ato parti marksiste-leniniste që janë krijuar si reaksion kundër revizionizmit modern. Sipas Hillit, ato parti marksiste-leniniste që flasin mirë për Partinë e Punës të Shqipërisë, janë parti lake, parti që duan t'i bëjnë qejfin Partisë sonë. Ai e shtron çështjen në këtë mënyrë: të gjitha ato parti marksiste-leniniste që kanë dashuri, respekt dhe janë dakord në pikëpamjet teorike dhe politike të tyre me Partinë e Punës të Shqipërisë, nuk janë parti të vërteta marksiste-

-leniniste. Sipas Hillit, vetëm partia e tij qenka «e kulluar dhe marksiste-leniniste!».

Hilli thotë se partitë e reja marksiste-leniniste përpiqen si e si të njihen. Po nga kush, nga Partia e Punës e Shqipërisë? Për Hillin lidhjet e këtyre partive me Partinë Komuniste të Kinës janë rruga më e drejtë dhe e domosdoshme, prandaj këtë rrugë duhet të ndjekin. Por shumë prej tyre kërkojnë të njihen edhe nga Partia e Punës e Shqipërisë, dhe ai tjerr gjoja anën teorike, se nga kjo lind pastaj çështja e partisë «mëmë» dhe e partisë «bijë». Kjo, sipas Hillit, do të thotë se Partia e Punës e Shqipërisë i jep të drejtën vetes të përcaktojë se cila nga partitë e reja është marksiste-leniniste dhe cila nuk është marksiste-leniniste.

Ku synon të dalë Hilli me këtë? Ai me këtë përpiket të dëmtojë unitetin internacionalist të partive komuniste marksiste-leniniste të botës, përpiket ta shpartallojë këtë unitet dhe t'ia lërë spontaneitetit forcimin dhe zgjerimin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Për sa i përket pozitës së Partisë sonë në lëvizjen komuniste botërore, ajo kurrë dhe asnjëherë nuk e ka konsideruar veten si një parti «mëmë» dhe partitë e tjera si parti «bija». Partia jonë kurrë dhe në asnjë rast nuk ia ka imponuar mendimet e veta ndonjë partie motër, bile vazhdimisht, sa herë që ne kemi rast të bisedojmë dhe t'u shprehim mendimet tona shokëve përfaqësues të partive të tjera motra, u bëjmë atyre të njohur se cilat janë pikëpamjet tona për këtë ose për atë problem, cila është përvoja që kemi ne, pastaj secila parti ka mendimet e veta të pavarura, gjykon e vendos vetë mbi çdo gjë.

Mbi të gjitha, ne vazhdimisht kemi theksuar dhe theksojmë se çdo mendim dhe çdo veprim i partive motra duhet të bazohet në marksizëm-leninizmin dhe vetëm në marksizëm-leninizmin. Kjo është e drejtë. Këtë e theksuam ne me forcë edhe në Kongresin e 7-të. Por Hillit

kjo nuk i leverdis dhe nuk i leverdis pikërisht për arsye se Partia e Punës e Shqipërisë nuk mendon ta barazojë marksizëm-leninizmin me maocedunidenë, se Mao Ce Dunin ne nuk e kemi vënë në radhën e katër klasikëve të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Hilli është në kundërshtim me këto pikëpamje e qëndrime të Partisë sonë dhe flet në çdo rast për Maon, i bën këtij ditirambe të mëdha, pa i njohur si duhet pikëpamjet e tij për të gjitha problemet, në mjaft nga të cilat, siç e dimë, ai ka gabuar. Maoja për ne nuk është një marksist i vërtetë. Këtë pikëpamje ne nuk e kemi deklaruar, por bindja jonë kjo është, kurse bindja e Hillit është e kundërt me tonën.

Për t'ia rritur vlerën Mao Ce Dunit, Hilli sulmon me këtë rast Engelsin, duke thënë se ky ka gabuar, prandaj ka rënë nga rangu i të katërve. Të njëjtën pikëpamje ka Hilli edhe për Stalinin. Në vend të këtyre dy marksistëve të mëdhenj, Engelsit dhe Stalinit, ai ngre Maon dhe thekson se ky është një marksist-leninist në përmasat e Marksit dhe të Leninit. Ashtu sikundër në kohën e vet Lenini ka pasuruar marksizmin, teorinë e Marksit, po kështu, sipas Hillit, e ka pasuruar atë edhe Maoja gjatë jetës së tij. Këtu qëndron thelbi i gjithë teorisë së Hillit që na e shtron neve në materialin e tij me terma gjoja miqësorë, por që, në fakt, janë sulme, shpifje dhe kritika të pabazuara jo vetëm kundër Partisë sonë, por edhe kundër Kominternit, kundër Engelsit, Stalinit dhe Dimitrovit. Po kështu mund të themi edhe për të tjera çështje, pse ka edhe mjaft teza të tjera antimarksiste në letrën e këtij demagogu revizionist.

Hilli vë në dukje se krizën botërore ne gjoja nuk e shikojmë si duhet, se kjo, sipas tij, nuk është një krizë e përgjithshme e sistemit botëror kapitalist, por një krizë superprodhimi dhe këtë ai gjoja e mbështet në teorinë e Marksit. Me një fjalë, veç akuzave të tjera pa baza që

bën kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, ai përpiqet të futë edhe disa kritika, gjoja teorike, për sa i përket përcaktimit të disa problemeve të mëdha ndërkombëtare, njëra prej të cilave është edhe kriza e tanishme botërore e kapitalizmit.

Si konkluzion mund të themi se është e qartë që provokatori Hilli erdhi në Kongresin tonë të 7-të jo pa qëllime. Por këto qëllime që i kishte vënë vetes, ai nuk i arriti dot në sallën e Kongresit. Atij iu desh të merrte avionin, të largohej nga vendi ynë dhe të na e dërgonte nga Londra këtë material me përmbajtje revizioniste. Prej andej ai u kthye pastaj në Australi dhe menjëherë, pa humbur fare kohë, u degdis në Pekin, ku, siç jemi në dijeni, iu bë një pritje shumë e nxehtë. Atë e pritën me radhë që nga Li Hsien Nieni dhe deri te Hua Kuo Feni. Hilli i bëri vizitë bile edhe gruas së Çu En Lait. Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi për pritjen që iu bë Hillit nga Hua Kuo Feni, për bisedimet e përzemërta që bënë me të lidhur me shumë probleme ndërkombëtare dhe theksoi se, për të gjitha, të dyja palët kanë qenë plotësisht të një mendimi.

HSINHUA-ja transmetoi edhe fjalimin e shkurtër të Li Hsien Nienit në këtë pritje, nëpërmjet të cilit hipokritët kinezë folën me terma korrektë, duke u përpjekur të vënë në dukje se Partia Komuniste e Kinës është kundër dy superfuqive, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai flet edhe për internacionalizmin proletar, pa harruar të vërë në dukje miqësinë e Partisë Komuniste të Kinës me Partinë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste) dhe me popullin e Australisë.

Pas Li Hsien Nienit, me këtë rast, e mori fjalën Hilli, i cili tërthorazi sulmoi Kongresin e 7-të të Partisë sonë. Ai vuri në dukje se Hua Kuo Feni ka vepruar si një «marksist-leninist i madh», si nxënës besnik i Mao

Ce Dunit, të cilin, siç thashë, e ngre në përmasat e Marksit dhe të Leninit. Hua Kuo Feni, thotë Hilli në fjalimin e tij, shpartalloi në masë elementët tradhtarë, me «katërshen» në krye. Ai nënvizon se vija që ka diktuar Mao Ce Duni, është vija e vërtetë marksiste-leniniste, teoria marksiste-leniniste është maocedunideja dhe nënvizon se ata elementë ose ato parti që e kundërshtojnë këtë vijë, që kundërshtojnë maocedunidenë, do të shpartallohen, siç u shpartallua «katërshja» me shokët e vet nga Partia e madhe Komuniste e Kinës, dhe përfundon se partitë marksiste-leniniste të botës do të ndjekin me besnikëri vijën e drejtë marksiste-leniniste të kryetarit Mao Ce Dun.

Këto thotë, me pak fjalë, në fjalimin e vet kryetari i partisë revizioniste prokineze australiane. Këto ide janë shprehur edhe në materialin që ai na ka dërguar neve. Ai me këtë dokument tregoi kështu fytyrën e tij të vërtetë prej renegati. Me këtë rast u vërtetua deduksioni ynë se Partia Komuniste e Kinës do të përpiqet të nxitë një-rëz të tillë që ta sulmojnë tërthorazi vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë për të dëmtuar në këtë mënyrë unitetin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për të shtrembëruar marksizëm-leninizmin e vërtetë, për të çoroditur proletariatin dhe për të shpartalluar partitë marksiste-leniniste në të gjitha vendet e botës. Zaten këtë punë e kanë filluar me kohë kinezët.

Për sa i përket asaj që thotë Hilli, se partitë komuniste marksiste-leniniste të botës konkurrojnë të marrin njohjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, në realitet është Partia Komuniste e Kinës që e kërkon dhe e praktikon një gjë të tillë, është ajo që mban lidhje me të gjitha ato fraksione që dalin nga gjiri i atyre partive të reja komuniste marksiste-leniniste, të cilat mbajnë qëndrim të drejtë; është ajo që nxit të dalin të tilla fraksione në shumë nga këto parti të reja, siç janë ajo e Portugalisë,

e Italisë, e Uruguait, e Francës etj., etj. Partia Komuniste e Kinës vepron haptazi dhe fshehtazi në këtë drejtim, me qëllim që të gjitha këto parti t'i përçajë dhe të krijojë nga fraksionet që lindin në gjirin e tyre, një sërë grupesh maoiste, që gjoja janë marksiste-leniniste, me qëllim që t'i përdorë si agjenturat e veta.

Hilli, në letrën që na ka dërguar, akuzon Kominternin dhe Stalinin se i kishin vënë partitë komuniste dhe punëto-re të botës para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore në shërbim të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Këto parti, sipas Hillit, «nuk mund të vepronin dhe të luftonin në bazë të marksizëm-leninizmit», i cili, siç e dimë, zbatohej drejt nga Lenini, nga Stalini dhe nga Partia Bolshevike. Për Hillin ato nuk ishin gjë tjetër veçse agjentura të Partisë Bolshevike dhe të Stalinin. Kjo që thotë Hilli përputhet me tezat që propagandon borgjezia reaksionare botërore për të luftuar partitë komuniste dhe punëto-re të botës dhe për të diskredituar komunizmin.

Por teza që mbron Hilli, është e njëanshme. Për atë, të jesh i lidhur me maocedunidenë dhe me Partinë Komuniste të Kinës nuk do të thotë aspak se je një parti e varur nga Partia Komuniste e Kinës, ndërsa faktet tregojnë të kundërtën.

Hilli, pra, është një provokator, një agjent i kinezëve, prandaj nuk e meriton të flitet më shumë për të dhe për partinë e tij të ashtuquajtur marksiste-leniniste. Për këtë parti vihet pyetja nëse ekziston apo nuk ekziston fare. Se sa anëtarë ka kjo parti, ne asnjëherë nuk e kemi mësuar dot, por mendimi ynë është se kjo parti nuk ekziston as në numër, pa lëre që të ketë një ideologji të qartë marksiste-leniniste, e cila ta udhëheqë drejt në veprimtarinë e saj.

Këto shpjegime ua bëra sot shokëve sekretarë të Komitetit Qendror. Si përfundim u thashë atyre se Partia

e Punës e Shqipërisë duhet të parashikojë një luftë të ashpër nga ana e revizionistëve kinezë dhe e veglave të tyre. Taktika kineze tani është e qartë për ne. Përveç notës verbale që na dërguan, ne mendojmë se ata nuk do t'i përgjigjen letrës që do t'u dërgojmë. Qëndrimin që do të mbajnë ndaj nesh, ata e theksojnë që më parë në notën verbale të datës 8 dhjetor, ku thonë se nuk do t'u përgjigjen «akuzave» tona, por do të vazhdojnë miqësinë etj., etj. Në realitet, ata do të vënë të tjerët, si Hillin me shokë, që të na sulmojnë, por do të dështojnë kurdoherë.

Luftën kundër Partisë sonë revizionistët kinezë do ta fillojnë në dy drejtime: në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe brenda vendit tonë. Brenda vendit lufta e kinezëve do të marrë karakterin e sabotimit ekonomik. Ky sabotim do të konkretizohet me ngadalësimin e realizimit të kredive të kontraktuara zyrtarisht nga të dyja palët. Dërgimin e objekteve të parashikuara për planin e pesëvjeçarit të kaluar, siç e dimë, këto vitet e fundit, kinezët e kanë ngadalësuar pa masë. Ka nga këto objekte që duhej të përfundonin dy dhe tre vjet më parë, por ato akoma presin, sepse nuk na janë dërguar makineritë dhe pajisjet. Ky është një dëm shumë i madh që po i bëhet vendit tonë nga ana ekonomike.

Megjithatë, ne i kemi përballuar vështirësitë që na kanë krijuar kinezët, dhe nuk kemi folur botërisht për to. Por në të ardhmen ta kemi të qartë se një punë të tillë ata do ta bëjnë në mënyrë edhe më të theksuar. Udhëheqësit revizionistë kinezë synojnë që ne të mbushim sirtaret e tyre me letra proteste, të cilave, siç e kanë zakon, asnjëherë nuk do t'u përgjigjen. Mirëpo këto vepra të mëdha, për ndërtimin e të cilave ne kemi investuar djersën dhe gjakun e popullit tonë, natyrisht nuk do t'i lëmë gërmadha. Me aq sa do të mundemi, në mungesë përgjigjeje nga ana e kinezëve, ne do të marrim masa për realizimin e planit, duke u përpjekur që veprat të mba-

rohen me mundësitë dhe me mjetet tona. Kështu do të lindë konflikti i tyre me ne. Ata do të gjejnë rastin të na akuzojnë se «ju, me gjithë këtë ndihmë të madhe që po ju japim, nuk pritët sa të përfundonim ne eksperimentimin etj., etj., po vazhdoni t'i realizoni vetë këto vepra pa u marrë vesh me ne; atëherë edhe ne po i tërheqim specialistët». Kështu do të bëhet tërheqja e specialistëve dhe mosdërgimi i ndihmave nga ana e tyre. Natyrisht, kjo punë nga ata do të marrë karakterin e një lufte politike dhe ideologjike. Ne, nga ana jonë, do të përpiqemi që këtë luftë me ta të mos e hapim publikisht.

Por veprimtaria e revizionistëve kinezë kundër Partisë sonë do të bashkërendohet edhe me luftën që ata do të na bëjnë nga jashtë. Se si do të zhvillohet kjo luftë e tyre nga jashtë, ua shpjegova shokëve. Dy drejtimet e luftës kanë të njëjtin qëllim:

Së pari, të izolojnë Partinë e Punës të Shqipërisë nga gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare, në mënyrë që zëri i drejtë marksist-leninist i Partisë sonë të mos dëgjohej në këtë lëvizje.

Së dyti, të krijojnë grupime të ndryshme që vetëquhen «marksiste» dhe që përbëhen nga provokatorë, të cilët kanë dalë si rezultat i veprimtarisë së tyre përçarëse në radhët e partive komuniste marksiste-leniniste. Kinezët, ashtu siç bënë edhe hrushovianët, do të krijojnë të tilla grupime në favorin e tyre, të cilat do të financohen nga ata vetë, si dhe nga borgjezia e vendeve ku krijohen. Me këta provokatorë ata do të përpiqen të zhvillojnë një propagandë të shfrenuar kundër marksizëm-leninizmit; propaganda e tyre do të drejtohet veçanërisht kundër Partisë sonë dhe pro vijës revizioniste kineze. Do të ngjasë përsëri ashtu siç ngjau me hrushovianët. Kundër tyre në fillim u gjend në luftë të hapët vetëm Partia e Punës e Shqipërisë. Atëherë u gjend, gjithashtu, së bashku me ne, në luftë me hrushovianët edhe Partia Komuniste

e Kinës, por jo duke u nisur nga pozita të qarta marksiste-leniniste. Në disa momente të zhvillimit të ngjarjeve; kinezët sulmuan krah për krah me ne, pastaj ata devijuan dhe ky devijim i tyre nga marksizëm-leninizmi po vazhdon. **Në veprimtarinë aktuale revizioniste Partia Komuniste e Kinës ka për qëllim të krijojë parti të ashtuquajtura marksiste-leniniste, që ato të kthehen në shërbëtorë të revizionizmit kinez, kundër marksizëm-leninizmit.**

Detyra jonë është ta parashikojmë këtë luftë, qoftë në platformën e brendshme, qoftë në platformën e jashtme. Lufta jonë do të bëhet në bazë të marksizëm-leninizmit, që është teoria jonë, në bazë të orientimeve që ka dhënë Kongresi i 7-të i Partisë. Prandaj duhen pasur parasysh dhe në asnjë moment nuk duhen lënë pas dore ato çka u thashë dy ditë më parë shokëve në lidhje me përvetësimin si duhet të ideve që u zhvilluan në Kongres dhe të shpjegimit si duhet të problemeve që lidhen me to.

Shumë probleme themelore politike, ideologjike, ekonomike etj. që trajtojnë raportet e Kongresit, duhet të zërthehen dhe të gjitha këto të trajtohen, të zhvillohen e të bëhen sa më të kuptueshme për komunistët dhe për masat e gjera të popullit tonë. Ato të shërbejnë njëkohësisht në dy drejtime, edhe për jashtë, edhe për brenda vendit, me qëllim që t'u dalim kështu përpara qëllimeve djallëzore, armiqësore, antimarksiste të revizionistëve kinezë. Për këtë qëllim mendoj të krijojme grupe të caktuara me kuadro të kualifikuar që të mendojnë thellë e të nxjerrin teza për probleme të ndryshme, të cilat t'i shqyrtojmë, dhe ato teza të tyre që do të jenë racionale, t'i aprovojmë. Duke u trajtuar në mënyrë teorike dhe politike, këto teza të bëhen bazë e përgatitjes ideopolitike të kuadrove tanë komunistë dhe të masave të gjera të popullit. Gjithashtu këto materiale duhet të shtypen nga ne, të përkthehen e të dërgohen edhe jashtë për t'ua dhënë partive marksiste-leniniste si shpjegime të mëtejshme të

dokumenteve të Partisë sonë për problemet themelore që ngriti Kongresi i 7-të. Kështu, mendoj se do t'ia dalim si duhet punës në krye për t'i ardhur në ndihmë lëvizjes komuniste ndërkombëtare më përpara se agjentët e revizionistëve kinezë të veprojnë, për arsye se duhet parashikuar që në këtë luftë që po u bëjnë marksizëm-leninizmit dhe Partisë sonë, kinezët do të përdorin mjete të shumta dhe të fuqishme propagandistike.

Jam i sigurt se, në rast se do ta organizojmë luftën si duhet (dhe duhet absolutisht ta organizojmë sa më mirë këtë luftë, pse është një çështje jetike), ne do t'i demaskojmë revizionistët kinezë, edhe pa i zënë në gojë hap-tazi. Kjo nuk do të thotë që ne të mos i përgjigjemi njëfarë Hilli, iksi ose ipsiloni, të cilët, pa na përmendur fare me emër, do të sulmojnë në kor tezat e Kongresit tonë të 7-të. Ne do të gjejmë rastin apo momentin e volitshëm që përnjëherë t'u përgjigjemi të gjithë këtyre, ose atyre që do të kenë vënë revizionistët kinezë për të sulmuar tezat e Kongresit tonë të 7-të. Përgatitja që thashë më parë, i shërben kësaj çështjeje. Në rast se ata do të na sulmojnë me emër, atëherë edhe ne duhet të mendojmë nëse duhet të hyjmë në polemikë me njërin ose me tjetrin, apo nuk duhet të hyjmë në polemikë. Çështja është të marrim masa të menduara me kohë, që të shpjegojmë sa më qartë dhe të mbrojmë fuqimisht e në mënyrë të drejtë, marksiste-leniniste, tezat e Kongresit tonë. Mbrojtja e tyre bëhet duke shpjeguar qartë e duke zërtëruar në mënyrë sa më të kuptueshme çdo tezë, sepse ka dhe do të ketë njerëz në radhët e partive marksiste-leniniste që nuk i kuptojnë si duhet tezat tona. Bile shumë prej këtyre njerëzve qysh tani i kanë nxjerrë veshët, sepse në partitë ku bëjnë pjesë ata, ecet drejt rutinës, domethënë ecet me tezat e pompuara nga kinezët.

Siç e shohim, kinezët dhe Hilli në rrugën e tyre janë socialdemokratë. Ata nuk e kuptojnë se partitë komunis-

te marksiste-leniniste luftojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira kundër një borgjezie të armatosur deri në dhëmbë, kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern, me socialshovinizmin sovjetik në krye. Ata nuk e kuptojnë që duhet absolutisht të punojnë, të përgatiten dhe të praktikojnë të dyja format e luftës, edhe legalen, edhe ilegalen, dhe duhet të dinë si t'i kombinojnë që të dyja, ashtu siç na mëson Lenini. Kinezët me fjalë e pranojnë një gjë të tillë, por në realitet ata janë vetëm për forma pune të hapëta, socialdemokrate, pse, natyrisht, edhe vetë janë socialdemokratë, por të maskuar me parulla «marksiste-leniniste», që në fakt janë antimarksiste.

Cështja tjetër që duhet të parashikojmë ka lidhje me punën brenda vendit. Të mos shkojmë me mendimin se gjithë komunistët dhe masat e popullit tonë i shikojnë qartë situatat. Ne duhet, çdo ditë e më shumë, t'ua bëjmë mirë të qartë të gjithëve se, derisa ekzistojnë elementë armiq të klasës, këta do të punojnë si brenda në parti, ashtu edhe jashtë saj. Këta, natyrisht, do ta përdorin kartën kineze edhe me njerëz të mirë të popullit tonë, edhe me komunistë të pasqaruar mirë, pse fakt është që Partia jonë ka folur drejt dhe në përkrahje të Partisë Komuniste të Kinës, të popullit kinez dhe të Mao Ce Dunit, pavarësisht nga kontradiktat që kemi pasur me ta.

Kjo nuk do të thotë se ne tani do të fillojmë të flasin kundër Kinës, as kundër pikëpamjeve revizioniste të udhëheqësve kinezë, por duhet të shpjegojmë e të bëjmë mirë të qartë në njerëzit tanë tezat marksiste-leniniste të Kongresit të 7-të. Në rast se armiku i klasës do të orvatet t'i shfrytëzojë tërthorazi kontradiktat që kemi me Partinë Komuniste të Kinës dhe luftën që po i bëhet Shqipërisë nëpërmjet radiove të huaja, veprimtaria e tyre nuk do të zërë vend vetëm në rast se Partia do të bëjë një punë të mirë sqaruese, e cila, përkundrazi, do të

ndihmojë që të shtohet vigjilenca e komunistëve dhe e punonjësve dhe të përgatitet si duhet terreni për të përballuar ditë akoma më të vështira.

Problem tjetër për ne janë çështjet ekonomike. Në asnjë mënyrë nuk duhet të mendojmë se një luftë e tillë, që po na bëjnë Kina dhe satelitët e saj nuk do të ketë efekte negative për ne. Pasojat negative të kësaj pune ne duhet t'i paramendojmë me kohë, t'i parashikojmë dhe t'u dalim përpara. Kjo kërkon që, për sa u përket planeve, të mobilizohemi tërësisht për realizimin frontal të të gjitha detyrave të shumta pa përjashtim, në gjithë sektorët e ekonomisë dhe të jetës në vendin tonë.

Veçanërisht rëndësi të padiskutueshme merr në këto situata realizimi i detyrave në sektorin e bujqësisë dhe të minierave, në radhë të parë në nxjerrjen e naftës. Në naftë ne duhet të bëjmë kujdes të madh, të zbulojmë fusha të reja, të mos lejojmë të ndodhin avari, sepse, ta kemi të qartë, pa naftë do të na mbetet prapa çdo sektor i ekonomisë. Minerale të tjera na sigurojnë të ardhura të mira, qoftë duke bërë përpunimin e tyre brenda, qoftë edhe me eksportimin e tyre bruto. Por në drejtim të eksportimit të mineraleve armiqtë mundet edhe të na sabotojnë, duke shfrytëzuar, për shembull, qoftë edhe mefshtësinë e disa njerëzve tanë të tregtisë dhe të mos gjejmë dot treg.

Duhet të kuptojmë se ne nuk jemi një shtet i tillë që mund të krijojmë për një kohë rezerva të mëdha minerale pa i shitur. Po të mendojmë kështu, do të na krijohen situata të vështira. Prandaj në këtë drejtim duhet të mendohet thellë. Jo vetëm të kemi plane të veçanta për këto situata të vështira që parashikojmë të na krijohen, por është e domosdoshme të veprohet me një shkathtësi më të madhe si në zhvillimin e minierave, ashtu edhe në eksportimin e mineraleve, qofshin këto të përpunuara, qofshin gjysmë të përpunuara, qofshin si

lëndë e parë. Të bëjmë përpjekje të gjithanshme që të mos na mbeten minerale e mallra të tjera stoqe nëpër depot dhe nëpër portet tona.

Sektor tjetër me rëndësi jetike për ne është bujqësia. Këtë ne duhet ta zhvillojmë në mënyrë intensive, që populli të ketë të hajë, të vishet e të mbathet, pra të mos ulet niveli ekonomik i punonjësve tanë.

Në realizimin e planeve tona duhet të ecim frontalisht, por ka edhe disa objekte që vërtet mund t'i kemi parashikuar në këto plane, por ndërtimi i tyre mund të presë, prandaj të mos hezitojmë për t'i lënë mënjanë përkohësisht, përpara këtyre dy problemeve kyç që kërkojnë zgjidhje në situatat e krijuara.

Prandaj u rekomandova shokëve që për këto çështje të mendojnë seriozisht dhe sa më parë, të mos i lihen këto spontaneitetit, as të kënaqen me marrjen e disa masave gjysmake. Është e domosdoshme të mendohet mirë programi i punës që duhet bërë për të gjitha këto probleme të mëdha.

E SHTUNE

25 DHJETOR 1976*

METODA AGJENTURORE PËR TË PËRÇARË LËVIZJEN KOMUNISTE BOTËRORE

Më vunë në dijeni për bisedën që kishte bërë kryetari i delegacionit të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të... me shokët tanë. Miku, siç na tha vetë, kishte vajtur në Kinë, i dërguar nga përfaqësuesit e 8 partive komuniste (marksiste-leniniste) të vendeve të Amerikës Latine për të vënë në dijeni Partinë Komuniste të Kinës për mbledhjen që bënë dhe për deklaratën që nënshkruan këto 8 parti.

Shoku ishte i revoltuar dhe i indinjuar për pritjen prej inkuizitorësh që i kishin bërë 8 shokë të Gën Biaos, pse ky vetë as denjoi të asistonte në këtë «gjyq». Ai tha se «Po dal për herë të parë nga vendi dhe nuk imagjinoja kurrë që në mes dy partive motra të mbahen qëndrime të tilla si të një hetuesi që ka përpara një kriminel. Në këtë rast, — tha ai, — «kriminelin» isha unë, sekretari i një partie komuniste (marksiste-leniniste), kurse «hetuesi» ishin ata.

Kinezët me orë e me ditë, pa pushim, — vazhdoi ai, — më sulmuan me pyetje dhe ngulnin këmbë të lexoja materialet e tyre.

Ata akuzuan Partinë e Punës të Shqipërisë dhe 8 partitë e vendeve të Amerikës Latine se këto «kanë akuzuar» haptazi botërisht Partinë Komuniste të Kinës dhe vijën e Mao Ce Dunit. Këto akuza unë ua hodha poshtë

me vendosmëri dhe i pyeta: Pse e përzieni Partinë e Punës të Shqipërisë në këtë çështje? Ajo nuk ka lidhje me mbledhjen tonë dhe nuk dinte gjë për të, po ne e vumë në dijeni, siç po ju vëmë edhe ju. Kinezët e quajtnë mbledhjen e përfaqësuesve të 8 partive tona «një komplot kundër Kinës, si ai që u bë në Bukuresht»».

Ç'monstruozi! Shoku tha që kinezët gjykojnë se Amerika Latine nuk është preja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se shtetet e kësaj zone nuk shkojnë drejt fashistizimit, por janë «shtete borgjeze demokratike të pavarura». «Pra, sipas gjykimit të kinezëve, — vijoi ai, — ne duhet ta shuajmë luftën e armatosur, bile të bëjmë autokritikë që e filluam këtë luftë».

Pastaj shoku shtoi se «duke shkelur çdo normë, kinezët sulmuan ashpër Partinë e Punës të Shqipërisë, duke numëruar një sërë kontradiktash që ju keni me vijën dhe me strategjinë e Mao Ce Dunit.

Më lodhën, më dërrmuan, shihni si jam tretur, — na tha, — donin të më thyenin, donin të kapitulloja përpara tyre. Unë isha vetëm, ata 8, por u bëra ballë. Tash që ndodhem në Shqipëri jam i lumtur dhe i qetë, jam krejt i çliruar nga një ankth që jua thashë më së fundi juve».

I rekomandova Ramizit që ta lënë shokun të qetësohet, pastaj të takohet me të, ta dëgjojë dhe, në vija të përgjithshme, t'i hedhë poshtë akuzat dhe shpifjet e kinezëve kundër tyre dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Pastaj, ndonjë ditë tjetër, të gjitha këto kundërakuza nga ana jonë t'ia faktojë me dokumente, që vërtetojnë vijën marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe vijën revizioniste të Partisë Komuniste të Kinës.

Ne e gjykuam drejt taktikën e Partisë Komuniste të Kinës. Kinezët nuk duan të na përgjigjen neve drejtpërdrejt, sepse nuk guxojnë të hyjnë në polemikë me ne.

Nga ana tjetër, ata përdorin metoda trockiste, agjenturore, inkuizicionale për të luftuar Partinë tonë prapa krahëve, për të na izoluar ne nga lëvizja komuniste ndërkombëtare dhe për ta përçarë këtë. Ky është një veprim që kryhet nga ana e një shteti të madh, borgjez, kapitalist dhe imperialist. Do të luftojmë ashpër kundër tyre dhe do të fitojmë.

DISA VEZEMIME NIKET ÇELIÇI - RAMIZIT
TË MAO CE DUNIT

Revizionistët kinezë, me parime të Mao Ce Dunit, na kërkoi të çliroheshim nga Partia Komuniste e Kinës dhe të bashkojmë forcat tona me forcat e Partisë Komuniste të Kinës. Kjo është një dokument i dështuar dhe një shprehje e dështimit të tyre për të marrë në konsideratë forcat tona të bashkuara të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës.

Kjo dështim i tyre tregon se kinezët janë të pamatur dhe të pamaturt. Ata na kërkoi të çliroheshim nga Partia Komuniste e Kinës dhe të bashkojmë forcat tona me forcat e Partisë Komuniste të Kinës. Kjo është një dokument i dështuar dhe një shprehje e dështimit të tyre për të marrë në konsideratë forcat tona të bashkuara të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës.

Kjo dështim i tyre tregon se kinezët janë të pamatur dhe të pamaturt. Ata na kërkoi të çliroheshim nga Partia Komuniste e Kinës dhe të bashkojmë forcat tona me forcat e Partisë Komuniste të Kinës. Kjo është një dokument i dështuar dhe një shprehje e dështimit të tyre për të marrë në konsideratë forcat tona të bashkuara të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës.

DISA MENDIME RRETH «DEKALOGUT» BALLIST TË MAO CE DUNIT

Revizionistët kinezë, me grupin e Hua Kuo Fenit në krye, i cili mori fuqinë në Kinë nëpërmjet një puçi ushtarak, botuan këtë javë një dokument të Mao Ce Dunit, një fjalim prej dhjetë pikash («Mbi dhjetë marrëdhëniet kryesore»), që ai ka mbajtur në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, në prill të vitit 1956.

Ky dokument është shkruar para Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës, ku raportin kryesor e mbajti Liu Shao Çia. Raporti ka pasur përmbajtje revizioniste. Ne që asistuaam në kongres, u çuditëm se si u mbajt ky raport dhe të paktën si nuk u dënua as më vonë tok me Liu Shao Çinë, që u likuidua. Në këtë raport të Kongresit të 8-të shtjelloheshin problemet sipas ideve të Mao Ce Dunit, prandaj, edhe pas Revolucionit Kulturor, ai u quajt i drejtë. **Këtë e afirmojnë të dhjetë pikat e «dekalogut» ballist të Maos, të cilat formojnë strategjinë dhe botëkuptimin e tij jomarksist, eklektik.**

Këto dhjetë pika të Maos u shkruan dhe u shtruan pas Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku revizionisti dhe renegati Hrushov sulmoi marksizëm-leninizmin dhe shpifi e hodhi baltë mbi Stalinin. **Me këtë veprim Maoja mori iniciativën, e cila mund të ishte e bashkërenduar me hrushovianët. Dhe kështu**

ishite. Hrushovi e ka pasë vënë në dijeni Maon për idetë e tij revizioniste dhe për veprimet që do të ndërmerre. Maoja ka qenë dakord me Hrushovin, gjë që e tha botërisht në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957, ku mburri Hrushovin, goditi Stalinin dhe aprovoi likuidimin nga Hrushovi të «grupit antiparti të Molotovit me shokë». Kështu Maoja e ndihmoi Hrushovin. Ai ishte dakord me vijën e Kongresit të 20-të, ishte kundër Stalinit. Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste të Kinës ishte i akorduar me hrushovianët, sepse të dy «kumbarët» kishin të njëjtat ide. Natyrisht, edhe Hrushovi i dha premtime Maos, por nuk i mbajti, vetëm e gënjeu sa kaloi lumin.

Pikësynimi i Maos nuk ishte të ndihmonte Hrushovin, po veten e tij, që Kina të bëhej udhëheqësja kryesore e botës komuniste dhe Maoja të zëvendësonte Stalinin, për të cilin menduan se e futën në dhe. Maoja veproi me shpejtësi për hegjemoni.

Nga ana e vet Hrushovi donte ta vinte Mao Ce Dunin në radhë dhe nën drejtimin e tij, mirëpo në këtë mes ndërhyri Partia e Punës e Shqipërisë, e cila mbrojti marksizëm-leninizmin dhe Partinë Komuniste të Kinës. Në Bukuresht u ndez zjarri i polemikës, që Partia e Punës e Shqipërisë e vazhdoi «me të shtëna mitralozi» në Mbledhjen e 81 partive në Moskë. Maoja ishte për shuarjen e këtij zjarri të madh, ishte kundër polemikës. Ai donte mbledhje, donte ujdi socialdemokrate, sepse edhe vetë ishte një socialdemokrat, një oportunist, një revizionist. Por Maoja nuk e shuajti dot zjarrin, as polemikën dhe, duke parë se nuk e vendosi dot hegjemoninë e tij, ai ndërroi qëndrim. Maoja u vendos disi «më mirë» në pozita antisovjetike dhe këtu në dukje u poq me ne që luftonim me konsekuencë revizionizmin hrushovian. Por edhe në këtë kohë ai kishte shpresa afrimi me revizionistët hrushovianë. Nga ana e udhëheqësve kinezë u bënë orvatje për këtë, por ne i kundërshtuam.

Kur ra Hrushovi, Maos iu ngjallën shpresat. Ai dërgoi Çunë në Moskë, na propozoi edhe neve që të vemi, por ne e refuzuam me vendosmëri. Kjo ishte një fiasko për Mao Ce Dunin. Atëherë ai, nga strategjia e luftës në të dy krahët, u kthye drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Takimet e shumta në Varshavë midis ambasadorëve kinezë dhe amerikanë përgatitën vajtjen e Kisingerit në Kinë dhe, pas këtij, edhe të Niksonit.

Revolucioni Kulturor mbaroi si një bisht peshku. Ky revolucion u ndal në mes të rrugës, ose, më mirë të themi, forcoi pozitën personale të Mao Ce Dunit. Elementët e majtë «u likuiduan me një të goditur» nga të djathtët me Hua Kuo Fenin në krye. Kështu vija revizioniste e Maos triumfoi dhe tash doli në dritë «dekalogu» që u përshtatet të djathtëve. Në këtë «dekalog» nuk bëhet fjalë fare për revolucionin botëror, për diktaturën e proletariatit, për luftën e klasave dhe për ndihmën ndaj popujve që duan liri dhe luftojnë për t'u çliruar.

Ky dokument është një pasqyrë e ideve revizioniste të Maos, i cili është për bashkekzistencë paqësore edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse nuk përmenden fare. Këtij dokumenti po i hedh një sy shpejt, por ai duhet analizuar thellë.

Asgjë nuk duhet të na çuditë për sa u përket qëndrimeve antimarksiste, pragmatiste, liberale, puçiste e plot zigzage të Mao Ce Dunit, Çu En Lait, Ten Hsiao Pinit, Hua Kuo Fenit dhe të revizionistëve të tjerë kinezë. Këto ide të tyre janë të vjetra, pesëdhjetëvjeçare, të gërshtuara me idealizëm dhe misticizëm dhe të lyera me një bojë të kuqe, të cilën dielli i marksizëm-leninizmit ua heq.

Një nga qëllimet kryesore të këtij «dekalogu» të Maos është të vërë kufirin midis vetes dhe Stalinit, midis ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe ideologjisë

që udhëheq ndërtimin e socializmit në Kinë. Me fjalë të tjera, Mao Ce Duni përballë teorisë marksiste vë idetë e tij, vë maocedunidenë, siç i quajnë tash kinezët këto të ashtuquajtura mendime «të njëllojta me teorinë thelbësore të marksizëm-leninizmit», por që në realitet janë në kundërshtim me të.

Lenini e ka parashikuar veprimtarinë e antimarksistëve, cilëtdo qofshin këta, Maoja, maoistët e të tjerë, kur thotë, në veprën e tij «Fatet historike të doktrinës së Karl Marksit» më 1913, se

«Dialektika e historisë është e tillë, që fitorja teorike e marksizmit i detyron armiqtë e tij të vishen me petkun e marksistëve»¹.

Mao Ce Duni, siç e tregon ky «dekalog», në shumë çështje parimore ka qenë me kohë në kundërshtim me teorinë dhe me praktikën revolucionare të marksizëm-leninizmit. Siç del nga «dekalogu», që në kohën e «Marshimit të Madh», që në Jenan, ai kishte pikëpamje antimarksiste mbi hegjemoninë e klasës punëtore dhe predikonte rolin drejtues të fshatarësisë në revolucion. Edhe aktualisht të ashtuquajturën botë të tretë Maoja e bën «qendrën dhe forcën drejtuese të revolucionit», duke mohuar kështu rolin drejtues të proletariatit ndërkombëtar. Pikëpamjet antimarksiste të Maos, që pasqyrohen edhe në këtë «dekalog» dhe që janë kristalizuar në kulmin e luftës çlirimtare kineze, jo vetëm e harrojnë luftën e klasave, por predikojnë haptazi shuarjen e saj.

Pra, këto teza reaksionare dhe antirevolucionare të Maos fiksohen edhe në «dekalogun» e vitit 1956. Në veprat e tij të shtypura në 4 vëllime nuk gjen hapur teza të tilla flagrante antimarksiste dhe antileniniste. Siç po du-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 18, f. 653.

ket, Mao Ce Duni ka qenë një eklektik, një revizionist i maskuar, i cili e çori maskën kur ra në ujdi me revizionistët hrushovianë për të shkurorëzuar leninizmin dhe për të atakuar Stalinin. Mao Ce Duni, nën maskën e marksizëm-leninizmit, shpalosi teorinë e tij pseudomarksiste dhe kjo «teori» «do të udhëhiqte këtej e tutje proletaria-tin botëror dhe revolucionin». Këtu e ka maocedunideja burimin e saj mashtrues, megaloman dhe denigrues ndaj marksizëm-leninizmit.

Maocedunideja udhëhoqi edhe «Revolucionin e Madh Kulturor Proletar» për t'iu kundërvënë Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, i cili, me fjalë të tjera, për Maon ishte «kapërcyer», ishte «vjetruar» tok me teorinë e Marksit dhe të Leninit. Kohët kanë ndryshuar, kështu që, sipas tij, duhej një «teori e re për marksizmin» dhe kjo ishte maocedunideja. Kjo është teoria e revizionizmit modern, e cila, si edhe ajo hrushoviana, ruan maskën leniniste. Që të dyja këto variante të revizionizmit modern janë një dhe të pandara, por çështja qëndron në atë se kush do të dominojë, varianti revizionist i Hrushovit apo ai i Maos, pavarësisht se të dy dalin në një qafë, në atë të antimarksizmit. Në këtë rivalitet qëndron çështja se cili shtet i madh do të arrijë të dominojë mbi tjetrin, cili do të bëjë ligjin.

Që të dy në këtë rrugë kanë marrë si spunto denigrimin e veprës gjeniale të Stalinin. Hrushovianët shpifën deri në fund kundër Stalinin, kurse Maoja përfitoi nga ky denigrim që i bëhej Stalinin, dhe përdori ato të dhëna që i duheshin për të fshehur vijën e tij revizioniste, për ta ngritur në qiell këtë si marksiste-leniniste dhe për t'u maskuar më mirë që të fitonte terren mbi hrushovianët. **Maoja tha se 30 për qind e veprës së Stalinin është e gabuar dhe 70 për qind është e mirë. Mjeshtër i madh i zigareve! E peshoi veprën e Stalinin me atë precizion që mund të peshohen edhe domatet në fushë!!**

Në pikën e parë të «dekalogut» të Mao Ce Dunit shtrohet teza antimarksiste e dhënies përparësi industrisë së lehtë e bujqësisë dhe jo industrisë së rëndë. Këtë devijim kosiginist-revizionist Mao Ce Duni e argumenton me atë që investimet në industrinë e rëndë janë të mëdha dhe jorentabël, kurse industria e karameleve dhe e shoshoneve ka të ardhura, është më rentabël. Sa për bujqësinë, kjo prodhon ushqimet e popullit.

Teza antimarksiste e Maos nuk e çon përpara, por e frenon zhvillimin e forcave prodhuese. Bujqësia dhe industria e lehtë nuk mund të zhvillohen me ritmet e duhura, në rast se nuk zhvillohet industria minerare, në rast se nuk prodhohet çelik, në rast se nuk prodhohen naftë, traktorë, trena, automobila, anije, në qoftë se nuk ngrihet industria kimike etj., etj.

Zhvillimi i industrisë, sipas Maos, është një proces artizanal. Industria e lehtë, që pretendon të zhvillojë Maoja, nuk ngrihet vetëm me tulla, biçikleta, basma, termose e erashka që vërtet mund të sjellin disa të ardhura, por njerëzit që t'i blejnë ato, duhet të kenë fuqi blerëse. Në vitin 1956, Kina, si vend me popullsi të madhe, ishte e prapambetur ekonomikisht dhe shumë artikuj të konsumit duhej të shiteshin nën çmimin e kostos. Atëherë rendimenti nuk ishte i madh.

Maoja në «dekalogun» e tij kritikon Stalinin dhe gjendjen ekonomike në BS. Por «dielli nuk mbulohet me shoshë». Realiteti tregon se në BS, brenda 24-25 vjetëve që nga Revolucioni e deri në Luftën e Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Leninit e pastaj të Stalinin, në sajë të një vije e politike të drejtë, u ngrit një industri e tillë e rëndë që jo vetëm i dha hov ekonomisë së brendshme të këtij vendi të parë socialist, por që lejoi t'i bëhet ballë sulmit të makinës së tmerrshme të Gjermanisë hitleriane. Kurse me politikën ekonomike të Maos, nga 1949 e deri në ditët tona, po mbushen afër 30 vjet dhe ku është

Kina me potencialin industrial? Shumë prapa! Dhe për këtë fajet i paska «katërshja»! Jo, fajin s'e ka «katërshja», por vija e Maos, siç e vërtetojnë pikëpamjet e tij të parashtruara në «dekalog».

Po si mund të bënte Kina e madhe socialiste pa industri të rëndë? Sigurisht, Maoja mendonte se do të ndihmohej nga Bashkimi Sovjetik për ndërtimin e industrisë së rëndë, ose do të kthente fletën nga kreditë amerikane. Kur pa se Bashkimi Sovjetik nuk iu «bind» dhe nuk ia dha ndihmën e kërkuar, Maoja filloi të derdhte çelik me sobat që ndërtoheshin në trotualet e bulevardeve ose me minifurra për gizë. Kina mbeti pas, Kina mbeti pa teknologji moderne. Është e vërtetë se populli kinez nuk vuante më për bukë si më parë, por të arrish të pohosh, siç bëri Maoja, se fshatari kinez më 1956 rronte më mirë se kolkoziani sovjetik, në një kohë kur në të vërtetë ai ishte prapa, kjo do të thotë të denigrosh kolektivizimin e bujqësisë dhe ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe të Stalinit.

Mao Ce Duni thotë me përçmim: «Ç'kuptim ka të bisedosh për zhvillimin e industrisë së rëndë? Duhet t'u sigurohen punëtorëve mjetet e jetesës». Me fjalë të tjera kjo është «teoria e gulashit» e Hrushovit. Dhe si përfundim Maoja në «dekalog» kërkon të thotë se ata s'kanë bërë gabime si paska bërë Bashkimi Sovjetik ose më mirë (po këtë nuk e thotë me plot gojën) si Lenini dhe Stalini. Por që ta mbulojë këtë devijim, ai nuk mungon të thotë se «duhet që edhe industrinë e rëndë ta zhvillojmë, por më shumë vëmendje t'u kushtojmë bujqësisë dhe industrisë së lehtë». Kjo pikëpamje e tij që u zbatua në mënyrë pragmatiste dhe që Kinën e ka lënë prapa, ka bërë që kësaj t'i duhen dekada, deri në vitin 2000, që të arrijë disi të kapërcejë prapambetjen... me ndihmën dhe me kreditë e kapitalit amerikan që po i siguron strategjia e re. Nuk ka asnjë dyshim se Kina mund të mbështetet

në forcat e veta, ajo ka një fuqi njerëzore të madhe, ka, gjithashtu, një fuqi ekonomike të konsiderueshme, por ka mbetur pas për shkak të vijës së saj të gabuar.

Në pikën e dytë të «dekalogut» shtrohet edhe çështja se ku duhet të ndërtohet industria, në bregdet apo në brendësi? Maoja thotë se «rreth 70 për qind e gjithë industrisë sonë, të lehtë dhe të rëndë, ishte ngritur në rajonet bregdetare dhe vetëm 30 për qind në rajonet e brendshme. Kjo ndarje e parregullt është rezultat i historisë». Kuptohet, kjo industri u ngrit nga të huajt, të cilët kishin koncesionet aty, thithnin lëndën e parë nga Kina e brendshme dhe në bregdet gjenin punëtorë skllëvër. Kësaj mënyre zhvillimi Maoja i jep rëndësi. Ai thekson se edhe në të ardhmen duhet të vazhdohet të ndërtohet në bregdet dhe bën për këtë një llogari fantaziste se me të ardhurat e një fabrike të industrisë së lehtë, «ne mund të fitojmë për të ndërtuar brenda katër vjetëve tri fabrika të tjera ose dy, ose një, ose të paktën gjysmën e njëres». Kjo i përngjet teorisë së revizionistit Koço Tashko, i cili në Konferencën e Parë të Partisë në Labinot tha se ne «duhet të bëjmë një revolucion me shumë gjak, me pak gjak ose, mundësisht, me aspak gjak».

Lidhur me këtë çështje Maoja nxjerr konkluzionin: «Të ndërtojmë industri edhe në thellësi, që ta kemi edhe për kohë lufte».

Por nga do t'i vijë lufta? Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Japonia, apo nga Bashkimi Sovjetik? Siç duket, në të njëjtën kohë ai mendon se lufta nuk do t'i vijë nga asnjë anë, sidomos jo nga deti, derisa në breg të tij Maoja rekomandon të ndërtohen fabrika.

Maoja, si duket, nuk mendon se në ç'mënyrë duhet ta shpopullojë ca Jugun dhe Juglindjen, për të populluar Veriun dhe Perëndimin.

Në pikën e tretë të «dekalogut» Mao Ce Duni përcak-

ton raportet në mes ndërtimeve ekonomike dhe atyre të mbrojtjes. Ai, kur thotë se duhet t'i ulim shpenzimet për mbrojtjen, duket qartë se mbështetet në përcaktime të gabuara. Mbrojtja kineze, sipas Maos, na qenka më e fuqishme se ajo e Bashkimit Sovjetik para Luftës së Dytë Botërore.

Hrushovi lëshoi tezën se gjoja Stalini e kishte lënë Bashkimin Sovjetik pa mbrojtje përballë hitlerianëve. Këtë shpifje adopton edhe Maoja, duke u mburrur, se me ata avionë dhe me ata topa që kishte (dhe me bombën atomike që do t'ia jepte Hrushovi), mbrojtja e Kinës ishte e siguruar.

Faktet tregojnë se Kina mbeti prapa. Kjo ishte pasojë e nënvleftësimit të industrisë së rëndë dhe e mbështetjes të tjerët për të forcuar aftësinë mbrojtëse me një strategji ushtarake të gabuar. Tash Kina ka filluar të ndërrojë mendje për mbrojtjen, por, tok me këtë, ka ndryshuar edhe aleancat. Ajo është afruar me amerikanët dhe ka blerë prej tyre teknologji moderne luftarake.

Po në këtë pikë të «dekalogut», Maoja shprehet qartë se është për një armatim të lehtë, për të paguar ushtarët kinezë (si një ushtri mercenare) dhe për të shkurtruar administratën, për të cilën asgjë nuk është bërë, në të kundërtën, ajo është shndërruar në një kancer për Kinën. Këtë ne e kemi konstatuar kur ishim atje në vitin 1956 dhe na e kanë thënë vetë: gjithë ish-ushtarakët e Çan Kai Shisë mbaheshin si nëpunës me rrogë.

Në pikën e katërt të «dekalogut» flitet për marrëdhëniet midis shtetit, njërive të prodhimit dhe prodhuesve. Natyrisht këtë organizim dhe këtë ndarje organizative të Kinës as nuk e kemi mësuar kurrë dhe as nuk dimë si janë marrëdhëniet në mes shtetit, njërive të prodhimit dhe prodhuesve. Kina mund dhe duhet të ketë specifikën e saj, sepse ajo ka një territor të madh, me plot kombësi dhe jo me republika, por me provinca. Ne

kemi ditur që atje ka centralizëm demokratik, por që provincat të mos kishin kompetenca në ndarjet brenda tyre dhe hozrashote në fabrika, këtë nuk mund ta imagjinonim. Maoja na thotë se në Bashkimin Sovjetik (kuptohet të kohës së Stalinit) ka pasur një centralizëm të madh e burokratik, dhe, sipas tij, republikat sovjetike i kishin duart të lidhura. Sa është e vërtetë kjo nuk e dimë, por aq burokraci dhe centralizëm, në mos më shumë nga sa kishte në Bashkimin Sovjetik, kishte e ka sot edhe në Kinë. Por Kina është në vijën e denigrimit të Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit dhe vepron ashtu si Hrushovi. Maoja dëshiron të tregohet më organizator «marksist-leninist», por, me këto që po bën, mos vallë ai po ecën në rrugën e vetadministrimit titist?

Maoja po në këtë pikë e krahason ushtrinë me shtetin, domethënë një armë të shtetit ai e quan shtet dhe e vë atë edhe mbi partinë. Në fakt, në Kinën e vjetër dhe në këtë të re, ushtria ka luajtur një rol vendimtar. Ajo ka mbështetur një fraksion dhe ka likuiduar tjetrin.

Centralizmin demokratik dhe pavarësinë ekonomike nga qendra, Maoja e banalizon me një shembull qesharak dhe semplist që të habit, se si ky «teoricien i madh» shpjegon një çështje kaq të rëndësishme politike, ideologjike dhe organizativo-ekonomike të socializmit me kaq *dezenvolytë?!?*

Kur flet për fshatarësinë, dhe këtë Maoja e bën më 1956, kur kanë kaluar vetëm pak vjet prej çlirimit, ai nxjerr në pah dhe vë në dukje se sistemi i kolkozeve dhe i sovkozeve në Bashkimin Sovjetik është një falimentim, se fshatarët atje janë të shtypur nga taksat, se prodhimet u paguhen lirë e të tjera të këqija, kurse në Kinë gati sa

1 Désinvolture (frëngjisht) — qëndrim, mënyrë të vepruari me një lehtësi e liri të tepruar.

nuk thotë që fshatarësia rron në bollëk e në lumturi, se prodhimi është i bollshëm, se çmimet janë të ulëta, se akumulimi shtetëror është i paktë. Analizë e çuditshme! Ne e kemi njohur vetë gjendjen si në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në Kinë, sepse kemi qenë në ato vite në të dy vendet, prandaj kjo që thotë Maoja nuk është reale.

Në këtë pikë të «dekalogut», analiza e Maos mbi marrëdhëniet shtet-bujqësi, komuna-komunarë, për ndarjen e të ardhurave, për problemin e investimeve, për çështjen e akumulimit dhe nivelin e jetesës së komunave fshatare dhe të qytetit nuk është aspak marksiste-leniniste, nuk është as një pasqyrë e qartë dhe objektive e gjendjes, por vetëm një demonstrim i «epërsisë» së rreme të bujqësisë kineze përballë asaj sovjetike. Hrushovi na doli një «teoricien i bujqësisë», i cili do ta nxirrte këtë «nga llumi ku e kishte futur Stalini». Edhe Maoja po imiton këtë kulak e matrapaz.

Këtë problem kaq të rëndësishëm Maoja e mbyll me fjalë që duan të tregojnë se në Kinë çdo gjë shkon mirë; industrinë e rëndë e vë në radhën e tretë, fabrikantët borgjezë i integron në socializëm; kështu predikon edhe për kulakët në fshat, e çdo gjë të rregullohet sipas teorisë së tij maoiste, që na qenka plotësisht e drejtë, pa gabime! Në të vërtetë këto ide të Maos janë në kundërshtim me ato të Leninit e të Stalinit.

Nuk ka ku vete më qartë megalomania e këtij «klasiku» revizionist dhe denigrimi që ai i bën veprës së Leninit dhe të Stalinit.

Në pikën e pestë të «dekalogut», ku flitet mbi marrëdhëniet midis qendrës dhe bazës, Mao Ce Duni përçakton cilat duhet të jenë këto marrëdhënie. Natyrisht, kjo varet nga kompetencat që i ka dhënë qendra bazës në Kinë. Tërë kjo punë ka lidhje me territoret e mëdha e të gjera të këtij vendi. Këtu Mao Ce Duni shtron se

nuk duhet ndjekur shembulli i Bashkimit Sovjetik në përqendrimin e çdo çështjeje në duart e organeve qendrore, duke u ndrydhur iniciativën organeve lokale, por të bëhen përpjekje që këto të drejtojnë në mënyrë të pavarur. Me këtë Maoja do të thotë se republikat e federuara në Bashkimin Sovjetik nuk kishin asnjë kompetencë. Ky është një bluf, një gënjeshtër, pse, siç e dimë, republikat sovjetike kanë pasur planet e zhvillimit të tyre ekonomik, planet industriale, ato bujqësore etj., natyrisht të lidhura ngushtë këto edhe me qendrën. Pra, të thuash se republikat në Bashkimin Sovjetik, siç mund të jenë provincat në Kinë, nuk kanë pasur kompetenca të tyre, do të thotë të denigrosh socializmin që u ndërtua atje në kohën e Stalinit, do të thotë të përpiqesh të tregosh se organizimi, drejtimi, ideologjia dhe politika e Kinës qëndrojnë më lart nga ato të Bashkimit Sovjetik, se praktika leniniste e ndërtimit ekonomik të socializmit në Bashkimin Sovjetik, sipas Maos, nuk është e drejtë, pse, sipas tij, këtë praktikë leniniste e kishte shtrembëruar Stalini! Mirëpo ne dimë që Stalini ka zbatuar me besnikëri politikën ekonomike, organizative dhe ideologjike të Leninit. Që mund të jenë bërë edhe atje gabime gjatë gjithë kësaj pune kolosale, kjo nuk përjashtohet. Vetë Mao Ce Duni thotë se edhe në Kinë janë bërë gabime, por, kur vjen rasti për të folur për Bashkimin Sovjetik, këto gabime ai i fryn shumë, bile i zmadhon në një shkallë të tillë saqë duket hapur se ai synon të denigrojë sistemin e drejtë të ndërtimit socialist të kohës së Stalinit.

Është absurde të pohosh se në Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit nuk ka pasur iniciativa nga ana e organeve lokale. Mos vallë Mao Ce Duni me këtë pohim dëshiron të minimizojë dhe të dobësojë rolin e centralizmit demokratik e të justifikojë rrugën e vetadministrimit titist? Ne nuk i harrojmë konsideratat e Mao Ce Dunit për

Titon. Të pranosh se ka gabuar Stalini në drejtim të Titos, kjo do të thotë se Mao Ce Duni duhet të ketë aprovuar metodat e vetadministrimit të ekonomisë jugosllave, domethënë metodat e vetadministrimit revizionist titist. Këtë vetadministrim Maoja dëshiron ta zbatojë progresivisht edhe në Kinë. Ai nuk mungon të flasë edhe për specifikën. Është interesante ajo që thonë kinezët se duan të ndërtojnë një socializëm specifik. Në këtë çështje puqen me Titon, i cili ka kohë që dërdëllis për ndërtimin e «socializmit specifik». Këtu nuk është çështja vetëm e termit që përdorin kinezët, por edhe e brendisë dhe e futjes në këtë të përvojës ala titiste.

Në pikën e gjashtë Maoja flet për marrëdhëniet midis kombësisë së hanëve dhe kombësive minoritare që jetojnë në Kinë. Në teori mund të flasësh sa të duash për barazinë midis kombeve, por, në fakt, në Kinë sundon kombësia e hanëve. Në marrëdhëniet midis kombësive populli han ka mbajtur dhe ruan epërsinë, ai dominon dhe urdhëron kombësitë e tjera, pavarësisht nga formulat bajate dhe demagogjike që përdoren. Në kohën e Stalinit, gjendja në marrëdhëniet midis kombësive ruse dhe pakicave kombëtare nuk ka qenë siç pretendon Maoja. Gabime ka pasur, por jo ashtu siç pohon ai. Në Kinë nuk ekziston demokraci e barazi midis kombësive. Atje ekziston, si në kohët e para, një diktaturë ushtarake. Ai fraksion i asaj kombësie që kishte ushtrinë me vete, u impononte vullnetin e vet masave të popullit dhe partisë. **Pra, në krye të partisë atje është ushtria, në krye të shtetit, gjithashtu, është ushtria.**

Në pikën e shtatë, lidhur me marrëdhëniet midis njerëzve me parti dhe atyre pa parti, Mao Ce Duni është plotësisht në vijën revizioniste, oportuniste. Partinë Komuniste ai nuk e vë në krye, në udhëheqje; lë të kuptohet që kjo është në udhëheqje, por kërkon dhe afirmon që pushteti të ndahet me partitë e borgjezisë. Pra, Maoja

është për pluralizmin e partive në drejtimin e shtetit proletar. Këto parti të ndryshme ai i quan të domosdoshme të ekzistojnë për shumë arsye: për arsye të kritikave që mund t'i bëhen Partisë Komuniste të Kinës, për arsye se mund të mësohet shumë prej tyre për të zbuluar çdo gjë që organizohet dhe vepohet nën rrogos etj. **Ekzistencën e këtyre partive ai e konsideron si një faktor përcaktues ose, më mirë të themi, si një faktor të domosdoshëm për ndërtimin e socializmit në Kinë.**

Me këtë Maoja bie në kundërshtim me Leninin, i cili, natyrisht, nuk ka lejuar që parti të tjera, veç asaj bolshevike, të drejtonin shtetin sovjetik. Pra, të pranosh vënien e sistemit të shumë partive në udhëheqje, do të thotë të udhëhiqesh nga pikëpamje ideologjike antimarksisiste. Në këtë kapitull Maoja përpiket që t'i reduktojë këto parti në disa njerëz, në disa udhëheqës, të cilët «bëjnë nga një kritikë ose miratojnë vendimet e Partisë Komuniste të Kinës». Këtu nuk është çështja e disa individëve demokratë përparimtarë, të cilët edhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, edhe Partia jonë e të gjitha partitë e tjera i kanë pranuar në front, i kanë mbajtur afër, janë këshilluar me ta kur ka qenë e nevojshme, **por Mao Ce Duni ligjëson ekzistencën e partive borgjeze në drejtimin e shtetit proletar. Me këtë tezë të tij ai shpjegon gjoja se «partitë demokratike janë produkte të historisë» dhe se «çdo gjë që lind në histori, zhduket në histori».** Për marksistë-leninistët është e qartë se çdo parti përfaqëson interesat e disa klasave e shtresave të caktuara, prandaj ç'kuptim ka të ruash në socializëm partitë që përfaqësojnë interesat e borgjezisë? Kjo do të thotë të mos bësh luftën e klasave, të mos luftosh për rolin hegjemon të proletariatit e të partisë së tij.

Këto parti të ashtuquajtura demokratike, deri tek ajo e Guomindanit, do të zhduken, sipas Maos, ashtu siç do të zhduket edhe partia komuniste. «Me zhdukjen e par-

tisë komuniste dhe të diktaturës së proletariatit, ne do të jemi shumë të kënaqur», thotë ai.

Maoja nuk mungon të thotë që aktualisht ne nuk mund të bëjmë pa diktaturën e proletariatit dhe pa partinë e proletariatit. Ai e thekson këtë dhe flet që partia duhet të bëhet e fuqishme, bile për këtë ai citon edhe Leninin, por këtë e bën pasi ka hedhur helmin. Lenini ka thënë se nuk mund të bëjmë pa partinë e proletariatit dhe pa diktaturën e proletariatit, ka shpjeguar edhe për se shërben kjo diktaturë. Më 1920 Lenini thoshte:

«Kush e dobëson qoftë edhe pak disiplinën e hekurit të partisë së proletariatit (sidomos në kohën e diktaturës së tij), ai në të vërtetë ndihmon borgjezinë kundër proletariatit»¹.

Stalini, gjithashtu, thotë:

«Mjafton vetëm të tronditet partia jonë, të dobësohet ajo, që menjëherë të tronditet dhe të dobësohet diktatura e proletariatit»².

Në pikën e tetë, ku bën fjalë për raportin midis revolucionit dhe kundërrevolucionit, Mao Ce Duni thotë se diktatura e proletariatit nevojitet për të shtypur kundërrevolucionin dhe kundërrevolucionarët, por, për fat të keq, ai i përkëdhel kundërrevolucionarët. Ai pohon se «kemi vrarë në fillim disa kundërrevolucionarë, por më nuk duhet të vrasim, nuk duhet të burgosim, ata nuk duhet t'i gjykojmë, por t'i bindim, t'i dërgojmë në fshat, ku të edukohen në punë» etj., etj. «Ne mund ta mbajmë në fuqi ligjin e dënimit me vdekje, — thotë Maoja, — por të mos e zbatojmë në praktikë!» Ç'është kjo? Kjo nuk

është luftë klase. Një qëndrim i tillë nuk e zhduk kundërrevolucionin, nuk i zhduk klasat shfrytëzuese.

Por, lidhur me këtë, në mes të tjerash, Lenini na mëson që të shkohet

«...deri në dëbimin total ose në internimin e shfrytëzuesve më të rrezikshëm dhe më kryeneçë, të vendoset një mbikëqyrje rigorozë mbi ta për të luftuar kundër orvatjeve të pashmangshme për rezistencë dhe për restaurimin e skllavërisë kapitaliste, vetëm masat e këtij lloji janë në gjendje të sigurojnë nënshtrimin e vërtetë të të gjithë klasës së shfrytëzuesve»¹.

Nga tezat e «dekalogut» të Maos duhet të jenë shkurtuar shumë gjëra, sepse disa muaj pas Kongresit të 8-të të Partisë Komuniste të Kinës është folur shprehimisht që pronarët e fabrikave duhet të marrin renta dhe të jenë zëvendësudrejtorë të tyre. Kjo pikëpamje duket në gjithë këtë tezë të Mao Ce Dunit. Ai i mban reaksionarët kapitalistë në drejtimin e fabrikave që kanë pasur pronë të tyre, u jep të ardhura nga këto fabrika, që u janë shtetëzuar, por që pjesërisht konsiderohen të tyre, dhe harron se ato i kanë ngritur e i kanë zgjeruar duke shfrytëzuar gjakun dhe djersën e punëtorëve. Luftë klase i thonë kësaj? Jo, nuk i thonë aspak luftë klase. **Këta ish-pronarë, sipas Mao Ce Dunit, duhet të shkrihen në shoqëri, të futen në shoqëri, të edukohen në shoqëri.** (Domethënë të integrohen në socializëm. Për integrim të kapitalizmit në socializëm po flitet sot shumë nga «teoricienët» borgjezë e revizionistë, si dhe nga titistët, eurokomunistët e të tjerë.) «Kjo do të jetë një gjë shumë e mirë, — pohon Maoja, — për shumë arsye, një nga të cilat është se ne (kinezët), do t'u japim kështu një shem-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 33.

2 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 7, f. 347.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 201.

bull të mirë vendeve të tjera të botës». (Shembull «i bukur» se si nuk luftohen armiqtë e popullit!)

Krejt ndryshe mendon Lenini. Ai thotë:

«Dhe lufta kundër kësaj vale spontane nuk mund të zhvillohet vetëm me propagandë dhe agjitacion, vetëm duke organizuar emulacionin, vetëm duke zgjedhur organizatorë, — lufta duhet zhvilluar dhe me detyrim»¹.

Dhe prapë Lenini, lidhur me këtë problem, thekson:

«... çdo mendim se kapitalistët do t'i nënshtrohen në mënyrë paqësore vullnetit të shumicës së të shfrytëzuarve, se mund të kalohet në mënyrë paqësore, reformiste në socializëm është jo vetëm marrëzia filistine më e madhe, por edhe një mashtrim i drejtpërdrejtë i punëtorëve»².

Pikëpamje tjetër e Maos është ajo se, sipas tij, po t'i zhdukim kapitalistët, ne do të humbasim edhe një burim informacioni, kështu që nuk do të dimë ç'ngjet në gjirin e tyre. Ç'përfundime «gjeniale» për të shuar luftën e klasave! Për të zbatuar edhe ne një «luftë klase» të tillë, u përpoq të na mbushte mendjen Çu En Lai, i cili na akuzonte se gjoja ne nuk bënim luftë klase! Qëllimi ishte për të parë se deri ku e bënim ne këtë luftë, ishim ne me vijën e Mao Ce Dunit për shuarjen e luftës së klasave, apo me rrugën leniniste dhe staliniane për zhvillimin me ashpërsi të kësaj lufte.

Në Partinë Komuniste të Kinës Maoja ka kultivuar kultin e tij dhe nuk ka zbatuar mësimet e mëdha të marksizëm-leninizmit, as luftën e klasave, as disiplinën

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 295.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 201.

e hekurt proletare, as diktaturën e proletariatit. Partia Komuniste e Kinës është rritur dhe është brumosur me norma liberale, reformiste, me dy e më shumë vija. Pra, tezat bazë të marksizëm-leninizmit janë fiktive për Maon dhe për Partinë Komuniste të Kinës.

Njerëz si Mao Ce Duni e akuzojnë Stalinin se gjoja paska bërë gabime në lidhje me luftën e klasave, kurse vetë afirmojnë se në socializëm lufta e klasave vjen duke u dobësuar. Bile Mao Ce Duni flet fare hapur që të mos bëjmë luftë klasash, të mos ekzekutojmë kriminelët, të mos pushkatojmë armiqtë e rrezikshëm, të mos futim njeri në burg. Kurse Stalini një gjë të tillë nuk e ka bërë kurrë. Ai në praktikë e vazhdoi me ashpërsi, me vendosmëri e deri në fund luftën kundër armiqve të popullit. Për ta shfajësuar kundërrevolucionin, për ta mbrojtur atë, Mao Ce Duni jep deri në pesë-gjashtë arsye dhe me to mundohet «të provojë» se rruga e tij na qenka e drejtë, marksiste-leniniste.

Maoja pretendon të zhdukë dhunën, dënimin me vdekje, gjykatat dhe prokuroritë, që të mos ndëshkohen kundërrevolucionarët. Ai predikon vetëm edukimin dhe propagandën. Ku është këtu lufta e klasave nga ana e Maos? Ku ekziston diktatura e proletariatit në pikëpamjet dhe në praktikën e tij?

Në pikën e nëntë Maoja flet mbi marrëdhëniet mi-dis së drejtës dhe së padrejtës. Ku synon ai që flet për këto marrëdhënie? Edhe këtu Maoja përpiqet të sulmojë Stalinin. Ai thotë se «Stalini pushkatonte njerëz për gabimin më të vogël». Kjo është një shpifje. Stalini nuk pushkatonte njerëz për gabime, përkundrazi ata që gabonin, ai luftonte t'i korrigjonte dhe për këtë të vërtetë janë dokumentet që flasin. Stalini orientonte që të futeshin në burg ose në kampe përqendrimi keqbërësit apo të pushkatoheshin kundërrevolucionarët, tradhtarët, spiunët dhe armiqtë e tjerë të popullit për krime veçanërisht të rrezik-

shme. Po të mos bëhej kjo nga ana e tij, nuk mund të ndërtohej socializmi në Bashkimin Sovjetik dhe ai nuk mund të ishte në rrugën leniniste. Mao Ce Duni është në kundërshtim me këtë vijë. Ai e përgjithëson çështjen dhe i trajton njëlloj si ata që kanë bërë krime jo shumë të rrezikshme, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të pushkatohen, ashtu edhe kundërrevolucionarët. Kush thotë t'i pushkatojmë ata që s'kanë bërë krime të rënda? Askush. Përkundrazi, ne jemi për atë që të tillë njerëz t'i ndreqim dhe kështu kemi vepruar.

Pika e dhjetë dhe e fundit e «dekalogut» bën fjalë për marrëdhëniet në mes Kinës dhe vendeve të tjera. Këto marrëdhënie, që ai i shpjegon dhe i ngre në teza, nuk kanë shumë marksizëm brenda; përkundrazi janë marrëdhënie oportuniste, revizioniste. Ato kanë për qëllim që në Kinë të mos zbatohet një vijë e drejtë revolucionare në ndihmë të proletariatit botëror dhe të revolucionit botëror, në ndihmë të partive komuniste marksiste-leniniste, që këto të luftojnë me sukses kundër borgjezisë, kundër kapitalizmit dhe revizionizmit modern. Në fakt, Maoja është një revizionist modern, si dhe revizionistët sovjetikë, titistë e të tjerë.

Lidhur me politikën e jashtme të Kinës, në tezat e famshme të Mao Ce Dunit thuhet: «Politika jonë është të mësojmë pikat e shëndosha të të gjitha kombeve dhe vendeve, të mësojmë gjithçka ka të mirë në fushën politike, ekonomike, shkencore dhe teknike, si dhe në letërsi e në art». Kjo është e gjithë politika e tij. Që të bëhen këto, sipas Mao Ce Dunit, duhet të vendoset bashkëkzistenca paqësore (revizioniste) me të gjitha shtetet e botës. Për Maon nuk ka dallim në mes këtyre shteteve. Mao Ce Duni, më vonë, duke injoruar rendin ekonomiko-shoqëror që ekziston në njërin apo në tjetrin vend, botën e ndau në tri dhe është për strategjinë e «tri botëve». Ai nuk është kundër asnjë «bote». Edhe në «botën

e parë», ku Maoja fut imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik, ai nuk bën dallime. Tash është pro imperializmit amerikan, nesër mund të jetë kundër; sot është kundër socialimperializmit sovjetik, nesër mund të jetë pro tij. Pra, ai lëviz sipas rrethanave, ashtu si e do interesi revizionist i shtetit kinez, dhe nuk vepron në bazë të parimeve marksiste-leniniste, nuk mendon se duhet të luftohen fuqitë imperialiste dhe të mbështetet lufta nacionalçlirimtare e popujve.

Luftën nacionalçlirimtare të popujve Mao Ce Duni nuk mund ta mbrojë me këtë vijë. Demagogji ai mund të bëjë dhe të deklarojë që «ne, kinezët, jemi me popujt e botës së tretë», por këto janë vetëm fjalë. Derisa formulon taktikën që përmenda më sipër, derisa është me imperializmin amerikan, me të cilin nuk dëshiron ta prishë, sepse duhet «të mësojë» nga ai, të marrë edhe kredi të hapëta ose të fshehta, Mao Ce Duni nuk mund të jetë me popujt e së ashtuquajturës botë e tretë, të cilët luftojnë kundër imperializmit amerikan, nuk mund t'i ndihmojë ata që të shpëtojnë nga zgjedha e këtij imperializmi. Me demagogji ai përpiqet të dalë në mbrojtje të shteteve që janë nën ndikimin e socialimperializmit sovjetik, por këtë e bën për t'i kaluar ato ose nën influencën e Kinës, ose nën influencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Duke ndjekur një strategji antimarksiste, Maoja pranoi Niksonin të vinte në Kinë, pa u njohur zyrtarisht ky shtet nga SHBA; gjithashtu, ai pranoi që të heqë për vizitën e presidentit amerikan pengesën e çështjes së Tajvanit, të cilën e kishte ngritur si një mur çeliku për çdo vend që donte të lidhte marrëdhënie diplomatike me Kinën. Që atëherë, ai e la në heshtje Tajvanin. Me këtë ai u thotë Shteteve të Bashkuara të Amerikës se mund të qëndrojnë në Tajvan, në Japoni, në ishujt Okinava, në Birmani e gjetkë, dhe mbi këtë strategji të Maos Kina

e udhëheqësit e sotëm revizionistë kinezë kanë mbështetur politikën e tyre të jashtme dhe mbrojtjen. Me siguri udhëheqja kineze duhet të ketë pranuar që amerikanët mund të qëndronin edhe në Vietnamin e Jugut dhe të pushohej lufta, që vietnamezët të binin në miqësi me amerikanët. Për këtë arsye duhet të kenë lindur kundërshtimet në mes kinezëve dhe vietnamezëve, të cilët në një kohë deklaruan hapur që «Ne (vietnamezët) nuk lejojmë asnjë shtet tjetër të përzihet në punët tona të brendshme. ...».

Mao Ce Duni e akuzon Stalinin për aventurizëm të majtë, e akuzon se ka bërë presione të mëdha kundër Kinës dhe Partisë Komuniste të Kinës. Stalinin duhet të mos ketë pasur besim tek udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës. **Kur u çlirua Kina, Stalini ka shprehur dyshimin se mos udhëheqja kineze shkonte në rrugën titiste. Duke u hedhur një sy gjithë parimeve kryesore të vijës revizioniste të Mao Ce Dunit, për të gjitha ato që ngre kundër Stalinit, mund të themi me plot gojën se Stalini ka qenë me të vërtetë marksist-leninist i madh dhe ka parashikuar drejt se ku po shkonte Kina, ka parë me kohë cilat ishin pikëpamjet e Mao Ce Dunit, ka vlerësuar se ato në shumë drejtime ishin pikëpamje revizioniste titiste, si në politikën ndërkombëtare, edhe në politikën e brendshme, në luftën e klasave, në diktaturën e proletariatit, në bashkekzistencën paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore etj.**

Duke botuar këtë «dekalog» Hua Kuo Feni me shokë duan të legalizojnë vijën e tyre revizioniste, të legalizojnë veprimtarinë e tyre kundërrevolucionare, të legalizojnë ndërprerjen e Revolucionit Kulturor, sepse mendojnë se kështu do të peshkojnë më lehtë, megjithëse, siç e kam pasë shkruar më përpara, Revolucioni Kulturor në Kinë nuk ka qenë në baza revolucionare, por në baza oportuniste. Ai ka qenë luftë e një grupi oportunist me Mao

Ce Dunin në krye, kundër një grupi tjetër oportunist me Liu Shao Çinë, Çu En Lain, Ten Hsiao Pinin, Pen Çenin e të tjerë në krye, që kishin uzurpuar pushtetin. Mao Ce Duni ishte vënë në rrezik nga grupi kundërshtar dhe personi i tij do të hidhej në shportën e historisë, siç hodhi Maoja Liu Shao Çinë. Maoja diti të përfitonte nga kulti që ishte ngritur në qiell për të, megjithëse për kultin ai akuzon të tjerët si mburravecë. Këta mburravecë, sipas Maos, janë Stalini me shokë, Pra, Mao Ce Duni përfitoi nga kulti i shfrenuar që ishte ushqyer gjatë gjithë jetës për personin e tij, ngriti ushtrinë në këmbë, u mbështet tek ajo e te rinia shkollore dhe shpërtheu të ashtuquajturin Revolucion Kulturor. Por edhe këtë revolucion ai e pengoi të zhvillohej deri në fund, për arsye se rrezikonte të gjithë kuadrot oportunistë që bënin pjesë në grupin e Liu Shao Çisë dhe të Çu En Lait, rrezikonte edhe vetë Mao Ce Dunin. Prandaj, pas një kohe, e ktheu në drejtim tjetër timonin, mbështeti të djathtët dhe i dha fuqi Çu En Lait, i cili përpunoi dhe vuri në zbatim planet e tij.

Gjatë kësaj kohe elementë të rinj, që dolën në procesin e Revolucionit Kulturor, sidomos ata të «katërshes», që tash quhen «tradhtarë» nga Hua Kuo Feni, e shikonin këtë greminë të tmerrshme ku po e çonin Kinën dhe, me mënyrën e me metodat e tyre, që, siç duket, nuk ishin shumë të studiuara e të pjekura, mundet edhe jo plotësisht të drejta, por megjithatë ishin pak a shumë revolucionare, u përpoqën t'i vinin një kufi kësaj veprimtarie armiqësore, e cila e çonte Kinën në socialimperializëm. Me vdekjen e Maos, të djathtët arritën të marrin fuqinë. Ata përnjëherë, me një të rënë, siç e thonë, goditën elementët e së majtës dhe shtypën revolucionin. Pra, kundërrevolucionarët, që ishin futur në pushtet e në parti nga Mao Ce Duni dhe nga pasuesit e tij, e shtypën revolucionin në Kinë.

E PREMTE

31 DHJETOR 1976*

STRATEGJIA KINEZE PO PËSON FIASKO

Asgjë, asnjë veprim antimarksist i kinezëve nuk duhet të na çuditë. Veprimet dhe mendimet e Partisë Komuniste të Kinës, të Komitetit Qendror të saj dhe të Mao Ce Dunit i gjykojmë në dritën marksiste-leniniste që ndriçon Partinë tonë. Por asgjë e tyre nuk del në rrugën e teorisë sonë, për arsye se Partia Komuniste e Kinës nuk udhëhiqet nga teoria marksiste-leniniste.

Siç e kam thënë e shkruar edhe herë të tjera, kjo sëmundje e Partisë Komuniste të Kinës është një sëmundje që nisi që në fazën e fillimit të veprimtarisë së saj. Ajo me gabime e filloi këtë veprimtari dhe me gabime po e vazhdon, edhe në çështjet bazë të teorisë marksiste-leniniste, megjithëse për këtë veprimtari asgjë zyrtare nuk është shkruar. Flitet për luftëra fraksioniste që janë zhvilluar në gjirin e saj: çdo fraksion kritikonte dhe akuzonte tjetrin; njëri hiqej sikur ishte pro Kominternit, tjetri jo; njëri pretendonte se «udhëhiqej nga ideologjia e klasës punëtore» dhe e konsideronte këtë klasë si udhëheqëse të revolucionit proletar, tjetri konsideronte fshatarësinë në këtë rol udhëheqës etj.

Këto probleme, nga ana e Partisë Komuniste të Kinës, nuk janë analizuar asnjëherë në mënyrë shkencore, nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste, nuk janë parë me të vërtetë në kushtet e Kinës. Edhe në qoftë se janë bërë, në këto të ashtuquajtura analiza mbizotërojnë agji-

tacioni dhe propaganda me një frazeologji boshe dhe stereotipe, në formë dhe në përmbajtje idealiste, sofistike, të ngjashme me stilin e vjetër të shkrimeve budiste, idealiste dhe mistike, ku ngrihet dhe ekzaltohet kulti i atij personi që udhëheq dhe drejton «shpirtërisht» fraksionin.

Një fraksion i tillë ka qenë edhe ai i Maos, për të cilin nuk mund të flasim, sepse nuk dimë shumë gjëra të sakta, nuk dimë përse u përjashtua disa herë nga partia. Dimë se Maoja u shkëput, u bashkua, u përjashtua, pastaj u ripranua në parti e u rizgjodh në Komitetin Qendror dhe bëri «Marshimin e Madh». Ky marshim mbeti në histori dhe këtej fillon legjenda e Maos. Ai shkoi në Jenan dhe atje formoi pushtetin «sovjetik» të Jenanit. Po si e formoi? Maoja veproi si majtist, veproi duke u nisur nga pikëpamje eklektike «marksiste», nga pikëpamje të gabuara mbi luftën e klasave dhe mbi pushtetin e ardhshëm. Mund të kuptohet se me termin «sovjetik» ai e kishte fjalën për «këshillat» si organe të diktaturës së proletarietit, mirëpo, siç po na del më vonë, ky pushtet «popullor revolucionar» i Mao Ce Dunit na kishte qenë «pushteti i punëtorëve, i fshatarëve, i borgjezisë së vogël dhe i borgjezisë së mesme». Në këtë pushtet hibrid secila klasë kishte yllin e saj në flamurin shtetëror. Ky pushtet nuk u zhvillua dhe nuk u bë kurrë *de facto* dhe *de jure* diktaturë e proletarietit, kurse me fjalë dhe me propagandë u fol dhe flitet për të, se gjoja është diktaturë e proletarietit.

Pushteti në Kinë nuk mund të ishte dhe nuk është diktaturë e proletarietit, se një nga funksionet e kësaj është: të shtypë shfrytëzuesit, kundërrevolucionarët, armiqtë e klasës dhe të socializmit, funksion ky që në Kinë nuk është kryer. Në kundërshtim me tezat e Marksit dhe të Leninit, Maoja jo vetëm nuk ka luftuar kundër restaurimit të kapitalizmit në Kinë, jo vetëm e ka

pranuar këtë restaurim, por edhe e ka përgatitur me teorinë e tij antimarksiste.

Por pse ngjau kjo? Kjo ngjau se Maoja, duke mos qenë marksist, as ka punuar dhe as ka ndërtuar e kalitur një parti marksiste-leniniste të vërtetë. Partia Komuniste e Kinës nuk është parti e klasës punëtore, ajo nuk udhëheq diktaturën e proletariatit. Një diktaturë e tillë nuk ekziston në Kinë. **Pushteti në këtë vend është një pushtet demokratiko-borgjez përparimtar, dhe, siç e pohon Maoja, ky pushtet «udhëhiqet nga një koalicion partish me pikëpamje politike dhe ideologjike të ndryshme».**

Pra, në këto probleme kyç të teorisë marksiste-leniniste, siç janë diktatura e proletariatit, udhëheqja e klasës punëtore dhe e pararojës së saj, partisë komuniste, si dhe lufta e klasave, Mao Ce Duni është në rrugë oportuniste, revizioniste, ai është një socialdemokrat. Ky kritikues i Stalinit është për integrimin e borgjezisë dhe të kulakëve në socializëm, është një Buharin i ri, i fshehur me formula gjoja marksiste. Për çështjen e diktaturës së proletariatit Mao Ce Duni, një nxënës i ri i Bernshtajnit dhe i Kautskit, formulon slogane gjoja marksiste. Për çështjen e drejtimit të vendit nga shumë parti ai është një socialdemokrat borgjez si gjithë të tjerët dhe vepron duke maskuar pikëpamjet e tij të djathta me slogane të majta.

Luftën nacionalçlirimtare të popullit kinez Mao Ce Duni e ka udhëhequr në bazë të këtyre parimeve në dukje marksiste, por në thelb jomarksiste. Lufta e popullit kinez kundër pushtuesve ka qenë një luftë e drejtë, por që mund ta barazojmë me luftën e popullit algjerian kundër francezëve. Populli algjerian bëri një luftë të vendosur çlirimtare, të udhëhequr nga nationalistë borgjezë, kurse lufta e popullit kinez u udhëhoq nga borgjezia progresiste dhe nga komunistë të paqartë, të lëkundur, jo të vendosur në parimet dhe në normat e

një partie të vërtetë marksiste-leniniste, e cila i zbaton këto parime dhe këto norma drejt dhe në kushtet e vendit. Fjala është për parimet bazë që theksova më lart, sesa për aleancat me elementë demokratë, përparimtarë dhe jokomunistë, ky është një tjetër problem i madh për fitoren. Por roli i Partisë Komuniste të Kinës nuk duhej errësuar dhe udhëheqja e saj nuk duhej ndarë me partitë e tjera, siç e formulon Maoja në «dekalogun» e tij të prillit 1956. E gjithë kjo tufë teorish të ashtuquajtura marksiste-leniniste të Mao Ce Dunit është zbatuar e propaganduar në mënyrë eklektike, sipas rasteve, nevojave dhe situatave.

Mao Ce Duni dhe shokët e tij kanë ndërtuar gjatë 50 vjetëve një strategji dhe taktika jo për triumfin e revolucionit nën flamurin e marksizëm-leninizmit, por për triumfin e një Kine si fuqi e madhe botërore.

Në Kinë, si në të kaluarën edhe në të tashmen, është vepruar sipas pikëpamjeve mikroborgjeze. Vija kineze ka zigzage të vazhdueshme, strategjia e partisë ka qenë e paqëndrueshme, politika e saj me batica dhe me zbatika dhe jo siç i shtron këto çështje dialektika materialiste marksiste-leniniste.

Aleancat e jashtme kineze, edhe gjatë luftës, edhe pas luftës, kur u vendos pushteti popullor, nuk kanë qenë kurrë të qëndrueshme. Çka është e rëndësishme, këto aleanca nuk kishin baza parimore, revolucionare, por karakterizoheshin nga dredhi hipokrite dhe nga kthesa koniunkturale të bazuara në idenë e forcimit të Kinës si shtet i madh. Kina, ish-mike e Bashkimit Sovjetik në kohën e Stalinit, kur morën fuqinë hrushovianët, u bë mike me ta, dhe, kur nuk përfitoi gjë prej tyre, atëherë u bë mike me amerikanët. Nesër ajo mund të bashkohet edhe me sovjetikët, ajo do të bëhet edhe me titistët në një shkallë më të madhe.

Revolucioni Kulturor kinez ishte një luftë fraksio-

niste midis grupit të Maos dhe atij të Liu Shao Çisë. As klasa punëtore, as aleatja e saj, fshatarësia, dhe sidomos as udhëheqja e tyre, Partia Komuniste e Kinës, nuk morën pjesë në të, nuk e kuptuan rolin e tyre, nuk u vunë në lëvizje as nga njëri, as nga tjetri fraksion. Rolin vendimtar në këtë revolucion e luajti ushtria, që ishte me Lin Biaon dhe me Maon.

E ashtuquajtura Partia Komuniste e Kinës nuk ishte parti e revolucionit, sepse as që ishte edukuar për një qëllim të tillë. Ajo ishte më shumë një «parti fshatarësh», e cila, sipas traditave, priste kush të fitonte me anën e forcës ushtarake.

Fraksioni i Maos fitoi, por «revolucionin» ai e frenoi në mes të rrugës, ai pengoi dhunën revolucionare, sepse nuk ekzistonte diktatura e proletariatit. Maoja tok me Çu En Lain punuan intensivisht të rindërtonin gjendjen dhe të forconin pozitën e klanit në rrugën e tyre. Ata mënjantuan Kan Shenin, likuiduan Lin Biaon dhe Çen Po Tanë, njëkohësisht përgatiteshin të spastronin edhe «ferrrat» që u kishin ngelur nëpër këmbë, «katërshen», siç e quajnë.

Me vdekjen e Çu En Lait dhe të Maos, klani humbi udhëheqësit kryesorë. Vendi dhe klani mbetën pa kokë dhe kanë rënë në kaos të madh. Këta që mbetën udhëhiqen me hijen e të vdekurve, nga një ideologji antimarksiste, brenda dhe jashtë vendit. Strategjia reaksionare e Maos dhe e Çusë ka pësuar dhe po pëson fiasko. Ata të dy manovronin, Maoja me «prestigjin» e pamërituar të «patriarkut» dhe Çuja me djallëzitë e tij në skenë e në prapaskenë.

Revizionistët e rinj që kanë ardhur në krye të partisë dhe të shtetit në Kinë, vazhdojnë të notojnë në lllumin socialdemokrat, ku po futen thellë e më thellë. Kujtojnë se maska marksiste nuk do t'u çirret, por ata po e çjerrin vetë. Ata kujtojnë se «prestigji» i Maos dhe

i Çusë do t'i nxjerrë nga llemi, mendojnë se potenciali i Kinës, si ai territorial dhe ai i popullsisë së saj, do t'u imponohet marksistë-leninistëve, revolucionarëve dhe popujve përparimtarë. Por ata do të demaskohen, do të falimentojnë, do ta shpien deri në fund vijën antimarksiste të Maos dhe të Çusë dhe do ta çojnë Kinën më me revan në rrugën e një shteti borgjez kapitalist. Kështu do të ndodhë me siguri në rast se elementët e këtij grupi, të këtij fraksioni kundërrivolucionar nuk rrëzohen dhe në rast se nuk qërohen me fshesë të hekurt «hauret» e Maos dhe të Çusë, por këtë herë me një revolucion me të vërtetë të madh e proletar, të udhëhequr nga një parti komuniste e vërtetë marksiste-leniniste, me një diktaturë të hekurt të proletariatit dhe me një luftë klase, ashtu siç na mësojnë Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Kjo është rruga e vetme e shpëtimit të Kinës. **Rruga e Maos, Çusë, Tenit e Hua Kuo Fenit është rruga e kapitalizmit, rruga e reaksionit dhe e socialimperializmit.**

Duhet rrëzuar që nga themelet mitet dhe kultet e Maos dhe të Çusë, se vetëm kështu do të shpëtojë Kina nga kthetrat kapitaliste. Tradhtarët kinezë që kanë marrë fuqinë kërkojnë të konsolidojnë gjendjen; revolucionarët marksistë-leninistë kinezë duhet të luftojnë me armë në dorë, të mos kenë frikë nga revolucioni. Kjo është e vetmja rrugë e shpëtimit të Kinës.

A

Afrimi, lidhjet dhe bashkëpunimi kino-amerikan — 84-87, — 117, 134-137, 164-165, 196-200, 229, 251, 282-284, 291-292, 311-313, 351, 369, 370, 417, 423, 536-537, 543

Aleanca, bashkëpunimi, kontraktat sovjeto-amerikane dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tyre — 26, 27, 29-30, 54, 86-87, 128-130, 132-133, 136-137, 169, 172, 287, 312, 457

Aleancat — politika revizioniste e udhëheqjes kineze lidhur me aleancat — 84-87, 91-92, 107-108, 116-117, 136-137, 146-147, 164-165, 172-173, 228-231, 310, 313, 319, 351, 370, 526, 537, 543

Ambasada e RPSH në Kinë — 141, 177, 190, 207, 238, 292, 362, 368, 370, 383, 389-390, 394, 432-433, 480

Ambasada e RP të Kinës në RPSH — 42-43, 160-162, 179, 240, 342, 349, 378-379, 391, 397, 398, 408, 428, 431

Anarkizmi, pozitat anarkiste të udhëheqjes kineze — 106, 225-227, 232, 267-268, 350-351, 361, 411, 420-421, 468-469

Anglia, imperializmi anglez — 27, 39-40, 83, 87, 88, 94, 132, 202, 403

Arabia Saudite — 11, 21-22

Armatimi, çarmatimi, armët bërthamore dhe qëndrimet demagogjike të fuqive imperialisto-revizioniste ndaj këtyre problemeve — 9-12, 21, 24, 31, 35, 81-83, 129, 131, 146, 161-162, 200-201, 425, 427

B

Ballkani. E ashtuquajtura aleancë ballkanike e revizionistëve kinezë — 94-105, 162, 174-175, 294, 296, 484

Bashkekzistenca paqësore — kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizioniste mbi bashkekzistencën paqësore — 113, 135-136, 232-233, 334, 520, 536-538

Bashkimi Sovjetik në periudhën e Leninit dhe të Stalinit — 183-185, 535-536

Bashkimi Sovjetik socialimperialist, revizionizmi sovjetik — degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i jetës politik-shoqërore në BS — 286-289, 338, 518-519

— strategjia globale e social-imperializmit sovjetik. Bashkëpunimi me imperializmin e reaksionin. Sabotimi i lëvizjeve nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve — 9-12, 29, 36-38, 54-55, 59-60, 81-84, 85-87, 128-130, 131-133, 136, 138, 200-201, 202, 320, 325, 334-335, 337-338

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 230, 233-234, 306, 353-354, 423-424, 519-520

— marrëdhëniet nënshtruese e të diktatit ndaj partive dhe vendeve të tjera revizioniste — 96-97, 130, 173-174, 276, 287, 336, 356-358, 455, 457

— qëndrimet armiqësore ndaj RPSH — 23, 74-75, 91, 93, 110, 357, 400, 404-405, 425, 433

Shih edhe: Aleanca, bashkëpunimi, kontradiktat sovjetiko-amerikane dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tyre; Superfuqitë dhe lufta kundër tyre. Përpjekjet e revizionistëve kinezë për ta shndërruar Kinën në superfuqi

Borgjezia. Borgjezia e re revizioniste — 14-16, 39, 54, 81-82, 87-88, 153, 184, 212, 273-274, 286-287, 331, 351, 411, 420, 455-456, 477, 495-496, 541

Bullgaria — gjendja e brend-

shme dhe politika e jashtme — 11, 28, 55, 95, 96-97, 103, 105, 130, 156

D

Delegacione e vizita të krerëve të vendeve imperialiste e revizioniste në Kinë — 64, 65, 118, 181, 192, 196-202, 311, 326, 443, 520

Diktatura e proletariatit — tradhtia e revizionistëve ndaj saj — 49, 224, 226, 253, 288, 318, 336, 350, 424, 472-473, 520, 531-532, 534-535, 541-542

Diplomacia borgjezo-revizioniste — 9-10, 107, 137, 147, 456-457

E

Egjipti — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme. Veprimtaria agresive e superfuqive dhe e Izraelit ndaj tij — 10-11, 26, 295, 320-321, 324-325, 340

Ekonomia kineze; marrëdhëniet ekonomike të Kinës me vendet e tjera — 93, 108-109, 117, 166-167, 252, 368, 369, 423, 523-528

Engels, Frederik — 110, 183, 215, 223, 247, 351, 363, 416, 452, 471, 490, 504, 545

Evropa. «Evropa e Bashkuar», «Sigurimi Evropian» dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë

ndaj tyre — 28-29, 40, 73, 80, 82-85, 120-121, 125, 126, 127-133, 174-175, 194, 199, 251, 338, 384

F

Fashizmi dhe fashistët në kohën e sotme; lufta kundër tyre — 184, 187-189, 327-331, 495-496

Franca, imperializmi francez — politika e jashtme e Francës — 27, 28, 39-40, 82, 87, 88, 133, 201-202

Fshatarësia kineze. Pikëpamjet antimarksiste të udhëheqjes kineze ndaj fshatarësisë. «Fshati të rrethojë qytetin» — 223-225, 227, 228, 248, 410, 411, 420, 472-473, 527-528

G

«Gardistët e kuq» (hunveibinët) në Kinë — 225-227, 250-251, 309, 361, 412, 419-420, 425, 444, 543-544

Greqia — politika e jashtme dhe gjendja e brendshme e Greqisë — 11, 28, 36, 94, 103-105, 188

— qëndrimet ndaj RPSH; reaksioni grek kundër Shqipërisë — 104, 182, 188, 242, 478

GJ

Gjermania — para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore — 88, 184, 523

— Republika Federale Gjermane, revanshizmi gjerman — 39, 71, 82-83, 87, 131-132, 133, 201-202, 212-213

— problemi i dëmshpërblimeve për Shqipërinë — 71, 216

H

Historia e Kinës. Trajtimi antimarksist i saj nga udhëheqja kineze — 287-289, 521, 541-543

I

Imperializmi e strategjia globale e tij; afrimi e bashkëpunimi midis vendeve imperialiste e revizioniste. Kontradiktat, kriza e sistemit imperialist — 13, 25-27, 35, 74, 83-84, 87-88, 94, 166-167, 184, 334, 337-338, 455

Internacionalizmi proletar. Qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj këtij parimi — 14-15, 32-33, 40, 89-90, 404-405, 414, 502

Internacionalja Komuniste (Komininterni) dhe pikëpamjet e revizionistëve kinezë ndaj saj — 303-304, 330, 332, 415-416, 490, 494-496, 504, 507, 540

Italia — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme — 28, 189, 202, 327-332, 336, 338-339

Izraeli — vegël e imperializmit; politika agresive e tij ku-

ndër vendeve arabe — 26, 38-39, 67, 324-325

J

Japonia, imperializmi japonez — 82-83, 146, 303-304

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav

— degjenerimi i LKJ, i jetës politike dhe ekonomiko-shoqërore. Konfliktet dhe grindjet nacionale — 13-17, 98-99, 173-174, 188-189, 195, 263, 265-275, 358, 455-457

— bashkëpunimi dhe lidhjet e revizionistëve jugosllavë me fuqitë imperialiste e revizioniste; politika demagogjike e mashtruese e titistëve — 11, 97-101, 105, 112-114, 201, 321-323

— lidhjet dhe bashkëpunimi jugosllavo-kinez — 102-103, 171-175, 228-231, 369, 373-374, 530

— qëndrimet armiqësore ndaj RPSH — 15, 91, 93, 101-102, 110, 188-189, 209, 322-323, 374, 400, 404-405

K

Kamboxia — lufta e popullit kamboxhian për çlirim kombëtar. Marrëdhëniet me RPSH — 18-20, 34, 35-36, 38, 70, 206, 208

«**Katërshja**» (banda e katërshes) në Kinë — 281, 282, 381, 413-414, 419, 422, 428, 436-440, 442-443, 446-449, 470

Kina — Partia Komuniste e Kinës

— historia e saj — 163-164, 224-225, 247-253, 298-307, 468-469

— konfuzioni politik, ideologjik dhe organizativ në parti (kaosi, vijat, komplotet, lufta për pushtet) — 139-140, 190-191, 221-228, 247-254, 255-256, 278-279, 281-285, 290-292, 298-309, 312-315, 350-352, 353-355, 360-364, 368-369, 380-382, 386-387, 409-414, 415-421, 422-426, 434-435, 436-451, 462-464, 467-471, 472-477, 518-539, 540-545

— Kongresi i 8-të i PKK, plenumet e komitetit qëndror të saj — 223, 312, 316, 353, 443, 462-463, 467, 518-519, 533

— perspektivat e lëvizjes marksiste-leniniste në Kinë — 256, 424-425, 471, 545

Kina — politika e jashtme

— qëndrimet oportuniste, pro-imperialiste të revizionistëve kinezë — 32-33, 73, 80-87, 106, 109, 134-139, 146-147, 163-169, 174-175, 194, 196-202, 228, 231, 233-234, 294, 525, 533-535

— afrimi dhe bashkëpunimi me qeveritë, partitë e klikat reaksionare të vende-

ve të ndryshme. Politika e «botës së tretë» dhe e «vendeve të paangazhuara» — 33, 74, 85, 106-108, 116-117, 137, 154, 164-166, 174, 198, 202, 228-230, 232-233, 282-283, 310-311, 318, 351, 370, 384, 422-423, 472, 501, 536-539

— përkrahja për partitë revizioniste dhe pozitat antimarksiste ndaj lëvizjeve komuniste dhe çlirimtare të popujve — 134, 135-138, 157, 158-159, 165-167, 192, 229-232, 251, 317-318, 500-507, 515-517, 536

— marrëdhëniet, kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 84-87, 91-92, 107, 116, 134-137, 164-165, 172, 228-229, 233-234, 305-308, 312-313, 351, 354, 415-417, 422-423, 499-500, 518-519, 527-528, 536-537, 543

— marrëdhëniet me Jugosllavinë — 75-76, 91-92, 97, 101-103, 169, 171-176, 177, 228-229, 231, 347, 369, 373-374, 484, 529-530

— marrëdhëniet me revizionistët rumunë — 64, 66, 75-76, 95-96, 103, 153-156, 228-229, 231, 247, 369, 373, 404

— marrëdhëniet, kontradiktat me Vietnamin — 146, 193, 538

— afrimi, lidhjet me Japoninë — 146, 369, 525

— marrëdhëniet me RF Gjer-

mane — 5, 71, 108, 181, 369 — qëndrimet antimarksiste ndaj PPSH dhe RPSH. Zvarritjet dhe sabotimi i furnizimeve, i pajisjeve dhe i kredive për Shqipërinë — 41-43, 72-77, 78-79, 89-93, 109-110, 115-117, 141-144, 168-170, 218, 221-222, 234-237, 244-246, 258-260, 311, 313-314, 346-348, 369-370, 373-374, 383-385, 389-393, 405-406, 426-429, 432-433, 480-483, 486-487, 499-500, 506-512, 516-517

Klasa punëtore në Kinë, në vendet kapitaliste e revizioniste — 164, 223-224, 225-226, 248, 330-331, 410, 420, 470, 521

Klasat dhe lufta e klasave; qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj këtij problemi — 137-138, 145-147, 164, 172, 187-188, 198-199, 225, 227, 251-252, 332-333, 336, 386, 409, 411, 464, 472, 512-513, 520, 521, 532-535, 538

KNER-i dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tij — 27-28, 156, 166, 287

Kolonializmi, neokolonializmi — 31-32, 83, 133

Kontradiktat në shoqërinë kapitaliste e revizioniste — 15, 85, 103, 188, 198, 282, 423

Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në Jugosllavi

— gjendja e brendshme në Kosovë. Politika shoviniste e revizionistëve jugosllavë ndaj shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në

Jugosllavi — 16, 98, 99, 189, 195, 277, 377
— marrëdhëniet e Kosovës me RPSH — 152, 366-367, 376-377

L

Lenin, Vladimir Iliç

- klasik i marksizmit; qëndrimi i revizionistëve kinezë dhe i revizionistëve të tjerë ndaj Leninit — 47, 49-51, 74, 85, 110, 183-185, 210, 215, 223, 226, 233, 247, 300-301, 330, 363, 416, 420, 471, 475-476, 491, 495, 506, 541
- qëndrimi parimor marksist i PPSH ndaj Leninit dhe veprës së tij — 46, 48, 324, 351, 452, 490, 502, 504, 507, 512, 521, 523, 524, 528, 529-532, 545

Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndërkombëtare

- strategjia dhe taktikat e partive marksiste-leniniste — 57, 85, 167, 168, 211-212, 350-352, 451, 452, 500-503, 506-507, 511-512
- partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine dhe veprimtaria agjenturore kineze kundër tyre — 479, 515-516
- Partia Komuniste e Australisë (m-l) dhe devijimet revizioniste të E. Hillit. Veprimtaria armiqësore kundër PPSH — 454, 489-492, 493-507, 511-512

- Partia Komuniste e Italisë (m-l) — 158-159
- Partia Komuniste e Brazilit — 453, 461, 465
- Partia Komuniste e Hollandës — 317-319
- Partia Komuniste e Spanjës (m-l) — 157
- Partia Komuniste e Birmanisë — 192
- Partia Komuniste e Suedisë — 243
- Partia Komuniste e Gjermanisë (m-l), marrëdhëniet e saj me PPSH — 211-215, 217, 478-479
- Partia Komuniste e Kolumbisë (m-l) — 149
- Partia Komuniste e Argjentinës — 478, 479
- Partia Komuniste e Polonisë. Qëndrimet provokuese ndaj PPSH — 44-51, 57-58

Lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve

- 29, 30, 32-33, 35, 36-37, 40, 85, 88, 166, 214
- Lindja e Mesme. Mesdheu* — 10-11, 21-22, 28, 38, 83, 133, 321-322
- Lufta. Imperializmi dhe revizionizmi si burim luftërash e agresionesh. Politika luftënxitëse e revizionistëve kinezë* — 9-11, 31, 55, 81-83, 129-130, 200-201, 320-321

M

«Maocedunideja». Kultit i Mao Ce Dunit — 227-228, 283, 300-

-301, 350-352, 353, 363-364, 384, 385-386, 467-468, 471, 474-475, 504-506, 522, 534-535

Marksizëm-leninizmi — armë dhe busull për udhëheqje e veprim. Qëndrimi armiqësor i revizionistëve kinezë ndaj m-l. Mbrojtja e tij nga PPSH —

169, 185-186, 227-228, 233, 318-319, 351-352, 353, 363, 385, 396, 410, 415-416, 417, 420-424, 428-429, 464, 468-469, 471, 474-475, 484-485, 501, 503-504, 520-521, 540-543

Marks, Karl — 51, 110, 183, 185, 215, 223, 226, 247, 286, 300-301, 351, 363, 416, 420, 452, 471, 476, 490, 504, 506, 507, 521, 522, 541, 545

Mbrojtja e atdheut; përgatitja e popullit shqiptar për mbrojtje. Sabotimet kineze në këtë fushë — 23, 74, 75-76, 91-93, 169-170, 347, 349, 401-406, 437-440, 512

Ministria e Punëve të Jashtme e RPSH — 216, 479

Ministria e Tregtisë së Jashtme e RPSH — 487

N

NATO; qëndrimi i Kinës ndaj saj — 27, 39, 166, 201

O

Organizata e Kombeve të Bashkuara — 148, 176

P

Parlamentarizmi — 232-234, 333, 334-336, 339

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e saj kundër:

- revizionizmit modern — 288-289, 334, 337, 353-359, 405-406, 502
- revizionizmit sovjetik — 101, 124, 286-289, 293, 458
- revizionizmit jugosllav — 101-103, 119-121, 124, 152, 241, 257, 263, 265-275, 321-323, 458
- revizionizmit kinez — 124, 227-228, 230-231, 236, 311-313, 363, 391-392, 395-396, 400-401, 405-406, 421-422, 424, 440-449, 459, 472-477, 480-481, 497, 498, 508-513, 544-545
- disa partive revizioniste të Evropës (Italisë, Francës, Spanjës) — 54, 261, 288, 329-339, 358

Partia e Punës e Shqipërisë — marrëdhëniet e saj me partitë marksiste-leniniste

- vija m-l në politikën e jashtme — 30, 85, 92-93, 167, 169-170, 184-185, 221, 254, 276, 404, 405, 427-430, 459-460, 466, 481, 491-492, 497-498, 501, 510, 540
- përkrahja dhe ndihma internacionaliste për partitë marksiste-leniniste — 47, 48, 159, 185-186, 318-319, 344, 351, 352, 353, 478-479, 497-501, 510-511
- marrëdhëniet, kontradik-

- tat me PK të Kinës — 69, 90, 139, 144, 167, 190-191, 210, 221, 229, 235, 238-239, 309-310, 375, 378-379, 383-384, 393-396, 425-430, 470, 481-485, 488, 497, 501-502, 512, 516-517
- takime, bisedime me përfaqësues të partive e të lëvizjeve m-l — 451, 452, 515-516
- Partitë komuniste marksiste-leniniste**
- Shih: Lëvizja komuniste marksiste-leniniste ndër-kombëtare
- Politika e jashtme e RPSH**
- qëndrimet parimore m-l në marrëdhëniet me vendet e tjera dhe përkrahja e luftërave revolucionare. Lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit — 23, 29, 30-33, 40, 73-74, 77, 92-93, 103, 119-121, 128, 137, 138-139, 168-170, 187-189, 232, 319, 321, 323-325, 340, 341, 343, 403, 482-483, 488, 501-502
- forcimi i autoritetit të RPSH në botë — 178, 404
- përkrahja dhe ndihma internacionaliste për Vietnamin — 52, 54-55, 56, 466
- marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 6, 33, 74, 111, 143, 144, 160-162, 180, 258-260, 261, 390-393, 428-429, 431, 481-485, 487-488
- përkrahja internacionaliste për Kamboxhian — 18-20, 34, 56, 70, 206
- qëndrimi ndaj Jugosllavisë — 103, 209, 241, 321-322, 340
- qëndrimi parimor m-l i RPSH ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi — 102, 151-152, 204-205, 257, 366-367, 376-377
- të huajt, miqtë e dashamirësit për Shqipërinë — 167-168, 178, 206, 244, 276, 328-329, 370, 429-430
- Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist** — 93, 102, 106, 119, 141-142, 145, 230, 234, 277, 278-279, 307-308, 331, 358, 362, 378, 386-387, 415, 422-424, 540-541
- Propaganda dhe shtypi i RPSH.**
- Propaganda për botën e jashtme** — 119-121, 125, 126, 128, 132, 263, 286-289, 293, 296, 343-344, 366, 378-379, 510-511
- Q**
- Qiproja — konflikti turko-grek për Qipron** — 11, 28, 104, 188
- R**
- Revizionizmi modern, vendet revizioniste**
- revizionistët modernë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe armiq të popujve — 54, 100-101, 146,

- 185, 227-228, 232-233, 332-333, 339, 380-381
- kontradiktat dhe kriza në gjirin e revizionistëve.
- Mbledhjet e partive revizioniste — 25-26, 37, 166-167, 338, 356-358
- qëndrimet armiqësore ndaj PPSH — 74-75, 348, 357
- Revolucioni kinez** — 289-290, 364, 521, 522-523, 543
- Revolucioni kulturor në Kinë** — 115, 139-140, 145-146, 225-227, 250-251, 256, 284-285, 308-309, 361, 374-375, 412, 418-420, 424-425, 444, 445, 471, 538-539, 543-544
- Revolucioni socialist, konceptet revizioniste të kinezëve ndaj tij** — 183-184, 233, 425, 429, 533-534
- Rumania**
- politika e jashtme oportunisto-revizioniste e udhëheqjes rumune — 11, 37, 66, 75-76, 105, 130, 153-156, 161-162, 231, 369, 373
- qëndrimet ndaj RPSH — 95-96, 110
- S**
- Spionazhi, agjuntura e huaj** — 11, 46-47, 75, 92, 188-189, 287, 345-348, 399-402, 455, 456, 493, 511, 515, 517
- Stalin, Josif Visarionoviç**
- klasik i m-l, mbrojtja e Stalinit dhe e veprës së tij nga PPSH — 88, 110,
- 183-184, 210, 215, 319, 374, 405, 452, 490, 495, 504, 523, 529, 532, 535, 543, 545
- lufta e revizionistëve jugosllavë e hrushovianë kundër Stalinit dhe veprës së tij — 112-113, 134, 177, 195, 334, 404-405, 423, 518, 522
- qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj Stalinit — 159, 171, 222-223, 231, 247, 301, 303-307, 353-354, 374, 415-416, 471, 474, 519, 520, 522, 527, 528, 538
- Superfuqitë dhe lufta kundër tyre. Përpjekjet e revizionistëve kinezë për ta shndërruar Kinën në superfuqi** — 9-12, 13, 28, 31-33, 40-41, 134-135, 161-162, 166, 187, 197-200, 211-213, 228, 230, 314, 319, 320-321, 385, 415, 422-423, 502, 505
- SH**
- Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan**
- strategjia globale, politika e luftës dhe e agresionit në Vietnam e në vende të tjera; disfatat e SHBA — 5-12, 21-23, 24-29, 35-40, 53-55, 60, 81-84, 86-87, 94, 128-129, 136, 311, 425
- marrëdhëniet, kontradiktat me shtetet imperialiste e revizioniste — 25-27, 329, 338
- qëndrimet armiqësore të

SHBA ndaj Shqipërisë dhe lëvizjeve revolucionare në botë — 74-75, 403, 433

Shih edhe: Afrimi, lidhjet dhe bashkëpunimi Kinë-Amerikan; Aleanca, bashkëpunimi, kontradiktat sovjeto-amerikane dhe qëndrimi i revizionistëve kinezë ndaj tyre

T

Traktati i Varshavës — 27-28, 74, 130-131, 156, 166

Tregu i Përbashkët Evropian — 29-30, 74, 80-81

Turqia — politika e jashtme dhe gjendja e brendshme — 11, 28, 94, 103-104

U

Ushtria kineze. Qëndrimi i revizionistëve kinezë lidhur me vendin dhe rolin e ushtrisë — 233, 248-249, 251, 418-419

V

Vendet arabe, popujt arabë — 10-11, 26, 38-39, 324-325

Vietnami — lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë; marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 21, 38, 51, 53-55, 59-60, 146, 193, 538

Vigjilenca revolucionare — 15, 23, 169-170, 187-188, 400, 404-406, 427-429, 491-492, 512-513

A

Adenauer, Konrad — 82
Aidit, Dipa Nasuntora — 112
Al Bakri, Ahmed Hasan — 26, 116
Alia, Ramiz — 124, 158, 203, 211, 241, 243, 262, 264, 286, 293, 294, 317, 341, 366-367, 376, 408, 452, 461, 466, 478, 479, 489, 493, 515
Amazona, Zhoao — 453, 461, 465
Andropov, Juri — 115
Arboleda, Pedro Leon — 149
Arruda, Dionis — 461, 465
Aust, Ernst — 211, 217
Averof, Evangjelos — 182, 188

B

Bajazit, Jellđerëm — 40
Bakalli, Mahmut — 373
Bakunin, Mihail — 226
Balluku, Beqir — 46, 75-76, 91-92, 93, 142, 143, 144, 155, 161, 236, 246, 345-348, 374, 392, 400-403, 426, 435
Barzan — 22
Bauer, Edgar — 333
Berlinguer, Enriko — 262, 335-336, 339, 358, 433
Bernshajn, Eduard — 330, 332-333, 542

TREGUESI I EMRAVE

Bicios, Dimitrios — 242
Bijediç, Xhemal — 169, 174-175, 177, 373
Bluher, Vasili — 303
Bodnarash, Emil — 154
Bonaparti, Napoleon — 127
Boris III — 97
Borxhia, Papa Aleksandër i 6-të — 127
Brand, Vili — 39
Brauder, Earl — 333
Brezhnjev, Leonid — 10, 40, 113, 127, 128, 131, 132, 234, 356, 357, 358, 425, 454, 456
Buharin, Nikola — 542
Buto, Ali Zylfikar — 26, 116

C

Cacos, Kostandin — 162, 183
Cami, Tefta — 376-377
Cedenbal, Jumzhagin — 55

Ç

Çako, Hito — 75, 143, 246, 345-346, 400, 402
Çan Çun Çiao — 158-159, 252, 253, 264, 281, 381, 412, 413, 419, 422, 428, 438-440, 442, 446-447, 470
Çan Kai Shi — 227, 302, 303, 472, 526

Çarçani, Adil — 43, 69, 72, 77,
78-79, 89-90, 92, 93, 109, 347,
349

Çausheku, Nikolae — 37, 66,
95-96, 113, 128, 153-156, 172,
208, 228, 358, 384, 455

Çen Po Ta — 116, 226, 251,
256, 291, 381, 412, 417, 442,
470, 544

Çian Çin — 160, 253, 281, 284,
313, 381, 412, 413, 419, 422,
424, 428, 438-440, 442, 443,
447-449

Çiao Kuan Hua — 238

Çu De — 301, 365

Çu En Lai — 12, 63, 72-76, 99-
-105, 109, 171, 190-191, 238-
-239, 250-253, 255-256, 281-
-285, 306-312, 347, 354-355,
360-362, 401-406, 409-414, 415-
-421, 425-426, 436-446, 462-
-464, 467-468, 499-501, 544-545

D

Daut, Muhamed — 116

D'Estën, Zhiskar Valeri — 27,
28, 83, 87, 127, 131, 132, 198,
201

Deva, Xhafer — 152, 277

Dë Gol, Sharl — 82

Dë Kastri — 25

Dimitrov, Gjergj — 97, 490,
495, 504

Dinuçi, Fosko — 158-159

Dode, Petro — 69

Dume, Petrit — 75, 246, 346,
400

Duraku, Emin — 8

Duraku, Rexhep — 8

Dyklo, Zhak — 490, 496

F

Fanfani, Amintore — 229

Fan Ji — 78

Feisal, Ibn Azis — 21

Ford, Xherald — 21, 23, 24-25,
38, 128, 131, 132, 146, 165,
169, 196-200, 282

Franko, Françisko — 107, 157,
164, 166, 172, 193, 229, 230,
251, 311, 351, 384

Fuçik, Julius — 458

G

Gën Biao — 65, 159, 171, 515

Gierek, Eduard — 358

Graci, Anxhelo — 159

Gramshi, Antonio — 330

Gripa, Zhak — 47

Gromiko, Andrei — 132

Gusho, Pirro — 403

GJ

Gjoni, Xhelil — 264

H

Hamiti, Abdyl — 112

Hazbiu, Kadri — 399

Hill, Eduard — 203, 454, 489-
-492, 493-497, 511

Hitler, Adolf — 32, 88, 112, 184

Hith, Eduard — 150, 198, 229

Honeker, Enrik — 358

Hoxha, Nexhmije — 203

Hoxha, Fadil — 102

Hrushov, Nikita — 44, 46, 50,

110, 136, 222-223, 232, 291,
306-308, 334, 335, 353-354, 385,
405, 423, 425, 481, 492, 518-
-520, 526-528

Hua Kuo Fen — 316, 355, 413-
-414, 415, 417, 422-424, 434-
-435, 439-444, 449, 450, 459,
462-464, 474-477, 505-506, 518,
520, 538-539

Husak, Gustav — 358

Huver, Herbert Klark — 22

I

Ibarruri, Dolores — 185

Isai, Hekuran — 63

Ivanaj, Fran Ndue — 209

J

Janekoviç, Dara — 265-276

Jao Ven Juan — 63, 253, 281,
310, 381, 412, 413, 419, 422,
424, 438, 442, 447, 470

Jeh Çien Jin — 236, 477

Jorgo II — 104

Judin, Pavël — 300

K

Kadar, Janosh — 491

Kan Shen — 210, 304, 381, 412,
442, 470-471, 544

Kao Gan — 299

Kapo, Hysni — 69, 78, 182, 453

Karajanis, Dionis — 242

Karamanlis, Kostandin — 11,
104

Karter, Xhimi — 457

Karriljo, Santiago — 230, 358

Kasaroli, Agostino — 127

Kastro, Fidel — 233

Kati, Vasil — 400

Kautsk, Karl — 333, 542

Kazhimiezh, Mijal — 44-47,
57-58

Këllezi, Abdyl — 75, 76, 91, 92,
93, 142, 143, 144, 161, 236,
246, 345-348, 392, 399-403, 426,
433, 435

Kim Ir Sen — 68, 122, 146

Kisinger, Henri — 10-11, 21,
23, 25, 26, 311, 336, 443, 520

Koleka, Spiro — 349

Kon — Bendit, Daniel — 232

Konfuci — 252, 297-298, 301,
447, 448

Konjev, Ivan — 345

L

Leone, Xhovani — 202, 338

Libkneht, Karl — 215

Li Çian — 42-43, 64, 278, 389-
-390, 432, 433, 487

Li De Shen — 145

Li Hsien Nien — 64, 72-73, 89-
-90, 109, 110, 115-117, 190-
-191, 278, 291, 310, 387, 413,
414, 415, 423-424, 477, 480, 485,
505

Li Li San — 247, 248, 252

Lin Biao — 116, 139-140, 250-
-253, 284, 299, 309, 312, 354-
-355, 361, 381-382, 385, 412,
417, 428, 443, 448, 470, 481,
544

Lindblom, Aka Per — 243

Liu Shao Çi — 107, 113, 197,
222-223, 249-251, 255, 281,
283-284, 290, 292, 299-300,

306-309, 361-362, 417-418, 445-446, 471, 484, 518, 539, 544
Liu Xhen Hua — 179, 349
Ljubičić, Nikola — 15
London, Xhek — 175
Longo, Luixhi — 496
Lon Nol — 18-19, 24, 35-36
Luciano, Luki — 22
Luksemburg, Roza — 215

LL

Lleshi, Haxhi — 206

M

Makarinos, Elefterios — 127
Mao Ce Dun — 90-91, 107, 190-191, 196-197, 221-236, 247-252, 278, 282, 285, 290-292, 299-301, 304-314, 353-355, 360-364, 380-382, 409-414, 415-421, 425-426, 434-435, 436-449, 462-464, 518-539, 542-546
Markos, Ferdinand — 108, 202
Marshall, Xhorxh — 304
Marshe, Zhorzh — 101, 262, 336, 358
Marti, Andre — 496
Metaksa, Janis — 104
Miki Takeo — 146
Mikojan, Anastas — 43, 309, 405, 487
Minić, Millosh — 322, 323
Mobutu, Sese Seko — 164
Molotov, Viaçeslav — 222, 306, 519
Monro, Xhejms — 39
Mubarak, Hosni — 326
Mugosha, Dushan — 16
Muka, Qerim — 257

Murra, Prokop — 486
Musolini, Benito — 112, 328

N

Nagi, Kosta — 373
Nase, Nesti — 71, 216
Naser, Abdel Gamal — 113, 325
Nashi, Lipe — 75, 403
Nehru, Xhavaharlal — 113
Nguyen Van Thieu — 20-21, 24, 36
Ngjela, Kiço — 399, 400, 433
Nikson, Riçard — 23, 54, 282-283, 291, 311, 417, 443, 483, 537
Nkruma, Nkvame — 113

P

Pahlevi, Ashraf — 62, 202
Pahlevi, Mohamed Reza — 62, 116
Papadhopulli, Jorgo — 11, 104
Pavli VI, Papa — 25, 26
Pavlo (mbret i Greqisë) — 104
Pen Çen — 223, 381, 415, 420, 446, 539
Pen Nut — 34
Peshe, Osvaldo — 159
Pin De Huai — 249-250, 299
Pinoçet, Augusto — 107, 157, 164, 166, 172, 198, 229, 251, 311, 351, 384
Polit, Harri — 495
Polo, Marko — 297
Pompidu, Zhorzh — 83

Popa, Agim — 44, 57, 58
Popoviç, Miladin — 16-17
Pospjelov, Pjotër — 115
Prudon, Pjer — 226

R

Ralis, Kostandin — 188
Rankoviç, Aleksandër — 277, 455
Rusvelt, Franklin — 29

S

Sadat, Anvar — 10, 325
Saragat, Xhuzepe — 338
Sarin Çak — 70
Sartr, Zhan Pol — 229, 351
Sihanuk, Norodom — 18-20, 70, 206, 208
Sirit Matak — 18
Smit, Jan — 107
Snou, Edgar — 304, 421
Suharto, I. — 112-113, 309
Sukarno, Ahmed — 112-113
Sun Jat Sen — 302
Suslov, Vasili — 425

Sh

Sharki, Lorens — 490, 495
Shehu, Mehmet — 459-460
Shelepin, Aleksandër — 27
Shell, Valter — 201
Shmid, Helmut — 131, 181
Shtirner, Maks — 226
Shtraus, Jozef — 5, 108, 198, 229

T

Tashko, Koço — 525
Telman, Ernest — 215
Ten Hsiao Pin — 57, 145, 155, 177, 196-202, 249-250, 256, 278-279, 283-285, 290-293, 307-309, 360-364, 368, 381-382, 417-418, 420, 422, 423, 428, 539
Timurlengu — 40
Tito, Josif Broz — 14, 97-101, 112-113, 128, 142, 171-175, 185, 188-189, 195, 265-275, 358, 374, 422, 455-457
Toliati, Palmiro — 101, 185, 329-330, 335, 337, 490, 495-496
Torez, Moris — 101, 335, 490, 495
Toska, Haki — 78
Trocki, Leon — 330
Truman, Harri — 22

Th

Theodhosi, Koço — 75, 76, 142, 347, 399-400, 402-403, 433

U

Uilson, Tomas — 132, 202
Ulbricht, Valter — 185
U Ne Vin — 192

V

Vandemejer — 304
Van Hun Ven — 253, 283, 381, 412, 413, 419, 422, 436-438, 442-443, 447, 467, 470

Van Min — 247, 248, 252, 283
Venizellos, Themistokli — 104
Vorms — 127

Y

Y Khan — 362, 391-392

Z

Zaharov, Bazil — 10

Zengo, Koci — 44, 57
Zogu, Ahmet — 100, 152
Zogu, Lekë — 151

Zh

Zhivkov, Todor — 95, 96, 97,
104, 231, 491
Zhyrke, Zhak — 198

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

Afganistan — 26, 31
Afrikë — 25, 38, 133, 310-311
Aleksandropol — 104
Algjeri — 542
Amerika Latine — 178, 515-
-516
Azi — 25, 55, 83, 129, 162, 202

B

Bagdat — 22
Bangladesh — 31
Bari (Itali) — 328
Beograd — 167, 322, 458
Berlin — 131-132, 356, 358, 403
Birmani — 133, 192, 537
Bolivi — 166
Bon — 71, 108
Bosnjë (Jugosllavi) — 98, 204
Bratislavë (Çekosllovakia) — 458
Bukuresht — 115, 516, 519
Bushat (Shkodër) — 78-79

C

Çekosllovakia — 38, 130
Çikago (SHBA) — 23

D

Danang (Vietnam) — 21
Dibër — 101

Dodekanez (Greqi) — 104
Dubrovnik (Jugosllavi) — 321

E

Elbë (ishulli ~) — 127
Eritre — 31
Etiopi — 31

F

Fenan (Kinë) — 383
Fier — 217, 403
Filipinë — 202

G

Goli-Otok (Jugosllavi) — 113
Gomindan (Kinë) — 247, 290,
302-304, 395, 440, 477, 531

GJ

Gjakovë (Jugosllavi) — 8
Gjiri Persik — 38
Gjirokastër — 204

H

Hani i Hotit (Shkodër) — 205
Hanxhou (Kinë) — 139, 145
Hercegovinë (Jugosllavi) — 98,
204

Hydrocentrali i Fierzës — 76
Hydrocentrali i Komanit — 78-79
Hong-Kong (Kinë) — 369
HSINHUA — 5, 61, 62, 63, 118, 150, 181, 192, 245, 264, 294, 316, 326, 365, 450, 505
Hue (Vietnam) — 21

I

Indi — 31, 105, 146, 178, 202, 500
Indonezi — 112-113, 133, 138
Internacionalja e Dytë — 85
Irak — 116, 118
Iran — 11, 26, 116

J

Jemen — 31-32, 521, 541

K

Kanton (Kinë) — 142
Kili — 137, 157
Kombinati Metalurgjik — Elbasan — 76, 258, 383, 388, 390
Konferenca e Helsinkit për «Sigurimin Evropian» — 125, 127-132, 140

Kore — 68, 122, 177
Kotorr (Jugosllavi) — 321
Kuantri (Vietnam) — 21
Kukës — 205

L

Labinot (Elbasan) — 525
Laos — 137
Lesoto — 63

Lezhë — 205
Liban — 26
Lima — 148
Lindja e Largme — 83
Lipari (ishujt ~) — 300
Londër — 493, 497, 505

M

Madrid — 157
Mali i Zi — 16, 98, 99, 100, 152, 204-205
Maqedoni — 16, 97, 98, 99, 100, 104, 152
Mat — 45, 50
Mekong (delta ~) — 20
Mongoli — 55, 116, 312
Moskë — 97, 115, 198, 201, 283, 288-289, 305, 330, 335, 429, 529-520

N

Nju-Jork — 23, 178

O

Okinava (ishujt ~) — 537
Olimp (Greqi) — 449
Oman — 11, 22
Oqeani Indian — 67
Otranto (kanali ~) — 322

P

Pakistan — 31, 116, 133, 202
Palestinë — 11
Paris — 61, 108, 127, 454, 489, 493
Pekin — 41, 118, 140, 141-142, 164, 190, 207, 230, 234, 245, 259, 307, 347, 378, 388, 390, 397, 422, 423, 437, 446, 454

Perandoria e Mesit — 297, 313
Pnom-Pen — 18, 34, 59
«Politika ndërkombëtare» (revista ~) — 119
Poloni — 130
Pragë — 127
Prishtinë (Jugosllavi) — 277

Q

Qipro — 11

R

Radio Moska — 93
Rafineria e Naftës — Ballsh (Fier) — 76, 260
Riad — 21
Rodezi — 107
ROJTER — 132
Romë — 57, 108

Rr

Rrashbull (Durrës) — 257

S

Sajgon — 20, 24, 51, 53, 55, 59
Sazan — 459
Selanik (Greqi) — 182
Sërbi — 99, 102
Sinkiang (Kinë) — 234
Siri — 11, 26
Slloveni — 99
Sofie — 104
Spanjë — 157, 330, 495-496
Split (Jugosllavi) — 321
Stamboll — 97
Suez (kanali ~) — 67
«Svjtnik» (gazeta ~) — 265-275

SH

Shangai (Kinë) — 139, 155, 165, 196, 199, 423, 472
Shën Naum — 101
Shkodër — 204
«Shqipëria e re» (revista ~) — 96

T

Tajlandë — 133, 202
Tajvan (Kinë) — 310, 311, 537
Tanshan (Kinë) — 378, 383
Taxhai (Kinë) — 160, 162, 467
Teheran — 22
Tiencin (Kinë) — 378
Tiranë — 204, 245, 328, 366, 378, 397, 493

TH

Thrakë (Greqi) — 97, 104

U

Uashington — 146, 284, 291, 305, 456
«Unita» (gazeta ~) — 262

V

Varshavë — 520
Vatikan — 125, 151, 152, 157, 327
Vermosh — 101
Vlorë — 204, 217, 459

Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 44, 45, 48-49, 124, 125, 126, 128, 264, 337-340, 343

ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~) — 160, 174, 294, 311, 467

LËNDA

1975

Faqe

1. — **17 janar 1975.** Shtrausi mik i Mao Ce Dunit 5
2. — **17 janar 1975.** Shënim 6
3. — **18 janar 1975.** Ten Hsiao Pini gradohet 7
4. — **21 janar 1975.** Vdiq babai i Emin Durakut 8
5. — **25 shkurt 1975.** Imperializmi amerikan dhe ai sovjetik përgatitin luftën e tretë botërore, por edhe i tremben asaj 9
6. — **1 prill 1975.** Formimi dhe zhvillimi i borgjezisë së re titiste jugosllave 13
7. — **2 prill 1975.** Luftë të pareshtur e të ashpër kundër superfuqive të errësirës e të gjakut 18
8. — **8 prill 1975.** De profundis tjetër për Shtetet e Bashkuara të Amerikës 24
9. — **17 prill 1975.** Pnom-Peni u çlirua — populli kamboxhian triumfoi mbi armiqtë e tij imperialistë 34
10. — **21 prill 1975.** Një vëzhgim i politikës ndërkombëtare në dritën e ngjarjeve dramatike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës 35
11. — **23 prill 1975.** Kinezët zvarritin vajtjen e një delegacioni shqiptar në Kinë 41
12. — **29 prill 1975.** Për provokatorin Mijal 44
13. — **30 prill 1975.** Përgjigjja që duhet t'i jepet polakut Mijal 48

	Faqe
14. — 30 prill 1975. Sajgoni u çlirua — fitore e madhe e popullit vietnamez	52
15. — 30 prill 1975. Vietnami i Jugut u çlirua	53
16. — 1 maj 1975. Shënim	56
17. — 3 maj 1975. Pozita e Kazhimiezh Mijalit është shumë e dyshimtë.	57
18. — 6 maj 1975. Fitore që duhet konsoliduar në rrugën marksiste-leniniste	59
19. — 18 maj 1975. Ten Hsiao Pini vizitoi Francën	61
20. — 20 maj 1975. Çu En Lai pret princeshën Ashraf	62
21. — 21 maj 1975. Jao Ven Juani pret delegacionin e Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë	63
22. — 22 maj 1975. Çu En Lai pret ministrin e Jashtëm të Lesotos	64
23. — 26 maj 1975. Çu En Lai pret një delegacion rumun	65
24. — 4 qershor 1975. Njeriu që bredh «hu më hu»	66
25. — 5 qershor 1975. U rihap kanali i Suezit	67
26. — 8 qershor 1975. Kim Ir Seni viziton miqtë e tij	68
27. — 9 qershor 1975. Lidhur me kreditë që nevojiten për pesëvjeçarin e gjashtë	69
28. — 16 qershor 1975. Takim me Sarin Çakun	70
29. — 17 qershor 1975. Të shpejtohet kërkesa për dëmshpërblimet nga RF e Gjermanisë	71
30. — 17 qershor 1975. Filloi presioni i fortë ekonomik kinez, por ne kurrë nuk do të thyhemi	72
31. — 18 qershor 1975. Kinezët nuk na japin të gjitha objektet industriale	78

	Faqe
32. — 21 qershor 1975. Kina po futet në ingranazhin e lojës politike të të dy superfuqive	80
33. — 25 qershor 1975. Rrugë armiqësore kundër Shqipërisë nga Çu En Lai e grupi i tij	89
34. — 2 korrik 1975. Ballkani, superfuqitë, Kina dhe ne	94
35. — 4 korrik 1975. Kina ka hyrë në vallen politike të borgjezisë	106
36. — 4 korrik 1975. Masakruesi i 500 mijë komunistëve indonezianë në Beograd	112
37. — 7 korrik 1975. Li Hsien Nieni vepron kundër Shqipërisë socialiste	115
38. — 7 korrik 1975. Pritje të mëdha sunduesve të Irakut	118
39. — 16 korrik 1975. Hedhim poshtë synimet armiqësore të titistëve dhe padronëve të tyre	119
40. — 19 korrik 1975. Shënim	122
41. — 21 korrik 1975. Shënim	123
42. — 22 korrik 1975. Kopaçe në kokë revizionistëve	124
43. — 27 korrik 1975. Do të demaskojmë qëllimet e vërteta të Konferencës së Helsinkit mbi «sigurimin evropian»	125
44. — 28 korrik 1975. Konferenca e pasigurisë së Evropës	126
45. — 31 korrik 1975. Konferenca e Helsinkit — një lojë infernale pa shpresa	127
46. — 31 korrik 1975. Politika kineze nuk ka bosht klasor proletar	134
47. — 5 gusht 1975. Qëndrimi i kinezëve ndaj nesh po keqësohet	141
48. — 21 gusht 1975. Veprime të çekuilibruara kineze	145

	Faqe
49. — 28 gusht 1975. Shënim	148
50. — 9 shtator 1975. Shoku Pedro Leon Arbole- do ra heroikisht	149
51. — 22 shtator 1975. Mao Ce Duni bisedon me Hithin	150
52. — 23 shtator 1975. Si duhet të jetë interesimi ynë për Kosovën e kosovarët	151
53. — 29 shtator 1975. Rumania dhe Kina kanë një vijë	153
54. — 30 shtator 1975. Asnjë fjalë nuk u tha në Kinë për heronjtë spanjollë	157
55. — 30 shtator 1975. Deklarata të Fosko Dinuçit	158
56. — 1 tetor 1975. Imperialistët amerikanë jo vetëm t'i demaskojmë, por edhe t'i luftoj- më	160
57. — 2 tetor 1975. Politika e jashtme e Kinës nuk është revolucionare	163
58. — 7 tetor 1975. Kina dhe Jugosllavia	171
59. — 10 tetor 1975. Mao Ce Duni pret Xhemal Bijediçin	177
60. — 14 tetor 1975. Ngrihet më lart autoriteti i vendit tonë	178
61. — 16 tetor 1975. Shënim	179
62. — 19 tetor 1975. Në shfaqjen e ansamblit ar- tistik të këngëve e valleve «Liaonin» të RP të Kinës	180
63. — 31 tetor 1975. Mao Ce Duni pret Helmut Shmidin	181
64. — 2 nëntor 1975. Grekët duhet ta dinë se ne nuk flemë	182
65. — 7 nëntor 1975. Katër yje që nuk do të shu- hen kurrë në tokën shqiptare	183

	Faqe
66. — 8 nëntor 1975. Asnjëherë të mos harrojmë rrezikun e armiqve fqinj	187
67. — 10 nëntor 1975. Ne jemi të shqetësuar se ç'do të ngjasë në Kinë pas vdekjes së Maos	190
68. — 14 nëntor 1975. Mao Ce Duni pret U Ne Vinin	192
69. — 19 nëntor 1975. Kina e Vietnamit janë zemëruar me njëri-tjetrin për çështje ku- fitare	193
70. — 21 nëntor 1975. Ç'thonë sot, nuk thonë nesër	194
71. — 22 nëntor 1975. Përse çirren titistët	195
72. — 3 dhjetor 1975. Fordi u prit nga Mao Ce Duni	196
73. — 6 dhjetor 1975. Shënim	203
74. — 7 dhjetor 1975. Triumfues e të mbushur me lavdi në gjirin e tokës mëmë	204
75. — 9 dhjetor 1975. Takim me Sihanukun	206
76. — 12 dhjetor 1975. Një njoftim që na ngroh ca	207
77. — 15 dhjetor 1975. Sihanuku ankohet për ru- munët	208
78. — 15 dhjetor 1975. Provokacion i rëndë i ti- tistëve	209
79. — 16 dhjetor 1975. Vdiq shoku Kan Shen	210
80. — 18 dhjetor 1975. Pozita të drejta të PK të Gjermanisë (m-l)	211
81. — 19 dhjetor 1975. Gjermanëve t'u jepet për- gjigjja që meritojnë	216
82. — 20 dhjetor 1975. Shënim	217
83. — 23 dhjetor 1975. Kinezët duan të sabotojnë forcën mbrojtëse të vendit tonë	218

1.	— 1 janar 1976. Zigzagjet e vijës kineze	221
2.	— 8 janar 1976. Vdiq Çu En Lai	238
3.	— 14 janar 1976. Në ambasadën kineze për ngushëllim	240
4.	— 18 janar 1976. T'u përgjigjemi sulmeve të revizionistëve jugosllavë	241
5.	— 19 janar 1976. Përgjigjja që u duhet dhënë grekëve Bicios dhe Karajanis	242
6.	— 20 janar 1976. Shënim	243
7.	— 22 janar 1976. Kinezët nuk propagandojnë vijën e drejtë të Partisë sonë	244
8.	— 23 janar 1976. Hezitim për zëvendësimin e Çu En Lait!	255
9.	— 26 janar 1976. Përgjigje e fortë revizionistëve jugosllavë	257
10.	— 29 janar 1976. Kinezët po ecin drejt bllokadës kundër Shqipërisë	258
11.	— 1 shkurt 1976. Shënim	261
12.	— 2 shkurt 1976. Të demaskojmë pikëpamjet likuidatore të revizionistëve	262
13.	— 3 shkurt 1976. Çështjet me rëndësi politiko-ideologjike ndërkombëtare duhen zërtëyer në mënyrë të posaçme për bazën e Partisë	263
14.	— 6 shkurt 1976. Djersë të ftohta korrespondentit të HSINHUA-së	264
15.	— 6 shkurt 1976. Intervistë vetëdemaskuese e Titos	265
16.	— 9 shkurt 1976. Në provokacionet e titistëve ne nuk biem	277
17.	— 11 shkurt 1976. Maoja vetë shkruan dhe vetë vulos	278

18.	— 12 shkurt 1976. Dacibao kundër Ten Hsiao Pinit	280
19.	— 25 shkurt 1976. Enigmë kineze, çoroditje maoiste	281
20.	— 1 mars 1976. Shënime për demaskimin e Kongresit të 25-të të PK të BS	286
21.	— 3 mars 1976. E sotmja është e turbullt, s'dihet ç'do të sjellë e nesërmja	290
22.	— 11 mars 1976. Kongresi i revizionistëve sovjetikë — kongres i demagogjisë dhe i ekspansionit socialimperialist	293
23.	— 12 mars 1976. Të demaskojmë përpjekjet e kinezëve për t'u përzier në punët e Ballkanit	294
24.	— 18 mars 1976. Vendim shumë i drejtë i Asamblesë Kombëtare të Egjiptit	295
25.	— 21 mars 1976. Çfarë e ndihmon dhe çfarë nuk e ndihmon sigurimin dhe bashkëpunimin e vërtetë të Ballkanit	296
26.	— 1 prill 1976. Ku ka qenë dhe ku po shkon Kina?	297
27.	— 7 prill 1976. Bie Ten Hsiao Pini, hipën Hua Kuo Feni	316
28.	— 15 prill 1976. PK të Holandës (m-l) t'i shpjegojmë vijën tonë	317
29.	— 20 prill 1976. Hap i rëndësishëm për forcimin e pavarësisë së Egjiptit	320
30.	— 20 prill 1976. Mao Ce Duni pret miq egjiptianë	326
31.	— 27 prill 1976. Analizë mbi gjendjen shumë shqetësuese në Itali	327
32.	— 29 prill 1976. Denoncojmë Jugosllavinë që u jep lehtësi portuale flotave ushtarake të	

	Faqe
SHBA dhe të BS	340
33. — 30 prill 1976. Kujdes për çështjen etnike	341
34. — 7 maj 1976. Kinezët kërkojnë agreement për një ambasador të ri që deri tash ka qenë në Moskë	342
35. — 12 maj 1976. Dy vërejtje për organet e shtypit	343
36. — 13 maj 1976. Komplotistët dhe tutorët e tyre	345
37. — 24 maj 1976. Sjellje të këqija të ambasadorit kinez në Tiranë	349
38. — 28 maj 1976. Maocedunideja	350
39. — 12 qershor 1976. Vija e Kinës është e djathtë	353
40. — 14 qershor 1976. Një mbledhje e ftohtë për të mjelur dhitë shterpa	356
41. — 24 qershor 1976. Në Kinë nuk veprojnë as partia, as shteti i proletariatit	360
42. — 6 korrik 1976. Vdiq Çu Deja	365
43. — 14 korrik 1976. Të presim me ngrohtësi ansamblet kosovare që vijnë në vendin tonë	366
44. — 17 korrik 1976. Politikë pa parim e shtetit të madh kinez	368
45. — 27 korrik 1976. Ngjarje historike për shkencën botërore	371
46. — 29 korrik 1976. Me ne kinezët ndjekin taktikën «hiq e mos e këput»	373
47. — 31 korrik 1976. Veprim që ia arriti qëllimit të tij të mirë	376
48. — 31 korrik 1976. Një çështje që duhet të ishte menduar më mirë më përpara	378
49. — 17 gusht 1976. Në Kinë ka pasur «njëqind	

	Faqe
rryma» dhe «njëqind shkolla»	380
50. — 24 gusht 1976. Kinezët po na krijojnë vështirësi	383
51. — 30 gusht 1976. Kjo gjendje nuk është as normale, as revolucionare	386
52. — 4 shtator 1976. Kinezët po shkelin angazhimet për objektet e metalurgjikut	388
53. — 5 shtator 1976. Shantazhe dhe bllokadë ekonomike të Kinës kundër Shqipërisë	389
54. — 7 shtator 1976. Shënim	394
55. — 9 shtator 1976. Vdiq Mao Ce Duni	395
56. — 10 shtator 1976. Ngushëllime në ambasadën kineze	398
57. — 21 shtator 1976. Fijet e komplotit çojnë edhe në Kinë	399
58. — 4 tetor 1976. Një vendim i PK të Kinës që dëmton marrëdhëniet internacionaliste midis partive komuniste	408
59. — 12 tetor 1976. Tragjedia e Kinës	409
60. — 13 tetor 1976. Kaos i madh në Kinë	415
61. — 14 tetor 1976. Që respekti të jetë reciprok	431
62. — 18 tetor 1976. Kinezët pengojnë importin tonë	432
63. — 22 tetor 1976. Kusari bërtet: «Kapeni kusarin!»	434
64. — 23 tetor 1976. Kështu duhet të ketë ndodhur me «katërshen»	436
65. — 25 tetor 1976. Të përpjetat e Hua Kuo Fenit	450
66. — 30 tetor 1976. Prita delegacionet e partive komuniste (m-l) që do të marrin pjesë në Kongresin e 7-të të PPSH	451
67. — 4 nëntor 1976. Takim me shokët e partive	

	Faqe
komuniste që ndodhen në Kongresin e Partisë sonë	452
68. — 5 nëntor 1976. T'ia them shokut Amazonas pikëpamjet tona ndaj vijës politike e teo- rike të Kinës	453
69. — 5 nëntor 1976. Qëndrim oportunist i Hillit	454
70. — 14 nëntor 1976. Tre antimarksistë të tërbuar	455
71. — 15 nëntor 1976. Bratislavë 1968	458
72. — 20 nëntor 1976. Një letër që nuk duhet bërë	459
73. — 25 nëntor 1976. Bisedë midis shokësh in- ternacionalistë	461
74. — 28 nëntor 1976. Luftë për pushtet	462
75. — 1 dhjetor 1976. Shokut Amazonas i folëm për mosmarrëveshjet tona me kinezët	465
76. — 1 dhjetor 1976. Një delegacion yni të marrë pjesë në Kongresin e PP të Vietnamit	466
77. — 2 dhjetor 1976. Parti e çoroditur	467
78. — 6 dhjetor 1976. Udhëheqje e pastabilizuar	472
79. — 7 dhjetor 1976. Për problemet e jashtme duhet punuar në mënyrë më të shkathët	478
80. — 9 dhjetor 1976. Notë kineze pa adresë dhe pa firmë	480
81. — 11 dhjetor 1976. Kinezët na nxjerrin pengesa të reja në fushën e marrëdhënieve tregtare	486
82. — 13 dhjetor 1976. Lakenjtë e kinezëve do të dështojnë	489
83. — 16 dhjetor 1976. Agjentët e Kinës po i nxjerrin veshët	493
84. — 25 dhjetor 1976. Metoda agjenturore për të përçarë lëvizjen komuniste botërore	515

	Faqe
85. — 28 dhjetor 1976. Disa mendime rreth «dekalogut» ballist të Mao Ce Dunit	518
86. — 31 dhjetor 1976. Strategjia kineze po pëson fiasko	540
Treguesi i lëndës	549
Treguesi i emrave	559
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	565

Ndreqje gabimi

Në faqen 567, në germën S, rreshti i dytë nga fundi, «Svjtnik» të lexohet «Vjesnik».